



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 15.7.2026, e cila filloi në orën 10:17

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina (Lidhja për Prishtinën) - kryesues i Kuvendit, Bekim Gashi (LDK), Fadil Aliu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Egzon Pacolli (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Etnik Mustafa (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Dhurata Jahaj - Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi - Osmani (LDK), Rifadije Sopi (LDK), Amir Simnica (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Muhamet Selmani (PDK), Agnesa Avdyli - Vitia (PDK), Elmi Fazliu (PDK), Ilirik Musliu (PDK), Yll Muriqi (PDK), Muhamet Ademi (PDK), Plator Gërdovci (PDK), Florian Beka (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fjolla Vukshinaj - Reçica (PDK), Trim Sylja (PDK), Mrika Limani - Myrtaj (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Jeta Dida - Bujari (LVV), Berita Abazi - Muhadri (LVV), Çlirim Gërbeshi (LVV), Feim Osmani (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Nexhmije Gjema (LVV), Lumnije Mikullovi (LVV), Leonora Shabani - Bajraktari (LVV), Enver Redenica (LVV), Kreshnik Smajlaj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Erblina Tahiraj (AAK), Teuta Kadiu - Gjinolli (Lidhja e Prishtinës), Arbentia Murseli - Haxholli (Lidhja e Prishtinës), Besa Shahini (PSD), Endrit Zabërgja (NISMA), Jeton Mehmeti (GUXO), Valbona Ajeti (e pavarur), Yll Bogaj (i pavarur), Betim Abdullahu (i pavarur).

Munguan:

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama - Kryetar, Besianë Musmurati - nënkryetare e Komunës, Valbona Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave, Zyhrije Pllana - drejtore e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, Leutrim Retkoceri - drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Gent Begolli - drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Bujar Gashi - drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Lulzim Fushtica - drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave, Driton Bardheci - drejtor i Drejtorisë së Administratës, Arianit Elshani - drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Albana Gjonbalaj - drejtore e Drejtorisë së Parqeve, Jeta Rafuna-Hasani - drejtore e Drejtorisë së Bujqësisë, Adelinë Sahiti - drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Geci - drejtor i Drejtorisë së Sportit, Pëllumb Bajçinovci - drejtor i Drejtorisë së Mobilitetit, Donat Gashi - drejtor i Drejtorisë së Rinisë, Agron Canolli - drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit, Rrezarta Aliu - drejtore e Drejtorisë së Turizmit, Bekim Brestovci - drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit,

Nora Cimili - drejtoresh e Drejtorisë së Transformimit, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të KFOR-it dhe të mediave.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina** - kryesues i Kuvendit.

Kryesuesi para se të fillonte me diskutimet për rendin e ditës, njoftoj për një ndryshim në përbërjen e Kuvendit. Agron Canolli zëvendësohet me anëtarin Muhamet Selmani i cili bëri betimin solemn dhe zyrtarisht mori detyrën si anëtarë i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi vazhdon mbledhjen më këtë:

REND DITE

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së dytë, tretë dhe të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të kryeqytetit;**
- 2. Propozim-vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit, nr. 01-020/0431224/26 të datës 2.3.2026 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 3. Propozim-vendimi për miratimin e lëvizjes së numrit të lejuar të të punësuarve në kuadër të Drejtorisë së Arsimit;**
- 4. Propozim-vendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane;**
- 5. Propozim-vendimi për caktimin e anëtarëve të komisionit për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukative-arsimore dhe aftësuese në kryeqytet;**
- 6. Propozim-vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve në ndërmarrjet publike të Komunës së Prishtinës;**
- 7. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Prishtina Parking";**
- 8. Pyetje dhe përgjigje;**
- 9. Të ndryshme.**

Gëzim Sveçla: - në emër të grupit të Lëvizjes Vetëvendosje, ngriti shqetësimin për moszbatimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal të Prishtinës. Ai theksoi se në rendin e ditës mungonin disa pika të parapara me plan, përfshirë raportin gjashtëmuor të punës së Kryetarit të Kryeqytetit, raportin financiar-buxhetor për periudhën 1 prill - 30 qershor, raportin e Komisionit Aksionar të ndërmarrjeve publike, si dhe shqyrtimin e raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2025. Sveçla kritikoi mungesën e raportimit të rregullt të kryetarit para Kuvendit, si dhe pjesëmarrjen e shkurtër të tij në mbledhje. Ai vlerësoi se Kuvendi Komunal nuk po zhvillon numrin e nevojshëm të mbledhjeve dhe nuk po trajton çështjet me rëndësi për qytetin. Gëzimi në emër të grupit të Lëvizjes Vetëvendosje, propozoi që në rendin e ditës të përfshihen: shqyrtimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2025, dhe propozoi që pika "Pyetje dhe përgjigje" të zhvendosej si pika e dytë e rendit të ditës, menjëherë pas miratimit të ekstraktit, me qëllim që drejtorët komunalë të jenë të pranishëm gjatë diskutimeve.

Berita Abazi – Muhadri: - propozoi si pikë të rendit të ditës; diskutim mbi rritjen e çmimeve të biletave të "Trafikut Urban".

Arbenita Murseli – Haxholli: - propozoi si pikë të rendit të ditës: ndryshimin e vendimit të komitetit për komunitete dhe kërkon që kjo pikë të jetë pika e dytë e rendit të ditës.

Besa Shahini: - propozoi si pikë të rendit të ditës; diskutim mbi rritjen e çmimeve të biletave të “Trafikut Urban”.

Endrit Zabërgja: - propozoi si pikë të rendit të ditës; diskutimin e kërkesës së banorëve të Bregut të Diellit.

Kryesuesi konstatoi se propozimi për pikë të rendit të ditës nga Gëzim Sveçla, “shqyrtimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2025”, me 15 vota për, 24 kundër, asnjë abstenim, nuk kalon.

Kryesuesi konstatoi se propozimi për pikë të rendit të ditës nga Gëzim Sveçla, që “pika e tetë pyetje dhe përgjigje të jetë pika e dytë e rendit të ditës”, me 16 vota për, 23 kundër, 2 abstenime, nuk kalon.

Kryesuesi konstatoi se propozimi për pikë të rendit të ditës nga Berita Abazi - Muhadri dhe Besa Shahini, “diskutim mbi rritjen e çmimeve të biletave të “Trafikut Urban”, me 19 vota për, 26 kundër, asnjë abstenim, nuk kalon.

Kryesuesi konstatoi se propozimi për pikë të rendit të ditës nga Arbenita Murseli - Haxholli, “ndryshimin e vendimit të komitetit për komunitete dhe kjo pikë të jetë pika e dytë e rendit të ditës”, me 26 vota për, 14 kundër, 4 abstenime, kalon.

Endrit Zabërgja: - theksoi se materiali ishte shpërndarë paraprakisht dhe duhej të ishte shqyrtuar nga të gjithë asamblistët. Ai propozoi që, nëse nuk ka pasur kohë për trajtimin e tij, çështja të shtyhet për seancën e radhës, me qëllim që banorëve t'u ofrohet një zgjidhje serioze.

Kryesuesi: - kërkoi sqarim nga asamblisti Endrit Zabërgja nëse propozimi nënkuptonte tërheqjen e pikës nga rendi i ditës.

Endrit Zabërgja: - konfirmoi se pika tërhiqet për t'u shqyrtuar në seancën e radhës, duke propozuar që ajo të procedohet paraprakisht edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa (KPF).

Gëzim Sveçla: - propozoi si pikë të rendit të ditës; diskutimin e kërkesës së banorëve të Bregut të Diellit.

Nexhmije Gjema: - ngriti shqetësimin për mungesën e përgjigjeve nga komuna ndaj një grupi qytetarësh, të cilët, sipas saj, kanë vazhduar t'u drejtohen institucioneve komunale dhe asamblistëve me kërkesat e tyre. Ajo theksoi se kjo paraqet pjesëmarrje qytetare që duhet të inkurajohet, e jo të injorohet. Gjema pyeti pse qytetarëve nuk u janë kthyer përgjigje dhe, nëse përgjigjet janë dërguar ndërkohë, pse asamblistët nuk janë njoftuar përmes kopjes së komunikimit (CC).

Kryesuesi: - i sqaroi zonjës Gjema se këto munden me u trajtu në pyetje dhe përgjigje ose në të ndryshme.

Fjolla Vukshinaj – Reçica: - duke iu referuar deklarimit të asamblistes Nexhmije Gjema lidhur me kërkesën e qytetarit Veton Kasapolli, sqaroi se atij i është kthyer përgjigje si nga ajo, ashtu edhe nga drejtori Pëllumb Bajçinovci. Ajo theksoi se, para se të ngrihen çështje të tilla në Kuvend,

është e rëndësishme të verifikohet nëse institucionet përkatëse kanë dhënë përgjigje. Fjolla tha se drejtori Bajčinovci ka trajtuar rastin në terren, ndërsa në komunikim ka qenë i përfshirë edhe Leutrim Retkoceri.

Kryesuesi konstatoi se propozimi për pikë të rendit të ditës nga Gëzim Sveçla, “diskutimin e kërkesës së banorëve të Bregut të Diellit”, me 16 vota për, 25 kundër, 2 abstenime, nuk kalon.

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për, 10 kundër, asnjë abstenim, miratohet rendi i ditës me ndryshime.

Pika e parë e rendit të ditës

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së dytë, tretë dhe të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për, asnjë kundër, 4 abstenime, miratohet ekstrakti i procesverbalit të seancës së dytë, tretë dhe të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e dytë e rendit të ditës.

Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 01-020/04-48094/26 të dt. 2.4.2026 për formimin e Komitetit për Komunitet.

Arbenita Murseli - Haxholli njoftoi se me kërkesë të Lidhjes së Prishtinës, propozohet zëvendësimi i anëtarit të Komitetit për Komunitete. Ajo propozoi që Betim Abdullahu të zëvendësohet nga Teuta Kadiu - Gjinolli.

Kryesuesi konstatoi se “Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 01-020/04-48094/26 të dt. 2.4.2026 për formimin e Komitetit për Komunitet”, miratohet me 28 vota për, 10 kundër, asnjë abstenim.

Pika e tretë e rendit të ditës

“Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër 01-020/0431224/26 të datës 2.3.2026 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa”.

Egzon Pacolli: - propozoi që Jeta Rafuna - Hasani (LDK), të zëvendësohet nga Donjeta Dragusha (LDK).

Fjolla Vukshinaj - Reçica propozoi që Leutrim Retkoceri (PDK), të zëvendësohet nga Plator Gërdovci (PDK), Agron Canolli (PDK) të zëvendësohet nga Muhamet Selmani (PDK).

Kryesuesi konstatoi se “Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit me nr. 01-020/0431224/26 të dt. 2.3.2026 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa”, miratohet me 30 vota për, 2 kundër, asnjë abstenim.

Pika e katërt e rendit të ditës.

“Propozim-vendimi për miratimin e lëvizjes së numrit të lejuar të të punësuarve në kuadër të Drejtorisë së Arsimit”.

Arianit Elshani: - kërkoi mbështetjen e Kuvendit Komunal për miratimin e vendimit që mundëson bartjen e vendeve të lira buxhetore për 25 punonjës të arsimit parashkollor, të cilët kanë qenë të angazhuar që nga viti i kaluar pa marrë pagë. Ai sqaroi se vendimi është harmonizuar me Drejtorinë e Financave dhe kërkohet për të mundësuar pagesën e tyre nga muaji i ardhshëm.

Gëzim Sveçla: - theksoi se edukatorët e angazhuara që nga muaji shtator kanë mbetur pa paga për shkak të një keqplanifikimi dhe vonesave në procedurat vendimmarrëse. Ai kritikoi prolongimin e çështjes, e cila sipas tij ka ardhur tri herë në Kuvendin Komunal, dhe shprehu mbështetjen për miratimin e vendimit, duke kërkuar mirëkuptim ndaj edukatoreve për vonesën në kompensimin e punës së tyre.

Arbenita Murseli - Haxholli: - deklaroi që Lidhja e Prishtinës e mbështet këtë pikë të rendit të ditës.

Fadil Aliu: - theksoi se kjo pikë po shqyrtohet për herë të tretë dhe se procedurat janë zhvilluar në përputhje me rekomandimet e Ministrisë së Financave. Ai sqaroi se vonesat kanë ardhur si pasojë e kërkesave për specifikim të saktë të numrit të vendeve të lira. Aliu ngriti shqetësimin se përkundër rritjes së numrit të banorëve dhe buxhetit të Komunës së Prishtinës, nuk është përditësuar numri i vendeve të lejuara të punës dhe kërkoi që Drejtoria e Financave dhe Burimet Njerëzore të adresojnë këtë kërkesë në Ministrinë e Financave për rritjen e numrit të vendeve të punës në përputhje me regjistrimin e fundit të popullsisë, me qëllim shmangien e problemeve të ngjashme në të ardhmen.

Kryesuesi konstatoi se “Propozim-vendimi për miratimin e lëvizjes së numrit të lejuar të të punësuarve në kuadër të Drejtorisë së Arsimit”, miratohet me 45 për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Pika e pestë e rendit të ditës.

“Propozim-vendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane”.

Driton Bardheci: - kërkoi nga grupet kuvendare të paraqesin propozimet e tyre për përbërjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, në përputhje me rregulloren në fuqi, me qëllim vazhdimin e procesit të zgjedhjes së këshillave lokalë.

Bekim Gashi: - në emër të grupit të LDK-së propozoi Egzon Pacollin.

Fjolla Vukshinaj-Reçica: - propozoi Florian Beka nga radhët e PDK-së.

Feim Osmani: - kërkoi që përveç formimit të komisionit për zgjedhjen dhe monitorimin e këshillave lokalë, të shqyrtohet edhe raporti i punës së komisionit të kaluar dhe të adresohen sfidat e hasura. Ai theksoi nevojën për ndryshimin e rregullores, veçanërisht për kompensimin financiar të kryetarëve të këshillave lokalë dhe për rregullimin e bashkëpunimit të administratës komunale me ta. Osmani shprehu shqetësim për mungesën e mbështetjes ndaj kërkesave të këshillave lokalë nga drejtoritë komunale dhe kërkoi që këto çështje të trajtohen me ndryshime konkrete në rregullore, dhe kërkoi sqarime për propozimin e përfaqësuesit nga shoqëria civile në komision. Ai njoftoi se grupi i Lëvizjes Vetëvendosje propozon Çlirim Gërbeshin si anëtar të komisionit.

Driton Bardheci- drejtor i Drejtorisë së Administratës: - dha sqarimet e nevojshme të kërkuara nga z. Osmani.

Endrit Gashi: - propozoi Erblina Tahiraj nga radhët e AAK-së.

Kryesuesi: - bëri të ditur se Kryetari nga ekzekutivi propozon Driton Bardhecin, nga shoqëria civile është propozuar Gresa Berisha.

Egzon Pacolli: - tërhiqet nga komisioni dhe kërkoi të zëvendësohet nga Milazim Vitia.

Enver Redenica: - ka mirëpritur emërimin e komisionit për vazhdimin e formimit dhe riformimit të këshillave lokalë të lagjeve të Prishtinës, duke theksuar rëndësinë e tyre si hallka e parë e komunikimit mes qytetarëve dhe institucioneve komunale. Ai ka ngritur shqetësime lidhur me proceset e deritashme zgjedhore në këshillat lokalë, duke kërkuar që zgjedhjet e ardhshme të jenë të drejta, transparente dhe të mbrojnë vullnetin e banorëve. Redenica ka kritikuar mungesën e trajtimit të kërkesave të kryetarëve të këshillave lokalë, duke theksuar se përgjigjet institucionale kanë qenë të pamjaftueshme dhe se kjo cenon funksionimin e këtyre strukturave. Ai ka kërkuar funksionalizimin e zyrave të këshillave lokalë, krijimin e kushteve më të mira për punë dhe pagesën e kompensimeve të papaguara për kryetarët e këshillave, duke theksuar se mungesa e mbështetjes institucionale demotivon angazhimin qytetar, dhe ju bënë thirrje komisionit të ri që të veprojë në interes të qytetarëve dhe jo të ndikimeve politike, duke kërkuar që fillimisht të zgjidhen problemet ekzistuese dhe më pas të organizohen zgjedhjet e reja për këshillat lokalë.

Arbenita Murseli – Haxholli: - ka mbështetur formimin e komisionit për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, duke theksuar se ato janë një urë lidhëse e rëndësishme mes qytetarëve dhe pushtetit lokal. Ajo ka inkurajuar banorët të angazhohen në këtë proces dhe i ka uruar sukses komisionit në përmbushjen e kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.

Kryesuesi: - i informoj të pranishmit se prej shtatë anëtarëve duhet të jenë tri të gjinisë femërore, prandaj LDK-ja donë t'a propozoi një emër.

Egzon Pacolli: - propozon Rifadije Sopi.

Kryesuesi konstatoi se “Propozim-vendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane”, miratohet me 37 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Pika e gjashtë e rendit të ditës

“Propozim-vendimi për caktimin e anëtarëve të komisionit për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukative-arsimore dhe aftësuese në kryeqytet”.

Arianit Elshani: - ka kërkuar miratimin e draft-vendimit për formimin e komisionit për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve arsimore, duke theksuar se duhet të plotësohen 23 pozita të lira. Ai ka sqaruar përbërjen e komisionit sipas udhëzimit administrativ të Ministrisë së Arsimit, si dhe ka njoftuar se procesi do të monitorohet nga përfaqësues të Këshillit të Prindërve dhe të mësimdhënësve. Elshani kërkoi mbështetjen e Kuvendit për miratimin e këtij draft-vendimi.

Gëzim Sveçla: - theksoi se komisioni për përzgjedhjen e menaxherëve të institucioneve shkollore ka rëndësi të veçantë, pasi vendimet e tij ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e udhëheqjes së shkollave dhe në edukimin e gjeneratave të ardhshme. Ai rikujtoi se në mandatin e kaluar formimi i një komisioni të ngjashëm nuk ishte mbështetur për shkak të shqetësimeve për politizimin e emërimeve, duke kërkuar që edhe tani të ketë garanci se procesi nuk do të ndikohet nga interesat partiake. Sveçla ngriti dyshime edhe për përbërjen e komisionit, duke vënë në pikëpyetje nëse kryesuesja e propozuar i plotëson kriteret e përcaktuara në rregullore, si dhe nëse është respektuar procedura për emërimin e saj. Ai kërkoi sqarime edhe për numrin e kandidatëve të propozuar dhe për paanshmërinë politike të anëtarëve të komisionit, dhe kritikoi përfshirjen e ish-drejtorit të shkollës në komision, duke përmendur çështjen nga mandati i tij ku në atë shkollë janë mbajtur ligjërata për gjykatën speciale, prandaj Lëvizja Vetëvendosje nuk do ta mbështesë formimin e këtij komisioni.

Betim Abdullahu: - kërkoi sqarim nga Drejtori i Arsimit për drejtorin Isak Bregaj, për shkak se shumica prej anëtarëve të Kuvendit komunal të Partisë Demokratike kan kërkuar shkarkimin e tij për shkak të pytesorëve që janë mbajtur në janar të këtij viti.

Lumnije Mikullovc: - theksoi rëndësinë e komisionit për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve arsimore, duke vlerësuar se cilësia e përbërjes së tij ndikon drejtpërdrejt në udhëheqjen e shkollave. Ajo kërkoi që komisioni të përbëhet nga persona me integritet, profesionalizëm dhe paanshmëri, në mënyrë që procesi i përzgjedhjes të jetë transparent, i drejtë dhe i bazuar në meritë. Mikullovc tha se çdo ndikim politik apo favorizim cenon besimin e qytetarëve në institucionet arsimore, prandaj procesi duhet të zhvillohet në përputhje me ligjin dhe në interesin më të mirë të arsimit në kryeqytet.

Besart Krasniqi: - ngriti shqetësime për mënyrën e zbatimit të mësimi tërëditor në SHFMU "Zenel Hajdini", duke theksuar se problemi nuk qëndron te koncepti i mësimi tërëditor, por te mungesa e kushteve për ta realizuar atë në mënyrë efektive. Ai përmendi mungesën e hapësirave të përshtatshme, faktin që nxënësit ushqehen në sallën e sportit duke kufizuar aktivitetet fizike, si dhe kostot dhe vështirësitë që u shkakton distanca nxënësve dhe prindërve. Krasniqi shtoi se, sipas prindërve, mungesa e aktiviteteve rekreative po ndikon edhe në mirëqenien e nxënësve, duke propozuar që shkollat të mbështeten me aktivitete sportive të rregullta jashtë ambienteve shkollore. Ai kërkoi gjithashtu sqarime nga Drejtoria e Arsimit për organizimin e vitit të ardhshëm shkollor në shkollat "Zenel Hajdini" dhe "Asim Vokshi", në mënyrë që mësimdhënësit, nxënësit dhe

prindërit të informohen me kohë. Ai kritikoi udhëheqjen komunale për mungesën e një zgjidhjeje konkrete për këtë çështje.

Jeta Dida–Bujari: - ngriti shqetësimin për mënyrën se si ishte zhvilluar procesi i emërimit dhe më pas anulimi i kontratave të 35 drejtorëve të shkollave në Prishtinë. Ajo theksoi se drejtorët u përballën me pasoja dhe parregullësi procedurale që, sipas saj, ishin përgjegjësi e administratës dhe jo e tyre, duke krijuar pasiguri në shkolla dhe duke cenuar integritetin profesional të drejtuesve. Ajo deklaroi se gjatë procesit kishte pasur ndërhyrje dhe përpjekje për të nxitur kandidime kundër drejtorëve në detyrë, gjë që, sipas saj, cenonte paanshmërinë e konkurrencës. Dida–Bujari tha se pavarësisht këtyre zhvillimeve, puna dhe rezultatet e shkollës vazhduan me sukses. Ajo kërkoi që proceset e ardhshme të emërimit të drejtorëve të zhvillohen me transparencë, profesionalizëm dhe respektim të ligjit, në mënyrë që të shmangen situata të ngjashme në të ardhmen.

Nënkryetarja- Besianë Musmurati: - deklaroi se procesi i rekrutimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave, gjatë kohës sa drejtonte Drejtorinë e Arsimit, ishte transparent dhe i bazuar në meritë. Ajo hodhi poshtë pretendimet për politizim, duke theksuar se përzgjedhjet nuk janë bërë mbi baza partiake, por sipas kriterëve profesionale dhe mbështeti përbërjen e komisionit të propozuar, duke vlerësuar kualifikimet dhe përvojën e anëtarëve të tij, si dhe u bëri thirrje asamblistëve që të mos e politizojnë procesin e emërimit të drejtuesve të institucioneve arsimore.

Gëzim Sveçla: - tha se ndryshimi i qëndrimit të Lëvizjes Vetëvendosje ndaj komisionit lidhet me zhvillimet politike të mëvonshme dhe me humbjen e besimit në qëllimet e udhëheqjes komunale. Ai theksoi se kundërshtimet e tij nuk kishin të bënin me përgatitjen profesionale të anëtarëve të propozuar, por me kërkesën e rregullores për paanshmëri politike, duke kërkuar që ky kriter të respektohet. Sveçla shtoi se emërimet duhet të bazohen në meritë dhe jo t'i atribuohen komisionit si favor politik. Ai kritikoi gjithashtu nënkryetaren për ndryshimin e qëndrimeve politike dhe tha se kjo ka ndikuar në humbjen e besimit ndaj veprimeve të saj dhe të udhëheqjes komunale.

Arianit Elshani; - iu përgjigj shqetësimeve të ngritura për përbërjen e komisionit, duke theksuar se nuk sheh bazë për pretendimet për ndikim politik dhe se çështjet e mundshme të konfliktit të interesit trajtohen nga institucionet përgjegjëse. Ai shtoi se lidhjet familjare apo perceptimet politike nuk duhet të ndikojnë në vlerësimin e anëtarëve të komisionit. Elshani foli edhe për organizimin e mësimin në shkollat "Zenel Hajdini" dhe "Asim Vokshi", ku i njoftoi se brenda javës do të jepet një përgjigje zyrtare për organizimin e vitit të ardhshëm shkollor, pasi planifikimet nga të dy shkollat tashmë kanë përfunduar.

Jeta Dida–Bujari bëri thirrje që arsimi në kryeqytet të mbetet i depolitizuar, duke theksuar se drejtuesit e institucioneve arsimore duhet të jenë të paanshëm politikisht. Ajo vlerësoi se i njëjti standard duhet të zbatohet edhe nga Drejtoria Komunale e Arsimit, në mënyrë që të ruhet besimi në proceset e emërimit dhe menaxhimit të shkollave. Dida–Bujari kërkoi që çështjet e arsimit të trajtohen me seriozitet dhe të vendosen mbi interesat partiake, duke theksuar se prioritet duhet të jetë interesi i fëmijëve dhe cilësia e sistemit arsimor.

Çlirim Gërbeshi: - kritikoi heshtjen e përfaqësuesve të PDK-së lidhur me një ish-drejtor shkolle, duke rikujtuar kundërshtimet që sipas tij kjo parti kishte shprehur më herët ndaj tij. Ai përmendi

rastin e mbajtjes së ligjëratave për Gjykatën Speciale në atë institucion dhe kërkoi qëndrime më të qarta nga PDK-ja për këtë çështje.

Kryesuesi konstatoi se “Propozim-vendimi për caktimin e anëtarëve të komisionit për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve edukative-arsimore dhe aftësuese në kryeqytet”, miratohet me 26 vota për, 13 kundër, 1 abstenim.

Pika e shtatë e rendit të ditës

“Propozim-vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve në ndërmarrjet publike të komunës së Prishtinës”

Egzon Pacolli: - nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës propozoi për aksionar në ndërmarrjen “Sport Marketing” Vedat Jashari dhe Astrit Gashi.

Kryesuesi konstatoi se “Propozim-vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve në ndërmarrjet publike të komunës së Prishtinës”, miratohet me 25 vota për, 4 kundër, 1 abstenim..

Pika e tetë e rendit të ditës

“Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL ”Prishtina Parking”

Valbona Makolli- drejtore e Drejtorisë së Financave: - paraqiti propozim-vendimin e plotësuar me vlerën përkatëse, duke marrë parasysh situatën e ngarkuar të ndërmarrjes “Prishtina Parking”. Ajo propozoi ndarjen e mjeteve në vlerë prej 100.000 euro nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, kodi ekonomik 16306, materialet dhe arsyetimet përkatëse i gjeni të bashkëngjitura në dokumentacionin e dërguar.

Nora Kelmendi: - paraqiti vërejtjet lidhur me propozim-vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për NPL “Prishtina Parking”. Ajo theksoi se dokumentacioni i dorëzuar përmban vetëm bazën ligjore dhe dispozitivin e vendimit, ndërsa mungojnë analiza financiare, arsyetimi faktik dhe juridik, si dhe sqarimet për përdorimin e mjeteve në vlerë prej 100.000 euro. Ajo kërkoi sqarime për përzgjedhjen e kodit ekonomik 16306, ndikimin e ndarjes në buxhetin komunal, si dhe arsyetimin e shumës së propozuar, duke theksuar se kërkesa e ndërmarrjes nuk mund të zëvendësojë vlerësimin e komunës. Nora tha se mungon analiza që do të justifikonte nevojën për subvencionim dhe lidhja e tij me interesin publik, ndërsa arsyetimi për vazhdimin e shërbimeve dhe mbulimin e obligimeve emergjente është i përgjithshëm dhe nuk paraqet pasoja konkrete për qytetarët. Kelmendi vlerësoi se vendimi nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm faktik dhe juridik dhe kërkoi që të ketë një shqyrtim më të plotë para miratimit në Kuvendin Komunal.

Enver Redenica: - ka kundërshtuar ndarjen e mjeteve nga taksat e qytetarëve për NPL “Prishtina Parking”, duke kërkuar fillimisht një hetim të plotë mbi menaxhimin dhe gjendjen financiare të ndërmarrjes. Ai ka pretenduar se ka pasur keqpërdorime të parasë publike dhe ka kërkuar që përgjegjësit të japin llogari para organeve të drejtësisë. Ai ka theksuar se mbështetja për ndërmarrjen dhe punëtorët e saj duhet të bëhet vetëm pas publikimit të raporteve të detajuara për

mënyrën e shpenzimit të fondeve, dhe ngriti shqetësime për funksionimin e sistemit të parkingut dhe tarifën ndaj qytetarëve, duke kërkuar hetim për këto pretendime. Redenica ka bërë thirrje që prokuroria të hetojë rastet e pretenduara të keqpërdorimit të zyrtarëve të përfshirë, duke theksuar nevojën për mbrojtjen e parasë publike dhe interesin e qytetarëve të Prishtinës.

Lumnije Mikullovc: - ka theksuar rëndësinë e shërbimit që ofron NPL “Prishtina Parking” për qytetarët dhe ka kërkuar trajtim dinjitoz për punëtorët e saj. Ajo ka theksuar se çdo ndarje e mjeteve financiare duhet të shoqërohet me transparencë të plotë, plan të qartë të shpenzimit dhe masa konkrete për shmangien e problemeve të ngjashme në të ardhmen dhe kërkoi që qytetarët të informohen për arsyet që e kanë quar ndërmarrjen në këtë gjendjen, dhe ka insistuar në respektimin e pagave dhe të drejtave të punëtorëve.

Feim Osmani: - tha se nuk e mbështet ndarjen e 100.000 euro, për NPL “Prishtina Parking” duke vlerësuar se arsyetimi i paraqitur është minimal dhe nuk ofron sqarime të mjaftueshme për mënyrën se si do të përdoren mjetet. Ai tha se një ndërmarrje me potencial të madh financiar duhet të paraqesë një plan të mirëfilltë biznesi për zhvillimin dhe zgjerimin e shërbimeve, e jo vetëm kërkesa për mbështetje financiare, dhe propozoi formimin e një komisioni nga Kuvendi Komunal për të hetuar punën pesëvjeçare të menaxhmentit të ndërmarrjes dhe kërkoi harmonizimin e rregullores me vendimet e gjykatës kompetente. Osmani theksoi se pa ndërmarrjen e këtyre hapave, nuk duhet të miratohet mbështetje financiare, pasi kjo do të mund të inkurajonte vazhdimin e keqmenaxhimit dhe keqpërdorimeve.

Ilirik Musliu: - tha se gjendja financiare e NPL “Prishtina Parking” është rënduar pas vendimit të gjykatës që ka shfuqizuar një pjesë të rregullores për parkingje, gjë që ka ndikuar drejtpërdrejt në uljen e të hyrave të ndërmarrjes. Ai vlerësoi se subvencioni prej 100.000 euro është një hap pozitiv, por theksoi se kjo shumë nuk është e mjaftueshme për të zgjidhur problemet financiare, duke përmendur obligimet e konsiderueshme për paga, furnitorë dhe qira. Musliu u shpreh se mbështet subvencionimin në parim, por jo shumën e propozuar, pasi ajo vetëm do ta shtyjë përkohësisht krizën financiare dhe bëri thirrje që ekzekutivi dhe Kuvendi Komunal të bashkëpunojnë për të sjellë sa më shpejt një propozim më serioz dhe më gjithëpërfshirës, i cili do t'i sigurojë ndërmarrjes stabilitet financiar dhe funksionim të qëndrueshëm, duke shmangur përsëritjen e problemeve me pagesat e punëtorëve dhe detyrimeve të tjera.

Nexhmije Gjema: - tha se dokumentacioni financiar i NPL “Prishtina Parking” u është dorëzuar asamblistëve vetëm një ditë para seancës, pa shënime shpjeguese, raport të auditorit, analizë krahasuese dhe sqarime të mjaftueshme, duke e bërë të pamundur një shqyrtim serioz të kërkesës për subvencionim. Ajo theksoi se nuk mund të kërkojë miratimi i ndarjes së mjeteve për një ndërmarrje me kapital negativ dhe mbi 2.5 milionë euro detyrime pa transparencë dhe dokumentacion të plotë. Gjema vuri në dukje se ndërmarrja kishte kaluar nga fitimi në vitin 2024 në një humbje të konsiderueshme në vitet 2025–2026, ndërsa detyrimet ishin rritur ndjeshëm brenda një periudhe të shkurtër. Ajo ngriti shqetësime për efektin e subvencionit prej 100 mijë euro përballë humbjeve dhe detyrimeve të mëdha, duke kërkuar një vizion dhe plan të qartë për të ardhmen e ndërmarrjes dhe mënyrën se si do të sigurohet qëndrueshmëria e saj financiare.

Çlirim Gërbeshi: - ngriti shqetësime lidhur me vendosjen e NPL “Prishtina Parking” në një objekt me qira, duke pretenduar se objekti është në pronësi të një personi të lidhur me LDK-në. Ai pyeti

për arsyet e ndryshimit të lokacionit të ndërmarrjes dhe shprehu dyshime se kjo ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve për qira, në kohën kur ndërmarrja po përballlet me vështirësi financiare dhe vonesa në pagesën e pagave të punëtorëve. Ai e cilësoi situatën si të papranueshme dhe kërkoi llogaridhënie për menaxhimin e ndërmarrjes.

Gëzim Sveçla: - tha se nuk e sheh si zgjidhje subvencionimin e vazhdueshëm të ndërmarrjeve publike me taksat e qytetarëve, duke vlerësuar se problemi kryesor të NPL “Prishtina Parking” është keqmenaxhimi dhe jo mungesa e mjeteve financiare. Ai theksoi se çdo subvencion duhet të lidhet me projekte konkrete që përmirësojnë shërbimet dhe qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjes, e jo të përdoret për mbulimin e pasojave të menaxhimit të dobët. Sveçla ngriti shqetësime për mungesën e llogaridhënies lidhur me gjendjen e ndërmarrjes, duke përmendur pretendime për keqmenaxhim, projektin e dështuar të digjitalizimit dhe vonesat në harmonizimin e rregullores pas vendimit të gjykatës. Ai vlerësoi se ekzekutivi ka përgjegjësi për rikthimin e ligjshmërisë dhe krijimin e kushteve që ndërmarrja të vetëfinancohet, ndërsa paralajmëroi se subvencionet pa reforma do të qojnë në përsëritjen e problemeve edhe në ndërmarrje të tjera publike.

Kryesuesi konstatoi se “Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL “Prishtina Parking”, miratohet me 33 vota për, 10 kundër, 1 abstenim.

Pika e nëntë e rendit të ditës

Pyetje dhe përgjigje

Trim Sylja, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale:

- Cila është gjendja aktuale e projektit të kolektorit në lagjen Kalabria, duke theksuar se punimet kanë kohë që janë duke u zhvilluar dhe se banorët, veçanërisht gjatë muajve të verës, vazhdojnë të përballen me kundërmimin e rëndë. Ai kërkoi gjithashtu të dijë se cili është afati i planifikuar për përfundimin e punimeve.

Kushtrim Sopa, për drejtorin e Drejtorisë së Sportit, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit, për drejtorin e Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave:

- A do të respektohen rekomandimet mjekësore për një punonjëse të Ndërmarrjes Publike Banesore, e cila sipas vlerësimit të mjekësisë së punës nuk është e aftë për sforcime pune?
- A do të përfshihet Klubi i Boksit për Femra "Dodona" në programin e mbështetjes financiare të Komunës?
- Kur do të rregullohet ndriçimi publik në rrugët “**Aleksandër Molosi**”, “**Bedri Dedja**” në Shkabaj dhe “**Stamboll**” në lagjen Arbëria, ku një pjesë e shtyllave nuk janë funksionale?
- Kur do të bëhet sanimi dhe izolimi i kulmit të objektit C13 në Ulpianë, në rrugën "17 Shkurti", për shkak të problemeve me lagështinë?
- A do të shqyrtohet mundësia e uljes së çmimit të qirasë për kioskat në sheshin e kryeqytetit?
- Kur do të trajtohet kërkesa për vendosjen e një lifti në një objekt banesor në rrugën “**Afrim Maliqi**” në lagjen Bregu i Diellit, ku banojnë persona me aftësi të kufizuara?

- Çfarë veprimesh do të ndërmerren lidhur me ankesat e banorëve të rrugës “**Zia Shemsiu**” në Ulpianë për një objekt që pretendohet se po përdoret si vend i improvizuar fetar?
- Kur do të trajtohen problemet me qentë endacakë, vendosjen e kamerave të sigurisë dhe para ndërtesës S12 në rrugën “**Zia Shemsiu**” largimi i shitësve ambulantë që pengojnë qarkullimin në trotuaret e lagjes Ulpianë?

Enver Redenica, për drejtoren e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Mobilitetit :

- Kur do të zgjidhet problemi i ujërave të zeza në zonën e Taukbahçes, i cili po shkakton kundërmim dhe po shqetëson qytetarët që frekuentojnë parkun e Taukbahçes dhe Gërmisë?
- Cili është plani konkret dhe afati për trajtimin e kësaj çështjeje, duke përfshirë zgjidhjen nga burimi i problemit dhe jo vetëm ndërhyrjet sipërfaqësore?
- Ku përfundojnë ujërat e zeza të cilat aktualisht pretendohet se janë rregulluar dhe a vazhdojnë të derdhen në zonën e Taukbahçes?
- Kur do të trajtohet kërkesa për vendosjen e masave të sigurisë në rrugën “**Nazim Gafurri**”, afër Viva Fresh, përfshirë ngritjen e asfaltit për ngadalësimin e shpejtësisë së automjeteve, vendosjen e vijave për këmbësorë dhe krijimin e një stacioni të autobusit?
- Kur do të hapet një hyrje-dalje më e përshtatshme në parkun e Taukbahçes, në mënyrë që qytetarët të mos detyrohen të kalojnë mbi rrethojat duke rrezikuar sigurinë e tyre?
- A do të shqyrtohet largimi i rrethojave në parkun e Taukbahçes, me qëllim që qytetarët të kenë liri më të madhe të lëvizjes, sikurse në parqet e tjera të qytetit?
- Kur do të trajtohet çështja e burimeve natyrore të ujit në Taukbahçe, të cilat sipas tij janë tjetërsuar dhe nuk janë më në funksion të qytetarëve?
- A do të ndërmerren masa nga Drejtoria e Inspeksionit për kthimin dhe mbrojtjen e këtyre burimeve natyrore, në interes të qytetarëve, natyrës dhe biodiversitetit?

Besart Krasniqi, për drejtoren e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Mobilitetit, për drejtoren e Drejtorisë së Parqeve, për drejtorin e Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave:

- Kur do të fillojë rehabilitimi i rrugës “**Xhavit Berisha**”, e cila lidh lagjen Kodra e Trimave me Shkabajn?
- Kur do të realizohet asfaltimi dhe rregullimi i rrugëve “**Beqir Sadiku**”, “**Arena Taçi**”, “**Besnik Lajqi**”, “**Daniel Defo**”, “**Gryka e Llapushnikut**” dhe rrugëve të tjera në Kodrën e Trimave, për të cilat janë bërë vazhdimisht kërkesa?
- Kur do të sanohen gungat në segmentin e rrugës “**Fahri Fazliu**”, para semaforëve të Xhamia e Llapit, që prej katër vitesh po shkaktojnë dëmtime të automjeteve dhe vështirësi në qarkullim?
- Kur do të rregullohet ndriçimi publik në rrugët “**Mon Balaj**”, “**Asllan Pireva**”, “**27 Nëntori**”, “**Afrim Krasniqi**”, “**Tafil Boletini**”, “**Aziz Zhilivoda**” dhe rrugët e tjera të Kodrës së Trimave, si dhe kur do të zgjidhet problemi i ndriçimit që mbetet i ndezur gjatë ditës në rrugën “**Ibrahim Kelmendi**”?
- Kur do të fillojë ndërtimi i dy degëzimeve që lidhen me rrugën “**Sofra e Gollakut**” në Grashticën e Epërme, projekt i premtuar gjatë fushatës zgjedhore?

- Kur do të vendosen stacionet e autobusëve për linjat 7 dhe 7A në rrugën “**Haxhi Zeka**” dhe në lokacionet e tjera ku mungojnë?
- Çfarë masash konkrete do të ndërmarrë Komuna për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave dhe zgjidhjen e problemet të qenve endacak?
- A planifikohet rishikimi dhe ulja e tarifave për shitësit ambulantë që ushtrojnë veprimtarinë në sheshin e Prishtinës, duke marrë parasysh premtimet e dhëna dhe barrën financiare që ata përballojnë?
- Kur do të bëhet pastrimi i mbledhësve të ujërave atmosferike në Kodrën e Trimave dhe në lagjet e tjera të Prishtinës, si Bregu i Diellit dhe Dardania, për të parandaluar përmytjet gjatë reshjeve?
- Kur do të vendosen shporta të reja për mbeturina në hapësirat publike dhe në stacionet e autobusëve në kryeqytet?
- Pse nuk janë mbjellë lule në hapësirat e dedikuara në qendër të Prishtinës, përfshirë rreth rrotullimin të fontana përballë Komunës, dhe cili është plani i ndërmarrjes “Gjelbër” për mirëmbajtjen dhe zbukurimin e hapësirave publike?

Feim Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, për drejtorin e Drejtorisë së Parqeve, për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- A është bërë vlerësim profesional i urave të ndërtuara në fshatin Sharban dhe a planifikon komuna të ndërmarrë masa korrigjuese, duke përfshirë ndërtimin e mureve mbrojtëse për të parandaluar dëmtimin e pronave private dhe pronës së xhamisë nga vërshimet?
- Kur do të fillojë pastrimi i shkurreve përgjatë rrugëve, veçanërisht në zonat rurale dhe fshatrat më të frekuentuara, ku ato po pengojnë qarkullimin e automjeteve dhe këmbësorëve?
- A është realizuar faza e radhës e dezinfektimit në territorin e Komunës së Prishtinës? Nëse jo, cila është arsyeja e vonës dhe kur pritet të përfundojë?
- Çfarë masash do të ndërmerren për të siguruar pjesëmarrjen e drejtorëve komunalë në mbledhjet e komiteteve të përhershme, kur ata ftohen për raportim?
- A do t’i marrë parasysh ekzekutivi komunal prioritetet dhe propozimet e paraqitura nga kryetarët e këshillave lokalë gjatë dëgjimeve publike, në mënyrë që ato të reflektojnë vullnetin e qytetarëve?
- A do të rishikojë Drejtoria e Shërbimeve Publike vendosjen e pengesave në rrugën “**Njësi Buna**” në Besi, Rimanishtë dhe a planifikon largimin e tyre, nëse konstatohet se janë vendosur në mënyrë të gabuar dhe po pengojnë qarkullimin?

Ilirik Musliu, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- A do ta shqyrtojë Komuna e Prishtinës kërkesën e operatorëve privatë të transportit publik për shtyrjen e afatit deri më **31 dhjetor 2026**, për dorëzimin e marrëveshjeve ose kontratave që dëshmojnë procesin e modernizimit të flotës së autobusëve, duke marrë parasysh vonesat e pagesave nga Komuna, vështirësitë financiare me të cilat janë përballur operatorët dhe nevojën për të siguruar vazhdimësinë e transportit publik?

Lumnije Mikullovc, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtoreshën e Drejtorisë së Investimeve Kapitale:

- Kur do të zgjidhet përfundimisht problemi i furnizimit me ujë të pijshëm në Bërnicën e Epërme dhe çfarë masash konkrete do të ndërmerren për të siguruar furnizim të rregullt për të gjithë banorët?
- Pse një pjesë e Bërnicës furnizohet rregullisht me ujë, ndërsa një pjesë e madhe e Bërnicës së Epërme vazhdon të mbetet pa ujë të pijshëm?
- Kur do të asfaltohen rrugicat anësore në Bërnicën e Epërme që ende kanë mbetur të paasfaltuara dhe po shkaktojnë vështirësi në lëvizje, veçanërisht gjatë reshjeve?
- Kur do të përmirësohet mirëmbajtja e ndriçimit publik në Bërnicën e Epërme, përfshirë zëvendësimin në kohë të poçave të djegur dhe funksionalizimin e plotë të rrjetit të ndriçimit?
- Çfarë investimesh konkrete planifikon Komuna për përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike në Bërnicën e Epërme, duke pasur parasysh mungesën e investimeve në këtë zonë?

Gëzim Sveçla, për drejtoreshën e Drejtorisë së Financave, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për Kryetarin ose nënkryetaren:

- Pse raporti financiar për tremujorin e dytë nuk është përfshirë në rendin e ditës të kësaj mbledhjeje të Kuvendit Komunal?
- Sa mjete financiare janë ekzekutuar përmes përmbarimit gjatë gjashtë muajve të parë të vitit dhe sa janë detyrimet ose pretendimet e parashikuara për pjesën e mbetur të vitit?
- Cilat janë arsyet e pagesës së rreth 2.4 milionë eurove përmes procedurave përmbarimore gjatë tri viteve të fundit dhe çfarë masash janë ndërmarrë për të parandaluar krijimin e detyrimeve të reja?
- Cilat masa konkrete po ndërmerr Komuna për zgjidhjen e gjendjes me menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e shëndetit publik në kryeqytet?
- A ka aktualisht operatorë privatë që ofrojnë shërbime të menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Prishtinës dhe, nëse po, a janë kontratat e tyre në përputhje me Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave dhe legjislacionin në fuqi?
- Cila është gjendja e zbatimit të dy projekteve të realizuara përmes UNDP-së, me vlerë rreth 5.3 milionë euro, dhe si është monitoruar përdorimi i këtyre mjeteve nga Komuna?
- Mbi çfarë baze ligjore është dhënë në shfrytëzim një pjesë e objektit të Gërmisë një operatori ekonomik pa vendim të Kuvendit Komunal dhe çfarë përfitimi financiar ka Komuna nga kjo marrëveshje?

Fjolla Vukshinaj Reçica, për drejtorin e Drejtorisë së Mobilitetit:

- A është hartuar dhe miratuar Plani i Biznesit i Trafikut Urban për vitin 2026 dhe, nëse po, kur do të publikohet për qytetarët në faqen zyrtare të Trafikut Urban?
- Cilat janë hapat konkretë që planifikohen për procesin e digjitalizimit të Trafikut Urban gjatë gjashtë muajve të ardhshëm dhe gjatë vitit 2026?
- A parashihet krijimi i një platforme të vetme digjitale që do të integrojë operatorët publikë dhe privatë të transportit urban?

- A do të sinkronizohet kuleta digjitale me sistemin e Trafikut Urban dhe cilat shërbime të reja do të ofrojnë ky proces për qytetarët?
- A janë bazuar vendimet për digjitalizimin e Trafikut Urban në analiza dhe të dhëna konkrete mbi nevojat dhe përdorimin e transportit publik?
- Si do të trajtohen qytetarët që nuk përdorin kuletën digjitale dhe çfarë alternativash ose lehtësirash do të ofrohen për ta në sistemin e ri të biletimit?

Leonora Shabani-Bajraktari, për drejtorin e Drejtorisë së Mobilitetit, për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale:

- Kur do të shpallet konkursi për punësimin e asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta?
- Pse Komuna e Prishtinës ende nuk ka ofruar asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta në zonat rurale dhe fshatrat përreth Prishtinës, dhe cilat masa do të ndërmerren për t'a adresuar këtë mungesë?
- A planifikohet të mundësohet transport publik në rrugën “**Malush Kosova**”, duke qenë se është një nga rrugët pa mbulim me linjë të transportit publik në lagjen **Mati 1**?
- Çfarë masash do të ndërmarrë Komuna për të kufizuar qarkullimin e kamionëve me ngarkesa të rënda që po dëmtojnë rrugët dhe po rrezikojnë sigurinë e banorëve në lagjen **Matiçan**?
- A është planifikuar ndërtimi i trotuareve në rrugët e lagjes **Matiçan**, për të rritur sigurinë dhe përmirësuar qasjen e këmbësorëve?

Nexhmije Gjema për Kryetarin Përparim Rama:

- Pse Komuna e Prishtinës po vazhdon zgjerimin e shesheve pa transparencë të plotë dhe pa miratimin e Kuvendit Komunal dhe qytetarëve?
- Pse projekti i sheshit "Gjorgj Bush" ka filluar dhe po vazhdon vetëm me një projekt ideor, pa projektin kryesor dhe pa lejen e nevojshme të punës?
- Si është e mundur që kontrata fillestare prej 18 milionë eurosh është rritur me 1,279,459 euro për punë shtesë?
- Pse janë shtuar edhe rreth 80 mijë euro të tjera me arsyetimin e "punëve të paparashikuara" për rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit, kur rrjetet e ujësjellësit, kanalizimit dhe energjisë elektrike zakonisht duhet të jenë të njohura në fazën e projektimit?
- Nëse tashmë në fillim të projektit janë paraqitur disa punë të paparashikuara, sa punë të tjera shtesë pritet të shfaqen gjatë realizimit të projektit dhe sa do të rritet kostoja përfundimtare?
- Pse Komuna po hap konkurse ndërkombëtare për projekte si varrezat e kryeqytetit dhe monumentet, kur janë ndarë 12 milionë euro për Zyrën e Arkitektit të Kryeqytetit?
- Çfarë pune konkrete ka realizuar Zyra e Arkitektit të Kryeqytetit dhe cilat projekte ka projektuar ose përfunduar deri më tani?
- Ku janë shpenzuar 12 milionë eurot e ndara për Zyrën e Arkitektit të Kryeqytetit?
- Pse janë ndarë edhe 20 mijë euro për një konsulent të jashtëm për menaxhimin e projekteve?
- Për cilat projekte është angazhuar ky konsulent, kush është ai dhe pse është konsideruar i nevojshëm?
- Nëse Komuna tashmë ka një zyrë dhe staf përgjegjës për menaxhimin e projekteve, pse është angazhuar një ekspert i jashtëm?

- Pse u krijua Zyra e Arkitektit të Kryeqytetit duke anashkaluar stafin profesional ekzistues të Komunës, përfshirë arkitektët, inxhinierët dhe urbanistët?
- A është nënvlerësuar dhe përjashtuar nga procesi profesional stafi ekzistues i Komunës me krijimin e kësaj zyre?

Mrika Limani-Myrtaj, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, për drejtorin e Drejtorisë së Sportit:

- A keni plan konkret në lagjen Mati 1 të bëni rritjen e numrit të pikave të grumbullimit të mbeturinave dhe rritjen e numrit të kontinjerëve?
- A keni plan konkret për fushën e sportit në shkollën SHFMU “Pavarësia” që ka mbi 3 vite që është nisur po ende nuk është përfunduar, a keni afate kur keni me përfundu sepse gjendja fushës së sportit dhe e oborrit të shkollës është shumë e keqe?

Muhamet Selmani, për drejtorin e Drejtorisë së Mobilitetit, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Sportit:

- ☐ Kur do të vendosen pengesa fizike ose zgjidhje të tjera në rrugën “**Nora Hoti**”, për të parandaluar aksidentet dhe për të rritur sigurinë e banorëve?
- ☐ Çfarë masash do të ndërmerren për të zgjidhur problemet e qarkullimit dhe parkimit në kryqëzimin e rrugëve “**Nora Hoti**”, “**Bashkim Fehmiu**” dhe “**Radovan Zogoviq**”, në mënyrë që të lehtësohet kyçja e banorëve në rrugën kryesore?
- ☐ Kur do të përfundojë projekti i varrezave të fshatit Barilevë dhe cilat veprime do të ndërmerren për të parandaluar ndërtimin e varrezave pa lejen e Komunës?
- ☐ Pse është zvarritur për rreth 35 muaj përfundimi i punimeve në rrugën “**Bashkim Fehmiu**” dhe kur pritet të përfundojë ky projekt?
- ☐ Cilat masa do të ndërmarrë Drejtoria e Sportit për rindërtimin dhe funksionalizimin e fushës sportive në Barilevë?

Drejtoresha për Financa- Valbona Makolli: - sqaroi se raporti gjashtëmujor i punës nuk është përfshirë në këtë seancë, pasi kërkesa për rendin e ditës është bërë para përfundimit të periudhës raportuese më 30 qershor. Ajo bëri të ditur se raporti është pothuajse i përfunduar, ndodhet në proces lekturimi dhe do t’i dorëzohet kryesuesit më së largu të premtën, me qëllim që të shqyrtohet në seancën e radhës para pushimit veror. Drejtoresha njoftoi për rastet përmbare se vlera e tyre për periudhën gjashtëmujore është rreth **12.8 milionë euro**. Ajo shtoi se të gjitha detajet sipas kategorive të shpenzimeve dhe investimeve kapitale do të paraqiten në raportin e TM2.

Nënkryetarja - Besianë Musmurati: - dhe sqarime për marrëveshjen me UNDP-në, dhe bëri të ditur se ka zhvilluar takime dhe është duke analizuar çështjen e ngritur nga auditori. Ajo theksoi se, sipas vlerësimit të saj paraprak, marrëveshja është në dobi të qytetarëve të Prishtinës dhe se marrëveshje të ngjashme janë lidhur edhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe shumica e komunave. Besiana tha se mbetet e paqartë pse gjetja e auditorit është adresuar vetëm ndaj Komunës së Prishtinës, ndërsa paralajmëroi se do t’a trajtojë çështjen deri në fund dhe do të japë sqarime të plota. Sa i përket ndryshimit të qëndrimeve politike dhe koalicionit qeverisës, ajo deklaroi se vendimi është marrë pas rezultatit zgjedhor, me synimin për të kontribuar në zhvillimin

e qytetit dhe jo për të bllokuar punën e institucioneve. Ajo foli edhe për raportet e auditimit të ndërmarrjeve publike, dhe vlerësoi se të gjetura ka në shumë ndërmarrje publike, duke përmendur edhe Stacionin e Autobusëve, dhe u zotua se të gjitha ndërmarrjet komunale do të raportojnë para Kuvendit Komunal për raportet e punës, gjetjet e auditimit dhe zbatimin e rekomandimeve, pa dallime politike. Në lidhje me rritjen e çmimit të biletës së autobusëve, ajo deklaroi se subjekti i saj politik kundërshton rritjen e çmimeve të shërbimeve publike dhe se do të angazhohet që të mos ketë rritje të çmimeve në nivel lokal, përveç rasteve kur ato diktohen nga rrethana të përgjithshme ekonomike.

Gëzim Sveçla: - deklaroi se përgjigjet e nënkryetares nuk iu referuan pyetjeve konkrete të parashtruara për çështje komunale, por u orientuan drejt zhvillimeve në nivel qendror. Ai theksoi se çmimet e produkteve dhe shërbimeve të përmendura nuk përcaktohen nga qeveria dhe se përgjegjësitë duhet të trajtohen në përputhje me kompetencat institucionale. Sveçla tha se marrëveshjen me UNDP-në, raporti i Auditorit ka evidentuar çështje që lidhen me procedurat e prokurimit në Komunën e Prishtinës dhe se nuk ka vend për krahasime me komunat e tjera. Ai vlerësoi se mbrojtja e kësaj marrëveshjeje nuk adreson gjetjet e raportit të auditimi, sa i përket Stacionit të autobusëve, ai sqaroi se nuk është më aksionar në ndërmarrje dhe se gjatë mandatit të tij janë ndërmarrë masa për përmirësimin e kushteve të punës, përfshirë rritjen e pagave, sigurimin e punëtorëve dhe përmirësimin e shërbimeve. Ai tha se gjetjet e auditorit në këtë ndërmarrje janë kryesisht të natyrës teknike dhe kritikoi ndryshimin e qëndrimeve politike të Partisë Demokratike të Kosovës ndaj qeverisjes komunale, duke theksuar se shumë nga qëndrimet e mbajtura gjatë fushatës zgjedhore janë braktisur pas krijimit të koalicionit qeverisës.

Nënkryetarja - Besianë Musmurati: - theksoi se performancën e partive e vlerësojnë qytetarët dhe argumenton se kjo është reflektuar edhe në rezultatet zgjedhore. Ajo tha se arsyeja kryesore e hyrjes në koalicion është ofrimi i shërbimeve për qytetarët e Prishtinës, duke premtuar trajtim të çdo kërkesë apo denoncimi për keqpërdorime. Besiana tha se vendimet e nivelit qendror ndikojnë edhe në nivelin lokal, ndërsa drejtorët e PDK-së do të jenë të gatshëm të japin përgjigje dhe të ofrojnë shërbime për qytetarët, dhe ajo shmang replikat politike dhe rithekson se fokusi i saj mbetet përmirësimi i jetës së qytetarëve të Prishtinës.

Gëzim Sveçla: - tha se performanca politike e Besiana Musmuratit dhe e subjektit të saj është vlerësuar nga qytetarët përmes rezultateve zgjedhore. Ai e kritikon për paraqitjen e saj në Parlamentin Evropian, duke pretenduar se nuk i ka adresuar temat për grupin terroristit të Radojçiçit, për shqiptarët në luginë të Preshevës. Sveçla shton se më parë e kishte vlerësuar publikisht punën e saj si drejtoreshë, por se ndryshimi i qëndrimeve të saj politike e ka bërë të humbasë besimin dhe si nënkryetare e Prishtinës, dhe se ajo mban përgjegjësi për punën dhe vendimmarrjen në qytet.

Nënkryetarja - Besianë Musmurati: - deklaroi se gjatë paraqitjeve të saj në Parlamentin Evropian ka ngritur çështje që sipas saj, lidhen me zhvillimet në Kosovë, përfshirë rënien e indeksit të lirisë së medias. Ajo thekson se do të vazhdojë bashkëpunimin me të gjitha grupet politike në Kuvendin Komunal të Prishtinës për çështje që lidhen me shërbimet për qytetarët, si ndërtimi i çerdheve, shkollave dhe përmirësimi i shërbimeve publike. Musmurati nënvizon se këtë qasje e ka pasur edhe gjatë mandatit si drejtoreshë e arsimit dhe se do ta vazhdojë edhe si nënkryetare e Prishtinës.

Bujar Gashi - drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë: - i përgjigjet z. Osmanit, për çështjen e inspektimit hapësinor kanë pasur takime dhe diskutime lidhur me kërkesat e ngritura. Ai thekson se ekipet menaxhuese kanë vizituar terrenin dhe disa zona që nuk kanë mundur të trajtohen me larvicide. Gashi sqaroi se faza e tretë e dezinfektimit hapësinor është realizuar të shtunën për shkak të reshjeve, ndërsa faza e katërt është planifikuar për këtë javë, të premten, nëse kushtet atmosferike e lejojnë, me ekipet që do të jenë edhe në Besi.

Feim Osmani: - theksoi se çështja e dezinfektimit duhet të diskutohet me kujdes dhe të mos paragjykohet. Ai sqaroi se nuk e mohon realizimin e fazës së dytë të dezinfektimit, por ngriti shqetësimin se në disa rrugë, konkretisht rruga “15 Marsi”, nuk është përfshirë në këtë fazë. Osmani deklaroi se nuk ka marrë njoftim paraprak, siç do të duhej të ndodhte si banor i kësaj rruge dhe si kultivues i bletëve, dhe nuk e ka parë ekipën duke e bërë dezinfektimin, prandaj kërkoi që rasti i rrugës “15 Marsi” të verifikohet dhe rishikohet.

Bujar Gashi - drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë: - sqaroi se nëse bëhet fjalë për rrugën e përmendur, sipas informatave të marra nga ekipet në terren, ditën e shtunë ekipi ka arritur deri te shtëpia juaj dhe më pas është kthyer, pasi ajo është edhe shtëpia e fundit.

Leutrim Retkoceri - drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike: - dha përgjigje për disa çështje të shërbimeve publike, për ndriçim publik, ai sqaroi se projekti është në fazën përfundimtare dhe se prioritet u është dhënë rrugëve me numër më të madh banorësh dhe me kërkesa më të hershme. Ai theksoi se do të trajtohet edhe rruga “Stambolli”, ndërsa kërkesat për mirëmbajtje dhe zgjerim të rrjetit do të përfshihen edhe në kontratat e ardhshme të mirëmbajtjes, për çështjen e çmimeve të kiosqeve, ai tha se kjo duhet të rregullohet përmes rregullores për taksa dhe tarifa komunale, duke theksuar nevojën për bazë ligjore dhe transparencë në përcaktimin e çmimeve, ndërsa për pusetat sqaroi se ato janë në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale. Retkoceri tha se ndriçimi në Kodrën e Trimave, konkretisht në rrugën “Mon Balaj”, është identifikuar si problem dhe se po punohet në sanimin e rrjetit të dëmtuar. Ai njoftoi gjithashtu se ekipet do të intervenojnë në rastet kur ndriçimi publik qëndron ndezur pa nevojë dhe se do të trajtohen edhe zonat ku mungon ndriçimi. Për mirëmbajtjen e rrugëve, pushtetave atmosferike dhe shportave të mbeturinave, Retkoceri tha se po punohet në sigurimin e kontratave të reja dhe në krijimin e një modeli më efikas të mirëmbajtjes. Ai theksoi nevojën për një strategji të përbashkët për vendosjen e shportave të mbeturinave dhe përfshirjen e kuvendit dhe qytetarëve në këtë proces, për transportin publik bëri të ditur se kompetencat tashmë kalojnë te Drejtoria e Mobilitetit, por premtoi bashkëpunim për përmirësimin e shërbimeve për qytetarët. Drejtori deklaroi për furnizimin me ujë në Bërnice të Epërme se do të vazhdojë angazhimin dhe bashkëpunimin me kompaninë rajonale të ujësjellësit për zgjidhjen e problemit. Ai foli edhe për transparencën e kontratave dhe raporteve financiare, duke theksuar rëndësinë e informimit të qytetarëve për përdorimin e mjeteve publike dhe deklaroi se raportet e auditorit janë duke u analizuar dhe se do të jepen përgjigje për gjetjet. Sa i përket menaxhimit të mbeturinave, kërkoi që çështja të trajtohet si përgjegjësi e përbashkët dhe jo vetëm përmes fajësimit, për gjendjen me kontejnerët në lagjen Mati 1, njoftoi se do të bëhet inspektimi në terren dhe se do të punohet për një zgjidhje të qëndrueshme në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

Pëllumb Bajçinovci - drejtor i Drejtorisë së Mobilitetit: - iu përgjigj pyetjeve lidhur me transportin publik, infrastrukturën rrugore dhe sigurinë në komunikacion. Ai kërkoi që kërkesat

për dislokimin dhe ndërtimin e stacioneve të autobusëve t'i dërgohen në e-mailin zyrtar për trajtim të mëtejshëm, duke sqaruar se procesi i modernizimit të stacioneve është në zhvillim dhe realizohet sipas kushteve të terrenit. Bajçinovci tha se procesi i digjitalizimit të transportit publik, sistemi Trip – Transporti i Ri i Prishtinës synon një transport të integruar dhe gjithëpërfshirës, me bilete të unifikuar për operatorët publikë dhe privatë. Kuleta digjitale rrit transparencën, përmirëson menaxhimin dhe mundëson mbledhjen e të dhënave për planifikimin e shërbimeve, ndërsa në të ardhmen do të mundësohet edhe pagesa me kartela bankare. Ai njoftoi gjithashtu se Trafiku Urban është në proces zgjerimi me flotë të re, me synimin që transporti publik të shtrihet në të gjitha lagjet e kryeqytetit, dhe informoi se janë ndërmarrë veprime për lirin e hapësirave pranë një udhëkryqi në Arbëri për të rritur sigurinë në komunikacion, si dhe se do të shqyrtohen në terren kërkesat për vendosjen e pengesave dhe përmirësimin e sinjalizimit rrugor.

Granit Geci - drejtor i Drejtorisë së Sportit: - njoftoi se pas një vizite në shkollën "**Pavarësia**" në lagjen Muharrem Fejza, është konstatuar gjendja e rënduar e hapësirave sportive. Ai bëri të ditur se deri në muajin shtator planifikohet ndërtimi i dy hapësirave të reja sportive: një fushë futbollit me bar artificial dhe një fushë basketbollit, me qëllim përmirësimin e kushteve për nxënësit. Geci theksoi se zona e Muharrem Fejzës dhe Matit është ndër më të dendurat në kryeqytet, me rreth 80 mijë banorë dhe përdorues të përditshëm, duke nënvizuar se përballimi i sfidave infrastrukturore kërkon angazhim të përbashkët të ekzekutivit, Kuvendit Komunal dhe institucioneve përgjegjëse. Drejtori konfirmoi se për fushës sportive ekzistuese në Barilevë, do të ndërhyjë shumë shpejt për rregullimin e saj, dhe gjithashtu njoftoi se javën e ardhshme pritet të inaugurohet një hapësirë e re sportive në lagjen Leci..

Enver Redenica: - falënderoi drejtorin për përgjigjen dhe sqaroi se kërkesa e tij ishte dorëzuar më 3 mars 2026, në një kohë kur drejtori aktual nuk ishte ende në detyrë. Ai theksoi se kërkesa ishte adresuar në drejtori, me pritjen që ajo të trajtohej pavarësisht ndryshimeve në udhëheqje. Redenica bëri të ditur se e kishte kërkesën edhe në formë fizike dhe elektronike dhe u zotua ta ridërgojë me e-mail. Ai shtoi se kërkesa përfshinte edhe hapjen e një hyrjeje në lagjen Tokëbahqe, çështje që, sipas tij, bie në kompetencën e drejtorisë përkatëse.

Albana Gjonbalaj- drejtore e Drejtorisë së Parqeve: - sqaroi se kapacitetet e **Ndërmarrjes "Gjelbër"** për furnizim me lule sezonale janë të kufizuara, prandaj Drejtoria e Parqeve po orienton mbjelljet drejt bimëve shumëvjeçare, të cilat janë më të qëndrueshme dhe më ekonomike për mirëmbajtje. Ajo bëri të ditur se mbjellja e planifikuar në rrethin e Ulpianës, te fontana, mbetet pjesë e planit të punës, dhe theksoi se për shkak të temperaturave të larta, aktivitetet e mbjelljes janë pezulluar përkohësisht, pasi mbjelljet gjatë kësaj periudhe kanë rrezik të lartë dështimi, cikli i mbjelljeve do të rifillojë gjatë muajit shtator. Gjonbalaj njoftoi se në kuadër të kontratës me Ndërmarrjen "**Gjelbër**", janë realizuar krasitje dhe kositje në Besi, përgjatë rrugës për Prapashticë, si dhe në Prugoc. Ajo shtoi se drejtoria, në bashkëpunim me ndërmarrjen, reagon ndaj çdo raportimi që lidhet me pengimin e lëvizjes së qytetarëve, rrezikimin e sigurisë në komunikacion apo rrezikun nga drunjtë.

Zyhrije Pllana-Gashi, drejtore e Drejtorisë së Investimeve Kapitale: - njoftoi se përgjigjet për pyetjet e adresuara Drejtorisë së Investimeve Kapitale do të përgatiten dhe do të dërgohen nga ekipi i drejtorisë në ditët në vijim, duke sqaruar se nuk kishte qenë e pranishme në mbledhje.

Nexhmije Gjema: - shprehu shqetësime për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të kuletës digjitale, duke kërkuar sqarime për arsyen e mbledhjes së dokumentit të identifikimit, fotografisë dhe të dhënave të tjera personale, bazën ligjore për përpunimin e tyre, rolin e kompanisë private PBC Group në menaxhimin e këtyre të dhënave, si dhe nëse është marrë opinion nga Agjencia për Informim dhe Privatësi.

Drejtori Pëllumb Bajçinovci : - sqaroi se procesi i kuletës digjitale është pjesë e një projekti në vazhdim dhe se ai është përfshirë në një fazë të mëvonshme të tij, sa i përket të dhënave personale, ai theksoi se edhe para aplikimit të sistemit digjital, në biletat fizike të Trafikut Urban janë evidentuar të dhëna identifikuese të udhëtarëve, si emri, mbiemri, data e lindjes, numri personal dhe fotografia, me qëllim të identifikimit të përdoruesit të transportit. Ai shtoi se procedurat e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave janë realizuar nga kompania përgjegjëse në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe se informacionet e plota lidhur me këtë çështje do të përmbledhen dhe do t'u përcillen anëtarëve përmes e-mailit në ditët në vijim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:42

Procesmbajtësi
Skender Tora

Kryesues i Kuvendit
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



TRANSKRIPT

**I mbledhjes së katërt të rregullt të Kuvendit të Komunës së Kryeqytetit, mbajtur më datë
15.7.2026, duke filluar në orën 10:00**

Kryetari: - përshëndetje për të gjithë. Të nderuar anëtarë të Kuvendit të kryeqytetit, i nderuari kryetar i kryeqytetit zoti Përparim Rama, të nderuar nënkryetarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm. Ju përshëndes dhe uroj mirëseardhjen në mbledhjen e katërt të rregullt të Kuvendit të kryeqytetit. Në fillim të seancës dëshiroj të njoftoj për një ndryshim në përbërjen e kuvendit. Për shkak se zoti Agron Canolli ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit pas emërimit të tij si drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit. Ai nuk është më anëtar i Kuvendit të kryeqytetit. Me këtë rast në emër të Kuvendit e falënderoj zotin Canolli për kontributin e dhënë si anëtar i Kuvendit dhe i uroj suksese në detyrën e re, si dhe mbarësi në angazhimet e mëtejshme profesionale në përputhje me rezultatet e zgjedhjeve komunale dhe radhitjen e kandidatëve në listën zgjedhore, mandati i anëtarit të kuvendit i takon zotit Muhamed Selmani i cili edhe në mandatin e kaluar ka ushtruar funksionin e anëtarit të kuvendit. E ftoj zotin Selmani të ngritet në këmbë që së bashku të bëjmë betimin solem. Betohem se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime, me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë. Betohem. Falemnderit. Në mbështetje të nenit 35, pika 5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Ju si anëtarë i Kuvendit keni obligim ta nënshkruani betimin solem. Ju ftoj ta nënshkruani? E keni nënshkruar? Mirë ju falemnderit. Atëherë në këtë rast i uroj mirëseardhje zotit Selmani dhe i uroj suksese në ushtrimin e mandatit të tij si anëtar i Kuvendit të kryeqytetit. Urime zoti Selmani. Falemnderit. Ju dëshiroj suksese në ushtrimin e mandatit tuaj. Të nderuar kolegë, vazhdojmë me punimet e seancës. Sot jemi mbledhur për të zhvilluar mbledhjen e IV-të të rregullt të Kuvendit të kryeqytetit të Republikës së Kosovës në përputhje me rregulloren e punës dhe me materialet që ju janë shpërndarë me kohë nga shërbimi i Kuvendit. Para se të kalojmë në shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, do të bëjmë verifikimin e pranisë së anëtarëve dhe konstatimin e kuorumit të nevojshëm për zhvillimin e punimeve të kësaj seance. Kërkoj nga shërbimi i Kuvendit të konfirmojë numrin e anëtarëve të pranishëm në sallë.

Gjithsej 47. Konstatohet se ekziston kuorum i nevojshëm dhe mund të vazhdojmë me zhvillimin e seancës. 47 janë prezent. Në këtë seancë do të shqyrtohen pikat e rendit të ditës, i cili përmban gjithsej nëntë pika.

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së dytë, të tretë dhe të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit me numër 01-020 / 0431224 / 26 të datës 02.03.2026 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
3. Propozim-vendimi për miratimin e lëvizjes së numrit të lejuar të të punësuarve në kuadër të Drejtorisë së Arsimit;
4. Propozim-vendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të dy fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
5. Propozim-vendimi për caktimin e anëtarëve të komisionit për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukative arsimore dhe aftësuese në kryeqytet;
6. Propozim-vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për përcaktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve në ndërmarrjet publike të Komunës së Prishtinës;
7. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL, Prishtina Parking;
8. Pyetje dhe përgjigje dhe
9. Të ndryshme.

A ka ndonjë propozim nga ana e juaj? Nëse ka mund të propozoni. Çdo propozim i juaj hedhet në votim. A e ka kërkuar fjalën kush? Z. Sfeçla ka kërkuar fjalën

Gëzim Sfeçla: - të nderuar anëtarë të ekzekutivit, kryesues kolegë asamblistë, përfaqësues të mediave dhe të dashur qytetarë të Prishtinës. Në emër të grupit të Lëvizjes Vetëvendosje e kemi një propozim tani, por që fillimisht po dua me u ndal te një çështje që është shumë e rëndësishme që ka të bëjë me mbarëvajtjen e seancës. Para vetes këtu e kam Planin vjetor të punës të Kuvendit Komunal të Prishtinës, të cilin e kemi përpiluar bashkërisht, do të thotë nga një përfaqësues prej secilit subjekt politik dhe i cili e ka marrë miratimin e këtij Kuvendi. Por ajo çka është mjaft shqetësuese për neve dhe krejt e papranueshme ka të bëjë me faktin se ky dokument që është ndër dokumentet e para që e kemi miratuar bashkërisht nuk po zbatohet fare. Po dua me kalu te muaji korrik sipas planit të punës e ne jemi sot në mes të muajit korrik dhe janë të paraparë si vijon raporti i punës së kryetarit të kryeqytetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026. Do të thotë sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Kryesuesi: - ju lutem regjia fjalën. Vetëm një minutë po thotë me prit se paska një pengesë. Vazhdo zoti Sfeçla.

Gëzim Sfeçla: - falemnderit. S'do të thotë që veç mikrofonat s'punojnë në Kuvendin komunal. Sipas planit të punës, sot do të duhej të diskutonim për raportin e punës së kryetarit të kryeqytetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kryetari i kryeqytetit është obliguar që të paktën dy herë në vit të raportojë para Kuvendit për gjendjen financiare në kryeqytet. Kjo nuk ka ndodhur as mandatin e kaluar. E tashmë jemi në muajin e shtatë, po mbaron edhe muaji i shtatë prej se jemi betuar si legjislaturë e re dhe akoma nuk e kemi një raportim të

kryetarit. Për më tepër kryetari vjen dhe rrin nga 15 minuta në mbledhje të Kuvendit komunal dhe largohet duke shpërfillur tërësisht institucionin më të lartë të qytetit. Pastaj është raporti financiar buxhetor i kryeqytetit për periudhën 1 prill 30 qershor. Nuk është pikë e rendit të ditës sot. Raport lidhur me punën e komisionit aksionar të ndërmarrjeve publike. Do të thotë jemi tre muaj vonë me raportime të ndërmarrjeve publike. Deri sot do të duhej t'i kishim të paktën gjashtë raporte nga ndërmarrjet publike të qytetit. Të gjithë jemi dëshmitarë se cila është gjendja në këto ndërmarrje. Informatë për raportin e zyrës së auditorit të përgjithshëm për vitin 2025 dhe plani i zbatueshmërisë për të gjeturat e këtij raporti. Ka një kohë që raporti i zyrës kombëtare të auditimit është bërë publik. Ka një kohë që Komuna e Prishtinës e ka pranuar këtë raport dhe në kushte normale do të duhej sot që të shqyrtohej ky raport dhe një varg çështjesh të tjera, të cilat janë të parapara me planin e punës por të cilat nuk po zbatohen. Siç e dini ne sot jemi tek në mbledhjen e katërt të Kuvendit Komunal të Prishtinës, ndërkohë që jemi në muajin e shtatë prej që jemi formuar. Disa komuna këtë javë i mbajnë mbledhjet e dhjeta dhe kjo nuk i bën nder kryeqytetit që me shpërfaq këtë mospunë. Unë e di që propozimet për pikat do duhej të vinin prej ekzekutivit dhe e di që edhe kryesuesi nuk mundet me ftu mbledhje kur nuk ka pika të tilla, por mendoj që Prishtina ka mjaft telashe, mjaft probleme dhe mjaft nevojë për diskutim për një varg çështjesh të cilat para nesh askush nuk është më tepër i thirrur që t'i diskutojë. Në vazhden e kësaj si grup i Lëvizjes Vetëvendosje propozojmë që si pikë e rendit të ditës sot të futet raporti i zyrës së auditorit të përgjithshëm për vitin 2025. E kemi parë nga mediat, po e kemi parë dhe vetë raportin që është një dokument me të gjetura skandaloze si asnjëherë më parë për Komunën e Prishtinës. Prandaj i bëj ftesë secilit asamblist që për një moment të zhveshen nga petku partiak dhe t'i kryejnë detyrat dhe obligimet të cilat i takojnë që të kujdesen të paktën për të diskutuar nëse nuk kanë fuqi për t'i ndalë të gjitha ato të gjetura të cilat i ka shprehur ky raport. Prandaj propozojmë që si pikë e rendit të ditës të jetë diskutimi mbi raportin e zyrës së auditorit të përgjithshëm për vitin 2025. Ky është propozimi i parë. Kemi dhe një propozim. Meqenëse kemi parë që në seancat e kaluara drejtorët me gjasë për shkak të obligimeve që i kanë edhe pse do të duhej që ditën kur është seanca t'i përkushtohen vetëm seancës, nuk po arrijnë të qëndrojnë deri në fund të seancës. Propozojmë që pika pyetje përgjigje të kalojë si pika e dytë e rendit të ditës menjëherë pas miratimit të ekstraktit. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit zoti Sfeçla. Berita Abazi ka kërkuar fjalën.

Berita Abazi: - përshëndetje për të gjithë. Në emër të grupit të asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje, propozojmë që të këtë diskutim edhe në lidhje me rritjen e çmimit të biletave të trafikut urban. Ky propozim vjen pasi qytetarë të shumtë janë të revoltuar për rritjen e çmimit të biletave të trafikut urban. Marr parasysh faktin që nuk ka infrastrukturë ose përmirësim të kushteve as flotë të re të autobusëve në këtë drejtim. Atëherë do të thotë arsyeja pse ne po e propozojmë është kjo që të diskutojmë për shkak se është marrë një vendim i cili i ka prekur direkt qytetarët e Prishtinës dhe nuk ka pasur asnjë konsultim paraprak dhe asnjë njoftim paraprak.

Kryesuesi: - falemnderit zonja Abazi. Arbenita Murseli ka kërkuar fjalën.

Arbenita Murseli: - i nderuar kryesues, kryetar, drejtorë, kolegë asamblistë, përfaqësues të mediave, të gjithë pranishëm. Përshëndetje. Lidhja e Prishtinës ka një propozim për këtë pikë, për këtë rend të ditës edhe kjo të jetë pika e dytë e rendit të ditës. Propozim-vendimi për zëvendësimin

dhe ndryshimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete dhe të jetë pika e dytë për këtë rend të ditës. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit. Besa Shahini ka kërkuar fjalën. Arbenita fjala për juve

Arbenita Murseli - me Teuta Kadiu Gjinollin. Falemnderit.

Kryesuesi: - Besa Shahini e ka fjalën.

Besa Shahini: - falemnderit kryesues. Propozimi im për pikë të rendit të ditës shtesë është gjithashtu rritja e çmimit të transportit publik në Prishtinë. Kosto e jetesës në Prishtinë është problemi kryesor me të cilin po ballafaqohen qytetarët si ata që kanë të hyra të ulëta, si ata që kanë të hyra mesatare. Është një grup shumë, shumë i vogël që sot nuk është duke i vuajt pasojat e krizës ekonomike të cilën po e përjetojmë të gjithë ne. Tash komuna ka për obligim që qytetarëve të vetë t'ju ndihmojnë në kësi raste edhe ka shumë mekanizma në dorë që mundet për me ul koston e jetesës nga banimi te kopshtet publike, te transporti shkollor, transporti publik rritja e çmimit për 50 % pa asnjë diskutim paraprak edhe pa asnjë paralajmërim, pa asnjë shpjegim se pse kemi ardhur te ky çmim është totalisht e papranueshme dhe mendoj që duhet të diskutohet këtu në Kuvendin komunal edhe duhet të raportohet për gjithçka që po ndodh brenda trafikut urban gjithashtu. Domethënë ku janë autobuset e rinj, cili është plani strategjik për rritjen edhe zgjerimin e rrjetit e të tjerë. Për mua nuk ka logjikë. Domethënë qeverisja për Përparim Ramën apo Uran Ismailin nuk po e kuptoj logjikën e qeverisjes nëse kosto e jetesës është problemi kryesor. Nëse Bedri Hamza në krejt fushatën zgjedhore flet për koston e jetesës, pse merret ky vendim ku rritet çmimi i transportit publik? Pa asnjë diskutim paraprak edhe pa asnjë shpjegim. Në anën tjetër sheshi po vazhdon të ndërtohet që nuk është prioritet për asnjërin nga qytetarët e Prishtinës.

Kryesuesi: - zonja Shahini, a ke pika?

Besa Shahini: - po.

Kryesuesi: - cila ke pika?

Besa Shahini: - për rritjen e çmimit të transportit publik, të cilin unë jam duke argumentuar pse duhet ta fusim si pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi - në rregull jemi.

Besa Shahini: - në anën tjetër 18 milionë euro janë ndarë për sheshin e këtë pjesën e sheshit që ka filluar të hapet për të cilën Uran Ismaili ka thënë që duhet të mbyllet e duhet të hapet për trafik e të tjerë janë shtuar dhe 3 milionë në mbledhjen e kaluar që i patëm për ta zgatur sheshin deri te Rrethi i Flamurit shumë mirë që kryetari është këtu edhe shumë mirë që Besiana si përfaqësuesja e Uran Ismailit është këtu. Është mirë të na shpjegojnë logjikën e kësaj qeverisjeje që e rrit çmimin për shërbime bazë si transporti publik, ndërsa nuk kanë asnjë problem që të paguajnë nga paraja publike që të realizojnë projekte të cilat nuk janë prioritet për qytetarët e Prishtinës. Gjithashtu siç thashë raportim nga trafiku urban edhe nga komuna për nga ekzekutivi i komunës për çështjet që

kanë të bëjnë me numrin e autobusëve, zgjerimin e rrjetit edhe si ka ardhur te vendimi për rritjen 50% të çmimit të biletës së transportit publik. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit zonja Shahini. Zonja Shahini kjo pikë e njëjtë me të Beritës është domethënë ajo pikë është edhe kjo ashtu e propozoi Berita. Endrit Zabërgja e ka fjalën.

Endrit Zabërgja: - falemnderit kryesues. Përshëndetje të dashur kolegë në veçanti qytetarë të Prishtinës, kolegë asamblastë. Ju uroj seancën të mbarë sot dhe punë mbarë në punimet e kësaj seancës. Unë e mora fjalën për një arsye të veçantë me ngrit është tash në sa kohë kemi kërkesë prej një pjese të madhe të banorëve. E kemi marrë të gjithë asamblastët një email prej banorëve të lagjes “Bregu i Diellit”. Edhe pika të cilën propozoj është trajtimi i kësaj kërkesë dhe diskutimi për këtë kërkesë nga banorët e lagjes së “Bregut të Diellit”. Besoj që si asamblast nuk duhet me u tërheq prej kërkesave të qytetarëve, duhet me diskutuar me ato dhe në veçanti nëse obligimi ligjor i përket asamblesë e jo pjesëve tjera. Trajtimi i kërkesës dhe diskutimi i kërkesës së banorëve është ashtu siç na ka ardhur në email të gjithë asambleistëve. Kjo është normalisht me kërkesë të qytetarëve. I kemi materialet në email të gjithë.

Kryesuesi: - a dëshiron dikush fjalën? Jo. Atëherë po lexojmë edhe propozimet e juaja.
Urdhëro zoti Bllaca

Osman Bllaca: - Gëzim Sfeçla nga Vetëvendosja ka propozuar: Diskutim i raportit të zyrës kombëtare të auditimit për vitin 2025 për Komunën e Prishtinës.

Kryesuesi: - falemnderit. Atëherë lus regjinë të jetë gati për votim, propozimin e zotit Gëzim Sfeçla. Votojmë tash. Falemnderit, me 15 vota për 24 kundër asnjë abstenim nuk kalon kjo pikë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e radhës.

Osman Bllaca: - Gëzim Sfeçla ka propozuar edhe që pika e tetë pyetje dhe përgjigje të jetë pika e dytë e rendit të ditës.

Kryesuesi: - falemnderit. Lus regjinë të jetë gati për votim të kësaj pike propozimit të zotit Sfeçla. votojmë tash me 16 vota për, 23 kundër, dy abstenime. Edhe kjo pikë nuk kalon. Vazhdojmë me pikën e radhës, me propozimin e radhës.

Osman Bllaca: - edhe Berita Abazi nga Vetëvendosja edhe Besa Shahini nga PSD kanë propozuar pikën e njëjtë për me qenë në rend dite. Është diskutim mbi rritjen e çmimeve të biletave të autobusëve. Pra kjo është vetëm si një pikë që hyn në rend dite. Atëherë procedoj kryesues për votim.

Kryesuesi: - falemnderit. Atëherë lus regjinë të jetë gati për votim të propozimit të dy kolegëve. votojmë tash. Tani me 19 vota për, 26 kundër, asnjë abstenim nuk kalon as ky propozim. Vazhdojmë me propozimin e radhës.

Osman Bllaca - Arbenita Murseli ka propozim. Vendimi për ndryshimin e vendimit të Komitetit për Komunitete dhe kërkon që kjo pikë të jetë në qoftë se votohet edhe në pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryesuesi: - Lus regjinë të jetë gati për votim të propozimit të Arbenitës. Votojmë tash. Me 26 vota për, 14 kundër, 4 abstenime kalon propozimi i Arbenitës. Edhe Floriani është për se s'po bën pajisja. Edhe Floriani për Po nuk po bën. Në rregull. Nëse nuk bën atëherë janë 27 vota, jo 26 sa është në ekran aty. A ka mundësi regjia me konfirmuar edhe njëherë? Po. A po i bën Florianit? Hajde Florian ju lutem. Florian voto. Në rregull. Falemnderit, vazhdojmë.

Osman Billaca: - Endrit Zabërgja ka propozuar që të jetë në rend dite diskutimi i kërkesës së banorëve të “Bregut të Diellit”.

Kryesuesi: - ju lutem regjia të jetë gati për votim.

Osman Billaca: - Endrit në qoftë se votohet kjo pikë, përcjellja të gjithë anëtarëve të Kuvendit se nuk e paskan.

Kryesuesi: -ju lutem regjia të jetë gati për votim të propozimit të zotit Zabërgja. Ju lutem një moment fjalën e ka z. Zabërgja. Urdhëro zoti Zabërgja. A ke diçka për të shtuar?

Endrit Zabërgja: - unë besoj që të gjithë ju e keni pas materialin dhe e keni trajtuar sepse ne s'mundemi me trajtu materialin tash për gjysmë ore. Nëse nuk e keni trajtuar këtë material, mundemi me lënë për një ditë tjetër, por e rëndësishme është me ju dhënë zgjidhje serioze banorëve edhe mos me bë më hajgare me këto çështje. Kur kemi kërkesë prej banorëve me e kap me trajtu ashtu qysh është përtej krejt interesave dhe kalkulimeve. Kështu që ne mundemi e jam i interesuar me trajtuar mirë edhe me lënë seancën tjetër nëse veç jeni të të...

Kryesuesi: - zoti Zabërgja kjo nënkupton që ju po e tërhiqni, zoti Zabërgja do të thotë ju po e tërhiqni këtë pikë për seancën e radhës.

Endrit Zabërgja: - për seancën e radhës. Mirëpo në seancën e radhës me pas prej pikës të rregullt edhe me fut edhe ju në KPF.

Kryesuesi: - falemnderit. Atëherë po vazhdojmë. A jo, kërkoj falje. Zoti Gëzim Sfeçla ka një propozim.

Gëzim Sfeçla: - falemnderit. Propozoj që asambleja të diskutojë sipas kërkesave të banorëve të “Bregut të Diellit” që ka të bëjë me çështje të pronave e për të cilën është diskutuar edhe gjatë diskutimit publik ku kryetari ka qenë prezent edhe për të cilin kemi parë edhe emisione televizive. Prandaj mendoj që kjo të futet si pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi: - falemnderit zoti Sfeçla. Edhe Nexhmie Gjema ka kërkuar fjalën.

Nexhmie Gjema: - gjithashtu dua të ndërlidhem me dy bashkëfolësit për të cilët janë duke e ngre çështjen e qytetarëve të cilëve komuna nuk po iu kthen përgjigje e ata janë Fatmir Kabashi, Veton Kasapolli, Xheladin Aliu, Shukrie, Miradie, Admir Aliu, Namon Aliu, Jakup Alijeviçi, Xhemshit dhe Taibe Cakolli si dhe Asllan Vllasaliu. Deri më tash pavarësisht se nuk kanë marrë përgjigje nga institucionet komunale, ata kanë vazhduar t'ju shkrujnë institucioneve tona, por edhe neve si

asamblistë. Kjo është pjesëmarrje qytetare që duhet t'i inkurajojmë e jo t'i injorojmë. Andaj pyetja ime është se pse nuk po ju kthejmë përgjigje qytetarëve edhe nëse në ndërkohë janë kthyer përgjigjet pse neve si asambles nuk na kanë përfshir në CC. Ju falemnderit.

Kryesuesi: - Falemnderit zonja Gjema. Këto mundemi me i trajtu në pyetje dhe përgjigje. Jo tash edhe në të ndryshme. Falemnderit shumë. Fjolla Vukshinaj Reçica e ka kërkuar fjalën.

Fjolla Vukshinaj Reçica: - falemnderit kryesues. Vetëm po ndërlidhna te zonja Gjema tek kërkesa e zotit Veton Kasapolli. Zonja Gjema, po më vjen shumë keq, mirëpo edhe unë i kam kthyer përgjigje zotit Veton Kasapollit, si dhe drejtori Pëllumb Bajqinovci i ka kthyer. Është shumë mirë që në këtë platformë të asamblesë komunale kur të drejtohem paraprakisht t'i marrim edhe njëherë përgjigjet prej kolegëve tanë nëse kanë kthyer përgjigje ose nëse jo. Unë s'po dua me bë avokatin e kërkujt, mirëpo me Veton Kasapollin kemi diskutuar disa herë si dhe Drejtori Pëllumbi ka qenë shumë korrekt, ka dalë në terren dhe e ka vizituar gjithashtu edhe Leotrim Retkoceri ka qenë i përfshirë në komunikim dhe i ka kthyer përgjigje.

Kryesuesi: - kolege, këto të gjitha i trajtoni në pyetje dhe përgjigje. Tani kemi veç propozime të pikave të rendit të ditës. Falemnderit. Nuk ka propozime tjera si duket. Kush është? Zoti Sfeçla e ka kërkuar fjalën. A e bënë propozimin? Në rregull.

Osman Billaca: - Gëzim Sfeçla ka propozuar diskutimi i kërkesës së banorëve të “Bregut të Diellit” për çështjen e pronave.

Kryesuesi: - falemnderit. Lus regjinë të jetë gati për votim, propozimin e zotit Sfeçla. Kush është për? Me 16 vota për, 25 kundër, dy abstenime. Nuk kalon edhe propozimi i zotit Sfeçla. Falemnderit. A dëshiron dikush me marrë fjalën? Jo. Atëherë po e lexoj edhe njëherë rendin e ditës edhe e hedhim në votim rendin e ditës.

- 1.Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së dytë, të tretë dhe të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.
- 2.Propozim-vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për Komitetin për Komunitete.
3. Propozim- vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit nr. 01-020 /0431224 /26 të datës 2.3.2026 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
- 4.Propozim- vendimi për miratimin e lëvizjes së numrit të lejuar të të punësuarve në kuadër të Drejtorisë së Arsimit.
- 5.Propozim- vendimi për caktimin e Komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
6. Propozim- vendimi për caktimin e anëtarëve të komisioneve për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në Kryeqytet.
- 7.Propozim- vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve në ndërmarrjet publike të Komunës së Prishtinës.
8. Propozim- vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL Prishtina Parking
9. Pyetje dhe përgjigje.
10. Të ndryshme.

Ju lutem regjia të jetë gati për votim të rendit të ditës. Votojmë tash. Me 34 vota për, 10 kundër, 1 abstenim, kalon. Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Domethënë kalon rendi i ditës. Tash vazhdojmë me pikën e parë. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit, të seancës së të dytë, të tretë dhe të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit. Lus regjinë të jetë gati. A ka dikush rreth miratimit të ekstraktit me marrë fjalën? A dëshiron dikush fjalën? Jo. Atëherë e lus regjinë të jetë gati për votim të pikës së parë. Votojmë tash. Atëherë me 31 vota për, asnjë kundër, katër abstenime. Kalon edhe pika e parë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e dytë. Plotësim ndryshimi i vendimit të Komitetit për Komunitete. Për këtë pikë fjalën ia jap Arbenita Murselit. Fjala për juve është Arbenita.

Arbenita Murseli: - falemnderit kryesues. Me kërkesë e Lidhjes së Prishtinës parashtrohet kërkesa e zëvendësimit të anëtarit të Komitetit për Komunitete nga anëtari Betim Abdullahu zëvendësohet kolegja Teuta Kadiu Gjinolli.

Kryesuesi: - falemnderit Arbenita. Dëshiron dikush fjalën? Jo. Atëherë lus regjinë të jetë gati për votim të kësaj pike. Votojmë tash të me 28 vota për, 10 kundër, asnjë abstenim. Kalon pika e dytë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e tretë. Propozim - vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit me numër 01-020 / 0431224 / 26 të dates datës 2.3.2026 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa. Zoti Pacolli ka kërkuar fjalën.

Egzon Pacolli: - atëherë, përshëndetje të gjithëve. Sa i përket vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të anëtares të deritanishme, zonjës Jeta Rafuna Hasani zëvendësohet me anëtares e re zonjën Donjeta Dragusha.

Kryesuesi: - a ka mundësi edhe njëherë Egzon. Në rregull atëherë. Fjolla Ukshinaj e ka kërkuar fjalën.

Fjolla Vukshinaj: - ju falemnderit. Partia Demokratike e Kosovës propozon në vend të Leotrim Retkocerit zotin Plator Gërdovcin dhe në vend të zotit Agron Canolli zotin Muhamed Selmani për zëvendësim të anëtarëve në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi: - falemnderit. Një propozim tjetër? Nuk ka. Atëherë ju lutem regjia të jetë gati për votim të propozimet për të dy propozimet, tri propozimet. Donjeta Dragusha shkon në vend të Jeta Rafunës. Plator Gërdoci në vend të Leotrimit dhe Muhamet Selmani në vend të Agron Canollit. Regjia të jetë gati për votim. Votojmë tash. Me 30 vota për, dy kundër, asnjë abstenim. Kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e radhës. Pika katërt, Propozim - vendimi për miratimin e lëvizjes së numrit të lejuar të të punësuarve në kuadër të Drejtorisë së Arsimit. Fjalën ia japim drejtorit Aranit Elshanit. Fjala për juve është drejtor.

Arianit Elshani: - e para, më lejoni që t'ju falënderoj të gjithëve për dy vendimet paraprake që i keni marrë lidhur me këtë çështje. Kjo është hera e tretë që po i kthehet Kuvendit Komunal lidhur me lëvizjen e numrit të lejuar për kategorinë e pagave në raport me 25 punonjës, të cilët janë angazhuar gjatë vitit të kaluar për të cilët që një vit rresht nuk kanë marrë pagë. Pra prej shtatorit të vitit të kaluar nuk kanë marrë asnjë pagë edhe i falënderoj edhe gjithë ata punonjës që kanë qenë të angazhuar dhe që nuk e kanë lënë punën në gjysmë gjatë gjithë kësaj kohe në kopshtet "Xixëllonja" dhe në kopshtin "Dardania", ky vendim sot, ky draftvendim realisht që e keni para

vetes vjen pas një vendimi paraprak të marrë edhe nga Ministria e Financave e cila e ka kthyer pra për rishqyrtim edhe njëherë në Kuvendin komunal ku kërkohet që të specifikohet sakt numri i lejuar dhe hapësirat që ekzistojnë në kuadër të kodeve buxhetore tona, fatkeqësisht kur i kanë marrë vendimet pavarësisht vullnetit të mirë që ka qenë në Kuvendin komunal kur janë marrë vendimet në këto kode buxhetore nuk ka pasur vende të lira për shkak që shumica e punonjësve janë të angazhuar prej periudhës së qershorit edhe në anën tjetër edhe pensionet, pensionimet zakonisht ndodhin përgjatë këtyre muajve, prandaj është koha e verës atëherë kur ekzistojnë mundësitë që të barten këto normat dhe të lëvizin meqënëse ekziston hapësirë. Prandaj ky vendim është i bazuar mbi këta numra të cilët janë të koordinuar edhe me Drejtorinë e Financave dhe janë pozicione të lira që mund të barten. Konkretisht bëhet fjalë për 24 që do të barten nga kategoria e arsimit të mesëm të lartë edhe 11 të tjerë nga kategoria e arsimit fillor edhe i mesëm i ulët në kategorinë e arsimit të parashkollorëve. Pra që t'i bëhet vend t'u mundësohet këtyre punonjësve të cilët kanë qenë të angazhuar prej shtatorit të vitit të kaluar për të marrë pagën prej muajit të ardhshëm, sigurisht duhet një vendim. Prandaj unë ju kërkoj, ju ftoj ashtu siç keni vepruar në të kaluarën që të mbështesni pagesat e këtyre punonjësve që të fillojnë të shpërblehen për punën të cilën e kanë bërë edhe të cilën disa prej tyre do të vazhdojnë edhe ta bëjnë. Falemnderit shumë.

Kryesuesi: - falemnderit drejtor. Hapim diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës. Shkojmë me shefat e grupeve Egzon. Në rregull a doni ju a Adili ju në emër të grupit munda me fol. Në rregull atëherë nga radha e PDK-së dëshiron fjalën dikush? Jo. Nga Lëvizja Vetëvendosje dëshiron fjalën? Zoti Sfeçla ka kërkuar fjalën.

Gëzim Sveçla: - falemnderit. Duhet njoftuar opinionin që siç e tha edhe drejtori këto edukatore janë prej muajit shtator pa paga. Kjo është rezultat i një keqplanifikimi që ka ndodhur. Mos harroni që në shtator kur janë punësuar kemi qenë në fushatë zgjedhore dhe si shkak i këtyre veprimeve pa fajin e tyre tash e 10 muaj nuk marrin paga, nuk paguhen për punën dhe kontributin e tyre. Gjithashtu mos të harrojmë po i bëjmë shtatë muaj. Kjo pikë e rendit të ditës ka ardhur që tri herë në asamblenë komunale dhe paaftësia juaj për me e krijuar ose me e formuluar një vendim në formën e duhur e ka prolonguar edhe më tutje këtë çështje. Natyrisht që e mbështesim dhe do ta votojmë por gjithmonë duke ju kërkuar falje dhe mirëkuptim atyre edukatorëve që për shkak të paaftësisë të ekzekutivit të Prishtinës dhe veprimeve elektorale që kanë ndodhur vitin e kaluar nuk janë paguar për mundin që kanë dhënë në edukimin e gjeneratave të reja. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit zoti Sveçla. Nga radhët e Aleancës dëshiron fjalën dikush? Jo. Lidhja e Prishtinës. Arbenita ka kërkuar fjalën.

Arbenita Murseli: Edhe Lidhja e Prishtinës është për aprovimin e kësaj pike të rendit të ditës. Pikë kjo që e kemi votuar edhe herave të kaluara. Meqënëse Ministria e Financave ka kërkuar sqarime shtesë përgjatë numrit të punësuarve. Sqarime këto që i ka dhënë drejtorja e arsimit edhe ne jemi për që këto edukatorët të vazhdojnë punën. vazhdojë mbarëmbajtja e procesit arsimor dhe këto të punësohen dhe të shpërblehen për mundin që e kanë bërë. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit Arbenita. Dëshiron dikush fjalën? Zoti Zabërgja, jo. Mehmeti. Jo. Fadil Aliu ka kërkuar fjalën.

Fadil Aliu: - përshëndetje për të gjithë. Kjo pikë është për herën e tretë që po vjen. Është e vërtetë. Megjithatë unë besoj që Komuna e Prishtinës ka vepruar në dakordim me rekomandimet qysh i ka marrë nga Ministria e Financave, respektivisht nga Departamenti për buxhet në këtë ministri ku ne kemi kërkuar kalimin e numrave që kemi pas të lirë në institucionet shkollore të nivelit fillor dhe të mesëm. Megjithatë duke pasur parasysh që dinamika në Drejtorinë e Arsimit është aq e madhe sepse kemi një numër të madh të punësuarve e po flas prej përvojës kur kam qenë edhe vetë drejtor i burimeve njerëzore aty prej muaji në muaj lëviz numri dhe kur e kemi kaluar herën e parë ata na kanë thënë që nuk i keni numrat e lirë ashtu siç keni votuar në Kuvend, pastaj është dashur herën e dytë me thënë që okay nëse është ashtu, meqënëse është një dinamikë e madhe po i kalojmë numrat komplet sa janë të lirë pa marrë parasysh sa janë, a janë 30, 40, 35 edhe kjo na është refuzuar sepse kanë thënë nuk mundem me pranë këtë gjë të tillë, por duhet specifikuar me numra. Po kthehem pak në retrospektivë për problemin me të cilin jemi duke u ballafaquar tash siç e dimë buxheti i Republikës së Kosovës ndahet për komuna për kokë banori, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë edhe është shumë e çuditshme qysh Komunës së Prishtinës nga regjistrimi i popullsisë së fundit iu ka shtuar buxheti, mirëpo paralelisht është dashur t'i shtohet edhe numri, edhe numri i vendeve të lira të punës sepse numri i përgjithshëm i shërbyesve civilë ndahet për kokë banori, dhe kjo nuk është pa te Komuna e Prishtinës. Kam kontaktuar më shumë eksponentë të Ministrisë së Financave atje sepse për besë është një situatë shumë absurde çka është duke ndodh mos me u paguar këta mësimdhënës që tash e 1 vit për shkak të mungesës së numrit, kur Komunës së Prishtinës dihet që iu ka shtuar buxheti i vet si rezultat i rritjes së popullsisë, ndërsa numri i vendeve të punës nuk iu ka shtuar. Pas bisedimeve me Ministrinë e Financave që kam kontaktuar me shumë persona atje ata më kanë sugjeruar që Komuna e Prishtinës duhet, respektivisht Drejtoria e Financave me e bërë një kërkesë tek Ministria e Financave me kërkuar me u përditësuar numri i vendeve të lira të Komunës së Prishtinës. Unë mendoj që Komuna e Prishtinës është, në bazë të numrit të ri të regjistrimit të popullsisë i takojnë minimum edhe 300-400 vende të lira sepse aashtu është vetë sistemi. Ne kur i kemi pas me 198 mijë banorë, kur i kemi pas rreth 4870 vende të punës në Komunën e Prishtinës tash me 217 mijë ishte dashur për një 300-400 m'u rrit numri i vendeve të punës. Unë jam duke folur për vende të lira që shtohet për shkak të numrit të ri të regjistrimit të popullsisë, e nëse ish bë ajo na nuk e kishim pas problemin për të cilin jemi duke diskutuar, prandaj kërkoj edhe Drejtoria e Financave në koordinim me burimet njerëzore, me e shkruar një shkresë dhe nga kabineti i Kryetarit, t'i shkruajnë një shkresë Ministrisë së Financave që të bëhet përditësimi i vendeve të punës në Komunën e Prishtinës komform regjistrimit të fundit të popullsisë. Unë besoj që nëse bëhet kjo edhe mundet me e përditësu situatën edhe mos me pas ne këso probleme. Kjo shkon përtej asaj sepse nëse ne edhe duam me e bërë çerdhe të reja, që është e pamundur me bërë edhe çerdhe të reja për nevojat e qytetarëve të Komunës së Prishtinës sepse ti i bën çerdhet, po ti numra s'ke edhe vjen në një situatë qysh jemi ardh me edukatorët në çerdhen "Dardania" dhe Xixëllonja. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit zoti Aliu. Dëshiron dikush fjalën? Jo. Atëherë lus regjinë të jetë gati për votim të pikës së katër. Propozimin e dimë për miratimin e lëvizjes së numrit të lejuar të të punësuarve në kuadër të Drejtorisë së Arsimit. Së pari konstatojmë a kemi kuorum, gjithsej 45 janë present, ka kuorum. Regjia të jetë gati për votim. Votojmë tash. Falemnderit. Me 45 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon edhe pika e katërt e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e radhës. Ju lutem për qetësi. Pika e radhës, pika pesë Propozim-vendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave,

vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Për këtë pikë të rendit të ditës, fjalën i jap drejtorit zotit Bardheci. Fjala për juve drejtor.

Driton Bardheci: - falemnderit kryesues, i nderuar Kryetar Rama, e nderuar nënkryetare Musëmurati, të nderuar kolegë drejtorë, anëtarë të Kuvendit komunal të kryeqytetit, të dashur qytetarë të Prishtinës. Së pari falnëderoj shumë të gjithë anëtarët e komisionit për koordinim të punëve dhe angazhimeve për këshilla të vendbanimeve dhe lagjeve urbane për punën dhe angazhimin e deritanishëm. Tani sot në bazë të rregullores në fuqi për përzgjedhjen e këshillave, fshatrave dhe lagjeve urbane, katër anëtarë zgjedhen, do të thotë nga asambleja komunale, nga përfaqësuesit e partive, katër grupeve kuvendare, përfaqësuesve me shumicë do thotë të partive dhe tre të tjerë do të thotë një nga shoqëria civile, një nga ekzekutivi dhe një anëtar zgjedhet nga fshati vendbanimi apo lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal. Kështu që kërkoj nga grupet kuvendare t'i kenë propozimet e tyre dhe ta votojmë këtë pikë të rendit të ditës dhe të vazhdojmë me punën dhe angazhimin tonë për zgjedhjen e këshillave lokal. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit drejtor. Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës. Vazhdojmë me grupe. Propozoni, Bekim Gashi nga LDK.

Bekim Gashi: - falemnderit kryesues. Falemnderit për të gjithë. Në emër të grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës propozojmë Egzon Pacollin.

Kryesuesi: - nga radhët e PDK-së. Kush dëshiron fjalën? Zonja Fjolla Vukshinaj.

Fjolla Vukshinaj: - atëherë ne propozojmë kolegun tonë Florian Beka për shkak të përvojës së gjatë në këtë drejtim si anëtar të komisionit për emërtim të rrugëve dhe këshillave lokal. Jo të rrugëve më fal të këshillave dhe fshatrave të vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Kryesuesi: - falemnderit. Vetëvendosja a dëshiron. Feim Osmani ka kërkuar fjalën.

Feim Osmani: - falemnderit kryesues. Përshëndetje të gjithëve. Meqë kjo pikë ka të bëjë me formimin e komisionit për monitorimin, zgjedhjen dhe mbarëvajtjen e zgjedhjes së këshillave lokal nëpër fshatra dhe lagje të Prishtinës, unë kisha dashur t'i them disa fjalë për arsye se mendoj që do të duhej këtë çështje me trajtu pak më ndryshe sesa në formën ashtu siç ka ardhur si pikë e rendit të ditës. Së pari më vjen keq që brenda kësaj pike nuk është propozuar edhe diskutimi për raportin e punës të cilin komisioni i kaluar e ka pasur të gatshëm dhe ka qenë pikë e propozuar në një prej mbledhjeve të vitit të kaluar të Kuvendit komunal, mirëpo nuk është diskutuar për shkak të mungesës së kuorumit dhe nuk është futur më asnjëherë në rend dite do të duhej që kuvendi i ri të kishte informatë deri ku ka arritur puna me këtë, puna e këtij komisioni, të cilët këshilla janë zgjedhur, të cilët kanë mbetur dhe natyrisht do duhej që të përmbledheshin edhe problemet me të cilat komisioni ka hasur me qëllim që brenda rregullores të punohej dhe të ndryshoheshin disa çështje të cilat do ta bënë më të lehtë punën e komisionit të ri. Unë mendoj që çështja që do duhej të diskutohej është rregullorja, do të duhej rregullorja të vinte për plotësim ndryshim së paku në aspektin e rimbursimit financiar të kryetarëve të këshillave, për arsye se siç e dimë ka më shumë se 20 muaj që kryetarët e këshillave i kryejnë punët e veta dhe nuk mbështeten financiarisht për punën që e bëjnë sipas ligjit të Kosovës dhe sipas rregullores së miratuar në Kuvendin komunal.

Kjo do të ishte një arsye e mirë që të diskutohej, të ndryshohej dhe kjo pjesë të bëhej. Unë nuk po them që është e vështirë për ta realizuar pagesën sepse edhe me rregullore, edhe me Ligjin për Financat është mjaftueshëm e qartë se si do të duhej të bëhej kompensimi, mirëpo të futej si kategori e veçantë brenda Drejtorisë së Financave për arsye që ekzekutimi i pagesave do të bëhej më shpejt. Natyrisht që nuk ka pasur asnjë arsye përveç mospunës së administratës. Ndoshta edhe pjesa ligjore, pjesa e Drejtorisë së Financeve nuk e ka bërë punën e vet. Mirëpo kryetarët e këshillave do të duhej të kompensoheshin për punën që e kanë bërë, sepse ka kohë të gjatë që nuk e kanë përfituar të drejtën e tyre financiare. Duke qenë se çështja është kështu edhe rregullorja nuk ka ardhur për plotësim ndryshim, ne duhet të ecim tutje. Jemi vonuar besoj shumë në zgjedhjen në fillimin e punës për zgjedhjen e këshillave që ka mbetur pa u përfunduar dhe do ta mbështesim, do ta kemi propozimin tonë. Gjithashtu do duhej të zyrtarizohej me rregullore edhe niveli i bashkëpunimit të drejtorive apo i administratës komunale me kryetarët e këshillave, sepse në terren kjo çështje nuk po vërehet, kryetarët e këshillave po ashtu dhe anëtarët e kuvendit të këshillave janë të pakënaqur me mënyrën se si po trajtohen nga drejtoritë, nga kabineti i kryetarit dhe nga të gjithë ata nga të cilët varet puna e tyre dhe bashkëpunimi i tyre për të realizuar projektet e tyre në terren. Kërkesat nuk po merren parasysh për arsye se drejtorët sidomos tek pjesa financiare aty ku duhej t'i mbështesin idetë, projektet, propozimet dhe listën prioritare që e bëjnë kryetarët e këshillave po e neglizhojnë dhe po punojnë nëpër rrugë të tjera me propozime të tjera të banorëve, të aktivistëve të ndryshëm politik dhe po neglizhohen kërkesat e kryetarëve të këshillave. Prandaj konsideroj që nëse jo në këtë seancë, sepse nuk ka ardhur dhe ne nuk jemi të përgatitur ta trajtojmë tash në një seancë të radhës të vijë rregullorja për përmirësim dhe këto dy çështje të trajtohen me seriozitet dhe të gjendet një pozicion i qartë me pikë mbështetëse, me nenë, i cili i obligon drejtorët, administratën që këto dy çështje t'i trajtojnë ashtu siç e meriton, siç do të duhej të ishte në rregullore. Pastaj tek propozimi i shoqërisë civile edhe herën e kaluar e kemi trajtuar emrin e përveçëm. Ka qenë një emër tjetër. Tash natyrisht është një emër tjetër. Do duhej që drejtori i administratës apo dikush që e ka bërë propozimin të na japë sqarim më shumë. Ne e kemi vetëm një CV të të propozuarës dhe nuk e dimë nga ka ardhur propozimi, si ka ndodhur e gjithë ecuria deri këtu sepse ai person ka të drejtë vote dhe është person i rëndësishëm njësoj sikurse edhe anëtarë të tjerë të komisionit. Prandaj kërkoj sqarim nga personi kompetent që të na e sqarojë se si ka ardhur deri te propozimi i zonjës apo zonjushës për të cilën e kemi CV këtu në email. Këto janë çështjet që unë kisha dashur t'i ngris, ndërsa si propozim nëse nuk kemi nevojë ta marrim fjalën edhe njëherë nga Lëvizja Vetëvendosje propozohet Çlirim Gërbeshi.

Kryesuesi: - falemnderit z. Osmani. Drejtori Bardheci e ka fjalën.

Driton Bardheci: - falemnderit z. Osmani. Sa i përket bashkëpunimit me këshilla lokal, ne veç kemi arrit me fillu një dinamikë të re të angazhimit, të punëve tona të përditshme. Kemi takime të rregullta mujore dhe pjesa e pagesave, veç jemi në proces drejt përfundimit të obligimeve që i kemi ndaj këshillave lokal, ndërsa sa i përket anëtarit të zgjedhur nga shoqëria civile, do të thotë është pjesë, do të thotë gjithë siç ka qenë në të kaluarën në bazë të rregullores ku ne kemi kërkuar do të thotë nga një emër nga shoqëria civile. Besoj që e kemi edhe materialin me CV - biografi të anëtarit që është propozuar nga ata. Nuk e kemi zgjedhur ne. Ashtu do jetë. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit z. Bardheci. AAK-ja ka të drejtën. Endrit Gashi e ka kërkuar fjalën.

Endrit Gashi: - përshëndetje për të gjithë. Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës propozojmë Erblina Tahiraj.

Kryesuesi: - falemnderit. Nga ekzekutivi ka një propozim. Po. Urdhëro. Kush do me propozu? Kryetar a doni ju me propozu? Driton Bardhecin e ka propozuar kryetari. Atëherë nga shoqëria civile keni emrin? E kemi, në rregull. Qysh e ka emrin? Gresa Berisha. Falemnderit.

Kryesuesi: - urdhëro z. Pacolli!

Egzon Pacolli: Në vend të Egzon Pacollit zëvendësohet me Milazim Vitia.

Kryesuesi: Faleminderit shumë. Enver Redenica e ka kërkuar fjalën.

Enver Redenica: Faleminderit kryesues, z. Kupina. Të nderuar kolegë asamblastë, drejtorë të drejtorive, ju të gjithë të pranishëm në sallë, qytetarë të dashur. Ne mirëpresim emërimin e anëtarëve të komisionit për të vazhduar formimin apo riformimin e këshillave lokal të lagjeve të Prishtinës. Këtë e kuptoj shumë mirë sepse vetë kam qenë kryetar këshilli dhe e di se këshillat lokal janë hallka e parë ku qytetari adreson problemet e lagjes përt'u përcjellë më pas te drejtoritë përkatëse në komunë. Por pikërisht këtu fillojnë problemet. Së pari gjatë zgjedhjeve të deritashme -të këshillave lokal kemi parë devijim të vullnetit të banorëve. Në shumë raste janë bartur militantë të LDK-së nga lagjia në lagjen tjetër për të zgjedhur kryetarë sipas interesit të partisë e jo të qytetarëve. Kjo ka shkelur vullnetin e banorëve, ndërsa në një rast ka përfunduar edhe me përleshje fizike dhe ndërhyrje të policisë në shkollën "Gjergj Fishta" më 24 mars të vitit 2023. Kjo dukuri nuk duhet të tolerohet më, dhe kushdo që tenton të manipulojë vullnetin e qytetarëve duhet të mbajë përgjegjësi. Prandaj ju komision i nderuar që të emëroheni sot ju bëj thirrje të garantoni zgjedhje të drejta dhe transparente. Problem tjetër është që shumica e kërkesave të kryetarëve të këshillave lokal janë injoruar deri tani. Nëse kryetari nuk është i njëjtës linjë politike me pushtetin komunal, pra me LDK-në, kërkesat e tij shpesh nuk trajtohen fare. Po e marr shembull veten, nga 64 email që i kam dërguar në komunë deri tani nga data 24.6.2023 deri më 11.11.2025 kanë marrë përgjigje vetëm gjashtë prej tyre. Kjo tregon mungesë të respektit institucional dhe moszbatim të obligimeve ligjore për t'u përgjegjur qytetarëve dhe përfaqësuesit e tyre legjitim. E njëjta gjë ka ndodhur në Shkabaj ku kryetari Avni Osmani është injoruar tërësisht, ndërsa janë pranuar si zyrtar kërkesat e një anëtar të LDK-së i cili nuk është as anëtar këshilli lokal. Po aq shqetësuese është edhe mungesa e kushteve në punë. Shumica e këshillave lokal nuk kanë zyre, ndërsa ato që ekzistojnë shpesh janë jashtë funksioni. Si për shembull zyra në Shkabaj nuk funksionon fare për arsye se Avni Osmani është anëtar i LVV-së, ndërsa ajo në tasligje është lëshuar me qira. Prandaj para se të mbahen zgjedhje të reja duhet të funksionalizohen zyrat ekzistuese dhe ato ku mungojnë të krijojnë kushte normale për punë. Dhe krejt në fund është e papranueshme që kryetarët e këshillave që e cekëm edhe më herët kanë mbetur që 20 muaj pa pagesat e tyre edhe pse kompensimi është vetëm 93 € në muaj, as ato nuk janë paguar. Me këtë qasje keni demotivuar njerëzit që kanë shërbyer për komunitetin dhe po largoni çdo interes që dikush të angazhohet në të ardhmen. Prandaj anëtarëve të rinj të komisionit ju bëj thirrje që të mos bëheni pjesë e lojrave politike të Përparim Ramës. Shikoni realitetin në terren dhe mos lejoni që këshillat lokalë të përdoren për interesa politike apo të një individi të caktuar. Së pari, paguani detyrimet që u keni

borxh kryetarëve aktual, krijoni kushte dinjitoze për punë për këshillat lokal dhe vetëm pastaj organizoni zgjedhje. Po ashtu gjeni mënyra për të arritur dhe nivelin e kompensimit të tyre. Vetëm kështu i shërbehet qytetarëve dhe jo interesave partiake. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit. Arbenita Murseli e ka kërkuar fjalën.

Arbenita Murseli: - dhe Lidhja e Prishtinës është për formimin e këtij komisioni për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave. Këshillat e fshatrat kanë një rëndësi shumë të madhe. Ato shërbejnë si urëlidhëse mes qytetarëve të Prishtinës edhe pushtetit lokal. Andaj inkurajojmë krejt banorët përmes fshatrave, këshillave të cilët do të përzgjidhen. Me sa kam informatë janë 14 këshilla që do të përzgjidhen. Po ashtu i dëshirojmë suksese komisionit që do të formohet që t'i përkrahë krejt nevojat edhe kërkesat e qytetarëve në adresimin e problematikave të tyre. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit Arbenita. Prej shtatë anëtarëve duhet me qenë tri të gjinisë femërore. LDK- doni të propozoni një emër.

Egzon Pacolli: - propozojmë Rifadije Sopin.

Kryesuesi: - Rifadije Sopi në vend të Milazim Vitisë. Po i lexoj përsëeri emrat. LDK propozon Rifadije Sopi. PDK - Florian Bekën. LVV - Çlirim Gërbeshin. AAK - Erblina Tahirajn, nga ekzekutivi - Driton Bardhëci, nga shoqëria civile Gresa Berisha. Së pari konstatojmë kuorumin. 46 janë prezent. Votojmë tani! Falemnderit. me 37 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kalon edhe pika pestë e rendit të ditës. **Propozim-vendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave, fshatrave, vendbanime dhe lagjeve urbane.** Falemnderit shumë. Vazhdojmë me pikën e radhës, pika gjashtë. **Propozim - vendimi për caktimin e anëtarëve të komisionit për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendësrejtoreve të institucioneve edukative, arsimore dhe aftësuese të kryeqytetit.** Për këtë pikë fjalën ia jap drejtorit Elshani.

Arianit Elshani: - përshëndetje njëherë për të gjithë. Para vetes e keni një draftvendim pra që është proceduar nga Drejtoria e Arsimit që ka të bëjë lidhur me komisionin për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendësorëve të të shkollave. Aktualisht janë 23 pozicione që do të hapen për institucionet arsimore për shkolla të cilët kanë mungesë të drejtorëve dhe zëvendësrejtoreve dhe sigurisht që këto duhet të mbulohen, dhe prandaj kërkohet që të procedohet tutje ky komision i cili sipas udhëzimit administrativ nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, parasheh që dy anëtarë në këtë rast të jenë nga përfaqësues të DKA-së që propozohen nga Drejtoria e Arsimit dhe një përfaqësues pastaj që është nga Ministria e Arsimit për secilën prej këtyre kategorive që do të hapen. Prandaj i keni emrat të cilët janë znj. Fitnete Tutuli që e keni bashkëngjitur edhe CV po ashtu që ka trajnimin dhe certifikimin për udhëheqjen në arsim që është e domosdoshme për të qenë pjesë e komisionit si përfaqësuese e drejtorisë. Pastaj z. Isak Bregaj i cili është drejtor me performancë të lartë i cili është drejtor shkolle po ashtu, dhe në rast të mungesës së tij e që nevojitet në këtë rast vendimi i kuvendit komunal z.Egzon Gashi i cili është prej pjesës së shoqërisë civile si ekspert i arsimit. znj. Fitnete dhe Egzoni kanë qenë paraprakisht edhe në komisionet e kaluara, janë miratuar nga Kuvendi komunal edhe kanë qenë pjesë e këtyre komisioneve përgjegjëse. Prandaj dy anëtarë të tjerë të cilët nuk nominohen në këtë rast nga kuvendi dhe nuk votohen janë edhe vëzhguesit që do të jenë të pranishëm të cilëve do t'u bëhet nga Drejtoria e Arsimit, ftesë Këshillit të Prindërve dhe mësimdhënësve për të qenë pjesë e vëzhgimit të këtij procesi. Janë tre

institucione, pra tre kopshte të cilët do të shpallen pozitat dhe 15 shkolla fillore dhe 5 shkolla të mesme të larta të cilat duhet të plotësohen me këto pozicione. Rekomandoj edhe njëherë. Kërkoj mbështetjen tuaj për këtë draft-vendim të përgatitur nga Drejtoria e Arsimit. Falemnderit shumë.

Kryesuesi: - falemnderit drejtor. Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës. Shkojmë me shefat e grupeve. Nëse dëshiron fjalën dikush. z.Pacolli e ke kërkuar fjalën? E përkrahni. Në rregull. Falemnderit. Vazhdojmë me PDK-në. Vazhdojmë me LVV-në. z. Sveçla e ka kërkuar fjalën.

Gëzim Sveçla: - është shumë i rëndësishëm komisioni të cilin sot po e votojmë në Kuvendin komunal, sepse puna e cila është kompetencë e tyre ka të bëjë me përzgjedhjen e menaxherëve të institucioneve shkollore rrjedhimisht në përgjegjësi të tyre si personat kryesorë në shkolla kudo që zgjidhen dhe cilët do që zgjidhen, ka të bëjë me gjeneratat e ardhshme. Natyrisht që një drejtor ose një menaxher i zoti dhe dinamik në punën e tij rezulton pashmangshëm me suksese për shkollën e vetvetiu edhe me nxënësit të cilët ndjekin mësimin në ciltado qoftë shkolla. Duhet potencuar se edhe gjatë mandatit të kaluar disa herë na ka ardhur si pikë e rendit të ditës, por nuk është votuar sepse ka pasur një insistim shumë të madh nga zonja nënkryetare e kryeqytetit e cila në atë kohë nuk ishte as drejtoreshë sepse paraprakisht Përparimi e kishte shkarkuar gjatë pushimit të lehonisë, por ka pasur një insistencë të saj para seancave nëpër këto kafet këtu rreth që mos ta mos ta votojmë një komision të tillë çfare na ka ardhur, sepse rrezikojmë që drejtorët ose shkollat t'i mbushim me militant të LDK-së edhe nuk e kemi votu. Tash sot neve na duhet të kërkojmë garanci që nuk do t'i mbushim me militantë të PDK-së. Po pikërisht për këtë duke u bazuar në konsistencën tënde na duhet kjo garanci. Tani për këtë pjesën e propozimeve dy nene të rregullorës, jo udhëzim administrativ drejtor, rregullore është, pika 11 ka të bëjë dhe flet për kualifikimin e anëtarëve të komisionit i cili duhet të jetë i barazvlefshëm me kushtet për kandidimin e kandidatëve për drejtor dhe zëvendëjtarë. Unë i kam dyshimet e mia që zonja të cilën e keni propozuar për kryesuese të komisionit i ka këto kualifikime nga CV-ja të cilën na e keni dërguar dje pas mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ku e kemi kërkuar, shohim që e ka mbaruar fakultetin në AAB dhe ka të bëjë me edukimin dhe mirëqenien e fëmijëve. Ndërkohë këtu është e propozuar për kryesuese të komisionit. Gjithashtu të njëjtës Ia keni ndërprerë pushimin pa pagesë, ka qenë pushim pa pagesë dhe e keni ftuar për me qenë kryesuese e komisionit. Duhet sqarime për këtë çështje. Rregullorja thotë që Kuvendi komunal i voton dy emra. Ju na i keni sjell tre. Qysh e keni llogaritur këtë punë, e dini ju? Pika 12 flet për paanshmërinë politike të anëtarëve të komisionit. A jeni të sigurt që këta anëtarë të komisionit kanë paansshmëri politike? Mos kanë farë lidhje familjare politike diçka? Duke pa që nuk keni qenë konsistent në qëllimet, që i shërbejnë publikës dhe duke u bazuar në këta që na keni sjellë, ne nuk mund ta përkrahim dhe të mbështesim formimin e këtij komisioni. Ose te drejtori i shkollës. Në CV-në e tij nuk e keni shkruar që gjatë mandatit që ai ka qenë drejtor i shkollës, në atë shkollë janë mbajtur ligjërata për gjykatën speciale. Sa e rëndësishme është gjykata speciale?

Ka pasur reagim shumë të madh me të drejtë të Partisë Demokratike të Kosovës në atë kohë. Atë drejtor e keni fut anëtar të komisionit. Prandaj gjithë këto veprime Lëvizja Vetëvendosje voton kundër këtij komisioni. Falemnderit.

Kryesuesi: - Betim Abdullahu e ka kërkuar fjalën.

Betim Abdullahu: - përshëndetje. Të njëjtin sqarim deshta me marrë prej drejtorit për drejtorin Isak Bregaj, për shkak se shumica prej anëtarëve të Kuvendit komunal të Partisë Demokratike ka kërkuar shkarkimin e tij për shkak pytesorëve që janë mbajt në janar të këtij viti. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit. Lumnije Mikullovcit e ka kërkuar fjalën.

Lumnije Mikullovcit: - përshëndetje për të gjithë. Falemnderit z. kryesues për fjalën e dhënë. Ky propozim - vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve edukative arsimore dhe aftësitë në kryeqytet kanë një rëndësi të veçantë sepse lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e udhëheqjes së shkollave tona. Prandaj është e domosdoshme që komisionet të bërëbhen nga persona me integritet, profesionalizëm dhe paanshmëri, duke garantuar që procesi i përzgjedhjes të jetë transparent, i drejtë dhe i bazuar vetëm në meritë. Fëmijët, mësime dhënësit dhe prindërit meritojnë drejtues që kanë vizion, përgatitje profesionale dhe aftësi menaxhuese. Çdo ndikim politik apo favorizim do të dëmtonte besimin e qytetarëve në institucionet tona arsimore. Prandaj, kërkoj që ky proces të zhvillohet me përgjegjësi të plotë në përputhje me ligjin dhe në interesin më të mirë të arsimit në kryeqytet. Ju falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit znj. Mikullovcit. Besart Krasniqi e ka kërkuar fjalën.

Besart Krasniqi: - përshëndetje të gjithëve. Të nderuar kolegë asamblistë. Meqënëse po flasim për arsimin, dua të flas sot për procesin e mësimit tërëditor në Komunën e Prishtinës, në veçanti shkollën fillore “Zenel Hajdini” në Kodrën e Trimave. Duhet ta theksojmë në fillim se mësime dhënësit, as nxënësit, as prindërit e tyre, por as unë nuk jemi kundër mësimit tërëditor. Ajo që na shqetëson neve është fakti se mënyra qysh funksionon mësimi tërëditor në shkollën fillore “Zenel Hajdini” në Kodrën e Trimave, tash gati dy vite. Domethënë për me qenë një mësime tërëditor më funksional, për me qenë i efektshëm, duhet t'i paraprijë disa kushte, ndër to janë hapësira më të mëdha, aktivitete ditore, kuzhina për ushqim deri më tani që dy vjet nxënësit e shkollës “Zenel Hajdini” ushqehen në sallën e sportit e në mungesë të sallës së sportit ata nuk kanë mundur me bë as aktivitete sportive ose i kanë bërë jashtë përgjatë sezonit të dimrit ose kur ka rënë shi nuk kanë mund me mbajt hiç. Po ashtu distanca për të shkuar në shkollë po krijon kosto financiare për nxënësit si dhe domethënë mungesat në praninë në shkollë. Domethënë kanë mungesa për shkak se tash kur u bë ky ndryshimi mes “Asim Vokshi” e “Zenel Hajdinit”, domethënë dikush është me lokacion goxha larg e ka shkollën “Zenel Hajdini”. Po ashtu domethënë vërehet se nxënësit sipas prindërve të tyre një agresivitet më i madh për faktin se nuk kanë domethënë aktivitete ditore, por normal që është shqetësuese kur nxënësit rrinë tetë orë në një karrige të drurit dhe nuk kanë aktivitete ditore. Të paktën unë mendoj që Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Arsimit do të duhej që t'i mbështesë shkollat sidomos “Zenel Hajdinin” dhe plot shkolla të tjera që një herë në javë të paktën të shkojnë në aktivitet sportiv relaksues në parkun Gërmi ose në Touk Bahçe. Dhe pyetja e fundit është nga unë, por edhe mësime dhënësit më kanë drejtuar, kanë thënë a keni ndonjë plan para për fillimin e vitit shkollor për këto dy shkolla, “Zenel Hajdini” dhe “Asim Vokshi”. A ka me funksionu të ndara qysh kanë qenë sivjet apo po mendoj të bashkuara, si dhe është mirë që këtë plan me na tregu neve sot këtu po ashtu edhe mësime dhënësit dhe nxënësit me ju drejtu me një mënyrë zyrtare në informim sepse ata nuk e dinë a kanë me banuar në shkollë me “Zenel Hajdinin” apo me “Asim Vokshin”. Kështu që këto janë kërkesa shumë të rëndësishme që unë mendoj që Drejtoria e Arsimit duhet me i marrë me përkushtim të madh. Ish-drejtori i kaluar më ka akuzuar mua në fushatë që po bëj fushatë me çështjen e shkollës “Zenel

Hajdini”. Unë nuk kam bërë fushatë. Fushatë ka bërë pikërisht Përparim Rama dhe ish-drejtori që nuk po dua as emrin me ia përmend. Mendoj që duhet me marrë hapa konkret me rregullu këtë çështje se tash nuk jemi në fushatë. Tash domethënë jemi vitin e parë të qeverisë së Ramës. Kështu që është mirë konkretisht me bërë një zgjidhje për këto dy shkolla sepse lagjja jonë është një lagje që ka kontribuar shumë për Prishtinën, për vendin. Nuk është mirë me lënë anash qysh po e lë LDK-ja, tash e pesë vite në pushtet. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit z. Krasniqi. Jeta Dida - Bujari e ka kërkuar fjalën.

Jeta Dida – Bujari: - i nderuar kryesues, i nderuar kryetar i komunës, të nderuar kolegë e asamblistë, drejtorë komunal. Duke u ndalur te pika e pestë e rendit të ditës, e ndjej obligim moral dhe institucional ta ngre një shqetësim që nuk buron vetëm nga një përvojë personale, por nga një precedent që nuk duhet të përsëritet më në sistemin tonë arsimor. Në vitin 2020 u emërova ushtruese e detyrës së drejtoreshës së shkollës së mesme të lartë “Prek Jakova” në Prishtinë. Në 2021 mora pjesë në konkursin e rregullt dhe i përmbusha të gjitha procedurat ligjore dhe natyrisht u përzgjedha drejtoreshë me mandat katërvjeçar. Dy vjet më vonë, Drejtoria e Arsimit Komunal anuloi kontratat e 35 drejtorëve me arsyetimin se gjatë procesit të përzgjedhjes paskan ekzistuar parregullësi procedurale. Dua të theksoj qartë se këto nuk ishin parregullësi të shkaktuara nga drejtorët. Ishin nëse ekzistonin përgjegjësi të administratës që kishte organizuar procesin. Megjithatë pasojat i bartëm ne. Për muaj të tërë u krijua pasiguri në 35 shkolla të kryeqytetit, u destabilizua menaxhimi i institucioneve arsimore, u dëmtua klima e punës dhe u godit rënd integriteti profesional i drejtorëve. Disa u tërhoqën, disa si unë vazhduam dhe ju nënshtroam edhe njëherë intervistave për të njëjtat pozita që tashmë i kishin fituar sipas ligjit. Ky ishte një nënçmim institucional, por fatkeqësisht kjo nuk ishte e tëra. Në atë periudhë kolegët nga 35 shkollat tona tregonin se janë thirrur për takim ose me telefonatë nga disa zyrtarë të drejtorisë komunale të cilët i inkurajonin të kandidonin kundër drejtorëve aktual duke krijuar bindjen se ne nuk do të rikthehemi në pozitat tona. Kjo nuk ishte garë e ndershme. Kjo ishte ndërhyrje në proces që duhej të ishte i paanshëm, transparent dhe i bazuar vetëm në meritë. Për fat ato llogari nuk dolën. Shumica prej nesh u rikthye me dinjitet në detyrë dhe vazhduan punën me shumë sukses. Në rastin tim si drejtoreshë e të vetmes shkollë profesionale të muzikës në kryeqytet vazhduam të arrijmë suksese të jashtëzakonshme brenda dhe jashtë Kosovës duke e përfaqësuar me dinjitet Prishtinën me mbi 80 nxënës në vende të Evropës si në Itali, Kroaci, Slloveni dhe Shqipëri. E them këtë sot jo për të rikthyer një histori personale, por sepse institucionet duhet të mësojnë nga gabimet e tyre. Asnjë drejtor, asnjë mësimdhënës dhe asnjë punonjës publik nuk duhet të bëhet viktimë e gabimeve procedurale të administratës. Stabiliteti në udhëheqjen e shkollave është parakusht për cilësinë e arsimit. Ndryshimet arbitrare, presionet dhe manipulimet politike nuk prodhojnë arsim më të mirë, prodhojnë vetëm pasiguri dhe humbje besimi në institucione. Prandaj kërkoj që çdo proces i emërimit të drejtorëve të zhvillohet me transparencë të plotë, profesionalizëm dhe respektim të ligjit në mënyrë që të mos përfetojmë më situata të tilla që dëmtojnë njerëzit, shkollat dhe vetë sistemin arsimor. Ju falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit znj. Dida. Nënkryetaria e ka kërkuar fjalën, Besiana.

Besianë Musëmurati: - falemnderit shumë kryesues. Atëherë përshëndetje për të gjithë për shkak që e përmendët emrin tim edhe në cilësinë e ish-drejtores të arsimit. Kam kënaqësinë me ju treguar që procesi i rekrutimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave të Prishtinës ka qenë

procesi më transparent i rekrutimit mendoj në Republikën e Kosovës. Edhe për këtë gjë jam jashtëzakonisht shumë krenare. Më vjen shumë mirë që edhe Jeta e mori fjalën sepse Jeta asambleiste tashmë e Lëvizjes Vetëvendosje, Rifadije tashmë asambleiste e LDK-së janë zgjedhur drejtoresha në kohën kur unë kam qenë drejtoresha e arsimit. Kjo tregon asnjë asambleistë i PDK-së sot nuk është drejtor shkollë qysh edhe po e shihni. Asnjë kandidat për asamble i PDK-së nuk ka qenë në listë i cili është drejtor apo ka qenë drejtor apo zëvendësdrejtor shkollë, por ka pasur të tillë që kanë qenë edhe në LDK edhe në Lëvizjen Vetëvendosje. Kjo tregon që PDK-ja asnjëherë nuk e ka pas për qëllim dhe prapë nuk e ka për qëllim, do të thotë politizimin e shkollave të Prishtinës. Jam shumë e lumtur që Arianiti e ka bërë një punë të jashtëzakonshme. Ka vazhduar punën të cilën e kemi bërë edhe e ka emëruar në komision Fitnetes Tutulin të cilën për besë Gëzim po vjen keq që nuk 'po e votoni sepse të njëjtën e keni votuar më herët. Në qoftë se folni për konsistencë mirë është me qenë konsistent jo veç me fol për konsistencë. Fitnetja që me ditë ju është një ndër personat e vetëm në Drejtorinë e Arsimit që është trajnuar prej Ambasadës Britanike që me bërë rekrutimin sa më meritues dhe është meritë e punës së fitnetes dhe komisioneve që sot Jeta siç e tha me të drejtë, procesi ka qenë jashtëzakonisht transparent edhe i përgjegjshëm. U përmend edhe çështja e Egzonit, po besoj që për Egzonin ishte fjala kur ju referuat familjarëve. Egzon Gashi është, do të thotë një prej udhëheqësve të një prej institucioneve më të mira arsimore në Republikën e Kosovës. Është doktor shkence prej Universitetit Johns Hopkins në SHBA. Nuk po besoj që do të thotë i vëni në dyshim kredencialet e tij si person, së pari akademik me thirrje të duhura akademike. Gjithashtu ka qenë i trajnuar nga Ambasada Britanike në të kaluarën për me bërë rekrutimin sa më meritues. Edhe ka qenë person që gjithashtu Jeta Didën të cilën e ke afër e ka zgjedhur si drejtoreshë të shkollës edhe që e përgëzoj për punën që e ka bërë, për punën si drejtoreshë të shkollës njëjtë edhe dijen. Kështu që ju kisha lutur politizimin ta lëni anash ju, sepse asnjëherë nuk ka qenë qëllim i Partisë Demokratike me politizuar këtë proces, përkundrazi i kemi bërë ballë të gjitha sfidave, të gjitha sulmeve që i kemi pasur. Kështu që ky proces do të jetë i njëjtë prapë edhe jam shumë e lumtur që Arianiti do ta udhëheq.

Kryesuesi: - falemnderit nënkryetare. Gëzim Sveçla e ka kërkuar fjalën.

Gëzim Sveçla: - falemnderit kryesues. znj. nënkryetare, folët për konsistencë dhe përmendët që ne e kemi votuar këtë komision. Po, sepse ne kemi besuar në qëllime të mira, por zhvillimet e mëvonshme politike, metamorfoza juaj ka ndikuar që ne mos me e besu më këtë që bëni ju. Edhe po ju referohesh zonjës Dida. Zonja Dida është aty për shkak të përgatitjes së vet dhe kapaciteteve të veta. Jo që ai komision e ka zgjedhur, e paska zgjedhur komisioni. E para, nuk ju referova në fjalimin tim përgatitjes profesionale të anëtarit të shoqërisë civile të cilin ju e keni propozuar. Nuk e përmenda përgatitjen profesionale. Unë e përmenda nenin e rregullores që ka të bëjë me paanshmërinë politike. Nuk e di pse u more me pjesën profesionale. Kush e qiti këtë në diskutim? Sepse askund nuk thotë që nëse është shumë profesional po edhe ka lidhje familjare, nuk ka lidhje. Nuk e thotë rregullorja. Prandaj është mirë me u koncentruar dhe me u fokusuar në atë që e them. Edhe i bëra do pyetje te drejtori. Mirë që u përgjigje ti. Drejtori nuk e ka vazhduar punën tuaj, e ka vazhduar punën e një drejtori paraprak që ka qenë i LDK-së. Ti shumë moti po e përsëris, prej pushimit të lehonisë edhe shkarkimit prej Përparim Ramës, për të cilin ti ke thënë na e ka humbur shpresën e qytetit. Pajtohen këtu me ty, por kjo metamorfoza prej humbjes së shpresës në krahun e tij të djathtë më bën mos me besuar në qëllimet tua me keqardhje.

Kryesuesi: - falemnderit z. Sveçla. Drejtori i arsimit e ka kërkuar fjalën.

Arianit Elshani: - me dorën në zemër për të më shumë mendohet që është me një subjekt tjetër politik, se sa që është Jo jo shiko shiko, po e them publikisht që më shumë mendohet që me një parti tjetër politike sesa që ka lidhje me Partinë Demokratike të Kosovës, por idëqoftë pavarësisht asaj e vlerësojmë faktin e gatishmërisë për me qenë pjesë e këtij paneli. E dyta, çështjen e mësimit tërëditor që u përmend pak a shumë, disa diskutime i ke mbajtur edhe me “Asim Vokshin” edhe me “Zenel Hajdinin”, është çështje që është vështirë me u ndryshu. Po përgjigje zyrtare brenda kësaj jave për këtë punë deri në të premtën e kemi definitive. Kështu se i kanë bërë të gjitha planifikimet të dy shkollat, edhe drejtoresha e shkollës së “Zenel Hajdinit” edhe në anën tjetër edhe të “Asim Vokshit”. Në raport me komision nuk po shtoj diçka tjetër se lidhjet familjare në fund nuk duhen me ndikuar së paku. Unë mendoj që janë edhe format e caktuara ato që e qesin para përgjegjësisë secilin. Në fund është edhe Agjencioni kosovar kundër korrupsionit në çfarëdo formati të konfliktit të interesit për ndonjë anëtar të subjektit politik që janë bashkë diku një organizatë mundet me marrë veprime. Po po them prapë po e potencoj më shumë ka diskutime brenda partisë se ai është me një parti tjetër politike sesa që mundet me qenë me Partinë Demokratike Kosovës.

Kryesuesi: - falemnderit drejtor. A dëshiron dikush fjalën? Jeta Dida ka kërkuar fjalën.

Jeta Dida - Bujari: - i nderuar drejtor, pavarësisht se tash jeni përfaqësues i një partie politike, unë besoj se arsimi në kryeqytet do të duhet të jetë absolutisht jo i politizuar, sepse prej drejtorëve të shkollave me shumë të drejtë kërkohet që të jenë njerëz apolitikë. Edhe është një gjë tepër e mirë për shkak se asnjë drejtor nuk mund të anojë në asnjë parti politike derisa udhëheq një institucion shkollor, por ajo nuk bëhet edhe përbrenda DKA-së. Do të thotë DKA-ja e jep një shembull jashtëzakonisht të vrazhdë në këtë aspekt. Po ju lus të jeni pakëz më, jo ju personalisht por duke u referuar në situatat që kemi parë paraprakisht është mirë që të jeni pak më nën hije kur flitet për një parti politike që përfaqësoni për shkak të interesave të mëdha të fëmijëve tanë. Kështu që, ju kisha lutur që vetëm ta konsideroni si një ide e cila ishte dashur të konsiderohet me shumë apo të merret me shumë seriozitet nga të gjithë, sepse arsimi mendoj se duhet të jetë prioritet. Edhe unë besoj se të gjithë ne këtu e kemi arsimin prioritet, por si i qasemi atij ajo pastaj po na diferencon. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit znj. Dida. Çlirim Gërbeshi e ka kërkuar fjalën.

Çlirim Gërbeshi: - për besë, kështu është pak për keqardhje. Kërkush i PDK-së nuk çohet me fol për drejtorin që dikur e kanë kundërshtuar. Domethënë ky drejtor e ka lejuar me hy me mbajtur ligjërata për gjykatën speciale. Edhe ju nuk thoni asnjë fjalë. Çka me bë me ato deklaratat e juaja që i keni pas më herët.

Kryesuesi: - falemnderit z. Gërbeshi. Dikush tjetër? Jo. Atëherë lus regjinë të jetë gati për votim. Konstatojmë kuorumin njëherë. 45 janë prezentë. Falemnderit shumë. Regjia të jetë gati për votim. Votojmë tani për pikën e gjashtë. **Propozim - vendimi për përcaktimin e anëtarëve të komisionit për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendësrejtoreve të institucioneve edukative, arsimore dhe aftësuese në kryeqytet.** 26 vota për, 13 kundër, një abstenim. Kalon edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e radhës. Pika e shtatë e rendit të ditës. **Propozim - vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për caktimin e anëtarëve të komisionit e**

aksionarëve në ndërmarrjet publike të Komunës së Prishtinës. Hapi diskutime për këtë pikë të rendit të ditës. Nga radhët e LDK-së Ka propozime? Egzon Pacolli ka fjalën.

Egzon Pacolli: - atëherë prej Lidhjes Demokratike të Kosovës propozohen për ndërmarrjen publike Sport marketing aksionarët Vedat Jashari edhe Astrit Gashi.

Kryesuesi: - falemnderit shumë. A ka të tjerë? A ka dikush tjetër me shtu ndonjë gjë? Nuk ka. Atëherë konstatoj korumin. Gjithsej 47. Lidhja Demokratike e Kosovës propozon Vedat Jasharin dhe Astrit Gashin për aksionarë në ndërmarrjen publike Sport marketing. Lus regjinë të jetë gati për votim.

Votojmë tani. Me 25 vota për, 4 kundër, një abstenim kalon edhe kjo pikë, pika e shtatë. Vazhdojmë me pikën e radhës. **Propozim - vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL Prishtina Parking.**

Për këtë pikë fjalën i jap drejtoreshës të financave.

Valbona Makolli: - falemnderit kryesues. Përshëndetje të gjithë anëtarëve asamblastë të Kuvendit Komunal të Prishtinës. Paraqes propozim-vendimin e mbledhjes së kaluar i plotësuar me vlerën duke pa situatën e ngarkuar të ndërmarrjes Prishtina Parking. Ndarja prej vlerës 100.000€ nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve. kodi ekonomik 16306 ku edhe materialet e nevojshme dhe arsyetimet janë të bashkëngjitura në materialin të cilin është dërguar. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit drejtoreshë. Hapi diskutime për këtë pikë të rendit të ditës.

Shkojmë me grupe nëse doni. Dëshiron fjalën Egzon. Jo. Nga radhët e PDK-së dëshiron fjalën dikush? Jo. Nga Lëvizja Vetëvendosje fjalën e ka kërkuar Nora Kelmendi.

Nora Kelmendi: - falemnderit shumë. I nderuar kabinet, asamblastë. Më lejoni që këtu shkurtimisht para jush t'i paraqesim vërejtjet tona sa i përket vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për këtë ndërmarrje publike lokale. Dokumenti i cili është dorëzuar tek ne përmban vetëm bazën ligjore dhe dispozitivin ku miratohet ndarja e mjeteve financiare për NPL Prishtina Parking. Preambulla ka një bazë ligjore të kufizuar, sepse janë cituar vetëm neni 12 me paragrafe i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe neni 34 i Statutit të Komunës së Prishtinës. Në pikën dy mungon analiza financiare dhe baza materiale dhe kemi vetëm një vendim i cili nuk shpjegon bazën faktike dhe juridike dhe arsyet pse financimi është i nevojshëm, si dhe për çfarë qëllime do të përdoren këto mjete në shumë prej 100.000 eurove. Pse e keni përdorur kodin ekonomik 16306 dhe çfarë ndikimi do të ketë kjo ndarja në buxhetin komunal? Në pikën tre ju i referoheni kërkesës e cila asnjëherë nuk mund ta zëvendësojë vlerësimin e komunës. Komuna në bashkëpunim me aksionarët dhe menaxhmentin e ndërmarrjes nuk ka bërë asnjë vlerësim dhe kemi vetëm një kërkesë të ndërmarrjes ku thuhet se borxhi është 900.000 euro, por askund nuk arsyetohet shuma e kërkuar prej 100.000 euro. Pra, pse pikërisht keni vendosur që t'i ndani 100.000 euro dhe sipas cilit kalkulim është vendosur që kjo shumë është e mjaftueshme dhe e arsyeshme për t'i mbuluar detyrimet e kësaj ndërmarrjeje? Subvencionin nuk lidhet askund me interesin publik, por në arsyetim vetëm thuhet se duhet t'i vazhdojmë shërbimet në mënyrë që të paguhet obligimet emergjente dhe të sigurohet vazhdimësia e operimit. Pra nuk sqarohet se cilat shërbime do të ndërpriteshin, nëse nuk do të subvencionohej ndërmarrja dhe çfarë pasoja do të ketë kjo për qytetarët. Pra, thënë shkurt, ekziston një arsyetim faktik minimal në kërkesën e një ndërmarrjeje lokale publike dhe kemi të bëjmë me një arsyetim tepër të përgjithshëm i cili nuk ofron analiza konkrete për interesin publik. Për më tepër, mënyra e hartimit të vendimit lë hapësirë për të vënë

në dyshim nëse ai është nënshtruar një shqyrtimi të plotë juridik para procedimit për miratim në këtë Kuvend komunal apo nëse ky vendim është sjellë këtu vetëm për të përmbushur formalisht kërkesën për motivim të punëtorëve të ndërmarrjes pa adresuar në thelb arsyet që justifikojnë këtë vendimarrje. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit znj. Kelmendi. Nga radhët e AAK-së dëshiron fjalën dikush? Jo. Lidhja e Prishtinës. Jo. Dëshiron dikush fjalën tjetër? Jo. Në rregull. Atëherë vazhdojmë me Enver Rednicën.

Enver Redenica: - falemnderit kryesuesi z. Kupina. Është hera e tretë që në këtë sallë mundoheni në emër të NPL Prishtina Parking të ndani taksat e qytetarëve për shokët e Përparim Ramës dhe të Sokol Havollit që kanë keqpërdorur paratë e kësaj ndërmarrjeje deri tani. Duhet kujtuar se pas qëndrimeve tona si Vetëvendosje dhe presionit mediatik kanë filluar dhe dorëheqjet aty, përfshirë raportet e keqësuarat të këtyre dyve Përparimit dhe Sokolit, por kjo është e pamjaftueshme duhet një hetim i plotë aty. Ne edhe herëve të kaluara kemi thënë se ne në parim jemi me mbështet këtë ndërmarrje dhe punëtorët e saj, por fillimisht duhet të kemi raporte të detajuara se kush dhe si e vodhi këtë ndërmarrje dhe e sollën në buzë të falimentimit. Pra dikush duhet të japë llogari sepse aty ka ndodhur një hajni e madhe dhe duhet prokuroria të hetojë sa më parë. Është e tmerrshme që dhe tani menaxherët e kësaj ndërmarrjeje po vazhdojnë me plaçkitje të qytetarëve. Unë këtu me vete kam argumentet dhe informatat e sakta se si qytetarë po plaçkiten në vend se ndalet 1 euro në parking, ndërmarrja ndal 7 deri në 8 euro dhe këtë e bëjnë me vetëdije për përfitime të disa personave aty. Këtu unë kam siguruar edhe numrin e tabelave të disa veturave të atyre që ua kanë plaçkitur paratë duke shkaktuar qëllimshëm problem me aplikacion se gjëja nuk po funksionon. Nga kjo sallë u bëj thirrje të gjithë qytetarëve të Prishtinës që të keni kujdes kur parkoni veturën te Prishtina Parking, se sa mjete po ju ndalen se po plaçkitni pa i vërejtur llogaritë e juaja. Për këto posedoj informata të sakta. Tani loja me shifra të parave herë 700.000 e herë 100.000 që doni t'i ndihmoni kinse kësaj ndërmarrjeje ta çon mallin e tregtarëve dhe siç po shihet dikujt doni t'i përmirësoni xhirollogarinë, e kujt tjetër pos Përparim Ramës dhe Sokol Havollit i cili ende po përzihet aty, bile ky i fundit arriti të nxjerrë në protestë punëtorët duke e lajthitur edhe vetë sindikatën e kësaj ndërmarrjeje. Për këtë gjë kam informata të bollshme nga vetë punëtorët që m'i kanë dërguar mua se si shantazhojnë njëri-tjetrin që mos të zbulohet plaçkitja e tmerrshme në këtë ndërmarrje dhe krejt kjo në kurriz të qytetarëve dhe parasë publike besa dhe të vetë punëtorëve që janë viktimë e këtyre të dy të lartëcekurve Ne normal që jemi kundër këtyre pazareve, rrjedhimisht i bëjmë thirrje prokurorisë t'i hetojë këto raste duke u nisur nga Sokol Havolli deri te Përparim Rama. Këta duhet të marrin dënimin e merituar që kanë keqpërdorur dhe po keqpërdorin para publike që më pas të jetë një mësim i mirë për pasardhësit se nuk duhet vjedhur taksa e qytetarëve më. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit z. Redenica. Lumnije Mikullovcit e ka kërkuar fjalën.

Lumnije Mikullovcit: - ju falemnderit. Prishtina Parkingu ofron një shërbim me rëndësi për qytetarët dhe punëtorët e saj meritojnë trajtim dinjitoz. Çdo vendim për darjen e mjeteve financiare duhet të jetë i shoqëruar me transparencë të plotë dhe me një plan të qartë për përdorimin e tyre. Qytetarët kanë të drejtë të dinë pse ka ardhur ndërmarrja në këtë gjendje, si do të shpenzohen mjetet dhe çfarë masa do të merren që të mos përsëritet i njëjti problem në të ardhmen. Po ashtu është e domosdoshme të garantohet se pagat dhe të drejtat e punëtorëve do të respektohen dhe se

ndërmarrja do të ketë një plan të qëndrueshëm financiar e menaxherial. Ne duhet të marrim vendim që të mbrojmë interesin publik, punëtorët dhe qytetarët e Prishtinës, duke kërkuar përgjegjësi, llogaridhënie dhe menaxhim të mirë të parasë publike. Ju falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit znj. Mikullovc. Feim Osmani e ka kërkuar fjalën.

Feim Osmani: - falemnderit kryesues meqë është e disata herë që po vihet ne rend në Kuvend dhe informatat janë të njëjta tashmë edhe shuma e kërkuar është e njëjtë 100 mijë euro, unë pa marrë parasysh për cilën ndërmarrje është fjala edhe po të ishte një institucion cilido qoftë që kërkon ndihmë nga Kuvendi komunal ndihmë financiare me këtë arsyetim me të cilin na ka ardh dhe me këto informata që i kemi nuk do ta përkrahja për arsye se është arsyetim minimalist. Një ndërmarrje për të cilën e kemi parasysh dhe e dimë të gjithë që është me potencial të jashtëzakonshëm financiar për ta ndihmuar Kuvendi komunal apo ekzekutivi i Komunës së Prishtinës do të duhej ta kishte një plan të mirëfillt biznesi, i cili do të kishte të bënte me zgjerimin apo ndryshimin e madh të games së shërbimeve që i ofron në këtë rast nuk është gjendja e tillë, por është një ndihmë financiare të cilën nuk po e dimë se ku do të shkojë edhe çfarë zbrastie e ndërmarrjes do të mbulohet me të. Sidoqoftë unë mendoj që ky Kuvend komunal e ka për obligim vetëm dy çështje t'i trajtojë në lidhje me ndërmarrjen në fjalë. Së pari do të duhej ta formonte një komision i cili do ta hetonte punën 5 - vjeçare të menaxhamentit të kësaj ndërmarrjeje sepse edhe njëherë po e përsëris janë ndërmarrje me kapacitet të tillë financiar e nuk do të duhej të vinte në gjendje që t'i sillte në diskutim edhe pagat e punëtorëve, ndërsa gjëja e dytë e cila do të duhej të kryhej tashmë do të ishte ta sillte rregulloren për plotësim- ndryshim për ta përshtatur me vendimet e gjykatës kompetente as asnjë vendim tjetër pa marrë parasysh se në çfarë forme është nuk do të duhej që të përkrahej nga ky Kuvend komunal sepse jam i sigurt që nuk do t'i bëjë mirë ndërmarrjes, por vetëm se do të ia rrisë apetitet që ata të vazhdojnë me keqpërdorime dhe me keqmenaxhim edhe më tutje, falemnderit shumë.

Kryesuesi: - falemnderit zoti Osmani, Ilirik Musliu ka kërkuar fjalën.

Ilirik Musliu: - falemnderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Mora fjalën për faktin që sot po e diskutojmë një çështje që nuk lidhet veç me një ndërmarrje publike, po lidhet me një prej funksionimit të shërbimit më të rëndësishëm të kryeqytetit. Ndërmarrja publike Prishtina Parkingu po shihet që është duke u përballë me vështirësi të mëdha, pra serioze financiare pas vendimit të gjykatës për me e shfuqizua një pjesë të rregullores për parkingje. Kjo u pa edhe prej raportit, materialet që e kemi marrë, pra raportit financiar, ku te të hyrat direkte pamë që ka një rënie të dukshme. Ky vendim pra ka ndikuar drejtpërdrejt në të hyrat e ndërmarrjes edhe ka krijuar një situatë të rëndë financiare. Tash propozimi për subvencionim prej 100 mijë eurosh është një hap që është pozitiv edhe e përshëndes këtë vullnetin për me e ndihmu ndërmarrjen. Po ne duhemi me qenë në këtë rast realist edhe me i pa faktet. Sipas kësaj gjendjes aktuale financiare ndërmarrja i ka rreth 200.000 euro obligime për paga, ka 100.000 euro obligime për furnitorë të cilët pra janë obligime që mund shumë shpejt me ju drejtu përmbauesit edhe i kemi 15.000 € obligime për qira.

Veç këto që i përmenda tre zëra të obligimeve janë diku 365.000 000 €. Pra në këtë kontekst nëse subvencionimi prej 100.000€ sot po votohet, ne po shohim që nuk e zgjidh problemin. Andaj sot po dua veç me e thënë që mos të krijojmë iluzionin si asamble që po japim një subvencion e po i ndihmojmë Prishtina Parkingut edhe i japim zgjidhje të përhershme problemit të parkingjeve në kryeqytet. Nëse duam që Prishtina Parkingu me vazhduar me funksionuar normalisht e që ne duhemi me dasht se është një prej shërbimeve kryesore për me i paguar punëtorët, me i shly këto obligime të furnitorët, me i shly obligimet e qirave, atëherë njërmend duhet me e trajtuar me më shumë seriozitet. Nëse për shkak të procedurave nuk mund me e rrit këtë shumë sot të subvencionimit, atëherë gjithsesi duhemi krejt bashkë edhe ekzekutivi edhe asambleja me punu që nëse jo në seancën e ardhshme shumë shpejt me dalë me një subvencion tjetër për arsye se kjo çka po bëjmë sot nuk e zgjidh problemin. Unë sot po e mbështes subvencionimin si parim, por nuk po e mbështes shumën. Domethënë po mendoj që shumë mirë e arsyetova. Kështu që krejt çka po dua me thënë është që të punojmë krejt bashkë që nëse jo në seancën e ardhshme gjithsesi ë radhën tjetër pra jo nëse seancën po në kohë shumë të shkurtë të shpejtë me bë një propozim tjetër edhe shumë më konkret më serioz edhe me i jep zgjidhje këtij problemi për arsye se me 100.000€ në bazë të raportit financiar. Tash mos dalim naiv se ne dimë me i lexu numrat. Në bazë të atij raporti financiar që e kemi marrë të hyra të cilat i ka ne mund me e shty probleme ndoshta për disa javë ndoshta edhe për një muaj po jo më shumë. Kështu që prapë kemi me i pa ata punëtorë kanë me dalë në rrugë grevë me i kërku pagat kjo është krejt, falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit zotri Musliu. Nexhime Gjema ka kërkuar fjalën.

Nexhmie Gjema: - pasqyrat financiare na janë dorëzuar vetëm një ditë para seancës, pa shënime shpjeguese, pa raport të auditorit, pa analizë krahasuese dhe pa sqarim të periudhës së vitit 2026. Nuk mundemi me kërku nga asambleistët me votuar ndarje të mjeteve për një ndërmarrje me kapital negativ dhe me mbi 2.5 milionë euro detyrime pa pasur kohë dhe dokumentacion të mjaftueshëm për shqyrtim. Sipas pasqyrës të të ardhurave veç në vitin 2024 kjo paska pasur fitim prej 57.128 eurove përderisa në vitin 2025-2026 domethënë kemi një humbje gati 700.000€ euro brenda një viti. Pyetjet pasojnë për të mos përsëritur me bashkëfolësit më parë se për një periudhë relativisht të shkurtë detyrimet janë rritur me mbi 814.000 €, atëherë çfarë mundemi ne me subvencionu me 100.000 € siç tha edhe Liriku edhe kolegët e m'i kur e shohim domethënë një shumë afro 1 milion, çka na pret e ardhmja, si mund ta subvencionojmë Prishtina Parkingun nëse kjo siç po dhe e dëshmon nonstop na sjell vetëm humbje. Çka parashikohet në të ardhmen? Çfarë po bëjmë me këtë subvencionim? A do vazhdojmë kështu a po ku është fundi, ku është vizioni i Prishtin Parkingut? Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit zonja Gjema. Çlirim Gërbeshi ka kërkuar fjalën.

Çlirim Gërbeshi: - falemnderit, një çështje që është shumë me rëndësi me e ditur qytetarët e Prishtinës është që Prishtina Parking sot funksionon në objektin e Ragip Zhabës, Ragip Zhaba

është anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së e djali i tij është asambleist i LDK-së në këtë Kuvend komunal. Pse Prishtina Parking u desh me ndërru lokacionin e hapësirave në të cilat ka qenë e u shku te Ragipi. Ky është pra abuzimi që po i bëhet kësaj ndërmarrjeje për shkak se duhet Ragipit me i jep do para për qira e punëtorët tani normalisht që mbesin pa paga. Singërisht është e turpshme çka ka ndodhur, çka po vazhdon me ndodh me këtë ndërmarrje. Falemnderit.

Kryesuesi: - Gëzim Sveçla e ka kërkuar fjalën, falemnderit.

Gëzim Sveçla: - i shtyrë nga diskutimet që ndodhën këtu, e kam të pashmangshme që edhe njëherë me ju kthi Prishtina Parkingut. Për besë është problematike si qasje nëse shpëtimin e ndërmarrjeve komunale e shohim përmes subvencionimit të vazhdueshëm, përmes taksave të qytetarëve të Prishtinës. Ne jemi dëshmitarë të ankesave të vazhdueshme të ekzekutivit të Prishtinës për mungesë të mjeteve financiare, për punë dhe projekte konkrete e në anën tjetër ato pak mjete, po them pak sepse në realitet nuk janë pak. Prishtina është fuqi financiare, por është problemi tek keqmenaxhimi me paratë ato që janë, dëshirojmë të subvencionojmë ndërmarrje. Ndoshta edhe mund të ndodhë subvencionimi, por subvencionimi mund të bëhet për një projekt konkret që potencialisht e rrit cilësinë e shërbimeve dhe ndikon pozitivisht në afarizmin e ndërmarrjes, e mbi të gjitha e lehtëson përditshmërinë e qytetarëve të Prishtinës, të cilët supozohet se ne i përfaqësojmë këto, po me të vërtetë nuk jemi duke i përfaqësuar nëse kërkuar prej nesh këtu nuk pyet çka ndodhi me disa pretendime që unë personalisht i ngrita në seancën e kaluar, me dyshimin për falsifikim të identitetit, me mesazhe në grupe telefonike ku dëshmohet, konfirmohet hajnia në ndërmarrje. Kërkuar nuk po pyet këtu. Kemi aksionarë të emëruar në këtë ndërmarrje. Kërkuar nuk po pyet këtu. Po shtrojmë kërkesë, a mjaftojnë 100.000 a ndoshta duhet më shumë me ju dhënë. Kërkuar nuk po thotë pse ka ardhë në këtë gjendje ndërmarrja Prishtina Parking. Kërkuar nuk po e kërkon fajtorin pse një ndërmarrje që ka monopol duhet me u subvencionu prej Kuvendit komunal. Këtu ka zyrtarë shumë të lartë të Komunës së Prishtinës. Kërkuar natyrisht nuk pret kurgjë prej Përparimit që hyn e del, sepse ai s'i ka mendt te Komuna e Prishtinës, ka telashe tjera. Në këtë rast barra e përgjegjësisë bie mbi nënkryetaren që është personi i dytë në Prishtinë. E bëjsh me shëndet Besianë se vetë e ke zgjedhur këtë rrugë. Çka po bëjmë me të prishtinalive? Pse po e shpërblejmë keqmenaxhimin? Punëtorët e Prishtina Parkingut i kanë marrë pagat. Këto 100.000 euro nuk janë për paga të punëtorëve. Edhe në këtë gjendje qysh është edhe me këto të hyra që i ka pagat mjaftojnë. Janë dy burime që e kanë shterrë Prishtina Parkingun. Një projekt i dështuar i digjitalizimit me vlerë 2 milionë euro e gjysmë dhe është vendimi i gjykatës supreme shtatë muaj e gjysmë në qeverisje ka dalë para tre muajve në dëgjim public, akoma nuk u mbajt dëgjimi publik për rregullore të Prishtina Parkingut, nuk po doni të ktheni ligjshmërinë veç po doni mënyrën e lehtë taksat e qytetarëve të Prishtinës. Shpenzoj. Jepja një operatori ekonomik. Jepja një qiramarësi dhe prapë vazhdon gjendja në Prishtinë Parking njësoj për besë. Duhet me pasur njëfarë ndjenje të përgjegjësisë ndaj secilës që e keni marrë e sidomos ndaj gjendjes që është në qytet. Prishtina i ka 1 milion kërkesa. Prishtina Parkingu ka mundësi financiare për vetëfinancim. Duhet me rregullu aspektin ligjor. Është në dorën e ekzekutivit këtë çështje me rregulluar. Nuk e keni rregulluar që shtatë muaj e gjysmë. Nuk po e rregulloni as sot. Nuk është problemi. Ju i keni numrat edhe i votoni këto 100.000 €. Po njëjtë ka me ju ndodhur me ndërmarrje të tjera komunale dhe pastaj në fund kur nuk realizohen projektet me të cilat e keni marrë votën e qytetarëve keni me dalë me thënë ose na ka bllokuar qeveria ose na i mori gjykata paret ose na pengoi ai. Ky është vizioni që

ju po i ofroni qytetarëve të Prishtinës. Pagesa të dyfishta, qoftë përmes pagesës për shërbimin, qoftë përmes shpenzimit të taksave të tyre. Me të vërtetë mbetet që qytetarët me ju vlerësu për këto veprime që po i bëni.

Kryesuesi: - faleminderit. A dëshiron dikush fjalën? Jo, lus regjinë të jetë gati. Konstatoj njëherë kuorumin 47 janë prezent, kemi kuorum, faleminderit shumë. Regjia të jetë gati për votim, votojmë tash, faleminderit me 33 vota për, 10 kundër, një abstenim, kalon edhe pika e tetë:

Propozim - Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL “Prishtina Parking”. Na kanë mbetur tash edhe dy pika. A doni me shkuar në pauzë? Se është koha e pauzës. Nëse jeni shumica me kryer, po e kryjmë. Nëse jo, po dalim në pauzë dhe po kthehemi. A po e çoni dorën kush është mos me dalë në pauzë? Mos me dalë, shumica janë mos me dalë. Atëherë po e vazhdojmë, faleminderit shumë.

Po fillojmë. Pika e nëntë e rendit të ditës: Pyetje dhe përgjigje. Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Trim Sylja nga radhët e Partisë Demokratike ka kërkuar fjalën.

Trim Sylja: - përshëndetje për të gjithë pyetja im është drejtuar Drejtorisë së Investimeve Kapitale. Projekti i kolektorit në lagjen Kalabria ka qenë realizim për një kohë goxha të gjatë. Gjatë muajve të verës. Banorët vazhdojnë me u përballë me kundërmimin e rëndë edhe janë të interesuar me e ditë se kur kanë me u përfundu punimet. Pyetja është për zonjën Pllana e cila nuk qenka këtu cila është gjendja aktuale e projektit të kolektorit në Kalabri dhe cili është afati i planifikuar për përfundimin e tij? Ju faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit, dëshiron dikush fjalën? S’është askush, në rregull. Kushtrim Sopa nga radhët e LDK-së ka kërkuar fjalën.

Kushtrim Sopa: - faleminderit kryesues, unë zakonisht për këtë pikë të rendit të ditës e bëj një publikim në rrjete sociale dhe i marr të gjitha kërkesat edhe rekomandimet e qytetarëve për disa drejtorë që ishin prezent këtu. Unë po shkoj t’u i lexu një nga një ato kërkesat që m’i kanë përcjellë mua. Nuk po i kërkoj përgjigjet menjëherë tani për tani, por ndërkohë kemi emaile zyrtare dhe i pranoj dhe pastaj ia përcjelli qytetarëve, një qytetar ka kërkuar respektimin e rekomandimit mjekësor për një punonjëse e cila është konstatuar nga QKUK, mjekësia e punës e cila nuk është e aftë të marrë sforcim pune dhe disa rekomandime të tjera mjekësore për të cilën nuk po respektohet nga Ndërmarrja publike banesore.

Një kërkesë tjetër është kërkesë për përfshirjen e klubit të boksit për femrat Dodona në programin e mbështetjes financiare të kuvendit dhe të komunës tonë duke respektuar maksimalisht punën e Leutrimit që po bënë nëpër shumicën e lagjeve të qytetit. Lagjja e vëneshtave ka kërkuar ndriçim gjegjësisht rruga “Aleksandër Molosi”, po shkoj te këto ndriçimet që mos të ikur radhën dhe vazhdon menjëher me fjalën ndriçim, gjithashtu kanë kërkuar edhe rruga “Bedri Dedaj” në Shkabaj. Disa prej shtyllave nuk funksionojnë si dhe në rrugën “Stamboll” në lagjen Arbëria po ashtu disa prej shtyllave nuk funksionojnë ka dhe puseta dhe pengesa që shkojnë për shërbimet publike. Besoj ke parasysh edhe nuk dyshoj në gadishmërinë tonë tjetër kërkesë është sanimi kulmit të objektit C13 në Ulpianë rruga “17 Shkurti” është emergjente mbyllja dhe izolimi i kulmit

për shkak të lagështisë pas çdo reshjeve të shiut. Tjetër kërkesë kam edhe nga pronarët e kiosqeve në sheshin e kryeqytetit ata kërkojnë zbritjen ose uljen e çmimit të qirave për shfrytëzimin e kioskave pasi ata veç paguajnë për 15€ për metër katror edhe në sezon i kanë disa tarifa shtesë. Kërkesë tjetër kam edhe kërkesën për lift në rrugën Afrim Maliqi, lagja Bregu Diellit, në këtë hyrje janë katër njerëz në nevojë dhe dy me karrocë që është emergjente, kërkesë që ka ardhë disa herë në komunën tonë por nuk është trajtuar ende dhe kam një mori kërkesash prej ë lagjes Ulpiana, të cilat janë dhe po mundohem me i përmbledh shkurt që mos të marr shumë kohë. Në lagjen në rrugën “Zia Shimsiu” mbrapa objektit C12 që i bie përballë kishës katolike gjendet një shtëpi në të cilën shtëpi një person i ardhur nga Shqipëria sipas informatave i përzënë nga i ati, i ashtuquajtur prift e ka shndërruar atë shtëpi si një lloj kishë, ky person ngritë njëfarë kombane paralel me kishën. Unë njihem që i respektoj të gjitha besimet fetare dhe qëndroj mbas atij parimi. Kërkesa të tjera i kanë të trajtohen qentë endacak në lagje, të vendosen kamera në lagje gjithashtu për shkak të sigurisë së fëmijëve si dhe shitësit ambulatorivë gjegjësisht para ndërtesës S12 në rrugën “Zia Shemsiu” të trajtohen dhe të largohen nga rruga sepse janë duke penguar qarkullimin normal nëpër trotualet e kësaj lagje. Faleminderit shumë respekt gjitha të mira.

Kryesuesi:- faleminderit zotri Sopi, Enveri Redenica ka kërkuar fjalën.

Enver Redenica: - faleminderit kryesues zotëri Kupina. Kërkesat dhe ankesat e qytetarëve na janë grumbulluar shumë. Ato përmes imellave po na injoroni. Mbledhje të rregulla po mbani rrallë si kjo, tani po kemi shumë probleme që zëri i qytetarëve të dëgjohet këtu. Unë kam me vete disa prej tyre se këtu edhe koha shumë e shkurtër. Këto kërkesa kanë të bëjnë me Drejtorinë e Investimeve Kapitale që nuk po e shoh drejtoreshën këtu shërbime publike dhe inspektionin. Ujërat e zeza në Tokbashqe janë bërë problem i madh, jo vetëm për banorët rezidentë por për të gjithë banorët e Prishtinës që frekuentojnë parkun e Tokbashqes dhe Gërmisë. Këtë problem z. Rama e ka premtuar se do t’a rregullojë përmes is- drejtorit Krenar Xhaferi në vitin 2023. Pastaj në fushatën zgjedhore para një viti në shtator 2025 në shkollën “Gjin Gazulli”. E këtu mbetën vetëm disa nga mashtrimet e tij, qytetarët në vend se të dalin të thithin ajër të pastër në Tokbashqe në parkun më të bukur të Prishtinës, atje është bërë tmerr nga kundërmimi i ujërave të zeza dhe për këtë nuk kanë ndarë asnjë cent për këtë vit. Dy vite e fundit e sidomos sot e pashë në një video Përparimin si kamuflazh ka qitur një bager aty dhe disa gypa kinse po bëjmë diçka por ujërat e zeza nuk rregullohen nga fundi, nga fillimi zoti Rama duke filluar nga shtëpitë e dostave të tij përballë shkollës Normale aty duhet ndërtuar një implant ose do largohen ujërat e zeza nga prockat që vjen nga pishina e Gërmisë, këtu qëndron problemi e jo aty ku kanë filluar. Tani nuk është këtu por të ishte ia kisha bërë një pyetje se ku përfundon ato ujërat e zeza që është duke i rregulluar ato tani derdhën përsëri në Tokbashqe në prockë domethënë ky është një mashtrim total i tij, por kjo është dhe pasqyra reale e qeverisjes së tij në Prishtinë. Me datën 3/3/26 kam bërë një kërkesë që në rrugën “Nazim Gafurri” përkatësisht te Viva Fresh në Tokbashqe të ngritet asfalti që të zvogëlohet shpejtësia e veturave të vendosen vija të bardha për këmbësor dhe të bëhet një stacion autobusi sepse është shumë larg distancë mes stacionit tek Gjergj Fishta deri tek ai mbikryqin e Bledit. Kam kërkuar që do të hapet një derë ku qytetarët të mos i kalojnë rrethojat për hyrje e daljen në Tokbashqe sepse po rrezikohet çdo ditë jeta e tyre. U bën që tre muaj dhe ende kurrfarë përgjigje s’ka marrë nga drejtoria në fjalë. E kur jemi te rrethojat e parë ky Tokbashqes, shumë qytetarë janë ankuar, por edhe unë si zëri i

tyre mendoj se ato rrethoja janë krejtësisht e panevojshme dhe duhet e larguar të gjitha. Kujtoj këtu se asnjë park në Prishtinë nuk ka rrethoja të tilla. Edhe ato që kanë pasur më herët janë larguar e pse të ketë vetëm parku i Tokbashqes. Pra duhet të mendojmë për lirinë e lëvizjes së qytetarëve dhe jo të kufizojmë ata si në kopsht. Po këtu në këtë park në Tokbashqe dikur kishim katër burime të ujit natyror që të rinjtë nga ato i kanë përvetësuar ose i keni përvetësuar njerëzit që kanë lidhje të forta në komunë. Njëri është tjetërsuar te shkolla normale në qeverisjen e zotit Ismet Beqirit. Njëri është tjetërsuar në kohën e Isa Mustafës, pak më lart se fushat e futbollit Rilindja dhe tjetri u tërësua pasi është rregulluar në kohën e Përparim Ramës që gjendet pak më lartë se ish-OSBE-ja. Unë si kryetar i këshillit kam adresuar shumë herë drejtorisë së inspektionit dhe paqeve, por kot kurrë përgjigje s'kam marrë nga ato. Kujtojmë se aty me vetëdije komuna ka bërë krim ndaj natyrës, qytetarëve dhe botës shtazore, rrjedhimisht kërkojmë që këto burime natyrore të kthehen siç ishin dikur. Faleminderit.

Kryesuesi: -faleminderit zotri Redenica. Besart Krasniqi ka kërkuar fjalën.

Besart Krasniqi: - përshëndetje të gjithëve. Unë i kam disa kërkesa që më kanë adresuar nga qytetarët e Prishtinës, duhet t'a ngris problemin, infrastrukturë rrugore në lagjen Kodra E Trimave. Pra kjo është gjendja në rrugën "Xhavit Berish" që lidhë këtë rrugë me lagjen në fshatin Shkabaj. Një rrugë mjaft e frekuentuar kështu që u lënë në këtë gjendje, tash gati thua që një vit e më shumë. Në gjendje jo të mirë janë edhe shumë rrugë të lagjes tonë siç është rruga "Beqir Sadiku" "Arena Taci", "Besnik Lajçi", "Daniel Defo", "Gryka e Lapushnikut" e shumë rrugë të tjera ku vazhdimisht janë bërë kërkesa, por nuk janë marrë parasysh nga Drejtoria e Investimeve Kapitale. Po ashtu problem është edhe rruga kryesore "Fari Fazliu" ku fillimi i rrugës që nisë para semaforit te Xhamia e Llapit është me gunga, tash e katër vite mundem me thënë disa herë e kam ngritur këtu në seancë në Kuvendin komunal. Po mendoj në kuvendin e kaluar Drejtoria e Investimeve Kapitale nuk ka marrë parasysh kërkesën, domethënë nuk i ka as 500 metra thënë aty. Shumë janë 500 m, po janë t'u e dëmtuar shumë, domethënë te veturat është t'u paraqitë probleme edhe në trafik. Kur të flasim për Kodrën e Trimave duhet me fol edhe për mungesën e ndriçimit. Po është një paradoks se në rrugën "Ibrahim Kelmendi", ndriçimi ndezet tërë ditën kurse mungon natën në rrugën "Mon Balaj", "Asllan Pireva", " 27 Nëntori", "Afrim Krasniqi" ,..... dhe shumë rrugë të lagjes të kodrës së trimave andaj banorë kërkoj që të bëhet rregullimi i ndriçimit sa më parë. Banorët e Grashticës së epërme dëshirojnë ta dinë se kur do të fillojë ndërtimi i dy degëzimeve që lidhen me rrugën "Sofra e Gollakut" madje edhe gjatë fushatës së premtuar ndërtimi i këtyre rrugëve. Kështu që pyetja e tyre është kur do të fillojë ndërtimi i këtyre dy degëzimeve që lidhet me rrugën "Sofra e Gollakut"? Kurse pyetja tjetër ose ankesa, kërkesa është e linjës së autobusave 7 dhe 7A kërkojnë vendosjen e stacioneve në rrugën "Haxhi Zeka", por edhe në vende të tjera ku ka mungesë. Domethënë këtu lindë, kërkojnë domethënë vendosjen e stacionit për shkak se nuk e dinë ku duhet me u ndalë. E një problem tjetër që po përballen banorët e lagjes "Kodra e Trimave", por edhe në përgjithësi Prishtina janë problemet me mbeturinë dhe qendrën dasak. Pra dy probleme që po përballen vazhdimisht banorët e Prishtinës e ku po rrezikohet

shëndeti i tyre fizik e higjenik. Kurse kërkesa apo shqetësimi tjetër ka të bëjë me shitësit ambulantivë që janë statik në sheshin e Prishtinës. Kjo kërkesë e kam ngritur edhe në mandatin e kaluar ku ata kërkojnë të ankohen për KSN e lartë që paguajnë, ku me vendosjen e kioskave të reja nga 45€ për tre muaj. Tash ata që dy vite paguajnë nga 310€ për një muaj. Shumë kjo e paperballuar për këta shitës pasi këta ankohen se përveç verës muaj të tjerë kanë shumë pak punë e kjo shumë prej 310€ është e papërballueshme dhe ata kërkojnë që të zbritet përndryshe ka pasur edhe një premtim nga ekzekutivi i komunës që kjo shumë të zbritet por deri më tani nuk është bërë problem tjetër që po përballen rrugët nëpër të gjitha lagjet e Prishtinës janë edhe mbyllje mbledhës atmosferik pra pastrimi i tyre është tejt i nevojshëm pasi bllokimi i posetave shkakton vështirësi të vazhdueshme, veçanërisht gjatë reshjeve të shiut si pasojë krijojnë grumbullimet e ujit në rrugë, vështirëson qarkullimin e automjeteve dhe kombësore si dhe rritet rreziku për dëmtimin e infrastrukturës rrugore. Vetëm në Kodrën e Trimave Leotrim janë 10 mbledhës gati krejt të mbyllur po edhe lagje të tjera që më kanë ardhë kërkesa prej shembull Bregu i Diellit në Dardani ujë mbledhës atmosferik janë shumë të mbyllur edhe sidomos gjatë kohës së vjeshtës kur bën shi ata shkaktojnë problem. Kërkesë tjetër apo ankesë është po ashtu një problem tjetër që po ballafaqohen qytetarët e Prishtinës është mungesa e shportave në kryeqytet e sidomos në hapësira publike më parë që po ashtu edhe në stacionet e autobusave se dhe pyetja e fundit ka të bëjë me mbjelljen e luleve u vëre që edhe në mandantën e parë dhe në të dytin kemi mungesë mbjelljes së luleve në kryeqytet argument për këtë është dëshmia ku përballë së komunës së Prishtinës të rrethi me fontan kemi tre hapësira ku mundet me mbjell lule dhe Ndërmarrja e Gjellbër nuk e ka mbjellë këtë pjesë si shumë pjesë në kryeqytet. Atëherë shtrohet pyetja çka shërben Ndërmarrja e Gjellbër. Këto ishin kërkesat, ankesat që janë kanë adresuar nga qytetarët të ndryshëm të Prishtinës ku ata kërkojnë në zgjidhje sa më të shpejt.

Kryesui: - faleminderit zotri Krasniqi, Feim Osmani ka kërkuar fjalën.

Feim Osmani: - faleminderit kryesues, në fakt faleminderit edhe prej drejtorëve që janë prezent keqardhje për ata që kanë shkuar për arsye se sot ne e sakrifikuam edhe pauzën me qëllim që të jenë një numër më i madh i drejtorëve i kryetarit, i atyre që duhet t'i dëgjojnë hallet e qytetarëve, sepse ne i përcjellim hallet e tyre, jo tonat. Këtu po filloj me disa pyetje. Në fakt janë edhe kërkesa për sqarim, po ashtu edhe për të intervenuar aty ku duhet patjetër. Po fillojmë me drejtorinë e investimeve kapitale. Në fakt drejtoria sa ka përfunduar një investim, një projekt në fshatin Sharban ku ka ndërtuar dy ura të cilat mundësojnë lidhjen e fshatit me një pjesë të lagjes dhe xhaminë, atje në fshat e të cilat kanë qenë kërkesë e banorëve shumë herë e që janë drejtuar përmes asambleve, përmes kryetarëve të këshillave lokale në të gjitha kanalet që kanë pasur mundësi tek ato ura unë kam qenë në vendngjarje dhe kam parë që janë të ndërtuar të dyjat në kundërshtim me vijën e rrjedhës së Prockës, e cilat me vërshimet e para do të shkaktojnë dëme të jashtëzakonshme. Njëra në parcelën që është pronë e xhamisë dhe tjetra në dy parcela të cilat janë pronë private, thërras Drejtorinë e Investimeve Kapitale, po ashtu dhe kryetarin që të dal në vendngjarje t'i shikoj ato, të marri masat e nevojshme. Tashmë meqë është bërë një investim bukur i madh aty është bërë gabimisht t'a shtojë numrin e mjeteve dhe t'a parashe ndërtimin edhe e dy mureve mbrojtëse për të mbrojtur ato prona, sepse jam i sigurt që vitin tjetër komuna do të përballlet me padi ngase

pronat do të dëmtohen. Kurdo që del dikush që kupton sado pak ose edhe nëse s'kupton fare, vetëm se i shikon këto projekte, e sheh çfarë gabimi i madh është bërë dhe se si janë orientuar gabimisht taksat e qytetarëve, dy trajtimi i rrugëve nga shkurret sidomos në pjesën rurale sidomos në fshatra. Duhet të kemi parasysh këtë shqetësim e kam ngritur pothuajse çdo pranverë këtu në këtë pikë në pyetje dhe përgjigje për arsye se shkurret rriten me shpejtësi jashtëzakonisht të madhe ndërsa ndërmarrja ose kushdo qoftë që ka kontratë ose nuk ka fare nuk ka dalur t'i menaxhojë t'i pres ato shkurre të cilat e kanë zvogëluar jashtëzakonisht shumë hapësirën për qarkullimin e automjeteve edhe të qytetarëve bashkërisht thërras edhe njëherë komunën që të intervenojnë në këto pjesë e sidomos në fshatrat që janë më të frekuentuara të kenë prioritet dhe intervenimi të jetë më i shpejtë, çështja tjetër lidhet me drejtorinë e shëndetësisë se është fjala te dezinfektimi. E kam ngritur si shqetësim këtë çështje edhe para një muaji ashtu diçka prapë po e shoh që nuk kanë dalë përveç të premtes së para tre javëve nuk kanë dalë me kry fazën e ardhshme të dezinfektimit dhe sivjet gjendja sidomos me mushkonja është alarmante drejtor. Konsideroj që do duhej ta kemi një sqarim a ka ndodhur një dezinfektim edhe kanë bërë prapë diferencë në rrugë të ndryshme apo nuk ka ndodhur faza tjetër e cila ka qenë e paraparë me datë të caktuar pastaj është një shqetësim bukur i madh tek komitetet e përhershme aty ku po thirren në përgjegjësi ose në raportim drejtorët e që nuk po marrin pjesë. Këtë pikë do të kisha pasur dëshirë t'a trajtoja në prani të kryetarit. Mirëpo meqë nuk është kryetari, nënkryetarja besoj që në takimin e parë me drejtor do t'ua tërheq vërejtjen se ata janë të obliguar të jenë prezent kur thirren të raportojnë në komitetet përkatëse. Unë kam përvojë nga komiteti të cilin marr pjesë që asnjëri nga drejtorët e ftuar nuk kanë marrë pjesë dhe nuk na kanë informuar për çështjet që kanë qenë interes i komitetit. Pastaj e tash po fillojnë dëgjimet publike e kam një sugjerim që drejtorët t'i marrin parasysh pothuajse në në tenesi listen e propozimeve të kryetarit të Këshillave lokale sepse mosmarrja parasysh e listës prioritare që ata e sjellin këtu devijon vullnetin e qytetarëve sepse ata i kanë përfaqësuesit të vetë janë përfaqësuesit e tyre këtu dhe propozimet e tyre duhet të trajtohen me prioritet, gjithashtu e kam një kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, dy pengesa që janë vendosur në rrugën njesiti Buna në Besi, Rimanishtë, për të cilat e kam ngritur zërin edhe në mandatin e kaluar, të cilat janë vendosur me rekomandime të disa aktivistëve në fshat që nuk e përfaqësojnë as bashkësinë lokale as banorët, janë të vendosura gabim, e kanë rënduar jashtëzakonisht shumë qarkullimin e automjeteve thërras në drejtori fjalë që të dal t'i shikoj dhe t'ja eliminojë të i hek.

Kryesuesi: - a përfundove Feim? Faleminderit shumë, Ilirik Musliu ka kërkuar fjalën.

Ilirik Musliu: - faleminderit kryesues, prapë përshëndetje për të gjithë e kemi një kërkesë prej operatorëve privat të transportit publik që është dorëzuar edhe në kabinet të kryetarit edhe në drejtori të mobilitetit edhe në drejtori të shërbimeve publike, të cilën mendoj që duhet me e shqyrtu edhe me seriozitet edhe me përgjegjësi. Ata e kanë një kërkesë për me e shty afatin deri më 31 dhjetor të këtij viti, të vitit 2026, për dorëzimin e marrëveshjeve ose kontratave që e dëshmojnë procesin e modernizimit të autobusëve që është pikë brenda kontratës të cilën e ka bërë komuna me operatorë të privatë. Ne sot jemi të vetëdijshëm se modernizimi i flotës së autobusëve është i

domosdoshëm, s'ka diskutim. Qytetarët meritojnë me e pas autobus të rinjë, të sigurtë ekologjik edhe më standarte më të larta të shërbimit. Po është e rëndësishme edhe me i ditur rrethanat në të cilën kanë operuar këto kompanitë e transportit publik gjatë viteve të fundit. Domethënë për një periudhë shumë të gjatë këto kompani janë përballur me vonesa të pagesave prej komunës së Prishtinës. Edhe kjo direkt ka ndikuar në likuiditetin e tyre financiar edhe në mundësinë për me e siguruar ata një financim prej bankave komerciale. Pavarësisht këtyre vështirësive operatorët nuk e kanë ndërprerë asnjëherë shërbimin. Ata kanë vazhduar me mbajt gjallë transportin publik në kryeqytet. Ne e dim shpesh e kemi quajtur edhe hero edhe shpesh kanë funksionuar edhe me financim të vetin edhe duke u përballë me kosto shumë të larta. Kjo është një sakrificë të cilën sot ne duhet me vlerësuar dhe mendoj që duhet me qenë një prej elementeve kur e kemi bazë kërkesën e tyre. Duhet me kuptu që kjo shtymje nuk e cënon interesin publik. Përkundrazi, e krijon një mundësi reale që operatorët me siguruar financimin e nevojshëm edhe me e realizuar këtë obligim të cilin del prej kontratës të cilën ata e kanë nënshkruar me komunën e Prishtinës. Për këtë arsye konsideroj sot se miratimi i kësaj kërkesë është një vendim i arsyeshëm, është proporcional është në interes të funksionimit të transportit publik të Prishtinës, faleminderit.

Kryesusi: - faleminderit zotri Musliu, Lumnije Mikullovcia ka kërkuar fjalën.

Lumnije Mikullovcia: - në këtë pikë të rendit të ditës dua t'a shpreh indinjatën time, por edhe shqetësimin e madh të banorëve të Bërnices së Epërme për mungesë të ujit të pijshëm. Është e turpshme që në shekullin XX ende të diskutojmë për nevojë elementare si uji. Ky problem ekziston prej shumë vitesh, madje edhe para se unë të bëhem banorë e parkut të Bërnices. Banorët janë ankuar vazhdimisht te drejtorët e KRU Prishtinës Kanë marrë premtime të shumta, por zgjedhje nuk ka patur. Sot familjet zgjohen dhe mbyllin ditën pa ujë, jo të gjithë kanë puse. Edhe ato shërbejnë kryesisht për pastrim, jo për ujë të pijshëm. Për të siguruar ujë për konsum, shumë banorë detyrohen të blejnë ujë ose të shkojnë në qytet për të mbushur. Nga ky Kuvend si organi më i lartë vendimmarrës i komunës kërkoj që kjo çështje të trajtohet me urgjencë dhe seriozitet. Çdo ditë marr ankesa nga banorët. Me të drejtë ata kërkojnë përgjigje. Pyetja ime është e thjeshtë. Ku po shkon uji? Si është e mundur që një pjesë e bërnices ka furnizim të rregullt, ndërsa një pjesë e madhe e Bërnices së Epërme vazhdon të mbetet pa ujë? Më vjen mirë që është drejtori Leutrim Rotkoceri kjo pyetje është për ty edhe besoj që do të punosh në këtë drejtim. Po ashtu dua t'i ngre edhe dy çështje të tjera, rruga kryesore është e asfaltuar, por rrugicat anësore disa rreth 100 ose 50.000 metra nuk janë asfaltuar edhe na bëjnë probleme kur sa herë që bie shi balta bartet në rrugë, rrugën e asfaltuar dhe vështirësohen lëvizjet e banorëve. Gjithashtu ndriçimi publik nuk mirëmbahet, poçat djegen nuk ndërrohen me muaj të tërë ndonëse Bërnica është vetëm rreth 6 km larg ndërtesës së Kuvendit komunal. Për fat të keq investimet në periferi kanë qenë pothuajse zero, kërkoj përgjigje konkrete nga drejtoria përkatëse, kur do të zgjidhet problemi i ujit në parkun e Bërnices së Epërme? Kur do të asfaltohen rrugicat dhe kur do të mirëmbanë si çdo ndriçim publik dhe infrastrukturë në këtë zonë. Qytetarët nuk kanë nevojë për premtime të reja, ata kanë nevojë për ujë, rrugë dhe shërbime dinjitoze, ju faleminderit kjo ishte.

Kryesuesi: - faleminderit. Zonja Mikullovc. Gëzim Sveçla e ka kërkuar fjalën.

Gëzim Sveçla: - faleminderit edhe unë po dua me shpreh mirënjohje për drejtorët që po vazhdojnë të qëndrojnë këtu me ne me i trajtu kryesisht kërkesat e qytetarëve që neve na vijnë pothuajse në baza ditore, por dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me interesin publik dhe me qytetin në përgjithësi. Pyetja e parë është për drejtoreshën e financave, drejtoreshë pse sot nuk është pikë e rendit të ditës raporti financiar për tremujorin e dytë dhe pyetje në kuadër të kësaj sa mjete financiare janë marrë nga përmbaruesi për këta gjashtë muaj deri më tani dhe sa janë pretendimet për këtë vit? Pretendimet gjyqësore je afër me Leutrimin 7 gusht 2025, Leutrim e ke bërë një deklaratë ku ke kërkuar përgjigje dhe përgjegjësi se qysh përparim Rama ka arritur me i pagu 2.4 milion euro për tre vite, tash meqenëse je afër z. Rama, pyetja ime është a munde me kuptu qysh ja ka arritë? Pyetja tjetër para një viti, po vazhdojmë njësoj. Para një viti gjatë fushatës zgjedhore kur ti ke qenë kandidat për deputet, e ke pasur një status ku ke thënë që përparim Rama nuk mundet me ik përgjegjësisë si zyrtari më i lartë i komunës për gjendjen me mbeturina në kryeqytet. Sot gjendja me mbeturina është më keq se asnjëherë më parë. Përpos mbeturinave kemi minj, kemi dhe gjarprinë. Shëndeti publik asnjëherë nuk ka qenë më i cënuar. A vazhdon edhe sot me menduar që përgjegjësia kryesore është mbi Përparim Ramën për këtë gjendje? Kur jemi te mbeturinat, edhe një pyetje për ty Leutrim. Në këtë kuvend me propozimin tuaj dhe me mbështetjen e Lëvizjes Vetëvendosje është votuar, është plotësuar, ndryshuar rregullorja për menaxhimin e mbeturinave, ku kjo e drejtë ekskluzive sipas rregullores i takon Ndërmarrjes pastrimi. Ju e dini që ne e kemi mbështetur atëherë këtë propozim me qëllim që ndërmarrja të funksionalizohet dhe të revitalizohet edhe më tepër dhe sipas kësaj rregullore dhe gjithë asaj beteje që ju e keni bërë në të kaluarën, keni potencuar se në kundërshtim me këtë rregullore, në kundërshtim me ligjin, ka operatorë privat të cilëve Përparim Rama ju ka dhënë kontrata operimi në sistemin e menaxhimit të mbeturinave. A ka sot operatorë privat dhe a janë këto kontrata në përputhje me rregulloren për menaxhimin e mbeturinave si rregullorja që është në fuqi për këtë çështje? Edhe një pyetje mbasi pasna kohë akoma për nënkryetaren e qytetit sipas raportit të auditimit 5.3 milion euro të buxhetit të Prishtinës. Kryetari Përparim Rama procedurat të prokurimit i ka bartur te UNDP-ja për dy projekte të cilat gjatë rrugës kanë pësuar shumë ndryshime dhe të cilat nuk ka një raport askush në komunë të paktën nga ajo çka thotë raporti i auditimit se në çfarë faze janë dhe si janë shpenzuar këto mjete. Për më tepër një pjesë e objektit të Gërmisë në shesh pa vendim të Kuvendit komunal i është dhënë në shfrytëzim një operatori i cili gjeneron të hyra nga ai objekt, nga ai shërbim që e bën. Ndërkohë që komuna nuk përfiton asgjë, 5.3 milion euro. Pyetja ime është si nënkryetare e kryeqytetit a je interesuar për këtë çështje për shkak të mungesës të kryetarit Rama edhe si ndihesh me qenë dora e djathtë e një kryetari që keqmenaxhon kështu me pare. Këtë nuk po e them unë e ka thënë zyra kombëtare e auditimit si organi që është vulë dhe që merret me menaxhimin qoftë financiar qoftë operativ të institucioneve shtetërore, faleminderit

Kryesusi: - a dëshiron dikush me ju përgjigjë a po po vazhdojmë ne me të tjerët? Po vazhdojmë atëherë me Fjolla Vukshinaj.

Fjolla Vukshinaj: - faleminderit shumë, pyetja ime drejtohet për zotërin Pëllumb Bajqinovci. Fillimisht po dua me falenderu sepse gjithmonë ka qenë i qastshëm ndaj kërkesave që i kemi pas qoftë unë apo banorë të tjerë ka kthyer përgjigje, ka dalë në terren, kështu që por po dua me u kthyer me 30 qershor në një njoftim që kryeqyteti Prishtina e ka bërë për shtim të biletave të trafikut urban dhe mes të tjerash ka thënë që ky shtim vjen si proces i digjitalizimit të trafikut urban që për mua ka disa pikëpyetje që kisha pas qejf me i marrë nga zotri Pëllumb. Në një kërkim të thjeshtë në faqen e trafikut urban unë nuk munda me gjetur planin e biznesit të vitit 2026, edhe kisha pasur qejf me dit nëse ju e keni atë plan të biznesit dhe nëse jo, atëherë me publiku në faqen e trafikut urban dhe qytetarët me ditë se çka parasheh viti 2026 për përdoruesit e rregullt të trafikut urban. Unë jam përdoruese e rregullt edhe kam hulumtuar se si funksionon digjitalizimi në Selanik, në Tiranë dhe në një qytet të vogël në Norvegji. Shumë kisha pasur qejf me di se cilat do të jenë hapat që keni me ndërmarrë si drejtori për digjitalizim. A do të jetë një bashkim i platformave? A është bërë ndonjë vendimmarrje bazuar në të dhëna? Prishtina funksionon shumë mirë në bashkimin e operatorëve privat dhe publik, gjë që nuk e kishin as rajoni dhe në shumë vende të Evropës. Mirëpo duhet me kuptuar që digjitalizimi nuk është vetëm teknologji, ne flasim për një filozofi të re të shërbimeve publike, një eksperiencë të re kur udhëtojmë. Edhe tek e fundit, ne si komunë duam me krijuar eksperiencë më të përshtatshme për banorët që e përdorin dhe qytetarët që e përdorin trafikun urban. Kështu që unë po dua me ditë se cilat kanë me qenë planet, planet për digjitalizim brenda gjashtë muajsh dhe brenda një viti kuleta digjitale a ka me u sinrkonzuar me trafikun urban, a ka me u krijuar një platformë e vetme, a ka me u shtuar elemente të tjera si dhe çka do të ndodhë për ata banorë të cilët qytetarë në fakt nuk e përdorin kuletën digjitale, si munden me pas lirime të tjera.

Kryesusi: - faleminderit Leonora Shabani ka kërkuar fjalën.

Leonora Shabani :- faleminderit kryesues, pyetjet e mia kanë të bëjnë më shumë që janë disa nëna që më shkruajnë vazhdimisht që kanë fëmijë me nevoja të veçanta dhe nevoja e tyre kryesore është për mundësinë e një asistentit për fëmijët me nevoja të veçanta. Komuna e Prishtinës, asnjë asistent për fëmijët me nevoja të veçanta nuk ka ofruar nëpër pjesët rurale apo nëpër fshatrat përreth qytetit të Prishtinës. Kështu që pasi që drejtori nuk është këtu duhet të merret seriozisht kjo çështje. Gjithashtu e dimë që çdo vit punësohen asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta dhe duhet të dimë se kur do të shpallet konkursi që bile t'ju jepëm një shpresë nënave që kanë fëmijë me nevoja të veçanta, gjithashtu vazhdon prapë kërkesa pasi që para dy muajve tre pata kërkuar nga drejtorët e kaluar për një për mundësimin e një autobusi në rrugën “Malush Kosova” për arsye se është më duket që në Matin 1 është e vetmja rrugë që nuk ka transport publik gjithashtu kamionët me pesha të rënda janë duke e dëmtu secilën rrugicë në lagjen e Matičanit. Qytetarët e Matičanit janë të rrezikuar prej kamionëve me pesha të mëdhaja dhe më e keqja që asnjë rrugë në lagjen e Matičanit nuk ka trotuar, kështu që mundësisht të ndihmohen këto kategori, këto lagje për me pas një qasje sa më të lehtë, faleminderit.

Kryesusi: - Nexhima, ka kërkuar fjalën.

Nexhmi Gjema: - meqënëse jemi te pyetjet edhe përgjigjet, ndoshta ju kisha preferuar herën e ardhshme me bë vetëm pyetje, se ne vetëm po shtrojmë pyetje, po rrallë herë marrim përgjigje vazhdimisht po filloj prej pyetjeve te “Gjorgj Bushi” sheshi. Përkundër fakteve që kemi kundërshtuar që kemi kërkuar një transparencë edhe përgjigje prej kryetarit të komunës së Prishtinës Përparim Rama për me n’a tregu se çfarë po ndodh me sheshet, pse po don me i zgjeru sheshet e tjera e të tjera. Këto vetëm po i shohim edhe po i kuptojmë, po i realizojmë se ato vetëm po vazhdojnë si projekte pa miratimin tonë, pa miratimin e qytetarëve e kështu me radhë. Por më shumë se kjo po brengos dhe po na brengos të gjithëve që përkundër faktit domethënë që projektet po vazhdojnë projekti i cili i sheshit “Gjorgj Bush” me miratimin e një projekti ideor ai ka vazhduar punimet. Kjo po më brengos shumë sepse nuk mund të punohet me një projekt ideor, është koncept në të njëjtën kohë domethënë kontratat me miratimin e një projekti ideor, pa miratimin e projektit kryesor, domethënë pa leje pune, po vazhdojnë projektet pa projektin e e detajuar. Projekti nis me një kontratë bazë prej 18 milion eurove e më pas shtohet në po të njëjtin kontratë edhe 1.279.459€ me arsyetimin e përfshirjes së dy pozicioneve shtesë, por çka është edhe më e çuditshme që tash janë shtuar edhe gati 80 mijë euro me arsyetimin se ka qenë një pikë e paparashikuar kur flasim për rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit. Të paparashikuar të gjithë kolegët të cilët janë në këtë fushë e dinë që nuk hyn ujësjellësi, nuk hyn kanalizimi, nuk hyn elektrika. Domethënë si mundet këta të punohet në këtë formë kur meqënëse këto tre pikë shtesë janë veç në fillim të punëve të sheshit, janë parashtruar deri më tani po e shtroj pyetjen se sa e sa pika të paparashikuara dështohen përgjatë rrugës këtij buxhetit të 18 milion eurove. Mandej po hapen konkurse ndërkombëtare për varrezat e kryeqytetit, për monumentin e sheshit, për projekte të ndryshme. Duke pasur parasysh se prej këtij buxheti, prej taksapaguesve tanë janë ndar 12 milion euro për zyrën e arkitektit. Edhe shtrohet pyetja, nëse ne kemi nevojë për me hapur konkurse të jashtme, nuk jam kundër tyre, po megjithatë çka ka bë që kjo zyrë e arkitektit që i ka marrë 12 milion euro deri më sot, të cilin projekt e ka filluar edhe mbaruar. Ndërkohë janë ndahen edhe 20.000 euro prej taksapaguesve tanë për konsulentin e jashtëm për menaxhimin e projekteve, por nuk potencohet për cilat projekte, askush, as pse është, kush është ky ekspert për menaxhim të projekteve. Nëse komuna ka zyrë për menaxhimin e projekteve dhe stafin përgjegjës për këtë punë, pse shtrohet nevoja për këtë ekspert të cilat edhe kur është shtruar kërkesa e 12 milion eurove për formimin e zyrës së Arkitektit të Kryeqytetit besomëni që të kisha qenë në vendin e secilit staf që është nis prej arkitekt, inxhinier, urbanistë të komunës unë do ndihesha e fyer nga kryetari i komunës që duke përfshirë gjithë stafin e komunës që unë i njofë shumicën prej tyre që janë të mrekullueshëm, janë shumë profesional edhe atëherë janë ndier të ofenduar, të fyem dhe të larguar nga procesi i projektimit të qytetit nga kryetari i komunës Përparim Rama. Me ardhjen e kryetarit domethënë ai i ka injorë të gjithë komplet stafin duke i parashtrua nevojat e një zyrje të kryeqytetit të arkitektit të Kryeqytetit dhe ndarjen prej 12 milion euro. Ku janë ata çfarë po projektojnë dhe ku kanë shku 12 milion euro e Prishtinës. Ju faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit. Mrika Limani-Myrtaj e ka kërku fjalën.

Mrika Limani- Myrtaj: - faleminderit shumë i nderuar kryesues, pyetjet e mia ndërlidhen me lagjen ku banoj me Matin 1. Specifikisht për drejtorinë e Shërbimeve Publike, gjendja me mbeturina qysh e përmenden edhe shumë parafolës të mi është alarmante në gjithë Prishtinën, po me qenë se Mati 1 është shndërruar në një nga lagjet më të banuara të kryeqytetit, a keni plan konkret për rritjen e numrit të pikave të grumbullimit të mbeturinave dhe rritjen e numrit të kantave? Mendoj që kjo është imediate. Gjithashtu pyetje e mia ndërlidhen edhe për Drejtorinë e Arsimit, me aq sa po e shoh nuk qenka këtu. Gjithsesi po e parashtroj, ka te bëjë me fushën e sportit në shkollën SHFMU “Pavarësia” që ka mbi 3 vite që është nisur por ende nuk është përfunduar, a keni afate konkrete kur keni me përfundu sepse gjendja edhe e oborrit të shkollës edhe fushës së sportit është shumë e keqe? Faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit, Muhamet Selmani e ka kërku fjalën.

Muhamet Selmani: - faleminderit kryesues. Përhëndetje për të gjithë. Kërkesa ime e parë dhe pyetja është për Drejtorinë e Mobilitetit. Z. Drejtor faleminderit, t’i ke qenë në vizitë në kryqëzimin e rrugës “Nora Hoti”, “Bashkim Fehmiu” dhe “Radovan Zokovic” që lidhet me rrugën e hekurudhave e reja e ndërtuar. Tani veç sa ka fillu rruga të merr kuptimin e plotë qarkullues. Edhe shqetësimi më i madh si lagje të cilët banoj edhe unë është lëvizja e shpejtë e veturave, bllokimi i shpeshtë i aksidenteve të shpeshta që kanë fillu të ndodhin si rezultat i kësaj lëvizje dhe bllokimit. Është kërkesë e imja edhe e banorëve të cilët jetojnë afër atyre, të shpreh këtu, të vendosen pengesa të cilat e zvogëlojnë ose ndikojnë në zvogëlimin e shpejtësisë të veturave në atë rrugë para se të ndodh ndonjë me e keqe që gjasat janë shumë të mëdha për arsye se ka lëvizje të madhe të njërzve dhe të fëmijëve në atë rrugë. E dyta kërkesë që lidhet pra me këtë pikë është kryqëzimi i rrugës “Nora Hoti”, “Bashkim Fehmiu” dhe “Radovan Zokovic” qasja në udhëkryqin e ri të rrugës “Nora Hoti” nga rruga “Bashkim Fehmiu” dhe “Radovan Zokovic” është jashtëzakonisht e komplikuar për momentin për arsye një pengesë, si e ke parë është në rrugë e vendosur dhe parkingun jo, të drejtë të veturave që ndodhin në rrugën në krahun e djathtë të rrugës “Nora e Hotit”. Kërkoj nga ju që t’i merrni masa për zhbllokimin e kësaj pjese dhe vendosjen ose gjetjen e një zgjidhje, një kryqëzimi që do të lehtësonte kyqjen nga të dy anët e rrugës të banorëve të asaj lagje faleminderit. Kërkesa ime e tretë shkon për Drejtorinë e Investimet Kapitale a po se di cila drejtori e ka marr tani përsipër. Është një projekti i varrezave të fshatit Barilevë. Është projekt që ka fillu në vitin 2014 dhe ende nuk ka zgjidhje. Momentalisht dëshiroj të ju informoj se disa lagje të fshatit Barilevë kanë fillu të ndërtojnë varreza pa pëlqimin e Komunës me vetiniciativë kanë bërë disa rregullime të pronave të veta ose të pronave që kanë qenë të cilat janë pronë e komunës, të cilat i kanë rrafshuar dhe kanë filluar të përdorin si varreza për lagjet e tyre të caktuara dhe në këtë formë ka fillu të bëhet edhe ndarja e varrezave mes lagjeve gjë e cila nuk është e mirë sepse një projekt që ka qenë për varreza është zvarritë tej mase. Kërkoj nga drejtoria të cilat merren, Drejtoria e Investimeve Kapitale, Shërbimet Publike, Mobiliteti apo të cilën tani në fushë është t’a trajtojnë zonën ku është e përcaktuar varreza së bashku me tërë zonën ku është e paraparë një projekt më i gjërë dhe të përfundoj sa më shpejtë. Besomëni gjendja është alarmante, ju kisha lutë miqësisht dhe si përgjegjës që i keni marr detyrat e juaja për këtë punë të intervenoni sa më shpejt për zgjedhjen e këtij problemi. Kërkesa e dytë po ashtu për Drejtorinë e Investimeve Kapitale, drejtoreshë rruga “Bashkim Fehmiu” sipas vendimit të komunës është nënkontraktuar që të kryhet nga investitori i cili është duke punuar në një ndërtesë, po në këtë rrugë është investitori “Dumnica

Grup”, është vendimi numër 05 numër 35102 45623/23 datë 21.3.2023 afati i përfundimit të punimeve është gjashtë muaj. Sot janë vonesë 35 muaj dhe rruga ende nuk është e përfunduar. Të lutem a ka mundësi një informacion? Jo veç për mua, por edhe për atë banorët e asaj lagje kur do të përfundojë kjo rrugë edhe pse është zvarritur kaq gjatë? Pyetja e fundit shkon për drejtorin e sportit. Drejtor, një fushë që e ka Barileva që është më shumë simbolike që e rezistencës të vazhdueshme të viteve të 90-ta ka mbetur si ka mbetur t’u kisha lutur t’i merr të gjitha masat që t’i japim një zgjidhje të kësaj rindërtimit të kësaj fushe. Faleminderit. S’kam pyetje të tjera. Këto ishin pyetjet për fillim.

Kryesuesi: - faleminderit z. Selmani. Pyetje të tjera nuk ka? Urdhëro, drejtoresha e financave e ka fjalën.

Valbona Makolli: - përshëndetje. Lidhur me pyetjen e z. Sveçla, kërkesa për pikat e rendit të ditës kanë qenë para se me u përmbyllë periudha 30 qershor, kur zakonisht raportojmë dhe pra kjo është arsyeja pse s’ka hyr në këtë mbledhje, por gjithsesi do të mbahet edhe një mbledhje para se me shkuar në pushim. Materiali është thuar se gati krejt, por nuk kam mundur me e sjell në këtë seancë se ende nuk është mbyllur periudha raportuese për atë, veç përse që kërkesa ka qenë më herët dhe jam njoftuar prej kryesuesit që do të mbahet deri para se me shkuar në pushim Kuvendit. Do të bëhet edhe një seancë është në lektorim e sipër po gjithsesi do të vjen më së larti të premten kam me ia dërguar kryesuesit, kështu që është gati ajo. Po veç kjo ka qenë arsyeja. Sa i përket pyetjes së dytë, rreth rasteve përmbartimore për periudhën gjashtë mujore janë afërsisht 12. 800.000. Në raportin e TM2 do të jenë detajet prej cilave kategori janë marrë edhe për secilin prej investimeve kapitale është rubrika që tashmë veç është vendosur në bazë të cilave ku janë shpenzuar dhe cilat kategori janë shpenzuar.

Kryesuesi: - faleminderit drejtoreshë, nënkryetarja Besjana ka kërkuar fjalën.

Besjana Musmurati: - faleminderit kryesues, për pyetjen që e patët për UNDP-në unë veç se kam realizuar disa takime deri më tash edhe e pashë që realisht marrëveshja me UNDP-në është një marrëveshje në benefit të qytetarëve të Prishtinës. Çka ka ndodhur gjatë procesit do të thotë edhe pse është e gjetur e auditorit edhe për mua është ende pikëpyetje. Jam duke e analizuar dhe do ta kem një përgjigje shumë të shpejt besoj çka e pashë gjatë hulumtimit tim është që edhe qeveria e Republikës së Kosovës i ka kontratat e njëjta ashtu siç e ka edhe komuna e Prishtinës. Gati se të gjitha komunat e Kosovës kanë kontrata të njëjta me UNDP-në, vlerat të cilat qeveria e Kosovës e ka do të thotë vjetore të marrëveshjeve të lidhura me UNDP-në janë në vlerë diku 2-3 milion në vit, kështu që flasim përafërsisht për projekte të njëjta të cilat janë bërë do të thotë në gjithë Republikën e Kosovës. Nuk e di pse është e gjetura e auditorit vetëm për komunën e Prishtinës, pasi që e gjetura siç e kam parë në raportin e auditorit ka të bëjë me çështjen e prokurimit dhe çështjes së avancit. Se a ka të drejtë do të thotë një komunë të transferojë një vlerë buxhetore tek një institucion tjetër për të kryer procedura të prokurimit. Me sa e pashë dhe aq sa e lexova deri më tani, po them unë tash juriste nuk jam, po do t’i shkojmë deri në fund kësaj çështjeje. Do të thotë çështja është se këto kompetenca janë deleguar edhe më herët edhe nga qeveria dhe nga komunat e tjera dhe nuk e di pse është e gjetur veç për komunën e Prishtinës. Sa i përket pyetjeve të mëhershme rreth çështjes së ndryshimit të qëndrimeve, po e them tash po do t’a them edhe në çdo seancë kurdo që ka nevojë për këtë sqarim që e kemi thënë edhe më herët, rezultati zgjedhor

ka qenë i tillë. Të gjithë kemi qenë pjesë e një gare politike. Ne jemi parti politike të cilët besojmë që jemi përballë me një vendim pas zgjedhjeve. Ato kanë qenë me vazhduar dhe me bllokuar qytetin apo me kontribuar diçka me bë më të mirë për këtë qytet i cili ashtu qysh jemi pajtuar gjithmonë edhe me grupin e Vetëvendosjes edhe me grupin e LDK-së edhe me grupin e PDK-së, të AAK-së e të gjitha partive politike këtu ka nevojë për më shumë punë edhe ka nevojë për më shumë angazhim. Për këtë arsye edhe si parti demokratike jemi bashkuar në një koalicion i cili besojmë që do të çojë përpara punë të mira për qytetin. Do të jemi këtu për kritika normalisht dashamirëse dhe jo me tendencë politike, për t'i dhënë përgjigje të gjitha kërkesave të qytetarëve edhe për me dhënë punë të mira për qytetin ashtu qysh e kemi bë gjithmonë kur kemi qenë në qeverisje. Sa i përket raporteve të auditorit, vlen të ceket që raporti të auditorve do të thotë me të gjetura shumë të mëdha ka në secilën ndërmarrje, përfshirë edhe në ndërmarrjen ku ju jeni aksioner. Nuk e di çfarë hapa tash ju si aksioner keni marrë që ndërmarrja Stacioni i autobusëve e ka është realisht ndërmarrja me raportin më të dobët të auditorit, pra ka raport të kundërt, kështu që nuk e di ndoshta është pyetje që ju bëj edhe unë juve tash çfarë veprimi keni marrë ju për me i adresuar të gjitha shkeljet, 17 rekomandime dhe 14 gjetje të reja si aksioner në Ndërmarrjen "Stacioni i Autobusëve". Si nënkryetare zotohem që secila ndërmarrje do të bëjë raportime të duhura dhe do t'i ballafaqojmë secilin kryeshef pa dallime politike, pa dallime do të thotë tendenca të tilla politike me politizuar çdo gjë, por në mënyrën më profesionale që me u thirrë me dhënë shërbimet e tyre për qytetarë të Prishtinës. Kështu që ashtu siç kemi me thirrë Gizë stacionin e autobusëve, kemi me thirrë edhe do të thotë Prishtina parkingun edhe të gjitha ndërmarrjet rendë me raportu para kuvendit për raportet e tyre të punës, për raportet e auditimit e të gjitha çështjet të cilat i kemi. Me vjen keq që drejtorët që s'janë këtu sot që do të thotë gjatë kohës u dash me lëvizë. Përgjigjet keni me i marrë me shkrim. Sa i përket edhe njëherë rritjes së çmimit më vjen keq që edhe Besa paska lëvizur edhe pse po besoj që përfaqësohet mjaftueshëm nga Lëvizja e Vetëvendosje, do të thotë ngritja e çmimit të biletës së autobusëve po besoj që është dhënë një sqarim edhe nga Pëllumbi nëse nuk gaboje edhe ka të bëjë do të thotë me rritjen e çmimeve në përgjithësi, si parti politike qëndrojmë kundër rritjes së çmimeve qëndrojmë kundër rritjes së çmimit, çmimet të bukës, të vajit, të energjisë edhe të gjitha çmimeve që kanë ndodhur dhe që rriten nga qeveria do të thotë çdo ditë e më shumë qashtu qysh do të qëndrojmë kundër edhe në nivelin lokalë për ngritje të çmimeve, do të punojmë që çmimet të mos rriten për asnjë shërbim. Në qoftë se çmimet duhet të rriten, ato ato duhet të bëhen konform rritjeve të tjera të cilat ndodhin edhe të cilat fatkeqësisht nuk mund t'i ndryshojmë edhe pak derisa t'a marrim edhe qeverinë. Faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit nënkryetare, z. Sveçla e ka fjalën.

Gëzim Sveçla: - faleminderit kryesues. Nënkryetare për besë pak po befasohem me narracionin që po mundohesh me e ngritë. Do të thotë në pyetjet e mia për gjëra konkrete po kthen përgjigje duke i bartur në zhvillime të nivelit qëndror. Ti je nënkryetare e Prishtinës edhe supozohet që ke me u marrë me çështje të Prishtinës, me probleme të Prishtinës. Për sqarimin tuaj, qeveria nuk i ngritë çmimet, nuk e ngritë qeveria bukën. Asnjë shërbim, qeveria nuk është kompetencë e qeverisë. Ka pasur një ligj për çmime tavan të cilat ti i përmende vaji, buka, mielli, por që partnerët tuaj të koalicionit e kanë dërguar në Gjykatë Kushtetuese. Prandaj me dalë kjo prej nënkryetares së qytetit me të vërtetë kam pasur vlerësim që ke njohuri më të thellë të gjërave sesa kaq. Çështja

e parë. Çështja e dytë me thënë nuk e di pse raporti i auditorit e ka gjetur të Prishtina problem çështjen me UNDP-në e s'e ka gjetur te komuna tjera. Le të merren komuna të tjera. Raporti i auditimit është për secilin institucion. Nuk ka asnjë të gjetur për UNDP-në. Problemi kryesor është te prokurimi. Pa prokurimi ka dhënë 5.3 milion euro edhe ti del e mbron Përparim Ramën. Cila është logjika këtu? Edhe krahasimi që e bën me stacionin e autobusëve kur siç e dinë jam kanë aksionar, nuk jam më aksionarë sa për njohurinë tuaj. Jam bërë aksionarë me votat tua edhe kemi pasur veç një qëllim me e mbrojt stacionin e autobusave prej tendencës së Përparim Ramës për me ndërtu qendër tregtare. E din shumë mirë këtë dhe besoj që s'mundesh me e mohu shko pyeti sot punëtorët e Stacionit të autobusave çka u punu në stacionit të autobusave ose pyte Granit Gecin të kallëzon se është i informuar, ka rritje të pagave të punëtorëve, ka pagesë të sigurimit për punëtorët e stacionit të autobusëve, ka 100 shërbime të cilat s'kanë ndodhur asnjëherë, të gjeturat e raportit të auditorit për stacionin e autobusave janë të gjetura teknike. Do të thotë të gjeturat në raportin e auditimit për stacionin e autobusëve janë të gjetura teknike. Janë një numër i madh i tyre sepse ato nuk është berë për vite të tëra auditim. Po shko pyeti qysh janë gjendja e punëtorëve sot. Shko shikoj qysh janë shërbimet në Stacionin e autobusëve edhe mbi të gjitha kauza për të cilat, a po ka mundësi me të lënë me shpreh mendimin? Faleminderit. A din për besë nuk ndihmon kjo. A e din që kjo tendenca me luajt zhurmuesin nuk ndihmon sepse ti je ulur afër përparim Ramës. Ti vetë s'ka send që s'ke thënë për Përparim Ramën. Nuk ndihmon kjo hiç. Të gjitha këto e bëjnë të qartë që nuk bëhet fjalë për konsistencë këtu as për strategji politike. Të gjitha çka i keni thënë ju në fushatë zgjedhore keni dalë kundër tyre për secilin projekt, prej çmimit të biletave, prej sheshit, prej çdo gjë që kjo është konsistenca juaj. Prandaj gjithçka çka të thua ti duhet me marrë me..

Kryesuesi: - faleminderit z. Svecła. Nënkryetarja e ka kërkuar fjalën

Besiana Musmurati: - po them prapë Gëzim. Do të thotë në fund performancën e vlerësojnë qytetarët edhe performancën edhe të PDK-së edhe të Vetëvendosjes e kanë vlerësuar qytetarët. Për këtë arsye jeni ulur pak më andej edhe besoj që në qoftë se vazhdoni kështu keni me vazhduar veç duke shku andej më lart. Arsyeja kryesore pse kemi hyrë në koalicion e kemi bërë të qartë që nga fillimi. Ajo është me qenë në shërbim të qytetare për çdo, do të thotë punë të PDK-së në qytet. Përgjigjemi me kënaqësinë më të madhe për çdo keqpërdorim ose do të thotë çfarëdo lloj kërkesë të cilën e kemi për me trajtuar do t'a trajtojmë në mënyrën më të mirë të mundshme. Unë t'a dhashë përgjigjen për UNDP-në sepse kjo është ajo çfarë e kam gjetur edhe çfarë e kam parë me pak hulumtime që kam bërë deri më tani. Sa i përket çështjeve të tjera, po besoj që 4 vjet kanë me shku shpejt kemi me u ballafaquar prapë me zgjedhje edhe atëherë kemi me pa rezultatin prapë po gjithsesi në qoftë se ke pyetje sa i përket jetës, përmirësimit të jetës qytetare të Prishtinës, unë do të jem këtu gjatë gjithë kohës edhe do t'u përgjigjem të gjitha pyetjeve. Jo, nuk po flas për qeverinë, po flas për një realitet i cili sepse gjithmonë të gjitha vendimet të cilat merren në nivel qendror kanë efekt edhe në nivel lokal. Edhe këtë po besoj e dini edhe ju. Kështu që me kënaqësinë më të madhe çkado që ka për qytetarët e Prishtinës, këtu kemi me qenë edhe gjatë gjithë kohës kemi me u përballë. Secili drejtor i PDK-së ashtu siç jemi përballë gjithmonë. Gjithashtu po kur po të konvenon, po e përdor drejtorat e PDK-së kur po të konvenon. Po e vërtetë. Po edhe në opozitë e vërtetë. Ama edhe në opozitë keni me vazhdu me mbet. Kështu që mirë është me vazhdu. S'është e vërtetë edhe do të thotë s'kam nevojë me hy në replika të njëjta sepse po vazhdojmë me fol për sendin e njëjtë. Ne jemi këtu për qytetarë të Prishtinës. Kemi me qenë në shërbim të qytetarëve të

Prishtinës edhe çkado që ka në drejtori të cilat udhëhiqen nga Partia Demokratike e Kosovës. Me kënaqësinë më të madhe do t'i japë përgjigje. Me kënaqësinë më të madhe do të ofrojmë shërbim. Faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit nënkryetare. Vazhdo z. Sveçla një minutë e ke.

Gëzim Sveçla: - faleminderit kryesues. Shkurt thatë që vlerësimi i qytetarëve, po pikërisht vlerësimi i qytetarëve ka vlerësuar që ti dy herë mos me u bë as deputete edhe subjekti yt me mbet aty ku ka qenë. Ky është vlerësimi. Edhe ky vlerësim nuk është jo i rastësishëm. I ke pasur pesë minuta kohë në Parlamentin Evropian ku në vend që me shkuar me fol për grupin terroristit të Radojçiqit në vend që me fol për shqiptarët në luginë të Preshevës që po ia fshijnë adresat, ti je shkuar ke thënë hajde ndihmona t'a heqim Albin Kurtin. Për atë e ke marrë këtë rezultat Besianë. Unë jam i pari nëse më mban mend para katër vjeteve ku shumë tabu u kanë kam dalë publikisht të kam livduar në emision për punën që ke bërë si drejtores se kam besuar në qëllimet tua të mira, po qëllimet tua të mira me metamorfozën që po e përsëris si shprehje e që ka ndodhur të ti për një kohë kaq të shkurtë më bëjnë shumë me dyshuar, prandaj e ke përgjegjësinë je nënkryetare e qytetit.

Kryesuesi: - faleminderit një minutë.

Besiana Musmurati: - është e vërtetë kam qenë në Parlamentin Evropian edhe sa herë që shkoj nuk kam me ulë zërin, por edhe kam me fol disa çështje të cilat ndodhin në Kosovë sepse tema ka qenë e tillë. Ndër kto ka qenë rënia drastike e indeksit për Freedom of Media që ka ra edhe është diçka që do të thotë është pasojë e një keqqeverisje që ka ndodhur në Kosovë. Unë besoj që në bashkëpunim me juve dhe me secilin grup këtu që është kemi me punuar bashkë për me ofruar shërbime për qytetarë e Prishtinës. Për këtë arsye dhe kemi pasur bashkëpunim atëherë për këtë arsye bashkëpunimin do t'a keni prapë sa herë që flasim për çerdhe të reja, sa herë që flasim për shkollat të reja, sa herë që folim për më shumë shërbime për qytetarë të Prishtinës, ka me qenë këtu për secilën parti politike pa dallim. Edhe për atë arsye edhe ne kemi pasur do të thotë bashkëpunim edhe atëherë sa kam qenë drejtores e arsimit edhe do të vazhdoj të njëjtë edhe sa do të jem nënkryetare e Prishtinës. E sa i përket rezultatit zgjedhor, po them prapë je pak më larg.

Kryesuesi: - faleminderit nënkryetare. Bujar Gashi ka kërkuar fjalën.

Bujar Gashi: - faleminderit kryesues. Përgjigje të shkurtë z. Osmani. Sa i përket inspektimit hapësinor jemi takuar dhe kemi diskutuar për kërkesat që i ka pasur. Po besoj ekipa menaxhuesit të ka takuar, ka qenë në fshat keni vizituar disa pjesë të cilat nuk kanë qenë të trajtueshme me larvicide. faza e tretë e dezektimit hapësinor z. Osmani është bërë ditën e shtunë për shkak të reshurave, ditën e enjte ndoshta s'ke qëlluar asajde. E faza e katërt është këtë javë, domethënë të premten. Nëse janë kushtet atmosferike në rregull, atëherë ditën e premte do të jenë ekipet në Besi.

Kryesuesi: - faleminderit drejtor. Z. Osmani, fjala për juve është.

Feim Osmani: - mos i paragjyko se duhet me diskutu nuk jemi asgjë për ngutë me përfunduar seancën. Kemi mundur edhe me shkuar në pauzë e me vazhdu tutje. Është çështje shumë e rëndësishme. Unë nuk po them që nuk ka ndodhur faza e dytë e dezinfektimit, mirëpo e kam fjalën që ka mundur të seleksionohem prapë rrugët si e kemi diskutuar edhe kur jemi takuar dhe kemi

ngritur si shqetësim. Prap po flas për rrugën “15 Marsi” është e njëjta çështje. Nuk kanë qenë në fazën e dytë të dezinfektimit. Dezinsektimi në fazën e parë është kryer më vonë për arsye se herën e parë s’ka ndodhur fare. Ndërsa hera e dytë s’ka ndodhur, unë nuk i kam parë, jam banor i asaj rruge dhe patjetër që do t’i kisha parë, sepse do duhej të më njoftonin për arsye se unë jam bletë kultivues dhe do duhej ta kisha njoftimin paraprak. Kështu që të jesh i sigurtë që kjo nuk ka ndodhur dhe unë kur e përmend rrugën “15 Marsi” ju është mirë me rishikuar.

Kryesuesi: - faleminderit z. Osmani. Urdhero drejtor, Bujar Gashi ka fjalën.

Bujar Gashi: - nëse është rruga e juaj me atë emër domethënë ju siguroj që ditën e Shtune ekipa ka qenë deri te shtëpia juaj dhe aty është kthyer se sipas informative aty duhet me u kthi nëse është ashtu, shtëpia e fundit, kështu i kam informatat prej ekipe sepse unë s’kam qenë në terren atje.

Kryesuesi: - faleminderit drejtor. Leutrim Ratkoceri ka kërku fjalën.

Leutrim Retkoceri: - faleminderit kryesues. Në konsideratë të pauzës së drekës, unë po i përmbledhi pyetjet me përgjigje me radhë, çështja e parë ke me ndriçim publik Aleksandër Moisiu, Bedri Dedaj edhe Stambolli kemi shkuar çështja e ndriçimit publik është një projekt i cili është ka fundi edhe shumica e investimeve pas një analize me departamentin e drejtorisë së shërbimeve publike kemi kërkuar që të bëhen intervenime në zgjerimin e rrjetit të energjisë të ndriçimit publik, kryesisht të fokusohet në rrugë ku ka më shumë banorë edhe ku kërkesat janë edhe më të vjetra. Është bërë ndriçimi, do të shikohet intervenimi edhe te rruga “Stambollit” sepse kryesisht janë kërkesa që kërkojnë të mirëmbahen apo të ndryshohen ose të ndërrohen poçat elektrik, ndërsa nuk kanë të bëjë me zgjerim të rrjetit të ndriçimit publik. Sigurisht se do t’i trajtojmë, nëse jo në këtë fazë gjatë përfundimit të kontratës do t’i trajtojmë me kontratën e re të mirëmbajtjes së ndriçimit publik. Është shumë e nevojshme në qytet. Edhe kërkesat janë një numër të madh sikurse edhe punimet që janë kryer janë një numër i madh i rrugëve në kryeqytet që po sanohen dhe po vazhdohet zgjerimi i ndriçimit publik. Sa i përket çmimit të kjosëve, jam interesuar edhe unë për këtë çështje. Është mirë të trajtohet me rregulloren për taksa edhe tarifa komunale që ka me ardhë këtu për votim. Ju kisha lutur edhe juve që t’i shikoni çmimet kur vendosen, sepse pastaj në bazë të rregullorëve vendosen edhe çmimet. Nuk kam parë ndonjë dokument se në bazë të çkafit janë vendosur. Kështu që çka na duhet me bërë një bazë ligjore dhe pastaj të vazhdojmë me atë praktikë. Pusetet nuk janë në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, janë te Drejtoria e Investimeve Kapitale. Sa i përket Kodrës së Trimave në rrugën “Mon balaj” është e vërtetë që për momentin nuk ka ndriçim. Arsyet janë intervenimi në rrjetin e ndriçimit publik që është duke ndodhur për shkak se rrjeti i kaluar ka qenë i dëmtuar nga punimet dhe është identifikuar problemi, është duke filluar sanimi i ndriçimit. Faleminderit shumë edhe për shqetësimin që dritat punojnë 24 orë. Do dalin ekipat të intervenojnë edhe ashtu rryma shtrenjtë është kështu që është e nevojshme me u intervenuar. Ato vende ku s’ka është e njëjta përgjigje identifikohen, listohen me kontratën e mirëmbajtjes do të intervenohet në të gjitha lagjet edhe në krejt qytetin. Mbyllja e pusetave të atmosferike, mbledhësav atmosferik për momentin nuk ka kontratë jemi duke punuar intensivisht në sigurimin e kontratës për mirëmbajtjen e rrugëve që do të jetë. Jemi t’u punuar në atë model që të jetë e dizajnuar masandej mos me pas ankesa nga operatorët edhe qytetarët për mirëmbajtjen sa më efikase të rrugëve të pusetave edhe të ujërave atmosferike, shportat prej praktikës na duhet edhe një diskutim tjetër me bë në kuvend me qytetarë. Në disa situata shportat

e xhepit nuk është që po funksionojnë në kryeqytet për shkak se mbeturinat e vogla nuk po mundën me u identifikuar masandëj po hudhën vetëm të voglat apo edhe ato të mëdhat. Duhet me të një strategji të mirëfilltë në shpërndarjen e tyre arsyen edhe qysh po i vendosim. Këto kena me të bashkërisht. Nuk mundem vetëm një drejtori me fol për këtë çështje. E patëm kërkesën për krahasitje. Po, faleminderit edhe për këtë kërkesë e nevojshme që fshatrat edhe lagjet me u trajtu me kontratën që ka me ardhë për mirëmbajtje të rrugëve verore dhe dimërore, që me u mirëmbajt edhe krahasitjet nëpër fshatra, sidomos ato fshatra ku ka banorë që jetojnë. Tjetër çka patëm, po transporti publik, zgjatja e kontratave është bërë një njoftim si drejtorja e shërbimeve publike, kompetenca tani kalon në drejtorinë e mobilitetit, por çka do që ka nevojë, qoftë si ish-kompetencë që ka pas Drejtorja e Shërbimeve Publike, por edhe në bashkëpunim me drejtorin Pëllumbin, ne do të bashkëpunojmë ngusht në zgjidhjen më të mirë për operatorë edhe për shërbime më të mira për qytetarë. Ujësja në Bernic të Epërme. Po është një shqetësim i kanë edhe sa kam qenë asamblist, vazhdon me qenë edhe si drejtor i shërbimeve publike kurdo që është e nevojshme unë jam në dispozicion me dalë me i taku banorët me thirrë edhe kompaninë regjionale ujësja. Unë mendoj që është një kompetencë përderisa qytetarët paguajnë ujë zgjerimi i rrjetit duhet me shku nga kompania ujësja që sigurisht në bashkëpunim edhe me drejtorinë që i keni. Mirëpo unë nuk jam që qasja e përjashtimit nga kompetenca me qenë përgjegjëse për qytetarët. Kështu që zonja Lumnie kurdo që e shihni të arsyeshme një takim me qytetarët thirrjen e institucioneve përgjegjëse me të me diskutuar me qëllimin e vetëm me ofruar shërbime sa më të mira te qytetarët edhe sigurisht uji është urgjencë është jetike, me pas qytetarët edhe në Bëricën e Epërme. I pata dhe tre pyetje nga ish-kolegu në Kuvend, po unë kam kërkuar edhe vazhdimisht kërkoj që të dihen paratë e taksapaguesve të qytetarëve ku shkojnë. Kontratat që janë bërë me UNDP-në sikur në nivel qëndror edhe në nivel lokal është mirë me ditë për cilat projekte bëhen, ku shkojnë edhe me pas transparencë. Sa i përket raporteve edhe ato të auditorit jemi duke i analizuar si departamenti i Drejtorisë së Shërbimeve Publike edhe kemi me kthyer secilën përgjigje për gjetjet që i ka bërë sa i përket kapaciteteve dhe kompetencave të Drejtorisë së shërbimeve publike. Sa i përket mbeturinave, përgjegjësitë mendoj që ne nuk duhet me shiku më këtë çështje si fajësim, arsyetim edhe përgjegjësi vetëm kujt i takon. Unë mendoj që përgjegjësi kemi krejt përgjegjësi kemi dhe kemi me pas. Unë të 3 pyetjet të inkurajoj me shiku sa më shumë videot se po të shërbejnë edhe sot që disa prej pyetjeve që je tu i bë je tu i bazuar në videot që i kam thënë unë. Të përgëzoj, të inkurajoj, vazhdo, lëshoj, mëson më shumë. Ka bazë aty edhe vazhdo me i përdorë edhe janë të mirë të interesit publik atyre s'ju biem pishman mos u bë merak. Përgjegjësia në këtë çështje ka qenë edhe e kuvendit është edhe e secilit sigurisht se qëndron mbi përgjegjësinë e udhëheqësve sa më lart që i kanë pozicionet vazhdon. Mirëpo ne e kemi votuar një rregullore këtu që mos u bë merak ti për atë pjesë, nëse je i interesuar me lënë radhën me jep përgjigjet e pyetjeve që i bënë kolegët sjellu të paktën dinjitetshëm si përfaqësues i qytetarëve për zhurmë dal andej nuk pritoj unë masandëj të japi përgjigje çfarë duash. Për rregullore unë krejt fjalët i mbaj që i kam pas edhe votimet që i kemi bë, por në fund është edhe regjistër në diskutimet në komitet për politikë edhe financa që na bashkërisht jemi zotuar që rregullorja bëhet për interes publik me mbrojt qytetin, me i mbrojt edhe institucionet publike, por është edhe një përgjegjësi që ju vetë e keni iniciu që është mirë me vazhduar ne me e bërë që është subvencionimi i borxheve të ndërmarrjes publike, KRM pastrimit që e keni çuar ju si pikë dhe ju inkurajoj prapë me inicuar prapë me inicuar t'a gjejë procesverbalin, t'a qes në seancë të rregullt këtu është më e rregullt, t'a rriti veç mbaj fjalët.

Çështja tjetër sa i përket operatorët privatë janë njëri e ka përfunduar kontratën edhe tjetri e përfundon shumë shpejt ato i konstaton dikush tjetër kontratat e rregullta edhe raportin e auditorit a e ke marrë a i ka cilësu të rregullta a jo, të njëjtën e ka bërë edhe Fushë Kosova. S'mundem me t'u përgjigjë pa mikrofon. Faleminderit shumë. Sa i përket raporteve, unë një gjë shumë pozitive që e vlerësoj është kolegja këtu Fjolla e ka bërë një propozim ku bash është inkorporuar edhe në raportet financiare katër mujore që i marrin edhe Kuvendi edhe qytetarët ku do të identifikohen kodi 0040 për të treguar se cilat mjete janë përmbaruar prej përmbaruesve dhe është një e drejtë që duhet me ditë edhe kuvendi edhe qytetarët edhe kjo është në interes edhe në funksion të interesit publik. Pyetja e fundit ke gjendja me mbeturina dhe kontinjerët në lagjen Mati 1 jemi duke punuar në këtë drejtim. Sot do dalim edhe personalisht në terren me ekipë për të shikuar, nuk munda me u pajtuar me një realitet të krijuar që lokacioni i kontinjerëve është përgjegjësi në bazë të lejeve ndërtimore edhe ndërtuesve që me i caktu. Edhe këtu nuk ka funksionuar kjo çështje. Bashkërisht me inspektionin do të dalim. Nuk do t'a ndjekim një logjikë të barazisë edhe një logjikë që nuk munden qytetarët e rregullt që nuk hudhin mbeturina me pagu kosto për persona që kanë pasur përgjegjësi me i kryer investimet në bazë të lejeve dhe kontratave që i kanë pas. Kjo çështje do të don pak kohë, por në fund do të përmbyllet si një proces ku do t'a ndërtojmë bashkë edhe do t'a përmbyllim me sukses. Faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit. Leutrim, fjalën Pëllumb Bajqinovci.

Pëllumb Bajqinovci: - faleminderit kryesues. Përsëritje për të gjithë masi jemi edhe në fund edhe ka humb pak durimi. Unë po mundohem me i përfshi krejt pyetjet të cilat janë bërë sot. Atëherë po filloj me Enver Redenica, me stacionin e autobus dhe sa e mora vesh në Tokbashqe për dislokim ka qenë. Unë nuk e kam parë kërkesën më herët. Të lutem e keni e-mailin tim zyrtar e dërgoni edhe detajet edhe pastaj do marrim masa. Faleminderit shumë. Njëjtë edhe nga Besarti për stacionin për linjën shtatë 7 Dhe 7A në Kodrën e Trimav "Haxhi Zeka". Po siç e dini kemi filluar me rritjen e stacioneve modernizimin e tyre dhe në atë fazën e cila kërkon kohë.

Disa stacione të cilat kanë pasur hapësirën e mjaftueshme për me u ndërtu vetëm se kanë përfunduar. Disa të tjera kemi kërkuar me e ndryshuar formën. Janë 3 lloj stacione A, B dhe C dhe varësisht prej pozicionit do i vendosim. Sigurisht kërkesën nuk e kam marrë Besart të njëjtë nëse e keni gati vetëm e përcjellni në e-mail zyrtar tek unë. Rimanishtë pengesa e cila po pengon që për herë të parë po e dëgjoj se kemi nevojë për pengesa shumë, Feim për herë të parë po pengon dikund në rregull është kërkesë, në rregull personalisht do dal në Rimanishtë edhe me pa edhe do marr masa nëse me të vërtetë i kanë vendosur jokonform ligjit, të lutem nëse e keni kërkesë të njëjtë nuk e kam parë nëse e keni që e keni dërguar më herët dikund për arsye se e dini angazhimin tim që është bërë, tash e përcjellni te unë..... Unë në momentin e parë do dal në terren edhe do marrë masa. Pastaj Fjolla lidhje me trafikun urban edhe me biletën digjitale dhe përgjithësi për digjitalizimin. Po mundohem shumë shkurt për arsye se detajet pastaj të detajuara ju sjellim më vonë me e-mail. Biseduam a po bëhet pyetje për trafikun urban dhe planin e biznesit. E kanë ata planin e biznesit. Nëse futeni web- faqen e Trafikut Urban –Pr mundeni me kliku dhe me marrë. Përndryshe sot kur flasim për trafikun urban apo trafikun privat flasim për një trafik të përgjithshëm në kryeqytet i cili quhet Trip Transporti i ri i Prishtinës. Qëllimi ka qenë që transporti të jetë gjithëpërfshirës për të gjithë të jetë alternativa a po dera e parë e secilit qytetar. Andaj edhe

procesi i digjitalizimit si proces ka për qëllim që të futet në secilën transportues digjitalizimi. Qëllimi është që e kemi bërë edhe tash që bileta është uniforme pa marrë parasysh qytetari a e shfrytëzon trafikun urban a po privat. Domethënë çmimi i biletës është uniforme edhe është i njëjtë tek secili transportues në kryeqytet. Kuleta digjitale është një platformë e të cilën e kemi filluar digjitalizimin e procesit. Jemi munduar me kriju përmes saj një transparencë, një përmirësim të menaxhimit edhe përfundimisht po na krijon data, po na krijon atë sistemin. E dimë saktësisht sa kemi njerëz në autobusin e caktuar, në secilin linjë ku kemi mangësi, ku kemi nevojë me shtu. Andaj rritja digjitalizimi i përkon kohës sonë bashkëkohore edhe rritjes së nivelit të shërbimit edhe qëndrueshmërisë së saj. Nuk do të jetë kuleta digjitale e vetmja platformë e cila do jepë shërbimin. Sigurisht do të fillojmë edhe me forma të tjera të pagesës së biletës si me kartela bankare me klikim kur futesh brenda në autobus ku qëllimi jonë është që të kemi zvogëlim të shpenzimeve administrative edhe të jetë një kosto e cila digjitalizimi të jetë një kosto e cila është e pashmangshme të secilit transportues. Detajet e detajuara thashë ju tregoj më vonë me e-mail dhe do komunikojmë pastaj më vonë. Një pyetje tjetër ka qenë nga Leonora lidhje me rrugën “Malush Kosova” dhe nevojën për transportin urban. E kam marrë kërkesën Leonorë dhe më herët transporti urban është duke u rivitalizuar dhe duke u rritur. Jemi me flotën e re ku do e sjellin trafik urban, pastaj edhe flotën që e sjell trafiku privat. Ne do të jemi në secilën lagje dhe do të japim shërbimin për secilin qytetar. Andaj që sigurisht që kërkesën e kam përcjellë dhe do e shoh se ku ka mbërri edhe ku jemi me afate. Muhameti për lëvizjen e shpejtë tek pjesa e Arbërisë jemi takuar dy kërkesat të cilat kanë qenë mediate në lidhje me lirimin e një pjesës të parkingut tek udhëkryeqi. Vetëm se si mobilitet e kemi dërguar tek operatori privat i cili këto ditë vetëm se du bënë lirimin e disa hapësirave dhe të krijojmë një shikueshmëri edhe një siguri më të madhe në udhëkryqe, mirë ka qenë një kërkesë për semaforët në sinjalizimin në pjesën e sipërme të Arberisë të rrisim kycjen poshtë edhe të rrisim kohën realisht të kalimit të automjeteve dhe këtë do e bëjmë kohën më të shpejtë për shkak se nuk e kemi operatorin ende të na e krye atë shërbim por kërkesa është shkuar tek vendi dhe besoj që kryhet shpejt. Në anën tjetër për pengesat do dalim në terren dhe do e shohim se si janë mundësitë që ligjërisht të vendosen dhe të krijojmë siguri më të madhe për banorët. Duket nuk ka pasur pyetje të tjera. Ju faleminderit

Kryesuesi: faleminderit z. Bajqinovci. Granit Geci ka kërkuar fjalën.

Granit Geci: - faleminderit kryesues. Përsëritet për të gjithë kolegë asamblistë. Me u përgjigjë pyetjes së Mrikës. Ditë më parë bashkë me drejtorin e arsimit e kemi bërë një vizitë në ambientin sportiv që është në shkollën “Pavarësia” në Muharrem Fejza e vërteta është pikërisht ajo që thatë edhe ju që gjendja ishte bajagi e rëndë. Mirëpo e kemi marrë përsipër që deri në shtator me i kriju dy hapësira të reja sportive. Pjesën e prapme ku është pjesa e futbollit që ka qenë e dedikuar dhe basketbollit kemi vendosur me e nda pjesën prapa do të jetë vetëm për futboll dhe jemi duke tentuar që shumë shpejt t’a sigurojmë edhe që t’a shtojmë edhe me bari artificial. Ndërsa në pjesën e përparme ku është edhe parking, kemi gjetur një hapësirë e cila është e mjaftueshme që me u kriju hapësirë vetëm për basketboll. Atë po besoj shumë që do ta bëjmë në kohë dhe në shtator fëmijët do ta kenë mundësinë që t’u ekspozohen këtyre dy hapësirave të reja. Muharrem Fejza siç e dimë po dhe në përgjithësi Mati sot është një prej zonave më të dendura sa i përket banimit dhe frekuentimit ku besoj që rreth 80.000 banorë në ditë ose jetojnë ose minimalisht punojnë, veprojnë dhe e frekuentojnë në atë zonë dhe është shumë sfiduese për të gjithë ne dhe kjo lyp angazhim jo

vetëm të ekzekutivit por edhe të asamblesë dhe të gjithë atyre që kanë përgjegjësi në Prishtinë të na ndihmojnë që të bëjmë më të mirën që t'ua lehtësojmë jetën atyre banorëve. Një përgjigje e kam edhe për Muhamet Selmanin që e patë për Barilevë, po Muhamet jam në ngjarje për atë fushë sportive dhe kemi marrë përsipër që edhe atë ta rregullojmë. Në të njëjtën kohë besoj që javën e ardhshme do e përurojmë edhe një hapësirë të re sportive në Barilevë e cila është në lagjen Leci ku jemi në finalizim të punimeve. Të ftoj me qenë i pranishëm si përfaqësues i fshatit. Në të njëjtën kohë kemi takuar edhe disa nga banorët pikërisht për kërkesën e juaj dhe besoj që shumë shpejt do të bëjmë intervenimet e nevojshme që t'i përfundojmë atë fushë për të cilën po flini dhe jam saktësisht në ngjarje për çka është fjala.

Kryesuesi: - faleminderit z. Geci. Enver një minutë.

Enver Redenica: - faleminderit kryesues. Faleminderit drejtor për përgjigje. Meqënëse kërkesa ime ka qenë me të 3.3.2026 nuk keni qenë drejtor në atë kohë, por unë ju kam drejtuar drejtorisë duke menduar që çdo drejtor që vjen e përcjell atë kërkesë. Unë fizikisht e kam këtua kërkesën, po nëse doni ju përsëriti edhe me e-mail kam edhe këtua. Aty ishte edhe me u hap edhe një derë në Tokbashqe përpos që aty besoj që i takon drejtorisë së juve. Po këtua kam kërkesën mundu të ju dorëzoj edhe fizikisht po edhe me e-mail. Faleminderit përgjigjen.

Kryesuesi: - faleminderit z. Redenica. Drejtoresha e parçeve Albana Gjymbalaj e ka fjalën.

Albana Gjymbalaj: - për pyetjen lidhur me mbjelljet me lule sezonale me ju tregu që “Ndërmarrja e Gjellbërt” është në një kapacitet pak më të kufizuar për furnizim me lule sezonale si rrjedhojë ne si drejtorja e parçeve jemi duke i bërë të pamundshmen me i bërë mbjelljet me kontratën që e kemi për mbjelljen e bimësisë nëpër kryeqytet, jemi duke shkuar me zgjidhje si me thënë pakës më të qëndrueshme në aspektin financiar bimë të cilat nuk janë njëvjeçare po të cilat qëndrojnë pakëz më gjatë, ndërsa për çështjen e mbjelljes saktësisht të rrethi i Ulpianës aty ka qenë veç është i planifikuar të rrethi i fontanës. Unë e mora. Po po kjo është për shkak të kapaciteteve të të kufizuar po ne jemi në vazhdimësi duke pranuar kërkesa prej qytetarëve për realizimin e mbjelljeve. Tash ju e dini edhe vetë që koha nuk është e mbjelljeve dhe ne i kemi stopuar aktivitetet e mbjelljes për shkak se ato çkado që mbillet tash është e destinum, ka gjasat më të mëdhaja me dështuar sikur mbjellje dhe në periudhën e shtatorit mandej, kemi me rifilluar me mbjelljet nëpër kryeqytet. Për me e plotësuar drejtorin Leutrim lidhur me krasitjet dhe shkurtimet e shkurrve nëpër fshatra kjo është veç si informatë shtesë me ju treguar që ndërmarrja e gjellbërt në kuadër të kontratës që e kemi me ta për mirëmbajtjen e hapësirave publike i bën krahasitje dhe kositje edhe në fshatra aktualisht këto dy javët e fundit janë realizuar krahasitje dhe kositje në Besi në rrugën për Prapashticë edhe në Prugovc. Kështu që kudo që kemi raste të tilla të ankesave Ndërmarrja Gjellbërt i përfundon ato punë Besi edhe Prugovc kanë bërë, domethënë kudo që ka raportim kudo që ka raporte që cënohet në një lëvizja e qytetarëve, cënohet siguria rrugore e komunikacionit edhe kudo që ka rreziqe të tilla që mundet me pas ose ramje të drunjëve ose ti. Ne si drejtori në bashkëpunim me Ndërmarrjen e Gjellbërt i realizojmë edhe ato.

Kryesuesi: - faleminderit drejtoreshë. Drejtoresha e Investimeve Kapitale e ka fjalën. Znj.Gashi e ka fjalën. Drejtoresha e Investimeve Kapitali.

Zyhrije Pllana- Gashi: - përshëndetje të gjithëve. Pyetjet të cilat i keni dërguar për Drejtorinë e Investimeve Kapitale ju sjellim me ekip në ditët në vazhdim se nuk isha prezente.

Kryesuesi: - faleminderit drejtoreshë, Nexhmie Gjema edhe një minutë po ju jap.

Nexhmie Gjema: - kur jemi te kuleta digjitale dhe mbrojtja e të dhënave personale po i drejtohem zotëri Bajqinovci . Jemi të brengosur lidhur me të dhënat të cilat kërkohen për kuletën digjitale ku është dokumenti i identifikimit, fotografia ose selfi, edhe pse duhen të gjitha këto informata, të dhënat personale t'i ndahen dhe të menaxhohen apo të një kompanie private siç është PBC Group. Kush është kjo që i merr të dhënat domethënë konfidenciale të secilit qytetar dhe në bazë të cilit ligj është lejuar kjo dhe a keni marrë një opinion nga agjensioni për informim dhe privatësi? Faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit znj. Gjema, dëshiron me ju përgjigjë. z. Bajqinovci e ka fjalën.

Pellumb Bajqinovci: - faleminderit shumë. Atëherë siç e dini jam kyçë më vonë në projekt edhe i cili po vazhdon. Aktualisht nëse flasim për të dhënat personale para se me pasur kuletën digjitale nëse keni pasur më herët një biletë fizike nga transporti urban, e dini se aty të njëjtë janë shënuar emri mbiemri, data e lindjes, pastaj numri personal dhe ka qenë obligative me qenë një fotografi fizike e vendosur për arsye se me identifikim personin i cili po udhëton me transport. Sigurisht se kompania e ka bërë në bazë ligjeve në fuqi për të cilat tash nuk kam informatë, mirëpo do i përmbledh të gjitha dhe ju do ju dërgoj në email në ditët në vazhdim. Sigurisht se po, drejtë legjitimi. Faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit z. Bajqinovci . Dikush tjetër s'ka. Po kalojmë në pikën e 10 të ndryshme. S'ka diçka. Atëherë unë ju falenderoj për pjesëmarrje. Me kaq po e përfundoj këtë mbledhje. Mirupafshim në mbledhjet e ardhshme. Me kaq konstatoj të mbyllur këtë seancë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 31.7.2026, e cila filloi në orën 10:16.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina (Lidhja për Prishtinën) kryesues i Kuvendit, Bekim Gashi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Fadil Aliu (LDK), Egzon Pacolli (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Etnik Mustafa (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Dhurata Jahaj Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi Osmani (LDK), Rifadije Sopi (LDK), Amir Simnica (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Muhamet Selmani (PDK), Elmi Fazliu (PDK), Agnesa Avdyli-Vitia (PDK), Yll Muriqi (PDK), Muhamet Ademi (PDK), Plator Gërdovci (PDK), Florian Beka (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Fjolla Vukshinaj-Reçica (PDK), Trim Sylja (PDK), Gëzim Sveçla (LVV), Jeta Dida-Bujari (LVV), Berita Abazi-Muhadri (LVV), Çlirim Gërbeshi (LVV), Feim Osmani (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Nexhmiqe Gjema (LVV), Lumniqe Mikullovc (LVV), Leonora Shabani-Bajraktari (LVV), Enver Redenica (LVV), Kreshnik Smajlaj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Erblina Tahiraj (AAK), Arbentia Murseli-Haxholli (Lidhja e Prishtinës), Teuta Kadiu-Gjinolli (Lidhja e Prishtinës), Besa Shahini (PSD), Endrit Zabërgja (NISMA), Jeton Mehmeti (GUXO), Valbona Ajeti (e pavarur), Yll Bogaj (i pavarur), Betim Abdullahu (i pavarur).

Munguan: Ilirik Musliu (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Mrika Limani-Myrtaj (LVV), Nora Kelmendi (LVV).

Të pranishëm ishin edhe: Besianë Musmurati - nënkryetare e Komunës, Valbona Makolli - drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Luftar Braha - drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Inovacionit, Brahim Mehmetaj - drejtor i Drejtorisë së Pronës, Gent Begolli - drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Bujar Gashi - drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Bekim Brestovci - drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Arianit Elshani - drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Agron Canolli - drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit, Lulzim Fushtica - drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave, Pëllumb Bajçinovci - drejtor i Drejtorisë së Mobilitetit, Driton Bardheci - drejtor i Drejtorisë së Administratës, Rrezarta Aliu - drejtoreshë e Drejtorisë së Turizmit, Granit Geci - drejtor i Drejtorisë së Sportit, Albana Gjonbalaj - drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Adelinë Sahiti - drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Donat Gashi - drejtor i Drejtorisë së Rinisë, Isah Mustafa - drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Nora Cimili - drejtoreshë e Drejtorisë së Transformimit, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të KFOR-it dhe të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina** - kryesues i Kuvendit, i cili tha se për këtë mbledhje është parapa ky:

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit;**
- 2. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill – 30 qershor 2026 (TM2);**
- 3. Propozim vendimi për caktimin e Komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale;**
- 4. Pyetje dhe përgjigje;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesi i njoftoj se në mbledhjen e djeshme të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), kanë shqyrtuar dhe kanë rekomanduar për procedim në këtë seancë dy propozim-vendime: Propozim-vendimin për transferimin e mjeteve financiare i propozuar nga drejtoresha Valbona Makolli dhe Propozim-vendimin për formimin e Komisionit për Ankesa për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale i propozuar nga drejtori Brahim Mehmetaj. Duke qenë se KPF-ja ka rol rekomandues, këto dy pika i propozohen Kuvendit për shqyrtim dhe vendimarrje.

Kryesuesi hapë diskutimin rreth rendit të ditës.

Gëzim Sveçla: - kërkoi që kryetari i Kryeqytetit të deklarohet publikisht në Kuvend lidhur me materialet e shpërndara para fillimit të seancës, të cilat, sipas tij, përmbajnë pretendime serioze që cenojnë integritetin e institucionit dhe të zyrtarëve të komunës. Ai theksoi se ndonëse çështja i është referuar organeve kompetente për trajtim, një sqarim publik nga kryetari është i domosdoshëm në aspektin moral dhe institucional. Sveçla ngriti shqetësimin për moszbatimin e planit të punës së Kuvendit, duke theksuar se kryetari ende nuk ka raportuar para Kuvendit sipas obligimeve ligjore. **Ai propozoi si pikë të rendit të ditës raportin e auditimit që të sillet për shqyrtim në Kuvend,** duke kërkuar sqarime për vonesën e procedimit të tij dhe respektimin e planit të punës së miratuar nga Kuvendi.

Osman Billaca: - sqaroi se raportet e auditimit të brendshëm i ka paraqitur rregullisht, ndërsa raportimi për periudhën gjashtëmujore është shtyrë për shkak të arsyeve teknike dhe do të prezantohet në seancën e ardhshme. Sa i përket raportit të auditimit të jashtëm, ai theksoi se procedimi i tij në rendin e ditës është kompetencë e ekzekutivit, përkatësisht kërkon propozim nga kryetari. Ai vlerësoi se diskutimi i këtij raporti është i rëndësishëm dhe publik, duke shtuar se nuk ka arsye për të shmangur shqyrtimin e tij. Osmani tha se pret që në seancën e ardhshme të trajtohen raporti i auditimit të jashtëm, ashtu edhe ai i auditimit të brendshëm, ndërsa për propozimin e paraqitur në këtë seancë theksoi se vendos Kuvendi përmes votimit.

Besa Shahini propozoi që në rendin e ditës të përfshihet diskutimi mbi sigurinë në vendpunishtet e ndërtimit në Komunën e Prishtinës, pas rasteve tragjike të humbjes së jetës së

punëtorëve. Ajo vlerësoi se reagimi i Komunës ndaj këtyre rasteve ka qenë i pamjaftueshëm dhe kërkoi që të shqyrtohet roli dhe përgjegjësitë e komunës në mbikëqyrjen e zbatimit të kushteve dhe procedurave gjatë procesit të ndërtimit. Shahini theksoi nevojën për një debat institucional mbi masat që mund të ndërmerren komuna për rritjen e sigurisë në vendpunishte dhe për parandalimin e rasteve të ngjashme në të ardhmen.

Drejtori Brahim Mehmetaj: - kërkoi tërheqjen nga rendi i ditës të pikave që kanë të bëjnë me themelimin e Komisionit Vlerësues dhe Komisionit për Ankesa, me arsyetimin se nevojiten disa rregullime teknike lidhur me përcaktimin e anëtarëve të komisioneve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ai sqaroi se kërkesa nuk lidhet me diskutimet e zhvilluara në Komitetin për Politikë dhe Financa, por vetëm me nevojën për përmbushjen e kërkesave ligjore dhe procedurale.

Kryesuesi konstatoi se propozimi për pikë të rendit të ditës nga drejtoresha Valbona Makolli, “Propozim vendimi për transferimin e mjeteve financiare” kalon me 28 vota për, 8 kundër dhe 1 abstenim.

Kryesuesi konstatoi se propozimi për pikë të rendit të ditës nga Gëzim Sveçla, “Raporti i auditorit të jashtëm”, nuk kalon me 16 vota për, 23 kundër, asnjë abstenim.

Kryesuesi konstatoi se propozimi për pikë të rendit të ditës nga Besa Shahini, “diskutimi mbi sigurinë në vend punishteve të ndërtimit në Komunën e Prishtinës”, nuk kalon me 12 vota për, 24 kundër, asnjë abstenim.

Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për, asnjë kundër, 3 abstenime, miratohet rendi i ditës me ndryshime.

Pika e parë e rendit të ditës

“Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit”.

Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohet ekstrakti i procesverbalit të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e dytë e rendit të ditës

“Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill – 30 qershor 2026 (TM2)”.

Drejtoresha e Financave - Valbona Makolli: - paraqiti raportin financiar tremujor për periudhën prill-qershor 2026, të përgatitur në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Raporti përfshin performancën e të hyrave dhe të shpenzimeve buxhetore për periudhën raportuese. Ajo njoftoi se të hyrat vetanake kanë shënuar rënie prej 32.95% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, kryesisht për shkak të shpërndarjes së vonshme të faturave të tatimit në pronë dhe mosmiratimit ende të rregullores për tarifa dhe gjoba. Sa i përket shpenzimeve buxhetore, u raportua se janë realizuar 45,015,910 euro, ose 56.52% e buxhetit për periudhën raportuese. Shpenzimet për paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, si dhe subvencione e transfere kanë shënuar rritje krahasuar me vitin paraprak, ndërsa shpenzimet për investimet kapitale kanë

shënuar rënie. Veçanërisht, realizimi i investimeve kapitale u vlerësua si jo i kënaqshëm, me vetëm 10.69% të realizimit dhe një rënie prej 20.40% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2025. Drejtoresha u shpreh e gatshme t'u përgjigjet pyetjeve dhe komenteve të anëtarëve të Kuvendit.

Fjolla Vukshinaj-Reçica: - falënderoi Drejtoreshën e Financave për raportimin dhe veçoi rritjen e të hyrave nga Biblioteka dhe Teatri Dodona. Ajo theksoi se sipas raportit financiar, këto të hyra janë rritur nga 1,600 euro në vitin 2025, në 37,000 euro në vitin 2026 duke shënuar një rritje të konsiderueshme. Ajo përgëzoi Drejtorinë e Kulturës për këtë rezultat, duke theksuar se rritja e të hyrave vetanake është një objektiv i rëndësishëm për Komunën dhe se ky është një shembull pozitiv i përmirësimit të performancës financiare.

Feim Osmani: - kritikon raportin financiar të tremujorit të dytë të Komunës së Prishtinës, duke e cilësuar atë më të dobët se raporti paraprak dhe si dëshmi të keqmenaxhimit financiar. Ai thekson se të hyrat vetanake kanë shënuar rënie të konsiderueshme, me vetëm 20% të planit vjetor të realizuar, ndërsa komuna po bëhet gjithnjë e më e varur nga grandet qeveritare, tatimi në pronë dhe lejet e ndërtimit. Ai tha se kjo paraqet rrezik për qëndrueshmërinë financiare të kryeqytetit. Osmani argumenton se fondet janë orientuar kryesisht në mallra dhe shërbime, paga dhe pagesa të vendimeve gjyqësore, ndërsa investimet kapitale kanë mbetur shumë të ulëta. Ai ngre dyshime për shpenzime të raportuara në projekte që, sipas tij, nuk janë realizuar në terren dhe kërkon sqarime për këto raste. Osmani i bëri thirrje ekzekutivit komunal të japë përgjigje për menaxhimin e taksave të qytetarëve, duke paralajmëruar se vazhdimi i këtij trendi do ta përballë Prishtinën me vështirësi serioze financiare.

Nexhmije Gjema: - kritikon raportin financiar të Komunës së Prishtinës për tremujorin e dytë të vitit 2026, duke evidentuar mospërputhje në raportim dhe probleme serioze në menaxhimin e financave publike. Ajo thekson se të hyrat vetanake kanë rënë nga 12.31 milionë euro në vitin 2025, në 8.25 milionë euro në vitin 2026, kryesisht për shkak të rënies së të hyrave nga lejet ndërtimore, ndërsa kërkon sqarime për arsyet e kësaj uljeje. Nexhmija tha se të hyrat kanë rënë për rreth 33%, shpenzimet e përgjithshme janë rritur mbi 56%, veçanërisht në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Ajo ngre shqetësime se rritja e shpenzimeve nuk është shoqëruar me rritje të investimeve reale kapitale, pasi një pjesë e madhe e shpenzimeve kapitale lidhet me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore. Gjema kritikon rritjen e pagesave nga vendimet gjyqësore, duke kërkuar transparencë për ndarjen e borxhit bazë, kamatave dhe shpenzimeve përmbarimore. Ajo kërkon gjithashtu shpjegime për projektet kapitale pa realizim financiar, për rritjen e llogarive të arkëtueshme dhe për mospërputhjet në raportimin e detyrimeve kontigjente. Ajo shpreh shqetësim për rritjen e numrit të kontratave për shërbime të veçanta, duke kërkuar sqarime nëse këto kontrata po përdoren për të mbuluar pozita të rregullta pune.

Fiknete Bejta: - shpreh shqetësim për nivelin e ulët të realizimit të hyrave nga taksat për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike. Ajo thekson se kjo kategori ka një mospërputhje të madhe krahasuar me vitet paraprake, pasi janë realizuar vetëm 42,253 euro ose rreth 12.78% e planifikimit. Bejta tha se një realizim kaq i ulët i të hyrave vetanake mund të ketë ndikim negativ në strukturën buxhetore të komunës, veçanërisht në mundësinë e realizimit të investimeve kapitale. Ajo kërkon sqarim nga Drejtoria përkatëse nëse kjo gjendje është rezultat i një gabimi teknik në raportim apo paraqet realisht nivelin e arkëtimit të mjeteve në këtë kategori.

Fjolla Vukshinaj-Reçica: - kërkon sqarime nga Drejtoria e Financave dhe zyra ligjore lidhur me ndikimin e kontratës kolektive në buxhetin e Komunës së Prishtinës. Ajo thekson se bazuar në të dhënat e Asociacionit të Komunave të Kosovës, komunave në nivel vendi u janë marrë rreth 344 milionë euro përmes ekzekutimeve që lidhen me këtë çështje. Ajo kërkon që të paraqitet një pasqyrë e qartë për procesin e ekzekutimit të këtyre vendimeve, numrin e lëndëve gjyqësore që ende priten të ekzekutohen, shumën e mjeteve të mbetura për pagesë dhe ndikimin që kjo situatë pritet të ketë në buxhetin e Komunës së Prishtinës deri në fund të vitit, dhe kërkoj transparencë për këto të dhëna sepse është e rëndësishme si për asamblistët, ashtu edhe për qytetarët, për të kuptuar pasojat financiare të kontratës kolektive.

Gëzim Sveçla: - shprehu shqetësimin për mungesën e kryetarit të komunës në mbledhjet e Kuvendit dhe për mosangazhimin e tij në raportimin para asamblistëve. Ai thekson se raporti financiar nuk është vetëm dokument financiar, por pasqyrë e mënyrës së qeverisjes së komunës, dhe kritikon rënien e të hyrave, rritjen e shpenzimeve, nivelin e ulët të investimeve kapitale dhe rritjen e pagesave përmes vendimeve gjyqësore e përmbartimore, duke argumentuar se këto tregues paraqesin një gjendje të rënduar financiare. Ai tha se problemet e paraqitura në raport janë të dhëna të ofruara nga vetë administrata komunale dhe jo vetëm pretendime politike. Sveçla shpreh shqetësim edhe për bartjen e mjeteve rezervë për shkak të ekzekutimeve përmbartimore që kanë prekur fondet e destinuara për investime kapitale. Ai kërkon përgjegjësi nga udhëheqja komunale dhe thekson se përfaqësuesit e zgjedhur duhet të veprojnë në interes të qytetarëve, pavarësisht dallimeve politike.

Feim Osmani: - kërkon sqarime teknike nga Drejtoresha e Financave lidhur me disa paqartësi në raportin financiar, veçanërisht për projektet ku figurojnë mjete të shpenzuara, por që sipas tij nuk kanë filluar të realizohen në terren. Ai thekson se këto çështje duhet të sqarohen nga hartuesit e raportit, pasi kanë ndikim direkt në vlerësimin real të investimeve kapitale. Osmani kërkon të dijë nëse shpenzimet e paraqitura si investime kapitale përfshijnë edhe mjete të ekzekutuara nga përmbartuesit dhe vendimet gjyqësore, duke ngritur shqetësimin se vlera reale e investimeve kapitale mund të jetë dukshëm më e ulët se 5.7 milionë euro të raportuara, si shembuj përmend projektet e tregjeve të gjelbra dhe ndërtimin e thertores, për të cilat pretendon se nuk kanë nisur punimet, ndonëse figurojnë me shpenzime. Ai kërkon transparencë për numrin e projekteve të tilla dhe ndikimin e tyre në buxhetin e investimeve kapitale, ndërsa thekson se përgjegjësitë për problemet e menaxhimit duhet t'i japin drejtoritë përkatëse dhe kryetari i komunës.

Valbona Makolli- drejtore e Drejtorisë së Financave: - u përgjigjet shqetësimeve të ngritura nga asamblistët lidhur me raportin financiar të tremujorit të dytë. Ajo thekson se raporti është hartuar në mënyrë të detajuar dhe se, me kërkesë të Kuvendit, janë ndarë veçmas të dhënat për ekzekutimet e vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore për secilën drejtori përmes kodit të veçantë buxhetor. Ajo sqaron se mjetet e paraqitura në disa projekte nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht investime të realizuara në terren, por pagesa për raste përmbartimore dhe vendime gjyqësore. Makolli sqaroi se për çdo drejtori ekziston ndarje e qartë e buxhetit dhe shpenzimeve për këto raste dhe dokumentacioni përkatës është dorëzuar edhe në Ministrinë e Financave, sa i përket rënies së të hyrave, pranon se realizimi ka qenë më i ulët dhe shpjegon se një nga arsyet lidhet me problemet teknike në sistemin e tatimit në pronë, të cilat kanë prekur edhe komunat e tjera. Ajo përmend ndryshimet në sistemin e Ministrisë së Financave, vonesat në evidentimin e pagesave dhe shpërndarjen e faturave si faktorë që kanë ndikuar në arkëtim. Drejtoresha shton se disa të hyra

janë ndikuar edhe nga mosmiratimi ende i rregulloreve për tarifa dhe gjoba, duke theksuar se këto masa duhet të kalojnë për votim në Kuvendin Komunal para se të fillojë zbatimi i tyre. Makolli sqaron se të dhënat për llogaritë e arkëtueshme bazohen në pasqyra financiare dhe mund të verifikohen përmes Ministrisë së Financave, ndërsa për çështjet që lidhen me aspektet ligjore dhe kontratat kolektive, ajo thekson se përgjigjet duhet të jepen nga zyra ligjore, të cilës do t'ia përcjellë pyetjet e ngritura nga asamblistët.

Nexhmije Gjema: - kërkon sqarim lidhur me klasifikimin buxhetor të shpenzimeve, duke ngritur pyetjen se pse ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është përfshirë në kategorinë e shpenzimeve kapitale.

Drejtoresha - Valbona Makolli: - sqaron se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është përfshirë në shpenzimet kapitale për shkak të ndryshimeve në Ligjin e Buxhetit 2026, i cili i lejon Ministrisë së Financave të marrë mjete nga buxheti i komunës për këto obligime. Ajo thekson se komuna ka orientuar këto pagesa te investimet kapitale për të mbrojtur shpenzimet operative dhe se problemi i kontratës kolektive ka rënduar buxhetet komunale, pasi nuk janë siguruar mjete shtesë për mbulimin e tyre.

Pika e tretë e rendit të ditës

“Propozim -vendimi për transferimin e mjeteve financiare”.

Drejtoresha- Valbona Makolli: - tha se pas miratimit të buxhetit komunal nga Kuvendi, Ministria e Financave bën verifikimin e projekteve sipas kriterëve dhe planit të saj kontabël, ku disa projekte, të cilat sipas vlerësimit të Ministrisë nuk përputhen me klasifikimin e përcaktuar, kalojnë në fondin rezervë dhe mund të rikthehen vetëm përmes një vendimi të ri të Kuvendit. Në vitin 2025 në rezervë janë kaluar disa projekte, ndër to blerja e autobusëve për transportin urban dhe fasadimi i ndërtesave të vjetra, ku Komuna i ka konsideruar këto si investime kapitale, pasi autobusët do të regjistrohen si pasuri e komunës, ndërsa fasadimi ka qenë kërkesë e dalë nga dëgjimet buxhetore me qytetarët, por Ministria e Financave i ka riklasifikuar këto projekte në kategori të tjera buxhetore. Ajo tha se përmes këtij propozim-vendimi kërkohet që mjetet nga rezerva komunale të transferohen në projektin kapital **“Eficiencia e energjisë në ndërtesat publike në Prishtinë”**, projekt i financuar përmes marrëveshjes me BERZH-in, ku Ministria e Financave është garantuese, ku gjatë zbatimit të projektit ka pasur vonesa në përzgjedhjen e operatorit nga BERZH-i, ndërsa ndërkohë mjetet janë përdorur për nevoja të tjera dhe komuna është zotuar para Ministrisë së Financave dhe Thesarit që këto mjete do të kthehen. Makolli tha se bëhet fjalë për shumën prej **2,056,148 euro**, për të cilën ekziston dokumentacioni përkatës financiar dhe faturat mbështetëse. Transferimi i këtyre mjeteve synon të sigurojë vazhdimin e projekteve të planifikuara pa prekur kontratat dhe obligimet ekzistuese të komunës.

Gëzim Sveçla: - deklaroi se çështja e transferimit të mjeteve nga rezerva komunale është diskutuar edhe më herët dhe se kanë pasur dilema lidhur me këtë proces. Megjithatë, duke qenë se mjetet lidhen me investime në sektorin publik, konkretisht me projektin për eficiencën e energjisë në ndërtesat publike, ai bëri të ditur se do t'a mbështesin me votë propozimin. Sveçla theksoi rëndësinë e bashkëpunimit institucional mes nivelit lokal dhe atij qendror, duke vlerësuar se akuzat e vazhdueshme ndaj nivelit qendror nuk ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve dhe kërkoi që puna

të kryhet në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë institucionale, duke shmangur arsyetimet për dështime apo keqmenaxhim në administrimin komunal.

Drejtoresha- Valbona Makolli: - sqaroi se qëllimi i saj nuk ka qenë të akuzojë institucionet e tjera, por të paraqesë të gjitha rrethanat që kanë ndikuar në situatën e krijuar. Ajo theksoi se një pjesë e përgjegjësisë lidhet edhe me funksionimin e mekanizmave të monitorimit, gjë që sipas saj, është evidentuar edhe në raportet e auditorit. Sipas saj, ekzistenca e një departamenti monitorues nënkupton se duhet të ketë pasur kontroll dhe reagim në kohën e duhur. Makolli sqaroi se Komuna e Prishtinës realizon një numër të madh pagesash ditore dhe se në raste kur evidentohen probleme teknike apo procedurale, pagesat zakonisht kthehen për korrigjim, dhe tha se ka pritur që edhe në këtë rast të ndodhte një reagim i tillë në kohë. Ajo theksoi se nuk ka pasur qëllim të ngarkojë apo akuzojë askënd, por vetëm të sqarojë rrethanat konkrete të rastit, duke nënvizuar se bëhet fjalë për një shumë reale financiare dhe jo për çështje të tjera të pretenduara.

Feim Osmani: - theksoi rëndësinë që materialet dhe sqarimet shtesë t'u dërgohen asamblistëve në kohë, në mënyrë që të kenë mundësi t'i shqyrtojnë dhe të verifikojnë çështjet nga ana e tyre. Ai vlerësoi se edhe pse sqarimi i dhënë është më i mirë sesa mungesa e informacionit, vendimmarrja me informacione të pjesshme krijon vështirësi për asamblistët, pasi duhet të zgjedhin mes votimit pa pasur të gjitha të dhënat ose mosvotimit të një çështjeje të rëndësishme. Osmani kërkoi që në të ardhmen materialet shtesë dhe pikat që kërkojnë shqyrtim të dërgohen më herët ose të shtyhen për një seancë tjetër, duke theksuar se përgatitja në kohë ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e vendimmarrjes.

Kryesuesi konstatoi se “ Propozim-vendimi për transferimin e mjeteve financiare” miratohet me 40 vota për, 1 kundër, 1 abstenim.

Pika e katërt e rendit të ditës

Pyetje dhe përgjigje

Fjolla Vukshinaj Reçica- pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, drejtoreshën e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, për drejtoreshën e Drejtorisë së Parqeve:

- A planifikojnë Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Investimeve Kapitale të organizojnë një vizitë në terren në fshatrat Besi, Tenezhdoll, Vranidoll dhe Rimanishtë, në koordinim me Këshillin lokal dhe banorët, për të shqyrtuar kërkesat e tyre lidhur me shtrimin e rrugëve, ndriçimin publik dhe mirëmbajtjen e varrezave?
- A do të angazhohet ndërmarrja "Gjelbër" në mirëmbajtjen e varrezave, veçanërisht në Vranidoll, ku aktualisht banorët organizohen vetë për pastrimin e tyre?
- Kur pritet të realizohet kjo vizitë në terren dhe të ndërmerren veprimet konkrete për adresimin e këtyre kërkesave bazike të banorëve?

Kushtrim Sopu - për drejtoreshën e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Sportit:

- Kur do të përfundojë ndërtimi i kolektorit në rrugën "Rexhep Krasniqi" në lagjen Emshirë, në segmentin prej rreth 300 metrash që ende ka ujëra fekale të hapura dhe paraqet rrezik për shëndetin e banorëve?
- Kur do të vazhdojë trajtimi dhe procedimi i Planit Zhvillimor Komunal?
- A do ta shqyrtojë Komuna kërkesën për emërtimin e një rruge në fshatin Prapashticë me emrin e të ndjerit Ragip Nuredin Prapashtica, në lagjen e Cubave që lidhë fshatrat Hajkobillë dhe Mutivodë, në nderim të kontributit të tij si mësimdhënës dhe i përndjekur politik?
- Kur do të bëhet rregullimi dhe mirëmbajtja e këndeve të lojërave në lagjen Bregu i Diellit (te banesat e Standardit) dhe në parkun e lagjes Arbëria?
- A do të intensifikohen punimet në rrugën "Bajram Bahtiri", duke shtuar pajisjet dhe fuqinë punëtore për përfundimin sa më të shpejtë të projektit?
- Çfarë veprimesh do të ndërmarrë Komuna për mbrojtjen dhe shënimin e bustit të Faik Rexhepit në Arbëri, përfshirë vendosjen e një pllake informuese për jetën dhe veprën e tij?
- Kur do të sanohen problemet me ndriçimin publik në rrugën "Bedri Dedja" në fshatin Shkabaj, ku disa shtylla nuk janë funksionale?
- Çfarë masash do të ndërmarrë Komuna për mbrojtjen e orareve të qytetarëve në fushat e tenisit në Taukbahçe dhe për zgjerimin e infrastrukturës së tenisit në Prishtinë?
- A është duke u shqyrtuar kërkesa për subvencionimin e Klubit të Basketbollit "Sigal Prishtina" dhe kur pritet të procedohet për vendimmarrje?

Plator Gërdovci – për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, për drejtorin e Drejtorisë së Parqeve, për drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë , për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Mobilitetit:

- Çfarë veprimesh janë ndërmarrë për zgjidhjen e problemit të ujërave të zeza në Parkun Taukbahçe dhe kur pritet të eliminohet kjo problematikë, e cila po ndikon në funksionalitetin dhe cilësinë e parkut?
- A është planifikuar ridizajnimi dhe riorganizimi i hapësirave brenda Parkut Taukbahçe, në mënyrë që ato të shfrytëzohen më mirë nga qytetarët?
- Pse është vërejtur mungesë e bashkëpunimit me donatorët në fushën e grandeve dhe subvencioneve për bujqësinë, dhe a ka plane drejtoria për të riaktivizuar këto bashkëpunime?
- A është duke u planifikuar për vitin e ardhshëm krijimi i një mekanizmi për mbrojtjen e fermerëve nga dëmet e shkaktuara nga breshëri dhe fatkeqësitë natyrore?
- Në cilën fazë është procesi për vendosjen e pengesave në rrugë ("policëve të shtrirë") në lagjet ku qytetarët kanë kërkuar masa për rritjen e sigurisë në komunikacion, dhe kur pritet të fillojë realizimi i tyre?

Fiknete Bejta – për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, për drejtorin e Drejtorisë së Parqeve:

- A ka në plan Drejtoria e Arsimit të rishikojë dhe ndryshojë rregulloren për menaxhimin e kopshteve me bazë në komunitet, të cilat menaxhohen nga Këshillat e Prindërve, duke marrë parasysh mangësitë e evidentuara dhe nevojën për përmirësimin e cilësisë së menaxhimit?
- A do të vazhdojë asfaltimi i rrugës "Brahim Beka" në Ballaban, duke përfunduar segmentin e mbetur, në mënyrë që banorëve t'u sigurohet qasje e plotë dhe e lehtësuar?
- A ka plan Drejtoria e Parqeve, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, t'a shndërrojë hapësirën në rrugën "Nexhmi Llumnica" në Kodrën e Trimave në një park, me qëllim të parandalimit të krijimit të deponive ilegale dhe krijimit të një hapësire rekreative për banorët?

Muhamet Selmani – për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:

- Duke marrë parasysh mbylljen e parkingjeve private dhe vështirësitë që kjo ka shkaktuar në qarkullimin dhe parkimin në qytet, veçanërisht gjatë sezonit kur ka fluks të shtuar të mërgimtarëve dhe vizitorëve, a ka Drejtoria e Inspeksionit një plan ose modalitet duke respektuar legjislacionin në fuqi, të mundësojë funksionimin e këtyre parkingjeve deri në përmbushjen e kushteve ligjore, me qëllim të lehtësimit të situatës për qytetarët?

Feim Osmani – për drejtoreshën e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit:

- A është bërë vlerësim profesional i urave të ndërtuara në fshatin Sharban dhe a planifikon Komuna të ndërmarrë masa korrigjuese, duke përfshirë ndërtimin e mureve mbrojtëse për të parandaluar dëmtimin e pronave private dhe pronës së xhamisë nga vërshimet?(Pyetje nga senaca e katërt e mbajtur me dt. 15.7.2026).
- Në çfarë faze është trajtimi i çështjes së dy urave në Vranidoll dhe pse ende nuk është kthyer përgjigjja e premtuar me shkrim lidhur me këtë problematikë?
- Cilat kanë qenë kriteret për përcaktimin e prioritetëve në asfaltimin e rrugicave në fshatin Besi dhe pse është trajtuar fillimisht një rrugë që, sipas kërkesave të Këshillit lokal dhe banorëve, nuk ka qenë ndër prioritetet kryesore, ndërkohë që rrugë të tjera me nevoja më të mëdha kanë mbetur pa u trajtuar?
- Kur pritet të ndërhyhet në rrugën "Beqir Jakupi" në fshatin Bardhosh për sanimin e problemit të kanalizimit fekal, i cili po shkakton kundërmim dhe po rrezikon shëndetin e banorëve?
- Në çfarë faze është procedura për projektin dhe lejen e ndërtimit të shkollës në Besi, duke pasur parasysh se mjetet kanë qenë të zotuar nga Ministria e Arsimit dhe se kërkesa është adresuar nga shkolla, Këshilli lokal dhe Kuvendi Komunal? A ka ende koordinim me Ministrinë për realizimin e këtij projekti, apo ndërtimi i shkollës do të mbetet të financohet vetëm nga Komuna e Prishtinës?

Enver Redenica – për drejtoreshën e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave:

- Kur do të fillojë sanimi i gropave dhe dëmtimeve në rrugët "Ndue Përlleshi", rruga te banesat e Tregtisë në Mati 1, rruga nga shkolla "Sami Frashëri" në drejtim të Gërmisë, si dhe rrugët "Bislim Makolli", "BIA UÇK" dhe "Voskopojë" në Sofali?

- Kur do të merren masa urgjente për mbylljen dhe sigurimin e pushtave të dëmtuara në rrugën "BIA UÇK", të cilat paraqesin rrezik serioz për këmbësorët dhe automjetet?
- A do të rishikojë Komuna planifikimin e punimeve në rrugë, në mënyrë që ato të realizohen jashtë orareve me qarkullim të lartë ose në periudha që shkaktojnë sa më pak pengesa për qytetarët, veçanërisht gjatë sezonit të ardhjes së mërgimtarëve, bëhet fjalë për rrugën te Xhamia e Llapit, si dhe rrugën për Grashticë?
- Pse nuk është realizuar larja e rrugëve në kryeqytet dhe kur pritet të fillojë zbatimi i këtij shërbimi, duke pasur parasysh shqetësimet e qytetarëve për pastërtinë e hapësirave publike?
- Çfarë masash konkrete do të ndërmarrë Drejtoria e Sigurisë për të adresuar problemin e motoçikletave dhe automjeteve që shkaktojnë zhurmë të tepërt, veçanërisht gjatë orëve të mbrëmjes?
- A është duke u shqyrtuar mundësia e instalimit të pajisjeve inteligjente për matjen e zhurmës në pikat më problematike të kryeqytetit dhe në bashkëpunim me Policinë e Kosovës të bëhet identifikimi dhe ndëshkimi i automjeteve që tejkalojnë kufijtë e lejuar të zhurmës ose përdorin modifikime të paligjshme?

Besart Krasniqi - për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtoren e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, për drejtoren e Drejtorisë së Parqeve, për drejtorin e Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave:

- Kur pritet të zgjidhet problemi i mungesës së ndriçimit publik në rrugët "Naser Krasniqi", "Sabri Godo", "Arena Thaqi", "Daniel Deffo", "Besnik Lajçi", "Iset Maloku" dhe rrugët e tjera në Kodrën e Trimave, ku në disa raste mungojnë edhe shtyllat dhe instalimet e ndriçimit?
- Kur do të bëhet sanimi i rrugëve në rrugën "Nexhmi Llumica" dhe rrugicat përreth në Kodrën e Trimave, të cilat janë të dëmtuara dhe kanë shumë gropa?
- A është planifikuar ndërhyrje për zgjidhjen e problemit të kanalizimit në rrugën "Nexhmi Llumica", ku gjatë reshjeve ujërat dalin mbi rrugë dhe shkaktojnë probleme për banorët?
- Kur pritet të trajtohet problemi i furnizimit me ujë të pijshëm në zonën e Kodrës së Trimave, ku banorët përballen me reduktime të shpeshta gjatë ditës?
- A do të ndërhyhet në rrugën "Hakif Sheholli" në Kodrën e Trimave për largimin dhe menaxhimin e mbeturinave të krijuara në atë pjesë, dhe trajtimin e qenëve endacak?
- Kur do të realizohet krasitja dhe mirëmbajtja e plepave në oborrin e Xhamisë së Çarshisë dhe në pjesë të tjera të qytetit, për të garantuar sigurinë e qytetarëve dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike?
- Kur do të trajtohet kërkesa e banorëve të Tophanes për rregullimin e rrugëve në këtë lagje, përfshirë rrugët "Mahir Domi", "Vatra" dhe rrugët përreth?
- A do të vendoset një pikë e përshtatshme për hedhjen e mbeturinave në rrugën "Meto Bajraktari", pas largimit të kontejnerëve ekzistues, pasi kjo ka krijuar problem për banorët dhe bizneset?
- Kur do të bëhet rregullimi i rrugëve "Shkëlzen Haradinaj", "Osumi" dhe rrugëve të tjera në lagjen Kolovicë, si dhe kur do të vendoset ndriçimi publik në rrugët "Shkëlzen Haradinaj", "Osumi" dhe "Xheladin Kurtaj"?
- Kur pritet të përfundojë punimi në rrugën "Ilir Konushevci" dhe a ekziston një afat i përcaktuar për hapjen e saj, duke marrë parasysh ndikimin që ka pasur te bizneset dhe qarkullimi i qytetarëve?

- A është paraparë sanimi i rrugës së “Stokholmit” në lagjen Mati 1 dhe cili është afati për ndërhyrje?
- Kur do të bëhet asfaltimi i rrugës “Tomas More” në lagjen Përroi i Njelmët, e cila aktualisht është në zhavor?
- Kur do të rregullohet trotuari në rrugën “Pellazët” në Grashticë të Epërme dhe kur do të trajtohen dëmtimet në rrugën Koliq-Sharban, përfshirë krasitjen e lisave pranë rrugës që paraqesin pengesë për qarkullim?
- Kur pritet të zgjidhet problemi i vonesave të pagave për punëtorët teknikë në shkollat e Prishtinës dhe çfarë masash po ndërmerren për të siguruar pagesa të rregullta për rreth 200 punëtorët teknikë?
- A do të hapet në shtator shkolla fillore në lagjen Kalabria dhe a janë përmbushur të gjitha kushtet për fillimin e procesit mësimor?
- Cilat masa konkrete po ndërmerr Komuna e Prishtinës për trajtimin e problemit me qentë endacakë, veçanërisht në lagjen Arbëria, rruga “Kosturi”, dhe në zonat e tjera ku qytetarët po raportojnë rrezik për sigurinë e tyre, kur do të sanohet problemi me ndriqim në rrugën “Kosturi”?
- Kur pritet të vijë në votim në Kuvendin Komunal procesi i emërimit të rrugëve në kryeqytet, duke marrë parasysh vështirësitë që qytetarët po hasin me dokumentacion dhe procedura administrative?

Nexhmije Gjema- për Kryetarin, për drejtorin e Drejtorisë së Mobilitetit:

- A e kanë pranuar kryetari i Komunës dhe organet përgjegjëse sinjalizimin e datës 22 korrik 2026, lidhur me pretendimet për punësime familjare dhe politike në Komunën e Prishtinës, Trafikun Urban, Termokos, Prishtina Parking dhe ndërmarrje të tjera komunale, dhe a ka filluar ndonjë proces verifikimi për këto pretendime?
- A janë verifikuar pretendimet lidhur me audio-incizimet e publikuara në media, ku përmenden punësime në këmbim të mbështetjes politike, dhe a është konfirmuar autenticiteti i tyre nga personat e përfshirë?
- Për cilin institucion, pozitë ose konkurs pretendohet se është negociuar punësimi i personit të përmendur në sinjalizim dhe a është realizuar apo tentuar një punësim i tillë?
- A janë të sakta pretendimet për lidhjet familjare dhe konfliktet e mundshme të interesit të paraqitura në sinjalizim dhe a është zhvilluar ndonjë procedurë verifikimi, disiplinore apo tjetër institucionale lidhur me këto raste?
- A do t’u dorëzohen organeve kompetente, përfshirë Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, dokumentacionet relevante për verifikim, përfshirë konkurset, raportet e vlerësimit, procesverbalet dhe vendimet përfundimtare të punësimeve të përmendura?
- A mund të sigurojë Komuna transparencë të plotë për këto procese dhe të konfirmojë nëse punësimet në institucionet dhe ndërmarrjet komunale janë realizuar mbi bazën e meritës, ligjshmërisë dhe procedurave të rregullta?
- Kur do të jepet përgjigja lidhur me sqarimin për përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale gjatë regjistrimit në kuletën digjitale, pyetje e ngritur në seancën e kaluar?
- Cila është baza ligjore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale të qytetarëve gjatë përdorimit të biletave online dhe cila kompani private i administron këto të dhëna?

- Pse ekziston dallimi në çmim ndërmjet biletave online dhe atyre të blera manualisht dhe a është vlerësuar ndikimi i këtij sistemi tek të moshuarit, personat pa telefona të mençur dhe qytetarët që nuk dëshirojnë të ndajnë të dhënat e tyre personale me kompani private?

Lumnije Mikullovc – për drejtoreshën e Drejtorisë së Turizmit, për drejtoreshën e Drejtorisë së Parqeve:

- Në kuadër të raportit gjashtëmujor, sa është përqindja e realizimit të projekteve të planifikuara nga Drejtoria e Turizmit dhe Parqeve dhe cilat projekte janë përfunduar gjatë kësaj periudhe dhe sa është niveli i shpenzimit të buxhetit të drejtorive dhe në cilat projekte konkrete janë investuar mjetet publike gjatë gjashtëmujorit të parë?
- Çfarë është realizuar konkretisht për zhvillimin dhe promovimin e turizmit në Prishtinë, si dhe për promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të kryeqytetit?
- Cilat parqe dhe hapësira të gjelbra janë rehabilituar, mirëmbajtur apo krijuar gjatë kësaj periudhe dhe çfarë masash janë ndërmarrë për mirëmbajtjen e tyre, inventarit urban, ndriçimit, pastërtisë dhe sigurisë?
- Cilat janë arsyet e mosrealizimit të projekteve të planifikuara dhe kush mban përgjegjësi për vonesat në realizimin e tyre?
- Cili është plani konkret i drejtorisë për gjashtëmujorin e dytë, me qëllim përmirësimin e mirëmbajtjes së parqeve, hapësirave të gjelbra dhe shërbimeve për qytetarët?

Pyetje për Kryetarin e Kryeqytetit

- Duke marrë parasysh shqetësimet e shumta të qytetarëve për trafikun, kolonat, mungesën e ujit të pijshëm, gjendjen e rrugëve, ndriçimin publik, mbeturinat dhe mungesën e mirëmbajtjes së hapësirave publike, cilat janë masat konkrete që komuna do të ndërmarrë për përmirësimin e këtyre problemeve?
- Si e vlerëson kryetari gjendjen aktuale në kryeqytet dhe cilat janë prioritetet e tij për t'iu përgjigjur pakënaqësive të qytetarëve, veçanërisht për problemet e trafikut dhe ndërhyrjet që po shkaktojnë bllokime në rrugët kryesore të qytetit?

Rifadije Sopi – Për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, për drejtorin e Drejtorisë së Mobilitetit, për drejtoreshën e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, për drejtorin e Drejtorisë së Mobilitetit:

- Kur pritet të hapet kopshti i ri në lagjen Kolovicë dhe kur do të njoftohen prindërit për afatin e fillimit të funksionimit të tij, duke marrë parasysh se shumë prej tyre kanë dorëzuar dokumentacionin në kopshtet publike "Yllkat" dhe "Buzëqeshja"?
- A do të bashkëpunojë Drejtoria e Arsimit me grupin e mësimdhënësve të interesuar për të kontribuar vullnetarisht në organizimin, planifikimin dhe funksionalizimin e mësimi gjithëditor në shkollat e Prishtinës?
- A është planifikuar ndërhyrje për funksionalizimin e plotë të linjës S27 dhe vendosjen e një pritoreje në fillim të rrugës Taukbahçe, afër Bibliotekës "Hivzi Sylejmani", sipas kërkesës së banorëve?
- Kur pritet të intervenohet në rrugën "Kadri Bajri" në lagjen e Spitalit, pjesë e rrugës kryesore "Holger Petersen", e cila aktualisht është në gjendje të rëndë dhe vështirëson qarkullimin e banorëve?

- Kur pritet të trajtohet kërkesa për asfaltimin e rrugicës në lagjen Shefki Rrahmani, konkretisht tek familjet Rrahmani, e cila është paraqitur nga banorët si nevojë për përmirësimin e qarkullimit?
- A do të shqyrtohen propozimet për emërtimin e rrugëve në fshatin Tenezhdoll me emrin "Ahmet Rexhepi", në fshatin Prapashticë me emrin e të ndjerit Ragip Nuredini?

Gëzim Sveçla - pyetje për Komunën e Prishtinës dhe aksionarët e Ndërmarrjes Publike "Termokos"

- Çfarë masash konkrete do të ndërmarrë Komuna e Prishtinës, si aksionare e Ndërmarrjes Publike "Termokos", për të adresuar shqetësimet e ngritura nga Banka Zhvillimore Gjermane lidhur me menaxhimin e ndërmarrjes dhe për të garantuar vazhdimin e projektit për zgjerimin e ngrohjes qendrore në kryeqytet?
- A është duke u zhvilluar ndonjë proces verifikimi, plan veprimi ose koordinim me bordin dhe menaxhmentin e "Termokosit" për të shmangur rrezikun e tërheqjes së financimit dhe dështimit të një prej projekteve më të rëndësishme infrastrukturore për qytetin?
- Si do të sigurojë Komuna që kjo ndërmarrje publike të menaxhohet në mënyrë të qëndrueshme dhe transparente, duke mbrojtur interesin publik, punonjësit dhe investimet strategjike për zhvillimin e kryeqytetit?

Berita Abazi – për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:

☐ Çfarë veprimesh ka ndërmarrë Drejtoria e Inspeksionit lidhur me ndërtimin e objektit në rrugën "Yllka Domi" në lagjen Arbëria, duke pasur parasysh se, sipas përgjigjes së Drejtorisë së Urbanizmit, për këtë objekt nuk ka leje ndërtimore dhe as aplikim për leje? A është kryer inspektimi në terren dhe cilat masa janë ndërmarrë?

☐ A ka ndërhyrë Drejtoria e Inspeksionit lidhur me shfrytëzimin e hapësirës publike në rrugën "Ahmet Dërguti" në lagjen Arbëria, ku një biznes po përdor rrugën dhe trotuarin si parking privat pa leje, duke penguar qarkullimin e këmbësorëve? Nëse po, cilat masa janë ndërmarrë dhe kur pritet zgjidhja e këtij problemi?

Leonora Shabani Bajraktari – për drejtorin e Shërbimeve Publike, për drejtoren e Drejtorisë së Investimeve Kapitale:

☐ Kur do të ndërhyhet për sigurimin ose largimin e shtyllës së anuar në rrugën "Papa Gjon Pali" në Matëçan, e cila paraqet rrezik për këmbësorët, automjetet dhe banorët, dhe a është planifikuar ndërtimi i trotuarit në këtë rrugë?

☐ Kush është përgjegjës për sanimin e shaktave të hapura ose të dëmtuara në rrugën "Stambolli", afër KFOR-it, dhe kur pritet të eliminohet ky rrezik?

☐ A disponon Komuna me një evidencë të plotë të shtyllave dhe shaktave të dëmtuara në territorin e Prishtinës dhe sa raste të tilla janë raportuar, sanuar apo mbeten ende pa u trajtuar gjatë këtij viti?

☐ A do të zhvillohet një inspektim i përgjithshëm në territorin e kryeqytetit për identifikimin dhe eliminimin e rreziqeve të tilla dhe cili është afati i planifikuar për ndërhyrje?

Pika e pestë e rendit të ditës

Të ndryshme

Rifadije Sopi: - njoftoi Kuvendin për pjesëmarrjen në punëtorinë për stimulimin e Asamblesë së qytetarëve, organizuar nga Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ajo theksoi se kjo përvojë paraqet një mundësi për komunën e Prishtinës që të shqyrtojë zbatimin e këtij modeli, i cili synon rritjen e pjesëmarrjes qytetare, transparencës dhe cilësisë së vendimmarrjes. Sopi rekomandoi përgatitjen e një projekt pilot për Asamblenë e qytetarëve, krijimin e bazës së nevojshme institucionale dhe planifikimin e resurseve financiare e njerëzore për zbatimin e tij, dhe falënderoi ekipin e Komunës së Prishtinës për mbështetjen dhe vlerësoi se ky mekanizëm mund të shërbejë si urë më e fortë ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve.

Nexhmije Gjema: - ngriti çështjen e menaxhimit të jetës së natës në Prishtinë, duke theksuar se kufizimi i orarit të punës së lokaleve deri në ora 23:00, po ndikon në gastronomi, turizëm, kulturë dhe ekonominë e natës. Ajo vlerësoi se mbyllja e njëkohshme e të gjitha lokaleve nuk e ka zgjidhur domosdoshmërisht problemin e zhurmës, pasi krijon dalje masive të qytetarëve në të njëjtën kohë dhe rrit ngarkesën në rrugë, trafik dhe hapësira publike. Gjema kërkoi të dijë nëse komuna ka një strategji për zhvillimin dhe menaxhimin e jetës së natës, nëse janë analizuar efektet e kufizimit të orarit dhe nëse mund të shqyrtohet një model me orare dhe zona të ndryshme, në varësi të lokacionit dhe kushteve të veprimtarisë. Ajo gjithashtu kërkoi debat publik me banorët, gastronomët, artistët dhe ekspertët për gjetjen e një zgjidhjeje që ruan qetësinë e qytetarëve, por edhe zhvillon jetën urbane të kryeqytetit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

Procesmbajtësi
Skender Tora

Kryesues i Kuvendit
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



TRANSKRIPIT

I mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Kryeqytetit, mbajtur më 31.7.2026, duke filluar në orën 10:00

Kryesuesi: Përshëndetje të gjithëve. Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Kryeqytetit, e nderuara nënkryetare, të nderuar drejtorë të drejtorive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm. Mirë se keni ardhë në këtë seancë të pestë të rregullt të Kuvendit të kryeqytetit. Sot jemi mbledhur për të zhvilluar mbledhjen e pestë të rregullt të Kuvendit të kryeqytetit të Republikës së Kosovës në përputhje me Rregulloren e punës dhe me materialet që janë shpërndarë me kohë nga shërbimi i Kuvendit. Fillimisht para se të nisim shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, do të verifikojmë praninë e anëtarëve dhe korumin e nevojshëm për zhvillimin e punimeve të kësaj seance. Kërkoj nga shërbimi i Kuvendit që të konstatojë se a kemi kuorum për mbajtjen e kësaj seance apo jo. 38 janë prezent. Konstatoj se kemi kuorum për mbajtje të kësaj mbledhjeje. Konstatoj se janë plotësuar kushtet për punë dhe mund të vazhdojmë. Në këtë seancë do t'i shqyrtojmë këto pika të rendit të ditës. Gjithsej pesë pika.

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit;**
- 2. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2026 (TM2);**
- 3. Propozim - vendimi për caktimin e Komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale;**
- 4. Pyetje dhe përgjigje;**
- 5. Të ndryshme.**

Të nderuar anëtarë të Kuvendit, para se të vazhdojmë me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, dëshiroj t'ju njoftoj se në mbledhjen e djeshme të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), janë dhënë dy rekomandime lidhur me pikat e rendit të ditës. Rekomandimi i parë është paraqitur nga drejtoresha e Drejtorisë së Financave znj. Valbona Makolli lidhur me Propozim - vendimin për transferimin e mjeteve financiare. Rekomandimi i dytë është paraqitur nga drejtori i Drejtorisë së Pronës, z. Ibrahim Mehmetaj lidhur me Propozim - vendimin për formimin e komisionit për ankesa për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale. Komiteti për Politikë dhe Financa ka rekomanduar që këto dy pika të propozohen në seancë për arsye se komiteti vetëm rekomandime jep, Ndërsa tani është fjala për ju. A ka ndonjë propozim tjetër nga dikush? Gëzim Sveçla e ka kërkuar fjalën.

Gëzim Sveçla: - falemnderit z. kryesues. Përshëndetje për të gjithë anëtarë të ekzekutivit, kolegë asamblistë, përfaqësues të mediave, qytetarë të Prishtinës. Para vetes keni një material që bashkë me kolegët e grupit tonë e kemi shpërndarë para fillimit të kësaj seancës dhe ky material siç e dini ka arritur në adresat tona përmes sinjalizuesve dhe përmbajtja e tij është mjaft denigruese për vetë institucionin e kryeqytetit sidomos për personat e apostrofuar në këtë përmbajtje e gjithashtu fyes edhe për një numër të madh të kolegëve zyrtarëve të Komunës së Prishtinës. Prandaj vlerësojmë se është shumë e rëndësishme një adresim i kryetarit të kryeqytetit për shkak se ai është protagonist i kryesor që përflitet në këto biseda në mënyrë që të sqarohet mirë kjo çështje. Me të vërtetë është e pakuptimtë që ne të vazhdojmë të punojmë kështu duke e shikuar njëri-tjetrin diqysh si nën sy, si me marre pa i sqaruar këto gjëra. Ne kemi parë një reagim të kryetarit, por që fare nuk e ka përmendur përmbajtjen e këtyre mesazheve, bisedave. Prandaj është shumë e rëndësishme që kryetari i kryeqytetit të deklarohet publikisht nga asambleja e qytetit, nga vendi ku janë të zgjedhurit e qytetarëve për këto pretendime. Siç e dini, në këto materiale i kemi dorëzuar edhe te organet kompetente dhe natyrisht që është në kompetencën dhe pjesë e punës së tyre që t'i trajtojnë qoftë për autenticitet qoftë për përmbajtje. Po megjithatë nëse jo ligjore të paktën është morale që Përparim Rama publikisht para Kuvendit me u deklaruar për këto gjëra. Kjo është çështja e parë. Çështja e dytë kryesues të cilën e kam ngritur edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa. Ju si kryesues i Kuvendit jeni përgjegjës që ta zbatoni Planin e punës që ky Kuvend e ka miratuar. Siç e dini ai plan fare nuk është duke u zbatuar.

Ne sot e kemi mbledhjen e pestë ku janë vetëm dy pika të rendit të ditës, ndërkohë që janë bërë tetë muaj prej se e kemi marrë mandatin. Kryetari Rama akoma nuk ka raportuar para kësaj asambleje ashtu siç parashihet me ligj. Çështja tjetër mjaft delikate të cilën gjithashtu propozojmë ta kemi rend të ditës sot ka të bëjë me raportin e auditimit. Ju pranë vetes e keni edhe zyrtarin e auditimit të brendshëm. Pyetja ime është pse raporti i auditimit nuk po vjen në asambleenë komunale? Nuk duhet ekzekutivi me sjell raportin e auditimit. Zotëri Osman, ju jeni auditor i brendshëm. Ju e keni pranuar atë raport të auditimit. Është nënshkruar nga kryetari, është nënshkruar nga të gjithë zyrtarët e komunës. Pse po i ikni diskutimit për raportin e auditimit? Pra ky është propozimi dhe pres një sqarim nga kryesuesi i Kuvendit në lidhje me atë çka thashë për zbatimin e Planit të punës që unanimisht është votuar nga asambleja. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit z. Sveçla. Sa i përket propozimit të juaj dje në KPF, unë menjëherë kam marrë përsipër dhe kam biseduar me Osmanin, dhe Osmani më tha që jam duke përgatitur për seancën tjetër me sjell. Po Osman fjala për juve.

Osman Bllaca: - raportin e auditorit të brendshëm, unë e kam raportuar çdoherë edhe raporto, por nuk kam mundur me bë për shkaqe teknike raportimin e auditimit të brendshëm për periudhën gjashtëmujore. Edhe raporto në seancën e radhës, por për raportin e auditorit të jashtëm duhet të propozohet prej kryetarit për me hy në rend dite, është edhe me plan të Kuvendit, është edhe vetë është shumë e mirë. Është proces shumë i mirë me u diskutuar, por nuk është ardhur prej ekzekutivit për me u diskutu në kuvend. Mbledhjen e kaluar e ke propozim nga ana juaj, por me shumicë votash u hodh poshtë dhe tash nuk e kuptoj edhe pse edhe ekzekutivi dhe pse nuk duhet. Kështu që duhet, besoj që mbledhjen e ardhshme duhet të jenë edhe raporti i auditorit edhe raporti i auditimit të brendshëm, pasi që nuk ka diçka aty për me u fsheh, është publike, është më mirë me u diskutuar dhe me u zbatuar rekomandimet që janë prej ZKA-së, por për sot prapë votohet kjo pikë e rendit të ditës që ishte propozim prej Gëzimit.

Kryesuesi: - falemnderit z. Bllaca. Besa Shahini e ka kërkuar fjalën.

Besa Shahini: - falemnderit kryesues. Do doja që nëse është e mundur në rend të ditës ta fusim edhe diskutimin për sigurinë nëpër vendpunishtet në Komunën e Prishtinës. Kemi raste tragjike të humbjes së jetës të punëtorëve. Edhe reagimi që erdhi nga komuna si nga kryetari, si nga drejtori i inspeksionit ishte për mendimin tim i pandjeshëm sepse përveç i ngushëlluan familjen, hoqën dorë nga përgjegjësia dhe thanë që nuk është kjo përgjegjësia jonë, është përgjegjësi e nivelit qendror që mund të jetë nëse e shohim në mënyrë shumë të ngushtë po komuna ka përgjegjësi edhe me i mbikëqyr gjithë fazat e një procesi të ndërtimit, ka përgjegjësi për të na treguar edhe nëse keni lëshuar veç kushtet e ndërtimit apo i keni lëshuar edhe lejen e ndërtimit se dhe kjo është e rëndësishme. Po përtej kësaj, nëse komuna mbikëqyr edhe nëse kamionët që dalin nga vendpunishtet janë të pastër ose të papastër, si është e mundur thoni që nuk keni përgjegjësi të mbikëqyrni gjithë parregullësitë në një vendpunishte? Kështu që do doja që ta diskutonim në Kuvendin komunal se çfarë mund të bëjë më shumë komuna që të sigurohet që të mos kemi dëmtime të tilla dhe humbje jete. Edhe pasi kam mikrofoni edhe 30 sekonda për asambleistët e Lëvizjes Vetëvendosje se e keni revoltën në maje të gjuhës po nuk jeni opozitë edhe në nivelin qendror.

Kryesuesi: - znj. Shahini a ka mundësi veç me të ndërpre diçka? Për secilin vlenë kjo, për secilin pa dallim. Këtu paraqesim pika të rendit të ditës. Aty është kur është pika e fundit pyetje dhe përgjigje. Mundesh me i bë pyetje secilit subjekt.

Besa Shahini: - e kam plotësisht të qartë, vetëm se po lidhen temat kështu që nëse më lejon është janë dy fjali që kam me i thënë. Është një koment që mendoj që është i rëndësishëm. Ligji për Ndërtimin që e limiton komunën se çka bën dhe çka nuk bën në relacion me ndërtimin e sa kohë merr për me dhënë një leje, duhet të ishte adresuar tash nga niveli qendror në Parlamentin e Republikës së Kosovës. Pse nuk e ngritni ju këtë çështje në partinë e juaj që ta çoni përpara? Një proes i cili është absolutisht shumë problematik për kryeqytetin?

Kryesuesi: - falemnderit znj. Shahini. z. Sveçla urdhëro një minut.

Gëzim Sveçla: - falemnderit për shkak që ka të bëjë me neve dhe duhet të përgjigjemi. Gjithsesi unë e kuptoj znj. Shahini sepse nuk po arrijnë që të futen atje ku ngriten çështjet e nivelit nacional. Po ajo duhet me ndje veten përgjegjëse, njësoj ashtu siç po i bën tash kritikën me vend që i ka në raport me qeverisjen lokale. Duhet me ndje veten përgjegjëse sa herë ulet në atë ulëse sepse edhe ajo është kontribuuese që në anën tjetër të sallës është i ulur Përparim Rama dhe qeverisin këto subjekte politike.

Kryesuesi: - falemnderit z.Sveçla. Rifadije Sopi e ka kërkuar fjalën.

Rifadije Sopi: - falemnderit kryesues. Të nderuar kolegë, unë desha vetëm tek pika e ndryshme të bëj një njoftim mbi punëtorinë, simulimi i asamblesë së qytetarëve. Falemnderit.

Kryesuesi: - po kjo nuk ka nevojë me hy si pikë. Po. Në rregull. Falemnderit. Dikush tjetër? Urdhëro drejtor. Ibrahim Mehmetaj e ka fjalën.

Ibrahim Mehmetaj: - përshëndetje kryesues, përshëndetje kuvendarë, i nderuar ekzekutiv. Me mirëkuptim kërkoj që pikat e rendit të ditës që janë propozuar për themelimin e komisioneve, komisionit vlerësues dhe komisionit të ankesave të tërhiqen me arsyetim që disa çështje teknike duhet t'i rregullojmë prapë. Nuk ka të bëjë me Gëzimin që e kemi diskutuar në

komitet, por ka të bëjë me themelimin e anëtarëve të komisionit, përcaktimin e tyre, siç e para shohin ligjet që janë në fuqi. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit drejtor. A patët një propozim të tjerët? Domethënë drejtor ju e tërhiqni pikën. Në rregull. Falemnderit shumë. A dëshiron dikush ta marrë fjalën? Jo. Falemnderit. Atëherë kemi tri rekomandime. Një Valbona edhe një e Gëzimit edhe Besës. Në rregull. Tani po i lexojmë ato dy rekomandime. Drejtoresha Valbona ka propozuar. Propozim- vendimi për formimin e komisionit për ankesa për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale. Mirë, atëherë lus regjinë të jetë gati për votim të propozimit të Valbonës. Votojmë tash, falemnderit. 28 vota për, 8 kundër, 1 abstenim. Kalon edhe propozimi i drejtoreshës Valbona. Propozimi i dytë. Është raporti i auditorit të jashtëm. Propozimi i z. Sveçla është. Ju lutem regjia të jetë gati për votim. Kush është për? Me 16 vota për, 23 kundër, asnjë abstenim. Nuk kalon ky propozim. Propozimi i radhës është Besa e Shahinit. Diskutim mbi sigurinë në punishte gjatë ndërtimit në Prishtinë. Ju lutem regjia të jetë gati për votim. Votojmë tash. 12 vota për, 24 kundër, asnjë abstenim, nuk kalon as ky propozim. Vazhdojmë me rendin e ditës. Po e lexoj edhe njëherë rendin e ditës.

1. **Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të kryeqytetit;**
2. **Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2024;**
3. **Propozim - vendimi për transferimin e mjeteve financiare;**
4. **Pyetje dhe përgjigje;**
5. **Të ndryshme.**

Lus regjinë të jetë gati për votim të rendit të ditës. A ka mundësi edhe njëherë me konstatu kuorumin? 44, falemnderit shumë. Regjia të jetë gati për votim. Votojmë tash. Falemnderit. Në 35 vota për, asnjë kundër, 3 abstenime. Kalon dhe rendi i ditës. Po fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. **Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së jashtëzakonshme të kuvendit të kryeqytetit.** Lus regjinë të jetë gati për votim të kësaj pike. Votojmë tash. Falemnderit. 35 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kalon edhe pika e parë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e radhës. **Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2024 (TM2).** Për këtë pikë të rendit të ditës, fjalën i jap drejtoreshës Valbona Makolli. Fjala për juve është drejtoreshë.

Valbona Makolli: - falemnderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Para jush sot paraqes raportin tremujor për periudhën e dytë prill - qershor 2026, i përgatitur në bazë të Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësi, konkretisht neni 45 dhe pika dy, 4 dhe 46.1. Raporti normal është i përgatitur nga stafi i Drejtorisë së Financave në autorizim të kryetarit të komunës. Në këtë raport është e paraqitur performanca e të hyrave dhe performanca e shpenzimeve buxhetore për këtë periudhë. Sa i përket performancës së të hyrave, janë të paraqitura të hyrat tatimore dhe jotatimore për periudhën prill - maj 2026. Siç vërehet nga ana e raporteve dhe baza tabelare kemi një rënie prej 32.95%. Ka një rënie siç e theksova prej 32.95% në korrespondencë prej 4,054,441 më pak krahasuar me vitin paraprak, domethënë 2025. Kjo performancë ka ardhur si rezultat i shpërndarjes së vonshme të fakturave të tatimit në pronë e cila u bë me 12.6.2026, kurse afati i parë është me 30.6.2026, dhe kështu që ka pamundësuar me kohë të bëhet pagesa e kështit të parë. Po ashtu një rënie të tillë ka shënuar dhe Rregullorja për tarifa gjoba e cila është në pritje, ka kaluar fazën e diskutimeve publike dhe pritet që të vë në aprovim të Kuvendit komunal dhe më pas të bëhet inkasimi i atyre të hyrave të cilat ne veç i kemi planifikuar për vitin 2026. Sa i përket të hyrave vetanake është tabela e

paraqitur dhe krahasimet me vitin 2025. Për mos me iu marrë kohë po shkoj te performanca e shpenzimeve. Sa i përket shpenzimeve buxhetore për periudhën për të cilën po raportoj ka arritur vlerën prej 45,015,910, kjo vlerë e përfshirë në 56.52% të buxhetit për periudhën raportuese është e ndarë në pesë kategori ekonomike dhe atë të shpenzimi i pagave dhe medijave që për këtë periudhë për të cilën po raportoj ka një rritje prej 26.37% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Kjo fakturë e pagave ka shënuar rritje për shkak të rritjes së koeficientit nga niveli qendror dhe ka qenë komplet grant qeveritar. Sa i përket kategorisë së shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve po ashtu ka një rritje prej 32.02% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025. Kjo ka ndodhur për arsye se në periudhën e njëjtë të vitit 2025 nuk kemi pasur buxhet dhe obligimet janë paguar në këtë periudhë kohore. Shpenzimet e komunalive kanë shënuar një rënie prej 20.88% krahasuar me vitin 2025. Kjo është për shkak të kohës për të cilën po raportojmë. Koha ka qenë e mirë dhe këto shpenzime do të rriten në fund të vitit kur edhe do të kemi shpenzime më të mëdha për shkak të periudhës që do të jetë më ftohtë. Sa i përket shpenzimeve të subvencioneve dhe transfereve ka arritur vlerën prej 2,142,723 që është prej 31.51 % krahasuar me vlerën e vitit, për periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2025%, është një rritje prej 21.30 %. Kurse sa i përket shpenzimeve të fundit kapitale është një normë jo e kënaqur që ka arritur vlerën prej 5.713,570 apo 10.69 % krahasuar me periudhën e të njëjtit vit kemi rrënie prej 20.40%. Meqënëse po e shoh që nuk ka interesim me e dhënë detaje më tutje, unë po pres për ndonjë kërkesë. Atëherë po pres ndonjë koment prej juve.

Kryesuesi: - falemnderit drejtoreshë. Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës. Shkojmë me shefa të grupeve. Egzon nuk do me marrë fjalën. Nga radhët e PDK-së, dëshiron fjalën dikush? Fjolla Vukshinaj Reçica.

Fjolla Vukshinaj Reçica: - falemnderit kryesues. Të nderuar ekzekutiv, të nderuar kolegë asambleistë. Falemnderit drejtoreshë për raportimin. Unë vetëm e kam një pikë që në mesin e shumë paraqitjeve që janë këtu në raportin financiar është të hyra nga biblioteka dhe teatri “Dodona”. Në vitin 2024 kanë qenë 4.000, në vitin 2025 kanë qenë vetëm 1600 dhe në vitin 2026 domethënë janë 37.000 domethënë ka një rritje prej 2209%. Kështu që vetëm dashta me përgëzuar Drejtorinë e Kulturës për rritjen e këtyre të hyrave. Unë edhe në seancat e kaluara kam thënë që është shumë mirë me gjet që si komuna duhet me i rrit të hyrat vetanake. Edhe në mesin e këtyre e vetmja domethënë që ka të hyra më të mëdha të rritura është Drejtoria e Kulturës, kështu që drejtor Isa Mustafa përgëzime.

Kryesuesi: - falemnderit znj. Reçica. A dëshiron drejtoreshë fjalën? Jo. Feim Osmani e ka kërkuar fjalën.

Feim Osmani: - falemnderit kryesues. Përshëndetje të gjithëve. Kisha kërkuar vëmendje sepse bëhet fjalë për afërsisht 50,000,000 euro të hyra, taksa të qytetarëve të cilat diskutohen në këtë raport. Nuk është punë e vogël sa të mos ketë vëmendje kaq kaq shumë nga ana e Kuvendit. Tremujori i dytë si periudhë dhe raportimit financiar do të duhej ta përmirësonte edhe tremujorin e parë në pikat ku raporti i kaluar kishte probleme e ku kishte ngecje për arsye se është periudha më e përshtatshme e vitit për të realizuar punët me ritëm të plotë në krahasim me periudha të tjera, por ja që ky raport është edhe më i keq sesa ai i kaluari. Tashmë ka disa vite që për të kuptuar gjendjen në të cilën është katandisur Komuna e Prishtinës, nuk ka nevojë për analizë fare. Vetëm shikojeni raportin financiar dhe e kuptoni se ku e keni sjellur Prishtinën me mënyrën si po menaxhoni paratë tona. Nëse ju duket që për njëmend ky raport s'ka vlerë. Pra vetëm shikohet ky raport financiar dhe vërehet saktësisht gjendja ku është katandisur Komuna e Prishtinës. Pra të hyrat janë keq, shpenzimet edhe më keq, ndërsa vendimet

gjyqësore e kontratat përmbartimore mizerje fare. Fillimisht të hyrat. Nëse lexojmë raportin e të hyrave shohim qartë dështimin i cili është shumë vështirë të rikuperohet për periudhën që ka mbetur dhe po nëse vazhdojmë me këtë trend të të hyrave nuk do të mund të realizohen as gjysma e projekteve të parapara për vitin 2026. Prishtina pra të dashur qytetarë e ju të pranishëm në sallë po bëhet përditë e më shumë e varur tërësisht nga të ardhurat që i siguron Qeveria e Kosovës e sidomos nga grantet që ja përcakton ligji. Fatmirësisht Prishtina është kryeqytet dhe ligji trajton më mirë se sa komuna të tjera në aspektin financiar. Por nuk duhet harruar se edhe obligimet i ka shumë më të mëdha sesa komuna të tjera. Të hyrat pra kanë shënuar rënie për 33 % në krahasim me vitin paraprak ose nominalisht përmbi 4,000,000 më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Por kjo thellohet kur vlerësimi bëhet në krahasim me planifikimin, ngase buxheti i vitit 2026 është për 13 % më i madh sesa i vitit paraprak e po ashtu edhe planifikimi i të hyrave ka qenë përafërsisht për aq në përqindje më ambicioz sesa i kaluari. Faktikisht nga 41,000,000 të planifikuara në këtë periudhë janë arkëtuar vetëm 8,200,000 ose vetëm 20 % e planit vjetor. Andaj dështimi është më i madh sesa 33 %. Madje të hyrat në këtë periudhë të vitit 2026 janë për 1,250.000 euro më pak edhe sesa në vitin 2024. Vit ky kur buxheti i komunës ishte shumë më i vogël sesa i vitit 2026. Pra është dështim spektakulor dhe i paspjegueshëm. Edhe në këtë periudhë dominojnë të hyrat e realizuara nga tatimi në pronën e paluajshme që ka grumbulluar mbi 50 % apo 4,700,000 të totalit të të hyrave, si dhe të hyrat nga lejet ndërtimore. Ndonëse te kjo kategori pra te lejet ndërtimore ka rënie drastike në krahasim me vitet paraprake. Saktësisht nga afër 5,000,000 sa ishin në vitin 2025, këtë vit janë realizuar vetëm 1.740,000 euro ose 70 % më pak. Dhe ky është rast që kryetari të na shpjegojë këtë dukuri. Domethënë 80 % e të hyrave vetanake burojnë nga tatimi në pronë dhe lejet ndërtimore, ndërsa të gjitha të hyrat tjera përbëjnë më pak se 20 % të shumës së përgjithshme të të hyrave. Natyrisht ky nuk është fare tregues i mirë për të ardhmen e kryeqytetit për arsye se sektori i ndërtimeve mund të bie në ritëm në të ardhmen dhe kjo ndikon drejtpërdrejt në të hyra nëse edhe vitin në vazhdim vazhdoni ta mbështesni gjithë politikën zhvillimore të kryeqytetit në këtë mënyrë. Pra në këta dy komponentë, sa më shpejt që qeverisja e Prishtinës sheh me vizion përpara, duhet ta ndryshojë strategjinë dhe të fokusohet edhe në fusha të tjera ose ta presë qetësisht falimentimin. Shpenzimet sikurse edhe herave tjera edhe këtë herë paraqesin anën e errët të udhëheqës së kryeqytetit, ndonëse analiza nga tabela e paraqitur ka qenë paksa e vështirë për shkak se në tabelë është paraqitur viti 2025 si vit i raportimit, mirëpo që shifrat e buxhetit përkrijnë me vitin 2026 dhe ne ju kemi referuar kështu duke llogaritur gabim teknik nëse nuk është kështu të lutem drejtoreshë na e shpjego situatën. Sidoqoftë të dhënat në raport tregojnë se nga 162,000,000 sa ka në buxhet të miratuar komuna jonë ka shpenzuar për këtë tremujor të dytë mbi 45,000,000 apo 27.5% të buxhetit të paraparë vjetor. Pra nga 162,000,000 sa ka qenë të miratuara në buxhet për këtë periudhë janë shpenzuar mbi 45,000,000 apo 27.55 të buxhetit paraparë vjetor. Shifër kjo që tregon se shpenzimet kanë tejkaluar planifikimin, sidomos për këtë periudhë të planifikimit fillestar për vitin 2026, por edhe në krahasim me vitin e kaluar. Madje vitin 2025 e kemi kaluar me shpenzime për 56.12 %. A është pozitive kjo dukuri shtrohet pyetja, përgjigjja është shkurt jo. Madje është shumë keq. Është shumë keq ngase analizuar kategoritë që dominojnë shpenzimet janë pikërisht ato kategori nga të cilat nuk përfitojnë qytetarët e Prishtinës, por vetëm dëmtohen. Madje dëmtohen shumë. Për shembull dominojnë kategoria mallra dhe shërbime me 17,130,000 euro ose 44.43 %. Paga dhe medijtë me 12,770,000 ose 26.36 % shpenzime komunale me 856.497 euro, subvencione dhe transfere me 2,140,000 euro dhe vendimet gjyqësore e lëndë përmbartimore me 6,399,000 euro ose 79.83 % e totalit të parapartë për këtë kategori, dhe në fund kategoria që na intereson të gjithëve dhe që në fakt është i vetmi shpenzim që ndikon pozitivisht në jetën e qytetarëve të kryeqytetit e që është realizuar më së keqi domethënë në normën vetëm 10.69 % apo 5.713.000 euro në total. Ndonëse kjo shifër nuk përkon me gjendjen faktike, ngase ka dhe mjete të tjera që nuk janë të realizuar si projekte dhe që nuk është sqaruar ku janë shpenzuar

faktikisht, mirëpo që në raport janë paraqitur si shpenzime kapitale e nëse i heqim të gjitha këto, vlera e vërtetë e shpenzimeve kapitale nuk shkon me më shumë se 8 % nga totali të kjo kategori. Raporti për tremujorin e dytë të këtij viti thotë kështu: në rastin kur shpenzimet janë rritur për 56 % në total për kategori të tjera krahasuar me vitet paraprake, tek shpenzimet kapitale janë zvogëluar për 18 % ose për 22 % krahasuar me vitin 2025, dhe për 44 % krahasuar me vitin 2024. Pra nuk ka nevojë fare për analizë të kësaj situate dhe përfundimi është i qartë. Buxhet që shpenzohet e jo buxhet që investohet. Tabela e shpenzimeve ka edhe disa paqartësi siç i ceka edhe më lart në disa projekte të cilat nuk duket se kanë filluar që realizohen në terren ndonëse ka shpenzim të mjeteve të parapara për to. Për shembull ndërtimi i tregjeve të gjelbërta edhe në **olperian** edhe ky këtu afër nesh 42.962 euro. Ndërtimi i therrores së kryeqytetit 497.227 euro. Ndërtimi i Qendrës multifunksionale për shërbime sociale 152.649 euro, e projekte të tjera që natyrisht kërkoj nga drejtoresha të na sqaron këtë dukuri. Në këtë rast vazhdon të rritet në përmasa shqetësuese ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që vetëm për këtë periudhë tremujore kap shifrën alarmante prej 6, 400,000 euro apo afër 80 % e gjithë shumës së paraparë vjetore. Pyetja që shtrohet këtu është se pse edhe në këtë raport nuk e keni specifikuar sa mjete nga kjo shumë janë tërhequr si lëndë përbarimore ose detyrime nga kontratat kolektive e sa prej të tjera prej kësaj shume nga vonesa në pagesat operatore për punët e kontraktuara apo më mirë themi se sa është shuma e paguar me vendimet gjyqësore si pasojë e keqmenaxhimit, neglizhencës, sabotimit e pse jo edhe e keqpërdorimit. Është shumë e rëndësishme të ketë parasysh se ky raport kaq negativ paraqet punën tuaj për këtë periudhë kalendarike. Domethënë nga 1 prilli deri më 30 qershor të këtij viti dhe është përpiluar nga vetë ju, pra askush nuk po e vesh dështimin. Ju vetë e keni treguar përmes këtij raporti. Të nderuar kolegë asambleistë, i nderuar kryetar Përparim Rama dhe ju të dashur qytetarë të Prishtinës. Sa më shpejt që të kemi përgjigjen në pyetjet që shtruan rreth mënyrës se si janë shpenzuar taksat tona dhe kjo nuk është vetëm në këtë raport, por në të gjitha raportet që kanë ardhur deri sot dhe sa më shpejt të adresohen shqetësimet tona e të merren parasysh sugjerimet tona, Prishtina do të ketë shpresë. Në të kundërtën trendi po e tregon qartë se ditë të vështira po e presin kryeqytetin dhe përgjegjësia sigurisht që ka adresë. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit z. Osmani. Nga radhët e aleancës. A dëshiron fjalën dikush? Jo. Lidhja e Prishtinës, jo. Nisma? Jo. Besa dëshiron fjalën? Jo. Falemnderit shumë. Fjalën e ka kërkuar Nexhmie Gjema.

Nexhmie Gjema: - ju falemnderit. Të nderuar, raporti që po e shqyrtojmë mbulon periudhën 1 prill 30 qershor 2026. Megjithatë qysh në hyrje thuhet gabimisht se mbulon tremujorin e parë. Kjo është në kundërtënie e drejtpërdrejtë dhe raporti është për tremujorin e dytë, jo për të parin. Në raportin TM2 2025 komuna kishte realizuar 12.31 milionë euro të hyra vetanake, ndërsa në TM2-shin e vitit 2026 veç 8.25 milionë euro. Pra kemi një rënie prej 4 milionë 05 milion eurosh ose më mirë me thënë 32.95 %. Rënia kryesore nuk vjen prej tatimit në pronë siç thuhet në tekstin e raportit sepse të hyrat nga kjo kategori janë rritur për rreth 64.000 euro. Rënia kryesore vjen nga lejet ndërtimore prej 4.94 milionë eurove në 1.74 milion ose rreth 3.19 milionë euro më pak. Prandaj pse konstatimi në tekst nuk përputhet me tabelën? Pse kanë ra kaq shumë të hyrat nga lejet ndërtimore? A janë lëshuar më pak leje? Ka pasur vonesa administrative, mosfaturim apo mosarkëtim? Kur jemi te shpenzimet e përgjithshme, në anën tjetër ndonëse të hyrat kanë ra për 32.95 %, shpenzimet e përgjithshme janë rritur për 16.18 milionë euro ose më mirë me thënë për 56.12 %. Veç mallrat edhe shërbimet janë rrit prej 7.32 milionë në 17.13 milion euro, pra për 9.81 milion euro. Në cilat kontrata dhe shërbime konkrete kanë shkuar këto mjete shtesë? Raporti paraqet se 12.11 milionë euro shpenzime kapitale. Mirëpo prej kësaj shume 6.40 milionë euro janë ekzekutime të vendimeve gjyqësore. Kjo domethënë se për investime kapitale të mirëfillta mbesin vetëm 5.71 milionë euro, rreth 1.95

milion euro ose 25.40 % më pak sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Me fjalë të tjera, shpenzimet po rriten, por investimet reale kanë rënë. Kur jemi te investimet kapitale dhe vendimet gjyqësore, raporti paraqet 12.11 milionë euro shpenzime kapitale, por prej kësaj shume 6.40 milionë euro janë ekzekutime të vendimeve gjyqësore. Pra, investimet kapitale të mirëfillta janë veç 5.71 milionë euro, të cilat kanë rënë për 1.95 milion euro ose 25.40 krahasuar me vitin e kaluar. Me fjalë të tjera shpenzimet po rriten, investimet reale kanë rënë. Edhe më shqetësuese janë pagesat përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore. Ato janë rritur prej 4.30 milionë eurove në TM2 2025 në 11.15 milionë euro. Në TM2 2026 rreth 6.85 milionë euro më shumë. Vitin e kaluar e dimë të gjithë se komuna i ka paguar 45.7 milionë euro përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore. Kemi pritur që pas kësaj goditjeje të madhe për buxhetin dhe taksapaguesit këtë vit do kishte më pas me shumë kujdes dhe përgjegjësi, por pagesat pothuajse janë trefishuar dhe jemi vetëm në tremujorin e dytë. Pse veç Drejtoria e Investimeve Kapitale si shembulli më i mirë në thonjëza ka paguar 5.10 milionë euro përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore veç brenda tre muaj ditëve. Sa prej këtyre pagesave janë borxh bazë, sa kamata dhe sa shpenzime përbarimore? Nuk kemi asnjë informatë. Realizimi i projekteve kapitale. Drejtoria e Parqeve ka realizuar 10.47 %, ndërsa 10 projekte me buxhete të përbashkët prej 2.3 milionë euro nuk kanë asnjë shpenzim. Te shërbimet publike progresi financiar ka rënë 59 % ndërsa gjashtë projekte me buxhet prej 3.4 milionë eurove nuk kanë asnjë realizim. Pse këto projekte nuk kanë filluar? A rrezikojnë mjetet me mbet të pashpenzuara deri në fund të vitit? Edhe raportimi i pasurisë jofinanciare përmban mospërputhje serioze. Gjithashtu komuna ka 91.76 milionë euro llogari të arkëtueshme ose 6.07 milionë euro më shumë se në vitin e kaluar. Te detyrimet kontigjente 271 nga 385 lëndë janë paraqitur pa klasifikim dhe pa vlerë financiare. Ndërkaq 736 lëndë që figurojnë raportin e vitit të kaluar nuk paraqiten fare. Këto 736 lëndë nuk figurojnë në raportin e vitit të kaluar dhe fare në vitin të TM2-shit të këtij viti 2026, por këto të dhëna Kuvendi nuk mundet me e ditur ekspozimin real juridik dhe financiar të komunës. Çka ka ndodhur me 736 lëndë dhe sa është vlera financiare e 271 lëndëve të paprecizuara? Numri i personave me kontrata për shërbime të veçanta është rritur prej 17 në vitin 2024 në 199 në vitin 2026. Vetëm në shëndetësi janë 61 persona me kontrata të veçanta, ndërkohë që në kujdesin primar mungojnë 60 punonjës të rregullt. A përdoren këto kontrata për me mbulu pozita të përhershme? Pse tabelat paraqesin 199 persona, ndërsa shpjegimi thotë 195? Për çfarë detyrash janë angazhuar

Kryesuesi: - falemnderit zonja Gjema. Fiknete Bejta e ka kërkuar fjalën.

Fiknete Bejta: - falemnderit kryesues. Të nderuar drejtorë, të nderuar kolegë asambleistë, të dashur qytetarë. Nuk dëshiroj të përsëritem në të gjitha ato që u thanë nga parafolësit e mi, mirëpo kam vërejt tek taksat për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike një diskrepancë të madhe pasi që të hyrat vetanake të planifikuara për këtë kategori kanë një diskrepancë të madhe nëse i krahasojmë me vitin 2025 ose me vitin 2024 janë realizuar vetëm 42.253 € euro ose vetëm 12.78 %. Kjo nëse shihet në ndikimin në strukturën buxhetore tek buxheti vetanak mendoj që do të ketë një rezultat të tillë do të ketë impakt tek investimet kapitale. Edhe kisha dëshiruar meqenëse po mungojka drejtori i shërbimeve publike ta di a është gabim teknik apo me të vërtetë është një realizueshmëri e tillë e kësaj kategorie të arkëtimit të mjeteve vetanake. Falemnderit kryesues.

Kryesuesi: - falemnderit zonja Bejta.

Fjolla Vukshinaj Reqica fjalën e ka kërkuar.

Fjolla Vukshinaj Reqica: - atëherë falemnderit. Unë domethënë e kam një pyetje për drejtoreshën e financave, por edhe për Zyrën ligjore në lidhje me kontratën kolektive shumë kisha pasur dëshirë Zyra ligjore apo Drejtoria e Financave me na dhënë një rrjedhje se si kjo kontratë kolektive po e implikon Komunën e Prishtinës. Sipas një statistike të asoacionit të komunave të Kosovës, 344 milionë kanë qenë domethënë buxheti që i është marrë komunave në krejt Republikën e Kosovës për ne si asambleisë, por edhe për si qytetarë është shumë me rëndësi me kuptu procesin, si merren këto para edhe sa kanë mbet, domethënë si shkon procedura, sa vendime gjyqësore janë në tavolinë që priten me u ekzekutuar deri në fund të vitit sa pritet me qenë shuma e kontratës kolektive që ka me ju marrë Komunës së Prishtinës. Mendoj që këto janë në interes edhe të neve si asambleistë, por edhe si qytetarë me kuptuar logjikën po dhe me kuptu sa mjete janë dhe si ka me pasur implikime buxhetore. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit. Zoti Svecla e ka kërkuar fjalën.

Gëzim Svecla: - falemnderit zoti kryesues. Unë e kam një pyetje. A dihet ku është kryetari? A dihet ndonjë send për fatin e tij? Sepse po flasim për raportin financiar të Komunës së Prishtinës që aj e drejton? Unë e di që është i marr peng politikisht. Po kështu fizikisht po them a është mirë asnjë mbledhje. Sot është mbledhja e pestë, muaji shtatë. Hala s'ia kena ni zërin Përparim Ramës duke fol në Kuvend. E paska bërë një status ku bash kurrë nuk mohon prej atyre të cilat janë këtu në materiale. Kjo është shumë, kjo i ndryshon gjërat plotësisht. Kredibiliteti i Komunës së Prishtinës është zero. Ne po flasim tash për një raport tremujor, por në realitet kjo është pasqyra e qeverisjes. Të hyrat kanë rënë, shpenzimet janë rrit, investimet kapitale veç 10 % më shumë para për gjykata përmbaruese për investime kapitale Prishtina po bankroton. Edhe ne që jemi të zgjedhur të qytetarëve po flasim një me tjetrin as raportin se dëgjojmë. Po s'është faji jonë, sepse lidhshipi është kështu qysh është. Një kryetar që s'merr pjesë në asnjë mbledhje, një kryetar që merret me gjithçka përveçse se me Prishtinë. Veç me Prishtinë nuk merret. Merret me pula, me gjela. Nuk merret me bërlllog. Për besë qytetarët e Prishtinës nuk e meritojnë këtë. Edhe është detyrë bre secilit prej nesh këtu pavarësisht bindjeve tona politike me kërku me ndryshu kjo gjendje. Asnjëherë nuk ka qenë kështu. Kurrë Prishtina s'ka pasur buxhet më të madh. Kurrë në histori nuk ka pas Prishtina buxhet më të madh. Ky buxhet këto para nuk po mund me u kthi në zhvillim për shkak të politikave të Përparim Ramës. Pika tjetër e rendit të ditës është bartja e mjeteve rezervë për shkak se përmbaruesi i ka marrë mjetet ku kanë qenë të dedikuara për investime kapitale. Edhe këto të cilat po i themi ne as nuk janë slogane politike, as nuk janë pretendime. Janë shifra që vetë ekzekutivi e ka sjell, vetë kabineti, zyrtarët, varësit e Përparim Ramës na i kanë sjellur këto të dhëna. Po kështu ndodh sepse kur nuk menaxhon vetë të menaxhojnë të tjerët. Kështu ndodh kur nuk i menaxhon financat pastaj financat prodhojnë kriza. Kur nuk merresh me qytetin, qytetin e mbulojnë problemet. Unë për besë po ndjehem keq edhe në çfarë pozite jeni ju në anën tjetër të sallës, kur s'e keni as guximin as mundeni një fjalë me u çu me thënë. Kemi materiale diskredituese të paraqitura para nesh, para krejt neve. Lëni për një moment subjektin politik. Jemi përfaqësues të qytetarëve të Prishtinës. Edhe çdo ditë kur dalim prej shtëpisë, kur dalim prej derës, kur shkojmë në punë, dijeni që në këtë gjendje Prishtinën e ka sjellë Përparim Rama dhe bashkëpunëtorët e tij, Uran Ismaili me partinë e tij. Pa të kurrë Prishtina s'kish ardhur në këtë gjendje. Faji është i përbashkët. Kërkush nuk mundet me ik prej fajt. Mund të mos vini në mbledhje, po përgjegjësi edhe publike edhe ligjore krejt kanë me dhënë, sepse Prishtina u kanë para tyre e Prishtina do të mbetet pas tyre.

Kryesuesi: - falemnderit zoti Svecla. Ju lutem kushdo që e merr fjalën fokusohuni vetëm në pika. Vazhdojmë. A ka dikush që dëshiron me marrë fjalën? Po Feim Osmani

Feim Osmani: - jo unë veç po kërkoj se i ngrita si pyetje tre katër shqetësime. Po pres së paku nga përpiluesi i raportit teknikisht drejtoresha e financave sepse këto e di saktësisht që janë probleme të menaxhementit të krejt drejtorive e shumë më shumë të kryetarit. Mirëpo meqë drejtoreshë fazën finale të përpilimit të raportit e keni ju në dorë së paku me na sqaruar problemin e asaj pjesës që ka shumë projekte në të cilat janë shuma të paguara parash e që nuk kanë filluar fare. Ne jemi marrë vesh edhe ashtu. Ministria ka lejuar një kod të veçantë që të futen të gjitha mjetet që tërhiqen nga përmbaruesi dhe nga vendimet gjyqësore, kështu që me na sqaruar a janë edhe ato që i përmenda që janë nja tre katër që unë po i di, por që munden me qenë edhe shumë kontrata tjera të ngjashme. Nëse ka edhe të tjera mund të ta zvogëlojnë këtë pjesën e buxhetit të investimeve kapitale deri në 3 milionë dhe është interes i Kuvendit edhe i qytetarëve me dit a janë 5 milionë e 700.000 € euro faktikisht investime kapitale apo janë edhe më pak për arsye se për shembull thertorja s'ka filluar fare, po ashtu as tregjet as kjo tek ne as ai në Ulpianë s'kanë filluar fare shumë pozicione të tjera nga të cilat janë tërhequr mjete, por që projektet nuk janë. Kisha dashur një sqarim së paku në këtë çështje sepse është çështje teknike. Pjesën tjetër drejtorët do duhej të ishin këtu dhe kryetari me na sqaruar pse raporti është kaq negativ.

Kryesuesi: - falemnderit zoti Osmani. Drejtoreshë dëshiron fjalën. Drejtoresha Makolli ka kërkuar fjalën.

Valbona Makolli: - falemnderit. Unë provova me i shpjegu të gjitha, po në pamundësi të zhurmës së madhe nuk pata mundësi me arrit me përfundu të gjithën. Raporti është shumë i qartë, është thënë e ndamë domethënë është bërë jashta me kërkesën e Kuvendit jashta pikave ligjore domethënë të Ligjit për Menaxhimin e Financave pika 45 dhe 46 ne i kemi nda për shkak se u krijuan rrethana ashtu, domethënë kur u bë ligji nuk kanë qenë këto përmbarime kështu edhe ne e kemi ndryshuar raportin edhe i kemi paraqitur kodin 0040 në secilën drejtori për secilën drejtori e keni çitur edhe ekzekutimin çka janë bërë prej tyre domethënë në disa prej tyre ndoshta po e marrim hipotetikisht një shembull që me e kuptuar të tjerët. Për shembull, nëse në projektin e “Xhorxh Bushit” janë marrë 5 milionë grante për të bërë ekzekutimin e rasteve përmbarimore, ato kanë ndodhur që 3 milionë e 800 ose 3 milionë sipas raportit kanë mundur me u kryer deri në qershor, por pjesa tjetër me 2 ose 3 korrik, po në kontinuitet shkon ajo. Përndryshe në qoftë se thertorja qoftë secila prej që e marrë është me zero 40-sh domethënë të gjitha janë për raste përmbarimore. Nëse kemi ndonjë prej tyre që dyshoj, unë mund me dërgu dhe raportin të cilin ia kemi dërgu Ministrisë së Financave për këto mundesh me qasje në dokumente publike, ne komplet lëndën e paraqesim. Tash konkretisht nuk po e di për cilën, mirëpo të gjitha janë rubrika e dytë e në secilën drejtori është buxheti për vendimet gjyqësore dhe shpenzimet të cilat janë bërë për to. Desha edhe njëherë me ju përmbledh të gjitha se dëgjova disa prej pyetjeve. Ato që i kam dëgjuar po mundoha me u përgjigjen. Ato të cilat i kam harruar mund me ju përgjigj ose me email ose e merrni fjalën përsëri. Është e vërtetë që të hyrat janë më pak. Ato ne vetë i kemi deklaruar ato që e thatë ju veç e lexuat prej raportit. Arsyeja është kjo. Domethënë e para po flas për drejtorinë time se më takon me ia nis prej drejtorisë time. Unë përndryshe e menaxhoj edhe sektorin e tatimit në pronë. Kemi pasur vonesë jo veç ne, por krejt komunat. Nëse i marr raportet e komunave të tjera ne e kemi paraqit hallin edhe Ministrisë së Financave, por edhe nëpërmes asocionit të komunave ku ne e ngritim zërin si komuna që mos me shkru secila një email ose një kërkesë në ministri ne e çojmë përmes asocionit të komunave ku Ministria e Financave ka bërë ndryshimin e sistemit. Ajo është më e

dishme, kemi qenë edhe në trajnim dhe është duke u përmirësuar. Nuk po e marr atë që të gjithë duhet me u ankuar, mirëpo është një realitet të cilin mundeni me verifiku shumë lehtë. Janë duke u përmirësuar, por ka shumë probleme të mëdha. Domethënë ndërimi i sistemit nganjëherë ia bart borxhin ose vlera është më e madhe ose një vërtetim që u pagua përmes e-benkingut e nuk u përfshi. Janë disa telashe teknike, mirëpo faturat janë nda, janë shpërndarë me 12.6.2026, ku afati i fundit për pagesa, edhe pse ky raport është i vogël, se të viteve me radhë më 30 qershor është afati i fundit për pagimin e tatimit për pjesën e parë të vitit në viim. Normal që edhe një pjesë është vonuar tek hyrat qysh po shpresoj që muajve të tjerë do të realizohen. Janë edhe moskalimi ose fazat procedurale të Rregullores për tarifa gjoba dhe kjo rregullorja e fundit që ka dalë në diskutim publik edhe që duhet prapë ajo nuk mundet me u bë valide nëse nuk vjen prapë me marrë votën e juaj. Në momentin që e merr votën e juaj shkon për ligjshmëri dhe ne fillojmë me bë grumbullimin e të hyrave. Përndryshe përderisa rregullorja nuk vjen këtu, këto të hyra kanë me mbet vetëm të figurume. Sa i përket të hyrave tjetër nuk ka, krahasimet normal që janë, po vetëm mos me harru se çdo vjet të hyrat rriten, niveli ose tavanet për të hyrat për komuna rritet. Nëse vitin e kaluar kemi pasur hipotetakisht me mbledh 38 milionë sipas Ministrisë së Financave të tavanit mundesh më shumë po më pak është mosrealizim i të tyre. Sivjet i kemi pasur 43 domethënë çdo vit ministria, Fondi Monetar Ndërkombëtar bashkë me Ministrinë e Financave e bëjnë nivelizimin ose këtë kufi si për të hyrat tatimore ashtu edhe për të hyrat jotatimore. Domethënë këto që po e them janë edhe për komuna të tjera, por konkretisht po përgjigjem për kryeqytetin. Tjetër s'po më kujtohet diçka çka pat për momentin. Po ose për shembull të llogaritë e arkëtueshme, nuk e kemi një sistem të cilin ne mund çdo muaj ose çdo tre muaj me pas të dhëna të sakta, po ato bëhen me pasqyrë financiare, ato mundeni me i verifiku në Ministri të Financave. Ju si asamblistë e keni qasjen veç me kërkesë i merrni që të gjitha. Përsa i përket Zyrës ligjore ndoshta ju përcjell me email kërkesat e juaja se nuk mund me u përgjigj në emër të tyre. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit drejtoreshë. Dikush tjetër? Zonja Gjema, ju e keni konsumuar të drejtën. Mirë ke një pyetje, mundesh me ia bë urdhëro.

Nexhmie Gjema: - lidhur me shpenzimet kapitale nuk po e kuptoj pse renditet ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përfshihen tek kategoria e shpenzimeve kapitale. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit zonja Gjema, drejtoreshë dëshiron me ju përgjigj?

Valbona Makolli: - me Ligjin 01 L001, Ligji për Buxhetin 2026 është hera e parë që në Kuvend të Kosovës është aprovuar një nen ku thuhet që Ministria e Financave për obligimet e vendimeve gjyqësore i merr mjetet aty ku t'i gjen nga komuna. Ne për mos me shkue te shpenzimet operative qysh ka ndodhur vitin e kaluar e te subvencionet e tek mallrat e shërbimeve që janë shpenzime operative ose të domosdoshme, ne e kemi çuar vetë kërkesën në ato projekte të cilat kryhen në pjesën e dytë të vitit ose për arsye të ndryshme nuk kryhet i kemi çuar njoftim se duhet të merren e ato është një pjesë e grandeve të investimeve kapitale. Po zakonisht 80 % të krejt komunave i marrin te investimet kapitale. Normal, pagat asnjëherë nuk i prekin, edhe pse u desh sipas mendimit tim profesional, jo tjetër është desh nëse ato janë paga jubilarë, u desh me i marrë prej pagave e jo prej kapitaleve. Po kjo nuk është në dorën tonë. Po është e vërtetë që kontrata kolektive tashmë është stërfol 100 herë ku është problemi. Dy ministritë janë marrë vesh në kurriz të komunave, asnjëherë nuk janë qitur mjete për to dhe asnjëherë nuk u bë ndonjë hap për me eliminuar këtë problem i cili është për të gjitha komunat po më shumë neve na kanë dëmtuar.

Kryesuesi: - falemnderit drejtoreshë. Kalojmë në pikën e tretë pasi s'ka kërkuar kush fjalën. Pika e tretë, Propozim -vendimi për transferimin e mjeteve financiare. Edhe për këtë pikë fjalën i jap drejtoreshës zonjës Makolli.

Valbona Makolli: - falemnderit shumë. Kemi sjellë një Propozim-vendim për transferimin e mjeteve të cilat janë në pjesën e rezervës komunale. Për asamblastët të cilët nuk kanë qenë viteve të tjera dhe vite të tjera kemi pas, po e shpjegojmë më së pari qysh kanë kaluar këto mjete në rezervë. Cdo shtator komuna e bën buxhetin edhe votohet në kuvend. Mirëpo pasi të votohet në Kuvend, Ministria e Financave disa prej projekteve sipas ligjeve, sipas planit kontabël të tyre konsiderojnë që nuk janë, nuk i kanë plotësuar kriteret dhe i qesin në fondin rezervë. Ato fondi rezervë kthehet vetëm momentin kur sillet në kuvend edhe përmirësohet ajo kërkesë ose ai plan kontabël që nuk përputhet me planin e kontabël të Ministrisë së Financave. Çfarë i bie kjo? Vitin e kaluar, vitin 2025, ne kemi menduar dhe kemi konsideruar që është investim kapital blerja e autobusëve që do të jenë pasuri e komunës e do t'i jepen në shfrytëzim ndërmarrjes tonë Trafikut urban dhe Ministria e Financave i ka çitë në fond rezervë me arsyetimin se këto duhet me qenë subvencione meqenëse do t'i shfrytëzon ndërmarrja. Ne kemi menduar edhe prapë hala mendoj që ato janë investime kapitale që duhet me u ble dhe me u regjistruar si pasuri e komunës, mirëpo i kanë çitë rezervë dhe tash duhet me respektuar atë vendim të tyre. Edhe është fasadimi i ndërtesave të vjetra që është kërkesë që ka rrjedhur prej kërkesës të qytetarëve në dëgjime buxhetore, është cek që është me kërkesën e tyre, ata e kanë konsideruar që ajo duhet të shndërrohet në kategorinë e mallrave shërbimeve edhe për ata i kanë kthyer, mirëpo i kanë kthyer edhe disa projekte të tjera, po në rastin e këtij vendimi këto dy projekte kanë kaluar në rezervë dhe nga fondi rezervë pjesa e të hyrave kërkojnë që të kalohet në projektin prapë investim kapital që është efienca e energjisë së ndërtesave publike në Prishtinë. Ky projekt është veç i hapur. Është projekt kredi me BERZH edhe mes komunës ku Ministria e Financave është garantues dhe kjo ka qenë prej vitit 2023 tutje. Po deri në vitin 2026 BERZH-i nuk ka mundur me përcaktuar operatorin se ai sipas marrëveshjes e ka me zgjedh operatorin dhe ne çfarë kemi bërë? Kemi bërë një të them gabim që edhe ne edhe Ministria e Financave bashkërisht, ne i kemi shfrytëzuar ato mjete për projekte të cilat nuk kemi pasur mjete, mirëpo Ministria e Financave sipas tyre kemi bërë gabim që i kemi përdorur ato mjete. Normal dhe Ministria e Financave ka një pjesë të paktë të them të fajit se e ka një Departament të Monitorimit edhe u desh me ndal pagesën e parë jo tek sa të vjen vlera 2 milionë e 56 mijë 148, mirëpo ka ndodhur kjo. Kjo është edhe në raport. Ne i kemi çu ministrit të financave, zotit Murati dhe drejtorit të thesarit kërkesë që ne do të zotohemi me i kthyer këto mjete. Ato nuk janë marrë, ato janë mjete të cilat kemi pranuar shpenzim dhe janë faturat dhe i kanë kërkuar auditorë faturat edhe janë të dëshmuara dhe kemi kërkuar që mjetet në rezervë, që mos me ia marrë mjetet projekteve të tjera, të cilat kanë kontratë dhe besoj që në këtë pjesën e dytë të vitit do të shpenzohen jemi zotuar që këto mjete nga të hyrat të kalojnë në këtë fond të 06-shit ose kodi 53455 efienca e energjisë në ndërtesat publike në Prishtinë. Kjo është kërkesa. E bëra një analogji për arsye se disa prej asamblastëve të rinj nuk më ka ra me bë kthimin e rezervës se është vitin 2023 ka qenë njëherë 2024 dhe 2026. Ju falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit drejtoreshë. Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës nga LDK? Shkojmë me shefat e grupeve. Dëshiron fjalën dikush? Jo. PDK dëshiron fjalën dikush? Jo. Zoti Svecla e ka kërkuar fjalën nga Lëvizja Vetëvendosje.

Gëzim Svecla: - falemnderit. Drejtoreshë po e kemi votuar dhe përpara këtë çështjen e rezervës. Edhe te ne pati diskutime dhe dilema për këtë çështje. Po meqenëse ka të bëjë me

investime në sektorin publik, konkretisht efienca e ndërtesave publike, ne gjithsesi do ta votojmë. Po thatë që mora një analogji. Po hiç s'ke e qëllime analogjia se the që ne kemi gabuar e i kemi shpenzuar e po ata kanë faj pse s'kanë reaguar. Tash po e marr unë një analogji tjetër është si hajnat me thënë që ne kemi vjedhur po policia ka faj që s'po na nxen. A po kupton? Po edhe ideja që vazhdimisht bre me akuzuar nivelin qendror vazhdimisht, për besë unë, ti e din që kemi pasur bashkëpunim dhe vazhdojmë të kemi bashkëpunim të mirë me juve si drejtoreshë. U bënë pesë vjet që po mundohesh me ia mshef të zezat Përparim Ramës. Tash jemi në një fazë ku Përparimi ia nis i qet shokët e vet. Shiko sot. Kështu që është mirë me bë kujdes edhe është mirë në shërbim të punës që e bën e me qëllimet më të mira me kryer punën në bazë të kompetencave tuaja, jo me u mundu me i mbulu më dështimet edhe keqmenaxhimin e Përparim Ramës.

Kryesuesi: - falemnderit zoti Svecla. Drejtoreshë a dëshiron fjalën?

Valbona Makolli: - s'po di as çfarë me thënë unë.

Kryesuesi: - nëse s'din qka me thanë mos e merr fjalën hiç.

Valbona Makolli: - jo po dua, se tash s'po guxoj as me ja përmend emrin. Problemi është që, jo se s'po dua me zgjatë. Problemi është pse është një pjesë e fajit. Është konstatuar edhe prej auditorit se është një departament i monitorimit sikur mos të kishin ekzistuar nuk e kisha përmendur. Eshte problemi që pagesat tjera na i kthejnë nëse rastësisht se stafi e di, Komuna e Prishtinës i ka 200 deri 300 pagesa në ditë edhe në qoftë se teknikisht ose një problem ndodh ata e kthejnë edhe kam shpresuar që e kthejnë. Nuk e përmenda me e akuzu po ai departament tash ka bërë edhe disa ndryshime që me ja mundësu vetit at monitorim. Po s'ke aktakuzë. Ke vetëm shumë reale. Falemnderit.

Kryesuesi: - AAK nuk dëshiron fjalën. Lidhja e Prishtinës? Jo. Grupe të tjera? Jo. Feim Osmani ka kërkuar fjalën.

Feim Osmani: - falemnderit drejtoreshë për sqarimin. Konsideroj që do duhej të na vinte si pikë më herët për arsye se do të kishim pasur mundësi që ne vetë të hulumtojmë edhe ta shohim të vërtetën edhe nga ana jonë. Megjithatë, më mirë pak shpjegim sesa fare. Natyrisht që duhet me i vë kujdes punës derisa e punon, mos me lëshu gabimin, sepse me përmirësu dikush tjetër rrugës është shumë e vështirë ose është me pasoja siç është në rastin konkret. Kështu që për hera të tjera është mirë materialet shtesë, pikat shtesë me na ardhur ose më herët ose me u shty për seanca të tjera, sepse po dalim në një pozitë që është pak e palakmueshme. Me votu me gjysëm informata është e rëndë, mos me votue është keq. Ne sot po e zgjedhim të parin, mirëpo kujdes herave të tjera, sepse ka rëndësi jashtëzakonisht shumë kur i dërgohet materiali asambleistit edhe sa ka mundësi me shqyrtu. Në bazë të atyre informative vendos me votuar edhe është më i lirë me natyrisht me dhënë votën sidomos kur është për, s'kam diçka tjetër. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit zoti Osmani. Dëshiron dikush fjalën? Jo. Ju lutem regjia të jetë gati. A ka mundësi me konstatuar kuorumin njëherë? Gjithsej janë 43 janë prezent. Kemi kuorum. Rexhia të jetë gati për votim. Votojmë tash. Falemnderit. 40 vota për, një kundër një abstenim. Kalon edhe pika e tretë. Propozim - vendimi për transferimin e mjeteve financiare. Kalojmë te pika e katërt. Para se me kaluar te pika katër, a po doni me shku në pauzë apo doni me vazhdu? Jo jo veç një moment krejt përmjehërë s'mundeni me fol se s'mundem me ju dëgju krejt. Po

doni me vazhdu? Në rregull. Vazhdojmë pa problem hiç. Vazhdojmë, pyetje dhe përgjigje, pika e katërt hapi diskutimin. Fjolla Vukshinaj Reçica ka kërkuar fjalën.

Fjolla Vukshinaj Reçica: - pyetja ime drejtor për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe për investimet kapitale por pasi që këta nuk janë prezent ne kemi pranuar një kërkesë nga këshilli lokal në Besi i cili përfaqëson fshatrat Besi, Teneshdoll dhe Vranidollë. Banorët kanë kërkuar me Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe investimet kapitale me dalë në terren për me i pa disa kërkesa bazike që banorët e atyre fshatrave i kanë. Kërkesat kryesisht lidhen me shtrimin e rrugëve, me pastrimin e varrezave dhe me ndriçim. Vetëm një shembull. Kryesisht banorët e Vranidollit organizohen vetë dhe i pastrojnë varrezat. Mirëpo këtu ndoshta do të ishte mirë edhe Ndërmarrja e Gjellbë të dalë në terren bashkë me ta, por unë i kam kërkesat. Ata i kanë adresuar edhe tek Leutrim Retkoceri, po edhe tek drejtoresha Pillana. Mirëpo unë kisha pasur dëshirë që me me u organizuar dhe po i bëj ftesë kushdo tjetër ka dëshirë me dalë në terren në fshatrat e anës së Llapit, atëherë me na u bashkëngjit dhe me i pa kërkesat e tyre me biseduar me banorët. Po ashtu kjo është edhe kërkesë specifike e tyre që mos të dalin në terren pa e njoftuar këshillin e bashkësisë lokale dhe banorët. Prandaj kam me adresu kërkesën edhe me email apo me platforma të tjera. Kështu që unë i mirëpres ata në Besi, në Vranidoll, në Tenezhdoll dhe Rimanishtë dhe të dalim bashkë t'i shikojmë kërkesat edhe intervenimet janë shumë bazike dhe janë kërkesa që ia lehtëjnë jetën qytetarëve të asaj ane.

Kryesuesi: - falemnderit Fjolla. Kushtrim Sopa ka kërkuar fjalën.

Kushtrim Sopa: - falemnderit shumë, unë po vazhdoj me një traditë të kërkesave të qytetarëve. Unë po i përcjelli si pyetje edhe përgjigjet s'është problem me i marrë edhe më vonë. Po ju kisha lutur edhe prej seancës së kaluar, nuk më kanë ardhur ne email zyrtar përgjigjet nga drejtorat përkatës përveç Granitit që më ka përgjigjur privatisht për një kërkesë, falemnderit Granit. Edhe Leutrimi gjithashtu po vazhdoj. Janë tetë pyetje, po mundohem shpejt me i përmbledh kërkesë prej qytetarëve të lagjes “Emshir”, rruga “Rexhep Krasniqi”. Ndërtimi i kolektorit, janë diku 300 metra që prej vitesh nuk po mbulohen. Kërkesa është për shkak që ka erëra të rënda, ujëra fekale, ndotje dhe kushte që rrezikojnë shëndetin e banorëve seriozisht kërkesë tjetër është e shumë qytetarëve të Prishtinës se kur do të vazhdohet me trajtimin e planit zhvillimor komunal. Kërkesë tjetër është nga banorët e fshatit Prapashticë, emërtimi i një rruge në fshatin Prapashticë në emër të të ndjerit “Ragip Nuredin Prapashtica” në lagjen e Cubave në tokat që lidhin fshatrat Hajkobillë dhe Motivodë tokë e të ndjerit në fjalë i nderuari ishte mësimdhënës në Prapashticë dhe i përndjekur politikisht nga regjimi i atëhershëm. Kërkesë tjetër është kërkesë për rregullimin e këndeve të lojërave dhe hapësirat përcjellëse në lagjen “Bregu i Diellit” tek banesat e standardit, si dhe në parkun e lagjes “Arbëria”. Kërkesë tjetër është intensifikimi i punimeve në rrugën “Bajram Bahtiri” sepse për momentin po punohet me pak pajisje dhe fuqi punëtore. Kërkesë urgjente për mbrojtjen kam edhe një kërkesë nga familja Rexhepi në lagjen “Arbëria” kërkesë besoj që ju ka ardhur edhe kolegëve të tjerë në asamble dhe drejtuesve të komunës. Është kërkesë urgjente për mbrojtjen dhe respektimin e bustit të Faik Rexhepit. Të vendoset me urgjencë një mbishkrim dhe një pllakatë për historiatin e këtij personaliteti dhe këtij busti. Rruga “Bedri Dedja” në fshatin Shkabaj seancën e kaluar e kam ngritur shqetësimin për një shtyllë të ndriçimit, por meqë ka një problem pak më të gjerësishëm

tani dhe janë disa shtylla të ndriçimit që nuk po funksionojnë. Kërkesë tjetër kam edhe kërkesë nga qytetarët për mbrojtjen e orarit të qytetarëve në fushat e tenisit në Taukbahqe dhe sigurisht zgjerimin e infrastrukturës së tenisit në Prishtinë me Granitin besoj që e bisedojmë pak më gjerësisht. Pastaj besoj që edhe një kërkesë tjetër ju ka ardhur prej klubit të basketbollit “Sigal Prishtina” për subvencionim që unë e konsideroj që duhet me trajtu. Po shpresoj kësaj radhe nuk paska ardhë dhe nuk u propozua nga udhëheqësia e Komunës së Prishtinës, por po shpresoj që në seancën e radhës. Klub me nam, me renome edhe njëri prej klubeve më të suksesshme në Kosovë, në regjion dhe më gjerë. Kisha pasur dëshirë me pasur konsideratë ndaj këtij klubi, por normal të gjitha klubeve sportive në Prishtinë, falemnderit shumë, respekt.

Kryesuesi: - falemnderit Zotri Sopa. Plator Gërdovci ka kërkuar fjalën.

Plator Gërdovci: - falemnderit kryesues. Unë i pata disa pyetje për të dy drejtoret që unë i kam pyetjet, sot nuk qenkan këtu. E pata për zonjën Xike Pllana edhe për Jeta Rafunën për bujqësi. Po sidoqoftë unë po i parashtroj pyetjet më shumë në formë të informimit edhe të pyetjes. Po besoj që seancën tjetër na i kthejnë përgjigjet. Për drejtoreshën e Infrastrukturës është paraqitur edhe herave të kaluara në seancat e kaluara, rast problemi i ujërave të zeza në parkunë Tokëbashqe. Edhe po më intereson me ditë a është ndërmarrë diçka apo henz ka mbetur në shtjellim e sipër që të paktën me e ditë ku është si problematikë, sepse ne e kemi dy parqe krejt në Prishtinë. Kështu me thënë që i plotësojnë kushtet për park edhe në njërin prej tyre ujërat e zeza kalojnë në mes të parkut, në atë rrjedhën e ujit që është dhe nuk po më duket që ish dashur me qenë problem i madh për me u zgjidhë si problem. Prandaj pres prej drejtoreshës me na e kthyer një përgjigje ose që ka nevojë me shkuar bashkë me të edhe me e pa problematikën sepse përnjëmend i gjithë ai park dhe në fund me u ndotet prej ujrave të zeza nuk po më duket shumë normale edhe mendoj që ish dashur me u zgjidh si problematikë. Unë e falenderoj edhe asamblistin Redenica të Lëvizjes Vetëvendosje e ka paraqitur edhe në seancat e kaluara. Po mendoj që bashkë si asamble me shkuar bashkë me drejtoreshën, sepse përnjëmend është problem serioz ai edhe duhet me u zgjidh disi. Normalisht që edhe Drejtoria e Parqeve kishte mundur të paktën në parkun e Tokëbashqes me tentu me e bë një farë ridizajnim, sepse shumë hapësir brenda atij parkut nuk janë tu u shfrytëzu dhe mendoj që kishte mundur me u dizajnu edhe më mirë. Mendoj që bashkë mundem me punu në atë drejtim. Po ashtu për drejtoreshën e bujqësisë Jeta Rafuna i pata disa pyetje, po e shoh që po mungon bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm në fushën e subvencionimit apo të granteve në bujqësi. Ka donatorë të ndryshëm që sa kam qenë unë drejtor i drejtorisë së bujqësisë kemi bashkëpunuar dhe kanë rezultuar shumë me sukses, dhe kohën e fundit nuk po shoh ndonjë iniciativë në atë drejtim që me i vazhdu ato bashkëpunime. Deshta t'i shtroj pyetje drejtoreshës se ku është problemi që nuk ka iniciativa të tilla dhe normalisht nëse ka nevojë për kontakte ose me i ndihmu diçka, ne këtu jemi mundemi me i ndihmu. Pastaj si problematikë tjetër për Drejtorinë e Bujqësisë ose si formë të grantimit, ish dashur me mendu sidomos për vitin e ardhshëm me e mendu sistemin e mbrojtjes apo rrezikut ndaj breshrit sepse ne kemi fermer shumë serioz në komunën tonë. Dhe mendoj që ishte dashur me e mendu, se rasti i fundit në Istog na e ka rikujtua që natyra ndonjëherë din me qenë shumë e ashpër edhe me i dëmtu fermerët dhe ato dëme munden me qenë të pa parikuperueshme për ta. Mendoj që për vitin e ardhshëm është kohë e mirë, sepse

buxheti ende nuk është, qysh me thënë nuk u dizajnu, është hapat në draftet e para dhe mendoj që duhet me mendu diçka sepse edhe në Prishtinë kemi pasur raste kur breshëri ka dëmtuar kulturat tona shumë. Prandaj mendoj që drejtoresha duhet me mendu seriozisht, është më shumë kem si në formë të informimit me e ditë se a ka mendu diçka për vitin e ardhshëm. Po ashtu e kam edhe një pyetje për Pllumbin mbasi qenka këtu, mendoj Pllumb në shumë lagje shumë banorë e kanë një ankesë sa i përket pengesave në rrugë policët e shtrirë. E di që edhe në seancën e kaluar ose dy seancat prej tash u diskutua kjo temë, por po mendoj që nuk mjafton të diskutohet secilën seancë sepse nuk zgjidhet problemi, shumë qytetarë e kanë si kërkesë që me e gjetur një formë. Se përnjëmend në disa lagje veturat po lëvizin shumë shpejt dhe po i rrezikojnë edhe edhe banorët. Prandaj a mundesh me na informuar ku është si proces? A është kontrata, a je duke bërë, a e din, a është një kontratë në ardhje apo qysh po e mendon me realizu, sepse përnjëmend ka kërkesa shumë të mëdhaja prej banorëve. Ju faleminderit shumë.

Kryesuesi: - faleminderit zotri Gërdovci. Fiknete e Bejta ka kërkuar fjalën.

Fiknete Bejta: - unë kam disa pyetje. Një pyetje e kam për drejtorin e arsimit. Para se të fillojmë me pyetjen dua me e përgëzuar drejtorin për procesin e digjitalizmit të pranimit të fëmijëve në shkollat e mesme. Edhe pse është proces i vonuar mirë është që ka filluar të realizohet. Në Prishtinë funksionojnë edhe kopshtet me bazë komunitet, para së gjithash është e qartë se këto kopshte kanë mundësuar një numër të mirë të fëmijëve të parafillorët në procesin e edukimit të hershëm të përfshihen. Mirëpo kam pa që një rregullore e menaxhimit të këtyre çerdheve ose kopshteve të cilat menaxhohen nga Këshilli Prindërve është bazuar në një rregullore, që për mendimin tim edhe si personel arsimor ka mangësi të theksuara të cilat mund të ndikojnë edhe në cilësinë e menaxhimit të këtyre kopshteve. Meqenëse është në direktivës në domenin e juaj si drejtori desha të di a keni menduar për me i ndryshuar këto rregullore, me qenë se veç janë të tejkalume dhe kemi parë mangësi të theksume. Një pyetje tjetër është për drejtorin, Drejtorinë e Investimeve Kapitale. Desha drejtoreshës t'ja shtroj një pyetje, por meqë qenka këtu po e merr online. A do të vazhdojë shtrimi i rrugës “Brahim Beka” në Ballaban, meqenëse kjo rrugë ka fillu të asfaltohet në kohën e mandatit të Krenar Xhaferit. Mirëpo është asfaltuar vetëm gjysma e rrugës dhe pikërisht qasja e banorëve të asaj rruge që është menduar t’ju ja lehtësojë jetën atje nuk është asfaltuar. Një tjetër pyetje është për Drejtorinë e Parqeve në rrugën “Nexhmi Llumnica” në Kodër Trimeve, është një hapësirë bukur e madhe e hapësirës së pashfrytëzuar me gjasë se është pronë e ujësjellësit Prishtina. Mirëpo shqetësuese është që ajo hapësirë po shëndërrohet kohë pas kohë në deponi ilegale. Banorët me vetë iniciativë kanë pastruar disa herë dhe herën e fundit është pastruar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, është një kërkesë e banorëve që kjo hapësirë të shndërrohet në një park dhe kështu kishim mundur t’a eliminojmë krijimin e deponisë ilegale. Drejtoreshë unë të falenderoj për bashkëpunimin deri më tani, por kisha dashur që në mënyrë kërkesa të është eksplicite nga banorët, kishin mundur me bashkëpunu në këtë drejtim dhe këtë hapësirë me shndërru në një park të vogël. Faleminderit. Këto ishin pyetjet e mia. Ju kërkoj falje.

Kryesuesi: - faleminderit zonja Bejta, Muhamed Selmani e ka kërkuar fjalën.

Muhamet Selmani: - faleminderit kryesues, përshëndetje të gjithëve. E kam një lutje për drejtorin e Inspeksionit zotrin Brestrovci pa dashur të implikoj ose të ndikoj në zbatimin e rregulloreve dhe ligjeve që janë të ekzekutueshme ose në fuqi. Po t'kisha lutë shumë me prioritet çështjen e parkingjeve. Dje edhe pardje ka qenë një aksion i madh i inspeksionit të komunës së Prishtinës për kontrollimin parkingjeve private që është e drejtë, mirëpo mbyllja e tyre ka shkaktuar një kaosë shumë të madh në qytet. Të lutem sipas kompetencave që ke dhe autorizime ose bashkëpunim me drejtori të tjera, të shihni mundësinë që parkingjet të hapen prapë, sidomos këtë muaj kur dihet që është fluks i madh i mërgimtarëve nëpër qytet edhe fluksi që vijnë nga qytete të tjera, do të ishte mirë që të gjendet një modalitet që ato të punojnë pavarësisht se të obligohen t'i respektojnë dhe t'i plotësojnë kushtet që duhen për parkingje. Faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit zotri Selmani. Feim Osmani ka kërkuar fjalën

Feim Osman: - faleminderit kryesues, unë natyrisht së pari po filloj nga çështja që e ngrita për të marrë përgjigje herën e kaluar që na u premtuar nga drejtoresha që do të na dërgojë përgjigje me shkrim por nuk e kam marrë ende. Nuk e di nëse është në përpilim të asaj përgjigjeje apo çka ka ndodhur edhe pse ka qenë shumë e thjeshtë me na informuar çka po ndodh me dy urat në Vranidollë, shqetësim që është dalë nga banorët nga organet e Bashkësisë lokale edhe është bërë edhe mediatik nuk ka marrë përgjigje. Po dua me përsërit pyetjen që tashmë është regjistruar në seancën e kaluar dhe po pres përgjigje prapë. Besoj që kësaj here drejtoresha do të reagojë, mirëpo shtoj kësaj kam edhe një çështje tjetër e për të cilën po ashtu është reaguar dhe kam kërkesë nga banorët edhe nga Këshilli lokal në Besi. Çështja është për trajtimin e rrugicave, rrugica të cilat kanë filluar në fund të vitit 2024, pak para zgjedhjeve qendrore të vitit 2025 dhe që s'kanë përfunduar fare. Mirëpo që së fundi Drejtoria e Investimeve Kapitale ka intervenuar në një rrugë e cila jam shumë i lumtur që është pikërisht në fshatin tim, në fshatin Besi, mirëpo që edhe unë jam dëshmitar që nuk ka qenë domosdoshmërisht rruga e parë që do duhej të trajtohej. Natyrisht rrugicat ashtu siç janë paraqitur edhe si kërkesa nga organet e këshillit lokal do duhej trajtoheshin të gjitha përnjëherë sepse vlera nuk është vlerë që nuk përballohet as nga shuma që është e ndarë në buxhetin e vitit 2026. Mirë po nuk e di pse ka ndodhur që është intervenuar së pari në atë rrugë e që ajo ndoshta i ka vetëm katër ose pesë metra larg rrugës kryesore të fshatit, rrugës së “2 Prillit” që pothuajse është në buzë të rrugës së asfaltuar. Natyrisht nuk dua të paragjykoj, mirëpo dua t'a shtroj para kryetarit që edhe kësaj here po mungon, po edhe para drejtoreshës. Pse ka ndodhur ky ndryshim? Pse është trajtuar me përparësi një rrugë që është mirë, që është trajtuar, por që ndoshta do duhej të trajtohej nga fundi i listës prioritare për shkak se gjendja aty është shumë më e mirë sesa në plot rrugë e rrugica të tjera të cilat nuk po trajtohen dhe po presin në rend. Gjithashtu kam një kërkesë për të bërë pyetje, po për të bërë edhe kërkesë për intervenim në rrugën “Beqir Jakupi”. Kam qenë e kam parë, është një rrugë në fshatin Bardhosh, aty afër stacionit të autobusëve, ku kanalizimi fekal del gjatë gjithë gjatësisë së rrugës. Nuk e kam bërë kërkesë me shkrim për arsye se banorët më kanë thënë dhe më kanë dokumentuar se i janë drejtuar edhe Drejtorisë së Shërbimeve publike edhe asaj të Investimeve kapitale. Por po e bëj pyetje për të trokitur në kujtesë që mos të harrohet sepse është në gjendje jashtëzakonisht të rëndë. Ka kundërmim shumë të madh e të keq dhe është rrugë që është e dendur me banorë. Kërkoj që të intervenohet nga drejtoria përkatëse. Nuk e di cila do t'a bënte Drejtoria e Shërbimeve Publike apo ajo e investimeve

kapitale. Dhe në fund kam një kërkesë po ashtu sa për të trokitur në kujtesë për Drejtorinë e Arsimit. Me drejtorin jam takuar kështu edhe personalisht. Unë jam për bashkëpunim me të gjithë drejtorët edhe jam në gjendje të takohem për interesat e banorëve sa herë që ka nevojë me ta. E kemi diskutuar çështjen e shkollës në Besi, çështjen e projektit dhe lejes së ndërtimit. Kam kërkuar nga drejtori që ta hulumtoj ku ka ngecur për arsye se kemi pasur të zotuar mjetet nga Ministria e Arsimit. Kemi bërë kërkesë publikisht në kuvend, kërkesë me shkrim nga shkolla, kërkesë nga bashkësia lokale, por që deri tash në momentin kur po flasim nuk kemi një përgjigje e hiç se hiç s'kemi hapa të ndërmarrë për të dhënë lejen e ndërtimit apo projektin. Kërkoj nga drejtori që nëse ka informata të na sqarojë sot edhe njëherë ku ka shkuar çështja dhe a duhet të dorëzohemi në këtë drejtim dhe të kërkojmë vetëm nga komuna e Prishtinës të na ndërtojë shkollën apo ka ende shpresë se në bashkëpunim me ministrinë do të gjejmë rrugë për të ecur përpara dhe për t'a bërë një shkollë që është jashtëzakonisht e nevojshme e që komuniteti po pret që shumë vite.

Kryesuesi: -faleminderit zotri Osmani. Enver Redenica ka kërkuar fjalën

Enver Redenica: - faleminderit kryeseu zotëri Kupina. Përshëndetje drejtorë të drejtorive dhe ju kolegë asamblistë. Siç po e shihni dhe ju vetë shumë rrugë në kryeqytet janë dëmtuar rend dhe janë mbushur me gropa. Me ritmin me të cilin po punohet deri tani duket se do të duhen edhe disa vite që ato të sanohen. Po veçoj disa rrugë për të cilat janë ankuar qytetarë dhe të cilat i kam parë dhe vetë. Rruga “Ndua Prillishi” Mati 1, rruga te banesat e Tregtisë, po dhe kjo te Mati është në gjendje shumë të rëndë. Rruga nga shkolla “Sami Frashëri” në drejtim të Gërmisë si dhe në veçanti rrugët “Bislim Makolli”, “Bia UÇK” dhe “Voskopja” në Sofali ku më shumë ka gropa sesa asfalt. Për këto rrugë në Sofali është njoftuar disa herë dhe drejtoresha e Investimeve kapitale. Së fundi është njoftuar edhe zonja Pllana rreth një muaj dhe më pas edhe javën e fundit. Meqënëse gojarisht të premtuar se do të ndërmerren masa për mbylljen e këtyre gropave, deri më sot nuk ka pasur asnjë veprim konkret. Është më shqetësues fakti se në rrugën “Bia UÇK” janë hapur dy puseta pasi janë thyer shaktet e tyre. Njëra ndodhet e hapur tash e një muaj, ndërsa tjetra rreth dy javësh. Këtu mundeni me i parë dhe fotot të këtyre pusetave këto paraqesin rrezik serioz për këmbësorët dhe drejtuesit e automjeteve nuk kalon ditë pa u lënduar ndonjë qytetar apo pa u dëmtuar ndonjë veturë aty. Për këtë problem është njoftuar dhe drejtoresha zonja Pllana, siç thashë më herët përmes e-mail por nuk është ndërmarrë asnjë veprim. Kjo është e papranueshme dhe tregon pabërgjegjësi nga komuna, në veçanti nga Drejtoria e Investimeve Kapitale e cila sot nuk qenka këtu dhe Drejtoria e Sigurisë të cilat kanë obligim të jenë në shërbim të qytetarëve sidomos kur rrezikohet siguria dhe jeta e tyre. Pra ju lutem të ndërmerrni masa para se të ndodhë ndonjë fatkeqësi e më pastaj jo të kërkojnë arsytme të kota. Një çështje tjetër është bllokimi i rrugëve pikërisht në periudhën kur mërgimtarët vijnë në Kosovë. A nuk ka mundësi bre që këto punime të fillojnë më herët ose shtyhen pak më vonë? Pse nuk realizohen gjatë vikendeve ose gjatë natës kur qarkullimi është shumë më i vogël? E kam fjalën për rrugën te Xhamia e Llapit, arterin kryesore që lidhë Podujevën me Prishtinën si dhe rrugën për Grashticë. Qytetarët po presin shumë gjatë në kolona, sidomos tani kur mërgimtarët po vijnë në atdhe. Është e vështirë të kuptohet se pse nuk planifikohen këto më mirë këto punime në mënyrë që të mos u shkaktohen kaq shumë vështirësi

qytetarëve e veç mbas mërgimtarëve më pas nuk e di drejtori i Shërbimeve Publike nuk qenka këtu. Deri tani s'kam pas një rrugë në Prishtinë që është pastruar nga uji. Prishtinën përpos që e ka mbuluar berllugu e ka mbuluar papastërtia. Nuk mbaj mend ndonjë vit që ka ndodhur që Prishtina mos të lahen rrugët e Prishtinës. Mendoj që mjete ka mjaft vetëm nuk ka vullnet. Jeni të zgjedhur këtu nga qytetarët e Prishtinës për me ju shërbyer, jo vetëm për me marrë paga edhe me bë filma siç po bën Përparim Rama në ujrat e zeza që përmendi ai kolega. Faleminderit. Në Tokëbashqe të cilat nuk kanë probleme aty që nuk po mund me i rregulluar, por problemi qëllon pikërisht te karrika Përparim Ramës aty ku është ulur edhe shtëpiave të cilat i kanë ndërtuar në tokë publike mbi shkollën Normale edhe ujërat e zeza i kanë derdhë në atë procken që është rregulluar, domethënë është një problem shumë më i madh që më së pari mendoj që ka punë prokuroria dhe gjyqësia e më pastaj të rregullohet kanalizimi fekal. Faleminderit shumë.

Kryesuesi: - faleminderit zotri Redenica, Besart Krasniqi ka kërkuar fjalën.

Besart Krasniqi: - faleminderit të gjithëve, përshëndetje. Unë i kam 16 kërkesa, ankesa që më kanë adresuar nga lagjet e ndryshme të kryeqytetit. Po fillojmë lagjen Kodra e Trimave për shkak problemet janë më të theksuar dhe vazhdimisht nuk po gjen zgjidhje nga drejtoritë përkatëse. Banorët e rrugës “Naser Krasniqi”, “Sarbi Gordo”, “Arena Thaqi”, “Daniel Defo”, “Besnik Lajqi”, “Iset Maloku” dhe disa rrugë të tjera në lagjen Kodra e Trimave ankohen për mungesën e ndriçimit publik. Sipas tyre në këto rrugë nuk janë as instaluar fare shtyllat dhe poçat e ndriçimit. Është në plan të komunës zgjidhja e këtij problemi dhe kur pritët të realizohet. Kurse banorët e rrugës “Nexhmi Llumica” dhe rrugicat përreth në Kodrën e Trimave thonë se rrugët janë dëmtuara shumë dhe ka shumë gropa dhe kanë nevojë për sanim. Po ashtu në rrugën “Nexhmin Llumica” kanë probleme me kanalizim ku një shi me ra krejt uji shfaqet mbi rrugë, ku po paraqet problem për banorët dhe veturat e tyre. Po ashtu në këtë rrugë dhe rrugica përreth ankohen se kanë problem edhe me ujë të pijshëm, ku kanë disa orë gjatë ditës kanë reduktime dhe për këto probleme banorët këtu mund të bëhet një zgjidhje e shpejtë. Po ashtu në rrugën “Hakif Sheholli” në Kodrën e Trimave e cila është nën urë ankohen në lidhje me mbeturinat qent endacak që po paraqet problem për banorët, dhe normal që ata kërkojnë të ndërhyjnë në organet komunale. Në oborrin e xhamisë së qarshisë ndodhen dy plepa shumë të gjatë. Edhe pse i japi hjeshti dhe zbukurojnë ambientin për shkak të lartësisë së tyre tashmë kanë nevojë për krasitje dhe me qëllim të mirëmbajtjes dhe sigurisë për besimtarët që falen. Po ashtu qytetarët që kalojnë në atë pjesë dhe e ruajtës një ndër xhamive më të vjetra në Prishtinë. I njëjti problem është edhe në lisat ose plepat mund me i quajti në Dardani, në rrugën kryesore po kërkesa për krasitje thuajse është e nevojshme në shumë pjesë të kryeqytetit. Po ashtu banorët e lagjes Tophane kërkojnë të bëhet rregullimi i rrugëve “Mahir Domi” “Vatra” edhe rrugë e të tjera të kësaj lagje këtu përballë komunës së Prishtinës. Në rrugën “Meto Bajraktari” kanë qenë të vendosur disa kontejnerë prej hudhjes së mbeturinave tash në një muaj janë larguar banorët e biznesitve në kohë se nuk kanë ku t'i hudhin mbeturinat, andaj kërkojnë të bëhet një vend i përshtatshëm për hudhjen e mbeturinave. Në lagjen Kolovica kërkojnë të bëhet rregullimi i rrugës “Shkëlzen Haradinaj”, “Osomit” dhe rrugëve dhe rrugicave të tjera që janë të dëmtuara në këtë lagje. Kurse rrugët “Shkëlzen Haradinaj”, “Osomi” dhe “Xheladin Kurtaj” nuk ka ndriçim fare. Rruga “Irir Konushevc” është mbyllur më shumë se një javë, por deri më tani shumë pak është duke punuar, e në njërin anë po dëmtohen bizneset, kurse në anën tjetër po krijohen kolona të gjata. A ka ndonjë afat kohor se kur do të përfundojë kjo rrugë? Tash pyetja e radhës është për drejtorin e arsimit. Punëtorët teknik në shkollat e Prishtinës kanë hyrë në grevë. Ata bëjnë të ditur se prej muajit qershor deri më tani nuk kanë marrë paga. Fjala është drejtor për 200 punëtorë teknik. Këtë problem këta janë tu ballafaquar. Tash mundem me thënë

dy vite kur do të bëhet një zgjidhje për ta punëtor ku vazhdimisht ju vonohen pagat. E banorët e rrugës së Stokholmit në lagje Mati 1 ankohen se rruga është dëmtuar rënd, shkakton vështirësi në qarkullimin e përditshëm. A është paraparë sanimi i kësaj rruge dhe cili është afati për ndërhyrje? Pyetja tjetër vjen nga banorët e Kalabrisë, ata janë të interesuar me ditë se a do të hapet në shtator shkolla fillore në lagjen Kalabria. Banorët e lagjes Arbëria veçanërisht në rrugën “Kosturi” shprehen shqetësimin për numrin e madh të qenëve endacak, si dhe mungesën e ndriçimit në këtë pjesë e duke qenë se problemi me qen endacak është i pranishëm pothuajse në të gjitha lagjet e Prishtinës. Cilat janë masat konkrete që komuna e Prishtinës po ndërmerr për të trajtuar këtë çështje që po rrezikon qytetarët e Prishtinës. Banorët e lagjes Prroi i Njelmët kërkojnë asfaltimin e rrugës “Tomas More” pasi që për momentin është vetëm në zhavor e banorët e Grashticës së Epërme në rrugën “Pellazët” kërkojnë të rregullohet trotari i cili është dëmtuar dhe po paraqet problem për banorët. E në rrugën Koliq - Sharban kërkojnë të bëhet rregullimi i rrugës që është bërë me gropa. Po ashtu kërkojnë të bëhet krositja e listave që janë afër rrugës pasi që po paraqesin problem për vozitësit. Pyetja e fundit, ka të bëjë se kur do të vjen në votim në kuvend për votim emërimi i rrugëve në kryeqytet pasi që qytetarët ankohen se po paraqet problem për ta, sidomos në lidhje me dokumentacionet, e ata i vyjnë për komunë ose për zgjedhje të tjera.

Kryesuesi: - faleminderit shumë, zotri Krasniqi, Nexhmie Gjema ka kërkuar fjalën.

Nexhmije Gjema: - faleminderit, fjalën po e filloj me dyshimet për punësime familjare, politike dhe pazare me vende pune. Kemi pranuar një sinjalizim anonim të dërguar edhe te kryetari, te kryesuesi i Kuvendit, organet e drejtësisë, agjencia për parandalimin e korrupsionit dhe mediat. Në të gjithë e dimë se paraqiten emra konkrete me pretendime për punësime familjare politike në komunën e Prishtinës, Trafikun Urban, Termokosin, Prishtina Parking dhe ndërmarrje të tjera komunale. Krahas këtij sinjalizimi në emisionin Debat Plus është publikuar dhe një audio inçizim ku pretendohet se dëgjohej zyrtari komunal Gentrit Syla duke i kërkuar nënshkrimin e një delegati tjetër të LDK-së në këmbim të punësimit të gruas së tij. Në vazhdim të bisedës përmendën edhe Egzon Pacolli, shëf i grupit të asamblesëve të LDK-së, i cili sipas inçizimit konfirmon se do t'a mbajë fjalën e kështu me radhë. Nuk po i paraqesim këto pretendime si shkelje të dëshmuar, por kur kemi emra specifikë, konkret, lidhje familjare, të pretendu dhe audio inçizime ku vendet e punës përmenden si këmbim për nënshkrime, heshtja nuk është e mirëseardhur. Kërkohej verifikimi institucionale dhe një transparencë e plotë. Prandaj pyetjet e mia janë këto. A e keni pranuar ju si dhe kryetari që nuk është kurrë këtu sinjalizimin e datës 22 korrik të vitit 2026, dhe a ka nisur verifikimi i pretendimeve për punësime familjare dhe politike. A janë autentike audio inçizimet e publikuara dhe a pranojnë personat e përmendur se e kanë zhvilluar bisedën? Për cilin institucion, pozitë dhe konkurs është negociuar punësimi i gruas së delegatit? A është realizuar ose tentuar ky punësim? A janë të sakta këto pozita dhe lidhje familjare të paraqitura në sinjalizim? Sepse këto përfshihen thuajse me familjarë, me vajza, djem, gratë e djemëve, nuse, shoqe, kunata, teze. Diçka është më duket sikur aq abstrakte saqë po simbolizon sikur nëpër do filma të viteve 30 në Amerikë. A është nisur ndonjë procedurë verifikimi ose disiplinore dhe a do u dorëzohen sinjalizimi, inçizimet dhe dosjet përkatëse organeve kompetente për hetim? A do t'i dorëzojë komuna e

Kuvendit dhe agjencisë për parandalimin e korrupsionit dokumentacionin e plotë të këtyre procedurave? Përfshi konkurset, raportet e vlerësimit, procesverbalet dhe vendimet përfundimtare. Nëse punësimet kanë qenë të ligjshme në të gjitha këto ndërmarrje si dhe në komunë duhemi t'i kemi këto konfirmime të kuptojmë se a janë meritore, a publikohen, domethënë a është bërë ndonjë konflikt interesi, pazare me vende pune, duhet të kemi përgjegjësi secili prej neve. Andaj besoj se i mirëpresim këto informata dhe dokumentime nga ju dhe kërkojmë që të na dërgoni me e-mail. E dyta, në seancën e kaluar kam te Kuleta Digjitale dhe mbrojtja e të dhënave personale kam shtruar pyetjen lidhur me sqarimin për përpunimin e të dhënave personale gjatë regjistrimit në kuletën digjitale. Më është premtuar përgjigje, por deri më sot nuk kam pranuar. Dhe numër dy janë biletat, kosto e biletave online. Dallimi prej atyre që përmbajnë një besoj se biletat online të cilat shiten më lirë sesa ato manuale përbën jo vetëm një trajtim të pabarabartë ndaj të moshuarve, personave pa telefon të mençur dhe qytetarëve që nuk dëshirojnë t'i japin të dhënat e veta personale një kompanie private. Gjithashtu kemi kërku të dimë se kush është kjo kompani private e cila i mbledh të dhënat tona personale dhe në bazë të cilit ligj komuna e ka obliguar që kjo kompani private t'i mbledhë të dhënat tona. Ju faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit zonja Gjema, Lumnije Mikullovcit ka kërkuar fjalën.

Lumnije Mikullovcit: - faleminderit për fjalën, pyetja ime sot është raporti gjashtë mujor i Drejtorisë së Turizmit dhe Parqeve. Presim përgjigje, pres përgjigje të qartë për punën dhe realizimin. Kërkojmë të dimë cilat projekte të planifikuara janë përfunduar dhe sa është përqindja e realizuar, realizimit të tyre, sa është niveli i shpenzimit të buxhetit, në cilën projekt janë investuar mjetet publike? Çfarë është bërë konkretisht për zhvillimin e turizmit në Prishtinë dhe promovimi i trashëgimisë kulturore e natyrore, cilat parqe dhe hapësira të gjelbërta janë rehabilituar, mirëmbajtur ose krijuar gjatë kësaj periudhe. Çfarë masa janë ndërmarrë për mirëmbajtjen e investuara, inventarit urban? Pastërtinë, ndriqimin dhe sigurinë në parqe? Cilat janë arsyet e mosrealizimit të projekteve të paparara dhe kush mbanë përgjegjësi për vonesë? Qytetarët e Prishtinës nuk presin raport me statistika, por rezultate konkrete në terren. Prandaj raporti gjashtë mujor duhet të reflektojë punën reale, transparencën në shpenzimet e parasë publike dhe përgjegjësisë institucionale për çdo premtim të paralizuar. Si kuvend komunal kemi obligim të kërkojmë llogaridhënie dhe të sigurohem në çdo euro të taksapaguesit të kthehen në shërbim dhe projekt për përmirësimin e jetës në qytet. Gjithashtu qytetarët përballen çdo ditë me mungesë të mirëmbajtjeve me shumë parqe, me inventar urban të dëmtuar, ndriçim të pamjaftueshëm, gjelbërim të paprerë ose të tharë dhe mungesa të kujdesit institucional. Këto nuk janë vetëm çështje estetike, por ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës dhe sigurinë publike. Prandaj kërkoj që drejtoria të japë llogari jo vetëm për fondet e shpenzuara, por edhe për realizimin e arriturave. Sfida e përgjegjësisë për vonesën dhe planin konkret për gjashtë mujorin e dytë. Qytetarët e Prishtinës meritojnë më shumë se premtim. Ata meritojnë punë të dukshme, transparencë dhe menaxhim të përgjithshëm të pasurisë publike pyetje për kryetarin i cili karrika është bosh për qytetarë e Prishtinës është një zhgënim i madh ata që të sollën në pushtet dhe vazhdojnë të të mbështesin, e bënë këtë për interes politike biznesore apo kishe besimin e shumicës së qytetarëve. Sot Prishtina po përballlet çdo ditë me kolona të gjata bllokim trafikut dhe një qytet të lodhur e të revoltuar. Durimi ka kufij banorët e Kodrës së Trimave kanë durim mjaft. Mungesë të ujit të pijshëm, rrugë me gropa, mungesa

sinjalizimit, ndriçim të mjaftueshëm dhe trotuare të papërfunduara. Mbeturinat kanë kapluar tërë Prishtinën. Këto janë problemet themelore që nuk mund të anashkalohen. Tani ngushtimi i rrugës për një kurs të Xhamia Llapit është kulmi i torturave që përballohen sot qytetarët së bashku me trafikun urban. Kryetar, qytetarët kanë filluar të shprehinë pakënaqësinë e tyre dhe askush nuk duhet të harrohet se vota është gjykimi më i drejtë për çdo qeverisje. Mos na detyroni të dalim rrugëve duke protestuar boll durimit i vjen fundi që pesë vite.

Kryesuesi: - ju faleminderit shumë, faleminderit zonja Mikullovc. Rifadije Sopi ka kërkuar fjalën.

Rifadije Sopi: - faleminderit kryesues, të nderuar kolegë unë do të vazhdoj kështu me bartjen e kërkesave të qytetarëve të cilat janë adresuar në formë të ndryshme tek unë. Fillimisht, mirëpo lëvizi drejtori i arsimit, desha atij t'i drejtohem rreth pyetjes se kur do të hapet kopshti në Kolovicë pasi që një numër i madh i prindërve më janë drejtuar si rrjedhojë se ata kanë dorëzuar dokumentet në dy kopshtet publike në çerdhën “Yllkat” dhe “Buzëqeshja”. Andaj ka nevojë besoj që për njoftim të duhur në afat kur ata presin t'i dërgojnë fëmijët e tyre në kopshtin e ri në lagjen Kolovica. Çështja tjetër që prapë i adresohet drejtorit të arsimit, një ekupe e mësimdhënësve si rrjedhojë angazhimeve të ndryshme nuk kanë arritur të jenë në diskutimin publik që është mbajtur për çështjen e arsimit janë të gatshëm dhe deklarohen se dëshirojnë në formë vullnetare të bashkëpunojnë me Drejtorinë e Arsimit me qëllim mirëorganizimit, planifikimit dhe të funksionalizimit të mësimi gjithëditor në shkollat të tjera. Gjithashtu pasi që u bë temë diskutimi që disa herë çështja e propozimit të emrave të rrugëve po shihet që në seancën e radhës do të merremi me këtë çështje edhe unë i kam disa propozime për emrat e rrugëve të cilat me janë adresuar. Njëra ka të bëjë për fshatin Teneshdöll, për rrugën “Ahmet Rexhepi”. Kërkojnë të emërohet kjo rrugë, domethënë propozim për emërimin e rrugës dhe “Shefki Rrahmani” në lagjen e cila gjithashtu kërkon që të shtrohet dhe të bëhet asfaltimi i kësaj rrugice konkretisht tek familjet Rrahmani, propozim tjetër është për fshatin Prapashticë të propozohet emri i rrugës për zotëri të ndjerit tashmë Ragip Nuredini për të cilën e propozoj edhe Kushtrimi, tjetër çështje që kam për të diskutuar drejtuar Drejtorisë së Mobilitetit që të cilën e falenderoj Zotrin Pllumbin për bashkëpunimin deritanishëm është për kërkesë e banorëve të lagjes për funksionimin e duhur të linjës S27 dhe vendosjen e pritores në fillim të rrugës Tokëbashqe afër bibliotekës Hivzi Sylejmani, një çështje tjetër që kërkohet kishim dashur të di a është në plan intervenim rruga kryesore “Holger Petersen” në lagjen e spitalit konkretisht rruga “Kadri Bajri” është vështirë e kalueshme mos themi e pakalueshme në tërësi, këto janë kërkesat prej anës time.

Kryesuesi: - faleminderit zonja Sopi, Gëzimi ka kërkuar fjalën.

Gëzim Sveçla: - faleminderit, unë e kam një shqetësim e ngrit në formë të pyetjes, po meqë asnjë prej zyrtarëve të lartë të komunës, as kryetari as të dy nënkryetarët nuk janë të pranishëm. Megjithatë po i ndjej për obligim që t'i njoftoj kolegët asamblistë për çështjen dhe të kërkoj

nga ata që bashkërisht të ngrisin zërin për këtë çështje që është mjaft e rëndësishme, ka të bëjë me Ndërmarrjen Publike Termokos. Unë edhe përmes rrjeteve sociale e kam ngritur si shqetësim në javën e kaluar. Bëhet fjalë për një letër që banka zhvillimore gjermane e ka drejtuar te bordi i ndërmarrjes Termokos, ku u shpreh pakënaqësinë e vet me keqmenaxhimin që ndodh në këtë ndërmarrje dhe paralajmëron mundësinë e tërheqjes nga projekti për zgjerimin e ngrohjes qendrore në kryeqytet. Me të vërtetë kjo është alarmuese dhe është obligimi ynë i të gjithëve sepse në fund të fundit unë nuk pres diçka nga ky ekzekutiv që ka me ndërmarrë. Po kuvendi komunal është edhe aksionar i ndërmarrjes. Prandaj ne të gjithë duhet të bëhemi bashkë që ta shpëtojmë këtë ndërmarrje dhe e njëjta mos ta ketë fatin e Pastrimit e Sport marketingut, ndërmarrje të tjera që kanë probleme edhe me paga. Termokosi është ndërmarrja më profitabile në komunën e Prishtinës, dhe nëse rrezikohet ky projekt konkretisht nëse kërcënimi ose paralajmërimi që ka bërë banka gjermane zbatohet në praktikë, atëherë një prej projekteve më të rëndësishme që ka të bëjë me qytetin, zgjerimi i ngrohjes qendrore, rrezikohet tërësisht ose më mirë të themi edhe mund të dështojë. Prandaj ju ftoj të gjithëve që me ndikimin që e keni te subjektet e juaja, sidomos dy partitë, tre partitë, katër partitë të cilat qeverisin, të gjithë ju të tjerët që qeverisni, pesë parti, që me shfrytëzu autoritetin që e keni që të ndërmerren hapa dhe të shpëtohet një prej projekteve kryesore të kryeqytetit. I cili nuk ka të bëjë vetëm me ngrohjen, po natyrisht që ka të bëjë edhe me politika të gjelbra edhe me zhvillim të qytetit edhe me vende të punës edhe me gjenerim të mjeteve materiale. Prandaj kërkoj nga asamblistët e subjekteve të cilat qeverisin me Prishtinën që ta ngrisin zërin e tyre në mbrojtje të pasurisë publike të qytetit të Prishtinës, kaq kisha.

Kryesuesi: - faleminderit, zonja Berita Abazi ka kërku fjalën.

Berita Abazi: - faleminderit kryesues, unë përmes emailit të martën ju kam drejtuar drejtorit Agron edhe Bekim në lidhje me ndërtimet në rrugën “Yllka Domi” në Arbëri. Aty një rrugë është bllokuar për qarkullim edhe është duke u ndërtuar një shtëpi. Ka edhe ndërtime të tjera që kanë ndodhur më herët, por aktualisht po vazhdon të ndërtohet një shtëpi. Për këtë kam kërkuar informacione se a ka leje dhe si është marrë ajo leje, kam marrë një përgjigje nga Drejtoria e Urbanizmit ku jam njoftuar se nuk ka leje as aplikim për leje ndërtimore dhe as leje ndërtimore për këtë, për atë objekt. Por në anën tjetër aty po vazhdon të ndërtohet dhe nuk kam asnjë komunikim, asnjë njoftim nga Drejtoria e Inspeksionit nëse kanë dalë edhe janë duke u marrë me këtë rast sepse po punohet me intensitet të lartë edhe shtëpia është thuajse në përfundim. Kështu që kisha dashur nga drejtori i inspeksionit një përgjigje për këtë. Ndërsa sa i përket po ashtu hapësirës publike në rrugën “Ahmet Dërguti” po ashtu në lagjen Arbëria aty një market po e shfrytëzon hapësirën e rrugës dhe të trotuarit për parking privat. Edhe për këtë ka marrë përgjigje nga Drejtoria e Urbanizmit që nuk ka një leje dhe nuk është në domenin e tyre që me jap leje të tilla. Në këtë drejtim po ashtu du me dit prej inspeksionit se a ka dalë në terren, e ka edhe atë parking privat që po shfrytëzohet trotuari për parking të kerreve duke vështirësuar qarkullimin e qytetarëve në atë zonë dhe a do të veprojë inspeksioni?

Kryesuesi: - faleminderit zonja Abazi, Leonora Shabani ka kërkuar fjalën.

Leonora Shabani: - faleminderit kryesues, unë kam pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike. Po gjithashtu edhe kushdo që e sheh që është e nevojshme të përgjigje nuk ndryshon diçka. Në rrugën “Papa Gjon Pali” në Matigan në shtyllë është anuar rrezikshëm mbi rrugë. Duke rrezikuar këmbësorët, automjetet dhe banorët e zonës. Gjithashtu kjo rrugë “Papa Gjon Pali” nuk ka dhe trotuar. Gjithashtu në rrugën “Stambolli” afër KFOR-it disa shakta gjenden të hapura ose të dëmtuara prej muajsh. Për këto nuk janë raste të vetme. Shembuj të tillë hasen gjithandej nëpër Prishtinë. Pyetjet e mia janë këto, kur do të largohet ose sigurohet shtylla e anuar në rrugën “Papa Gjon Pali” edhe pse nuk është ndërhyer deri tash? Kush është përgjegjës për shaktat e hapura në rrugën “Stambolli” dhe kur do të sanohen ato? A ka komuna evidencë të plotë të shtyllave, kapakëve të shaktave dhe të dëmtuara në territorin e Prishtinës? Sa raste të tilla janë raportuar gjatë këtij viti, sa janë sanuar dhe sa vazhdojnë me përbërë rrezik për qytetarët, se siç e dimë gati çdo ditë ne hasim tek qytetarët ku aksidentalisht janë viktimat të këtyre shaktave të pamirëmbajtura. Gjithashtu, a do të zhvillohet një inspektim urgjent në krejt kryeqytetin dhe të përcaktohet afat konkret për eliminimin e këtyre rreziqeve, ju faleminderit.

Kryesuesi : - faleminderit zonja Shabani, fjalën e ka zotri Redenica

Enver Redenica: - faleminderit kryesues, po e ngriti një shqetësim nga banorët e kryeqytetit tonë e që unë kam obligim ta përcjell në këtë kuvend si zëri i tyre. Motoçikletat apo motorrat me zhurmë të madhe janë kthyer në një problem serioz, sidomos gjatë orëve të mbrëmjes dhe të natës. Banorët ankohen se kjo zhurmë po i tremb fëmijët, po shkakton shqetësim grave shtatzëna dhe po ua vështireson jetën personave me probleme shëndetësore dhe të moshuarve. Nuk është normale që një numër relativisht i vogël motorrësh të mbajnë peng qetësinë e mijëra të qytetarëve në kryeqytet. Prandaj kërkoj nga Drejtoria e Sigurisë që të instalohen mac inteligjent të zhurmës në pikat më problematike në kryeqytet, të identifikohen automjetet dhe motorrat që tejkalojnë kufirin e lejuarve të decibaleve, të bashkëpunohet me policinë e Kosovës për shqiptimin e gjobave dhe largimin nga qarkullimi i automjeteve me modifikime të paligjshme. Duke kuptuar që qytetarët nuk po kërkojnë privilegje, ata po kërkojnë diçka elementare të kenë qetësi dhe siguri në kryeqytetin tonë. Besoj se po të merren këto masat e duhura, në njërën anë krijohet qetësi dhe siguri për qytetarët dhe në anën tjetër demotivohen të tjerët që janë më të rinj për të vazhduar këtë dukuri. Faleminderit dhe pres reflektim nga drejtori i sigurisë.

Kryesuesi: - faleminderit zoti Redenica. Dëshiron dikush fjalën? Jo. Kalojmë edhe në pikën e fundit të ndryshme. S'ka kurrëgjë. Paskemi të ndryshme. Hajde Rifadije. Për herë të parë ka kërkuar fjalën dikush. Pika të ndryshme.

Rifadije Sopi: - për herë të parë edhe më të rëndësishmen, po besoj edhe mos të jetë e fundit. Unë edhe në fillim e diskutova dhe thashë mos po shkojmë për atë arsye, se e dita që nuk mundet me hy në rend të ditës me pika të rendit të ditës. Por tash mbasi janë këtu kolegë thash t'ja u bëjë me dije që kam me fol diçka te të ndryshmet. Unë e kam për qëllim njoftimin mbi punëtorinë, stimulimi i asamblesë së qytetarëve, të cilën nga data 21 deri më 23 korrik 2026 patëm mundësi bashkë me ekipen prej komunës së Prishtinës të marrim pjesë në punëtorinë stimulimi i asamblesë së qytetarëve, të organizuar nga Këshilli i Evropës në bashkëpunim me asociacionin e komunave të Kosovës dhe Ministrinë e Administrimit të pushtetit lokal. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të komunave të ndryshme të Kosovës me qëllim të njohjes dhe stimulimit praktik të modelit të asamblesë së qytetarëve si një mekanizëm i

demokracisë deliberative. Gjatë punëtorisë janë trajtuar mënyrat e organizimit të asamblesë së qytetarëve, financimi i tyre, procesi i hartimit dhe trajtimit i rekomandimeve, roli i kuvendit komunal si dhe nevoja për krijimin e një baze ligjore që do të mund të mundësonte institucionalizimin e këtij mekanizmi në komunat e Kosovës. Po ashtu u prezantuan praktikat evropiane dhe mbështetje që Këshilli i Evropës do t'u ofrojë komunave gjatë fazës së pilotimit dhe zbatimit. Për komunën tone kjo përvojë paraqet një mundësi të mirë për të shqyrtuar zbatimin e këtij modeli e cila rrit pjesëmarrjen qytetare, transparencën dhe cilësinë e vendimmarrjes. Rekomandojmë bashkë me ekipën të cilën realisht e kanë pranuar edhe kabineti i kryetarit një email organizimin e një pilot projekti përgatitjen e akteve komunale në përputhje me kornizën e ardhshme ligjore forcimi i bashkëpunimit me partneritet institucional dhe planifikimi i mjeteve financiare për zhvillimin e proceseve deliberative. Kemi si propozim që organizimi i asamblesë qytetare kërkon vullnet, dihet që kërkon vullnet politik, resurse humane, kohë dhe financa dhe ajo nga çka u ligjërua e kuptuam se procesi merr kohë rreth tre vite dhe kërkon resurse humane. Kjo pjesa e financimit besoj që mund të gjejë forma të ndryshme dhe mundësi sikurse që kanë zbatuar në praktika të tjera ajo e Sarajevës që u përmend në punëtori. Ndërsa për ne si asambleiste bashkë me kolegën Fjolla që kemi pasur bashkë me Vebiun, zonjën Aishe e cila sot nuk është këtu por zyrtarja tregon që modeli për qytetari janë të përfshirë aktivisht në propozim dhe zgjidhje me një apo më shumë problemeve. Prishtina duhet të jetë model për Ballkanin, dhe në fund pa dashur ta harroj desha të falenderoj ekipën e vozitësve nga komuna e Prishtinës, që në kushte aspak të favorshme klimatike na e mundësuan transportin e sigurtë dhe qasjen tejet profesionale dhe njerëzore, dhe besoj që mekanizmi të cilin e përmenda më lart do të mund të shërbejë si një urë e fortë ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve tona duke u bërë vendimmarrje lokale dhe gjithëpërfshirëse më të besueshme. Faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit zonja Sopi. Nexhmie Gjema ka kërkuar fjalën.

Nexhmije Gjema: - faleminderit, jeta e natës në Prishtinë. Çka po ndodh sot? Sidomos në sezonin kur kemi vizitorë, turistë, mërgatë edhe është zona më e preferuar për të gjithë ata që dojnë me ardhë në Kosovë. Prishtina është kryeqyteti i Kosovës, por kam frikë se jeta e saj e natës po përfundon pothuajse dy orë para se me ra terri. Në qytete që funksionojnë si duhet, nata zhvillohet si një zinxhir, puna, palestra, darka, teatri, koncerti e më pastaj lokalet edhe muzika. Kur gjithçka mbyllet në ora 11 të natës, qytetari detyrimisht ka me zgjedhur darkën, kulturën ose daljen. Të tria bashkë nuk mundet me i përjetuar. Kështu që kufizimi i njëjtë për të gjitha lokalet që nuk e ka zvogëluar domosdoshmërisht zhurmën për të cilën gjithëherë brengosemi. Krejt njerëzit dalin të njëjtën kohë sepse e dinë që lokalet kanë me u mbyll 11. Ato mbingarkohen, trafiku dhe parkingjet bllokohen, ndërsa në ora 11 qindra qytetarë, mos me thënë mijëra nxirren për menjëherë në rrugë. Muzika ndalen, po zhurma bartet prej lokaleve në dritaret e banorëve. Në të njëjtën kohë po dëmtohet gastronomia, kultura, transporti, turizmi edhe ekonomia e natës. Turisti që del pas darke e gjen kryeqytetin të fikun, të vdekur mos me thënë pikërisht në kohën kur kishte mujt me dalë edhe me shpenzu një kohë të mirë me miq edhe me mysafirë. Prandaj pyetjet e mia janë këto. A ka komuna ndonjë strategji konkrete për zhvillimin edhe menaxhimin e jetës së natës në Prishtinë apo politika e vetme është mbyllja e lokaleve në orën 11? A ka analizuar komuna faktin se kjo mbyllje e lokaleve në të njëjtin minutë i nxjerr qindra siç e potencova, qytetarë e vizitorë në rrugë dhe shumfishojnë zhurmën në vend se ta zvogëlojnë? Pse nuk përcaktohen orare edhe zona të ndryshme që është shumë e logjikshme varësisht prej lokacioneve, izolimit akustik dhe llojit të aktiviteteve në vend se ta kufizojë orën për të gjitha lokalet. A ka komuna të dhëna sesa të hyra dhe vende pune gjithashtu janë humbur për shkak të kufizimit të këtij orari dhe sa ka ndikuar kjo në ofertën turistike të kryeqytetit. Gjithashtu a do të hapet debat publik me banorët, gastronomët, artistët, operatorët

turistikë dhe ekspertët për një model që do e kishte mbrojt qetësinë e qytetarëve të njëjtën kohë pa e mbytur jetën e natës. Edhe në anën tjetër ndoshta nuk ndërlidhet me jetën e qytetit të natës në Prishtinë, por po brengosimi tmerrësisht lidhur me punishtet që po bëhen në sheshin e kryeqytetit, por jo vetëm, gjithashtu po ndodhen në çdo punishte tjetër që nuk po përkujdesen për qytetarët, për kalimtarët e rastit thojë se është qesharake mbrojtjet që po vendosen aty, sepse çdo moment po vërejmë që po e rrezikojnë siç e përmendën edhe kolegët, po e rrezikojnë jetën e qytetarëve. Gjithashtu po më vjen shumë keq që Besa e shtroi propozimin e temës për të folur për sigurinë e punishtve edhe që nuk është këtu sepse ka qenë një temë shumë e domosdoshme, e mirëpritur për të diskutuar të gjithë ne. Nuk e di a do e vazhdojmë pabesën apo çfarë do propozoni ju kryesues. Faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit zonja Gjema, dikush tjetër ka ndonjë pyetje? Nuk ka. Atëherë me kaq konstatoj të mbyllur punimet e mbledhjes së pestë. Nuk ka. Konstatoj të mbyllur këtë mbledhje. Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrje, angazhim dhe diskutim. Mirupafshim në mbledhjen e radhës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of
Kosovo

**Kryeqyteti i Republikës së
Kosovës – Prishtina**
Glavni grad Republike Kosovo –
Priština
Capital City of the Republic of
Kosovo – Prishtina



**RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORËS PËR
TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE NR. 01.NR.110-2782, DT.02.12.2011**

Prishtinë, 2026

PËRMBAJTJA

Përmbajtja

PËRMBAJTJA	2
KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....	3
KAPITULLI II - LICENCA SEKTORIALE, LEJA KOMUNALE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË AFARISTE DHE LEJE PËR SHËRBIME PROFESIONALE	6
KAPITULLI III - TARIFAT PËR LËSHIMIN E DOKUMENTACIONIT	8
KAPITULLI IV - TAKSA KOMUNALE PËR LEJEN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË AFARISTE DHE LEJEN PËR SHËRBIME PROFSIONALE	8
KAPITULLI V - TAKSA E AKOMODIMIT	11
KAPITULLI VI - ZONA E TRAFIKUT TË KUFIZUAR (ZTL).....	13
KAPITULLI VII - MBIKËQYRJA, PROCEDURA DHE ARKËTIMI I DETYRUESHËM	16
KAPITULLI VIII - DISPOZITAT SHFUQIZUESE DHE KALIMTARE.....	20
SHTOJCA 1 - TABELA E KATEGORIVE DHE TARIFAVE SIPAS KODEVE NACE.....	22
SHTOJCA 2 – TARIFAT DHE NGARKESAT TJERA ADMINISTRATIVE	33
SHTOJCA 3 – TAKSA PËR AUTOMJETET MOTORIKE	34
SHTOJCA 4 – Tarifat për shfrytëzim afatshkurtër të hapësirës publike	35
SHTOJCA 5 – Tarifat për reklama	37
SHTOJCA 6 – ZONA E KUFIZUAR E TRAFIKUT	39
SHTOJCA 7 – TARIFAT DITORE TË ZTL-së SIPAS KATEGORISË SË AUTOMJETIT	40
SHTOJCA 8 – PARAMETRAT, METODOLOGJIA E MODELIT A–G DHE REZULTATET SIPAS METODOLOGJISË	41

Në mbështetje të nenit 12, paragrafit 12.2, shkronja c), dhe nenit 40, paragrafit 40.2, shkronja a), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale; neneve 3, 8 dhe 10 deri 17, si dhe neneve 20 dhe 21, të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, me ndryshimet dhe plotësimet e tij; Ligjit nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën; neneve 42 dhe 43 të Ligjit nr. 08/L-074 për Turizmin; dispozitave përkatëse të Ligjit nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor; Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative; Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje; Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; si dhe nenit 34, paragrafit 34.1, shkronja c), të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më _____, miraton:

**RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORËS
PËR TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE NR. 01.nr.110-2782, DT.
02.12.2011**

KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo Rregullore përcakton llojin, bazën, lartësinë dhe mënyrën e administrimit të taksave, tarifave, ngarkesave dhe gjobave komunale që paguhen nga personat fizikë dhe juridikë për:
 - 1.1. shërbimet komunale, lëshimin e dokumenteve publike, përpilimin e shkresave dhe ofrimin e shërbimeve profesionale, sipas kërkesës së palës ose sipas detyrës zyrtare;
 - 1.2. ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe ofrimin e shërbimeve profesionale;
 - 1.3. pronësinë dhe përdorimin e automjeteve motorike;
 - 1.4. dhënien në përdorim ose shfrytëzim të pronës komunale dhe të hyrat nga qiradhënia;
 - 1.5. shfrytëzimin e burimeve natyrore;
 - 1.6. shërbimet dhe bashkëpagesat komunale në arsim dhe shëndetësi;
 - 1.7. taksën e akomodimit;
 - 1.8. hyrjen dhe qarkullimin e automjeteve në Zonën e Trafikut të Kufizuar; dhe
 - 1.9. gjobat për kundërvajtjet në trafik dhe shkeljen e rregulloreve komunale, brenda kompetencave të Kryeqytetit.
2. Kjo Rregullore përcakton procedurat e caktimit, faturimit, pagesës, lirimit, reduktimit, evidencimit, raportimit, ankesës, mbikëqyrjes dhe arkëtimit të detyrimeve komunale.
3. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është krijimi i një sistemi transparent, proporcional, të parashikueshëm dhe jodiskriminues të të hyrave vetanake komunale, duke siguruar trajtim të barabartë të subjekteve dhe duke mos cenuar kompetencat e autoriteteve qendrore, rregullatorëve ose organeve profesionale për regjistrimin, licencimin dhe mbikëqyrjen sektoriale.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet ndaj personave fizikë dhe juridikë që ushtrojnë veprimtari afariste, ofrojnë shërbime profesionale, shërbimi akomodimi, shfrytëzojnë shërbime ose infrastrukturë komunale, ose hyjnë me automjet në një zonë të aktivizuar të trafikut të kufizuar brenda territorit të Kryeqytetit.

2. Dispozitat e saj janë të detyrueshme për të gjitha njësitë organizative të Kryeqytetit që administrojnë, faturjnë, mbikëqyrin ose arkëtojnë detyrimet e përcaktuara me këtë Rregullore.

Neni 3

Parimet

1. Zbatimi i kësaj Rregulloreje mbështetet në ligjshmëri, barazi, mosdiskriminim, proporcionalitet, siguri juridike, transparencë, mosretroaktivitet dhe mbrojtje të konkurrencës.
2. Tarifa administrative nuk mund të tejkalojë koston e arsyeshme të ofrimit të shërbimit ose lëshimit të dokumentit.
3. Ndalohet vendosja dy herë e të njëjtit detyrim komunal për të njëjtën bazë, subjekt, lokacion dhe periudhë; ky ndalim nuk përjashton detyrime të ndryshme të autorizuar me ligj.
4. Njësitë përgjegjëse sigurojnë ndarjen e caktimit, faturimit, arkëtimit, kontrollit dhe shqyrtimit të ankesës, si dhe mbledhin vetëm të dhënat e nevojshme për qëllimin ligjor.

Neni 4

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:
 - 1.1. **“Kryeqyteti”** nënkupton Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën;
 - 1.2. **Taksë komunale** – nënkupton shumën fikse dhe të pakthyeshme të pagesës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, që paguhet nga personat juridik dhe fizik autoriteteve të Kryeqytetit në mënyrën e paraparë në këtë Rregullore, në emër të:
 - 1.2.1. Lëshimit të Lejeve për ushtrimin e veprimtarisë afariste
 - 1.2.2. Lëshimit të Lejeve për shërbime profesionale
 - 1.2.3. Taksës për akomodim
 - 1.2.4. Taksës komunale për hyrje të automjeteve në zona të caktuara të Kryeqytetit.
 - 1.3. **Taksa për ushtrimin e veprimtarisë afariste**- është tarifë komunale e cila paguhet nga subjektet afariste me rastin e marrjes së lejës për ushtrimin e veprimtarisë afariste.
 - 1.4. **Taksa për ofrimin e shërbimeve profesionale**- është tarifë komunale e cila paguhet nga kategoritë të cilat ofrojnë shërbime profesionale me rastin e marrjes së lejës për shërbime profesionale.
 - 1.5. **Taksa komunale për hyrje të automjeteve në zona të caktuara të Kryeqytetit** - është tarifë e cila paguhet nga personat fizik dhe juridik për hyrjen e automjeteve në territorin administrativ të Kryeqytetit.
 - 1.6. **Taksa për akomodim** – është tarifë komunale që paguhet për çdo natë qëndrimi nga personat që shfrytëzojnë shërbime akomodimi.
 - 1.7. **Person** – nënkupton personin fizik dhe juridik;
 - 1.8. **Person fizik** – nënkupton personin fizik jo afarist që nuk ka të regjistruar aktivitet biznesi; dhe personi fizik afarist që ka të regjistruar biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe që zhvillon aktivitet të rregullt afarist;
 - 1.9. **Person juridik** – nënkupton një shoqëri ose një organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare dhe çdo legjislacion tjetër të aplikueshëm në Kosovë;

- 1.10. **“subjekt afarist”** nënkupton personin fizik afarist ose personin juridik të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.11. **“licencë për veprimtari”** nënkupton licencën, autorizimin, certifikatën profesionale, pëlqimin ose dokumentin tjetër sektorial të lëshuar nga ministria, agjencia, rregullatori, oda profesionale ose autoriteti tjetër kompetent;
- 1.12. **“leje komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste”** nënkupton dokumentin administrativ-fiskal të lëshuar nga Kryeqyteti për lokacionin ku ushtrohet veprimtaria dhe që dëshmon regjistrimin e detyrimit komunal, pagesën, lirimimin ose reduktimin e tij;
- 1.13. **“lokacion”** nënkupton adresën e veçantë ku ushtrohet realisht veprimtaria;
- 1.14. **“njësi”** nënkupton degën, pikën ose lokacionin shtesë të të njëjtit subjekt afarist;
- 1.15. **“strukturë akomoduese”** ka kuptimin e përcaktuar me Ligjin për Turizmin dhe përfshin hotelin, motelin, hostelin, bujtinën, apartamentin me qira ditore dhe format e tjera të lejuara të akomodimit;
- 1.16. **“ZTL”** nënkupton Zonën e Trafikut të Kufizuar, zonë e caktuar brenda territorit të kryeqytetit, ku qasja e automjeteve menaxhohet sipas kategorisë, emetimeve, kohës, qëllimit të udhëtimit dhe tarifës ditore;
- 1.17. **“banor i ZTL-së”** nënkupton personin me vendbanim të regjistruar brenda kufirit të zonës së aktivizuar;
- 1.18. **“vit fiskal”** nënkupton periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor.
- 1.19. **“DPIA”** – nga anglishtja (**Data Protection Impact Assessment**), që në shqip ka këtë kuptim “Vlerësimi i Ndikimit në Mbrojtjen e të Dhënave Personale”

Neni 5

Hierarkia dhe interpretimi

1. Kjo Rregullore zbatohet në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Në rast mospërputhjeje zbatohet akti me fuqi më të lartë.
2. Kur e njëjta çështje rregullohet me ligj të posaçëm, dispozita e posaçme prevalon ndaj dispozitës së përgjithshme të kësaj Rregulloreje.
3. Asnjë interpretim nuk mund të krijojë taksë, tarifë, ngarkesë, gjobë, masë ose kompetencë pa autorizim ligjor.
4. Pavlefshmëria, anulimi ose pazbatueshmëria e një dispozite, e konstatuar nga organi kompetent, nuk prek dispozitat e tjera vetëm kur ato mund të interpretohen dhe zbatohen në mënyrë të pavarur, pa ndryshuar qëllimin, përmbajtjen ose efektin juridik të pjesës së mbetur.
5. Kur ndashmëria nuk është e mundur, njësia përgjegjëse pezullon vetëm veprimet e prekura brenda kufijve të vendimit të organit kompetent dhe i propozon Kuvendit harmonizimin pa vonesë.

Neni 6

Organet përgjegjëse dhe ndarja e kompetencave

1. Zbatimi bëhet nga njësité organizative sipas ligjit, Statutit dhe aktit për organizimin e administratës; shprehja ‘njësia përgjegjëse’ nënkupton njësinë që ushtron funksionin përkatës.
2. Njësia përgjegjëse për veprimtaritë administron kërkesat dhe regjistrin, ndërsa zyrtari i autorizuar nxjerr vendimin për caktim dhe lejen. Kjo njësi nuk arkëton, nuk inspekton dhe nuk shqyrton ankesat ndaj akteve të veta.

3. Njësia përgjegjëse për financa regjistron, rakordon dhe raporton pagesat dhe procedon për ekzekutim vetëm detyrimet përfundimtare e të ekzekutueshme; ajo nuk ndryshon shumën pa akt kompetent.
4. Inspektorati ushtron vetëm kompetencat e dhëna me ligj, dokumenton gjendjen faktike dhe referon çështjet jashtë kompetencës së tij.
5. Njësitë për trafik, mjedis, teknologji dhe financa zbatojnë ZTL-në sipas ndarjes së funksioneve; Kryeqyteti është kontrollues i të dhënave të ANPR-së dhe çdo operator i jashtëm vepron vetëm si përpunues i kontraktuar.
6. Ankesat shqyrtohen nga organi i përcaktuar me ligjin e posaçëm; për kompetencat vetanake ose të zgjeruara, kur ligji i posaçëm nuk përcakton ndryshe, nga komisioni i themeluar sipas nenit 12 të Ligjit nr. 08/L-284.
7. Kryetari miraton matricën e kompetencave, ndarjen e detyrave dhe kontrollin e brendshëm, pa krijuar ose transferuar kompetenca të reja.

KAPITULLI II - LICENCA SEKTORIALE, LEJA KOMUNALE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË AFARISTE DHE LEJE PËR SHËRBIME PROFESIONALE

Neni 7

Licenca sektoriale

1. Licenca për veprimtari afariste dhe profesionale lëshohet, ndryshohet, pezullohet ose revokohet vetëm nga autoriteti sektorial ose profesional kompetent sipas ligjit përkatës.
2. Kur veprimtaria kërkon licencë sektoriale, subjekti duhet ta posedojë atë para ushtrimit të veprimtarisë. Kryeqyteti mund ta verifikojë ekzistencën dhe vlefshmërinë e licencës, por nuk rivlerëson kushtet profesionale që i ka vlerësuar autoriteti licencues.
3. Mospagesa e një detyrimi komunal nuk pezullon dhe nuk revokon licencën sektoriale. Kryeqyteti mund t'ia njoftojë autoritetit licencues vetëm faktet që lidhen me kompetencën e tij.

Neni 8

Natyra dhe kufijtë juridikë të lejes komunale

1. Leja komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste ose për ofrimin e shërbimeve profesionale lëshohet vetëm për qëllimet dhe brenda autorizimit të përcaktuar në nenet 10 dhe 11 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal. Leja lidhet me veprimtarinë për të cilin lëshohet dhe ka karakter fiskal dhe evidentues.
2. Leja komunale sipas këtij neni nuk është leje pune ose licencë për ushtrimin e tregtisë dhe nuk përbën autorizim material për fillimin ose vazhdimin e veprimtarisë.
3. Leja komunale nuk vërteton plotësimin e kushteve teknike, sanitare, shëndetësore, mjedisore, ndërtimore ose të kushteve të tjera të përcaktuara me ligj të posaçëm.
4. Leja komunale nuk zëvendëson certifikatën e regjistrimit të biznesit, licencën profesionale ose sektoriale, pëlqimin sanitar, lejen mjedisore, lejen e ndërtimit ose dokumentin tjetër të kërkuar me ligj.
5. Për lëshimin e lejes kërkohet vetëm dëshmia për regjistrimin e subjektit në regjistrin kompetent. Për shërbimet profesionale kërkohet edhe dëshmia për licencën ose certifikatën profesionale, kur kjo kërkohet sipas nenit 11 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal ose sipas ligjit të posaçëm.
6. Lëshimi i lejes ose pagesa e taksës nuk legalizon veprimtarinë e ndaluar, të paregjistruar ose të palicencuar dhe nuk krijon të drejtë për ushtrimin e veprimtarisë në kundërshtim me ligjin.

7. Leja lëshohet edhe kur subjekti është i liruar nga taksa ose përfiton reduktim, duke shënuar bazën juridike dhe periudhën e lirit ose të reduktimit.

Neni 9

Kërkesa dhe dokumentacioni

1. Kërkesa paraqitet fizikisht ose elektronikisht dhe përmban vetëm të dhënat e nevojshme për identifikimin e subjektit, lokacionit, kodit të veprimtarisë dhe licencës kur kërkohet me ligj.
2. Kryeqyteti siguron nga regjistrat zyrtarë dokumentet dhe të dhënat që mund t'i marrë ligjërisht përmes shkëmbimit ndërinstitucional; pala nuk detyrohet t'i paraqesë përsëri.
3. Kur aktiviteti faktik ndryshon nga ai i regjistruar, zyrtari harton procesverbal, administron prova dhe e njofton palën për faktet, klasifikimin e propozuar dhe afatin për deklaram.
4. Riklasifikimi dhe detyrimi bëhen vetëm me vendim të arsyetuar, pas ushtrimit të së drejtës për t'u dëgjuar. Vendimi përmban mjetin juridik dhe njoftohet para faturimit sipas kategorisë së re.

Neni 10

Lëshimi, forma dhe vlefshmëria

1. Zyrtari i autorizuar vendos për kërkesën dhe caktimin e taksës brenda tridhjetë (30) ditëve, përveç kur ligji përcakton afat tjetër.
2. Vendimi përmban subjektin, lokacionin, veprimtarinë, bazën ligjore, periudhën, shumën, afatin e pagesës dhe udhëzimin juridik.
3. Pas vendimit lëshohet fatura me të dhënat e pagesës dhe leja komunale me kod verifikimi. Fatura nuk e zëvendëson vendimin.
4. Dokumentet mund të lëshohen elektronikisht dhe të nënshkruhen ose vulosen sipas legjislacionit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.
5. Leja është e vlefshme për vitin fiskal dhe duhet të jetë e dukshme ose e qasshme elektronikisht gjatë kontrollit të ligjshëm.

Neni 11

Ndryshimet gjatë vitit fiskal

1. Subjekti njofton brenda tridhjetë (30) ditëve ndryshimin e emrit, kontrollit, lokacionit, veprimtarisë, statusit ose licencës sektoriale.
2. Ndryshimi prodhon efekt fiskal nga dita e parë e muajit pasues, përveç kur ligji ose faktet e provuara kërkojnë datë tjetër.
3. Riorganizimi, ndarja, bashkimi, transferimi ose ndryshimi formal nuk krijon status të ri kur ka vazhdimësi të kontrollit, aktivitetit, lokacionit, pasurive ose organizimit. Për këtë nxirret vendim i arsyetuar.

Neni 12

Taksa për shërbime profesionale

1. Taksa caktohet sipas nenit 11 të Ligjit për financat e pushtetit lokal për subjektin që ofron shërbim profesional dhe për lokacionin ku ushtrohet veprimtaria.

2. Kur ligji sektorial kërkon licencë ose certifikatë profesionale, Kryeqyteti verifikon vetëm ekzistencën e saj dhe nuk vlerëson përshtatshmërinë profesionale.
3. Nuk caktohet taksë e veçantë për secilin profesionist të punësuar në të njëjtin subjekt dhe lokacion. Detyrim i veçantë lind vetëm për subjektin ose njësinë e regjistruar veçmas.

KAPITULLI III - TARIFAT PËR LËSHIMIN E DOKUMENTACIONIT

Neni 13

1. Tarifat administrative për dokumente dhe shërbime përcaktohen në [Shtojcën 2](#) dhe nuk mund të tejkalojnë koston e arsyeshme të ofrimit. Analiza e kostos ruhet në dosjen e rregullores dhe rishikohet periodikisht.
2. Kërkesa pranohet pa dëshmi fizike të pagesës kur pagesa mund të verifikohet elektronikisht. Lirimi zbatohet vetëm kur përcaktohet me ligj ose akt të vlefshëm të mbështetur në ligj.
3. Taksa vjetore për automjetet motorike caktohet vetëm për banorët e Kryeqytetit dhe subjektet me seli në Kryeqytet, sipas fuqisë dhe/ose llojit të automjetit, në [Shtojcën 3](#). Regjistrimi i automjetit verifikohet nga regjistri zyrtar.
4. Dhënia në shfrytëzim e pronës komunale bëhet sipas ligjit të posaçëm, procedurës së konkurrimit ose përjashtimit ligjor, vlerës së tregut dhe kontratës. Tarifat për shfrytëzim afatshkurtër të hapësirës publike zbatohen vetëm pas lejes dhe sipas [Shtojcës 4](#).
5. Tarifat kadastrale, bashkëpagesat në arsim ose shëndetësi dhe pagesat sektoriale zbatohen vetëm në masën dhe shumën e përcaktuar me ligjin ose aktin nënligjor të organit kompetent.

KAPITULLI IV - TAKSA KOMUNALE PËR LEJEN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË AFARISTE DHE LEJEN PËR SHËRBIME PROFSIONALE

Neni 14

Detyrimi për pagesë

1. Subjekti që ushtron veprimtari të listuar në [Shtojcën 1](#) paguan taksën vjetore për secilin lokacion në territorin e Kryeqytetit.
2. Për çdo lokacion zbatohet shuma e plotë e kategorisë së veprimtarisë që ushtrohet realisht në atë lokacion. Selia, dega, njësia, pika e shitjes ose forma tjetër organizative trajtohen njësoj kur aktiviteti dhe kriteret e lejuara janë të njëjta.
3. Nuk mund të caktohet taksë për veprimtari që nuk është përfshirë në [Shtojcën 1](#) me analogji ose me vendim individual.
4. Lokacioni përcakton vetëm se ku lind detyrimi; nuk mund të përdoret për ndryshimin e shumës së taksës.
5. Ndërmarrjet Publike Lokale në të cilat Kryeqyteti është aksionar lirohen nga tarifat dhe ngarkesat komunale që lidhen drejtpërdrejt me vendosjen, përdorimin, mirëmbajtjen ose shfrytëzimin e hapësirës publike, pronës, infrastrukturës ose aseteve komunale, kur këto veprime kryhen brenda mandatit të tyre për ofrimin e shërbimeve publike dhe asetet mbeten në pronësi të Kryeqytetit ose të Ndërmarrjes Publike Lokale.
6. Nga tarifat dhe ngarkesat e përcaktuara në [Shtojcën 4](#) dhe në [Shtojcën 5](#) lirohet edhe operatori ekonomik i cili, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, është palë në një kontratë të

vlefshme të investimit dhe shërbimit me Kryeqytetin, kur plotësohen bashkërisht kushtet në vijim:

- 6.1. kontrata është lidhur dhe ka hyrë në fuqi para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje;
- 6.2. operatori ekonomik ka realizuar ose është i detyruar të realizojë investimin me mjetet e veta financiare;
- 6.3. kontrata, oferta e pranuar, modeli financiar ose aneksi kontraktual i lidhur para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje përcakton se kthimi i investimit ose kompensimi i operatorit realizohet, tërësisht ose pjesërisht, përmes komercializimit të hapësirave, sipërfaqeve ose aseteve përkatëse, duke përfshirë vendosjen dhe ekspozimin e reklamave;
- 6.4. hapësirat, infrastruktura dhe asetet e krijuara ose të përmirësuar përmes investimit janë dhe mbeten në pronësi të Kryeqytetit gjatë dhe pas përfundimit të kontratës;
- 6.5. komercializimi realizohet vetëm brenda objektit, lokacionit, sipërfaqes, kushteve dhe periudhës së përcaktuar në kontratë; dhe
- 6.6. operatori nuk pranon nga Kryeqyteti pagesë ose rimbursim të veçantë për tarifat dhe ngarkesat nga të cilat lirohet sipas këtij neni.
- 6.7. Për qëllim të këtij neni, “kontratë ekzistuese” konsiderohet vetëm kontrata që është e nënshkruar dhe në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje. Lirimi zbatohet deri në përfundimin e afatit kontraktual të përcaktuar në atë datë.

Neni 15

Kategorizimi sipas veprimtarisë

7. Kategorizimi mbështetet në klasifikimin zyrtar NACE të përdorur nga regjistri i bizneseve dhe në veprimtarinë faktike të provuar sipas nenit 9.
8. Nënkatëgoria komunale lejohet vetëm kur pasqyron kategorinë e aktivitetit, llojin e objektit ku zhvillohet veprimtaria ose shitjen e pijeve alkoolike.
9. Nënkatëgoria nuk paraqitet si kod zyrtar NACE dhe nuk mund të krijojë ose zëvendësojë licencim shëndetësor, turistik, profesional ose sektorial.
10. Ndryshimi i klasifikimit zyrtar zbatohet pas harmonizimit të [Shtojcës 1](#) me akt të Kuvendit.

Neni 16

Kriteret e ndaluara

1. Tarifa nuk mund të diferencohet drejtpërdrejt ose tërthorazi sipas numrit të punëtorëve, qarkullimit, prodhimit, kapacitetit real të biznesit, sipërfaqes së lokalit, lokacionit, të hyrave, fitimit, qarkullimit të parasë ose treguesve të ngjashëm. – Referenca në nenin 10.4 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.
2. Një karakteristikë sektoriale e regjistruar mund të përdoret vetëm kur përcakton objektivisht llojin e institucionit ose strukturës dhe nuk përdoret si zëvendësim për të ardhurat ose performancën ekonomike. Arsyeimi dokumentohet në analizën që shoqëron [Shtojcën 1](#).

Neni 17

Lirimet dhe reduktimet

1. Subjekti lirohet nga taksa gjatë vitit të parë fiskal të regjistrimit, pa marrë parasysh muajin e regjistrimit.
2. Subjekti në pronësi të grave përfiton reduktim për dy vitet e para fiskale. Në vitin e parë zbatohet lirimi prej njëqind për qind (100%), ndërsa në vitin e dytë reduktimi prej pesëdhjetë për qind (50%).

3. Pronësi e grave nënkupton së paku pesëdhjetë e një për qind (51%) të pronësisë dhe kontrollit efektiv. Transferimi formal te personi i lidhur, ndarja, riorganizimi ose vazhdimi i së njëjtës veprimtari nuk krijon të drejtë të re për lirim.
4. Subjekti në pronësi të veteranit të luftës përfiton reduktim për dy vitet e para fiskale. Në vitin e parë zbatohet lirimi prej njëqind për qind (100%), ndërsa në vitin e dytë reduktimi prej pesëdhjetë për qind (50%).
5. Pronësi e veteranit të luftës nënkupton së paku pesëdhjetë e një për qind (51%) të pronësisë dhe kontrollit efektiv. Transferimi formal te personi i lidhur, ndarja, riorganizimi ose vazhdimi i së njëjtës veprimtari nuk krijon të drejtë të re për lirim.
6. Lirimet nuk kumulojnë; zbatohet masa më e favorshme, përveç kur ligji përcakton ndryshe.
7. Subjektet afariste të cilat ndodhen në zona industriale, lirohen nga taksa për ushtrim veprimtarie.
8. Për të përfituar lirim dhe reduktim të taksës për ushtrim veprimtarie dhe shërbime profesionale, subjektet afariste janë të obliguara të parashtrojnë kërkesë pranë autoritetit përkatës, gjatë regjistrimit ose pas pranimit të faturës.

Neni 18

Faturimi dhe pagesa

1. Detyrimi caktohet me vendim administrativ. Pas njoftimit të vendimit lëshohet fatura me kodin, kategorinë, lokacionin, periudhën, shumën, afatin dhe të dhënat e pagesës.
2. Pagesa bëhet në euro përmes bankës, institucionit financiar të licencuar, platformës elektronike ose kanalit tjetër zyrtar.
3. Për subjektin që regjistrohet ose fillon veprimtarinë gjatë vitit, vendimi dhe fatura lëshohen brenda tridhjetë (30) ditëve nga kërkesa ose identifikimi, pas procedurës së nenit 9.
4. Detyrimi procedohet për arkëtim të detyrueshëm vetëm pasi të jetë përfundimtar dhe i ekzekutueshëm dhe pasi të jetë dërguar njoftimi sipas nenit 39.

Neni 19

Pasiviteti, pushimi dhe korrigjimi

1. Subjekti që nuk ka ushtruar veprimtari gjatë gjithë vitit mund të kërkojë anulimin e detyrimit, në bazë të të dhënave zyrtare dhe, kur është e nevojshme, verifikimit faktik.
2. Kur veprimtaria pushon ose pasivizohet gjatë vitit, taksa llogaritet proporcionalisht deri në fund të muajit të pushimit, nëse njoftimi dhe provat paraqiten brenda tridhjetë (30) ditëve. Vonesa nuk e heq të drejtën kur data mund të vërtetohet nga regjistri zyrtar, por mund të ndikojë në periudhën e korrigjimit sipas ligjit.
3. Kryeqyteti korrigjon me iniciativë ose kërkesë faturën e dyfishtë, gabimin material, lokacionin, kategorinë, periudhën, statusin ose pagesën. Refuzimi bëhet me vendim dhe mjet juridik.
4. Kërkesa për korrigjim nuk e zëvendëson ankesën dhe nuk e zgjat afatin e saj, përveç kur ligji përcakton ndryshe.

Neni 20**Shtojca e tarifave sipas veprimtarisë**

1. [Shtojca 1](#), me numrin rendor, sektorin, kodin zyrtar NACE, nënkategorinë e lejuar dhe shumën vjetore, është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.
2. [Shtojca 1](#) publikohet e plotë bashkë me Rregulloren.
3. Çdo ndryshim i kategorisë ose shumës bëhet vetëm me ndryshimin e kësaj Rregulloreje, me arsyetim, analizë të ndikimit dhe konsultim publik.

KAPITULLI V - TAKSA E AKOMODIMIT**Neni 21****Taksa e akomodimit**

1. Taksa e akomodimit është detyrim i klientit të strukturës akomoduese dhe paguhet për çdo natë qëndrimi në një njësi akomodimi në territorin e Komunës së Prishtinës.
2. Taksa e akomodimit përlllogaritet në masën dy për qind (2%) të çmimit të shërbimit të akomodimit.
3. Bazë për përlllogaritjen e taksës së akomodimit është vetëm çmimi i shërbimit të akomodimit, pa përfshirë shërbimet e tjera.
4. Taksa e akomodimit përlllogaritet për njësi akomodimi dhe për çdo natë qëndrimi, pavarësisht nga numri i personave që qëndrojnë në atë njësi.
5. Taksa e akomodimit nuk zbatohet kur klienti e shfrytëzon njësinë akomoduese për një periudhë që nuk përfshin qëndrimin gjatë natës.
6. Për qëllime të këtij kapitulli, strukturë akomoduese konsiderohet hoteli, moteli, hosteli, resorti, fshati turistik, bujtina, kampingu, qendra kurative, struktura “fjetje dhe mëngjes”, apartamenti për akomodim afatshkurtër dhe çdo strukturë tjetër që ofron shërbime akomodimi në pajtim me legjislacionin përkatës për turizmin.

Neni 22**Përjashtimet nga taksa e akomodimit**

1. Nga pagesa e taksës së akomodimit përjashtohen:
 - 1.1. fëmijët nën moshën shtatë (7) vjeç;
 - 1.2. personat që qëndrojnë për qëllime shërimi, në bazë të referimit mjekësor;
 - 1.3. personat me aftësi të kufizuara, në bazë të dokumentacionit përkatës, si dhe shoqëruesi i tyre;
 - 1.4. nxënësit, studentët, udhëheqësit dhe mentorët e tyre, kur marrin pjesë në programe edukative të organizuara mbi baza jofitimprurëse;
 - 1.5. nxënësit dhe studentët që qëndrojnë në konvikte;
 - 1.6. personat që punojnë përkohësisht dhe qëndrojnë në të njëjtën strukturë akomoduese për më shumë se tridhjetë (30) ditë;
 - 1.7. shtetasit e huaj të liruar nga pagesa e taksës në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare; dhe
 - 1.8. pjesëmarrësit në aktivitete sportive, kur baza e përjashtimit dëshmohet me dokumentacionin përkatës.
2. Kur në një njësi akomodimi qëndrojnë vetëm persona të përjashtuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, taksa e akomodimit nuk zbatohet.

3. Kur në të njëjtën njësi akomodimi qëndron së paku një person që nuk është i përjashtuar nga taksa e akomodimit, taksa aplikohet sipas kërkesave të këtij kapitulli.
4. Ofruesi i shërbimit të akomodimit verifikon dhe ruan dokumentacionin që dëshmon bazën e përjashtimit.

Neni 23

Mbledhja dhe transferimi i taksës së akomodimit

1. Çdo ofrues i shërbimit të akomodimit në territorin e Komunës së Prishtinës është i detyruar ta mbledhë nga klienti taksën e akomodimit në momentin e pagesës së shërbimit të akomodimit.
2. Taksa e akomodimit paraqitet veçmas në faturën që i lëshohet klientit.
3. Ofruesi i shërbimit të akomodimit është përgjegjës për përlogaritjen, mbledhjen dhe transferimin e shumave të mbledhura nga taksa e akomodimit në llogarinë përkatëse të Komunës së Prishtinës.
4. Deklarata përmban vetëm të dhënat e nevojshme agregate: netët e tatueshme, bazën, taksën, netët e liruara, korrigjimet dhe shumën për transferim.
5. Shuma e taksës së mbledhur gjatë muajit paraprak transferohet më së voni deri më datën pesëmbëdhjetë (15) të muajit vijues.
6. Transferimi i taksës së mbledhur në llogarinë e Komunës së Prishtinës bëhet përmes formularit ose dëftesës së përcaktuar nga Komuna e Prishtinës, duke përdorur UNIREF-in e dedikuar për taksën e akomodimit.
7. Kur pagesa mblidhet nga platformë ose ndërmjetësues, përgjegjësia e transferimit përcaktohet me marrëveshjen dhe legjislacionin përkatës, pa e liruar ofruesin nga deklarimi dhe rakordimi.
8. Gabimet dhe rimbursimet korrigjohen me deklarata korrigjuese dhe dokumentacion të verifikueshëm.

Neni 24

Destinimi i të hyrave nga taksa e akomodimit

1. Të hyrat nga taksa e akomodimit janë të hyra vetanake të Komunës së Prishtinës dhe të njëjtat planifikohen dhe shpenzohen në pajtim me legjislacionin përkatës për financat publike dhe financat e pushtetit lokal.
2. Të hyrat nga taksa e akomodimit dedikohen për zhvillimin dhe promovimin e turizmit në Komunën e Prishtinës, përfshirë zhvillimin e infrastrukturës turistike, promovimin e ofertës turistike, organizimin e ngjarjeve, zhvillimin e produkteve turistike dhe ngritjen e kapaciteteve në sektorin e turizmit.
3. Komuna e Prishtinës publikon në faqen e saj zyrtare raporte gjashtëmujore dhe vjetore për mbledhjen dhe shpenzimin e të hyrave nga taksa e akomodimit.

Neni 25

Evidentimi dhe raportimi

1. Ofruesi i shërbimit të akomodimit mban evidencë për:
 - 1.1. njësitë e akomodimit të shfrytëzuara;
 - 1.2. numrin e netëve të qëndrimit;
 - 1.3. çmimin e paguar për shërbimin e akomodimit;
 - 1.4. shumën e taksës së përlllogaritur dhe të mbledhur; dhe
 - 1.5. personat e përjashtuar nga pagesa dhe bazën e përjashtimit.
2. Evidencat dhe dokumentacioni sipas paragrafit 1 të këtij neni ruhen nga ofruesi i shërbimit të akomodimit dhe i vihen në dispozicion organit kompetent të Komunës për qëllime të inspektimit.
3. Evidentimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave bëhen në pajtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 26

Inspektimi

1. Inspektorati kompetent i Komunës së Prishtinës mbikëqyr zbatimin e dispozitave të këtij kapitulli dhe mund të kërkojë faturat, evidencat dhe dokumentacionin përkatës.
2. Ofruesi i shërbimit të akomodimit është i detyruar të bashkëpunojë me inspektoratin kompetent dhe t’ia vërë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar.
3. Qasja, kontrollimi dhe përpunimi i të dhënave personale gjatë inspektimit bëhen në pajtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
4. Për shkeljen e dispozitave të këtij kapitulli shqiptohen gjobat dhe masat e tjera të përcaktuara me legjislacionin përkatës për kundërvajtje.

KAPITULLI VI - ZONA E TRAFIKUT TË KUFIZUAR (ZTL)

Neni 27

Qëllimi i ZTL-së

1. ZTL-ja synon zvogëlimin e kongestionit, ndotjes së ajrit dhe zhurmës, përmirësimin e sigurisë rrugore, rritjen e shpejtësisë dhe besueshmërisë së transportit publik dhe lirin e hapësirës publike për këmbësorë dhe biçikleta.
2. Tarifa e ZTL-së nuk është taksë pronësie mbi automjetin dhe zbatohet vetëm për qasjen në zonën e aktivizuar, gjatë orarit dhe sipas kushteve të përcaktuara.

Neni 28

1. Kufiri maksimal i ZTL-së përcaktohet me hartën gjeoreferuese në [Shtojcën 6](#), e cila përmban koordinatat, rrugët kufizuese dhe pikat e mundshme të hyrjes e daljes.
2. Vendimi i aktivizimit mund të aktivizojë tërë zonën ose një pjesë të saj, vetëm brenda kufirit të [Shtojcës 6](#), dhe përcakton pikat e kontrollit e sinjalizimin.
3. Mospërputhja ndërmjet emërimit të rrugës dhe koordinatave zgjidhet sipas hartës së miratuar; ndryshimi i kufirit maksimal kërkon ndryshimin e Rregullores.

Neni 29**Tarifat ditore sipas kategorisë së automjetit**

1. Taksa paguhet një herë për ditën e ZTL-së për automjetin që hyn gjatë orarit të aktivizuar; hyrjet e përsëritura në të njëjtën ditë nuk krijojnë taksë tjetër.
2. Dita, orari, kategoritë dhe shumat përcaktohen në [Shtojcën 7](#). Pronari i regjistruar është obligues, përveç kur provon se automjeti është përdorur ligjërisht nga person tjetër që merr përgjegjësinë.
3. Automjetet me targa të huaja trajtohen sipas të njëjtave kritere dhe u ofrohet mënyrë pagese e qasshme para ose menjëherë pas hyrjes.
4. Shumat rishikohen vetëm me ndryshimin e Rregullores, mbi bazën e studimit të trafikut, mjedisit, barazisë dhe ndikimit ekonomik.

Neni 30**Klasifikimi i automjeteve**

5. Kategoria dhe standardi Euro verifikohen nga të dhënat e regjistrimit, certifikata e homologimit ose regjistri tjetër zyrtar.
6. Kur standardi i emetimeve nuk mund të verifikohet, automjeti klasifikohet përkohësisht në kategorinë më të afërt më kufizuese, me të drejtë korrigjimi pas paraqitjes së dëshmisë.
7. Korrigjimi i të dhënave bëhet pa tarifë; pagesa e tepërt rimburohet ose kreditohet automatikisht. Pala njoftohet për rezultatin dhe mjetin juridik.
8. Mjetet motorike me tarifë zero mund t'i nënshtrohen regjistrimit teknik për verifikim dhe kontroll të qasjes.

Neni 31**Rezidentët dhe lejet e posaçme**

1. Banori me vendbanim të regjistruar brenda ZTL-së ka të drejtë të aplikojë për leje rezidenti për qasje në banesë, pronë ose garazh.
2. Numri i automjeteve, dokumentet, vlefshmëria dhe kushtet e lejes së rezidentit përcaktohen me vendimin e aktivizimit, duke respektuar proporcionalitetin dhe duke parandaluar keqpërdorimin.
3. Leja e rezidentit nuk përjashton automatikisht automjetin nga kufizimet e sigurisë, emetimeve, parkimit ose zonave këmbësore.

Neni 32**Përjashtimet dhe tarifa zero**

1. automjetet e policisë, zjarrfikjes, emergjencës dhe ambulancës në detyrë;
2. transporti publik i licencuar dhe automjetet zëvendësuese në shërbim;
3. automjetet e personave me aftësi të kufizuara, sipas procedurës së regjistrimit;
4. automjetet e shërbimeve publike dhe komunale kur kryejnë detyrë të dokumentuar;
5. automjete zyrtare të institucioneve publike (qendrore dhe lokale), gjatë kohës që janë në shërbim zyrtar;
6. automjetet diplomatike ose kategoritë e liruara me ligj ose marrëveshje ndërkombëtare;
7. automjetet me leje të përkohshme për emergjencë shëndetësore, funeral, furnizim esencial, punime urgjente ose arsye tjetër të arsyetuar;
8. automjetet elektrike dhe motoçikletat, sipas tarifës zero të [Shtojcës 7](#).

Neni 33**Furnizimet dhe automjetet komerciale**

1. Automjetet komerciale paguajnë taksën e kategorisë përkatëse dhe respektojnë masat e trafikut të vendosura e të sinjalizuara sipas ligjit.
2. Leja periodike për furnizim të rregullt jepet sipas kriterëve dhe formulës së [Shtojcës 7](#); shuma nuk tejkalon totalin e ditëve të autorizuar dhe nuk krijon trajtim preferencial arbitrar.
3. Dritaret e furnizimit, itineraret dhe kufizimet e peshës miratohen si masa trafiku dhe nuk ndryshojnë vetvetiu taksën.

Neni 34**Pagesa, kontrolli dhe njoftimi**

1. Pagesa bëhet brenda ditës kalendarike të hyrjes në ZTL, përmes platformës elektronike, aplikacionit, pikave të autorizuar ose kanaleve të tjera zyrtare dhe të qasshme.
2. Kontrolli bëhet me ANPR, kontroll fizik ose të dhëna zyrtare, vetëm për qëllimin dhe brenda kufijve të ligjit.
3. Kur nuk evidentohet pagesa, dërgohet njoftim provizor me datën, pikën e hyrjes, kategorinë, shumën, provën dhe afatin për pagesë ose kundërshtim. Pas shqyrtimit nxirret vendim me mjet juridik.
4. Gjoha, bllokimi, largimi ose konfiskimi i automjetit nuk përdoren për arkëtimin e taksës, përveç kur masa autorizohet shprehimisht nga ligji i posaçëm dhe vendoset në procedurën përkatëse.

Neni 35**Mbrojtja e të dhënave dhe rishikimi**

1. Kryeqyteti është kontrollues i të dhënave të ANPR-së. Para aktivizimit miraton DPIA-në, regjistrin e përpunimit, politikën e ruajtjes/fshirjes, nivelet e qasjes, regjistrat e veprimeve, planin e incidenteve dhe informacionin për subjektet.
2. Të dhënat e automjeteve pa detyrim ose me pagesë të verifikuar fshihen ose anonimizohen në afatin më të shkurtër teknikisht të arsyeshëm; të dhënat e kontestuara ruhen vetëm deri në mbylljen e pagesës, ankesës ose ekzekutimit dhe afatit ligjor.
3. Vendimi me efekt juridik nuk merret vetëm me përpunim automatik; sigurohet shqyrtim njerëzor, korrigjim dhe e drejta e ankesës.
4. Operatori i jashtëm vepron vetëm si përpunues me kontratë, masa sigurie, auditim dhe ndalim të përdorimit për qëllim tjetër.
5. Efektet e ZTL-së dhe respektimi i të dhënave vlerësohen e publikohen së paku një herë në vit.

Neni 36**Vlefshmëria e tarifës ZTL**

1. Tarifat ZTL do të jenë të vlefshme deri në përfundim të implementimit të projektit të Unazës së Jashtme të Kryeqytetit.

KAPITULLI VII - MBIKËQYRJA, PROCEDURA DHE ARKËTIMI I DETYRUESHËM**Neni 37****Mbikëqyrja administrative**

1. Drejtoria e Inspektionit është kompetente për mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të kësaj rregulloreje, në pajtim me kompetencat dhe autorizimet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
2. Inspektori, gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes inspektuese, ka të drejtë të verifikojë përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me këtë rregullore, përfshirë dokumentacionin, lejet, evidencat dhe të dhënat që lidhen drejtpërdrejt me objektin e mbikëqyrjes.
3. Për çdo kontroll inspektues përpilohet procesverbal, në të cilin evidentohen faktet e konstatuara, dokumentet dhe provat e administruara, si dhe masat e ndërmarra nga inspektori.
4. Gjatë procedurës së mbikëqyrjes inspektuese respektohen të drejtat e subjektit të mbikëqyrur, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe parimet e procedurës administrative.
5. Inspektori ka të drejtë të kërkojë vetëm dokumentet, të dhënat dhe provat që janë të nevojshme dhe relevante për konstatimin e gjendjes faktike dhe për zbatimin e kësaj rregulloreje.
6. Kur konstatohet ushtrimi i veprimtarisë pa leje, licencë ose pëlqim që është në kompetencë të Kryeqytetit, inspektori komunal ndërmerr masat e përcaktuara në paragrafet 2, 3 dhe 4 të nenit 39 të kësaj rregulloreje dhe legjislacionin në fuqi. Kur shkelja lidhet me një licencë ose autorizim që është në kompetencë të një autoriteti tjetër, Kryeqyteti njofton autoritetin kompetent për ndërmarrjen e masave nga kompetenca e tij.

Neni 38**Kundërvajtjet, Masat inspektuese dhe mospagesa e detyrimeve**

1. Mospagesa e gjobës, taksës, tarifës ose ngarkesës komunale nuk përbën, në vetvete, bazë për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë, përveç kur pagesa, sipas ligjit dhe kësaj rregulloreje, është kusht për marrjen ose mbajtjen në fuqi të lejes komunale.
2. Detyrimet monetare të papaguara, pas plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë së aktit përkatës, arkëtohen sipas procedurës së zbatueshme për përmbartimin e detyrueshëm.
3. Kur konstatohet se subjekti ushtron veprimtarinë pa leje, certifikatë, pëlqim ose vendim të detyrueshëm, inspektori urdhëron eliminimin e shkeljes brenda afatit të arsyeshëm dhe, kur parashihet me ligj, ndalon pjesërisht ose plotësisht veprimtarinë deri në përmbushjen e kushteve.
4. Skadimi i masës së përkohshme nuk e legalizon ushtrimin e veprimtarisë pa dokumentacionin e detyrueshëm. Vazhdimi i veprimtarisë pa i plotësuar kushtet përbën shkelje të vazhdueshme dhe trajtohet me riinspektim dhe vendim të ri ose përfundimtar.
5. Mbyllja e plotë zbatohet vetëm kur masa më e butë nuk mund ta arrijë qëllimin, kur vazhdimi i veprimtarisë paraqet rrezik për jetën, shëndetin, sigurinë publike ose mjedisin, apo kur ndalimi parashihet shprehimisht me ligjin e posaçëm.
6. Rihapja e subjektit të mbyllur deri në eliminimin e shkeljes lejohet vetëm pas verifikimit nga Inspeksioni dhe nxjerrjes së aktit për heqjen e masës dhe të bllobave.

Për çështjet që janë në kompetencën e një inspektorati tjetër, Drejtoria e Inspektionit e referon lëndën pa vonesë tek organi kompetent.

Neni 39

Kundërvajtjet dhe gjobat

1. Kundërvajtje të lehta lidhur me lejen komunale konsiderohen:
 - a. mosparaqitja e kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm për pajisje me leje komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste ose për ofrimin e shërbimeve profesionale, brenda afatit të përcaktuar në urdhrin për korrigjimin e shkeljes; dhe
 - b. mosekspozimi i lejes komunale të vlefshme në mënyrë të dukshme në lokacionin për të cilin është lëshuar.
2. Para fillimit të procedurës kundërvajtëse sipas paragrafit 1 të këtij neni, inspektori:
 - a. konstaton gjendjen faktike me procesverbal;
 - b. e njofton subjektin për shkeljen dhe veprimet që duhet të ndërmerren;
 - c. cakton afat prej pesë (5) ditësh pune për paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm për leje; ose
 - d. cakton afat prej një (1) dite pune për ekspozimin e lejes së lëshuar.
3. Nëse subjekti nuk vepron brenda afatit të përcaktuar në nënparagrafin 2.3 të këtij neni, shqiptohet gjobë fikse:
 - a. Njëqind (100) euro për personin fizik që ushtron shërbime profesionale;
 - b. Njëqind (100) euro për biznesin individual;
 - c. njëqind e pesëdhjetë (150) euro për personin juridik; dhe
 - d. njëqind (100) euro për personin përgjegjës të personit juridik.
4. Nëse subjekti nuk e ekspozon lejen brenda afatit të përcaktuar në nënparagrafin 2.4 të këtij neni, shqiptohet gjobë fikse:
 - a. njëqind (100) euro për personin fizik që ushtron shërbime profesionale;
 - b. njëqind (100) euro për biznesin individual;
 - c. njëqind (100) euro për personin juridik; dhe
 - d. njëqind (100) euro për personin përgjegjës të personit juridik.
5. Ofruesi i shërbimit të akomodimit kryen kundërvajtje nëse:
 - a. nuk e përllogarit ose nuk e mbledh taksën e akomodimit nga klienti;
 - b. nuk e paraqet taksën e akomodimit veçmas në faturën e lëshuar;
 - c. nuk e transferon në llogarinë e Kryeqytetit shumën e mbledhur të taksës së akomodimit brenda afatit të përcaktuar me këtë rregullore;
 - d. nuk mban ose nuk raporton evidencat për njësitë e shfrytëzuara, netët e qëndrimit, çmimin e akomodimit, taksën e përllogaritur dhe përjashtimet;
 - e. zbaton përjashtim nga taksa pa dokumentacionin përkatës ose paraqet të dhëna të pasakta për qëllim të zvogëlimit të detyrimit; ose
 - f. nuk ia vë organit kompetent në dispozicion faturat, evidencat dhe dokumentacionin e kërkuar ligjërisht.
6. Për kundërvajtjet e përcaktuara në nënparagrafët 5.1, 5.3 dhe 5.5 të këtij neni shqiptohet gjobë fikse:
 - a. njëqind (100) euro për personin fizik;
 - b. dyqind e pesëdhjetë (250) euro për biznesin individual;
 - c. pesëqind (500) euro për personin juridik; dhe
 - d. njëqind (100) euro për personin përgjegjës të personit juridik.
7. Për kundërvajtjet e përcaktuara në nënparagrafët 5.2, 5.4 dhe 5.6 të këtij neni shqiptohet gjobë fikse:
 - a. njëqind (100) euro për personin fizik;
 - b. njëqind e pesëdhjetë (150) euro për biznesin individual;
 - c. treqind (300) euro për personin juridik; dhe
 - d. njëqind (100) euro për personin përgjegjës të personit juridik.
8. Kundërvajtje lidhur me ZTL-në konsiderohet kur personi fizik ose juridik:

- a. hyn me automjet në ZTL-në e aktivizuar, gjatë orarit të zbatimit, pa e paguar tarifën brenda ditës kalendarike të hyrjes dhe pa poseduar leje, autorizim ose përjashtim të vlefshëm; ose
- b. përdor leje, autorizim ose përjashtim të lëshuar për person ose automjet tjetër, apo paraqet të dhëna të pasakta për përfitimin e lejes, tarifës zero ose përjashtimit.
9. Për kundërvajtjen e përcaktuar në nënparagrafin 8.a të këtij neni shqiptohet gjobë fikse:
 - c. pesëdhjetë (50) euro për personin fizik;
 - d. njëqind (100) euro për biznesin individual;
 - e. njëqind e pesëdhjetë (150) euro për personin juridik; dhe
 - f. njëqind (100) euro për personin përgjegjës të personit juridik, kur vërtetohet përgjegjësia e tij personale.
10. Për kundërvajtjen e përcaktuar në nënparagrafin 8.b të këtij neni shqiptohet gjobë fikse:
 - a. njëqind (100) euro për personin fizik;
 - b. dyqind e pesëdhjetë (250) euro për biznesin individual;
 - c. pesëqind (500) euro për personin juridik; dhe
 - d. njëqind (100) euro për personin përgjegjës të personit juridik, kur vërtetohet përgjegjësia e tij personale.
11. Për shkeljen e dytë të kryer brenda dymbëdhjetë (12) muajve nga dita kur vendimi për shkeljen e parë është bërë i formës së prerë, shqiptohet gjobë fikse:
 - a. njëqind (100) euro për personin fizik;
 - b. dyqind (200) euro për biznesin individual;
 - c. treqind (300) euro për personin juridik; dhe
 - d. njëqind (100) euro për personin përgjegjës të personit juridik, kur vërtetohet përgjegjësia e tij personale.
12. Për shkeljen e tretë dhe çdo shkelje të njëpasnjëshme, të kryer brenda dymbëdhjetë (12) muajve nga dita kur vendimi për shkeljen paraprake është bërë i formës së prerë, shqiptohet gjobë fikse:
 - a. treqind (300) euro për personin fizik;
 - b. gjashtëqind (600) euro për biznesin individual;
 - c. njëmijë (1000) euro për personin juridik; dhe
 - d. treqind (300) euro për personin përgjegjës të personit juridik, kur vërtetohet përgjegjësia e tij personale.
13. Hyrjet e shumëfishta të të njëjtit automjet brenda së njëjtës ditë kalendarike konsiderohen një kundërvajtje. Hyrja në një ditë tjetër konsiderohet kundërvajtje e re, ndërsa përshkallëzimi i gjobës zbatohet vetëm pasi vendimi për kundërvajtjen paraprake është bërë i formës së prerë.
14. Gjoha për hyrje në ZTL nuk shqiptohet kur:
 - a. tarifa paguhet brenda njëzetekatër (24) orëve nga hyrja;
 - b. personi dëshmon brenda afatit të përcaktuar në njoftim se ka pasur leje ose të drejtë për përjashtim;
 - c. sinjalizimi rrugor, sistemi i pagesës ose njoftimi për kufijtë dhe orarin e ZTL-së nuk kanë qenë funksionalë ose të publikuar; ose
 - d. hyrja është shkaktuar nga një emergjencë shëndetësore ose rrethanë tjetër e jashtëzakonshme e dokumentuar.
15. Kur automjeti konstatohet duke hyrë ose qarkulluar në kundërshtim me kushtet e ZTL-së, organi kompetent mund:
 - a. t'ia refuzojë hyrjen në ZTL;
 - b. ta urdhërojë drejtuesin që ta largojë menjëherë automjetin nga ZTL-ja; dhe
 - c. ta ndalojë përkohësisht hyrjen e automjetit në ZTL, deri në tridhjetë (30) ditë, pas shkeljes së tretë ose shkeljes së njëpasnjëshme, vetëm kur kjo masë lejohet me ligj dhe përcaktohet në vendimin e aktivizimit.
16. Bllokimi fizik ose tërheqja e automjetit mund të ndërmerret vetëm kur:

- a. automjeti është ndalur ose parkuar në kundërshtim me sinjalizimin dhe pengon qarkullimin, transportin publik, lëvizjen e këmbësorëve, qasjen e automjeteve emergjente ose funksionimin e ZTL-së;
 - b. drejtuesi refuzon ta largojë automjetin pas urdhrat të organit kompetent;
 - c. masa autorizohet shprehimisht me ligjin përkatës për trafikun rrugor ose me një ligj tjetër të posaçëm; dhe
 - d. masa urdhërohet dhe zbatohet nga Policia ose organi tjetër publik që ka kompetencë të përcaktuar me ligj.
17. Bllokimi ose tërheqja e automjetit nuk mund të zbatohet vetëm për shkak të mospagesës së tarifës ose gjobës së ZTL-së. Automjeti nuk mund të mbahet si garanci për arkëtimin e detyrimit.
 18. Para bllokimit ose tërheqjes përpilohet procesverbal dhe sigurohen dëshmi fotografike për automjetin, targën, lokacionin, kohën, sinjalizimin dhe arsyen e masës. Pronari ose shfrytëzuesi i regjistruar njoftohet pa vonesë për vendndodhjen e automjetit, mënyrën e lirit dhe mjetet juridike.
 19. Shpenzimet e ligjshme të bllokimit, zhbllokimit, tërheqjes dhe ruajtjes i ngarkohen pronarit ose shfrytëzuesit vetëm kur shumat, procedura dhe organi përgjegjës janë përcaktuar paraprakisht me akt juridik të bazuar në ligj.
 20. Kur i njëjti veprim përbën kundërvajtje sipas ligjit për rregullat e trafikut rrugor, zbatohet ligji i posaçëm dhe nuk shqiptohet gjobë shtesë sipas kësaj rregulloreje për të njëjtin veprim.

Neni 40

Arkëtimi i detyrueshëm

1. Detyrimi i papaguar, pas përfundimit të procedurës administrative dhe skadimit të afatit, arkëtohet sipas legjislacionit përkatës për ekzekutimin e detyrimeve publike dhe procedurën përmbartimore.
2. Para inicimit të arkëtimin të detyrueshëm, debitorit i dërgohet njoftim për shumën, bazën, afatin dhe mënyrën e pagesës.
3. Mospagesa e gjobës, taksës, tarifës apo ngarkesës komunale për më shumë se një vit, rezulton me revokimin e Lejes Komunale për veprimtari afariste.
4. Revokimi i Lejes Komunale për veprimtari afariste, inicon masat nga neni 39 i kësaj rregullore.

Neni 41

Ankesa

1. Kundër refuzimit të lirit, klasifikimit, detyrimit të akomodimit ose detyrimit të ZTL-së mund të paraqitet ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi.
2. Ankesa shqyrtohet nga komisioni kompetent në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Vendimi përmban arsyetim faktik dhe juridik dhe udhëzim për konfliktin administrativ.
3. Paraqitja e ankesës nuk e pezullon automatikisht ekzekutimin, përveç kur organi kompetent vendos ndryshe për të shmangur dëm të pariparueshëm.

Neni 42

Publikimi dhe raportimi

1. Kryeqyteti publikon tarifën, formularët, procedurat, afatet, vendimet e përgjithshme, raportin vjetor të të hyrave dhe rezultatet e vlerësimit të ZTL-së.

2. Raportimi nuk përmban të dhëna personale ose sekrete afariste dhe paraqitet në formë të agreguar.

KAPITULLI VIII - DISPOZITAT SHFUQIZUESE DHE KALIMTARE

Neni 43

Shfuqizimi, ruajtja e akteve të posaçme dhe vazhdimësia juridike

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet në tërësi Rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01 nr. 110-2782, e datës 02.12.2011, së bashku me ndryshimet dhe plotësimet e saj:
 - a. Rregullorja nr. 01-431/04-0253531/17, e datës 10.10.2017, e publikuar më 01.11.2017, për ndryshimin dhe plotësimin e tarifës për bartjen e pronës;
 - b. Rregullorja nr. 01-434/01-315069/19, e datës 30.12.2019, për ndryshimin dhe plotësimin e lirimeve nga tarifa për mjete motorike.
2. Me fillimin e zbatimit të taksës vjetore sipas [Shtojcës 1](#) shfuqizohen aktet që kanë rregulluar taksat dhe ngarkesat për ushtrimin e veprimtarive afariste dhe shërbimeve profesionale:
 - a. Vendimi nr. 01-110-21449, i datës 28.02.2013;
 - b. Vendimi nr. 01-020/01-139118/20, i datës 12.08.2020;
 - c. Vendimi nr. 01-431/04-112314/21, i datës 16.06.2021;
 - d. Vendimi nr. 01-431/04-185458/21, i datës 03.09.2021.
3. Vendimi nr. 14-020/04-0299221/19, i datës 09.12.2019, si dhe vendimet për ndryshimin dhe plotësimin e tij, shfuqizohen në ditën kur fillon punën organi i ankesave i caktuar në pajtim me këtë Rregullore. Deri në atë ditë, organi ekzistues vazhdon shqyrtimin e lëndëve pa ndërprerë ose rifilluar afatet procedurale.
4. Për detyrimet që i përkasin periudhës para datës së zbatimit të kësaj Rregulloreje zbatohen dispozitat materiale që kanë qenë në fuqi në periudhën kur është krijuar detyrimi.
5. Dispozitat procedurale të kësaj Rregulloreje zbatohen edhe për procedurat në zhvillim, përveç veprimeve procedurale të kryera në mënyrë të vlefshme sipas dispozitave të mëparshme dhe rasteve kur zbatimi i menjëhershëm do të cenonte afatin ose një të drejtë të fituar të palës.
6. Aktet administrative përfundimtare dhe të ekzekutueshme, faturat e lëshuara ligjërisht dhe pagesat e kryera para datës së zbatimit mbeten të vlefshme. Ato korrigjohen ose rimbursohen vetëm kur janë lëshuar apo paguar pa bazë ligjore, dy herë ose me gabim material.
7. Lejet komunale dhe aktet e tjera individuale të lëshuara para hyrjes në fuqi mbeten të vlefshme për periudhën për të cilën janë lëshuar, përveç kur bien ndesh me një dispozitë detyruese të ligjit.
8. Kreu V për ZTL-në zbatohet vetëm pas hyrjes në fuqi të vendimit të posaçëm të aktivizimit. Kuvendi Komunal autorizon Kryetarin e Kryeqytetit të lëshojë vendimin e posaçëm të aktivizimit.

Neni 44

Afatet dhe masat për zbatimin e Rregullores

1. Taksa vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe shërbimeve profesionale, së bashku me [Shtojcën 1](#), zbatohet nga 1 janari i vitit që pason vitin e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

2. Taksa e akomodimit zbatohet nga dita e parë e muajit që fillon pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.
3. Kapitulli për Zonën e Trafikut të Kufizuar zbatohet vetëm pas lëshimit të vendimit të posaçëm nga Kryetari i Kryeqytetit, pas vendosjes së sinjalizimit dhe funksionalizimit të sistemit teknik dhe të procedurës së ankesës.
4. Vendimi i Kuvendit sipas paragrafit 3 të këtij neni përcakton datën e fillimit, kufijtë e saktë të zonës, orarin, periudhën provuese, kategoritë e lejeve dhe mënyrën e monitorimit. Me këtë vendim nuk mund të ndryshohen norma, shuma ose elementet themelore të detyrimit të përcaktuara me këtë Rregullore.
5. Kryetari i Kryeqytetit dhe njësitë përgjegjëse miratojnë formularët, udhëzuesit dhe procedurat teknike të nevojshme për zbatim, pa ndryshuar subjektin, bazën, normën, shumën, lirimet ose afatet e detyrimit. Kuvendi Komunal autorizon Kryetarin e Kryeqytetit të bëjë ndryshime për periudha sezonale, më së shumti deri në 3 muaj, pa mundësi ripërtëritje.
6. Formularët, kodet e pagesës, UNIREF-i, procedurat e raportimit, korrigjimit dhe ankesës publikohen jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para datës së fillimit të zbatimit të detyrimit përkatës.
7. Formularët dhe procedurat ekzistuese vazhdojnë të zbatohen, në masën që nuk bien ndesh me këtë Rregullore, deri në zëvendësimin e tyre.
8. [Shtojca 1](#) dhe çdo hartë ose dokument tjetër i shpallur pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje publikohen së bashku me tekstin e saj. Ndryshimi i tyre bëhet vetëm sipas procedurës së paraparë për ndryshimin e Rregullores.
9. Ndryshimi i një tarife ose ngarkese nuk zbatohet në mënyrë retroaktive dhe nuk krijon, vetëm për shkak të ndryshimit të kësaj Rregulloreje, të drejtë automatike për kthimin e pagesave të kryera ligjërisht.

Neni 45

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas regjistrimit në ministrinë përgjegjëse për qeverisje lokale dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Kryeqytetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

Numri i aktit:

Data:

SHTOJCA 1 - TABELA E KATEGORIVE DHE TARIFAVE SIPAS KODEVE NACE

Nr.	Sektori	Kodi NACE	Veprimtaria	Tarifa vjetore (€)
1.	Energjia dhe shërbimet publike	3511	Prodhimi i rrymës elektrike	1,000.00 €
2.	Energjia dhe shërbimet publike	3513	Operator i rrjetit energjetik (KEK/KEDS/KESCO ose i ngjashëm)	3,000.00 €
3.	Energjia dhe shërbimet publike	3600	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	1,000.00 €
4.	Ndërmarrje publike	3600	Ndërmarrje rajonale e ujësjellësit	2,000.00 €
5.	Ndërmarrje publike	3811	Ndërmarrje për menaxhimin e mbeturinave	2,000.00 €
6.	Energji dhe Telekom	6110	Operator telekomunikimi (fiks, mobil, satelitor, ISP)	1,500.00 €
7.	Energji dhe Telekom	6110	Njësi/degë e operatorit telekomunikues	500.00 €
8.	Infrastrukturë digjitale	6311	Data processing, hosting dhe aktivitete të ndërlidhura	1,000.00 €
9.	Sektori financiar	6419	Bankë me licencë bankare – seli	2,000.00 €
10.	Sektori financiar	6419	Degë/njësi bankare	1,500.00 €
11.	Sektori financiar	6419	Zonë bankare vetëshërbyese 24/7	1,000.00 €
12.	Sektori financiar	6419	Bankomat i pavarur (ATM/CDM)	500.00 €
13.	Sektori financiar	6492	Institucion mikrofinanciar – seli ose njësi	1,000.00 €
14.	Sektori financiar	6619	Institucion pagesash dhe transfertash – seli ose njësi me seli jashtë kryeqytetit	700.00 €
15.	Sektori financiar	6512	Sigurimi jojetësor	1,000.00 €
16.	Sektori financiar	6511	Sigurimi i jetës	1,000.00 €

Nr.	Sektori	Kodi NACE	Veprimtaria	Tarifa vjetore (€)
17.	Automjete	4511	Tregtia e veturave dhe automjeteve të reja	700.00 €
18.	Automjete	4511 4519	Tregtia e veturave dhe automjeteve të përdorura	600.00 €
19.	Automjete	4520	Auto-servis i përgjithshëm	1,000.00 €
20.	Automjete	4520	Auto-servis i autorizuar i prodhuesit	1,500.00 €
21.	Automjete	4520	Autolarje	500.00 €
22.	Automjete	4520	Qendër auto-detailing	500.00 €
23.	Automjete	7711	Dhënie automjeteve me qira (Rent-a-Car)	500.00 €
24.	Automjete	7120	Kontrollim teknik i automjeteve	500.00 €
25.	Automjete	4532	Tregtia me pakicë e pjesëve dhe pajisjeve për automjete	300.00 €
26.	Karburante	4730	Tregtia me pakicë e karburanteve për automjete – zonë urbane	3,000.00 €
27.	Karburante	4730	Tregtia me pakicë e karburanteve për automjete – zonë rurale	1,000.00 €
28.	Barnatore	4646	Tregtia me shumicë e artikujve farmaceutikë	500.00 €
29.	Barnatore	4773	Tregtia me pakicë e artikujve farmaceutikë	300.00 €
30.	Bujqësi	4776	Barnatore bujqësore	150.00 €
31.	Hoteleri	5510	Hotel deri në 30 njësi akomodimi	500.00 €
32.	Hoteleri	5510	Hotel me 31–80 njësi akomodimi	1,000.00 €
33.	Hoteleri	5510	Hotel me 81–150 njësi akomodimi	2,000.00 €
34.	Hoteleri	5510	Hotel mbi 150 njësi akomodimi	3,000.00 €
35.	Hoteleri	5510	Motel	500.00 €
36.	Hoteleri	5510	Hostel	500.00 €

Nr.	Sektori	Kodi NACE	Veprimtaria	Tarifa vjetore (€)
37.	Hoteleri	5520	Bujtinë / apartament për qëndrim të shkurtër	500.00 €
38.	Siguria	8010	Aktivitetet e sigurimit privat	300.00 €
39.	Siguria	8424	Rendi publik dhe aktivitetet e sigurisë	300.00 €
40.	Siguria	8020	Aktivitete shërbyese të sistemeve të sigurimit	300.00 €
41.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4120	Ndërtim i objekteve banesore	2,000.00 €
42.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4120	Ndërtim i objekteve jobanesore	2,000.00 €
43.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4120	Komplekse banesore dhe zhvillime të integruara	3,000.00 €
44.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4211	Infrastrukturë lokale dhe urbane	500.00 €
45.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4211 4221 4222 4291 4299 4321 4329	Infrastrukturë rajonale dhe nacionale	2,500.00 €
46.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4211	Infrastrukturë aeroportuale	3,000.00 €
47.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Punime hidraulike, instalime ngrohjeje dhe kondicionimi	300.00 €
48.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Instalime hidraulike	300.00 €
49.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Instalime të ujësjellësit	300.00 €
50.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Instalime të kanalizimit	1,000.00 €
51.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Instalime sanitare	300.00 €
52.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Montim i pajisjeve sanitare	300.00 €
53.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Sisteme të ujit të ngrohtë	300.00 €
54.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Instalim i kaldajave	300.00 €
55.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Instalim i radiatorëve	300.00 €
56.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Ngrohje qendrore	300.00 €

Nr.	Sektori	Kodi NACE	Veprimtaria	Tarifa vjetore (€)
57.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Ngrohje nën dysHEME	300.00 €
58.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Instalim i pompave termike	300.00 €
59.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Sisteme ventilimi dhe klimatizimi	300.00 €
60.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Air conditioning (HVAC)	300.00 €
61.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Ventilim mekanik	1,000.00 €
62.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Ventilim industrial	1,000.00 €
63.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Sisteme filtrimi të ajrit	500.00 €
64.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Chiller dhe fan-coil	500.00 €
65.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Instalime të gazit	1,000.00 €
66.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Pajisje për shpërndarjen e gazit në objekte	1,000.00 €
67.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Servisim i sistemeve HVAC	300.00 €
68.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Riparime të instalimeve hidraulike	300.00 €
69.	Ndërtimtari dhe Infrastrukturë	4322	Mirëmbajtje teknike e sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes	300.00 €
70.	Tregti me shumicë dhe ndërmjetësim	4613	Tregtia me shumicë e materialeve ndërtimore – distributor lokal	500.00 €
71.	Tregti me shumicë dhe ndërmjetësim	4613	Tregtia me shumicë e materialeve ndërtimore – distributor rajonal/importues	1,500.00 €
72.	Tregti me shumicë dhe ndërmjetësim	4615	Ndërmjetësim për mobilie, mallra shtëpiake, pajisje elektronike dhe hekurishte	500.00 €
73.	Tregti me shumicë dhe ndërmjetësim	4673	Tregtia me shumicë e drurit, materialeve ndërtimore dhe pajisjeve hidrosanitare	700.00 €
74.	Tregti me pakicë	4711	Minimarket	200.00 €
75.	Tregti me pakicë	4711	Market	400.00 €
76.	Tregti me pakicë	4711	Supermarket	1,000.00 €

Nr.	Sektori	Kodi NACE	Veprimtaria	Tarifa vjetore (€)
77.	Tregti me pakicë	4711	Hipermarket	3,000.00 €
78.	Tregti me pakicë	4719	Qendër tregtare (Shopping Mall)	5,000.00 €
79.	Tregti me pakicë	4719	Shtëpi mallrash / vetëshërbim i madh	1,000.00 €
80.	Tregti me pakicë	4722	Tregtia me pakicë e mishit dhe produkteve të mishit	300.00 €
81.	Tregti me pakicë	4742	Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikimit	300.00 €
82.	Tregti me pakicë	4777	Tregtia me pakicë e orëve dhe argjendarisë	500.00 €
83.	Tregti me pakicë	4724	Furrë buke	100.00 €
84.	Tregti me pakicë	4729	Lokal ushqimor i lagjes	100.00 €
85.	Tregti me pakicë	4772	Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure	100.00 €
86.	Tregti me pakicë	4778	Tregtia me pakicë e mallrave të tjera të reja	400.00 €
87.	Tregti me pakicë	4778	Dyqan suveniresh	150.00 €
88.	Tregti me pakicë	4778	Dyqan i artikujve artistikë	150.00 €
89.	Tregti me pakicë	4778	Dyqan i artikujve për hobi	150.00 €
90.	Tregti me pakicë	4778	Dyqan i artikujve fetarë	150.00 €
91.	Tregti me pakicë	4778	Galeri arti komerciale	150.00 €
92.	Tregti me pakicë	4778	Dyqan i specializuar i mallrave të reja të paklasifikuara	300.00 €
93.	Tregti me pakicë	4752	Tregtia me pakicë e artikujve elektronikë, ngjyrave dhe xhamit	300.00 €
94.	Tregti me pakicë	4752	Dyqan bojrash	150.00 €
95.	Tregti me pakicë	4752	Dyqan xhami	150.00 €
96.	Tregti me pakicë	4752	Dyqan materialesh elektrike	150.00 €
97.	Tregti me pakicë	4752	Dyqan veglash pune	150.00 €
98.	Tregti me pakicë	4752	Dyqan materialesh për renovim dhe mirëmbajtje	150.00 €
99.	Tregti me pakicë	4759	Tregtia me pakicë e mobilieve, ndriçimit dhe artikujve shtëpiakë	500.00 €

Nr.	Sektori	Kodi NACE	Veprimtaria	Tarifa vjetore (€)
100.	Tregti me pakicë	4759	Sallon mobiliesh	500.00 €
101.	Tregti me pakicë	4759	Dyqan ndriçimi	300.00 €
102.	Tregti me pakicë	4759	Dyqan tapetesh dhe qilimash	300.00 €
103.	Tregti me pakicë	4759	Dyqan dekorimesh për shtëpi	300.00 €
104.	Tregti me pakicë	4759	Dyqan artikujsh të ndryshëm shtëpiakë	300.00 €
105.	Tregti me pakicë	4761	Tregtia me pakicë e librave	150.00 €
106.	Tregti me pakicë	4762	Tregtia me pakicë e gazetave dhe artikujve të kancelarisë	150.00 €
107.	Transport dhe Logjistikë	4939	Transport pasagjerësh lokal	1,000.00 €
108.	Transport dhe Logjistikë	4939	Transport ndërurban dhe ndërkombëtar i pasagjerëve	2,000.00 €
109.	Transport dhe Logjistikë	4941	Transport rrugor i mallrave	1,000.00 €
110.	Transport dhe Logjistikë	5221	Terminale dhe aktivitete mbështetëse të transportit tokësor	1,000.00 €
111.	Transport dhe Logjistikë	5223	Aktivitete shërbyese të rastit për transportin ajror	500.00 €
112.	Transport dhe Logjistikë	5223	Operim i terminaleve ajrore	1,000.00 €
113.	Transport dhe Logjistikë	5223	Shërbime të kontrollit të trafikut ajror	1,000.00 €
114.	Transport dhe Logjistikë	5223	Shërbime të navigimit ajror	1,000.00 €
115.	Transport dhe Logjistikë	5223	Shërbime në tokë për avionët (ground handling)	1,000.00 €
116.	Transport dhe Logjistikë	5223	Shërbime sigurie dhe mbështetje teknike në aeroporte	1,000.00 €

Nr.	Sektori	Kodi NACE	Veprimtaria	Tarifa vjetore (€)
117.	Transport dhe Logjistikë	5223	Operim i hangarëve dhe infrastrukturës ndihmëse	1,000.00 €
118.	Transport dhe Logjistikë	5320	Korrier lokal	500.00 €
119.	Transport dhe Logjistikë	5320	Operator postar/korrier kombëtar ose ndërkombëtar	2,000.00 €
120.	Transport dhe Logjistikë	7911	Aktivitetet e agjencive të udhëtimit	300.00 €
121.	Transport dhe Logjistikë	7911	Shitje dhe ndërmjetësim i biletave të udhëtimit	300.00 €
122.	Transport dhe Logjistikë	7911	Rezervim hotelesh	300.00 €
123.	Transport dhe Logjistikë	7911	Organizim i udhëtimeve individuale	300.00 €
124.	Transport dhe Logjistikë	7911	Rezervim i transportit ajror, tokësor ose detar	300.00 €
125.	Transport dhe Logjistikë	7911	Shitje e paketave turistike të operatorëve turistike	300.00 €
126.	Transport dhe Logjistikë	7912	Aktivitetet e operatorëve turistike	300.00 €
127.	Transport dhe Logjistikë	7912	Projektim dhe organizim i paketave turistike	300.00 €
128.	Transport dhe Logjistikë	7912	Kombinim i transportit, akomodimit, ushqimit dhe aktiviteteve	300.00 €
129.	Transport dhe Logjistikë	7912	Organizim i tureve brenda dhe jashtë vendit	300.00 €

Nr.	Sektori	Kodi NACE	Veprimtaria	Tarifa vjetore (€)
130.	Transport dhe Logjistikë	7912	Shitje e paketave turistike drejtpërdrejt ose përmes agjencive	300.00 €
131.	Transport dhe Logjistikë	7912	Organizim i ekskursioneve dhe tureve tematike	300.00 €
132.	Shërbime profesionale	6831	Agjenci e patundshmërive	200.00 €
133.	Shërbime profesionale	6831	Zhvillues i projekteve ndërtimore dhe investitor i patundshmërive	300.00 €
134.	Shërbime profesionale	6910	Aktivitete juridike – avokat	150.00 €
135.	Shërbime profesionale	6910	Aktivitete juridike – noter	150.00 €
136.	Shërbime profesionale	6910	Aktivitete juridike – përmbaues privat	150.00 €
137.	Shërbime profesionale	6910	Aktivitete juridike – ndërmjetësues	150.00 €
138.	Shërbime profesionale	6920	Kontabilitet, librëmbajtje dhe auditim	150.00 €
139.	Shërbime profesionale	7112	Ndërmarrje projektuese dhe inxhinierike	150.00 €
140.	Shërbime profesionale	8220	Aktivitete të qendrave të thirrjeve	500.00 €
141.	Shërbime profesionale	7420	Fotograf	80.00 €
142.	Shërbime profesionale	8219	Fotokopje dhe shumëfishim dokumentesh	80.00 €
143.	Shërbime profesionale	7022	Konsulencë menaxheriale dhe biznesore	80.00 €
144.	Shërbime profesionale	7120	Testim dhe analiza teknike	250.00 €
145.	Shërbime profesionale	7311	Agjenci marketingu dhe reklame	200.00 €
146.	Arsimi	8510	Kopsht privat	300.00 €
147.	Arsimi	8520	Shkollë fillore private	300.00 €
148.	Arsimi	8531	Shkollë e mesme private	300.00 €
149.	Arsimi	8532	Shkollë e mesme profesionale private	300.00 €
150.	Arsimi	8542	Universitet privat	500.00 €
151.	Arsimi	8559	Akademi / qendër trajnimi	300.00 €

Nr.	Sektori	Kodi NACE	Veprimtaria	Tarifa vjetore (€)
152.	Arsimi	8553	Autoshkollë	300.00 €
153.	Shëndetësi	8621	Ambulancë shëndetësore	150.00 €
154.	Shëndetësi	8621	Ambulancë specialistike e mjekësisë familjare	150.00 €
155.	Shëndetësi	8623	Ambulancë stomatologjike	300.00 €
156.	Shëndetësi	8690	Ambulancë e ergoterapisë	150.00 €
157.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike kirurgjike	300.00 €
158.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e ortopedisë	300.00 €
159.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e urologjisë	300.00 €
160.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e gjinekologjisë	300.00 €
161.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e otorinolaringologjisë	300.00 €
162.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e oftalmologjisë/shërbim optik	300.00 €
163.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e fiziatrisë	150.00 €
164.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e fiziatrisë me terapi fizikale	300.00 €
165.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e sëmundjeve ngjitëse	500.00 €
166.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e pulmologjisë	300.00 €
167.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e alergologjisë me imunologji klinike	300.00 €
168.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e pediatriisë	150.00 €
169.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e neonatologjisë	300.00 €
170.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e sëmundjeve të brendshme	300.00 €
171.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e onkologjisë	300.00 €
172.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e neurologjisë	300.00 €
173.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e psikiatriisë	150.00 €
174.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e neuropsikiatriisë	300.00 €
175.	Shëndetësi	8690	Ambulancë e psikologjisë klinike	80.00 €
176.	Shëndetësi	8690	Ambulancë e seksologjisë klinike	80.00 €
177.	Shëndetësi	8690	Ambulancë logopedike	150.00 €
178.	Shëndetësi	8690	Ambulancë e terapisë fizikale	300.00 €
179.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e dermatologjisë	300.00 €
180.	Shëndetësi	8622	Ambulancë specialistike e mjekësisë sportive	300.00 €
181.	Shëndetësi	3250	Ortoprotetikë	300.00 €
182.	Shëndetësi	8690	Laborator mjekësor biokimik-hematologjik	300.00 €
183.	Shëndetësi	8690	Laborator i citologjisë	300.00 €

Nr.	Sektori	Kodi NACE	Veprimtaria	Tarifa vjetore (€)
184.	Shëndetësi	8690	Laborator i patologjisë	300.00 €
185.	Shëndetësi	8690	Laborator mjekësor i mikrobiologjisë klinike	500.00 €
186.	Shëndetësi	3250	Laborator i stomatologjisë	300.00 €
187.	Shëndetësi	8690	Laborator i mjekësisë transfuzive	500.00 €
188.	Shëndetësi	8622	Poliklinikë specialistike	500.00 €
189.	Shëndetësi	8690	Kabinet për radiologji	500.00 €
190.	Shëndetësi	8690	Kabinet për radiologji stomatologjike	300.00 €
191.	Shëndetësi	8690	Kabinet për ultrazë	300.00 €
192.	Shëndetësi	8690	Kabinet për tomografi të kompjuterizuar	500.00 €
193.	Shëndetësi	8690	Kabinet për rezonancë magnetike	500.00 €
194.	Shëndetësi	8690	Kabinet për angiografi digjitale subtraksionale	500.00 €
195.	Shëndetësi	8690	Ambulancë e mjekësisë nukleare	500.00 €
196.	Shëndetësi	8690	Kabinet i imazherisë radiologjike me dy ose më shumë veprimtari	500.00 €
197.	Shëndetësi	8610	Spital i përgjithshëm privat	1,000.00 €
198.	Shëndetësi	8610	Spital special privat	500.00 €
199.	Sport dhe Estetikë	9312	Klub sportiv amator	150.00 €
200.	Sport dhe Estetikë	9312	Akademi sportive	300.00 €
201.	Sport dhe Estetikë	9312	Klub sportiv profesional	300.00 €
202.	Sport dhe Estetikë	9313	Palestër fitnesi	300.00 €
203.	Sport dhe Estetikë	9313	Fitness & ëllness center	300.00 €
204.	Sport dhe Estetikë	9602	Floktari / berber	80.00 €
205.	Sport dhe Estetikë	9602	Sallon bukurie	150.00 €
206.	Sport dhe Estetikë	9602	Qendër estetike	300.00 €
207.	Sport dhe Estetikë	9604	Studio masazhi	300.00 €
208.	Sport dhe Estetikë	9604	Masazh dhe ëllness	300.00 €
209.	Sport dhe Estetikë	9604	Spa	400.00 €
210.	Sport dhe Estetikë	9604	Ëllness & spa resort urban	700.00 €
211.	Industri	2511	Industri mekanike	2,000.00 €
212.	Industri	2410	Industri metalurgjike	5,000.00 €

Nr.	Sektori	Kodi NACE	Veprimtaria	Tarifa vjetore (€)
213.	Industri	2010	Industri kimike	5,000.00 €
214.	Industri	0811	Gurëthyes dhe gurore	5,000.00 €
215.	Industri	1623	Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthtarisë ndërtuese	500.00 €
216.	Industri	3102	Prodhimi i mobilieve të kuzhinës	500.00 €
217.	Media dhe Botime	5811	Shtëpi botuese	300.00 €
218.	Media dhe Botime	1811	Veprimtari grafike dhe shtypshkronjë	300.00 €
219.	Prodhimi I gazit	3521	Prodhimi I gazit	2,000.00 €
220.	Ndertimtari dhe Infrastruktura	4212	Ndërtimi i hekurudhave mbi dhe nëntokësore	3,000.00 €
221.	Ndertimtari dhe Infrastruktura	4213	Ndërtimi i urave dhe tuneleve	3,000.00 €
222.	Tregti me shumice	4632	Tregtia me shumicë e mishit dhe produkteve të tij	500.00 €
223.	Postat e shpejta	5310	Veprimtaritë e postave me detyrimin e shërbimit të përgjithshëm (postat e shpejta)	1,000.00 €

SHTOJCA 2 – TARIFAT DHE NGARKESAT TJERA ADMINISTRATIVE

1. Tarifat për lëshimin e dokumentacionit

Nr.	Lloji i dokumentit ose shërbimit	Tarifa
1	Certifikatë e lindjes nga LAL	1 €
2	Certifikatë nga LAM	1 €
3	Certifikatë nga LAV	1 €
4	Certifikatë e statusit martesor	2 €
5	Certifikatë se personi është i gjallë	1 €
6	Procedura e kurorëzimit	2 €
7	Ceremonia e martesës në objektin e Kryeqytetit	15 €
8	Ceremonia e kurorëzimit jashtë objektit të Kryeqytetit	150 €
9	Certifikata të tjera	2 €
10	Vërtetim se personi është i lirë për martesë	1 €
11	Certifikatë e nënshtetësisë	2 €

2. Tarifat tjera të sektorit të ofiqarisë

Nr.	Lloji i dokumentit ose shërbimit	Tarifa
1	Dhënia e certifikatës në bazë të deklarimit të dy (2) dëshmitarëve	2 €
2	Deklaratë për bashkësinë familjare	2 €
3	Legalizimi i fotokopjes duke e krahasuar me dokumentin origjinal, për një faqe me tekst	1 €
4	Vërtetim mbi mjetet për jetesë	3 €
5	Vendim për korrigjimin e emrit personal	2 €
6	Vendim për ndërrimin e emrit personal	10 €
7	Kërkesë për regjistrim të mëvonshëm në LAL, LAM ose LAV	2 €
8	Kopje e vërtetuar e dokumentacionit të eksproprijimit, shpronësimit ose deeksproprijimit, pas përfundimit të procedurës administrative	5 €

SHTOJCA 3 – TAKSA PËR AUTOMJETET MOTORIKE

1. Taksa për automjetet motorike:

Nr.	Kategoria	Nënkategoria	Njësia matëse	Ngarkesa
1	Automjete dhe automjete-taksi, benzinë ose naftë	Deri në 3,500 cm ³	Për automjet	10 €
2	Automjete dhe automjete-taksi, benzinë ose naftë	Mbi 3,500 cm ³	Për automjet	20 €
3	Kamionë për transportin e mallrave, benzinë ose naftë	Deri në 3.5 tonë	Për kamion	10 €
4	Kamionë për transportin e mallrave, benzinë ose naftë	Mbi 3.5 tonë	Për kamion	20 €
5	Autobusë	Të gjitha kategoritë	Për autobus	20 €

2. Lirimet nga taksa për automjetet motorike

Nr.	Kategoria e automjeteve të liruara	Dokumenti dëshmuar
1	Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, vetëm për automjetet e zjarrfikësve;	Leja e qarkullimit
2	Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, vetëm për automjetet e ndihmës së shpejtë;	Leja e qarkullimit
3	Organizatës së Kombeve të Bashkuara apo cilitdo organ të saj, përfshirë këtu agjencitë dhe misionet e specializuara të saj;	Leja e qarkullimit
4	Bashkimit Evropian apo cilitdo organ të tij, përfshirë këtu agjencitë dhe misionet e specializuara të tij;	Leja e qarkullimit
5	Forcave Shumëkombëshe në Kosovë: KFOR, ICO, EULEX etj.;	Leja e qarkullimit
6	Përfaqësive dhe konsullatave të akredituara nga Republika e Kosovës; dhe	Leja e qarkullimit
7	Personave të verbër.	Leja e qarkullimit dhe dokumentacioni që dëshmon statusin
8	Automjetet e Policisë së Kosovës	Leja e qarkullimit
9	Automjetet civile të Policisë së Kosovës	Pa dokumentacion
10	Anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve dhe të të zhdukurve të UÇK-së, të familjeve të dëshmorëve të kombit, të rënë në forma të ndryshme për lirinë e vendit në periudha të ndryshme historike, dhe të familjeve të viktimave civile të luftës, vetëm për radhën e parë të trashëgimisë, në përputhje me dispozitat e Ligjit të trashëgimisë;	Leja e qarkullimit dhe dokumentacioni që dëshmon statusin
11	Veteranët e luftës së UÇK-së, invalidët e luftës së UÇK-së dhe invalidët e punës.	Leja e qarkullimit dhe dokumentacioni që dëshmon statusin
12	Të drejtën e liritë nga pagesa e taksës për automjete motorike e realizojnë të gjithë pronarët/poseduesit e kategorive të tjera që parashihen me ligje të tjera dhe që nuk janë përmendur në dispozitat e nënparagrafit 3.5	Leja e qarkullimit dhe dokumentacioni që dëshmon statusin

SHTOJCA 4 – Tarifat për shfrytëzim afatshkurtër të hapësirës publike**1. Qiraja dhe renta për pronën komunale - Zona e Bizneseve**

Nr.	Lloji i shfrytëzimit	Sipërfaqja	Periudha	Ngarkesa
1	Dhënia në shfrytëzim e lokaleve në pronësi komunale	Për m ²	Mujore	15.00 €/m ²
2	Dhënia në shfrytëzim e objektit për banim në pronësi komunale	Për m ²	Mujore	1.00 €/m ²
3	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	Deri në 100 m ²	Vjetore	8.00 €/m ²
4	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	101–500 m ²	Vjetore	7.00 €/m ²
5	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	501–1,000 m ²	Vjetore	6.00 €/m ²
6	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	1,001–3,000 m ²	Vjetore	4.50 €/m ²
7	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	3,001-5,000 m ²	Vjetore	3.50€/m ²
8	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	5,001-10,000	Vjetore	2.50€/m ²
9	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	Mbi 10,000 m ²	Vjetore	1.50 €/m ²

2. Qiraja dhe renta për pronën komunale - Zona I Afarizëm

Nr.	Lloji i shfrytëzimit	Sipërfaqja	Periudha	Ngarkesa
1	Dhënia në shfrytëzim e lokaleve në pronësi komunale	Për m ²	Mujore	13.00 €/m ²
2	Dhënia në shfrytëzim e objektit për banim në pronësi komunale	Për m ²	Mujore	1.00 €/m ²
3	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	Deri në 100 m ²	Vjetore	6.50 €/m ²
4	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	101–500 m ²	Vjetore	5.50 €/m ²
5	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	501–1,000 m ²	Vjetore	4.00 €/m ²
6	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	1,001–3,000 m ²	Vjetore	3.50 €/m ²
7	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	3,001-5,000 m ²	Vjetore	2.50€/m ²
8	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	5,001-10,000	Vjetore	1.50€/m ²
9	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	Mbi 10,000 m ²	Vjetore	1.00 €/m ²

3. Qiraja dhe renta për pronën komunale - Zona II Afarizëm

Nr.	Lloji i shfrytëzimit	Sipërfaqja	Periudha	Ngarkesa
1	Dhënia në shfrytëzim e lokaleve në pronësi komunale	Për m ²	Mujore	13.00 €/m ²
2	Dhënia në shfrytëzim e objektit për banim në pronësi komunale	Për m ²	Mujore	1.00 €/m ²
3	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	Deri në 100 m ²	Vjetore	6.50 €/m ²
4	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	101–500 m ²	Vjetore	5.50 €/m ²
5	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	501–1,000 m ²	Vjetore	4.00 €/m ²
6	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	1,001–3,000 m ²	Vjetore	3.50 €/m ²
7	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	3,001-5,000 m ²	Vjetore	2.50€/m ²
8	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	5,001-10,000	Vjetore	1.50€/m ²
9	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	Mbi 10,000 m ²	Vjetore	1.00 €/m ²

4. Qiraja dhe renta për pronën komunale - Zona III Afarizëm

Nr.	Lloji i shfrytëzimit	Sipërfaqja	Periudha	Ngarkesa
1	Dhënia në shfrytëzim e lokaleve në pronësi komunale	Për m ²	Mujore	10.00 €/m ²
2	Dhënia në shfrytëzim e objektit për banim në pronësi komunale	Për m ²	Mujore	1.00 €/m ²
3	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	Deri në 100 m ²	Vjetore	5.00 €/m ²
4	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	101–500 m ²	Vjetore	4.50 €/m ²
5	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	501–1,000 m ²	Vjetore	3.50 €/m ²
6	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	1,001–3,000 m ²	Vjetore	2.50 €/m ²
7	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	3,001–5,000 m ²	Vjetore	2.00 €/m ²
8	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	5,001–10,000	Vjetore	1.50 €/m ²
9	Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës	Mbi 10,000 m ²	Vjetore	0.80 €/m ²

5. Infrastruktura nëntokësore

Nr.	Lloji i shfrytëzimit ose investimit	Njësia	Ngarkesa
1	Shfrytëzimi ose përdorimi nga personi i tretë i tubacionit të infrastrukturës nëntokësore të investuar nga Kryeqyteti	Për metër gjatësi, në vit	8 €
2	Investimi vetanak i personit të tretë në infrastrukturën nëntokësore, duke përfshirë hapjen e kanaleve, vendosjen e tubave dhe punimet në puseta	Për metër gjatësi të projektit	3 €

1.1. Ndërmarrja publike lokale lirohet nga këto ngarkesa kur është përdoruese ose investuese në projektet e përcaktuara në këtë tabelë.

6. Antenat dhe rrjetet kablllore

Nr.	Lloji i investimit	Vlera e investimit	Norma
1	Ndërtimi i antenave televizive, telekomunikuese, kablllore dhe të ngjashme	Deri në 50,000 €	4‰
2	Ndërtimi i antenave televizive, telekomunikuese, kablllore dhe të ngjashme	Mbi 50,000 € deri në 100,000 €	3.5‰
3	Ndërtimi i antenave televizive, telekomunikuese, kablllore dhe të ngjashme	Mbi 100,000 € deri në 500,000 €	3‰
4	Ndërtimi i antenave televizive, telekomunikuese, kablllore dhe të ngjashme	Mbi 500,000 €	2‰
5	Shtrirja e rrjetit kabllor të internetit	Për metër gjatësi	1 €

7. Kiosqet dhe objektet e montueshme

Lloji i shfrytëzimit	Zona I	Zona II	Zona III	Zona IV	Periudha
Vendosja e kioskave dhe objekteve të tjera të montueshme ku ushtrohet kryesisht veprimtari tregtare	14 €/m ²	11 €/m ²	8 €/m ²	5.6 €/m ²	Mujore

8. Pajisjet për akullore dhe veprimtari të ngjashme

Lloji i shfrytëzimit	Zona I	Zona II	Zona III	Zona IV	Periudha
Vendosja e pajisjes për akullore ose pajisjes së ngjashme	15 €/pajisje	10 €/pajisje	7 €/pajisje	5 €/pajisje	Mujore

9. Stendat e hapura dhe të lëvizshme

Lloji i shfrytëzimit	Zona I	Zona II	Zona III	Zona IV	Periudha
Vendosja e stendës së hapur ose të lëvizshme për shitjen e librave joshkollorë	30 €	25 €	20 €	10 €	Mujore

1.1.1. Kuvendi autorizon Kryetarim të bëjë lirimin nga pagesa e kësaj ngarkese në raste të arsyetuara.

10. Foltoret telefonike dhe shkallët para objekteve

Nr.	Lloji i shfrytëzimit	Njësia/Periudha	Ngarkesa
1	Vendosja e foltores telefonike	Për foltore, në muaj	200 €
2	Vendosja e shkallëve para objektit ku ushtrohet veprimtaria e regjistruar	Për m ² , në vit	100 €

11. Shfrytëzimi i hapësirës para objekteve tregtare dhe hoteliere

Lloji i shfrytëzimit	Zona I	Zona II	Zona III	Zona IV	Periudha
Shfrytëzimi i hapësirës para objektit ku ofrohen shërbime tregtare ose hoteliere	8 €/m ²	6 €/m ²	4 €/m ²	3 €/m ²	Mujore

12. Shfrytëzimet e tjera të hapësirës publike

Nr.	Lloji i shfrytëzimit	Zona/Sipërfaqja	Periudha	Ngarkesa
1	Vendosja e automjetit të lëvizshëm për shitjen e ushqimit të shpejtë	Për automjet	Mujore	70 €
2	Vendosja e tendës së hapur dhe të lëvizshme me mekanizëm	Për m ²	Vjetore	11 €/m ²
3	Vendosja e pajisjeve për lojëra të fëmijëve	Për m ²	Vjetore	6 €/m ²
4	Vendosja e gjeneratorit statik	Zona I	Mujore	14 €/m ²
5	Vendosja e gjeneratorit statik	Zona II	Mujore	11 €/m ²
6	Vendosja e gjeneratorit statik	Zona III	Mujore	8.6 €/m ²
7	Ekspozimi ose deponimi i mallit dhe ambalazhit	Zona I	Mujore	28 €/m ²
8	Ekspozimi ose deponimi i mallit dhe ambalazhit	Zona II	Mujore	21 €/m ²
9	Ekspozimi ose deponimi i mallit dhe ambalazhit	Zona III	Mujore	14 €/m ²
10	Ekspozimi ose deponimi i mallit dhe ambalazhit	Zona IV	Mujore	7 €/m ²

SHTOJCA 5 – Tarifat për reklama

1. Reklammat, panot dhe ekranet elektronike

Nr.	Lloji i reklamimit	Periudha	Ngarkesa
-----	--------------------	----------	----------

1	Ekspozimi i panove reklamuese dhe muraleve brenda qytetit	Vjetore	80 €/m ²
2	Ekspozimi i panove reklamuese dhe muraleve me ndriçim brenda qytetit	Vjetore	300 €/m ²
3	Ekspozimi i automjetit vetëm për qëllime reklamuese	Vjetore	300 €/m ²
4	Ekspozimi i panove reklamuese jashtë qytetit	Vjetore	60 €/m ²
5	Ekspozimi i panove reklamuese me ndriçim jashtë qytetit	Vjetore	150 €/m ²
6	Ekspozimi i reklamave në autobusë	Vjetore	50 €/m ²
7	Ekspozimi i reklamave në automjete me 8+1 ulëse	Vjetore	50 €/m ²
8	Ekspozimi i reklamave në automjete me 4+1 ulëse	Vjetore	50 €/m ²
9	Vendosja e ekraneve elektronike reklamuese	Vjetore	300 €/m ²

SHTOJCA 6 – ZONA E KUFIZUAR E TRAFIKUT

ZTL është zona e kufizuar nga: Rr. Fehmi Lladrovci – Rr. Xhevë Lladrovci – Rr. Afrim Zhitia – Rr. Agim Ramadani – Rr. Ilir Konushevc – Rr. Sami Plakolli – Rr. Zagrebi – Rr. Tirana - Rr. Hekurudha - Rr. Jusuf Gërvalla – Rr. 5 Maji.



Figure 1 HARTA E ZONËS SË KUFIZUAR TË TRAFIKUT

SHTOJCA 7 – TARIFAT DITORE TË ZTL-së SIPAS KATEGORISË SË AUTOMJETIT

Tarifat ditore sipas kategorisë së automjetit për ditë për automjetin që hyn në ZTL gjatë orarit të zbatimit. Hyrjet e shumëfishta brenda së njëjtës ditë nuk krijojnë tarifë shtesë.

Kategoria e automjetit	Tarifa ditore (€)
Elektrike	0.00 €
Hibrid plug-in	1.00 €
Hibrid	2.00 €
Benzinë Euro 6	2.00 €
Diesel Euro 6	2.00 €
Benzinë Euro 5 ose më e vjetër	2.00 €
Diesel Euro 5 ose më i vjetër	2.00 €
Motoçikletë	0.00 €
Furgon / automjet i lehtë komercial	5.00 €
Kamion / autobus jo-publik	10.00 €

SHTOJCA 8 – PARAMETRAT, METODOLOGJIA E MODELIT A–G DHE REZULTATET SIPAS METODOLOGJISË

Ky është material orientues dhe sqarues

Kodi	Kriteri	Pesha	Shkalla / interpretimi	Pragu minimal	Tarifa minimale (€)	Tarifa maksimale (€)
A	Pesha ekonomike sektoriale dhe kompleksiteti tipik	1.00	1–5: Pesha ekonomike sektoriale dhe kompleksiteti tipik	4	80 €	150 €
B	Gjenerimi i trafikut	1.00	1–5: udhëtime, klientë, furnizime	9	150 €	300 €
C	Shfrytëzimi i infrastrukturës	1.00	1–5: rrugë, parking, ujë, kanalizim, hapësira	13	300 €	500 €
D	Ndikimi mjedisor	1.00	1–5: emetime, zhurmë, mbeturina, ujë/energji	17	500 €	1,000 €
E	Kosto administrative	1.00	1–5: verifikim, inspektim, koordinim	21	1,000 €	2,000 €
F	Ndikimi urban	1.00	1–5: mobilitet, dendësi, siguri, planifikim	25	2,000 €	3,000 €
G	Pesha strategjike	1.00	-2 = prioritet i fortë / lehtësim; +2 = eksternalitet / ngarkesë	29	3,000 €	5,000 €

Metodologjia A–G

- Tarifat e [Shtojcës 1](#) arsyetohen në nivel të kategorisë së veprimtarisë sipas këtyre kriterëve: A – pesha ekonomike sektoriale dhe kompleksiteti tipik;
B – gjenerimi i trafikut;
C – përdorimi i infrastrukturës dhe shërbimeve urbane;
D – ndikimi mjedisor dhe menaxhimi i mbeturinave;
E – kompleksiteti administrativ komunal;
F – ndikimi urban, siguria dhe qasja;
G – pesha strategjike.
- Kriteret A–F vlerësohen me pikë nga një (1) deri në pesë (5).
- Kriteri G vlerësohet nga minus dy (–2) deri në plus dy (+2), ku vlera negative pasqyron interesin publik ose nevojën për stimulim strategjik.
- Pikëzimi bëhet për kategorinë dhe nuk ndryshohet sipas gjendjes individuale të biznesit. Çdo ndryshim i pikëve ose tarifës bëhet vetëm me ndryshim të [Shtojcës 1](#) nga Kuvendi i Kryeqytetit.

Kodi	Kriteri	Shkalla	Udhëzimi
A	Pesha ekonomike sektoriale dhe kompleksiteti tipik	1–5	Vlerësim i kategorisë, jo i qarkullimit ose fitimit të operatorit individual.
B	Gjenerimi i trafikut	1–5	Lëvizja tipike e klientëve, furnizimeve dhe automjeteve.
C	Përdorimi i infrastrukturës	1–5	Ujë, energji, kanalizim, rrugë, parking dhe shërbime urbane.
D	Ndikimi mjedisor	1–5	Ndotje, zhurmë, mbeturina, materiale të rrezikshme dhe emetime.
E	Kompleksiteti administrativ	1–5	Koordinimi dhe administrimi komunal, pa dyfishuar licencimin sektorial.
F	Ndikimi urban dhe siguria	1–5	Qasja emergjente, siguria publike, furnizimi dhe funksionimi urban.
G	Pesha strategjike	–2 deri +2	–2 interes i lartë publik; 0 neutral; +2 ndikim në kundërshtim me objektivat strategjike.

Brezat orientues të tarifës

- Totali llogaritet si shuma e pikëve A–F dhe korrigjimi G. [Shtojca 1](#) cakton tarifën fikse për secilën kategori brenda brezit përkatës.

Totali A–G	Brezi orientues vjetor
4–8	80–150 €
9–12	150–300 €
13–16	300–500 €

Totali A–G	Brezi orientues vjetor
17–20	500–1,000 €
21–24	1,000–2,000 €
25–28	2,000–3,000 €
29–32	3,000–5,000 €

Rezultatet e vlerësimit sipas metodologjisë A-G

Nr.	Sektori	Kodi NACE	Veprimtaria	A	B	C	D	E	F	G	Totali i ponderuar A-G	Brezi Tarifor min (€)	Brezi Tarifor max (€)	Tarifa vjetore (€)
1.	Energjia dhe shërbimet publike	3511	Prodhimi i rrymës elektrike	5	3	5	3	4	4	- 1	23.00	1,000.00 €	2,000.00 €	1,000.00 €
2.	Energjia dhe shërbimet publike	3513	Operator i rrjetit energjetik (KEK/KEDS/KESCO ose i ngjashëm)	5	3	5	4	5	5	- 1	26.00	2,000.00 €	3,000.00 €	3,000.00 €
3.	Energjia dhe shërbimet publike	3600	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	5	3	5	4	4	4	- 2	23.00	1,000.00 €	2,000.00 €	1,000.00 €
4.	Ndërmarrje publike	3600	Ndërmarrje rajonale e ujës-jellësit	5	3	5	3	5	5	- 2	24.00	1,000.00 €	2,000.00 €	2,000.00 €
5.	Ndërmarrje publike	3811	Ndërmarrje për menaxhimin e mbeturinave	4	3	5	4	4	4	- 2	22.00	1,000.00 €	2,000.00 €	2,000.00 €

6.	Energji dhe Telekom	6110	Operator telekomunikimi (fiks, mobil, satelitor, ISP)	5	3	5	2	4	5	-1	23.00	1,000.00 €	2,000.00 €	1,500.00 €
7.	Energji dhe Telekom	6110	Njësi/degë e operatorit telekomunikues	5	2	5	2	3	4	-1	20.00	500.00 €	1,000.00 €	500.00 €
8.	Infrastrukturë digjitale	6311	Data processing, hosting dhe aktivitete të ndërlidhura	5	2	5	3	3	3	-2	19.00	500.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €
9.	Sektori financiar	6419	Bankë me licencë bankare – seli	5	4	4	1	4	4	0	22.00	1,000.00 €	2,000.00 €	2,000.00 €
10.	Sektori financiar	6419	Degë/njësi bankare	5	4	4	1	4	4	0	22.00	1,000.00 €	2,000.00 €	1,500.00 €
11.	Sektori financiar	6419	Zonë bankare vetëshërbyese 24/7	5	3	3	1	2	3	0	17.00	500.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €
12.	Sektori financiar	6419	Bankomat i pavarur (ATM/CDM)	5	2	2	1	2	2	0	14.00	300.00 €	500.00 €	500.00 €
13.	Sektori financiar	6492	Institucion mikrofinanciar – seli ose njësi	4	3	3	1	3	3	0	17.00	500.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €
14.	Sektori financiar	6619	Institucion pagesash dhe transfertash – seli ose njësi me seli jashtë kryeqytetit	4	3	3	1	3	3	0	17.00	500.00 €	1,000.00 €	700.00 €
15.	Sektori financiar	6512	Sigurimi jojetësor	5	3	3	1	3	3	0	18.00	500.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €
16.	Sektori financiar	6511	Sigurimi i jetës	5	3	3	1	3	3	0	18.00	500.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €
17.	Automjete	4511	Tregtia e veturave dhe automjeteve të reja	4	4	4	3	2	3	0	20.00	500.00 €	1,000.00 €	700.00 €
18.	Automjete	4511 4519	Tregtia e veturave dhe automjeteve të përdorura	4	4	4	3	2	3	0	20.00	500.00 €	1,000.00 €	600.00 €

19.	Automjete	4520	Auto-servis i përgjithshëm	3	4	4	4	1	1	0	17.00	500.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €
20.	Automjete	4520	Auto-servis i autorizuar i prodhuesit	4	4	4	4	2	3	0	21.00	1,000.00 €	2,000.00 €	1,500.00 €
21.	Automjete	4520	Autolarje	4	4	4	4	2	2	0	20.00	500.00 €	1,000.00 €	500.00 €
22.	Automjete	4520	Qendër auto-detailing	4	4	4	3	2	3	0	20.00	500.00 €	1,000.00 €	500.00 €
23.	Automjete	7711	Dhënie automjesh me qira (Rent-a-Car)	4	4	4	3	2	3	0	20.00	500.00 €	1,000.00 €	500.00 €
3.2.1 TË GJETURAT, KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET E BAZUARA NË OBJEKTIVIN E AUDITIMIT

OBJEKTIVI 1: Të vlerësohet nëse mirëmbajtja e objekteve shkollore planifikohet dhe menaxhohet në mënyrë të rregullt për të siguruar kushte të sigurta, funksionale dhe higjienike për nxënësit dhe stafin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3.2.1 KRITERI

Sipas Rregullore Rr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 001/2022 për prokurimin te neni 70.23 dhe 70.24 tregon detyrat dhe përgjegjësit e menaxherit të kontratës se si duhet ta mbikëqyrë dhe monitoroj një kontratë për të cilën caktohet, si dhe me Ligjin për kontrollin e brendshëm, menaxheri i kontratës është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës, sigurimin që shërbimet ofrohen sipas kushteve të përcaktuara dhe që operatori ekonomik përmbush të gjitha obligimet kontraktuale. Po ashtu, tek kontratat qe janë lidhure me OE ku janë te përcaktuara kushtet e përgjithshme dhe te veçanta te prej te cilave rrjedhin obligimet e te dy palëve nënshkruese të kontratës ku te cilat duhet të zbatohen në tërësi, përfshirë mbulimin e të gjitha institucioneve të parapara, përdorimin e pajisjeve përkatëse dhe furnizimin me produkte sipas specifikimeve (p.sh. materiale ekologjike).

1.2.1 GJENDJA

Tabela 3

Përshkrimi; Pastrimin e objekteve edukative arsimore të Komunës së Prishtinës Lloto 1 dhe 2	Llota 1	Llota 2
Vlera e kontratës	1,426,797 €	528,256 €
Shfrytëzimi i 30%	po	po
Numri i shkollave të parapara	37	16
Numri i shkollave të furnizuara/atestuara	9 shkolla të furnizuara	nuk e dim sakt
Evidenca për furnizime	Vetëm 9 nga 37(sipas faturës)	Vetëm 1 shkollë posedonte evidencë
Cilësia e materialeve	Material me cilësi të dobët	Materiale të cilësisë së dobët
Material higjienik	6,295.00€/muaj	1,297.70€/muaj
Materiale shtesë	Nuk është cekur	450€/muaj
Vlera mujore e faturës sipas kontratës	78,266 €	29,347 €
Vlera mujore e faturës me shtes 30%	88,914 €	40,388 €
Numri i Punëtorëve	Nuk kemi ka dëshmi lista e punëtorëve nga fillimi i kontratës	Nuk kemi ka dëshmi lista e punëtorëve nga fillimi i kontratës
Pagesat totale gjatë 2025	885,785.00 €	457,178.36 €

Sipas menaxherit të kontratës, operatori ekonomik nuk ka ofruar evidencë mujore të punëtorëve sipas shpërndarjes nëpër institucione, në përputhje me analizën financiare, duke e bërë të pamundur verifikimin nëse punëtorët e pastrimit kanë qenë të angazhuar në të gjitha shkollat sipas kontratës edhe pse në dy kontratat edhe për Pastrimin e objekteve edukative arsimore të Komunës së Prishtinës Lloto 1 dhe 2 kanë pasur punëtor shtesë siç shihet edhe në tabel 3.

Nga verifikimet në terren është vërejtur se në disa shkolla shërbimet e pastrimit kanë filluar me kohë, ndërsa në disa të tjera me vonesë. Gjithashtu, në disa raste mungojnë regjistrat e brendshëm që dëshmojnë datën e fillimit të punës së punëtorëve të pastrimit.

Tutje, në pothuajse të gjitha shkollat është konstatuar se nuk janë përdorur pajisjet e pastrimit nga operatori ekonomik, por janë shfrytëzuar vetëm pajisjet ekzistuese të shkollave. Po ashtu, nuk është realizuar pastrimi i xhamave në hapësira të larta, aty ku kërkohen pajisje specifike.

Në të gjitha shkollat është evidentuar përdorimi i materialeve jo ekologjike, ndërsa gjatë diskutimit me menaxherin e kontratës, ai ka deklaruar se nuk ka qenë i informuar që produktet e furnizimit duhet të jenë ekologjike dhe se është dashtë të ketë pasisje për pastrim, ne po thuaj se të gjitha shkollat është konstatuar se materialet të gjitha janë me cilësisë të dobët dhe materiali që ka qenë në depo është materiali që janë furnizuar që nga fillimi. Kemi bërë ekzaminim fizik dhe kemi zhvilluar pyetësor në 16 institucione.¹

Gjithashtu në institucionet që nuk kanë dërguar material higjienik kanë shfrytëzuar kontratën tjetër që është lidhur nga Kryeqyteti për punëtorët teknik që janë nëpër institucione e që ka qenë në vlerë 32,679 € e cila gjithashtu ka furnizuar shkollat me materiale të cilësisë së dobët.

Kemi identifikuar edhe një kontratë tjetër me vlerë të vogël 99€ për furnizim me material higjienik!

3.3.1 SHKAKU

Mangësitë në planifikimin, monitorimin dhe menaxhimin e kontratave për furnizim me materiale higjienike kanë ndikuar që furnizimet të mos realizohen në të gjitha institucionet sipas obligimeve kontraktuale. Po ashtu, mungesa e kontrollit efektiv nga menaxheri i kontratës dhe moskoordinimi ndërmjet Drejtorisë së Arsimit dhe menaxherëve të kontratave ka rezultuar me përdorimin e kontratave të tjera për të mbuluar nevojat e shkollave. Për më tepër, lidhja e kontratave me vlera të vogla për furnizim me materiale higjienike tregon planifikim të dobët të nevojave dhe rrezik të përdorimit shtesë të mjeteve financiare të pa kontrolluara!

Kjo situatë ka ardhur si rezultat i menaxhimit joefektiv të kontratës dhe mungesës së njohurive të mjaftueshme të menaxherit të kontratës lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Gjithashtu, ka munguar mbikëqyrja e duhur për të siguruar që operatori ekonomik zbaton kontratën sipas kushteve të përcaktuara.

Sipas mbikëqyrjes se njëres kontratë kanë qenë edhe pagesat e vonuara nga Kryeqyteti!

3.4.1NDIKIMI

Moszbatimi i plotë i kontratës ka ndikuar që një numër i konsiderueshëm i shkollave të mos përfitojnë shërbimet e pastrimit sipas planit, duke krijuar kushte jo të mira higjienike. Kjo ndikon drejtpërdrejt në shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve, si dhe në kushtet e punës për stafin arsimor. Mungesa e pajisjeve dhe përdorimi i materialeve jo ekologjike rrit rrezikun për dëmtim të ambientit dhe shëndetit, ndërsa gjithashtu krijon rrezik për mosshfrytëzim efikas të fondeve publike dhe mosarritje të objektivave të kontratës.

¹ Emin Duraku,Eqrem Qabej,Xizillonjat,Elena Gjika,Ahmet Gashi,Ditët e Minatorit,Asim Vokshi,Dardania,Gëzim Ynë,Gjergj Fishta,Gjinnazi Specialistik i Matematikës,Xhevdet Doda,Teuta,Zenet Hajdini,Iliria,Ditëria,Teuta

3.5.1 REKOMANDIMI I LARTË

Rekomandohet që menaxheri i kontratës të sigurojë zbatim të plotë të detyrave dhe përgjegjësi të tij, përfshirë monitorimin e vazhdueshëm të kontratës dhe verifikimin e përmbushjes së obligimeve nga operatori ekonomik. Gjithashtu, menaxheri i kontratës duhet të ndjekë trajnime për menaxhimin e kontratave me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale. Bazuar në mangësitë e identifikuar dhe moszbatimin e plotë të obligimeve kontraktuale nga operatori ekonomik, rekomandohet që autoriteti kontraktues të shqyrtojë aplikimin e masave kontraktuale, përfshirë aktivizimin/mbajtjen e sigurimit të ekzekutimit në përputhje me kushtet e kontratës dhe legjislacionin në fuqi.

Po ashtu, të shqyrtohet mundësia e kompensimit apo kthimit të mjeteve për materialet higjienike dhe obligimet tjera të papërmbushura, në rastet kur vërtetohet se ato nuk janë ofruar sipas kushteve të kontratës.

Në të ardhmen, në kushtet e veçanta të kontratave duhet të përfshihen në mënyrë të detajuar:

- llojet e produkteve/materialeve (me specifikim që duhet të jenë ekologjike),
- numri i punëtorëve për secilën shkollë/institucion,
- lista e pajisjeve për pastrim që operatori ekonomik obligohet t'i sigurojë.

Rekomandoj Kryetarin për autorizim për të identifikuar tutje se punëtorët me këto kontratë janë paguar sipas legjislacionit në fuqi të ATK-se, dukë e ditur që ka pasur ankesa nga punëtorët të cilët kanë qenë në grevë për mospagim të pagës mujore!

3.2.1 TË GJETURAT, KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET E BAZUARA NË OBJEKTIVIN E AUDITIMIT

OBJEKTIVI 2: Të vlerësohet nëse investimet për renovimin e objekteve shkollore planifikohen dhe menaxhohen, sipas nevojave të shkollave dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi

3.2.2 KRITERI

MIRËMBAJTJEN E RREGULLT TEKNIKE DHE RENOVIMIN URGJENT TË NDËRTESAVE EDUKATIVO-ARSIMORE NË KOMUNËN E PRISHTINËS (me numer Protikolli Hi-030/01-122176/23,date 14/06/2023

E lidhur në mes:1. Komunës së Prishtinës, të cilën e përfaqëson Përparim Rama, Kryetar i Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtutjeshëm "Autoriteti Kontrakutes") dhe 2. Ndërmarrjes Publike Banësore SH. A, Prishtinë, të cilën e përfaqëson Arton Berisha, Kryeshef Ekzekutiv (në tekstin e mëtutjeshëm "Ofruesi i Shërbimeve"). Neni 1 Lënda 1.1. Lënda e kësaj kontrate është që të themeloj kushtet, duke përfshirë shërbimet, çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen shërbimeve të Mirëmbajtjes së rregullt teknike dhe Renovimit urgjent të ndërtesave edukativo-arsimore në komunën e Prishtinës Lënda 1.2. Këto shërbime ekzekutohen me kapacitete ekzistuese apo kapacitete të shtuara të cilat mund të anashohen sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me SHTOJCËN A dhe SHTOJCËN B ku janë të përfshira Specifikacioni Teknik dhe Përshkrimi i Çmimeve.

GJENDJA

Kryeqyteti nga kontrata e lidhur me NPB për renovimin e hapësirave në institucione arsimore një pjesë është investuar të SHFMU "Zenel Hajdini", në vlerë totale prej 366,566.72€, si në vijim:
Tabela 4

Nr	Përshkrimi	Data	Vlera
16	SHFMU "Zenel Hajdini" – renovimi i hapësirave të shkollës	26.09.2025	165,024.00 €
21	SHFMU "Zenel Hajdini" – vazhdimi i renovimit në hapësira të shkollës	12.12.2025	201,542.72 €
	Totali i investimit		366,566.72 €

Vizita 1. Megjithë vlerën e konsiderueshme të investimit, gjatë vizitës në teren dhe diskutimin me stafin e shkollës është konstatuar se një pjesë e madhe e punimeve nuk janë realizuar me cilësinë dhe standardet e nevojshme teknike, ndërsa disa punime kanë mbetur të papërfunduara.

Objekti ishte konsideruar funksional që nga shtatori i vitit 2025, megjithatë gjatë vizitës janë evidentuar mangësi të shumta në realizimin e investimeve. Në nyjet sanitare janë konstatuar punime të papërfunduara, mungesë e pjesëve përcjellëse të pajisjeve sanitare, përfshirë pjesë të guacave të banjove, si dhe investim i dobët në dyert e banjove kishte rast që nuk janë izoluar fare.

Në klasë dhe korridore, në hapësirat ku janë realizuar intervenime në dysHEME, punimet nuk janë përfunduar në pjesët anësore, ndërsa në muret anësore të klasave dhe korridoreve është vërejtur rënie e llaçit/malterit pas realizimit të intervenimeve. Gjendja e dysHEMEVE të renovuara nuk reflekton cilësi dhe qëndrueshmëri të investimit të realizuar.

Tutje, është konstatuar se kulmi i shkollës vazhdon të ketë probleme me depërtimin e ujit edhe pse sipas dokumentacionit janë realizuar intervenime. Gjatë vizitës është vërejtur se gypat vertikal të ujërave atmosferike (olluqet) nga jashtë objektit nuk janë vendosur deri në fund të murit, por janë ndërprerë në gjysmën e fasadës së objektit. Si pasojë, ujërat nga reshjet kanë depërtuar dhe kanë dëmtuar fasadën e jashtme të shkollës.

Ndërsa si pasojë e lagështisë dhe problemeve me kulmin, në tavane të klasave janë vërejtur shenja të lagështisë dhe kundërmim i rëndë, gjendje kjo shqetësuese për shëndetin dhe sigurinë e nxënësve dhe stafit të shkollës.

Në përgjithësi, gjatë vizitës në teren është vërejtur se në pothuajse në shumicën e hapësirave ku janë kryer intervenime, punimet janë realizuar me cilësi të dobët dhe një pjesë e dëmtimeve janë paraqitur ende pa hyrë investimi në funksion të plotë, pavarësisht shumës së konsiderueshme të mjeteve publike të investuara në këtë objekt shkollor.

Po ashtu, në hapësirat e kulmit janë evidentuar materiale kancerogjene të cilat nuk janë larguar.

Vizita 2. Në SHMU "Elena Gjika" janë realizuar intervenime në nyjet sanitare, mirëpo gjatë vizitës në teren së bashku me menaxherin e kontratës nga Kryeqyteti është konstatuar se punimet ende nuk janë plotësisht funksionale, edhe pse sipas stafit të shkollës dhe ankesave të vazhdueshme të tyre, punimet kishin filluar që nga tetori i vitit 2025.

Sipas menaxhmentit të shkollës, nga NPB ishte dërguar konstatim për pranimin/nënshkrimin e punimeve, mirëpo shkolla nuk kishte pranuar ta nënshkruajë për shkak të mangësive dhe mosfunksionalitetit të punimeve të realizuara.

Gjithashtu, gjatë realizimit të intervenimeve në banjo janë shkaktuar dëmtime në dritaret e shkollës, të cilat nuk janë riparuar nga realizuesi i punimeve. Për shkak të rrezikut potencial për nxënësit, stafi teknik i shkollës kishte improvizuar mbylljen e tyre me materiale druri për

të shmangur lëndimet e mundshme të fëmijëve.

Po ashtu, gjatë gjithë periudhës së realizimit të punimeve, nxënësit kanë qenë të detyruar të shfrytëzojnë vetëm banjot në njërën anë të shkollës, duke krijuar frekuencë dhe mbingarkesë të lartë në përdorim. Kjo gjendje ka ndikuar negativisht në mirëmbajtjen e higjienës dhe kushteve sanitare për nxënësit, duke rritur rrezikun potencial për përhapje të infeksioneve dhe problemeve të tjera shëndetësore.

Edhe aktualisht, banjot që janë në përdorim nuk janë plotësisht funksionale dhe nuk ofrojnë kushte adekuate për shfrytëzim normal nga nxënësit.

3.3.2 SHKAKU

Kjo gjendje dyshohet të ketë ardhur si rezultat i mungesës së planifikimit adekuat të investimeve dhe mungesës së projekteve të detajuara teknike për realizimin e intervenimeve në objektet shkollore.

Po ashtu, mungesa e mbikëqyrjes efektive gjatë realizimit të punimeve, kontrolleve të pamjaftueshme në teren dhe pranimi i punëve pa verifikim të plotë të cilësisë dhe funksionalitetit të tyre, kanë ndikuar që të pranohen punime jo cilësore dhe të papërfunduara. Gjithashtu, mosndërmarrja me kohë e masave ndaj NPB për eliminimin e mangësive dhe mosadresimi i problemeve të evidentuara nga shkollat kanë ndikuar në përkeqësimin e gjendjes së objekteve menjëherë pas realizimit të investimeve.

3.4.2 NDIKIMI

Mosrealizimi cilësor i renovimeve dhe investimeve në objektet shkollore ka ndikuar që investimet publike të mos arrijnë efektin dhe funksionalitetin e synuar.

Mangësitë dhe dëmtimet e evidentuara ende pa përfunduar punimet rrisin rrezikun për nevojë të investimeve shtesë dhe shpenzime shtesë për sanimin e objekteve. Gjithashtu, gjendja e krijuar ndikon negativisht në funksionalitetin e ambienteve shkollore dhe në zhvillimin normal të procesit mësimor. Po ashtu, pranimi i punëve jo cilësore dhe të papërfunduara krijon rrezik për mosrespektim të kushteve kontraktuale dhe cenim të menaxhimit efikas të parasë publike. Problemet me lagështinë, depërtimin e ujit, kundërmimin e rëndë dhe prania e materialeve kancerogjene në hapësirat e shkollës paraqesin rrezik potencial për shëndetin dhe sigurinë e nxënësve dhe stafit të shkollës.

3.5.2 REKOMANDIMI I LARTË

Rekomandojmë Kryetarin dhe DA të obligoj menaxherin e kontratës me NPB që të bëjë rishikimin dhe rivlerësimin e të gjitha punimeve të realizuara në objektet ku janë kryer renovime/investime, me qëllim identifikimin dhe eliminimin e mangësive dhe dëmtimeve të evidentuara.

Po ashtu, të ndërmerren masa konkrete ndaj punëkryesit për sanimin e të gjitha defekteve brenda afateve garantuese, ndërsa pranimi i punëve të bëhet vetëm pas verifikimit të plotë të cilësisë, funksionalitetit dhe përputhshmërisë së punimeve me kushtet kontraktuale dhe specifikimet teknike.

Objektivi 2a Të vlerësohet nëse investimet për renovimin e objekteve shkollore planifikohen dhe menaxhohen sipas nevojave të shkollave dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi

3.2.2a KRITERI

Rregullorja Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik paragrafi 54.15 përcakton: Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk din sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët, dhe në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikua.

3.2.2a GJENDJA

Tabela 5

Viti 2024(Nr Ko 516-24-5303-5-2-1)	Çmimi total	Çmimi total i peshuar	140,000.00	Kontrata 140,000 që duhet respektuar sipas kontratës	Totali për 4 situadone	Situadoni 1	Situadoni 2	Situadoni 3	Situadoni 4
A - Kategoria I	€ 3,662.78	€ 1,465.11	40%	56000	13,195.01	4,076.40	3,418.33	5,266.33	433.95
B - Kategoria II	€ 7,431.33	€ 371.57	5%	7000	14,704.70	4,500.00	2,481.06	5,589.88	2,133.76
C - Kategoria III	€ 4,832.00	€ 485.20	10%	14000	23,100.00	4,250.00	5,050.00	4,500.00	9,300.00
D - Kategoria IV	€ 520.00	€ 26.00	5%	7000	30,750.00	4,750.00	7,750.00	11,000.00	7,250.00
E - Kategoria V	€ 433.67	€ 130.10	30%	42000	28,129.00	345.00	17,748.86	9,360.14	675.00
F - Kategoria VI	€ 14,678.11	€ 1,467.81	10%	14000	25,371.00	14,544.00	6,177.00	4,650.00	-
€ 3,945.79				Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të kësaj vlera). Kjo është vlera e cila do të duhet të shenohet në Formularin e ofertës dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.					

Tabela 6

Viti 2025(Nr Ko 516-25-1169-1-2-1)	Çmimi total	Çmimi total i peshuar	140000	140,000 që duhet respektuar sipas kontratës	Totali për 4 situadone	Situadoni 1	Situadoni 2	Situadoni 3
A - Kategoria I	€ 3,810.69	€ 1,624.28	40%	56000.00	2,905.65	943.9	1,011.12	950.63
B - Kategoria II	€ 7,232.82	€ 361.64	5%	7000.00	4,029.59	1,489.00	1,240.59	1,300.00
C - Kategoria III	€ 5,202.00	€ 520.20	10%	14000.00	28,700.00	3,250.00	23,450.00	2,000.00
D - Kategoria IV	€ 400.00	€ 20.00	5%	7000.00	13,500.00	6,750.00	4,000.00	2,750.00
E - Kategoria V	€ 355.00	€ 106.50	30%	42000.00	4,356.08	1,603.58	1,807.50	945
F - Kategoria VI	€ 12,147.23	€ 1,214.72	10%	14000.00	9,268.00	566	4,536.00	4,166.00
€ 3,747.34				Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të kësaj vlera). Kjo është vlera e cila do të duhet të shenohet në Formularin e ofertës dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.				

Gjatë analizimit krahasues të kontratave për vitet 2024 dhe 2025 është konstatuar se në të dy kontratat janë evidentuar tejkalime të ngjashme të kategorive kontraktuese, duke treguar se

problematika nuk ka qenë rastësore, por e përsëritur dhe sistematike në menaxhimin e kontratave me operatorin e njëjtë ekonomik.

Në kontratën e vitit 2024, kategoritë me tejkalimet më të mëdha kanë qenë:

- Kategoria II, e cila nga limiti i lejuar prej 7,000.00 € është realizuar në vlerë 14,704.70 €;
- Kategoria III, nga 14,000.00 € është realizuar në 23,100.00 €;
- Kategoria IV, nga 7,000.00 € është realizuar në 30,750.00 €;
- Kategoria VI, nga 14,000.00 € është realizuar në 25,371.00 €.

Ndërsa në kontratën e vitit 2025 janë përsëritur tejkalimet kryesisht në:

- Kategorinë III, e realizuar në 28,700.00 € kundrejt limitit prej 14,000.00 €;
- Kategorinë IV, e realizuar në 13,500.00 € kundrejt limitit prej 7,000.00 €.

Nga krahasimi i të dy viteve vërehet se Kategoria III dhe Kategoria IV kanë qenë vazhdimisht të tejkaluara, çka tregon se planifikimi fillestar i sasive dhe ndarja e kategorive nuk është bazuar në analiza reale të nevojave dhe historikut të shpenzimeve. Përkundër kësaj, autoriteti kontraktues ka vazhduar me strukturë të njëjtë të kontratës edhe në vitin pasues, pa ndërmarrë masa korrigjuese për të shmangur përsëritjen e tejkalimeve.

Po ashtu, është konstatuar se pozicioni "Shqyrtimi i sistemit dhe lëshimi në punë i ngrohjes qendrore" është përsëritur në masë të madhe edhe në kontratën e vitit 2025, ndonëse operatori ekonomik në kontratën e vitit 2024 kishte obligim të siguronte garancion për 24 muaj. Kjo nënkupton se shërbime të njëjta ose të ngjashme janë faturuar përsëri gjatë periudhës së garancionit, pa u dëshmuar nëse këto punë duhej të mbulohehin nga garancioni ekzistues.

Këto raste tregojnë për:

- planifikim jo realist dhe jo të bazuar në nevoja faktike;
- mungesë të analizës së realizimit të kontratave paraprake;
- menaxhim joefektiv të kontratave dhe monitorim të dobët të realizimit të pozicioneve;
- moszbatim dhe mos monitorim të obligimeve të garancionit;
- rrezik të pagesave të panevojshme apo të dyfishta për pozicione të njëjta;
- mungesë të kontrollit adekuat nga menaxheri i kontratës dhe organet mbikëqyrëse.

Përsëritja e tejkalimeve në kategori të njëjta gjatë dy viteve radhazi tregon se autoriteti kontraktues nuk ka ndërmarrë masa për të përmirësuar planifikimin dhe menaxhimin e kontratave, duke rritur rrezikun për shfrytëzim joefikas të mjeteve publike.

3.3.2a SHKAKU

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i planifikimit jo adekuat të nevojave reale për mirëmbajtjen dhe renovimin e sistemit të ngrohjes qendrore, mungesës së analizës së realizimit të kontratave paraprake, si dhe monitorimit dhe menaxhimit joefektiv të kontratave nga personat përgjegjës.

Po ashtu, nuk është bërë kontroll i mjaftueshëm mbi zbatimin e obligimeve të garancionit nga

operatori ekonomik, duke lejuar përsëritjen e pozicioneve të njëjta edhe gjatë periudhës së garancionit. Mungesa e mbikëqyrjes teknike dhe financiare ka ndikuar që tejkallimet e kategorive të përsëriten në dy vite radhazi pa masa korrigjuese nga autoriteti kontraktues.

3.4.2a NDIKIMI

Menaxhimi joefektiv i kontratave dhe planifikimi jo realist i kategorive kanë ndikuar në tejkallimin e vlerave të parapara kontraktuese, devijimin e strukturës financiare të kontratave dhe rritjen e rrezikut për shfrytëzim joekonomik të mjeteve publike.

Po ashtu, përsëritja e pozicioneve të njëjta gjatë periudhës së garancionit ka krijuar rrezik për pagesa të panevojshme apo të dyfishta për shërbime që duhej të mbuloheshin nga operatori ekonomik pa kosto shtesë. Kjo situatë ka ndikuar edhe në dobësimin e kontrollit mbi realizimin e kontratave, uljen e efikasitetit në menaxhimin e mirëmbajtjes së sistemit të ngrohjes qendrore dhe rritjen e rrezikut për trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë gjatë procesit të tenderimit.

3.5.2a REKOMANDIMI LARTE

Rekomandojmë që DA të sigurojë planifikim më realist të kategorive dhe sasive në kontrata, duke u bazuar në analiza të nevojave reale dhe në realizimin e kontratave paraprake.

Rekomandojmë Menaxherët i kontratës dhe organet mbikëqyrëse duhet të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme realizimin e kategorive kontraktuese, me qëllim të shmangies së tejkallimeve të pajustificuara dhe devijimit të strukturës financiare të kontratës.

Gjithashtu, Kryeqytei e në këtë rast DA duhet të sigurojë zbatim të plotë të obligimeve të garancionit nga operatori ekonomik dhe të mos lejojë pagesa për pozicione apo shërbime që mbulohen nga garancioni kontraktues. Për çdo përsëritje të punimeve gjatë periudhës së garancionit duhet të ekzistojë arsyetim teknik dhe dokumentim përkatës.

3.2.1 TË GJETURAT, KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET E BAZUARA NË OBJEKTIVIN E AUDITIMIT

OBJEKTIVI 3: Të vlerësohet nëse furnizimi me materiale të nevojshme për procesin mësimor planifikohet dhe menaxhohet në mënyrë efikase, sipas nevojave të shkollave dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi

3.2.2 KRITERI

Sipas objektivit të auditimit, furnizimi me materiale të nevojshme për procesin mësimor duhet të planifikohet dhe menaxhohet në mënyrë efikase, bazuar në nevojat reale të shkollave, aktivitetet dhe prioritetet e tyre të përcaktuara në Planet Zhvillimore të Shkollave (PZSHS), si dhe në përputhje me legjislacionin dhe kushtet e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Po ashtu, sipas kërkesës së dosjes së tenderit, operatori ekonomik ka qenë i obliguar të dorëzojë

deklaratë me shkrim se të gjitha materialet e ofruara janë konform kurrikulave të arsimit të Republikës së Kosovës për vitin shkollor 2024-2025.

3.2.3 GJENDJA

Nga analiza e dokumentacionit dhe intervistat e realizuara është konstatuar se Drejtoria e Arsimit (DA) nuk ka bërë planifikim adekuat të furnizimeve me materiale për procesin mësimor bazuar në nevojat reale të shkollave.

Gjatë auditimit është vërejtur se shkollat nuk janë konsultuar në mënyrë të strukturuar lidhur me nevojat konkrete për materiale didaktike, ndërsa nuk janë përdorur as Planet Zhvillimore të Shkollave (PZHS) për identifikimin e prioriteteve dhe aktiviteteve që kërkojnë mbështetje me materiale mësimore.

Nga analiza e dokumentacionit është konstatuar se janë testuar mostra të lidhura me kontratën nr. 616-25-1941-1-2-1/C1755 për furnizim me material didaktik 1, në vlerë prej 28,865€, për të cilën është realizuar menjëherë furnizimi dhe pagesa, edhe pse kontrata kishte afat realizimi 12 mujor. Gjatë shqyrtimit të specifikave teknike janë evidentuar përshkrime dhe specifika të paqarta lidhur me materialet e kërkuara.

Po ashtu, si rezultat i planifikimit jo adekuat të nevojave për materiale didaktike, janë evidentuar edhe pagesa tjera për furnizime të ngjashme disa në vlera prej 99€ dhe 988€, përkundër faktit se ekzistonte kontrata aktive për furnizim me material didaktik.

Gjithashtu, edhe kontrata tjetër për furnizim me material didaktik në vlerë prej 16,945.00€, është realizuar me një furnizim/pagesë të vetme, pa shpërndarje graduale sipas nevojave reale të shkollave dhe dinamikës së procesit mësimor gjatë vitit shkollor.

Po ashtu, në kontratën për furnizim me letër të bardhë është vërejtur se furnizimet i parë përshkak të mungesës janë shpërndarë në shkolla pa kërkesa paraprake nga to. Në mostrën tonë ka raste, shkolla është furnizuar dy herë brenda një muaji, ndërsa nuk është evidentuar ndonjë analizë apo mekanizëm kontrolli mbi nevojat reale dhe nivelin e konsumit të materialeve ku në këtë kontrat ka furnizim në shkoll me emrin Shkolla e re 1 dhe 2.

3.3.3 SHKAKU

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mungesës së planifikimit strategjik dhe koordinimit efektiv ndërmjet DA-së dhe shkollave lidhur me identifikimin e nevojave reale për materiale mësimore dhe didaktike.

Po ashtu, mungesa e analizave të nevojave, mosshfrytëzimi i Planeve Zhvillimore të Shkollave dhe mungesa e mekanizmave për monitorimin e shpërndarjes së materialeve kanë ndikuar që furnizimet të realizohen pa prioritizim dhe pa bazë reale të kërkesave të shkollave.

Gjithashtu, mungesa e kontrollit dhe menaxhimit adekuat të kontratave ka ndikuar që furnizimet të shpërndahen në mënyrë joefikase dhe jo në përputhje me dinamikën dhe nevojat e procesit mësimor.

3.4.3 NDIKIMI

Planifikimi dhe menaxhimi joefikas i furnizimeve ka ndikuar që materialet e furnizuara të mos

përdoren në mënyrë optimale dhe të mos mbështesin në mënyrë efektive procesin mësimor sipas nevojave reale të shkollave.

Shpërndarja e materialeve pa analiza dhe kërkesa konkrete krijon rrezik për furnizime të panevojshme, shpërndarje jo të barabartë ndërmjet shkollave dhe shfrytëzim joefikas të mjeteve publike.

Gjithashtu, realizimi i furnizimeve në një periudhë të vetme, edhe pse kontrata kishte afat 12 mujor, kufizon mundësinë e përshtatjes së furnizimeve sipas nevojave reale që paraqiten gjatë vitit shkollor dhe rrit rrezikun që materialet e furnizuara të mos jenë në funksion të aktiviteteve dhe prioriteteve të shkollave.

3.5.3 REKOMANDIMI

Të obligohet DA që planifikimin e furnizimeve me materiale didaktike dhe materiale të tjera për procesin mësimor ta bëjë bazuar në nevojat reale të shkollave, kërkesat konkrete të tyre dhe prioritetet e përcaktuara në Planet Zhvillimore të Shkollave (PZSH).

Po ashtu, DA duhet të vendosë mekanizma efektivë për analizimin, monitorimin dhe kontrollin e shpërndarjes së materialeve, në mënyrë që furnizimet të realizohen sipas nevojave reale dhe dinamikës së procesit mësimor gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Gjithashtu, furnizimet duhet të planifikohen dhe shpërndahen në mënyrë graduale dhe të kontrolluar, duke shmangur furnizimet pa kërkesa konkrete dhe shpërndarjen joefikase të materialeve nëpër shkolla.

2. Emërtimi i auditimit: Auditim i Performancës- Drejtorisë së Financave dhe Drejtoria e Administratës

Objektivat e auditimit

Bazuar në auditimet e kaluar për zbatimin e procedurave për procesin e regjistrimit, përditësimit, kontrollit dhe raportimit të pasurisë ne kemi vlerësuar se është e nevojshme të kryhet një auditim i performancës me qëllim që të vlerësojmë nëse procesi i menaxhimit dhe regjistrimit të pasurisë është bërë në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive.

Objektivë kryesore e auditimit është:

“Të vlerësojmë nëse procesi i menaxhimit dhe regjistrimit të pasurisë është bërë në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive”.

Fushëveprimi i auditimit

Auditimi i zbatimit të procedurave për procesin e regjistrimit, përditësimit, kontrollit dhe raportimit të pasurisë në DA dhe DF ishte i fokusuar në periudhën e vitit 2025, (01.01.2025 – 31.12.2025) për procesin e menaxhimit dhe regjistrimit të pasurisë në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive.

3 Pyetjet e auditimit

A është menaxhuar dhe regjistruar pasuria në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive në përputhje me procedurat dhe kërkesat ligjore?

1. A janë regjistruar të gjitha pasuritë në regjistra përkatës?
 - a. A bëhet regjistrimi pas pranimi të pasurisë?
 - b. A ekzistojnë dokumente për regjistrimin e pasurisë (fatura, kontrata, procesverbalet e pranimi (përshkrimi, vlera, lokacioni, kodi i pasurisë))?
2. A përditësohen rregullisht të dhënat e pasurisë?
 - a. A ekziston një procedure e shkruar për përditësimin?
 - b. Sa shpesh bëhet përditësimi (periodikisht apo vetëm kur kërkohet)
3. A ka komisione për inventarizimi dhe vlerësimi?
4. A kryhet inventarizimi i pasurisë sipas afateve ligjore të parapara?
 - a. A përbëhet komisioni për inventarizim dhe vlerësim nga tre anëtarë?
 - b. A identifikohen dhe trajtohen dallimet gjatë inventarizimit?
 - c. A dokumentohen dëmtimet, humbjet apo mungesa e pasurisë?
5. A përgatiten raporte për pasuri jo financiare?
 - a. A janë raportet të sakta dhe të plota?
 - b. A dorëzohen në kohë tek menaxhmenti?
6. A janë regjistruar të gjitha pasuritë jopakitale dhe stoqet në programin e E-Pasurisë?
 - a. A përmbajnë regjistrat të dhëna të plota dhe të sakta?
 - b. A bëhet përditësimi i regjistrave pas çdo ndryshimi të pasurisë?
7. Si vlerësohen pasuritë jashtë përdorimit si të pa përdorura?
 - a. Si bëhet tjetërsimi i pasurisë?
 - b. A ka të themeluar komision për tjetërsim të pasurisë jo financiare 2025?

2.4 Kriteret e auditimit

Për të ju përgjigjur pyetjeve të auditimit janë ndërtuar kriteret që do të shërbejnë për të vlerësuar se zbatimi i procedurave për procesin e regjistrimit, përditësimi, kontrollit dhe raportimit të pasurisë në DA dhe DF ishte bërë në mënyrën ekonomike dhe efektive dhe efikase. Kriteret e ndërtuara janë si në vijim:

1. Pasuria duhet të regjistrohet menjëherë ose brenda afatit të përcaktuar pas pranimi fizik të saj, bazuar në dokumentacionin përkatës të pranimi.
- Çdo pasuri duhet të mbështetet me dokumentacion të plotë dhe të verifikueshëm i cili dëshmon pronësinë, pranimin, vlerën, lokacionin dhe identifikimin e saj në regjistër. Çdo pasuri duhet të ketë kodin identifikues të pasurisë dhe lokacion të përcaktuar se ku gjendet ajo pasuri. Çdo pasuri e komunës e pranuar si donacion duhet të jetë e regjistruar në regjistrat kontabël të

komunës dhe të identifikohet si donacion i pranuar.

2. Komuna e Prishtinës duhet të sigurojë përditësimin të rregullt dhe të saktë të regjistrave të pasurisë për të reflektuar gjendjen reale të pasurisë.

DF dhe DA duhet të këtë procedura të shkruara dhe të aprovuara që përcaktojnë mënyrën, përgjegjësit dhe afatet për përditësimin e regjistrave të pasurisë.

Përditësimi i regjistrave duhet të kryhet në mënyrë sistematike dhe periodike dhe çdo ndryshimi i pasurisë të bazohet në afate dhe kërkesa ligjore.

3. Komuna e Prishtinës - Kryetari duhet të emërojë komisione për inventarizim dhe vlerësim të pasurisë.

Komisioni duhet të ketë mandat të caktuar dhe përgjegjësi të qarta. Komisioni duhet të përbëhet nga tre anëtarë, zyrtarë kompetent - profesional dhe të paanshëm. Komisioni duhet të ushtrojë detyrën sipas afateve dhe procedurave ligjore.

4. Inventarizimi i pasurisë në KP, duhet të realizohet sipas afateve të përcaktuara me legjislacionin dhe procedurat në fuqi. Inventarizimi duhet të mbulojë të gjitha kategoritë e pasurisë. Rezultatet duhet të dokumentohen në raporte zyrtare. Diferencat e identifikuar duhet të trajtohen dhe dokumentohen.

Komisioni duhet të përbëhet nga numri i përcaktuar i anëtarëve siç parashihet në rregullore dhe të kenë vendimin zyrtar.

Çdo mospërputhje në mes të gjendjes fizike dhe regjistrave duhet identifikohet nga komisioni, ku të gjitha diferencat duhet të analizohen, arsyetohen, të merren masa korrigjuese dhe të raportohen tek menaxhmenti si të dokumentuara.

Çdo dëmtim, humbje apo mungesë e pasurisë publike duhet të evidentohet në procesverbal, ku DF dhe DA, duhet të analizoj shkaqet e humbjes dhe të ndërmarrë masa korrigjuese.

5. DF dhe DA, duhet të përgatisë raporte periodike për menaxhimin e pasurisë, ku ato raporte duhet të jenë të plota të sakta dhe të bazuara në evidenca. Raportet duhet të dorëzohen te ZKA brenda afatit të caktuar sipas rregullave në fuqi.

6. Të gjitha pasuritë jokapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e E-Pasurisë, regjistrimet duhet të jenë të plota të sakta dhe i përditësuar, të përdoret nga zyrtarët përgjegjës dhe në mënyrë të vazhdueshme.

Çdo ndryshim në statusin e pasurisë duhet të reflektohet menjëherë në sistemin E - Pasurisë si dhe përditësimi duhet të mbështetet në dokumentacionin përkatës.

7. Komuna e Prishtinës pasurinë të cilat janë jashtë përdorimit i mbanë në një lokacion të caktuar. Këto pasuri duhet të kalojnë përmes zyrtarit të logjistikes/depo dhe me pas e njoftojnë drejtorin e administratës dhe ZKA që të fillojë me procedurat e tjetërsimit të pasurive jashtë përdorimit. Komisioni për tjetërsimin e pasurisë jashtë përdorimit, me anë të vendimit, vendos për pasuritë të cilat duhet të asgjësohen, shiten, transferohen, dhurohen dhe bazuar në atë vendim, zyrtari për regjistrim dhe zyrtarit i logjistikes/deposë duhet të kryej regjistrimet e nevojshme.

2.5 Metodologjia e auditimit

Metodologjia e auditimit pasqyron qasjen e auditimit, metodat dhe teknikat e përdorura për mbledhjen dhe analizën e të dhënave, informacionit dhe marrjen e dëshmive të auditimit.

- Dëshmitë e mbledhura nga drejtoritë lidhur me procesin për regjistrimin, përditësimin, kontrollin dhe raportimin e pasurive gjatë vitit 2025.
- Analizimi i raporteve, regjistrimi i pasurive, funksionimi i sistemeve për regjistrim të pasurisë dhe stokeve, përditësimi, kontrolli dhe raportimi.

Gjithashtu janë mbajtur takime me:

- Drejtorët e drejtorive
- Zyrtarët përgjegjës të pasurisë dhe
- Vizita në teren.

Pjesë e këtij auditimi ka qenë edhe vëzhgimi dhe vizitave në teren.

Bazuar në vlerësimin e rreziqeve të mundshme në të gjithë hapat e procesit për zbatimin e procedurave për procesin e regjistrimit, përditësimin, kontrollit dhe raportimit të pasurisë gjatë vitit 2025 ne kemi planifikuar dhe kryer testimin e 10 mostrave/regjistrimeve (kontratave) të përzgjedhura lidhur me këtë proces.

1. DREJTORIA E FINANCEVE DHE DREJTORIA E ADMINISTRATËS – DETYRAT DHE PËRGJEGJESITË:

- Evidenton dhe mban regjistrin e pasurisë së Komunës;
- Udhëheq me çështje financiare;
- Është përgjegjës për mbajtjen e llogarive dhe raporteve vjetore financiare;
- Është përgjegjës për mbikëqyrjen e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit;
- Përgatitë procedurat dhe raportet e kontabilitetit;
- Përgatitë planin unik vjetor të punës dhe mbikëqyrë realizimin e tij;
- Kryen edhe punë të tjera, në përputhje me ligjet e aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë.
- Zbaton dhe bënë regjistrimin dhe mbajtjen e evidencës së materialit zyrtar që pranohet dhe dorëzohet nga zyra e arkivit të administratës së Komunës, si dhe arkivimin e lëndës arkivore dhe kujdesi për ruajtjen e sajë, dhe kujdesi për ruajtjen e akteve materiale të administratës (librat amë, kartotekat, protokollat, regjistrat, etj)
- Është përgjegjëse dhe kujdeset për ofrimin e shërbimeve postare për nevojat e organeve Komunale dhe organeve të administratës Komunale .

- Ushtron dhe menaxhon me fushën e logjistikës, duke përfshirë menaxhimin dhe kujdesin për automjetet, titullar pronësor i të cilave është Komuna e Prishtinës.
- Organizon dhe kujdeset për mirëmbajtjen e objekteve të administratës Komunale, duke përfshirë organizimin e shërbimeve të sigurimit për këto objekte.
- Ushtron të gjitha punët rreth përkujdesjes dhe mirëmbajtjes së teknologjisë informative dhe avancimit të saj për nevoja zyrtare.
- Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë.

Vlerat e pasurisë jo financiare nën kontrollin e komunës së Prishtinës janë të prezantuara në tabelën e shënuar në vazhdim.

Burim i informatës është raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31.12.2025.

3.1 Raporti për pasurinë jo financiare kapitale dhe jo kapitale të regjistruara në SIMFK dhe regjistrat e OB për vitin 2025, (janar – dhjetor 2025).

	Pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1000 euro)		Pasuritë kapitale (me vlerë nën 1000 euro)	
1	Ndërtesat	163,508,295.41	Inventari	1,723,434.98
2	Toka	2,245,308,338.64	Pajisje shëndetësore	151,269.71
3	Pajisjet	6,180,207.20	Pajisje shëndetësore	69,744.73
4	Infrastruktura	130,940,551.60	Pajisje elektrike	92,784.76
5	Makineria	1,315,442.08	Pajisje të tjera	1,137,994.09
6	Automjetet	506,308.31		
7	Projektet urbanistike	10,990,479.82		
8	Të tjera	14,512,363.12		
	Totali €	2,573,261,986.18		3,175,228.27

Ndërsa stoqet e Komunës së Prishtinës mbahen në faqe të excel të mbajtur nga zyrtaret. Stoqet në fund të vitit me 31.12.2025 janë prezentuar 16,194.70 euro.

Për kryerjen e këtyre detyrave dhe detyrave tjera në DF dhe DA, janë të angazhuar vetëm një zyrtar i regjistrimit të pasurisë në kuadër të drejtorisë së financave dhe një zyrtar si zyrtar i depos në kuadër të DA me kontrate 3 vjeçare si zyrtare mbështetëse.

4 REZULTATET

Gjatë ekzaminimit të këtij procesi do të prezantohen gjetjet e auditimit të performancës për zbatimin e procedurave për procesin e regjistrimit, përditësimit, kontrollit dhe raportimit të pasurisë në DF dhe DA, gjatë vitit 2025. Bazuar në procedurat e auditimit të zhvilluar lidhur me

menaxhimin e pasurisë, është konstatuar se DF dhe DA nuk ka arritur të sigurojë një sistem efektiv dhe funksional të menaxhimit të pasurisë për vitin 2025.

Rezultatet e auditimit identifikojnë mungesë të inventarizimit të pasurisë, mungesë të komisionit për inventarizim, vlerësimi si dhe funksionim të sistemit të E-Pasurisë.

1. Mos regjistrimi i plotë i pasurisë, dokumentacioni dhe procedurat për regjistrimin e pasurisë.

Sipas rregullave në fuqi DF dhe DA nuk ka regjistruar të saktë, të plotë dhe të besueshëm për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë. Regjistrimi i pasurisë mbahet në formë të excelit. Mungojnë regjistrat e pasurisë të pranuar si donacion. Nuk ka regjistër të ndarë të pasurive – si donacion. Nuk funksionon programi i E- Pasurisë dhe nuk ka ndonjë program alternativ për regjistrimin (evidencave) të pasurisë, kurse pasurit e regjistruara në SIMFK, nuk ishin regjistruar apo azhurnuar me kohë.

2. Mungesa e përditësimit të rregullt të pasurive

DA dhe DF nuk kishte rregulla të shkruara për përditësimin të rregullt dhe të saktë të regjistrave të pasurisë për gjendjen reale të pasurisë. Zyrtarët përgjegjës të pasurive nuk krijojnë mekanizma funksional për monitorimin e ndryshimeve të pasurive në komunë. Dëshmitë për regjistrimin e pasurisë, nuk na sigurojnë statusin e pasurisë nëse pasuria është në përdorim apo në stok dhe se është zbatuar zhvlerësimi i atyre pasurive.



DA, gjatë vitit 2025, ka blerë pajisje të cilat janë të regjistruara si pasuri, mirëpo ato pasuri nuk janë funksionalizuar dhe përdorur për më shumë se një vit nga pranimi. Si rezultat fondet publike janë angazhuar/shpenzuar në pasuri që nuk kanë kontribuar në realizimin e objektivave dhe nuk kanë gjeneruar vlerë për DA. Kjo tregon mangelësi në planifikimin e nevojave, koordinimin nëpërmjet njësive përgjegjëse dhe monitorimin e përdorimit të pasurisë.

3. Mos funksionimi i komisioneve për inventarizim dhe vlerësim

Gjatë vitit 2025 nuk kishte të themeluar komisione për inventarizim dhe vlerësim të pasurisë. Sipas rregullave komisioni për inventarizim duhet të themelohet deri me 31 tetor të vitit aktual dhe inventarizimi të përfundoj deri me 31 dhjetor të vitit aktual, ndërsa komisioni i vlerësimit duhet të themelohet pas raportit për inventarizim dhe duhet të përgatitë raport më së larti deri më 22 janar të vitit pasues. Gjatë vitit 2025, ZKA nuk kishte nxjerr vendim për inventarizim të pasurisë në afatin e paraparë dhe ka shkaktuar dobësi në raportimin e pasurive për vitin 2025.

4. Mos kryerja e inventarizimit sipas rregullave në fuqi

Gjatë vitit 2025, ZKA, nuk kishte të themeluar komision për inventarizim i cili komision duhet të përbëhej nga kryetari dhe anëtarët për inventarizimin e pasurisë jo financiare. Nuk ekziston asnjë arsyetim për mos kryerjen e inventarizimit të pasurisë dhe neglizhencën e formimit të komisionit. Në mungese të inventarizimit nuk mundëson matjen e efektiviteti dhe efikasitetin të inventarizimit të pasurisë. Nuk ka dokument/vendim/procesverbale – vlerësim për dëmtim, humbje, mungese të pasurisë jo financiare në komunën e Prishtinës.

5. Përgatitja e raporteve për pasuri jo financiare.

DF dhe DA për vitin 2025 nuk kishte përgatit raporte për regjistrim dhe inventarizim të pasurisë jo financiare. Nuk ishin formuar komisione për inventarizim dhe nuk kishte mbajtur regjistra të plotë të pasurisë duke e bërë të pa mundur përgatitjen e raporteve të besueshme mbi gjendjen reale të pasurive jo financiare.

Si rezultat i kësaj ZKA - menaxhmenti i lartë nuk ka pas informacione të mjaftueshme për të vlerësuar saktësinë e regjistrave të pasurisë, ekzistencën fizike të pasurisë, dallimet eventuale të identifikuara gjatë inventarizimit si dhe nevojën për masa korrigjuese lidhur me menaxhimin e pasurive jo financiare.

6. Funksionimi i pasurive jokapitale dhe stoqeve në programin e E- Pasurisë

Pasuritë jo financiare dhe stoqet në komunën e Prishtinës nuk regjistrohen në programin e E-pasuria. Programi i E-Pasurisë nuk funksion. Nuk ka zyrtare të caktuar për regjistrimin e pasurisë në programin e pasurisë. Sipas zyrtarëve përgjegjës sistemi i pasurisë nuk ka qenë funksional duke pa mundësuar regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave për pasuri jo financiare dhe stoqe.

7. Pasuritë jo financiare jashtë përdorimit dhe tjetërsimi i tyre

Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2025 nuk kishte themeluar komisione për tjetërsimin e pasurive jashtë përdorimit. Pasuritë e pa përdorura nuk menaxhohen nga zyrtaret përgjegjës dhe nuk alokohen në hapësirat adekuate. Pasuritë e tilla grumbullohen në zyre apo korridore të objekteve dhe nuk menaxhohen nga askush. Mungesa e funksionimit të shumë mekanizmave brenda komunës si zyrtarët përgjegjës për pasuri dhe komisionet për inventarizim ka krijuar hapësirë që pasuritë të mos përfshihen në procesin e tjetërsimit i cili këto pasuri do ti vlerësonte dhe do ti vendoste, nëse këto pasuri mund të shfrytëzohen, shiten, dhurohen apo duhen të asgjësohen.



Si rezultat i kësaj mungesa komuna e Prishtinës nuk kanë mundur të identifikoj pasuritë që janë jashtë përdorimit të vlerësoj gjendjen dhe vlerën e tyre aktuale si dhe të zhvilloj procedura të rregullta për tjetërsimin ose largimin e tyre nga përdorimi. Mungesa e inventarizimit periodik dhe e dokumentacionit mbështetës ka krijuar paqartësi lidhur me ekzistencën, gjendjen fizike dhe vlerën reale të pasurive në KP.

5 KONKLuzionET

Gjatë vitit 2025 nuk ka funksionuar një sistem efektiv i menaxhimit të pasurisë jo financiare. Komuna e Prishtinës nuk ka siguruar mekanizmat bazë të kontrollit dhe menaxhimit të pasurisë jo financiare, pasi nuk janë themeluar komisione për inventarizim dhe vlerësim, nuk është kryer inventarizimi sipas kërkesave ligjore, nuk janë mbajtur regjistra për plotë dhe të përditësuar të pasurisë, nuk janë përgatitë raporte për regjistrim dhe inventarizim e pasurisë jo financiare ndërsa sistemi i E-Pasurisë nuk funksionon duke mos ofruar mbështetje të nevojshme për menaxhimin e tyre.

Si rezultat, DF dhe DA nuk kishte siguri mbi ekzistencën, gjendjen, vlerën dhe përdorimin e pasurive jo financiare në komunën e Prishtinës. Mungesa e evidencave të besueshme dhe e mekanizmave të monitorimit ka rrit rrezikun e humbjes, dëmtimit, keqpërdorimit ose mosshfrytëzimit optimal të pasurive publike duke kufizuar aftësinë e KP për të menaxhuar pasuritë në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive.

6 REKOMANDIMET

Më poshtë janë prezantuar rekomandimet për DA dhe DF. Rekomandimet e detajuara janë si më

poshtë:

Rekomandimi nr.1:

Rekomandojmë DF dhe DA, të siguroj regjistrimin dhe përditësimin e rregullt të të gjithë pasurive jo financiare në regjistra përkatës. Të funksionalizohet softveri i E – Pasurisë apo ndonjë softver tjetër i cili do të mundësonte procesin e regjistrimit dhe monitorimit të pasurive.

Rekomandimi nr.2:

Rekomandojmë DF dhe DA që të siguroj që çdo pasuri jo financiare që regjistrohet në regjistrat e pasurisë të posedoj dokumentet të plotë dhe të arkivuara sipas kërkesave procedurale/ligjore.

Rekomandoj DF dhe DA në bashkëpunim me njësit varesë të siguroj procedura efektive për përditësimin efektiv të të dhënave të pasurisë.

Rekomandimi nr.3:

Rekomandojmë ZKA, në bashkëpunim me drejtoritë të siguroj themelimin me kohë të komisioneve për inventarizim dhe vlerësim të pasurisë, në përputhje me afatet dhe kërkesat ligjore në fuqi. Komisionet e formuara të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në mënyrë të vazhdueshme dhe të dokumentuar, duke identifikuar gjendjen reale të pasurive, ndryshimet në vlerë dëmtimet, humbjet apo pasurit jashtë përdorimit. Gjithashtu menaxhmenti i lartë të vendosë mekanizma mbikëqyrës për të monitoruar funksionimin e komisioneve dhe zbatimin e rekomandimeve të tyre.

Rekomandimi nr.4:

Rekomandojmë ZKA dhe menaxhmentin e lartë të siguroj që inventarizimi i pasurive jo financiare të kryhet çdo vit në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurat e përcaktuara. Procesi i inventarizimit mbështetet në vendime formale, plane punë, procesverbal edhe raporte përfundimtare që dokumentojnë gjendjen faktike të pasurisë, mospërputhjet e identifikuara, dëmtimet, humbjet dhe masat korrigjuese. Po ashtu duhet të krijoj mekanizma për monitorim dhe përcaktohen tregues për matjen e efektivitetit dhe efikasitetit të procesit të inventarizimit, në mënyrë që menaxhmenti të ketë siguri të arsyeshme mbi ekzistencën dhe përdorimin e pasurisë jo financiare.

Rekomandimi nr.5:

Rekomandojmë DF dhe DA të siguroj kryerjen e rregullt të inventarizimit të pasurive jo financiare, formimin e komisioneve përgjegjëse, përgatitjen e raporteve për rezultatet e regjistrimit dhe inventarizimit si dhe dorëzimin e tyre tek drejtori dhe ZKA për shqyrtim dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese ndaj mangësive të identifikuara. Kjo do ta mundësoj menaxhimin me ekonomik, efikas dhe efektiv të pasurive jo financiare.

Rekomandimi nr.6:

Rekomandojmë ZKA të ndërmarrë veprime për funksionalizimin e sistemit të E-Pasurisë, në bashkëpunim me drejtoritë dhe njësitë varëse dhe deri në funksionalizim

të plotë të sistemit, të siguroj mbajtjen e evidencave alternative për regjistrimin dhe monitorimin e pasurive kapitale dhe stoqeve si dhe të bëjë regjistrimin e tyre në sistem menjëherë pas rikthimit të funksionalizimit të E-Pasurisë.

Rekomandimi nr.7:

ZKA duhet të ndërmarr veprime të menjëhershme për krijimin dhe përditësimin e regjistrave të pasurisë, funksionalizimin e procesit të inventarizimit, formimin e komisioneve për vlerësim dhe tjetërsim të pasurive si dhe sigurimin e evidencave të plota dhe të besueshme për të gjitha pasurit në KP.

Gjithashtu duhet të identifikohen dhe vlerësohen të gjitha pasuritë jashtë përdorimit, në mënyrë që tjetërsimi ose trajtimi i tyre të kryhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe të sigurohet që pasuria menaxhohet në bazë të këtyre tri parimeve - ekonomik, efikas dhe efektiv.

3.Emërtimi i auditimit: Të vlerësojmë se lëndët në Drejtorinë e Inspektionit janë pranuar, autorizuar dhe shpërndarë me kohë sipas kërkesave ligjore

Objektivat e auditimit

Bazuar në rezultatet e dëshmive të mbledhura gjatë auditimit, që t'i japim opinione të arsyeshëm menaxhmentit të Komunës, dhe të vlerësojmë se është:

- ✓ Të vlerësojmë se lëndët në Drejtorinë e Inspektionit janë pranuar, autorizuar dhe shpërndarë me kohë sipas kërkesave ligjore

Objektivat :

1. Të vlerësojmë se lëndët në Drejtorinë e Inspektionit janë pranuar, autorizuar dhe shpërndarë me kohë sipas kërkesave ligjore
2. Të vlerësojmë se Sektori i Ndërtimit ka respektuar fazat e ndërtimit sipas legjislacionit në fuqi
3. Të vlerësojmë nëse janë zbatuar rekomandimet Auditimit DSHS 2402

2.2 Fushëveprimi i auditimit përfshinë:

- Periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025,por jo vetëm
- Njësitë organizative: Drejtoria e Inspektionit
- Procesi : Të vlerësojmë se lëndët në Drejtorinë e Inspektionit janë pranuar, autorizuar dhe shpërndarë me kohë sipas kërkesave ligjore

3.2.1 TË GJETURAT, KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET E BAZUARA NË OBJEKTIVIN E AUDITIMIT

Objekti vi 1: Të vlerësojmë se lëndët në Drejtorinë e Inspektionit janë pranuar, autorizuar dhe shpërndarë me kohë sipas kërkesave ligjore

Menaxhimi i dobët i data bazës dhe mungesë e proceseve administrative.

3.2.1 KRITERET

KRITERI 1 Sipas Ligjit Nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë, neni 7, të gjitha lëndët

e përfunduara dhe materiali tjetër i regjistraturës ruhen në arkivë, në njësitë përkatëse të regjistraturës (fashikuj, kuti, regjistratorë), të vendosura në dollapë, vitrina ose rafte, duke siguruar kushte të përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e lëndëve arkivore.

Po ashtu, Komuna e Prishtinës përdor aplikacionin Intranet për pranimin dhe trajtimin e kërkesave të qytetarëve.

KRITERI 2 Sipas Ligjit Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, neni 41, pika 3, forma dhe përmbajtja e legjitimacionit të inspektorit komunal përcaktohen nga organi kompetent në nivel lokal.

3.2.1 GJENDJA

GJENDJA 1 Drejtoria e Inspekcionit nuk ka siguruar menaxhim të plotë dhe të besueshëm të lëndëve në sistemin Intranet. Analiza e të dhënave tregoi se nga 4,346 lëndë të regjistruara gjatë vitit 2025, një numër i konsiderueshëm vazhdonin të figuronin në status "në proces", ndërsa sistemi nuk mundësonte bashkëngjitjen e dokumentacionit shtesë pas mbylljes automatike të lëndës. Për pasojë, dokumentet përcjellëse regjistroheshin si lëndë të reja me numra të veçantë protokolli.

Gjithashtu, Drejtoria nuk kishte procedurë të shkruara që përcaktojnë mënyrën e trajtimit, përditësimit dhe kompletimit të lëndëve nga pranimi deri në mbylljen e tyre në sistem.

GJENDJA 2 Drejtoria e Inspekcionit nuk ka siguruar mbylljen dhe përditësimin në kohë të statusit të të gjitha lëndëve në sistem. Në mostrën e audituar u identifikua një rast ku, megjithëse ishte shqiptuar gjobë mandatore në përputhje me legjislacionin në fuqi, lënda vazhonte të evidentohej si "në proces" dhe nuk ishte mbyllur në sistem.

3.3.1 SHKAKU

SHKAKU Mungesa e procedurave të standardizuara për menaxhimin e lëndëve, njohuritë e pamjaftueshme të stafit për funksionalitetet e sistemit Intranet dhe kufizimet teknike të aplikacionit.

3.4.1 NDIKIMI

NDIKIMI Mungesa e një baze të plotë dhe të saktë të të dhënave zvogëlon besueshmërinë e informatave për statusin e lëndëve, vështirëson monitorimin e progresit të tyre dhe krijon rrezik për vonesa në trajtim, raportim jo të saktë dhe ngarkesë të panevojshme administrative. Lëndët mund të mbeten të hapura për periudha të gjata, duke krijuar pasaktësi në evidencat zyrtare, duke ndikuar në raportimin e performances së Drejtorisë dhe duke rritur rrezikun që rastet e përfunduara të evidentohen gabimisht si të pa trajtuara.

3.5.1 REKOMANDIMET

REKOMANDIM ZKA, në bashkëpunim me DI dhe njësinë përgjegjëse për teknologjinë informative, duhet që brenda 6 muajve nga pranimi i raportit të auditimit të kryejë analizën

funkionale të bazës aktuale të të dhënave dhe të sistemit Intranet, të identifikojë kufizimet teknike dhe të zbatojë përmirësimet e nevojshme për mundësimin e bashkëngjitjes së dokumentacionit përcjellës dhe përditësimit të lëndëve nga personat e autorizuar.

Gjithashtu, DI duhet të caktojë zyrtarët përgjegjës për administrimin dhe monitorimin e të dhënave në sistem. Rezultati i pritshëm është që të paktën 95% e lëndëve aktive të kenë dokumentacion të plotë dhe status të përditësuar në sistem, duke reduktuar rastet e hapjes së lëndëve të reja për dokumente shtesë me së paku 80%.

3.2.2 TË GJETURAT, KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET E BAZUARA NË OBJEKTIVIN E AUDITIMIT

Objekti 2: Të vlerësojmë se Sektori i Ndërtimit ka respektuar fazat e ndërtimit sipas legjislacionit në fuqi

3.2.2 KRITERI

KRITERI Sipas Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim tek Neni 31 Inspektimi pas përfundimit të fazave ndërtimore tek pika 4 dhe 5 kërkon që

4. Poseduesi i lejes ndërtimore e njofton organin kompetent me shkrim lidhur me përfundimin e secilës fazë ndërtimi. Inspekcioni i ndërtimit do të realizojë secilin inspektim në ditën e shtatë pas pranimit të atij njoftimi.

5. Në rastin kur inspekcioni i ndërtimit konkludon se punët e kryera nuk përputhen me dokumentacionin ndërtimor, përgatitet protokoll i sqarues lidhur me mospërputhjen. Poseduesi i lejes ndërtimore korrigjon mospërputhjen brenda një kohe të arsyeshme, ashtu siç përcaktohet nga inspekcioni i ndërtimit.

3.2.2 GJENDJA

GJENDJA Auditimi ka identifikuar se Drejtoria e Inspekcionit nuk ka siguruar një sistem efektiv për mbikëqyrjen e fazave të ndërtimit sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Nuk janë hartuar procedura të brendshme të shkruara që përcaktojnë mënyrën e planifikimit, realizimit dhe dokumentimit të inspektimeve gjatë fazave të ndërtimit.

Gjithashtu, është konstatuar se inspektimet në terren nuk kryhen në mënyrë sistematike pas njoftimit për përfundimin e fazave ndërtimore. Si rezultat, mungon verifikimi në kohë i përputhshmërisë së punimeve me projektin e miratuar dhe kushtet e lejes ndërtimore.

3.3.2 SHKAKU

SHKAKU Kjo situatë ka ardhur si rezultat i mungesës së procedurave të brendshme për planifikimin dhe realizimin e inspektimeve, kapaciteteve të pamjaftueshme njerëzore dhe funksionimit joefektiv të mekanizmave të kontrollit të brendshëm në kuadër të Drejtorisë së Inspekcionit.

Gjithashtu, sipas zyrtarëve fazat kontrollohen edhe nga mbikëqyrësit e investitorit sipas

kërkesave ligjor, por që kontrollimi i dokumenteve është i pamundur me u bërë për shkak të ngarkesave në punë.

3.4.2 NDIKIMI

NDIKIMI Mungesa e kontrollës dhe mbikëqyrjes inspektive në fushën ndërtimore gjatë realizimit të fazave dhe mos kontrollimi i dokumenteve të realizuar nga përfundimi i fazës të mbikëqyrura nga kontrakti i investitorit me kohë, rrit rrezikun që projekti mos të realizohet sipas lejes ndërtimore dhe materialet e përdorura të mos jenë sipas standardeve ndërtimore. Gjithashtu, kërkimi i dokumenteve masë afateve të parapara rrit rrezikun që dokumentet e kërkuara të plotësohen në fund të ndërtimit të objektit nga Organi mbikëqyrës i Investitorit.

3.5.2 REKOMANDIMI

Rekomandojmë që ZKA dhe Drejtoria e Inspektionit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Komunës, duhet të sigurojë zbatimin e plotë të kërkesave ligjore për inspektimin e fazave të ndërtimit. Për këtë qëllim duhet të hartojë dhe zbatojë procedura të brendshme për planifikimin, realizimin dhe dokumentimin e inspektimeve, të forcojë kapacitetet njerëzore dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm, si dhe të sigurojë që inspektimet në terren të kryhen brenda afateve të përcaktuara me ligj pas përfundimit të secilës fazë ndërtimore.

Të gjitha fazat e ndërtimit të njoftuara nga poseduesit e lejeve ndërtimore të inspektohen dhe dokumentohen me kohë, duke siguruar përputhshmëri më të lartë të punimeve me projektet e miratuara dhe kërkesat ligjore.

3.2.3 TË GJETURAT, KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET E BAZUARA NË OBJEKTIVIN E AUDITIMIT

Objektivi 3: Të vlerësojmë nëse janë zbatuar rekomandimet Auditimit DSHS 2604

3.2.3 KRITERI

KRITERI Sipas Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, neni 17, auditimi i brendshëm ofron siguri të pavarur dhe objektive për efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe kontribuon në përmirësimin e proceseve të menaxhimit, kontrollit dhe qeverisjes.

Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit.

3.2.3 GJENDJA

GJENDJA Auditimi ka konstatuar se rekomandimet e dhëna në auditimin e mëhershëm DSHS 2404 nuk janë zbatuar plotësisht brenda afateve të përcaktuara. Nga shqyrtimi i Planit të Veprimit dhe aktiviteteve të ndërmarra është vërejtur se një pjesë e rekomandimeve kanë mbetur të pa implementuara, ndërsa masat e parapara për adresimin e tyre nuk janë zbatuar në tërësi.

Megjithatë, gjatë zhvillimit të auditimit aktual, Drejtoria e Inspektionit ka filluar të ndërmarre veprime për adresimin e rekomandimeve të mbetura dhe ka përcaktuar afate kohore për zbatimin e tyre.

3.3.3 SHKAKU

SHKAKU Kjo situatë ka ardhur si rezultat i mungesës së monitorimit sistematik të zbatimit të Planit të Veprimit, dobësive në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe mungesës së procedurave të shkruara që do të mundësonin adresimin e qëndrueshëm të çështjeve të identifikuara nga auditimi.

3.4.3 NDIKIMI

NDIKIMI Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të auditimit rrit rrezikun që dobësitë dhe mangësitë e identifikuara më herët të vazhdojnë të përsëriten. Si rezultat, mund të dobësohet efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm, të kufizohet përmirësimi i proceseve operative dhe të ndikohet negativisht në arritjen e objektivave të Drejtorisë së Inspektionit.

3.5.3 REKOMANDIM

REKOMANDIM Rekomandojmë që ZKA dhe Drejtoria e Inspektionit të sigurojnë monitorimin sistematik të zbatimit të rekomandimeve të auditimit përmes Planit të Veprimit, duke përcaktuar përgjegjësit, afatet dhe mekanizmat e raportimit për secilin rekomandim.

5. Emërtimi i auditimit: Auditim i Performancës- Kontrata e për ndriçim i titulluar "119 Programi për ofrimin e shërbimeve të energjisë në ulje të shpenzimeve financiare në Komunën e Prishtinës sipas UA 062021

1.1 Objektiva dhe pyetjet e auditimit

Objektiv i auditimit tonë është që të vlerësojmë se menaxhimi i për kontratën e për ndriçim i titulluar "119 Programi për ofrimin e shërbimeve të energjisë në ulje të shpenzimeve financiare në Komunën e Prishtinës sipas UA 062021.

Për të siguruar se DSHP dhe stafi ka bërë Menaxhimin e fondeve për ndriçim publik ekonomik, efikas dhe efektiv, ne kemi parashtruar pyetjet si në vijim ku DSHP na është përgjigjur në pyetësorin që e kemi përgatitur dhe na është kthyer përmes emailit: ²

1.2 Fushëveprimi i auditimit

Auditimi përfshiu periudhën nga 2022, 2023 dhe 2024, duke analizuar aktivitetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike lidhur me planifikimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve të ndriçimit publik. Fusha e auditimit përfshinte projektet e realizuara nga Komuna e Prishtinës për zgjerimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik në rrugë, parqe, sheshe dhe zona të tjera publike, duke përfshirë instalimin e teknologjive LED dhe sistemet smart lighting.

Pyetja kryesore

1. Cilësia e shërbimit të ndriçimit: Planifikimi

1.1 A janë të gjitha zonat publike të ndriçuara siç kërkohet nga standardet e vendosura?

1.2 A janë parashikuar plane për rinovimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së ndriçimit për të përballuar rritjen e popullsisë dhe kërkesat e reja?

1.3 Plani i zgjerimit dhe mirëmbajtjes së ndriçimit për vitin 2023 dhe 2024

4. Ekonomiciteti (kostoja dhe buxheti), regjistri i trupave ndriçues, parashikimet për mirëmbajtjen e të gjitha trupave tjerë.

1.1. Sa është kostoja totale e ofrimit të shërbimeve të ndriçimit dhe si krahasohet me buxhetin e parashikuar?

1.2. A ka shpenzime të panevojshme ose burime tjera që ndihmojnë në rritjen e kostos?

1.3. Si është shpenzimi i energjisë nga ndriçimi publik për vitin 2022, 2023, 2024 dhe sa janë investimet?

5. Efikasiteti (përdorimi i burimeve): A po përdoren teknologjitë më të avancuara që mund të ulë kostot, si ndriçimi LED ose ndriçimi me energji diellore?

5.1 Sa është niveli i konsumit të energjisë i vitit 2024 krahasuar me vitin 2023. A ka zvogëlim të shpenzimeve pas investimeve të përfunduara në zona përkatëse?

5.2 Sa është konsumi i energjisë për njësi ndriçimi dhe si mund të përmirësohet ky konsum?

5.3 A janë instaluar sisteme për monitorimin e konsumit dhe menaxhimin e energjisë?(nëse ka)

6. Efektiviteti (arritja e qëllimeve)

6.1 A ka mjaftueshëm ndriçim për të siguruar siguri për qytetarët dhe drejtuesit e automjeteve?

6.2 A ka shërbim të plotë në të gjitha zonat, sidomos në zonat e largëta ose më pak të zhvilluara?

6.3 Si është niveli i pranueshëm nga përdoruesit për sa i përket cilësisë dhe sasisë së ndriçimit?

1.3 Kriteret e auditimit

Përmes këtij raporti ne kemi verifikuar nëse në DSHPMSh janë duke siguruar funksionim të plotë të kontrollit të brendshëm të menaxhimit të fondeve për ndriçim publik dhe kanë arritur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin sipas planifikimit.

Për të verifikuar këtë, në bashkëpunim me entitetet e audituara, ne kemi vendosur kriteret si në vijim:

- DSHPMSh duhet të ketë planifikim të parashikuar, plane për zgjerimin, renovimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së ndriçimit për të përballuar rritjen e popullsisë dhe kërkesat e reja në tërë territorin e Kryeqytetit Prishtinës.
- DSHPMSh gjatë planifikimit duhet të ketë dokument analizë mbi nevojat reale të ndriçimit publik, duke e ditur edhe evidencën e saktë të trupave ndriçues.
- Duhet të ketë njohuri sa është kostoja totale e ofrimit të shërbimeve të ndriçimit dhe si krahasohet me buxhetin e parashikuar për tërë vitin.
- DSHPMSh duhet të bëjë analiza si është shpenzimi i energjisë nga ndriçimi publik për vitin paraprak dhe pas investimit reflektimi i kursimit energjetik.
- DSHPMSh duhet të përdor teknologjitë më të avancuara që mund të ulë kostot, si ndriçimi LED ose ndriçimi me energji diellore të ripërtërishëm.
- Duhet të dijë saktë a ka mjaftueshëm ndriçim për të siguruar siguri për qytetarët dhe mundësinë e realizimit të aktiviteteve të tyre kulturore dhe rekreative gjatë mbrëmjeve etj.

2 Të gjeturat kryesore

Kjo pjesë përmban gjetjet e auditimit lidhur me procesin zgjerimit dhe mirëmbajtjes së ndriçimit publik, duke u bazuar në kriteret e auditimit ashtu qysh ju kemi dhënë përgjigje pyetjeve të auditimit dhe

analizimit të mostrave.

Rekomandimet ndërlidhen me të gjitha nivelet përgjegjësi e të cilave është menaxhimi ekonomik, efikas dhe efektiv i ndërtimit, zgjerimit, modernizimit, mirëmbajtjes së ndriçimit publik.

Planifikimi

- *DSHPMSH duhet të ketë planifikim të mirëfilltë të parashikuar mbi planet për zgjerimin, renovimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së ndriçimit për të përballuar rritjen e nevojave dhe kërkesat e reja në tërë territorin e Kryeqytetit Prishtinës.*
- *DSHPMSH gjatë planifikimit duhet të ketë dokument analizë/strategji mbi gjendjen aktuale dhe nevojat reale të ndriçimit publik.*

Gjendja

Mungesa e planifikimit buxhetor për kontratën në vitet 2025 dhe 2026

Kriteri

Sipas legjislacionit për menaxhimin e financave publike dhe akteve nënligjore përkatëse, autoriteti kontraktues duhet të sigurojë planifikimin e mjeteve buxhetore për mbulimin e obligimeve që rrjedhin nga kontratat, veçanërisht për kontratat shumëvjeçare, me qëllim të garantimit të zbatimit të tyre dhe pagesës së obligimeve brenda afateve të përcaktuara.

Gjendja (e gjeturat)

Auditimi konstatoi se për kontratën **"119 – Programi për ofrimin e shërbimeve të energjisë në ulje të shpenzimeve financiare në Komunën e Prishtinës"** nuk ishin planifikuar mjete buxhetore në buxhetin e viteve 2025 dhe 2026, pavarësisht ekzistimit të obligimeve kontraktuale.

Shkaku

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i planifikimit të pamjaftueshëm të obligimeve kontraktuale dhe mungesës së koordinimit ndërmjet njësive përgjegjëse për menaxhimin e kontratës dhe planifikimin buxhetor.

Ndikimi

Mungesa e planifikimit buxhetor rrit rrezikun e mosshlyerjes së obligimeve kontraktuale në afat, krijimit të detyrimeve të papaguara dhe ekspozimit të Komunës ndaj kostove shtesë financiare.

Konkluzioni

Planifikimi buxhetor nuk ka qenë në përputhje me obligimet që rrjedhin nga kontrata, duke dobësuar menaxhimin financiar të saj.

Rekomandimi

Drejtoria përgjegjëse, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave, duhet të sigurojë që për të gjitha kontratat shumëvjeçare të planifikohen me kohë mjetet buxhetore në secilin vit fiskal, në përputhje me obligimet kontraktuale.

Gjendja

Kontrata nuk ishte përfshirë në Planin e Prokurimit për vitin 2025

Kriteri

Sipas **Ligjit për Prokurimin Publik** dhe rregullave për planifikimin e prokurimit, autoritetet kontraktuese duhet të përgatisin dhe përditësojnë Planin Vjetor të Prokurimit, duke përfshirë të gjitha aktivitetet e planifikuara të prokurimit.

Gjendja (e gjeturat)

Auditimi konstatoi se kontrata nuk ishte e përfshirë në Planin e Prokurimit për vitin 2025.

Shkaku

Shkaku ishte mungesa e koordinimit ndërmjet njësive përgjegjëse për planifikimin e prokurimit dhe njësive përgjegjëse për menaxhimin e kontratës.

Ndikimi

Mosplanifikimi në Planin e Prokurimit cenon procesin e planifikimit të prokurimit publik, zvogëlon transparencën dhe rrit rrezikun e mangësive në menaxhimin e kontratave.

Konkluzioni

Procesi i planifikimit të prokurimit nuk është zhvilluar në përputhje me kërkesat ligjore, pasi kontrata nuk ishte përfshirë në Planin Vjetor të Prokurimit.

Rekomandimi

Zyra e Prokurimit, në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse, duhet të sigurojë që të gjitha kontratat dhe aktivitetet e prokurimit të përfshihen në Planin Vjetor të Prokurimit dhe të përditësohen sipas nevojës.

Gjendja

Pagesat e kontratës janë realizuar kryesisht përmes procedurave përmbartimore

Kriteri

Sipas kushteve të kontratës dhe parimeve të menaxhimit të mirë financiar, autoriteti kontraktues duhet të kryejë pagesat brenda afateve të përcaktuara kontraktuale, duke shmangur krijimin e kostove shtesë për institucionin.

Gjendja (e gjeturat)

Auditimi konstatoi se pagesat ndaj operatorit ekonomik janë realizuar kryesisht përmes procedurave përmbartimore, duke gjeneruar shpenzime shtesë për Komunën në formë të tarifave përmbartimore dhe kostove të tjera të lidhura.

Shkak

Kjo ka ndodhur si rezultat i mosplanifikimit të mjeteve buxhetore dhe moskryerjes së pagesave brenda afateve të parapara.

Ndikimi

Si pasojë, Komuna ka bartur kosto të panevojshme financiare, duke ulur ekonomicitetin në shfrytëzimin e fondeve publike dhe duke ndikuar negativisht në menaxhimin financiar.

Konkluzioni

Procesi i pagesave nuk është menaxhuar në mënyrë efikase, pasi vonesat kanë rezultuar në procedura përmbartimore dhe shpenzime shtesë për Komunën.

Rekomandimi

Drejtoria përgjegjëse dhe Drejtoria e Financave duhet të vendosin mekanizma efektivë për monitorimin e obligimeve financiare dhe realizimin e pagesave brenda afateve kontraktuale, në mënyrë që të shmangen procedurat përmbartimore dhe kostot shtesë.

Praktikë e mirë e identifikuar gjatë auditimit (pozitive)

Auditimi konstatoi se, pavarësisht mangësive në aspektin e planifikimit financiar dhe administrativ, **implementimi i kontratës ishte në nivel të mirë**. Menaxheri i kontratës kishte dokumentuar procesin e zbatimit, ndërsa verifikimi në terren i **10 mostrave** të përzgjedhura nga auditori konfirmoi se punimet ishin realizuar në përputhje me kushtet dhe specifikimet e kontratës. Kjo tregon se aspekti operacional i menaxhimit të kontratës ishte efektiv, edhe pse proceset e planifikimit dhe menaxhimit të implementimin të kontratës ishin në nivelin e duhur.

5.Emërtimi i auditimit: Zbatimi i procedurave në Sektorin e Gjendjes Civile

Objektivat e auditimit

Qëllimi i këtij auditimi ka qenë që të sigurojmë menaxhmentin që procedurat e punës në Sektorin e Gjendjes Civile të Drejtorisë së Administratës janë zhvilluar në pajtueshmëri me legjislacionin, rregulloret dhe Udhëzimet administrative që janë në fuqi.

2.1 Objektivat kryesore për këtë auditim janë:

1. Të vlerësohet menaxhimi i të hyrave në Drejtorinë e Administratës (Sektori i Gjendjes Civile), përfshirë evidentimin, arkëtimin dhe raportimin e tyre.
2. Të vlerësohen aktivitetet e punës në Sektorin e Gjendjes Civile nëse janë realizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe procedurat e brendshme të institucionit.
3. Të vlerësohet nëse raportet e punës përgatiten dhe dorëzohen në afatin e paraparë dhe këto raporte janë të sakta dhe të plota.

2.2 Fushëveprimi i auditimit

- Periudha: 01.01.2026 – 30.03.2026
- Njësitë organizative: Drejtoria e Administratës
- Proceset: Procedurat e punës në Sektorin e Gjendjes Civile

3.1.Të gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet bazuar në objektivat e auditimit

Objektivi 1: Të vlerësohet menaxhimi i të hyrave në Drejtorinë e Administratës (Sektor i Gjendjes Civile), përfshirë evidentimin, arkëtimin dhe raportimin e tyre.

3.1.1 Të gjeturat

Kriteri:

Sipas Udhëzimit Administrativ (M.P.B.) Nr. 01/2022, neni 5 pika 3, specifikohet se dokumentet e gjendjes civile që dëmtohen ose përmbajnë gabime teknike gjatë lëshimit, duhet të evidentohen në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile dhe të bëhet shkatërrimi i tyre fizik. Ky proces siguron që dokumentet e pavlefshme të mos mbeten në qarkullim apo të keqpërdoren.

Gjithashtu, sipas Rregullave Financiare për Menaxhimin e të Hyrave Vetanake, çdo dokument i lëshuar (i vlefshëm apo i anuluar) duhet të jetë i pasqyruar saktë në raportet e arkëtimit për të siguruar përputhshmërinë mes letrave të certifikatave dhe mjeteve të grumbulluara.

Gjendja:

Gjatë vlerësimit të procesit në Sektorin e Gjendjes Civile në Komunën e Prishtinës, është vërejtur se dokumentet e dëmtuara ose ato me gabime teknike nuk shkatërrohen fizikisht pas anulimit në sistem. Këto dokumente grumbullohen ose mbeten tek zyrtarët pa u asgjësuar sipas procedurës ligjore të paraparë.

Gjatë vlerësimit, u vërejt se nuk ka një evidentim të rregullt mes numrit të letrave të certifikatave të shpenzuara dhe numrit të certifikatave të anuluar në sistemin financiar.

Shkaku:

Kjo gjendje vjen si pasojë mungesës së një mekanizmi kontrolli që lidh shpenzimin e materialit (letrës zyrtare) me procesin e arkëtimit.

Zyrtarët nuk mbajnë ditar të veçantë për numrin e serisë së certifikatave të dëmtuara që përputhet me procesverbalin e shkatërrimit.

Zyrtarët nuk kanë njohuri të mjaftueshme të detyrimeve nga UA 01/2022 për dokumentet e Gjendjes civile.

Ndikimi:

Mos shkatërrimi i certifikatave të dëmtuara krijon rrezik të lartë për keqpërdorim të të dhënave personale dhe cenim të sigurisë së dokumenteve zyrtare.

Ekziston mundësia që një certifikatë të anulohet në sistem si "e dëmtuar" (për të mos u arkëtuar pagesa), por dokumenti fizik të mbetet i paprekur dhe t'i dorëzohet palës jashtë procedurave zyrtare.

Kjo cenon integritetin e raportimit financiar, mundëson manipulimin me mjetet e arkëtuara dhe dëmton integritetin e shërbimeve të komunës.

Konkluzioni:

Sektori i Gjendjes Civile nuk ka arritur të zbatojë plotësisht kërkesat e UA 01/2022 sa i përket menaxhimit të dokumenteve të pavlefshme. Ky dështim në asgjësimin fizik tregon dobësi në kontrollet e brendshme dhe në menaxhimin e rreziqeve lidhur me dokumentacionin zyrtar.

Pa shkatërrimin fizik dhe regjistrimin e saktë të serisë së çdo dokumenti të dëmtuar, Drejtoria e Administratës nuk mund të garantojë se të gjitha shërbimet e ofruara janë arkëtuar dhe raportuar saktë. Kjo e vështirëson direkt edhe auditimin e të hyrave.

Rekomandimet:

- Të krijohet një regjistër i veçantë i dokumenteve të anuluar/dëmtuara ku shënohet numri i serisë së letrës dhe arsyeja e anulimit.
- Shkatërrimi fizik të bëhet në prezencë të një komisioni ose mbikëqyrësi dhe të dokumentohet me procesverbal për të vërtetuar se dokumenti nuk është në qarkullim.
- Pajisjeve adekuate (shredder-ë) për asgjësim të menjëhershëm pas verifikimit të komisionit.

Objekti 2. Të vlerësohen aktivitetet e punës në Sektorin e Gjendjes Civile nëse janë realizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe procedurat e brendshme të institucionit.

3.2.1 Të gjeturat

Kriteri:

Sipas Rregullores së Ministrisë së Financave mbi Menaxhimin e të Hyrave Publike, kërkohet që procesi i arkëtimit të jetë i ndarë nga procesi i regjistrimit dhe i dorëzimit të dokumentacionit (parimi i katër syve). Çdo inkasim i parësë së gatshme duhet të regjistrohet menjëherë në sistemin përkatës dhe të dorëzohet te Arkatari apo në Bankë brenda ditës zyrtare të punës, pa aplikuar limite arbitrare të mbajtjes së parave në sportel.

Gjendja:

Gjatë auditimit kemi konstatuar se në Zyrën e Gjendjes Civile nuk aplikohet ndarja e duhur e detyrave. Zyrtari i njëjtë lëshon certifikatat, pranon pagesat dhe mban mjetet monetare në posedim deri në vlerën 3000€. Vetëm pasi kjo shumë tejkalohet (pavarësisht sa javë/muaj mund të kalojnë) mjetet i dorëzohen Arkëtarit, duke lënë hapësirë që paratë e mbledhura të mos figurojnë në arkën qendrore për një kohë të gjatë.

Shkak:

Dobësitë në hartimin dhe mbikëqyrjen e procedurave të brendshme të arkëtimit, si dhe praktikat e trashëguara që bien ndesh me kornizën ligjore për menaxhimin financiar, kanë shkaktuar gjendjen e lartcekur.

Ndikimi:

Kjo praktikë rrit ekspozimin e institucionit ndaj rrezikut të keqpërdorimit të mjeteve (mashtimit). Mbajtja e parave jashtë arkës qendrore vështiron barazimin ditor të të hyrave dhe cenon integritetin e raportimit financiar.

Konkluzioni:

Sistemi i kontrollit të brendshëm mbi menaxhimin e të hyrave në Gjendjen Civile është joadekuat dhe nuk ofron siguri të mjaftueshme për mbrojtjen e parasë publike nga trajtimi i parregullt.

Rekomandimet:

- Të implementohet ndarjen e detyrave dhe të gjitha arkëtimet të dorëzohen tek Arkëtari në fund të çdo dite pune, pavarësisht vlerës së mbledhur;
- Të inkurajohen pagesat përmes sistemeve elektronike apo POS terminaleve për të minimizuar qarkullimin e parasë së gatshme (cash).

Objektivi 3: Të vlerësohet nëse raportet e punës përgatiten dhe dorëzohen në afatin e paraparë dhe këto raporte janë të sakta dhe të plota.

3.3.1 Të gjeturat

Kriteri:

Sipas parimeve të mirëfillta të menaxhimit publik dhe Rregullores së Brendshme për Organizimin e Komunës, Sektori i Gjendjes Civile duhet të përgatisë raporte periodike (muajore ose tremujore) mbi aktivitetet, shërbimet e ofruara dhe sfidat operationale. Raportimi i rregullt është i domosdoshëm për të siguruar llogaridhënie dhe për të mundësuar marrjen e vendimeve të bazuara në të dhëna nga ana e menaxhmentit të lartë.

Gjendja:

Në Sektorin e Gjendjes civile nuk ekziston një praktikë e raportimit të rregullt periodik. Raportet përgatiten kryesisht vetëm në fund të vitit (raporti vjetor) ose në raste kur kërkohen specifikisht nga menaxhmenti. Kjo dëshmon se nuk ka një kalendar të definuar për dorëzimin e raporteve të punës.

Shkaku:

Kjo gjendje vjen si rezultat i mungesës së një kërkesë zyrtare nga Drejtoria e Administratës për raportim periodik. Gjithashtu mbingarkesa me punë operative mund të ketë bërë që raportimi të shihet si proces dytësor.

Ndikimi:

Mungesa e raporteve periodike pamundëson mbikëqyrjen e performancës së zyrtarëve në kohë reale. Kjo çon në vonesa në identifikimin e problemeve (si p.sh. rritja e numrit të certifikatave të dëmtuara apo rënia e të hyrave) dhe e bën të pamundur vlerësimin e saktë të ngarkesës së punës për stafin.


Raportimi vetëm në fund vit është i pamjaftueshëm për të adresuar sfidat operative gjatë vitit.

Konkluzioni:

Procesi i raportimit në Sektorin e Gjendjes Civile vetëm në fund vit nuk i përmbush standardet e llogaridhënies. Raportet ekzistuese nuk mund të konsiderohen si mjete efektive menaxheriale pasi ato mungojnë në baza të rregullta kohore.

Rekomandimet:

- Drejtoria e Administratës duhet të përcaktojë një afat zyrtar (p.sh. deri me datën 5 të muajit vijues) për dorëzimin e raporteve mujore të punës.
- Të hartohet një format standard i raportimit që përfshin statistikën e shërbimeve, numrin e anulimeve të certifikatave dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo praktikë do të ndihmon menaxhmentin të ndërmarr veprime korrigjuese të menjëhershme.



(Nënshkrimi i udhëheqësit të NIA-së)

(Nënshkrimi i udhëheqësit të SSP-së)





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

PROPOZIM

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më .2026, miratoi këtë

V E N D I M **PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË VEPRIMIT PËR ARTIN DHE KULTURËN 2026-2031**

Neni 1

Miratohet vendimi i Strategjisë së veprimit për artin dhe kulturë 2026-2031;

Neni 2

Qëllimet kryesore të Strategjisë së veprimit për artin dhe kulturë 2026-2031: vjen si nevojë për të siguruar një kornizë ose udhërrëfyes për Kryeqytetin, për të realizuar potencialin kulturor dhe për të ndërtuar një sektor kulturor aktiv dhe të qëndrueshëm që kontribuon në zhvillimin e përgjithshëm social dhe ekonomik të Kryeqytetit;

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Strategjia e veprimit për artin dhe kulturë 2026-2031, si dhe Plani i veprimit;

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përgjegjëse;

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

STRATEGJIA E PRISHTINËS PËR ARTIN DHE KULTURËN 2026 - 2031

I. Lista e shkurtesave:	3
II. Lista e figurave:	4
III. Lista e tabelave:	4
Fjala e Kryetarit të Komunës së Prishtinës.....	5
Falënderime	6
Përmbledhje ekzekutive.....	7
HYRJE	9
METODOLOGJIA	10
MUZIKA.....	12
KINEMATOGRAFIA	14
ARTET PAMORE	16
TEATRI DHE ARTET PERFORMUESE.....	18
TRASHËGIMIA KULTURORE.....	19
ARTE DHE ARTIZANATET	22
BIBLIOTEKAT	23
INDUSTRIA E DIZAJNIT.....	25
EDUKIMI	26
TURIZMI DHE KULTURA.....	26
GASTRONOMIA DHE KULTURA.....	27
HAPËSIRAT PUBLIKE PËR ARTIN DHE KULTURËN NË PRISHTINË: Sfida dhe perspektivat për zhvillim.....	28
Aktivizim i hapësirave publike në Prishtinë	32
HAPËSIRAT PUBLIKE TË GJELBRA: PARAKUSHT PËR NJË JETË KULTURORE DINAMIKE	34
MANIFESTIMET DHE EVENTET.....	34
MENAXHIMI I POLITIKAVE KULTURORE NË PRISHTINË.....	36
Institucionet publike	36
FONDET PUBLIKE PËR ARTIN DHE KULTURËN NGA KRYEQYTETI I PRISHTINËS..	37

Fig.1. Ndarja e buxhetit të Prishtinës për kulturën 2020-2024.....	37
Tabela 1. Thirrje të hapura për aplikime për subvencione për kulturën nga Prishtina, për periudhën kohore 2020-2023.....	39
Fig 2. Shpërndarja e granteve për subvencionime në kulturë në vitin 2023.	41
ANALIZA SWOT	42
(Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet).....	42
VIZIONI: PRISHTINA – QYTET I ARTIT DHE KULTURËS	45
<u>OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE SPECIFIKE</u>	

I. Lista e shkurtesave:

SKK - Sektori Kulturor Krijues

OSHC - Organizata të Shoqërisë Civile

DK - Drejtoria e Kulturës

DA - Departamenti i Arsimit

EM - Qendra Multi-Kulturore Evropiane “Gërmia”

BE - Bashkimi Evropian

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

IKMM - Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve

KK - Kuvendi Komunal

KP - Komuna e Prishtinës

APK - Agjencia e Privatizimit të Kosovës

MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

MASHT - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

OJQ - Organizata Joqeveritare

QRTK - Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore

SWOT - Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet

UNESCO - Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë

UNHABITAT - Programi i Kombeve të Bashkuara mbi Vendbanimet Njerëzore

II. Lista e figurave:

Fig.1 Buxheti i Komunës së Prishtinës për kulturë në vitet 2020-2024

Fig. 2 Granti i alokuar për subvencionimet në kulturë në vitin 2023

III. Lista e tabelave:

Tabela 1. Thirrje e hapur për subvencionime në kulturë në Prishtinë prej 2020-2023

Tabela 2. Alokimi i fondeve për kulturë nga Komuna e Prishtinës në vitin 2023

GRUPI PUNUES DHE AUTORËT:

Ekipi i projektit IETL

Besa Zogaj-Gashi - udhëheqëse e projektit, autore e dokumentit strategjik

Philippe Kern - ekspert ndërkombëtar në politikat kulturore

Donjetë Murati - hulumtuese dhe sociologe e artit dhe kulturës

Rudina Hasimja - këshilltare e jashtme

Dardan Selimaj - ekspert në Sektorin e muzikës

Sali Shoshi - ekspert i trashëgimisë kulturore

Adrian Berisha - ekspert në Sektorin e muzikës, institucionet publike dhe hapësirën publike

Arta Agani - eksperte në arte vizuale, dizajn grafik

Vullnet Sanaja - ekspert i Skenës kulturore të pavarur dhe edukimit artistik

Qëndresa Zeka - dizajnere grafike

Rina Statovci - komunikim

Blerina Kanxha - përkthim

Fjala e Kryetarit të Komunës së Prishtinës

Të dashur qytetarë të Prishtinës,

Me kënaqësi të madhe ju prezantoj Strategjinë për Zhvillimin e Artit dhe Kulturës 2026-2031, një hap madhor për kryeqytetin tonë. Për herë të parë, kemi një plan të qartë për t'i dhënë Prishtinës një identitet të ri, atë të një qendre të rëndësishme artistike dhe kulturore me standarde evropiane.

Ky dokument është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e mbi 300 anëtarëve të komunitetit kulturor dhe në bashkëpunim me Institutin për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL). Gjatë këtij procesi, kemi siguruar që qëllimet tona strategjike të pasqyrojnë me saktësi nevojat dhe aspiratat e komunitetit artistik duke ndjekur një qasje të bashkëpunimit.

Historikisht, arti dhe kultura janë parë si luks, por nën udhëheqjen time, këto fusha janë bërë prioritet. Ne besojmë se kultura dhe arti janë të lidhura ngushtë me zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve. Me këtë në mendje, kemi vendosur të rrisim investimet tona me 10 % të buxhetit të qytetit për artin dhe kulturën, në përputhje me standardet e BE-së.

Strategjia mbështetet në këto pesë objektiva strategjike:

1. **E drejta për të krijuar** - Sigurimi i mundësive të barabarta për të gjithë që të shprehin kreativitetin e tyre.
2. **E drejta për qytetin** - Përmirësimi i qasjes dhe përfshirjes të gjithë qytetarëve në jetën kulturore.
3. **Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit kulturor dhe krijues** - Mbështetja dhe promovimi i një ekosistemi të qëndrueshëm për artin dhe kulturën.
4. **Kujtesa kolektive, gjithëpërfshirëse dhe e dekolonizuar** - Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore.
5. **Reforma administrative** - Rritja e efektivitetit të administratës së kryeqytetit në mbështetjen e zhvillimit kulturor.

Ky plan ambicioz do të transformojë Prishtinën në një qytet ku arti dhe kultura zënë një vend të rëndësishëm duke e vendosur atë në hartën e qyteteve kulturore të Evropës. Rruga para nesh është sfiduese, por e mundshme dhe jam i bindur se do të arrijmë sukses të madh.

Me respekt, Përparim Rama

Kryetar, Komuna e Prishtinës

Perparim Rama
Mayor of the Municipality of Pristina



Falënderime

Komuna e Prishtinës shpreh mirënjohjen e saj të thellë për bashkëpunëtorët dhe anëtarët e ekipeve profesionale dhe tematike që kontribuan në hartimin e Strategjisë për Artin dhe Kulturën. Me përvojën dhe përkushtimin e tyre u realizua një dokument strategjik i një cilësie të lartë, i cili adreson nevojat dhe aspiratat e komunitetit tonë.

Një falënderim i veçantë i dedikohet Institutit për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL) për mbështetjen e tyre profesionale dhe teknike që kontriboi në krijimin e një strategjie të qëndrueshme dhe vizionare. Ky bashkëpunim i suksesshëm shërben si shembull frymëzues dhe bazë për projekte të ardhshme që synojnë zhvillimin kulturor dhe artistik të qytetit tonë.

Përmbledhje ekzekutive

Strategjia e Prishtinës për Artin dhe Kulturën për vitet 2026-2031 përshkruhet si një vizion që synon të krijojë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin dhe promovimin e artit dhe kulturës duke e vlerësuar lartë kreativitetin dhe inovacionin.

Me një përkushtim të palëkundur për të nxitur mendimin kritik dhe shprehjen e lirë artistike autoktone, qyteti aspron të shfrytëzojë fuqinë e artit për të ndikuar në rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe për të zhvilluar një kulturë të përbashkët jetësore. Kjo strategji synon të krijojë një mjedis që nxit krijuesit të shprehen lirshëm dhe të kultivojnë shprehjen e tyre me lirinë dhe autonominë artistike.

Përmes artit dhe kulturës, Prishtina synon të influencojë sfera të ndryshme të jetës së përditshme duke filluar nga përjetimi i qytetit deri te zhvillimi urban dhe rritja ekonomike. Kjo qasje strategjike reflekton bindjen se arti dhe kultura janë motorë të rëndësishëm për transformimin social dhe ekonomik të qytetit dhe për avancimin e një shoqërie më të pasur dhe më të përparuar.

Fushat kryesore të adresuara në strategji janë të lidhura ngushtë me zhvillimin e integruar të Sektorit kulturor kreativ në qytet përfshirë: muzikën, artet pamore, teatrin, kinematografinë, edukimin, institucionet kulturore, hapësirat publike, manifestimet, buxhetin publik të qytetit për art dhe kulturë, trashëgiminë kulturore dhe shpirtërore, arkivat, gastronominë, artizanatet, bibliotekat dhe botimet.

Arti dhe kultura në të gjithë botën ballafaqohen me sfida të shumta dhe Prishtina nuk është përjashtim. Qyteti përballlet me: *mungesën e hapësirave të mjaftueshme publike* për aktivitete kulturore dhe krijimtari, për prova dhe studio për shfaqje të ndryshme, bashkëpunim për projekte të ndryshme dhe shkëmbimin e ideve, shfaqje dhe ekspozita, punëtori; *infrastrukturën e dobët të atyre ekzistuese dhe menaxhimin joefikas*, si dhe *mungesën e financimit të mjaftueshëm* që kufizon krijimtarinë dhe inovacionin dhe pengon një rritje ekonomike të qëndrueshme në këtë sektor.

Strategjia shfaq përkushtim për rëndësinë e rritjes së hapësirave publike dhe partneriteteve midis kryeqytetit dhe institucioneve qendrore, organizatave kulturore, shoqërisë civile, grupeve të të rinjve, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë për zhvillim.

Objektivat strategjike të strategjisë janë të lidhura ngushtë me objektivat specifike, sipas Kornizës për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik, për të krijuar hierarki të zbatimit dhe raportimit.

Ajo ofron vizion të unifikuar dhe pesëdhjetë e dy masa që lidhen me problemet e identifikuar në analizën e gjendjes.

Ndër masat dhe intervenimet kryesore të identifikuar në analizën e gjendjes janë: krijimi i programeve të edukimit artistik dhe kreativ për të gjitha grupmoshat, mbështetja e iniciativave lokale dhe të shoqërisë civile për të krijuar hapësira të lira për shprehjen artistike, konsultime dhe përfshirje e komunitetit në planifikimin urban dhe vendimmarrjen për përdorimin e hapësirave publike nga të gjithë qytetarët, ofrimi i granteve dhe subvencionve për krijuesit, organizatat kulturore dhe të rinjët për të zhvilluar projekte inovative, zhvillimi i programeve arsimore dhe kulturore që promovojnë njohjen dhe vlerësimin e historisë të të gjitha grupmoshave dhe kulturave në shoqëri, ndërtimi i monumenteve dhe hapësirave publike që përfaqësojnë historinë dhe kulturën e të gjithë grupmoshave dhe etnive në shoqëri, mbështetja e hulumtimeve dhe analizës të historisë së kolektivit për të adresuar dhe korrigjuar narrativet e shtrembëruara dhe të padrejta dhe rishikimi i strukturave dhe proceseve administrative për të përmirësuar efikasitetin e Drejtorisë së Kulturës për të siguruar që reforma administrative t'i përgjigjet nevojave dhe kërkesave të komunitetit.

Theksi vihet në politika që rrisin autonominë artistike, pavarësinë dhe fuqizimin e sektorëve kulturor dhe kreativ në kryeqytet.

HYRJE

Prishtina, kryeqyteti i Kosovës, shërben si qendra kryesore e vendit në fusha të ndryshme – ekonomike, arsimore, politike, kulturore, administrative, financiare dhe tregtare. Si vendndodhja e institucioneve kyçe shtetërore, përfshirë Qeverinë, Presidencën dhe Kuvendin, Prishtina luan një rol qendror në proceset vendimmarrëse politike dhe administrative të Kosovës.

Trashëgimia historike e Prishtinës përbën një komponent kyç të identitetit të saj, duke pasqyruar vlera të rëndësishme kulturore dhe historike. Lokalitetet arkeologjike që datojnë nga periudhat parahistorike, përfshirë artefakte nga periudhat paleolitike dhe neolitike, tregojnë për një histori të pasur që ruan vazhdimësinë kulturore. Për më tepër, monumentet historike dhe traditat kulturore të trashëguara deri më sot dëshmojnë lidhjen e qytetit me rrënjët e tij historike dhe zhvillimin shoqëror ndër shekuj. Edhe pse sfidat e shekullit XIX dhe periudha e luftërave në vitet '90 përbënë një periudhë të vështirë, Prishtina ka treguar qëndrueshmëri dhe rigjenerim të jashtëzakonshëm. Procesi i rindërtimit pas luftës ka pasuruar qytetin me një trashëgimi të gjallë duke ndërlidhur të kaluarën me aspiratat e modernizimit.

Kultura dhe arti në Prishtinë janë në një fazë të zhvillimit dinamik dhe inovativ. Qyteti ofron një gamë të gjerë të aktiviteteve artistike dhe kulturore duke përfshirë arte pamore, teatër, muzikë, kinematografi, arkitekturë, dizajn, botime dhe artizanate. Artistët e Prishtinës trajtojnë tema të rëndësishme si demokracia, mjedisi dhe përfshirja sociale përmes qasjeve kritike dhe inovative. Një numër i madh ngjarjesh kulturore dhe festivalesh ndërkombëtare e vendosin Prishtinën në hartën rajonale si një qendër kulturore aktive dhe ambicioze.

Përkundër përparimeve, Prishtina përballlet ende me sfida strukturore që prekin sektorin kulturor. Kufizimet financiare dhe mbështetja publike e pamjaftueshme kufizojnë mundësitë për qëndrueshmëri dhe zhvillim. Hapësirat për krijimtari, prova dhe kërkime janë të kufizuara, ndërsa mungesa e platformave për promovimin e artistëve të rinj dhe ndërlidhjen me tregjet ndërkombëtare përbën një pengesë të madhe për zhvillimin e sektorit krijues.

Angazhimi i Kryetarit të Prishtinës për t'i dhënë prioritet artit dhe kulturës është thelbësor. Ai ka shprehur një vullnet të fortë politik për të promovuar këta sektorë si në nivel lokal ashtu edhe ndërkombëtar. Në të njëjtën kohë, komuniteti artistik tregon gatishmëri për të kontribuar drejt pozicionimit të Prishtinës si një qendër kulturore me reputacion rajonal dhe ndërkombëtar. Strategjitë e partneritetit me organizata ndërkombëtare dhe donatorë ofrojnë një platformë të qëndrueshme për mbështetje afatgjate dhe inovacion.

Në këtë kontekst, Strategjia për Artin dhe Kulturën e Prishtinës për periudhën 2026-2031 paraqet një dokument të harmonizuar me standardet e BE-së, duke adresuar nevojat dhe potencialet e sektorit kulturor. Ajo fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës kulturore, rritjen e qasjes në

burime dhe fuqizimin e artistëve duke synuar krijimin e një ekosistemi të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës kulturor.

Ajo bazohet në kapitalin njerëzor dhe hapësirat publike për të forcuar kujtesën kolektive dhe identitetin unik të qytetit. Përmes kësaj strategjie, Prishtina synon të bëhet një model i avancuar për zhvillimin kulturor të qëndrueshëm duke promovuar një frymë bashkëpunimi dhe inovacioni artistik.

METODOLOGJIA

Metodologjia e përpilimit të strategjisë për artin dhe kulturën në Prishtinë është bazuar në Manualin për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të tyre të veprimit. Ky proces është zhvilluar në disa faza të mirëpërcaktuara, të cilat do të detajohen më poshtë.

Faza 1: Faza përgatitore

Procesi i përpilimit të strategjisë nisi në muajin dhjetor të vitit 2023. Ekipi hartues, i përbërë nga ekspertë dhe përfaqësues të ndryshëm të sektorit, u angazhua për mbledhjen e të dhënave kualitative. Një pyetësor me titull "Përpilimi i Strategjisë për Artin dhe Kulturën në Prishtinë" u shpërnda dhe u plotësua nga 150 respondentë të ftuar në punëtori. Ky pyetësor u përqendrua në aspekte të rëndësishme si roli i komunës në art dhe kulturë, mekanizmat e subvencionimit, përdorimi i hapësirës publike, praktikat edukative dhe proceset e vendimmarrjes. Ky instrument shërbeu si bazë për mbledhjen e të dhënave për analizën e gjendjes.

Përveç pyetësorit, ekipi kryesor e projektit ka bërë një rishikim të thellë të dokumenteve hulumtuese duke përfshirë dokumente të komunës, të dhëna demografike dhe statistikore, Bruto Prodhimin Vendor (BPV), legjislaturën kulturore dhe analizën e buxhetit të komunës për kulturë. Ky rishikim përfshinte shqyrtimin e shpenzimeve kulturore të Komunës së Prishtinës duke u fokusuar në pagat, investimet kapitale, subvencionet dhe grantet gjatë viteve të fundit.

Gjithashtu, u shqyrtuan dispozitat legislative që lidhen me zhvillimin kulturor në Kosovë, duke pasur parasysh kornizat ekzistuese dhe ndarjen e burimeve. Dokumentet strategjike të zhvilluara në kryeqytete të tjera u analizuan për të identifikuar praktikrat dhe standardet më të mira ndërkombëtare.

Faza 2: Organizimi i punëtorive

Në janar të vitit 2024, u organizuan gjashtë punëtori sipas fushave të ndryshme duke përfshirë palë të ndryshme të interesit si artistë, përfaqësues të institucioneve publike dhe të pavarura, shoqërisë civile, biznese dhe donatorë ndërkombëtarë. Punëtoritë u udhëhoqën nga Philippe Kern, një ekspert ndërkombëtar për politika kulturore, i cili nxori përfundimet më 30 janar 2024, duke shërbyer si platformë orientuese për hartimin e strategjisë.

Faza 3: Intervista individuale

Pas përfundimit të punëtorive, në muajin shkurt, u zhvilluan intervista individuale me palët e interesit. Këto intervista kishin për qëllim të thellonin diskutimet dhe të siguronin një konsensus më të gjerë rreth hapave të nevojshëm për avancimin e artit dhe kulturës në Prishtinë.

Faza 4: Analiza e gjendjes

Në këtë fazë u identifikuan problemet dhe prioritetet bazuar në diskutimet me ekspertë të fushave të ndryshme. Analiza SWOT ndihmoi në identifikimin e pikave të forta dhe të dobëta, si dhe mundësive dhe rreziqeve që lidhen me zhvillimin kulturor.

Faza 5: Përcaktimi i vizionit dhe objektivave strategjike

Gjatë kësaj faze, ekipi hartues përcaktoi vizionin e strategjisë së artit dhe kulturës. U vendosën pesë objektiva strategjike, të cilat prioritzuan veprimet kryesore për përmirësimin dhe avancimin e Sektorëve Kulturor dhe Kreativ (SKK)¹. Për secilin objektiv strategjik, u përcaktuan objektivat specifike, aktivitetet dhe treguesit.

Faza 6: Hartimi i draftit të parë

Drafti i parë u komentua nga eksperti ndërkombëtar Philippe Kern, i cili më 10 prill 2024 ofroi vlerësimet dhe sugjerimet e tij. Pas përmirësimeve, drafti u prezantua më 15 prill 2024 për Kryetarin e Komunës dhe drejtorët e departamenteve për sugjerime dhe komente.

Faza 7: Konsultimet dhe vlerësimet

Pas prezantimit, drafti pritet t'i nënshtrohet rishikimit nga publiku përmes platformës së komunës për konsultim publik. Komentet dhe sugjerimet e mbledhura do të analizohen dhe do të integrohen në versionin final të Strategjisë për Artin dhe Kulturën në Prishtinë, për periudhën 2026-2031.

ANALIZA E GJENDJES

Prishtina, si kryeqendra kulturore e Kosovës, ofron një jetë të pasur artistike dhe kulturore. Ky qytet, i formësuar nga historia dhe gjeografia unike, është gjithashtu një qendër e rëndësishme për zhvillimin e artit dhe kulturës në nivel kombëtar. Mikpritja dhe dinamika kulturore e Prishtinës janë të përforuara nga një lëvizje kulturore dhe artistike shumë aktive, e cila mbështetet kryesisht nga organizata joqeveritare (OJQ) të fuqishme dhe një skenë e pavarur kulturore. Kjo lëvizje kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e politikave kulturore, demokratizimin e shoqërisë dhe promovimin e identitetit kulturor të vendit të rëndësishëm së kësaj skene kulturore është fakti që Prishtina u zgjodh si nikoqire e edicionit të 14-të të Bienales Nomadike Evropiane "Manifesta" në vitin 2022².

¹ SKK- Anglisht CCI Cultural Creative Industries

² Manifesta është shtrirë në 25 hapësira emblematike të Prishtinës duke paraqitur në to 77 artistë nga 32 shtete, dhe 37 nga Kosova. E ftuar nga Komuna e Prishtinës ky festival ka mbështetur ambicien e qytetarëve të Kosovës për të rikthyer, rivitalizuar hapësirat publike dhe për të ndihmuar në rishkrimin e të ardhmes së kryeqytetit të tyre.

Kryeqyteti përfshin gjithashtu 48 fshatra që kontribuojnë në përbërjen e tij kulturore dhe sociale. Prishtina ka një popullsi të shumëllojshme, me shqiptarë që përbëjnë shumicën (97.7%) dhe me grupe të tjera etnike përfshirë turqit, ashkalitë, serbët, si dhe komunitetet goran, rom dhe egjiptian.

Sipas të dhënave preliminare nga regjistrimi i fundit i popullsisë, i realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në periudhën prill-maj 2024, popullsia e Prishtinës arrin në 227,154 banorë duke e bërë atë qytetin më të madh në Kosovë.

Megjithëse rëndësia e Sektorit kulturor (SKK) në Kosovë është pranuar, përfshirë në kryeqytet, ky sektor mbetet ende i padokumentuar në mënyrë të plotë. Aktualisht, Prishtina nuk ka një hartë të qartë të këtij sektori të rëndësishëm. Në nivelin e Bashkimit Evropian, CCS³ (SKK-të) luajnë një rol të konsiderueshëm duke kontribuar me 9 milionë vende pune, që përbëjnë 3.2% të GDP-së së BE-së, një kontribut që tejkalon sektorë si turizmi dhe industria e makinave (UNESCO, 2022). Parashikimet globale tregojnë se deri në vitin 2030, SKK-të përbëjnë rreth 10% të GDP-së globale (G20, 2021)⁴.

Në kontekstin e Prishtinës, sektorë të ndryshëm brenda sektorit kreativ dhe kulturor kontribuojnë në zhvillimin kulturor të qytetit, por shpesh mbeten të papërfaqësuar në statistikave zyrtare. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK)⁵, vetëm 3,720 individë janë të punësuar kulturore ose në profesione të lidhura me kulturën duke përbërë rreth 0.9 % të punësimit total në vend. Këto të dhëna nuk reflektojnë plotësisht kontributin e skenës së kulturës së pavarur (OJQ dhe individe), te cilet kanë një të rëndësishëm në zhvillimin dhe dinamizmin kulturor të qytetit.

Për këtë arsye, është thelbësore që të përmirësohet mbledhja e të dhënave në lidhje me SKK-të, në mënyrë që të kuptohet më mirë madhësia, shpërndarja dhe ndikimi i këtij sektori në ekonominë kombëtare. Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë ekonomike dhe shoqërore të SKK-ve është një hap i rëndësishëm i zhvillimit të qëndrueshëm dhe forcimit të pozicionit të tyre brenda ekonomisë së vendit.

MUZIKA

Skena muzikore e Prishtinës është një ekosistem i larmishëm dhe dinamik që ka një ndikim të rëndësishëm në identitetin kulturor të qytetit. Duke përfshirë një gamë të gjerë zhanresh dhe

³ Nuk ka një term të dakorduar mbi përkufizimin e Sektorit Kulturor dhe Krijues (CCS) në UNESCO, BE dhe institucione të tjera. Sektorët kulturorë dhe krijues përfshijnë të gjitha fushat aktivitetet e të cilave janë të rrënjësura në vlera kulturore ose përfshijnë shprehje artistike, qoftë individuale apo kolektive. Këta sektorë janë të përkufizuara në kornizën ligjore të Programit *Creative Europe*. Klasifikimi i Eurostat përfshin 10 fusha kulturore: Trashëgimia, Arkivat, Bibliotekat, Librat dhe shtypi, Artet pamore, Artet performative, Produktet audio-vizuale dhe multimedia, Arkitektura, Reklamimi, Punëdoret. Gjithashtu përfshin gjashtë veprimtari: krijimtarinë, prodhimin dhe publikimin, shpërndarjen dhe shitjen, ruajtjen, edukimin, menaxhimin dhe mundësimi i masave rregulluese.

⁴ G20 është një forum ndërqeveritar që përfshin 19 vende sovraane, Bashkimin Evropian dhe Bashkimin Afrikan. Ai punon për të adresuar çështjet kryesore që lidhen me ekonominë globale, të tilla si stabiliteti financiar ndërkombëtar, zbutja e ndryshimeve klimatike dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

⁵ Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) ne kemi informacion për të gjithë Republikën e Kosovës, dhe jo specifikisht për Prishtinën e vitit 2022. Të dhënat e punësimit në sektorin kulturor derivojnë prej pyetësorit të fuqisë punëtore. Punësimi kulturor përfshin të gjithë ata individë që punojnë në aktivitete ekonomike që konsiderohen kulturore nëse personat kanë një punë në sektorin kulturor. Kjo përfshin gjithashtu bashkëpunimin kulturor pavarësisht nëse punësimi i tyre është në një aktivitet jokulturor.

aktivitetesh, ajo ka ndihmuar në formësimin e Prishtinës si një qendër kulturore dhe artistike, jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në atë rajonal. Çdo vit, qyteti organizon mbi 30 festivale muzikore që mbulojnë zhanre nga muzika klasike deri te format bashkëkohore dhe eksperimentale, duke tërhequr artistë dhe adhurues nga e gjithë bota.

Përparësitë e skenës muzikore

Një nga përparësitë kryesore të skenës muzikore në Prishtinë është prania e festivaleve të shumta dhe aktiviteteve kulturore që përfaqësojnë një spektër të gjerë artistik. Festivali “Sunny Hill,” organizuar nga këngëtarja me famë botërore Dua Lipa, ka sjellë vëmendjen ndërkombëtare në Kosovë, duke tërhequr mijëra vizitorë dhe artistë të njohur. Festivale të tjera si “ReMusica,” që përqendrohet në muzikën klasike, dhe “DAM Festival,” i fokusuar në muzikën bashkëkohore, kontribuojnë gjithashtu në reputacionin kulturor të qytetit.

Institucionet muzikore publike luajnë një rol kyç në zhvillimin e skenës muzikore. Filharmonia e Kosovës, e përbërë nga Orkestra Simfonike dhe Kori, është një nga institucionet kryesore që promovon muzikën klasike me 120 anëtarë⁶, ndërsa Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit ofron një gamë të gjerë aktiviteteve muzikore. Këto institucione ndihmojnë në ruajtjen dhe promovimin e muzikës dhe kulturës së lartë në Prishtinë. Gjithashtu, qyteti ka një infrastrukturë të fortë për edukimin muzikor, me tri fakultete muzikore dhe shkolla të dedikuara që ofrojnë formim për muzikantët e rinj. Kjo krijon një brez të ri artistësh të talentuar që do të kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të skenës muzikore të qytetit.

Problemet dhe dobësitë e skenës muzikore

Me gjithë përparësitë e saj, skena muzikore e Prishtinës përballet me disa sfida të rëndësishme.

Mungesa e hapësirave për organizime është evidente për të gjitha aktivitetet muzikore në qytet. Skena e muzikës “live” dikur e shtrirë edhe në klube ikonike po ashtu vuan pasojat e pandemisë duke çuar në mbylljen e lokaleve për muzikë “live”. Disa prej hapësirave publike ku mbahen aktiviteteve kryesore të muzikës mbeten: Salla e Kuqe, Atelieja dhe Amfiteatri i Pallatit të Rinisë dhe Sportit, Amfiteatri i ri i Bibliotekës Universitare, Salla e vogël e Fakultetit të Arteve, Holli i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, Kino Armata, Modelariumi i Fakultetit të Arkitekturës, Kisha katolike “Shën Ndou” dhe Katedralja “Nënë Tereza”. Hapësira në pronësi private, si “Hotel Emerald” (salla “Beethoven”) dhe “Swiss Diamond” (salla “Dyarl”) kanë salla për shfaqje. Hapësira më periferike si Klan Arena apo AMC Hall, ndodhen në periferi të Prishtinës dhe shërbejnë për organizimin e eventeve më të mëdha (me kapacitet prej 1000 vetash).

⁶ Filharmonia e Kosovës paraqet padyshim vazhdimësinë e punës së ish Orkestrës Simfonike të Radiotelevizionit të Prishtinës (e themeluar 1975) veprimtaria e secilës u shua me dhunë nga regjimi serb në vitin 1990. Kori i Filharmonisë së Kosovës është ansamble profesionist me 50 anëtarë përfshinë vepra të epokave të ndryshme stilistike nga renesanca e deri te veprat e kompozitorëve të muzikës bashkëkohore.

Hapësirat publike të hapura përdoren kryesisht gjatë muajve të verës dhe janë: Sheshi “Skënderbeu”, amfiteatri në sheshin “Zahir Pajaziti”, rruga “2 Korriku”, platoja e Pallatit të Rinisë dhe Sportit, amfiteatri i parkut të Gërmisë dhe fusha e basketit, si dhe Kalaja e Harilaqit.

Rritja e numrit të hapësirave për koncerte dhe festivale do të ndihmonte në përmirësimin e infrastrukturës dhe do të krijonte mundësi të reja për artistët dhe organizatorët.

Financimi i pamjaftueshëm është një nga problemet kryesore për artistët e rinj muzikorë në Kosovë, pasi mbështetja nga sektori publik është shumë e kufizuar. Kjo mungesë financimi pengon zhvillimin e projekteve afatgjata dhe përmbushjen e nevojave të skenës muzikore në mënyrë të qëndrueshme. Për kompozitorët e rinj, mungesa e interpretimit profesional nga trupa të organizuara si kor apo ansamble është një tjetër pengesë, pasi kjo është një praktikë e zakonshme në konservatorët ndërkombëtarë, por mungon në Kosovë. Fakultetet muzikore nuk ofrojnë struktura të plota për prova dhe performanca, duke ndikuar negativisht në formimin artistik të studentëve. Për më tepër, mungesa e sallave të përshtatshme për aktivitete muzikore dhe prova është një sfidë e vazhdueshme.

Përballja me sfidën e "skills gap" kërkon një qasje gjithëpërfshirëse që fokusohet te krijimi i programeve arsimore të specializuara, mbështetja për teknologjinë muzikore dhe ngritja e mekanizmave që lidhin artistët me skenën globale. Kjo do të mundësonte zhvillimin profesional të artistëve dhe forcimin e industrisë muzikore në Kosovë.

Mundësitë për zhvillim

Komunat dhe festivalet kanë potencial të madh për të mbështetur zhvillimin kulturor, por shpeshherë nuk përfitojnë nga mundësitë ndërkombëtare si "EFFE Seal for Festival Cities and Regions." Gjithashtu, festivalet nuk janë integruar në mënyrë të qëndrueshme në një agjendë kombëtare kulturore, duke kufizuar ndikimin e tyre në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Skena muzikore e Prishtinës ka një potencial të madh për të zgjeruar ndikimin e saj në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Festivali “Sunny Hill” dhe festivale të tjera si “Chopin Piano Fest” tregojnë mundësitë që qyteti ka për të tërhequr audienca të reja dhe për të forcuar reputacionin e tij ndërkombëtar. Zhvillimi i zhanreve të ndryshme, përfshirë muzikën elektronike, po ashtu diversifikon ofertën kulturore dhe krijon një peizazh artistik më të pasur dhe energjik.

Për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm, është thelbësore të rritet mbështetja financiare nga sektori publik dhe privat. Një investim i qëndrueshëm në infrastrukturë dhe krijimi i hapësirave të reja për performanca muzikore do të ishin hapa të rëndësishëm për të përmirësuar skenën muzikore të qytetit dhe për të ndihmuar artistët të arrijnë sukses të qëndrueshëm.

KINEMATOGRAFIA

Kinematografia në Kosovë ka arritur sukses të jashtëzakonshëm në skenën globale duke u njohur në ngjarje prestigjioze si Oscars, BAFTA dhe Sundance. Këto arritje kanë tërhequr vëmendjen e

qeverisë duke ngritur si çështje të interesit publik me potencial të madh për rritje dhe suksese të mëtejshme.

Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK) është institucioni kryesor publik për kinematografi në Kosovë, i cili ka për qëllim realizimin e politikave kinematografike për interesin publik. QKK organizon thirrje vjetore për subvencionimin e projekteve filmike në kategori të ndryshme si metrazh i shkurtër dhe i gjatë artistik, dokumentar, animacion, zhvillim skenarësh dhe bashkëprodhime ndërkombëtare. Përveç kësaj, QKK promovon industrinë e filmit të Kosovës në festivale dhe tregje ndërkombëtare të filmit. QKK ka të regjistruara 280 studio filmike që rrisin fushën e regjisorëve të talentuar, producentëve dhe skenaristëve.

Sa i përket edukimit, Fakulteti i Arteve, përmes Regjisë së Filmit dhe Televizionit, është institucioni më i besueshëm për studimin e filmit në Kosovë. Ky fakultet ofron një bazë të fortë akademike dhe praktike për studentët e filmit.

Platformat joformale si “Neo School e Kino Armatës“, “Anibar“ dhe “Akademia e Animacionit“ ofrojnë trajnime ekstrakurrikulare për filmbërësit e rinj në zhanre të ndryshme. Këto programe janë thelbësore për zhvillimin e aftësive praktike dhe kreative të studentëve për aspektet e ndryshme të procesit të filmbërjes së dokumentarëve, prej produksionit, hulumtimit, zhvillimit të skenarit, regjisë, montazhit, audios.

Kino Armata, Kino Rinia dhe Kino ABC ofrojnë hapësira për shfaqje të filmave dhe promovimin e përmbajtjeve audiovizuale. Megjithatë, ekziston një mungesë e pajisjeve moderne dhe studiove të prodhimit, të cilat janë esenciale për post-produksionin dhe zhvillimin profesional të filmave.

Festivali ndërkombëtar i filmit në Prishtinë, ndryshe i njohur si PriFest, mbahet në Prishtinë dhe shfaq produksione të ndryshme filmash të mirënjohur ndërkombëtarisht në regjionin e Ballkanit. Është themeluar pas deklarimit të Pavarësisë së Kosovës, në vitin 2008. Përmes Pri Film Fest, Prishtina shfaqet si qendër për takime ndërkombëtare të filmbërësve dhe studiove. Këto ngjarje ofrojnë një platformë për shkëmbim ndërkombëtar, duke lejuar profesionistët vendas të shfaqin punën e tyre, të lidhen me homologët ndërkombëtarë dhe të shkëmbejnë njohuri të vlefshme me industrinë globale të filmit. Përveç kësaj, televizioni kombëtar i Prishtinës, RTK, luan një rol vendimtar në promovimin e talentëve dhe produksioneve vendore, duke forcuar më tej pozitën e qytetit në skenën ndërkombëtare të filmit.

Megjithëse qeveria njeh rolin vendimtar të filmit, industria përballlet me kufizime në infrastrukturë, teknologji dhe kapacitete. Në punëtorinë e organizuar më 24 janar 2024, me përfaqësues të Sektorit të kinematografisë dhe intervistat e zhvilluara me profesionistë të fushës, u identifikuan sfidat kryesore, si: mbështetja financiare e pamjaftueshme, mungesa e pajisjeve moderne kamera, audio pajisje, njësi montazhi, etj., procedurat burokratike për lejet e xhirimit. Mungesa e aftësive teknike

për rolet si teknikë transmetimi dhe audio-vizualë, dizajnerë grafikë dhe multimedial dhe fotografë. Këto role kërkojnë kompetenca të avancuara në montazh video, inxhinieri të tingullit, dhe dizajn digjital, por aftësitë ekzistuese nuk i përmbushin standardet e tregut. Mungesa e aftësive si gjuhët e huaja, përdorimi i mjeteve digjitale dhe njohuritë për mbrojtjen e mjedisit. Buxheti i ndarë nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve (MKRS) për vitin 2024 për QKK, prej 1,600,000 euro, u konsiderua i pamjaftueshëm. Në punëtori u theksua nevoja për një fond të veçantë të Kryeqytetit për kinematografinë sipas praktikave të vendeve të zhvilluara me qëllim të promovimit të artistëve të rinj dhe rritjes së pjesëmarrjes në skenën ndërkombëtare, e cila përkthehet në zhvillim ekonomik. Një industri e fortë filmike ndihmon në zhvillimin e identitetit dhe kulturës kombëtare, edukimin e publikut dhe promovimin e turizmit duke bërë që lokacionet filmike të kthehen në destinacione të njohura turistike.

ARTET PAMORE

Skena e arteve pamore në Prishtinë shquhet për pasurinë dhe larmishmërinë e saj duke reflektuar një ekosistem dinamik dhe të ndryshueshëm. Ajo mbështetet në një spektër të gjerë artistësh, hulumtuesish, kuratorësh, institucioneve dhe platformave online që promovojnë artin në forma të ndryshme si piktura, video, skulpturë, media të miksuara, performancë dhe publikime. Kjo larmi është përforcuar nga një rrjet i fuqishëm që përfshin kompani të printimit, dizajnit dhe prodhimit të materialeve duke krijuar një sistem të ndërlidhur që mbështet artin pamor.

Hapësirat kryesore për artet pamore përfshijnë institucionet publike si *Galeria Kombëtare e Kosovës*⁷, *Galeria e Ministrisë së Kulturës (Qafa)*⁸, si dhe hapësirat e institucioneve të arsimit të lartë, si Galeria e Arteve dhe Galeria e Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës. Megjithatë, pjesa më e madhe e aktiviteteve artistike realizohet nga skena e pavarur, e cila përfshin organizata si Foundation 17, Termokiss, Stacion - Qendra për Art Bashkëkohor Prishtinë dhe festivale si “HAPU”.

Artet rrugore përbëjnë një aspekt të rëndësishëm të skenës artistike në Prishtinë, me ngjyra dhe komente që zbukurojnë çdo anë të qytetit. Takimi i përvitshëm i “Meeting of Styles” sjell së bashku artistë vendorë dhe ndërkombëtarë duke ofruar një platformë për mesazhe të larmishme dhe ekspresive. Megjithatë, skena e arteve pamore përballlet me sfida të rëndësishme pasi që mungesa e hapësirave për prodhim, mjeteve dhe burimeve financiare ka ndikuar në zhvillimin e saj. Sidoqoftë, artistët e pavarur janë të angazhuar me çështje politike dhe shoqërore duke shfaqur punimet e tyre përmes ekspozitave dhe ndërhyrjeve artistike, të organizuara nga iniciativa si Oral History Initiative, Cultural Heritage without Borders (CHwB), dhe ForumZFD.

⁷ Galeria Kombëtare e Kosovës u themelua në vitin 1979 si institucion kulturor për prezantimin e artit pamor dhe ruajtjen e mbledhjen e veprave më me vlerë. Për këto 30 vjet të veprimtarisë ky institucion ka organizuar afro 500 ekspozita në vend dhe në botën e jashtme, të cilat janë përcjellë me shumë botime, dhe blerjen e afro 1000 punimeve artistike nga të cilat është formuar një fond i pasur i Galerisë.

⁸ Galeria e Ministrisë së Kulturës GMK ka filluar punën në shtator të vitit 2000. Që nga fillimi i saj e deri më sot, janë organizuar mbi 200 ekspozita individuale e kolektive të autorëve vendor dhe ndërkombëtar.

Peizazhi i artit publik në Prishtinë është gjithashtu i pasur me statuja dhe instalacione që përfaqësojnë figura historike dhe ngjarje të rëndësishme. Monumentet si ai i Skënderbeut dhe Ibrahim Rugovës, së bashku me instalacione të reja si "Trëndafili i Bardhë" nga Sislej Xhafa, e theksojnë rëndësinë e artit në hapësirën publike. Kjo shpërndarje e arteve publike nënvizon potencialin e pashfrytëzuar të qytetit për të integruar veprat e artit bashkëkohor në arkitekturën e tij duke krijuar hapësira interaktive që nxisin angazhimin e komunitetit.

Përveç kësaj, zhvillimi urban i Prishtinës ka anashkaluar angazhimin e komunitetit duke çuar në mungesën e hapësirave publike që nxisin ndjenjën e përkatësisë. Çështja e hapësirës publike është një temë e vazhdueshme në diskutimet mbi përdorimin dhe programimin e saj me artistët dhe organizatat e shoqërisë civile që kontribuojnë në këtë dialog përmes projekteve dhe hulumtimeve.

Artet pamore në Kosovë përballen me disa probleme kryesore, duke përfshirë mungesën e financimit dhe mbështetjes institucionale, e cila kufizon zhvillimin e projekteve dhe ekspozitave të qëndrueshme. Mungojnë hapësirat e dedikuara për ekspozita dhe studiot për artistë, duke ndikuar negativisht në krijimtarinë dhe prezantimin e punëve të tyre. Edukimi dhe trajnimi në artet pamore janë të kufizuara, me një mospërputhje mes programeve arsimore dhe kërkesave të tregut, si dhe mungesën e mentorimit dhe shkëmbimeve ndërkombëtare. Njohuritë për marketingun, promovimin dhe përdorimin e platformave digjitale janë të dobëta, duke kufizuar mundësitë për artistët që të arrijnë një audiencë më të gjerë dhe të hyjnë në tregje ndërkombëtare. Për më tepër, mungesa e vlerësimit të artit pamor dhe përfshirjes së tij në politikat kulturore redukton impaktin e tij në zhvillimin kulturor dhe ekonomik të vendit.

Në këtë kontekst, Prishtina shënoi një ngjarje të rëndësishme me Manifesta 14 në vitin 2018, e cila transformoi hapësirat publike me ndërhyrje artistike dhe rindezi interesin për artin. Kjo bienale ka shërbyer si një testament për potencialin e qytetit dhe është një shembull i rëndësishëm i bashkëpunimit ndërkombëtar. Megjithatë, mundësitë për rezidenca dhe trajnime për artistët janë të limituara duke e bërë të vështirë zhvillimin e tyre në nivel ndërkombëtar. Fondacioni 17 dhe Qendra Multimedia ofrojnë disa mundësi, por kërkohet më shumë mbështetje për të krijuar hapësira dhe burime që nxisin kreativitetin dhe angazhimin e artistëve.

Në përfundim, skena e arteve pamore në Prishtinë është një reflektim i pasurisë kulturore dhe sfidave që përballen komuniteti artistik. Me mbështetje të vazhdueshme dhe përkushtim për angazhimin e komunitetit, kjo skenë ka potencialin të zhvillohet dhe të rritet në mënyrë të qëndrueshme.

Skena e arteve pamore në Prishtinë jo vetëm që reflekton pasurinë kulturore dhe sfidat ekzistuese, por edhe demonstroi potencial të qartë për transformim urban dhe zhvillim social përmes artit publik. Integrimi strategjik i artit në hapësirat publike, mbështetja e iniciativave ekzistuese dhe promovimi i modeleve të suksesshme locale, duhet të jenë pjesë kyçe e politikave kulturore për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të sektorit.

TEATRI DHE ARTET PERFORMUESE

Skena teatrore dhe artistike në Prishtinë përbën një mozaik të pasur dhe të larmishëm, i cili reflekton një angazhim të vazhdueshëm për të promovuar artin dhe kulturën në nivel lokal dhe ndërkombëtar. Qyteti ofron një gamë të gjerë shfaqjesh përmes teatrove si Teatri Kombëtar i Kosovës, Teatri “ODA” dhe Teatri i Qytetit të Prishtinës “Dodona”. Veçanërisht Teatri i Kukullave “Dodona”, që është i vetmi teatër nën administrimin e qytetit, ka arritur të dallojë me pjesëmarrjen e tij në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky institucion është shembull i përpjekjeve të suksesshme për të ruajtur dhe promovuar artin në nivel komunal.

Përtej teatrove tradicionale, organizata të pavarura kulturore si Qendra Multimedia⁹ dhe “ART Polis” luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të skenës teatrore dhe artistike në Prishtinë. Këto organizata shfrytëzojnë teatrin për të ndihmuar zhvillimin social dhe kulturor përmes dialogut dhe projekteve të ndryshme duke sjellë në fokus çështje të rëndësishme shoqërore. Kontributi i tyre është një shtytje e rëndësishme për diversifikimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike në qytet.

Institucionet arsimore, si Kolegji “AAB” përmes teatrit “Faruk Begolli”, krijojnë platforma për shfaqje studentore duke mbështetur zhvillimin e talentëve të rinj dhe duke pasuruar jetën kulturore të qytetit. Festivalet si “Prishtina International Theatre Festival” (PITF) dhe festivali “HAPU” organizuar nga Teatri “ODA”, sjellin produksione inovative nga brenda dhe jashtë vendit duke e bërë qytetin një qendër për shfaqje ndërkombëtare dhe për bashkëpunime artistike.

Me gjithë vështirësitë historike dhe politike, scena teatrore e Prishtinës ka mbetur dinamike dhe e gjallë duke vazhduar të rritet me projekte të reja dhe iniciativa të freskëta. Një tjetër dimension i rëndësishëm i skenës artistike është ai i arteve performuese që përfshin: Operë, Baletin Kombëtar dhe Ansamblin “Shota”, të cilët luajnë një rol qendror në pasurimin e jetës kulturore të qytetit. Këto trupa performuese ofrojnë shfaqje të rregullta dhe bashkëpunojnë për të sjellë në jetë produksione të reja dhe me cilësi të lartë.

Prishtina është gjithashtu shtëpia e një numri të madh ansamblesh kulturore dhe artistike që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kombëtare. Ansamblet si “Bajram Curri”, Ansambli i Këngëve dhe Valleve të Universitetit të Prishtinës dhe shumë të tjerë, kanë ndihmuar në ruajtjen e traditave muzikore dhe koreografike të Kosovës duke ofruar një platformë për talente të reja dhe duke siguruar që trashëgimia kulturore të mos harrohet. Këto ansamble jo vetëm që performojnë në ngjarje të ndryshme lokale, por gjithashtu promovojnë Kosovën në arenën ndërkombëtare duke marrë pjesë në festivale dhe aktivitete jashtë vendit.

⁹ Nga viti 2002 Qendra ka organizuar dhe facilituar mbi 100 projekte artistike, në Kosovë por edhe në vende të tjera në Evropë. Komuniteti i artistëve/ekspertëve bashkëpunues të Qendrës krijon ngjarjet e veta dhe lehtëson programimin për të tjerët. Prodhimet e Qendrës kanë qenë me turne në më shumë se 100 teatro ndërkombëtare dhe festivale teatrore në Evropë, USA and Africa. Puna e Qendrës Multimedia është shfaqur gjerësisht në shtypin ndërkombëtar, përfshirë The Guardian (UK), Der Spiegel (Gjermani), La Repubblica (Itali), The Stage (UK), New York Times (SHBA), Teatri Heute (Gjermani) Danas (Serbi), Frankfurter Allgemeine Zeitung (Gjermani), Teatri Amerikan, Der Standard (Austri), Linköping (Suedi), Hystrio (Itali), Cassandre (Francë) etj

Nga ana tjetër, shumë prej këtyre ansambleve përballen me sfida të rëndësishme financiare dhe teknike. Mungesa e infrastrukturës adekuate dhe e fondeve ka ndikuar negativisht në mundësitë e tyre për të zhvilluar projekte ambicioze dhe për të zgjeruar aktivitetet e tyre. Për shembull, disa ansamble folklorike si “Bajram Curri” dhe “Hivzi Sulejmani” përballen me kufizime të mëdha në burime, gjë që ndikon në kapacitetet e tyre për të realizuar aktivitetet artistike dhe për të ruajtur trashëgiminë kulturore.

Përkundër këtyre sfidave, festivali ndërkombëtar i valleve folklorike për fëmijë “Ylberi i Prishtinës” ka arritur të ruajë statusin e tij si një nga festivalet më të rëndësishme për fëmijët në rajon. Ky festival tërheq qindra pjesëmarrës nga e gjithë bota, duke promovuar jo vetëm shkëmbimin kulturor, por edhe edukimin e brezave të rinj për rëndësinë e trashëgimisë kulturore.

Skena artistike e Prishtinës është një kombinim i pasionit, talentit dhe përkushtimit që vazhdon të gjallërojë qytetin, pavarësisht sfidave të shumta.

Megjithatë, mungesa e hapësirave të qëndrueshme kulturore dhe infrastruktures adekuate për prodhim dhe programim artistic, mbetet një nga kufizimet kryesore për zhvillimin afatgjatë të sektorit. Një pjesë e konsiderueshme e organizatave kulturore operojnë në kushte të përkohshme, pa qasje në hapësira të dedikuara, gjë që ndikon në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e aktiviteteve të tyre. Gjatë konsultimeve me palët e interes, është theksuar nevoja që kjo çështje të adresohet në mënyrë më konkrete në fazën e implementimit të strategjisë, përmes identifikimit dhe vënies në dispozicion të hapësirave publike për kulturë, si dhe zhvillimit të modeleve të qëndrueshme të menaxhimit të tyre.

TRASHËGIMIA KULTURORE

Qyteti i Prishtinës ka një trashëgimi të madhe historike dhe kulturore, me 102 monumente arkitekturore dhe 4 monumente arkeologjike. Qendra e vjetër e qytetit përfshin historinë e periudhës osmane mes xhamive, hamamit të madh (banja turke) dhe shtëpive tradicionale të asaj periudhe.

Sidoqoftë mungesa e një mekanizimi të mirëfilltë për mbrojtjen urbane dhe arkitekturore paraqet sfida të menaxhimit dhe ruajtjes së kësaj trashëgimie të vlefshme. Projekte të pakontrolluara të zhvillimit, ndërtime inkongruente të reja dhe gjendja e braktisur e monumenteve të rëndësishme si Hamami i Madh theksojnë nevojën urgjente për një plan strategjik të ruajtjes së tyre.

Përpyekjet e fundit nga UNHABITAT dhe MKRS kanë kërkuar ripërcaktimin e kufijve për zonën historike dhe krijimin e zonave mbrojtëse. Ky bashkëpunim fokusohet në monumentet e shekullit të XX-të dhe shënon një hap të rëndësishëm për një menaxhim holistik të trashëgimisë. Gjithashtu,

investime nga Bashkimi Evropian e kanë lehtësuar restaurimin e Kullës së Sahatit, ndërsa partneritetet e qytetit me organizata si CHwB synojnë të rigjallërojnë zona kryesore si rruga “Model”. Këto përpjekje përqendrohen kryesisht në trashëgiminë materiale, sfida qëndron në zgjerimin e këtyre përpjekjeve në mbrojtjen e elementeve kulturore jomateriale/shpirtërore.

Pavarësisht diversitetit të pasur kulturor të qytetit, ka një neglizhencë të dukshme për ruajtjen e elementeve të trashëgimisë jomateriale, duke përfshirë traditat, muzikën, gjuhën dhe praktikat kulturore. Këto elemente, të ngulitura thellë në kujtesën kolektive të qytetarëve, kërkojnë hulumtim dhe prezantim të mirërenduar për të kuptuar dhe vlerësuar plotësisht pasurinë kulturore të Prishtinës. Adresimi i këtij hendeku është thelbësor për një kuptim gjithëpërfshirës dhe ruajtjen e qëndrueshme të identitetit të qytetit.

Duke kuptuar se peizazhi urban është i endur në mënyrë të ndërlikuar në procese më të gjera shoqërore, çdo cep është formësuar nga zhvillimet politike dhe ekonomike. Kosova përballlet çdo ditë me ndikimin e qëndrueshëm të kolonializimit duke kaluar nëpër luftë, shumë nga arkivat e saj ende mungojnë, janë shkatërruar ose të vjedhura. Për më tepër, shumë artefakte nga Muzeu i Kosovës janë marrë dhe ndodhen në Beograd¹⁰. Gjatë luftës, gjatë viteve të 90-ta, Prishtina ishte qendra e rezistencës politike dhe qytetare. Ambientet si Teatri dhe Galeria Dodona, Elida apo Hani i 2 Robertëve tejkaluan funksionet e tyre kryesore¹¹. Ato nuk ishin thjeshtë skena për artin, ato u bënë platforma për shprehjen e mospajtimit dhe nxitjen e unitetit. Lufta për liri dhe organizim të shtetit të Kosovës atëherë bëhej nëpër shtëpi private ku tani shkollat e mesme mbaheshin sikurse Shtëpia e Herticës¹².

Sfida e sotme sillet rreth punës së kujtesës, interpretimit të ndërtesave, adresimit të arkivave të humbura dhe të vjedhura dhe ndërtimit të arkivave të reja për të nxjerrë në pah këto histori të ndërlikuara. Qëllimi është shpërndarja e njohurive, duke çuar në përmirësimin e kushteve materiale dhe të jetesës. Në Kosovë, punëtorët e kulturës janë angazhuar prej kohësh në veprimtari që lidhen me kujtesën, rrëfimet dhe hapësirat publike për shkak të përpjekjeve të gjera, përvijimit dhe interpretimit të nevojshëm.

Përpjekjet e tyre synojnë të sigurojnë që një histori me shumë shtresa dhe përfshirëse të tregohet. Jo vetëm disa arkiva mungojnë, por shumë vende mungojnë në demarkacionin e ngjarjeve historike të rëndësishme, kurse proceset e arkivimit janë ende në një pozicion të brishtë. Në Prishtinë ekziston Instituti Kombëtar i Historisë “Ali Hadri”, i cili kryen kërkime historike akademike. Në anën tjetër, shumë biseda dhe projekte rreth pyetjes së arkivave po sjellin

10 The stolen artefacts of Kosovo: <https://balkanacademia.com/2023/08/27/the-stolen-artefacts-of-kosovo/>

11 Hani i 2 Robertëve: cultural centre of Prishtina, rebellion against the regime, Koha Net: <https://www.koha.net/en/kulture/275125/hani-i-2-roberteve-ndash-brend-kulturor-i-prishtines-rebelim-ndaj-regjimit>

12 Heritca School House, Oral History Initiative: https://oralhistorykosovo.org/points_of_interests/home-schools-hertica-family-house/

organizatat kulturore shoqërore si Oral History Kosova, Fondacioni Lumbardhi, Pykë-Presje, Fondacioni 17, Qendra e Dokumentimit Kosova, YIHR, etj.

Thirrja për bashkëpunim të vazhdueshëm midis komunitetit, autoriteteve lokale dhe organizatave të trashëgimisë është një aspekt themelor i qëndrueshmërisë dhe promovimit të trashëgimisë kulturore të Prishtinës. Përtej strukturave fizike, ky angazhim bashkëpunues duhet të zgjerohet për të përfshirë dimensionet jomateriale të trashëgimisë që formësojnë identitetin e qytetit. Integrimi i trashëgimisë arkeologjike në planifikimin urban është gjithashtu i domosdoshëm për të siguruar balancën ndërmjet zhvillimit dhe ruajtjes.

Vetëm përmes përpjekjeve të bashkuara mund të zbatohet një strategji e qëndrueshme dhe efektive e mbajtjes. Identifikimi i disa sitesh¹³ arkeologjike dhe monumenteve brenda Komunës së Prishtinës është një hap vendimtar në njohjen e thellësisë së rrënjëve historike të qytetit. Megjithatë, kërcënimet e vazhdueshme nga zhvillimet e tanishme dhe të ardhshme, së bashku me industrializimin, kërkon masa parandaluese të menjëhershme për të mbrojtur këto thesare arkeologjike. Integrimi i ruajtjes arkeologjike në strategjitë e planifikimit urban dhe zhvillimit është i domosdoshëm për të siguruar bashkëjetesën pa problem të trashëgimisë dhe progresit.

Trashëgimia kulturore nuk është një objekt i historisë, por një fuqi dinamike që mund të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin ekonomik. Propozimi për një qasje të integruar në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë ruajtjen, vlerësimin dhe rivitalizimin, përputhet me besimin se pasuritë kulturore mund të veprojnë si katalizatorë për rritjen ekonomike. Duke përdorur trashëgiminë kulturore për turizëm të qëndrueshëm, Prishtina jo vetëm që mund të përforcojë identitetin e saj kulturor, por gjithashtu të krijojë krenari në mes të banorëve të saj. Në këtë kontekst, gjatë konsultimeve me palët e interesit është theksuar roli i sektorit të pavarur kulturor në zhvillimin e artit në hapësira publike, i cili në praktikë ka kontribuar në krijimin e një “galerie të hapur urbane” në qytet. Ky potencial paraqet një vlerë të rëndësishme për identitetin kulturor dhe ofertën turistike të Prishtinës. Megjithatë, institucionalizimi dhe mbrojtja e këtij fenomeni kërkon trajtim të mëtejshëm në nivel politik dhe rregullativ, përfshirë zhvillimin e kornizave për menaxhimin dhe mbrojtjen e artit në hapësira publike. Përvoja nga qytete evropiane tregojnë se qasjet e strukturara mund të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori.

Prishtina gjendet në një pikë kritike ku ndërhyrjet strategjike janë të pamohueshme për të gjetur një ekuilibër mes zhvillimit dhe mbajtjes së trashëgimisë së saj të pasur kulturore. Ndërsa iniciativat e fundit sinjalizojnë momentum pozitiv, ka një nevojë urgjente për të zgjeruar fokusin për të përfshirë elementet e pakënaqshme të trashëgimisë.

¹³ Termi “site” i referohet një vendi të caktuar me rëndësi historike, kulturore, arkeologjike ose natyrore. Në kontekstin e trashëgimisë kulturore, një site arkeologjik është një vend ku gjenden mbetje të lashta, struktura, ose artefakte që ofrojnë informacion mbi të kaluarën.

ARTE DHE ARTIZANATE

Jeta kulturore dhe shpirtërore e shqiptarëve kudo është shumë e pasur. Ajo ka një traditë të gjatë që rrjedh thellë në lashtësi dhe mban mbi supe peshën e shekujve dhe mijëvjeçarëve. Populli ynë e ka ruajtur me zell të madh këtë jetë të pasur kulturore me të gjitha veçoritë e saj karakteristike. Në varësi të kohës, kjo kulturë paraqet aktivitetet kryesore ekonomike të qyteteve tjera dhe të Prishtinës, që kanë pasur ndikim të madh në zhvillimin e saj.

Prishtina ka një trashëgimi të pasur në artizanatet tradicionale, përfshirë artet e tekstilit, punimet në metal, dru, argjend si dhe zeje tjera si teneqepunuesit duke pasur një ndikim të thellë në kulturën dhe identitetin e qytetit, e cila në kohën bashkëkohore shpesh nuk njihet dhe nuk vlerësohet në masën e duhur.

Në Prishtinë, artet e tekstilit, zejtaria e sermagjinjëve kanë qenë mjaft të zhvilluara. Veshjet e nusërisë dhe punimet me kadife të qëndisura me penj të art dhe argjend përbëjnë një aspekt të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore. Dyqanet e nuseve janë dëshmi e aftësive të artizanëve lokalë, të cilët përdorin teknika të ndryshme si thurja me grep, qëndisja dhe punimet me rruaza për të zbukuruar veshjet dhe sendet shtëpiake. Këto punime ruajnë dhe promovojnë trashëgiminë kulturore dhe janë të pranishme në dasma dhe ceremoni të tjera të rëndësishme. Përveç dyqaneve të nuseve edhe lëkurëpunuesit, rrobaqepësit, qëndistarët, endësit e mëndafshit dhe qilimpunuesit shfaqin ekspertizën e qytetit në fushën e tekstileve.

Përveç artit të tekstilit, punimet në metal dhe dru tregojnë gjithashtu një trashëgimi të pasur artistike në Prishtinë. Artizanët në këto fusha krijojnë objekte të rralla që rrëfejnë histori përmes detajeve dhe përkushtimit ndaj mjeshtërisë. Shumë nga produktet e punuara me dru përmbajnë motive dhe dizajne tradicionale që kanë kuptime simbolike.

Argjendarët dhe orëpunuesit përfaqësojnë përkushtimin e qytetit ndaj punimit të metaleve. Shumë nga dizajnet e përdorura në filigran kanë kuptime simbolike dhe shpesh janë të lidhura me histori lokale, mitologji dhe simbole që përfaqësojnë identitetin dhe traditat e komunitetit.

Një sfidë e rëndësishme për trashëgiminë e këtyre artizanateve është mungesa e mundësive për të fituar dhe përmirësuar aftësitë në këto zanate. Sipas specialistëve të kësaj fushe, zanatet janë shndërruar në punë jo edhe aq fitimprurëse, gjë që mund të jetë një nga arsytet pse të rinjtë nuk dëshirojnë të vazhdojnë zanatin e të parëve të tyre.

Në këtë kontekst, është e nevojshme të zhvillohen programe që ofrojnë trajnime dhe aftësime në artizanatin tradicional.¹⁴ Nga kjo do të përfitonte jo vetëm komuniteti vendas, por do të ndihmonte gjithashtu në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të qytetit.

Për të adresuar këtë problem, është e nevojshme të nisë një proces hulumtimi mbi potencialin e tregut dhe të zhvillohen programe afatshkurtra që të tërheqin vizitorët dhe popullsinë vendase në mësimin e këtyre zanateve. Mungesa e programeve gjithëpërfshirëse artistike dhe mbështetjes për punëtoritë vendore të artit dhe artizanateve është një problem që kërkon zgjidhje. Aktualisht, qytetarët kanë shumë pak mundësi për të ushtruar aftësitë e tyre krijuese në këto fusha. Iniciativat ekzistuese, të mbështetura nga fondet publike dhe OJQ-të, janë të pamjaftueshme për të arritur një masë më të gjerë qytetarësh që dëshirojnë të zbulojnë talentet e tyre.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të ndërtohen kapacitete në nivel komuniteti. Shkollimi dhe trajnimi profesional janë elemente thelbësore për ruajtjen dhe zhvillimin e zanateve tradicionale. Për të siguruar që këto aftësi dhe njohuri të mbeten autentike dhe të përcillen te brezat e rinj, disa hapa dhe strategji mund të jenë të dobishme: krijimi i programeve arsimore që përfshijnë mësimdhënien direkte nga mjeshtrit e zanateve tradicionale; organizimi i punëtorive dhe trajnimeve ku mjeshtrit ndajnë teknikat dhe aftësitë e tyre me të rinjtë; sigurimi i kushteve për nxënësit që të praktikojnë zanatet në mjedise reale dhe autentike; inkurajimi i përdorimit të materialeve dhe teknikave autentike në krijimin e produkteve. Kjo qasje holistike jo vetëm që ruan kulturën, por gjithashtu nxit kreativitetin dhe zhvillimin ekonomik në komunitetet lokale.

BIBLIOTEKAT

Komuna e Prishtinës ka 17 biblioteka publike, së bashku me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Biblioteka kryesore ka një koleksion prej 58,475 librash dhe 16 degët e saj shërbejnë në lagje të ndryshme.

Biblioteka e qytetit të Prishtinës “Hivzi Sulejmani” është institucion kulturor, edukues e informues që grumbullon, pasuron, përpunon, ruan dhe jep në huazim koleksionet e veta nga fushat e ndryshme të krijimtarisë dhe të veprimtarisë intelektuale, e menaxhuar nga Komuna e Prishtinës. Biblioteka Hivzi Sulejmani (Bibliotekat)¹⁵, shtrihet në degët “Përkujtimore”, “Përrallat” dhe “Lektyra” në Pallatin e Rinisë, Bardhosh, Llukar, Hajvali, Slivovë, Keqekollë, Koliq dhe Kishnicë, të gjitha këto degë nuk funksionojnë dhe e kanë të nevojshëm procesin e rivitalizimit që ato të jenë

¹⁴ Në Zagreb, trajnimet për artizanale organizohen nga institucione si **Muzeu i Arteve dhe Zejeve** dhe shkolla profesionale, duke përfshirë kurse për qeramikë, qëndisje, përpunim druri dhe metalesh. Komuna e Zagrebit mbështet këto trajnime përmes projekteve kulturore dhe programeve të ruajtjes së trashëgimisë, duke i integruar ato në nisma për zhvillimin lokal dhe turizmin kulturor.

¹⁵ <https://www.biblioteka-pr.org/sq/Stafi>

të mirëmbajtura, mikpritëse dhe të pajisura me mjete moderne. Tanimë ka nevojë për të aktivizuar disa nga degët ekzistuese, si dhe çdo lagje të ketë të mundur qasjen në bibliotekë.

Pavarësisht faktit se pati disa zbrapsje në vitet 1992-1999, duke përfshirë mbylljen e degëve të bibliotekave dhe dëmtimet nga lufta, u bënë përpjekje për të rindërtuar koleksionin e ri ku disa përpjekje për publikime janë përfunduar me sukses, duke përfshirë libra, disa numra të revistës letrare “Oaza”.

Pavarësisht kësaj, Prishtina has sfida në zhvillimin e leximit si *sjellje*. Këto sfida përfshijnë konkurrencën e medias digjitale dhe mungesën e fondeve mbështetëse, mungesën e programeve angazhuese dhe përzgjedhjen e limituar të librave.

Diversifikimi i koleksioneve pengohet prej dominimit të librit fizik dhe subvencionimeve të pamjaftueshme. Mungesa e përpjekjeve për digjitalizim paraqet një problem mbi të drejtat për *e-librat*. Në një përpjekje për t’i kapërcyer këto vështirësi, librarët e Prishtinës janë duke iu qasur në një formë aktive mundësisë për të patur udhëzim nga kolegët në rajon.

Sistemi arsimor kërkon kërkesa minimale për lexim për nxënësit dhe kjo duhet të rritet në të paktën tri libra në muaj për të nxitur një kulturë më të fortë leximi dhe për të ushqyer kuriozitetin e studentëve.

Sistemi bibliotekar i Prishtinës ka potencial të jashtëzakonshëm si një gurthemel për angazhimin kulturor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Megjithatë, kufizimet aktualisht pengojnë aftësinë e tij për t’i shërbyer plotësisht banorëve të qytetit. Me disa degë që u mungon funksionaliteti i plotë dhe mungesa e hapësirave të dedikuara për bibliotekë në shumë lagje, këto burime jetike nuk janë lehtësisht të aksesueshme ose të integruara në jetën e përditshme të banorëve të Prishtinës.

Përtej rivitalizimit të degëve ekzistuese, strategjia thekson rëndësinë e zgjerimit të pranisë fizike të sistemit të bibliotekave. Degët e reja të bibliotekave ose hapësirat e caktuara bibliotekare do të krijohen në mënyrë strategjike në lagjet ku këto biblioteka nuk janë më funksionale. Kjo do të sigurojë që të gjithë banorët, pavarësisht vendndodhjes, të kenë akses të përshtatshëm në pasuritë e bibliotekës. Këto hapësira të reja mund të projektohen si qendra multifunksionale, duke ofruar jo vetëm shërbime tradicionale të bibliotekës, por edhe duke mbajtur evente, seminare dhe programe nga dhe për komunitetin.

INDUSTRIA E DIZAJNIT

Prishtina ka një peizazh kreativ të gjallë me 668 biznese të regjistruara në industrinë e dizajnit. Kjo industri formëson një pjesë të rëndësishme të kulturës dhe ekonomisë së qytetit. duke kontribuar gjithashtu në ndërlidhjen ndërmjet krijimtarisë artistike dhe zhvillimit ekonomik urban.

Në dekadën e fundit, skena e dizajnit të modës ka lulëzuar duke e pozicionuar Kosovën si eksportuesen e dytë më të madhe të veshjeve të modës së lartë në Evropë. Ngjarjet si Java e Modës në Prishtinë (Prishtina Fashion Week) dhe Nata e Modës (Fashion Night), të cilat mbahen dy herë në vit, janë dëshmi e potencialit krijues të qytetit. Këto aktivitete promovojnë talentin lokal dhe ndërkombëtar, por kërkojnë mbështetje më të strukturuar dhe investime të qëndrueshme për të nxitur rritjen e sektorit dhe zhvillimin e startup-eve kreative.

Aktualisht, boshllëku i njohurive pengon potencialin e industrive krijuese në Prishtinë dhe Kosovë, ndërsa këto industri janë shtytës të rëndësishëm të rritjes ekonomike dhe krijimit të vendeve të punës, mungojnë të dhënat për kapacitetet aktuale, tendencat ekonomike dhe mundësitë e eksportit. Programet arsimore nuk janë të përshtatura me nevojat e industrisë, gjë që mund të lidhet me shkëputjen mes akademisë dhe kërkesave të tregut, çka rezulton në një hendek të vazhdueshëm ndërmjet aftësive të ofruara dhe atyre të kërkuara nga industria.

Programet edukative shpesh nuk janë të sinkronizuara me kërkesat reale të tregut, duke rezultuar në një hendek midis aftësive të mësuara dhe atyre të kërkuara nga industria. Dizajnerët duhet të zhvillojnë vazhdimisht aftësi të reja për të mbetur konkurrues, duke përfshirë aftësi digjitale, menaxhimin e projekteve dhe njohuritë në fusha si inteligjenca artificiale, analiza e të dhënave, marketingu dhe ndërmarrësia. Hendekët kryesorë përfshijnë mungesën e njohurive të avancuara në softuerët profesionalë të dizajnit si Adobe Suite, AutoCAD, 3D Max, si dhe aftësi të kufizuara në modelimin 3D, animacionin dhe përdorimin e teknologjive AR/VR. Për më tepër, krijimi i produkteve të riciklueshme dhe të ripërdorshme kërkon një qasje inovative në dizajn, duke përfshirë ndryshime të rëndësishme në proceset ekzistuese të prodhimit. Mungesa e një infrastrukture të mirëorganizuar për grumbullimin dhe riciklimin e materialeve pengon përpjekjet për një ekonomi më të gjelbër. Proceset aktuale të riciklimit shpesh janë të shtrenjta dhe jo efikase, duke i bërë më pak atraktive për bizneset. Për të adresuar këto sfida, nevojiten masa dhe politika për të mbështetur sektorin privat për kompanitë që implementojnë praktikën e ekonomisë qarkore dhe për startup-et e reja për krijimin e vendeve të punës në industrinë krijuese. Këto përpjekje duhet të përfshijnë grante dhe subvencione për projekte inovative, hapësira, si dhe një sistem mbështetës të integruar për zhvillimin e vazhdueshëm të peizazhit krijues të Kosovës, kurse dhe trajnime të specializuara që përditësojnë njohuritë dhe aftësitë e profesionistëve të industrisë, infrastrukturë e përmirësuar për riciklim, investime në teknologji dhe sisteme të avancuara të riciklimit për të përmirësuar efikasitetin dhe koston e procesit dhe rritje e bashkëpunimit ndërmjet universiteteve dhe industrisë për të siguruar që programet edukative janë të sinkronizuara me nevojat e tregut.

Në mënyrë më të gjerë, zhvillimi i industrive kreative kërkon një qasje më të integruar që i trajton ato si pjesë të një zinxhiri ekonomik të kulturës, ku prodhimi artistik lidhet drejtpërdrejt me shërbimet dhe produktet kulturore. Kjo qasje mundëson krijimin e vlerës së shtuar ekonomike, rritjen e punësimit dhe pozicionimin e sektorit si kontribues i rëndësishëm në zhvillimin urban dhe ekonomik të qytetit. Në këtë drejtim, kërkohet që në fazën e implementimit të strategjisë të zhvillohen instrumente dhe mekanizma më konkretë për mbështetjen dhe funksionalizimin e industrive kreative, duke i integruar ato në politikat e zhvillimit ekonomik dhe kulturor të qytetit.

EDUKIMI

Sistemi arsimor në Prishtinë përfshin 43 shkolla fillore dhe 11 shkolla të mesme, me statistika që tregojnë një total prej 38,465 nxënësish në vitin shkollor 2022/2023. Arsimi i mesëm ndahet në 29.347 nxënës në arsimin e mesëm të ulët dhe 9.118 në arsimin e mesëm të lartë. Përveç shkollave standarde publike ekzistojnë edhe programe të dedikuara për edukimin muzikor me një shkollë publike dhe pesë private.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) ka implementuar një projekt pilot “Arti në Shkolla” për klasat 6-9, duke përfshirë 1000 nxënës në katër shkolla të Prishtinës. Arsimi i lartë në art ofrohet në Universitetin e Prishtinës dhe universitete private, me programe të ndryshme si: piktura, skulptura, muzika, aktrimi dhe arkitektura. Sidoqoftë, ekzistojnë sfida të rëndësishme në zhvillimin e arsimit në art dhe kulturë. Një anketë e vitit 2024 tregoi se 75% e të anketuarve e identifikojnë mungesën e arsimit të duhur si një nga tri sfidat kryesore për zhvillimin e artit dhe kulturës. Arsimi formal dhe joformal në këtë fushë në Prishtinë vlerësohet si i dobët nga shumica e të anketuarve.

Ekziston një mungesë e trajnimit të specializuar për aftësi teknike dhe të buta në fushën e artit dhe kulturës, si menaxhimi dhe mbledhja e fondeve. Për më tepër, hendeku socio-ekonomik shpesh dikton qasjen në edukim artistik duke kufizuar potencialin krijues të individëve, veçanërisht të fëmijëve nga zonat rurale dhe vajzave.

Prishtina gjithashtu nuk ka krijuar ende një ekosistem të qëndrueshëm për të mbështetur industrinë krijuese, në krahasim me qytete si Zagrebi dhe Lubjana, të cilat kanë zhvilluar programe të konsoliduara për artistët e rinj dhe promovimin e tyre ndërkombëtar.

TURIZMI DHE KULTURA

Prishtina, me historinë e saj të pasur kulturore dhe energjinë bashkëkohore, ka potencialin të bëhet një destinacion tërheqës turistik. Në mënyrë më të gjerë, zhvillimi i industrive kreative kërkon një qasje më të integruar që i trajton ato si pjesë të një zinxhiri ekonomik të kulturës, ku prodhimi artistik lidhet drejtpërdrejt me shërbimet dhe produktet kulturore. Kjo qasje mundëson krijimin e vlerës së shtuar ekonomike, rritjen e punësimit dhe pozicionimin e sektorit si kontribues i rëndësishëm në zhvillimin urban dhe ekonomik të qytetit. Në këtë drejtim, kërkohet që në fazën e implementimit të strategjisë të zhvillohen instrumente dhe mekanizma më konkretë për mbështetjen dhe funksionalizimin e industrive kreative, duke i integruar ato në politikat e zhvillimit ekonomik dhe kulturor të qytetit.

Megjithatë, disa sfida pengojnë kapacitetin e Prishtinës për të përfituar nga ky potencial.

Një sfidë kryesore është aksesin e kufizuar për turistët. Mungesa e burimeve të centralizuara dhe pikave të informacionit turistik e bën të vështirë për vizitorët të zbulojnë atraksionet e fshehura të qytetit. Po ashtu, vendet me rëndësi historike shpesh nuk kanë interpretimin e duhur, duke penguar aftësinë e tyre për të tërhequr vizitorët. Pjesët e historisë së qytetit kanë potencialin për të treguar histori të pasura dhe për të pasuruar kulturën e Prishtinës. Potenciali narrativ i historisë dhe kulturës së qytetit mbetet i pashfrytëzuar në mënyrë sistematike.

Strategjia e zhvillimit të turizmit për periudhën 2018-2022 kërkon përditësim. Ajo identifikoi çështje si mungesa e udhërrëfyesve informues dhe komunikimi të pamjaftueshëm rreth atraksioneve. Gjithashtu, mungesa e bashkëpunimit midis palëve të interesuara ka penguar progresin në zhvillimin e turizmit. Këto sfida vazhdojnë të jenë relevante dhe kërkojnë një qasje më të koordinuar dhe ndërsektoriale.

Përmirësimi i interpretimit dhe promovimit të vendeve historike është një mundësi e rëndësishme. Duke investuar në këto aspekte, Prishtina mund të krijojë narrativa magjepsëse që do të pasurojnë përvojën e vizitorëve. Krijimi i një pike të dedikuar informacioni turistik dhe zhvillimi i paketave gjithëpërfshirëse do të lehtësojnë navigimin dhe eksplorimin e qytetit.

Në këtë kontekst, turizmi kreativ duhet të trajtohet si një dimension ndërsektorial që përshkon të gjithë sektorët kulturorë dhe industrinë kreative, duke lidhur trashëgiminë kulturore, artin bashkëkohor, dizajnin, performancën, dhe format e tjera të prodhimit kreativ me përvojën turistike. Kjo qasje mundëson krijimin e përvojave autentike dhe të diferencuara, duke rritur vlerën ekonomike të sektorit dhe duke forcuar identitetin kulturor të qytetit në nivel ndërkombëtar.

Për të realizuar këtë potencial, kërkohet zhvillimi i mekanizmave konkretë të koordinimit ndërinstitutional dhe mbështetjes së iniciativave që integrojnë turizmin me sektorët kreativë, si dhe përfshirja e këtij dimensionit në politikat e zhvillimit urban dhe ekonomik.

Për të arritur sukses, një strategji e re që adreson këto sfida dhe nxit bashkëpunimin midis palëve të interesuara është e domosdoshme. Kjo do të ndihmojë Prishtinën të shfrytëzojë potencialin e saj si një destinacion turistik ikonik, duke theksuar vlerat kulturore dhe duke krijuar një mjedis përfshirës për të gjithë.

GASTRONOMIA DHE KULTURA

Gastronomia është një element thelbësor i kulturës së Prishtinës duke luajtur një rol të rëndësishëm në formësimin e identitetit kulturor dhe përvojës së qytetarëve. Peisazhi urban i Prishtinës është i mbushur me kafene dhe restorante që ofrojnë shije të ndryshme për çdo buxhet duke krijuar një

atmosferë dinamike dhe të gjallë. Qendra e qytetit është e njohur për lokalet e saj të zhurmshme dhe tërheqëse, ku vizitorët mund të përjetojnë një gamë të gjerë mundësish kulinare. Megjithatë, sfida të caktuara pengojnë zhvillimin e plotë të skenës kulinare në Prishtinë. Qytetit i mungon një identitet i qartë kulinar dhe një infrastrukturë e fortë për turizmin gastronomik duke e bërë të vështirë tërheqjen e vizitorëve që janë të interesuar për kuzhinën lokale. Për më tepër edhe pse festimet dhe tubimet informale janë të zakonshme, Prishtina nuk ka festivale të dedikuara të ushqimit që pasqyrojnë thellësinë dhe pasurinë e kuzhinës së saj.

Një shembull pozitiv është Festivali i Gastronomisë së Prishtinës, i organizuar që nga viti 2019, i cili ofron një javë ushqim të përgatitur nga kuzhinierë vendas dhe ndërkombëtarë duke shoqëruar këtë ngjarje me muzikë dhe aktivitete kulturore. Megjithatë, është e nevojshme të rritet përhapja dhe fokusimi në ngjarje gastronomike për të krijuar një platformë që tërheq kuzhinierët dhe vizitorët.

Duke parë të ardhmen, mundësitë janë të shumta. Krijimi i hapësirave për bashkëpunim midis kuzhinierëve dhe prodhuesve të ushqimit mund të nxisë inovacionin dhe të promovojë ngrënien nga ferma në tryezë. Një strategji marketingu që shfrytëzon platformat online mund të tërheqë turistë që kërkojnë përvoja autentike duke e bërë gastronominë një gurthemel të zhvillimit turistik dhe kulturor të Prishtinës.

HAPËSIRAT PUBLIKE PËR ARTIN DHE KULTURËN NË PRISHTINË: Sfida dhe perspektivat për zhvillim

Hapësirat Publike për Artin dhe Kulturën në Prishtinë: Sfida dhe perspektivat për zhvillim

Menaxhimi dhe zhvillimi i hapësirave publike në Komunën e Prishtinës janë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm social, kulturor dhe ekonomik të qytetit. Ky proces përfshin katër komponentë kryesorë: Planifikimin strategjik; Programin vjetor të komunës/buxhetin; Zhvillimin e projekteve dhe mirëmbajtjen. Në këtë kontekst, sfidat kryesore që lidhen me hapësirat publike për artin dhe kulturën kërkojnë zgjidhje inovative dhe bashkëpunim të gjerë ndërmjet institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe komunitetit artistik.

Përkundër ekzistencës së një numri të konsiderueshëm të objekteve kulturore, sfida mbetet mospërputhja ndërmjet kapaciteteve ekzistuese dhe nevojave reale të organizatave kulturore për hapësira të qëndrueshme pune, prodhimi dhe zhvillimi. Kjo reflekton nevojën për një qasje më të strukturuar dhe të bazuar në të dhëna në planifikimin dhe shpërndarjen e hapësirave publike për art dhe kulturë.

Në rajonin e Prishtinës (PR), numri i objekteve kulturore sipas të dhënave ekzistuese është si vijon:

Galeria: 18; Klasa për bibliotekë: 35; Klasa për muzikë: 20; Klasa për art: 15; Teatri: 4; Biblioteka: 4; Shkolla e muzikës: 5; Shkolla e artit: 4; Kinemaja: 4; Muzeu: 3; Shtëpia e Kulturës: 6; Qendra e kulturës: 3; Atelieri: 3; Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor (ORTK): 1. Totali i objekteve kulturore në Prishtinë (PR): 130.

Këto të dhëna tregojnë një përqendrim të lartë të objekteve kulturore në Prishtinë krahasuar me rajonet e tjera duke përfshirë galeritë, klasat për bibliotekë dhe muzikë.

Ligji për Planifikim Hapësinor dhe Rregullimi i hapësirave publike

Ligji për Planifikimin Hapësinor nr. 04/L-174 është baza ligjore që rregullon përdorimin dhe zhvillimin e hapësirave publike në nivel lokal. Ky ligj ofron mekanizma strategjikë për menaxhimin e hapësirave publike përmes dokumenteve kryesore, si: Plani zhvillimor i komunës, Harta e zonimit të komunës dhe Planet rregulluese të detajuara. Megjithatë, për të mbështetur në mënyrë adekuate zhvillimin kulturor dhe artistik, ligjet ekzistuese kërkojnë një rishikim dhe përshtatje më të madhe për nevojat e komunitetit artistik dhe qytetar.

Një rregullore e propozuar për përdorimin e hapësirave publike për art dhe kulturë ishte në konsultim publik në vitin 2023, por ende nuk është miratuar. Kjo situatë paraqet një mundësi për të trajtuar çështje të rëndësishme që lidhen me qasjen dhe përdorimin e hapësirave publike për aktivitete artistike si dhe për të krijuar një kornizë më të qartë institucionale për zhvillimin dhe mbrojtjen e artit në hapësira publike. Roli i shoqërisë civile dhe standardet e përdorimit të hapësirave.

Roli i shoqërisë civile dhe standardet e përdorimit të hapësirave

Organizatat e shoqërisë civile, me në krye Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), kanë luajtur një rol të rëndësishëm në avokimin për një qasje të re ndaj menaxhimit të hapësirave publike. Ata kanë propozuar standarde të qarta për ndarjen dhe përdorimin e hapësirave duke përfshirë mekanizma mbikëqyrjeje dhe kriteret të rrepta për kualifikimin e përdoruesve, të cilat garantojnë transparencë dhe pjesëmarrje qytetare. Kjo qasje synon të parandalojë diskriminimin dhe të rrisë mundësitë për të gjithë qytetarët duke siguruar një përdorim më efektiv dhe të qëndrueshëm të hapësirave publike.

Mungesa e infrastrukturës dhe sistemit të integruar për qasje

Një nga pengesat kryesore në menaxhimin e hapësirave publike është mungesa e një sistemi të integruar për qasje dhe informacion mbi hapësirat publike në dispozicion. Aktualisht, nuk ekziston një platformë online që lejon qytetarët dhe organizatorët e ngjarjeve të shikojnë dhe të aplikojnë për përdorimin e hapësirave publike në mënyrë të thjeshtë dhe transparente. Për më tepër, mungesa e një politike të qartë dhe mekanizmave të strukturuar për zhvillimin e artit në hapësira publike, kufizon potencialin e këtyre hapësirave për të kontribuar në zhvillimin e industrive kreative dhe turizmit kulturor. Kjo thekson nevojën për zhvillimin e instrumenteve konkrete që mundësojnë përdorimin e qëndrueshëm dhe kreativ të hapësirave publike në funksion të zhvillimit urban.

Kjo mangësi krijon një barrierë për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike duke limituar potencialin e këtyre hapësirave për të nxitur kreativitetin dhe për të forcuar lidhjet brenda komunitetit. Në të njëjtën kohë, mungesa e të dhënave të centralizuara dhe e një sistemi të unifikuar për menaxhimin e hapësirave publike vazhdon të jetë një barrierë për planifikim strategjik dhe përdorim efikas të tyre. Zhvillimi i një sistemi të tillë është thelbësor për të mbështetur vendimmarrjen dhe për të rritur transparencën dhe qasjen për komunitetin kulturor dhe artistik.

Një platformë e tillë do të mundësonte një transparencë më të madhe dhe do të përmirësonte pjesëmarrjen e komunitetit në menaxhimin e hapësirave publike.

Përveç kësaj, zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit kulturor kërkon mekanizma mbështetës që tejkalojnë financimin afatshkurtër, duke krijuar kushte për stabilitet dhe zhvillim afatmesëm dhe afatgjatë të organizatave kulturore dhe praktikave artistike.

Duke lehtësuar procedurat për aplikim dhe duke ofruar informacion të qartë mbi rregullat dhe kapacitetin e hapësirave, qytetarët dhe organizatat kulturore do të kishin një qasje më të lehtë për të realizuar aktivitetet e tyre duke përmirësuar kështu cilësinë e jetës kulturore në qytet.

Modelet inovative të qeverisjes së hapësirave publike për artin dhe kulturën

Një mundësi për të rritur efikasitetin në menaxhimin e hapësirave publike është aplikimi i modeleve alternative të qeverisjes, të cilat përfshijnë partneritete mes sektorit publik, privat dhe shoqërisë civile. Organizatat lokale, si Termokiss, kanë demonstruar sukses në menaxhimin e hapësirave publike duke futur praktika demokratike dhe inovative të qeverisjes. Këto organizata kanë mundur të reaktivizojnë hapësira të braktisura ose të nënshfrytëzuara duke i shndërruar ato në qendra të gjalla për aktivitetet kulturore dhe artistike.

Shembulli i Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, është një rast i veçantë që ilustron potencialin e madh të hapësirave publike të Prishtinës. Ndërtuar në vitin 1977 dhe me një histori të gjatë të ngjarjeve të rëndësishme sportive dhe kulturore, Pallati i Rinisë ka nevojë për një rinovim të plotë për t'u rikthyer në një qendër moderne dhe multifunksionale për art dhe sport. **Projekti i rinovimit të ish-Shtëpisë së Mallrave “Gërmia”** është një tjetër shembull që thekson rëndësinë e revitalizimit të objekteve publike të vjetra për të nxitur jetën kulturore dhe për të promovuar turizmin.

Avancimi i menaxhimit dhe efikasitetit të hapësirave publike

Menaxhimi efektiv i hapësirave publike kërkon një qasje të koordinuar dhe të avancuar që përfshin jo vetëm monitorimin dhe vlerësimin e rregullt të përdorimit të tyre, por edhe përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje. Një sistem i tillë do të siguronte llogaridhënie dhe transparencë, duke garantuar që hapësirat të përdoren në mënyrë optimale për të përmbushur nevojat e komunitetit. Kjo përfshin jo vetëm zhvillimin e aktiviteteve kulturore, por edhe përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë banorët.

Monitorimi dhe vlerësimi i kontratave të lidhura për përdorimin e hapësirave publike duhet të bëhet në mënyrë të rregullt për të vlerësuar efektivitetin e këtyre hapësirave dhe për të identifikuar

mundësitë për përmirësim. Duke përfshirë komunitetin dhe organizatat kulturore në procesin e vendimmarrjes, mund të sigurohet që hapësirat publike të menaxhohen në mënyrë që të plotësojnë nevojat reale të qytetarëve.

Sfidat në menaxhimin e hapësirave publike në Prishtinë

Përkundër përpjekjeve për të menaxhuar dhe zhvilluar hapësirat publike në Prishtinë, sfidat vazhdojnë të jenë të shumta. Një nga problemet më të mëdha është mungesa e një procesi të thjeshtë dhe transparent për vendimmarrje, i cili pengon organizatorët e ngjarjeve dhe grupet kulturore që të kenë qasje të plotë dhe efektive në këto hapësira. **Drejtoria e Kulturës**, përgjegjëse për menaxhimin e këtyre hapësirave, shpesh përballët me burime të kufizuara dhe një ngarkesë të madhe pune, duke e bërë të vështirë krijimin e një sistemi efikas për menaxhimin e kërkesave të shumta. Një zgjidhje e mundshme për këtë problem është shtimi i zyrtarëve të dedikuar për mbikëqyrjen e hapësirave publike kulturore. Këta zyrtarë do të kenë përgjegjësinë për menaxhimin dhe monitorimin e këtyre hapësirave, duke siguruar që ato të përdoren në mënyrë efektive dhe të përmbushin nevojat e komunitetit për aktivitete kulturore dhe artistike.

Përfshirja e komunitetit në menaxhimin e hapësirave publike

Angazhimi i komunitetit është një element i rëndësishëm në procesin e menaxhimit të hapësirave publike për artin dhe kulturën. Organizatat kulturore dhe artistike, si dhe qytetarët e thjeshtë duhet të përfshihen në procesin e vendimmarrjes për të siguruar që hapësirat publike të përdoren në mënyrë që t'u përgjigjen nevojave dhe dëshirave të tyre. Kjo përfshirje jo vetëm që rrit transparencën, por gjithashtu ndihmon në zhvillimin e një skene kulturore që është më gjithëpërfshirëse dhe e pasur.

Mungesa e të dhënave dhe vlerësimi i hapësirave publike

Pavarësisht përpjekjeve të shumta për aktivizimin e hapësirave publike në Prishtinë, një nga sfidat më të rëndësishme mbetet mungesa e një sistemi të centralizuar të të dhënave që do të mundësonte një vlerësim të plotë dhe menaxhim efektiv të hapësirave publike. Parqet, rrugët, kopshtet urbane dhe sheshet e qytetit mbeten të paarrtshme për qytetarët dhe organizatat artistike për shkak të mungesës së informacionit të detajuar dhe qasjeve të qarta mbi rregullat e përdorimit të këtyre hapësirave.

Një sistem i centralizuar të dhënash do të ishte esencial për të identifikuar dhe vlerësuar potencialin e hapësirave publike, si dhe për të përmirësuar menaxhimin dhe përdorimin e tyre. Ky sistem do të ndihmonte në lehtësimin e procesit të aplikimit për përdorimin e këtyre hapësirave dhe do të kontribuonte në përmirësimin e infrastrukturës, duke krijuar një mjedis më transparent dhe të qasshëm për komunitetin.

Iniciativa të reja për aktivizimin e hapësirave publike

Qyteti i Prishtinës ka bërë hapa të rëndësishëm drejt aktivizimit të hapësirave publike për art dhe kulturë përmes iniciativave të reja që synojnë riaktivizimin e hapësirave të braktisura dhe përfshirjen e komunitetit në jetën kulturore. Një shembull i këtij angazhimi është Shtëpia e Kulturës në Llukar, e cila është riaktivizuar nga organizata Stereospace dhe ka shërbyer si një

platformë e rëndësishme për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike. Iniciativa të ngjashme janë duke u zhvilluar edhe në Hajvali dhe zona të tjera përreth Prishtinës, me synimin për të nxitur angazhimin e qytetarëve dhe për të ofruar mundësi të reja për zhvillimin e aktiviteteve kulturore në nivel lokal. Këto iniciativa demonstrojnë se bashkëpunimi mes organizatave të pavarura dhe institucioneve publike është thelbësor për aktivizimin e suksesshëm të hapësirave publike dhe për zhvillimin e skenës kulturore në Prishtinë.

Në përfundim, **hapësirat publike për artin dhe kulturën në Prishtinë** janë një burim i jashtëzakonshëm që duhet të menaxhohet me kujdes për të promovuar zhvillimin social dhe kulturor të qytetit. Përmes reformave të duhura ligjore, përfshirjes së shoqërisë civile dhe komunitetit, si dhe zbatimit të modeleve të reja të menaxhimit, këto hapësira mund të transformohen në qendra dinamike për artin, kulturën dhe jetën sociale.

Aktivizim i hapësirave publike në Prishtinë

Prishtina, kryeqyteti i Kosovës, është shtëpi e disa ndërtesave ikonike me një histori të pasur kulturore dhe artistike, por që aktualisht janë lënë në hije ose kanë vuajtur nga mungesa e investimeve. Këto ndërtesa, përfshirë **Pallatin e Rinisë dhe Sporteve, Kino Rinia, Fabrikën e Tullave dhe ish-Shtëpinë e Mallrave “Gërmia”**, përfaqësojnë mundësi të jashtëzakonshme për revitalizimin e hapësirave publike dhe zhvillimin e skenës kulturore dhe artistike të qytetit. Pavarësisht gjendjes së tyre aktuale, këto objekte kanë potencialin për t’u shndërruar në qendra të rëndësishme për artin, kulturën dhe inovacionin, duke ofruar hapësira të reja për ngjarje dhe ndërveprime sociale.

Rindërtimi i Pallatit të Rinisë dhe Sporteve

Ndërtesa emblemë e Prishtinës, Pallati i Rinisë dhe Sporteve, i ndërtuar në vitin 1977, ka shërbyer për dekada të tëra si një qendër për aktivitetet sportive dhe kulturore më të rëndësishme në qytet. Me një sipërfaqe prej 8,136 m² dhe kapacitet për të pritur 11.000 persona, pallati ka përfaqësuar një hapësirë kyçe për jetën publike të qytetit. Megjithatë, pas zjarrit shkatërrimtar të vitit 2000, ndërtesa ka mbetur në gjendje të rënduar dhe kërkon një rinovim të gjerë për t’u rikthyer në funksion të plotë.

Në prill 2024, një marrëveshje bashkëpunimi u nënshkrua për të lehtësuar rinovimin e Pallatit të Rinisë, me synimin për ta kthyer këtë ndërtesë historike në një qendër moderne kulturore dhe sportive. Ky projekt përfaqëson jo vetëm një mundësi për të ruajtur trashëgiminë kulturore të qytetit, por edhe për të rritur ofertën e aktiviteteve artistike dhe rekreative për komunitetin.

Transformimi i ish-Shtëpisë së Mallrave “Gërmia”

Një tjetër ndërtesë me potencial të jashtëzakonshëm për zhvillim është ish-Shtëpia e Mallrave “Gërmia”, e cila ka shërbyer si një qendër tregtare e njohur në Prishtinë që nga hapja e saj në vitin 1972. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, kjo ndërtesë mbeti pa një funksion të qartë, duke humbur statusin e saj si qendër e rëndësishme e jetës publike. Në vitin 2018, Komuna e Prishtinës bleu objektin me qëllim transformimin e saj në një qendër kulturore multimediale.

Synimi kryesor i këtij projekti është krijimi i një hapësire kulturore që do të ofrojë një gamë të gjerë aktiviteteve artistike, ekspozita, performanca dhe ngjarje sociale. Ky transformim do të rrisë

pjesëmarrjen e komunitetit në aktivitetet kulturore dhe do të nxisë turizmin, duke e kthyer këtë ndërtesë ikonike në një destinacion për art dhe kreativitet.

Kino Rinia në Prishtinë është një ndërtesë me një histori të gjatë dhe simbolike, e cila dikur ka funksionuar si një kinema dhe hapësirë kulturore për qytetarët. Aktualisht, ndërtesa është në pronësi publike të komunës dhe ka një status të papërcaktuar për shfrytëzim të plotë, me pjesë të saj që janë të braktisura ose të përdorura në mënyrë të kufizuar. Kino Rinia në Prishtinë ka një potencial të jashtëzakonshëm për t'u shndërruar në një hapësirë të dedikuar për kreativitet dhe zhvillim kulturor.

Ndërtesa përfaqëson një pasuri me vlerë për zhvillimin kulturor dhe kreativ të qytetit, por mungesa e investimeve dhe e planifikimit të qëndrueshëm e ka lënë atë të pazhvilluar. Megjithatë, potenciali i saj për t'u shndërruar në një qendër kreative mbetet i lartë, duke marrë parasysh vendndodhjen në qendër të Prishtinës dhe rëndësinë që ka për historinë dhe komunitetin lokal. Krijimi i një strategjie për rehabilitimin dhe përshtatjen e Kino Rinisë mund ta kthejë atë në një hapësirë funksionale për aktivitete kulturore dhe kreative, duke përfshirë artet pamore, shfaqjet, punëtoritë dhe eventet që mbështesin inovacionin dhe zhvillimin komunitar.

Fabrika e Tullave - Një qendër për art dhe inovacion

Fabrika e Tullave, e ndërtuar në vitin 1974, është një nga ndërtesat më të mëdha post-industriale në Prishtinë, me një potencial të jashtëzakonshëm për t'u transformuar në një qendër kulturore dhe inovative. Megjithëse ka kaluar në procesin e privatizimit dhe është lënë pas dore për vite me radhë, tani është nën administrimin e Komunës së Prishtinës, e cila ka plane ambicioze për ta kthyer këtë hapësirë në një qendër për art, kulturë dhe inovacion.

Projekti “Art-Tek Tulltorja”, një bashkëpunim mes komunës dhe MIT, ka për qëllim shndërrimin e fabrikës në një hapësirë për zhvillim të kulturës dhe teknologjisë. Kjo qendër synon të bëhet një platformë për artistët, krijuesit dhe inovatorët për të eksperimentuar dhe zhvilluar projekte të reja, duke kontribuar kështu në zgjerimin e potencialit të industrive krijuese dhe kulturore të qytetit.

Qendra për Praktikë Narrative - Transformimi i ish-Bibliotekës “Hivzi Sulejmani”

Një tjetër ndërtesë e rëndësishme që ka kaluar nëpër një fazë transformimi është ish-biblioteka “Hivzi Sulejmani”, e cila ka pësuar rehabilitim për t'u shndërruar në Qendrën për praktikë narrative. Pas një periudhe të gjatë të lënies pas dore, Komuna e Prishtinës vendosi të rikthejë në jetë këtë hapësirë publike, duke krijuar një qendër që shërben si një platformë për ndërveprime kulturore dhe sociale.

Ky institucion ka luajtur një rol të rëndësishëm në nxitjen e angazhimit kulturor dhe social të komunitetit, duke organizuar mbi 100 ngjarje të rëndësishme gjatë periudhës së bienales Manifesta 14. Transformimi i kësaj hapësire ka sjellë një kontribut të madh për rritjen e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në aktivitetet kulturore, duke rritur potencialin e hapësirave publike për të krijuar një ambient më të pasur dhe gjithëpërfshirës për art dhe kulturë.

HAPËSIRAT PUBLIKE TË GJELBRA: PARAKUSHT PËR NJË JETË KULTURORE DINAMIKE

Prishtina, si kryeqytet i Kosovës, ka potencial të jashtëzakonshëm për një jetë kulturore dinamike, e cila mbështetet në hapësira publike të gjelbra. Megjithatë, lagjet më të reja karakterizohen nga mungesa e hapësirave të tilla, që ndikon negativisht në cilësinë e jetës. Hapësirat e gjelbra janë thelbësore për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, si festivale dhe ekspozita, duke kontribuar në forcimin e identitetit kulturor dhe kohezionit shoqëror.

Planifikimi urban dhe rrjetet e këmbësorëve

Planifikimi urban duhet të adresojë nevojat për hapësira të gjelbra dhe ndërtimin e rrjeteve për këmbësorët dhe çiklistët, të cilat do të lidhin këto hapësira me zonat e populluara. Mungesa e këtyre rrugëve kufizon aksesin në aktivitete kulturore. Po ashtu, ndriçimi i pamjaftueshëm paraqet rreziqe sigurie, duke e bërë të vështirë angazhimin e qytetarëve në aktivitete kulturore, sidomos gjatë natës.

Sigurimi i aksesueshmërisë dhe sigurisë është thelbësor për krijimin e hapësirave kulturore gjithëpërfshirëse, të cilat i shërbejnë të gjithë qytetarëve, përfshirë individët me aftësi të kufizuara, veçanërisht personat e verbër. Realizimi i një studimi gjithëpërfshirës mbi aksesueshmërinë do të jetë një hap kyç për të identifikuar dhe adresuar nevojat specifike, duke mundësuar krijimin e hapësirave publike që janë të sigurta, të aksesueshme dhe të pajisura për të përmbushur standardet më të larta të përfshirjes.

Iniciativat artistike dhe biodiversiteti

Prishtina gjithashtu ka mundësi për të promovuar bashkëjetesën me biodiversitetin. Iniciativat artistike që përqendrohen në mbjelljen e bimëve dhe hapësira për kafshët do të rrisin ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetin. Instalimet artistike për kafshët dhe hapësirat e dedikuara do të kontribuojnë në një ambient më të gjallë dhe tërheqës.

Investimet në hapësira të gjelbra

Investimi në hapësira të gjelbra, përmirësimi i infrastrukturës dhe nxitja e iniciativave kulturore janë thelbësore për zhvillimin e një jete kulturore dinamike në Prishtinë. Këto hapësira do të shërbejnë si vende relaksimi dhe platforma për ngjarje kulturore, duke kontribuar në një cilësi më të lartë të jetës për të gjithë banorët.

MANIFESTIMET DHE EVENTET

Prishtina, si kryeqyteti i Kosovës, shërben si skenë qendrore për festimet dhe përkujtimet kombëtare. Ngjarjet si “*Dita e Pavarësisë*”, “*Dita e Fëmijëve*”, “*Dita e Personave të Zhdukur*” dhe “*Dita e Lirisë*” kanë një rëndësi të madhe në nxitjen e kohezionit social, ndjenjës së identitetit dhe përkatësisë. Këto tubime i bashkojnë njerëzit, duke ofruar mundësi për përvoja të përbashkëta dhe për të krijuar kujtesë kolektive. Megjithatë, organizimit të këtyre ngjarjeve në mbarë

kryeqytetin aktualisht i mungon një vizion koheziv dhe afatgjatë. Kjo mund të çojë në programim të paqëndrueshëm dhe në mundësi të humbura për të krijuar përvoja vërtet me ndikim.

Propozimi i kryetarit të Prishtinës për vendosjen e një linje buxhetore të dedikuar për nismën “Kuratori kulturor për organizime dhe manifestime të kryeqytetit” paraqet një zgjidhje premtuese, e cila ka filluar me procedura të prokurimit public, me kërkesa për staf të specializuar në fushën teknike, elektrike, dizajner, magjistër të arteve muzikore, skenarist, gazetar, dizajner grafik, kurator të programeve kulturore për një periudhë dyvjeçare, Prishtina mund të sigurojë një program të qëndrueshëm dhe cilësor për manifestime. Vendosja e kësaj linje buxhetore nënkupton se organizimi i ngjarjeve nuk do të bëhet nga drejtoria, në ç’rast drejtoria do të merrte rolin për të monitoruar dhe bashkëkrijuar konceptin e programit vjetor.

Kuratori do të jetë përgjegjës për zhvillimin e një kalendari gjithëpërfshirës të ngjarjeve, duke siguruar diversitet, vlerë të lartë prodhimi dhe një qasje strategjike ndaj festimeve në mbarë qytetin.

GJITHËPËRFSHIRJA DHE AKSESUESHMËRIA NË SEKTORIN KULTUROR DHE KRIJUES

Përfshirja dhe aksesueshmëria në jetën kulturore përbëjnë një parim të rëndësishëm të politikave kulturore bashkëkohore dhe janë të lidhura ngushtë me të drejtat themelore të njeriut dhe barazinë në pjesëmarrje. Në përputhje me standardet ndërkombëtare, përfshirë Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD), institucionet publike inkurajohen të krijojnë kushte që mundësojnë qasje sa më të gjerë dhe pjesëmarrje të barabartë në jetën kulturore.

Analiza e gjendjes në Prishtinë tregon se, megjithëse ekzistojnë iniciativa dhe praktika pozitive në sektorin kulturor dhe kreativ, qasja ndaj përfshirjes dhe aksesueshmërisë mbetet e fragmentuar dhe jo e standardizuar. Infrastruktura kulturore dhe programet artistike nuk janë gjithmonë të përshtatura për të gjitha grupet e shoqërisë, çka mund të ndikojë në nivelin e pjesëmarrjes dhe shfrytëzimit të ofertës kulturore.

Gjithashtu, mungojnë udhëzime të qarta dhe të unifikuara për institucionet dhe organizatorët kulturorë lidhur me mënyrat e përmirësimit të aksesueshmërisë, ndërsa përfshirja e këtij dimensionit në proceset e planifikimit dhe financimit mbetet e kufizuar. Në këtë drejtim, nuk ka ende një qasje të konsoliduar që do të siguronte integrimin gradual të standardeve të aksesueshmërisë në zhvillimin e sektorit.

Nga ana institucionale, ekziston hapësirë për përmirësim në drejtim të koordinimit, shkëmbimit të praktikave të mira dhe përfshirjes më të strukturuar të grupeve të ndryshme në proceset e planifikimit dhe zhvillimit të politikave kulturore. Njëkohësisht, mekanizmat për monitorimin e përfshirjes dhe aksesueshmërisë janë të kufizuar dhe nuk ofrojnë një pasqyrë të plotë mbi progresin në këtë fushë.

Megjithatë, kjo situatë paraqet një mundësi për përmirësim gradual dhe të qëndrueshëm. Integrimi i përfshirjes dhe aksesueshmërisë si parime ndërsektoriale (cross-cutting) mund të kontribuojë në zgjerimin e audiencave, rritjen e pjesëmarrjes dhe përmirësimin e cilësisë së ofertës kulturore, pa

kërkuar domosdoshmërisht ndërhyrje të mëdha financiare, por përmes optimizimit të praktikave ekzistuese dhe rritjes së ndërgjegjësimit institucional.

Në këtë drejtim, rekomandohet një qasje progresive që përfshin zhvillimin e udhëzimeve praktike, përfshirjen graduale të kriterëve të aksesueshmërisë në programet dhe thirrjet publike, si dhe forcimin e bashkëpunimit me organizata dhe aktorë që kanë përvojë në këtë fushë. Kjo do të mundësonte një tranzicion të balancuar drejt një sektori kulturor më gjithëpërfshirës, në përputhje me kapacitetet ekzistuese institucionale dhe financiare.

MENAXHIMI I POLITIKAVE KULTURORE NË PRISHTINË

Drejtoria e Kulturës e Komunës së Prishtinës ka një rol drejtues në hartimin e politikave që mundësojnë një mjedis të lulëzuar për zhvillimin e artit, kulturës dhe turizmit të kryeqytetit. Drejtoria është e përkushtuar për gjithëpërfshirje, mbrojtjen e vlerave kulturore dhe ruajtjen e trashëgimisë së Prishtinës.

Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Kulturës ka bërë përparime të rëndësishme duke rritur numrin e stafit në drejtorinë përkatëse dhe duke plotësuar pozitat në institucionet e artit dhe kulturës. Këto ndryshime synojnë përmirësimin e funksionalitetit dhe efikasitetit të këtyre institucioneve, duke mbështetur më tej zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike.

Drejtoria aktualisht menaxhon një portofol të gjerë përgjegjësish, duke përfshirë vendimmarrjen strategjike, shpërndarjen e fondeve publike, mbikëqyrjen e institucioneve kulturore dhe organizimin e ngjarjeve, ndërsa performanca e tyre në këto fusha është shembullore, vëllimi i madh i punës kërkon digjitalizimin të koordinojë më mirë përpjekjet për të monitoruar dhe zhvilluar plane të ndryshme. Për më tepër, investimi në ngritjen e kapaciteteve nëpërmjet vizitave studimore dhe programeve të trajnimit do të ndihmojë që të qëndrojnë të përditësuar me teknologjinë dhe trendet më të fundit.

Institucionet publike

Menaxhimi i institucioneve kulturore në Prishtinë përfaqëson një strukturë organike që ka si qëllim mbështetje dhe zhvillim të aspekteve të ndryshme të jetës kulturore dhe artistike të qytetit. Këto institucione përfshijnë Teatrin e Qytetit të Prishtinës “Dodona”, Qendrën kulturore të fëmijëve, dhe bibliotekën “Hivzi Sulejmani” me 10 degë në të gjithë qytetin. Po ashtu, përfshihen Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor dhe Arkivi i komunës, si dhe Pallati i Rinisë dhe Sporteve.

Institucionet publike kulturore luajnë një rol kyç në pasurimin e skenës kulturore të Prishtinës. Megjithatë, ato përballen me sfida të shumta për shkak të varësisë nga buxheti i komunës dhe kufizimeve legislative nga Departamenti i Kulturës. Kjo varësi shkakton pengesa në funksionimin e përditshëm, duke kufizuar autonominë dhe fleksibilitetin e institucioneve për të menaxhuar operacionet e tyre. Një problem tjetër është mungesa e kodeve buxhetore të dedikuara, të cilët janë të nevojshëm për të siguruar një menaxhim më efikas të financave. Çdo shpenzim nga pagat deri

te materialet programore, kërkojnë miratimin e Departamentit të Kulturës, duke e bërë procesin e menaxhimit më të ngadalshëm dhe më kompleks.


Për më tepër, edhe pse ligji i sapomiratur për artin dhe kulturën ka si qëllim të sjellë reforma, shumica e institucioneve publike kulturore mbështeten ende në subvencione dhe transfere nga buxheti qeveritar. Kjo krijon një varësi të madhe, e cila përkeqësohet nga fakti që të ardhurat nga shitjet e biletave dhe mallrave kthehen në thesarin e shtetit. Kjo situatë pengon zhvillimin e modele të qëndrueshme financimi dhe i bën institucionet të ndjeshme ndaj luhatjeve në alokimet e qeverisë, duke rrezikuar aktivitete të rëndësishme dhe programe të planifikuara.

Për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të përbashkët të kulturës në Prishtinë, është thelbësore të adresohen këto sfida dhe të krijohen mekanizma që mundësojnë autonomi më të madhe dhe një financim më të qëndrueshëm për institucionet kulturore.

FONDET PUBLIKE PËR ARTIN DHE KULTURËN NGA KRYEQYTETI I PRISHTINËS

Financimi i ndarë për kulturën nga Drejtoria e Kulturës në Prishtinë ka shfaqur luhatje gjatë pesë viteve të fundit, siç është paraqitur në tabelën e mëposhtme. Në vitin 2020, buxheti ishte 3,889,000.00 €, i cili u rrit në mënyrë të ndjeshme në 4,065,000.00 € në vitin 2021 përpara se të zvogëlohej në 3,150,000.00 € në vitin 2022. Megjithatë, pati një rënie të konsiderueshme në financim në vitin 2023, me vetëm 1.9600 00,00 € të shpërndara nga qyteti.

Fig.1. Ndarja e buxhetit të Prishtinës për kulturën 2020-2024



Burimi: IETL, 2024

Pavarësisht këtij konstatimi, pati një ringjallje të dukshme në vitin 2024, me buxhetin e kulturës që u rrit në 5,915,000.00 €, duke treguar theksin e ripërtërirë të qytetit në investimet kulturore.

Rritja e konsiderueshme e shpenzimeve kapitale për vitin 2024 i dedikohet posaçërisht rinovimit të monumenteve kryesore kulturore në Prishtinë. Këtu përfshihen vende ikonike si qendra e qytetit

“Kurrizi” dhe përshtatja e Tulltores në një qendër për art dhe teknologji. Gjithashtu, ky investim kapital i dedikohet rivitalizimit të Sallës së Koncerteve (Qendra Multikulturore “Evropa”), rinovimit dhe mirëmbajtjes së institucioneve, si dhe hapësirave të ndryshme kulturore të qytetit. Këtu përfshihen teatri i qytetit të Prishtinës “Dodona”, biblioteka “Hivzi Sulejmani” dhe degët e saj, Arkivi i qytetit, Qendra kulturore për fëmijë në Prishtinë dhe Klubi i Boksit. Kategoria e investimeve kapitale, e cila mbulon projektet e infrastrukturës dhe zhvillimit, ka përjetuar luhatje gjatë pesë viteve të fundit, duke filluar nga 2,250,000.00 € në vitin 2020, në 4,500,000.00 € në 2024.

Shërbimet dhe mallrat, duke përfshirë shpenzimet operacionale, kanë mbetur relativisht të qëndrueshme ndër vite, duke shfaqur luhatje të vogla. Subvencionet, të ndara për të mbështetur iniciativat dhe organizatat kulturore, panë një rritje të lehtë nga 580,000.00 € në vitin 2020 në 825,000.00 € në vitin 2023 dhe mbetën konsistente në vitin 2024.

Subvencionet përfaqësojnë llojin kryesor të mbështetjes që qyteti i Prishtinës mund t'i japë skenës së pavarur, e cila përfshin organizata kulturore, individë dhe kompani private. Megjithatë, vetëm afërsisht 100,000 nga 825,000 euro në vit u ndahen palëve të treta, ndërsa ngjarjet dhe festimet dhe institucionet publike mbështeten përmes kësaj linje buxhetore. Kjo është sasi shumë e vogël e kapacitetit dhe lë pak hapësirë për përmirësim dhe rritje të qëndrueshme.

Lëshimi i subvencioneve nga qyteti i Prishtinës ndjek drejtimin që parashtrohet në Rregullorja 01-011/01-79067/25 për Ndarjen e Subvencioneve nga Komuna e Prishtinës e miratuar nga Kuvendi i Prishtinës më 4.6. 2025.

Kjo rregullore përcakton limitet buxhetore, rregullat e përgjithshme të aplikimit për subvencione, procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve, përjashtimet nga ndarja e subvencioneve, komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për subvencione, vlerësimin e kërkesave dhe vendimmarrjen, komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave lidhur me ndarjen e subvencioneve, paraqitjen dhe zgjidhjen e ankesave për ndarjen e subvencioneve, marrëveshje për subvencionimin, monitorimin e përfituesve, raportimin dhe transparencën në ndarjen e subvencioneve.

Subvencionet ndahen për fushën e arsimit, zhvillimit ekonomik, bujqësisë, shëndetësisë, mirëqenies sociale për individë dhe familje, si dhe për kulturën, rininë dhe sportin.

Në Sektorin e kulturës, rregullorja specifikon disiplinat kulturore, duke filluar nga arti pamor - figurativ, botues, festivale, kinematografi, evente, mbështetje për aktivitetet vjetore të organizatave

dhe operatorëve kulturor, muzikë, organizim, shoqëri kulturo-artistike, teatër, trashëgimi kulturore, etj., dhe çmime vjetore.

Tabela e mëposhtme tregon llojin e thirrjes së hapur për aplikime për subvencione, për kulturën e Prishtinës nga viti 2020-2023, të cilat mundësojnë vëzhgimet e mëposhtme.

Tabela 1. Thirrje të hapura për aplikime për subvencione për kulturën nga Prishtina për periudhën kohore 2020-2023.

Viti	Titulli i thirrjeve të hapura për aplikime
2020	Produksion i performancave teatrore për Teatrin për fëmijë dhe për Skenën e Mbrëmjes për repertorin e Teatrin e qytetit të Prishtinës “Dodona”
2020	Arte pamore - figurative, publikime, kinematografi, muzikë, trashëgimi kulturore dhe turizëm, teatër - faza e dytë
2020	Thirrje publike <rrinshpi>
2020	Festival, muzikë, mbështetje për aktivitete vjetore për operatorë dhe organizatorë të aktiviteteve të përvitshme, shoqëria kulturore artistike
2020	Arte pamore - figurative, publikime, kinematografi, teatër
2021	Muzikë, botime, teatër
2021	Perfomancë muzikore
2021	Arti në hapësira publike
2021	Festivale, muzikë, shoqëri artistike-shoqërore, trashëgimi kulturore dhe turizëm
2021	Arte pamore - figurative, publikime, kinematografi, teatër
2022	Festivalet, mbështetja për aktivitetet vjetore, muzika, shoqëri kulturore artistike, trashëgimi kulturore dhe turizmi - faza I
2022	Arti pamor – figurativ, botues, kinematografi, teatër – faza I

2022	Produksion i performancave teatrore për teatrin për fëmijë dhe për skenën e mbrëmjes për repertorin e teatrit të qytetit të Prishtinës “Dodona”
2022	Arte pamore - figurative, publikime, kinematografi, trashëgimi kulturore dhe turizëm, evente - faza e dytë
2023	Arte pamore - figurative, trashëgimi kulturore dhe turizëm, shoqëri kulturore dhe artistike, mbështetje për aktivitete të përvitshme nga operatorë dhe organizatorë kulturor, publikime.
2023	Festivale, muzikë, evente, kinematografi, teatër

Burimi: IETL, 2024

Disa disiplina, si artet pamore, botimet, kinematografia, muzika dhe teatri, shfaqen vazhdimisht gjatë viteve në thirrjet e hapura për financim. Disa thirrje të hapura ndahen në dy faza, që do të thotë se disa disiplinave u jepet mbështetje publike dy herë në vit.


Ekziston gjithashtu një tendencë që disa disiplina të grupohen së bashku brenda një thirrjeje të vetme të hapur, duke filluar nga tre deri në gjashtë disiplina. Në raste të tjera, disiplina specifike trajtohen veçmas në thirrjet e hapura individuale. Për shembull, ka thirrje të veçanta për muzikë, botim, teatër dhe art në hapësirat publike në vitet 2021 dhe 2023.

Përveç kësaj, këto subvencione ndonjëherë ofrojnë mbështetje për programimin e institucioneve kulturore të qytetit. Për shembull, në vitin 2020 dhe 2022, qyteti i Prishtinës ka publikuar thirrje të hapura për prodhimin e shfaqjeve teatrore për repertorin e teatrit të qytetit të Prishtinës “Dodona”. Po ashtu, në vitin 2023, biblioteka “Hivzi Sulejmani” ka marrë 4,952€ nga thirrja e hapur për subvencione, si mbështetje për programin e saj vjetor.

Një pasqyrë e ndarjes së granteve të subvencioneve për kulturë në vitin 2023 në tabelën më poshtë, tregon se shumica e granteve në këtë vit bien në shumën prej 2,000.00 deri në 4,000.00 euro, me 42 grante të ndara në 2,000.00 euro dhe 44 grante të ndara në 3,000.00 euro.

Numri i granteve gradualisht zvogëlohet pasi shuma e grantit rritet përtej 4000 euro, me më pak grante të dhëna në shuma më të larta. Kjo shpërndarje tregon se Drejtoria e Kulturës kryesisht jep grante në shuma më të ulëta deri të mesme, me më pak grante të ndara në shuma më të larta.

Fig 2. Shpërndarja e granteve për subvencionime në kulturë në vitin 2023.



Burimi: IETL, 2024

Ndërkohë, tabela tregon shpërndarjen e fondeve për kulturën nga qyteti i Prishtinës në vitin 2023. OJQ-të marrin mbështetjen më të madhe me 341,390.00 euro, individët, kompanitë private, ansamblët folklorike, një institucion kulturor i qytetit dhe një përfitues i paidentifikuar kanë marrë fonde gjithashtu. Në total janë shpërndarë 718,782 euro në 188 projekte përgjatë vitit, duke patur një shumë mesatare të fondit prej 3,823.31 euro për projekt. Grantet kanë variuar nga kostoja minimale prej 500 euro deri te shuma maksimale prej 10,000.00 euro për projekt.

Shuma minimale e grantit ishte prej 500 euro dhe iu dha një individ për një projekt të titulluar “Fuqizimi i artistëve të rinj në Prishtinë”, një punëtori dhe ekspozitë që promovon kreativitetin dhe artin në komunitetin tonë që synonte zhvillim të aftësive krijuese mes artistëve vendas. Në anën tjetër, shuma maksimale prej 10,000 euro iu dha tre CSO-ve për organizim të festivaleve, një prej tyre ishte festival i muzikës klasike dhe tjetri operonte në kategorinë e kinematografisë.

ANALIZA SWOT

(Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet)

PËRPARËSITË	DOBËSITË
• Prishtina është një qytet i ri dhe energjik, me mbi 30% të popullsisë në moshën 15-29 vjeç, duke krijuar një bazë të fuqishme për inovacion dhe krijimtari. • Ka fituar njohje ndërkombëtare për arritjet në art dhe kulturë, duke u renditur ndër qytetet kryesore për evente dhe festivale. • Skena e artit dhe kulturës së pavarur është shumë aktive, duke kontribuar në rritjen e interesit publik për artin dhe krijimtarinë. • Ligji i miratuar për Artin dhe Kulturën në 2024 ka hapur më shumë mundësi për institucionet publike dhe zhvillimin e skenës së pavarur kulturore. • Prishtina ka një peizazh arkitekturor të veçantë dhe një trashëgimi kulturore të pasur që tërheq turistët dhe nxit kreativitetin lokal. • Qendra e qytetit ofron ambiente dinamike, me mundësi të shumta për turistët vendorë dhe ndërkombëtarë. • Liberalizimi i vizave ka lehtësuar shkëmbimin e përvojave ndërkombëtare për komunitetin e artit dhe kulturës. • Skena muzikore është e larmishme dhe e gjallë, me më shumë se 30 festivale muzikore që mbahen çdo vit. • Procedurat e thjeshtësuara për aplikime online rrisin efikasitetin e proceseve administrative në sektorin kulturor.	• Mungesa e një strategjie të qartë kulturore ka kufizuar menaxhimin dhe promovimin efektiv të burimeve dhe aktiviteteve kulturore. • Infrastruktura kulturore është e pamjaftueshme, duke përfshirë mungesën e sallave koncertale, galerisë së ekspozitave dhe hapësirave tjera të nevojshme për zhvillimin e artit. • Mungesa e mekanizmave të strukturuar dhe të koordinuar për zhvillimin e sektorit kulturor dhe industrive kreative. • Mospërputhje ndërmjet kapaciteteve ekzistuese (infrastrukturë, institucione) dhe nevojave reale të sektorit. • Qasja ndaj përfshirjes dhe aksesueshmërisë në sektorin kulturor dhe krijues mbetet e fragmentuar dhe jo e standardizuar, me mungesë të udhëzimeve të qarta praktike, integritet në skemat e financimit dhe mekanizmave bazë për monitorimin e pjesëmarrjes së barabartë. • Programet e pamjaftueshme të trajnimit për artistët dhe punëtorët e kulturës krijojnë vakume të mëdha në disiplina të rëndësishme si: fotografia, kinematografia, dizajni i modës dhe artet skenike. • Përdorimi i kulturës si mjet për aktivitete kreative në hapësirat publike është i kufizuar. • Angazhimi kulturor i të moshuarve mbetet i ulët, duke e kufizuar përfshirjen e tyre në aktivitete artistike dhe kulturore.

	• Vendorsja arbitrare e reklamave urbane ka dëmtuar integritetin estetik dhe kulturor të qytetit. • Neglizhimi i trashëgimisë jomateriale dhe kujtesës kolektive rrezikon humbjen e identitetit kulturor. • Mungesa e një databaze për hapësirat publike dhe ekosistemin kulturor pengon vendimmarrjen e informuar dhe shpërndarjen e duhur të burimeve. • Model financiar i paqëndrueshëm, i bazuar kryesisht në mbështetje afatshkurtër (subvencione vjetore). • Mungesë e integritit të kulturës dhe kreativitetit në politikat e zhvillimit ekonomik dhe urban. • Institucionet kulturore përballen me buxhet të pamjaftueshëm, staf të kufizuar dhe mungesë të mjeteve për zhvillimin e aktiviteteve të qëndrueshme kulturore. • Nuk ekzistojnë mekanizma të fuqishëm për monitorimin, vlerësimin e politikave dhe aktiviteteve kulturore.
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
• Pozicionimi i industrive kreative si sektor ekonomik me potencial për rritje dhe punësim. • Integrimi i turizmit kreativ si dimension ndërsektorial në të gjitha fushat kulturore dhe kreative. • Zhvillimi dhe digjitalizimi i sistemeve për menaxhimin e hapësirave, të dhënave dhe shërbimeve kulturore. • Forcimi i partneriteteve ndërmjet sektorit publik, privat dhe shoqërisë civile. • Revitalizimi i hapësirave publike dhe objekteve ekzistuese për përdorim kulturor dhe kreativ.	• Përpjekjet për të penguar miratimin dhe zbatimin e Strategjisë për Artin dhe Kulturën në Prishtinë mund të pengojnë zhvillimin afatgjatë të sektorit. • Buxheti i pamjaftueshëm për institucionet kulturore dhe projektet artistike paraqet një pengesë të vazhdueshme për zhvillimin e aktiviteteve të qëndrueshme kulturore. • Jostabiliteti politik dhe mungesa e mbështetjes për kulturën në nivel institucional mund të krijojnë vonesa në zbatimin e politikave kulturore. • Mungesa e hapësirave të përshtatshme për aktivitete artistike dhe kulturore

• Zhvillimi i programeve të edukimit dhe trajnimit të lidhura drejtpërdrejt me nevojat e tregut. • Krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm financiarë (grante shumëvjeçare, fonde zhvillimore, modele hibride). • Rritja e rolit të kulturës në zhvillimin urban, identitetin e qytetit dhe promovimin ndërkombëtar. • Promovimi i edukimit artistik dhe kulturor që nga fëmijëria e hershme përmes programeve si “Arti në shkollë” ofron potencial të madh për zhvillimin e talentit të ri. • Politikat arsimore që promovojnë qasje të barabartë në edukimin artistik dhe kulturor mund të nxisin një përfshirje më të gjerë shoqërore. • Revitalizimi i hapësirave publike si Gërmia, Tulltorja Art-Tek dhe Pallati i Rinisë mund të transformojë qytetin në një qendër të rëndësishme kulturore dhe multikulturore. • Industritë kreative përbëjnë një potencial të madh për punësim, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë. • Ndërtimi i një teatri të ri në Prishtinë dhe promovimi i arkitekturës unike të qytetit mund të fuqizojnë më tej pozicionin e tij si një destinacion kulturor. • Krijimi i një zyre të specializuar për menaxhimin e hapësirave publike të artit dhe filmit do të lehtësojë qasjen dhe përdorimin efikas të këtyre hapësirave. • Përgatitjet për aplikimin e Prishtinës për t'u shpallur Kryeqytet Evropian i Kulturës do të rrisin prestigjin ndërkombëtar të qytetit dhe do të sjellin investime të reja. • Pjesëmarrja në Rrjetin e Qyteteve Krijuese të UNESCO-s do të sjellë përfitime të mëdha për zhvillimin e sektorit të kulturës. • Të dhënat statistikore të kulturës mund të përdoren për të kuptuar më mirë dinamikat	mund të kufizojë zhvillimin e artit dhe të kulturës. • Vonesa në përmirësimin e menaxhimit të hapësirave publike dhe në promovimin e artit dhe kulturës në shkollë përbën një kërcënim për rritjen dhe përfshirjen e talentëve të rinj. • Çdo përpjekje që nënvlerëson angazhimin për t'u bërë partner i Rrjetit të Qyteteve Krijuese të UNESCO-s mund të kufizojë potencialin e qytetit për rritje ndërkombëtare. • Mungesa e aksesit në literaturë në gjuhët lokale mund të kufizojë zhvillimin dhe përfshirjen e komuniteteve në jetën kulturore të qytetit.
--	--

sociale dhe ekonomike të qytetit, duke ndihmuar në planifikimin dhe vendimmarrjen.	
---	--

VIZIONI: PRISHTINA – QYTET I ARTIT DHE KULTURËS

Prishtina synon të bëhet një qendër kulturore e gjallë, e formësuar nga energjia dhe kreativiteti i banorëve të saj. Potenciali i tyre e vendos qytetin si një katalizator të fuqishëm për zhvillimin artistik dhe kulturor.

Me politikat që i japin përparësi artit dhe kulturës, Prishtina ndodhet në një moment vendimtar për të ndikuar në zhvillimin urban, ekonomik dhe arsimor të qytetit, duke forcuar ndjenjën e përkatësisë të banorëve të saj. Kjo strategji synon investime në infrastrukturë dhe mbështetje për artistët, duke krijuar një ekosistem të qëndrueshëm që ndërthur artin me zhvillimin politik, social dhe ekonomik. Përmes kësaj, arti do të jetë një forcë transformuese drejt ndryshimit dhe përparimit.

Strategjia zhvillon mendimin kritik, kreativitetin dhe inovacionin, duke ndihmuar në krijimin e vendeve të punës, rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e pozitës ndërkombëtare të Prishtinës.

Objektivat strategjike:

1. **E drejta për të krijuar** – mundësi të pakufizuara për shprehje artistike.
2. **E drejta për qytetin** – hapësira publike gjithëpërfshirëse për një Prishtinë ikonike.
3. **Zhvillimi i qëndrueshëm i Sektorit kulturor krijues** – nxitja e rritjes ekonomike dhe inovacionit.
4. **Kujtesa kolektive dhe dekolonizimi** – ruajtja dhe përfshirja kulturore.
5. **Reforma administrative** – Përmirësimi i qeverisjes kulturore.

Strategjia adreson sfidat kyçe të qytetit, me objektiva specifike që përputhen me nevojat afatshkurtra dhe të qarta. Çdo objektiv ka masa dhe veprime konkrete që do të realizojnë këtë vizion.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE SPECIFIKE

Objektivi strategjik 1: E drejta për të krijuar – mundësi të pafundme për shprehje artistike

Qëllimi: të rritet dhe zgjerohet qasja në art dhe kulturë për të gjitha segmentet e shoqërisë, duke fuqizuar shprehjen artistike dhe identifikimin e vlerave kulturore që nga mosha e hershme. Ky

objektiv synon të ofrojë mundësi për artistët dhe punonjësit kulturorë, si ata në zhvillim ashtu edhe ata të afirmuar, duke rritur kapacitetet arsimore dhe prodhuese. Duke adresuar në mënyrë konkrete hendekun ndërmjet arsimit dhe nevojave të tregut, si dhe duke integruar aftësi digjitale, ndërmarrëse dhe profesionale në sektorin kulturor dhe kreativ.

Në të njëjtën kohë, ky objektiv promovon një qasje gjithëpërfshirëse në programe, burime dhe mundësi krijuese, duke inkurajuar pjesëmarrjen e të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, përmes masave progresive dhe të përshtatura me kapacitetet ekzistuese institucionale dhe financiare.

Objektivi specifik 1.1: Përforcimi i programeve arsimore për shkollat fillore dhe të mesme

Qëllimi: Ky objektiv synon të nxisë talentin artistik të fëmijëve dhe të rinjve në Prishtinë përmes pjesëmarrjes në programe arsimore krijuese dhe krijimit të mjediseve të favorshme për zhvillimin e tyre artistik. Duke promovuar kreativitetin dhe vlerësimin e kulturës, synohet të pasurohet përvoja arsimore dhe të fuqizohen individët për të shprehur veten artistikisht, duke vendosur themelet për të mësuar gjatë gjithë jetës dhe pasurim kulturor. , duke siguruar përputhje më të madhe me zhvillimet bashkëkohore të industrive kreative dhe kërkesat e tregut të punës.

Veprimet kryesore:

- 1. Veprimi 1.1.1: Zbatimi i programit arsimor “Arti në shkolla”**
Deri në vitin akademik 2030, të gjitha shkollat në Prishtinë do të integrojnë këtë program në kurrikulën e tyre, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Administratës Publike. Programi do të angazhojë aktivisht nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme në aktivitete të artit dhe trashëgimisë kulturore.
- 2. Veprimi 1.1.2: Zgjerimi i programit edukativ të teatrit të qytetit të Prishtinës “Dodona”**
Zgjerimi i programit dhe prodhimeve të teatrit do të krijojë një përvojë transformuese edukative, duke promovuar ndërgjegjësim kulturor përmes shfaqjeve artistike dhe ekspozitave historike.
- 3. Veprimi 1.1.3: Riorganizimi i Festivalit “Ylberi i Prishtinës” në një Event Multidisiplinar**
Ky event do të ofrojë një platformë për një gamë të gjerë disiplinash artistike, përfshirë artet pamore dhe performative, poezinë dhe tregimin e historive, duke nxitur një angazhim kulturor më të gjerë për të rinjtë.

Objektivi specifik 1.2: Mundësimi i krijimtarisë profesionale

Qëllimi: ky objektivi fokusohet në përmirësimin e qasjes në mjete prodhimi thelbësore dhe ofrimin e mbështetjes profesionale për artistët dhe punonjësit kulturorë. Synimi është të zhvillohen aftësi dhe të nxitet krijimtaria përmes programeve dhe burimeve të përshtatura.

Veprimet kryesore:

1. Veprimi 1.2.1: Zhvillimi i programeve të trajnimit të specializuar

Do të krijohet një program i specializuar edukativ dhe promovues për Sektorin Kulturor dhe Krijues në Prishtinë, për të zhvilluar aftësi teknike dhe krijuese bazuar në nevojat e identifikuar të sektorit, duke përfshirë kompetenca në teknologji digjitale, inovacion dhe ndërmarrësi kreative.

2. Veprimi 1.2.2: Krijimi i një fondi të dedikuar për artin public – “Rrugëtimi drejt një Prishtine Kreative dhe Artistike”

Ky fond do të mbështesë realizimin e punimeve artistike publike në lokacione të mirëpërcaktuara, duke shërbyer si pika qendrore për angazhimin e komunitetit dhe forcimin e identitetit urban. Fondi i artit publik, një buxhet i veçantë i ndarë nga komuna, ka për qëllim mbështetjen e artistëve dhe financimin e krijimit të veprave artistike që vendosen në hapësirat publike të qytetit. Synimi është të zbukurohet Prishtina me skulptura, murale, apo instalacione që jo vetëm rrisin estetikën e hapësirave publike, por gjithashtu krijojnë ambiente ku njerëzit mund të kalojnë kohë, të ndërveprojnë dhe të lidhen me artin. Përmes këtij fondi, artistët mund të paraqesin idetë e tyre dhe të marrin mbështetje për realizimin e tyre. Gjithashtu, fondi inkurajon që projektet të jenë të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin, duke promovuar përdorimin e materialeve cilësore dhe ekologjike. Në këtë mënyrë, ky fond ndihmon jo vetëm në zhvillimin e artit dhe kulturës, por edhe në krijimin e një qyteti të gjallë, modern dhe tërheqës për banorët dhe vizitorët. Ky fond do të strukturohet si mekanizëm i qëndrueshëm financiar, duke mbështetur prodhimin artistik, aktivizimin e hapësirave publike dhe zhvillimin e turizmit kreativ në qytet.

3. Veprimi 1.2.3: Krijimi i rezidencave profesionale

Artistët lokalë do të kenë mundësi të përmirësojnë aftësitë e tyre dhe të ndërtojnë rrjete përmes rezidencave artistike ndërkombëtare, duke rritur ndërkombëtarizimin dhe qasjen në tregje të reja kreative.

Objektivi specifik 1.3: Pjesëmarrje aktive e komunitetit në art dhe kulturë

Qëllimi: Ky objektivi synon të fuqizojë komunitetin duke krijuar aktivitete artistike dhe kulturore që nxisin bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen, duke e lidhur angazhimin komunitar me zhvillimin ekonomik lokal dhe turizmin kreativ.

Veprimet kryesore:

1. **Veprimi 1.3.1: Financimi i ansambleve folklorike**
Sigurimi i zgjidhjeve për financimin dhe sigurimin e hapësirave për ansamblët folklorike do të promovojë identitetin kulturor dhe do të tërheqë turizmin.
2. **Veprimi 1.3.2: Zhvillimi i programit të arteve dhe artizanatit**
Do të krijohet një kornizë për të mbështetur punëtoritë lokale të artit dhe artizanatit, duke përfshirë konsultime me komunitetin për të identifikuar nevojat dhe praktikatat më të mira.
3. **Veprimi 1.3.3: Angazhimi i të moshuarve në aktivitetet artistike**
Promovimi i shprehjes krijuese tek të moshuarit do të forcojë lidhjet sociale dhe kulturore brenda komunitetit.

Objektivi strategjik 2: E drejta për qytetin – udhëheqje demokratike për hapësirat publike

Qëllimi: të krijohen mjedise që nxisin kreativitetin, inovacionin, përfshirjen dhe diversitetin kulturor, ndërsa mundësojnë veprimin kolektiv, duke adresuar mungesën e qasjes së strukturuar në hapësira publike dhe nevojën për menaxhim të koordinuar institucional.

Objektivi synon të zgjerojë të drejtat kolektive për hapësirat publike dhe të shndërrojë Prishtinën në një qendër demokratike për diskutime publike dhe shprehje artistike.

Objektivi specifik 2.1: Zhvillimi i programit kulturor në hapësirat publike përmes Partneritetit Publiko-Civil

Qëllimi: të transformohen hapësirat publike të Prishtinës në qendra të gjalla kulturore përmes partneriteteve me institucionet e pavarura, duke krijuar modele të qëndrueshme bashkëpunimi dhe përdorimi efikas të hapësirave publike.

Në këtë drejtim, theksohet rëndësia e përdorimit gjithëpërfshirës të hapësirave publike dhe përmirësimit gradual të aksesueshmërisë së tyre, në mënyrë që ato të shërbejnë si platforma të hapura për shprehje kulturore dhe ndërveprim social për të gjitha grupet e shoqërisë.

Kjo iniciativë do të lehtësojë qasjen në të drejtat e përdorimit të hapësirës dhe do të promovojë programim gjithëpërfshirës që pasuron gjallërinë kulturore të qytetit.

Veprimet kryesore:

1. **Veprimi 2.1.1: Inventarizimi gjithëpërfshirës i hapësirave publike përmes GIS**
Zhvillimi i një baze të dhënash për inventarizimin e hapësirave publike duke mundësuar planifikim strategjik dhe përdorim më efikas për aktivitete kulturore dhe kreative.

2. Veprimi 2.1.2: Partneriteti Civilo-Publik për aktivizimin e hapësirave publike

Duke avancuar partneritetin civilo-publik, hapësirat publike do të përdoren nga organizatat e shoqërisë civile, artistët dhe sipërmarrësit socialë për të përmirësuar mirëqenien urbane.

3. Veprimi 2.1.3: Adoptimi i Rregullores për përdorimin e hapësirave komunale

Thjeshtëzimi i procedurave dhe rritja e transparencës për të mundësuar qasje më të lehtë për aktorët kulturorë dhe kreativë.

4. Objektivi specifik 2.2: Përshtatja e infrastrukturës kulturore për të shërbyer komunitetin

Qëllimi: të modernizohen dhe ripërdoren hapësirat duke adresuar mungesën e infrastrukturës funksionale dhe duke krijuar hapësira multifunksionale për sektorin kreativ.

Veprimet kryesore:

- Transformimi i hapësirave si Qendra multikulturore “Gërmia” dhe Pallati i Rinisë dhe Sporteve në qendra dinamike për angazhimin e komunitetit dhe aktivitete kulturore.

Objektivi strategjik 3: Zhvillimi i qëndrueshëm i Sektorit Kulturor dhe Krijues (SKK)

Qëllimi: të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm i Sektorit Kulturor dhe Krijues në Prishtinë, duke kontribuar në rritjen ekonomike, inovacion, kohezion social, forcimin e identitetit kulturor, si dhe duke zhvilluar mekanizma konkretë për integrimin e industrive kreative në zhvillimin ekonomik dhe urban të qytetit.

Strategjia synon të mbështesë sipërmarrjen kulturore, punësimin dhe turizmin, duke promovuar bashkëpunimin ndërsektorial.

Objektivi specifik 3.1: Forcimi i financimit dhe zhvillimit ekonomik të sektorit kulturor dhe kreativ

Qëllimi: të përmirësohet dhe strukturohet financimi për sektorin kulturor dhe kreativ, duke synuar rritje graduale të mbështetjes publike dhe një shpërndarje më strategjike të burimeve deri në vitin 2030, në përputhje me kapacitetet buxhetore të komunës. Ky objektivi synon zhvillimin e mekanizmave të qëndrueshëm financiarë që mbështesin rritjen ekonomike të sektorit, inovacionin dhe krijimin e mundësive për punësim.

Veprimet kryesore:

1. **Veprimi 3.1.1: Rritja e investimeve kapitale**

Njëzet përqind e buxhetit do të alokohen për investime kapitale, duke lehtësuar transformimin dhe përshtatjen e infrastrukturës kulturore ekzistuese dhe ndërtimin e hapësirave të reja kulturore.

2. **Veprimi 3.1.2: Ristrukturimi i financimeve publike për kulturën**

Financimi publik do të ristrukturohet për të mbështetur organizatat profesionale dhe projektet artistike, duke fuqizuar më tej ekosistemin kulturor të Prishtinës.

3. **Veprimi 3.1.3: Krijimi i Fondit për startup-e kulturore**

Ky fond do të mbështesë rritjen e startup-eve krijuese përmes ndihmës financiare për pajisje dhe zhvillim të qëndrueshëm të biznesit.

4. **Veprimi 3.1.4: Përfshirja e elementeve të aksesueshmërisë në thirrjet publike ekzistuese**
Do të inkurajohet integrimi gradual i kritereve bazë të aksesueshmërisë në programet dhe thirrjet publike për financim, në përputhje me kapacitetet ekzistuese dhe pa krijuar ngarkesa shtesë buxhetore.

Objektivi specifik 3.2: : Integrimi i turizmit kulturor dhe kreativ në zhvillimin ekonomik të qytetit

Qëllimi: të zhvillohet turizmi si një komponent i integruar i sektorit kulturor dhe industrive kreative, duke rritur dukshmërinë ndërkombëtare dhe vlerën ekonomike të ofertës kulturore të Prishtinës.

Veprimet kryesore:

1. **Veprimi 3.2.1: Zhvillimi i turizmit kreativ si dimension ndërsektorial**

Integrimi i turizmit kreativ në të gjithë sektorët kulturorë dhe industrinë kreative, duke lidhur artin, trashëgiminë, dizajnin dhe aktivitetet urbane me përvojën turistike.

2. **Veprimi 3.2.2: Krijimi i pozicionit të Kuratorit të qytetit**

Një rol i dedikuar për të mbikëqyrur planifikimin e ngjarjeve kulturore dhe festivaleve, duke forcuar lidhjet me komunitetin dhe duke pasuruar peizazhin kulturor të qytetit.

3. **Veprimi 3.2.3: Zhvillimi i produkteve dhe paketave të integruara kulturore-turistike**

Krijimi i ofertave të strukturuara që lidhin ngjarjet kulturore, hapësirat publike dhe industrinë kreative, duke rritur kohëzgjatjen e qëndrimit dhe shpenzimet e vizitorëve.

Objektivi strategjik 4: Kujtesë kolektive gjithëpërfshirëse dhe dekolonizuese

Qëllimi: ky objektivi synon të ripërcaktojë dhe zgjerojë konceptin e trashëgimisë kulturore, duke siguruar që ai të përfshijë dhe fuqizojë zërat e grupeve të marginalizuara. Objektivi promovon një narrativë më gjithëpërfshirëse që reflekton përvojat dhe historitë e ndryshme që formësojnë identitetin kulturor të qytetit të Prishtinës duke integruar qasje bashkëkohore të interpretimit, digjitalizimit dhe përfshirjes së komunitetit në krijimin e kujtesës kolektive.

Objektivi Specifik 4.1: Rijetësimi i arkivave të Prishtinës

Qëllimi: të angazhohet arkivimi përmes mediumeve dhe disiplinave të shumta, duke siguruar ruajtjen e të dhënave historike dhe bashkëkohore për brezat e ardhshëm dhe duke mundësuar qasje të hapur dhe përdorim aktiv të tyre për edukim, kërkim dhe prodhim kulturor.

Veprimet kryesore:

1. Veprimi 4.1.1: Krijimi i platformës digjitale për arkivin

Një platformë digjitale e lehtë për t'u përdorur do të krijohet për të ruajtur dhe ndarë historinë kulturore të qytetit, duke e bërë atë të qasshme për publikun.

2. Veprimi 4.1.2: Arkivimi i historisë bashkëkohore

Do të bashkëpunohet me komunitetin për të mbledhur artefakte të përditshmërisë, të cilat do të digjitalizohen dhe do të ruhen për brezat e ardhshëm.

Objektivi specifik 4.2: Ruajtja e trashëgimisë kulturore

Qëllimi: të krijohet një kornizë gjithëpërfshirëse për ruajtjen e aseteve kulturore, duke siguruar mbrojtjen dhe promovimin e tyre për të ardhmen.

Veprimet kryesore:

- Do të bashkëpunohet me ekspertë për të vlerësuar dhe prioritetizuar trashëgiminë kulturore përmes punëtorive me komunitetin dhe planeve të ruajtjes së dedikuar.
- Zhvillimi i programeve që lidhin trashëgiminë kulturore me edukimin, turizmin kulturor dhe industrinë kreative, duke rritur përdorimin dhe vlerën e saj ekonomike dhe sociale.

Objektivi strategjik 5: Reformat administrative për zhvillimin kulturor

Qëllimi: të forcohen kapacitetet administrative të komunës në mbështetje të zhvillimit kulturor, duke përmirësuar proceset e mbledhjes së të dhënave dhe kornizat vendimmarrëse.

Objektivi specifik 5.1: Rritja e kapaciteteve të Drejtorisë së Kulturës

Qëllimi: të përmirësohen kapacitetet e Drejtorisë së Kulturës për të realizuar misionin e saj përmes vlerësimeve të nevojave organizative dhe përmirësimit të qeverisjes demokratike në menaxhimin e buxhetit.

Veprimet kryesore:

Veprimi 5.1.1: Ndërtimi i kapaciteteve dhe vizitat studimore

Drejtorja e Kulturës do të zhvillojë një program të strukturuar për rritjen e kapaciteteve të stafit, duke përfshirë trajnime në menaxhim, monitorim dhe vlerësim të projekteve kulturore. Fokus kryesor do të jetë adoptimi i standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira. Gjithashtu, do të organizohen vizita studimore dhe shkëmbime ndërkombëtare për përmirësimin e aftësive profesionale të stafit.

Veprimi 5.1.2: Menaxhimi i të dhënave për zhvillim kulturor – hartëzimi i SKK

Do të krijohet një sistem i centralizuar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi sektorin kulturor dhe krijues (SKK). Ky sistem do të ndihmojë në monitorimin dhe zhvillimin e politikave kulturore përmes analizave të bazuara në të dhëna të sakta, duke mundësuar vendimmarrje të informuar për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit.

V Veprimi 5.1.3: Zgjerimi i kompetencave të Drejtorisë së Kulturës për menaxhimin e hapësirave publike

Drejtoria e Kulturës do të krijojë një zyrë të specializuar për administrimin dhe menaxhimin efektiv të hapësirave publike dhe kulturore, duke siguruar transparencë dhe qasje të lehtë për artistët dhe organizatat kulturore. Kjo nismë synon të optimizojë përdorimin e hapësirave për aktivitete kulturore.

Veprimi 5.1.4: Monitorimi dhe vlerësimi vjetor i Strategjisë së Artit dhe Kulturës 2026-2030

Do të vendoset një sistem i rregullt monitorimi dhe vlerësimi për të analizuar progresin e zbatimit të strategjisë. Raportet vjetore do të sigurojnë transparencë dhe do të ndihmojnë në përshtatjen e strategjisë për të përmbushur objektivat.

Veprimi 5.1.5: Takime vjetore me qeverinë dhe donatorët ndërkombëtarë

Takimet e përvitshme me qeverinë qendrore dhe donatorët ndërkombëtarë do të shërbejnë për koordinimin e mbështetjes financiare dhe teknike, duke garantuar një qasje të qëndrueshme dhe të koordinuar për zhvillimin kulturor.

Shtojcat

Shtojca 1. Plani i veprimit

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1. E DREJTA PËR TË KRIJUAR						
Krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës ku individë të të gjitha moshave, gjinive dhe prejardhjeve shoqërore kanë mundësi të pakufizuara për t'u angazhuar në shprehjen artistike.						
Treguesit e ndikimit të Objektivit strategjik 1:						
-Rritja e pjesëmarrjes në programet e edukimit artistik dhe kulturor për të gjitha grupmoshat, duke përfshirë fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit; -rritja e përfshirjes së komunitetit në ngjarjet kulturore; -ulja e pabarazive në qasjen ndaj arteve; -mbështetja e punonjësve të sektorit kulturor për të përmirësuar kushtet e tyre; -ngritja e nivelit të vlerësimit të kulturës dhe arteve në shoqëri; -sigurimi i qëndrueshmërisë afatgjatë të ekosistemit të arteve përmes rritjes, inovacionit dhe përshtatshmërisë.						
Intervenimet kryesore të strategjisë (masa)	Institucionet përgjegjëse	Buxheti ose lloji i veprimit	Lidhja e problemit / Shkakut me objektivin	Periodha e implementimit	Treguesi i produktit (autputeve)	Treguesit i rezultatit caku deri 2031
Objektivi specifik 1.1. Pasurimi i edukimit artistik për fëmijët dhe të rinjtë						
1.1.1. Zbatimi dhe zgjerimi i programit të edukimit artistik "Arti në Shkolla".	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHT) dhe Ministria e Administratës të Pushtetit Lokal (MAPL) Komuna e Prishtinës - Departamenti i Arsimit	Numri total i nxënësve është 38,465 Duke supozuar një tarifë prej 30 eurosh për nxënës (Kosto për njësi), shuma totale e shpenzimeve direkte për akomodimin e të gjithë nxënësve të regjistruar në program do të arrijë në 1,153,950 eur.	Sistemi aktual i arsimit publik për shkollat e mesme të ulëta dhe të larta nuk arrin, zhvillon te nxënësit mendimin kritik dhe krijues, duke i privuar ata nga mundësitë për të eksploruar dhe zhvilluar talentin e tyre kreativ Pabarazia socio-ekonomike: Vetëm fëmijët në familje me të ardhura financiare të larta kanë mundësinë të financojnë dhe mbështesin fëmijët e tyre në fushën e arteve dhe kulturës Nisur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), programi "Arti në Shkolla" synon të integrojë artin në kurrikulën shkollore për të ofruar një përvojë të pasur për nxënësit	2026 - 2031 2026: 20% 2027: 40% 2028: 60% 2029: 80% 203 : 90% 2031: 100%	Në vitin 2027, "Arti në Shkolla" do të përfshijë të paktën 10 shkolla nëpër Prishtinë Në vitin 2027, një minimum prej 15,000 studentëve do të marrin pjesë në aktivitete artistike dhe kulturore çdo javë gjatë vitit shkollor Në vitin 2031, të paktën të gjithë nxënësit në shkollat e Prishtinës do të marrin pjesë në të paktën një projekt krijimi artistik për çdo vit akademik dhe do të angazhohen në të paktën dy diskutime të strukturuar rreth artit dhe kulturës, duke treguar një përmirësim të rëndësishëm në integrimin e artit dhe alfabetizmin kulturor	Identifikimi i talenteve të rinj në fushën e arteve dhe kulturës në një fazë të hershme. Ngritja e vetëbesimit dhe shprehjes së vetes së studentëve përmes angazhimeve artistike Sigurimi i mundësive për studentët për të ndjekur karrierën në fushën e arteve dhe industrive krijuese. Ndërgjegjësimi i rritur në lidhje me identitetin kulturor dhe trashëgiminë kulturore tek studentët Në vitin 2027, pritet që të paktën 60% e mësuesve të arteve të kenë përfunduar një program zhvillimi profesional. Në vitin 2031, pritet që studentët të angazhohen dhe diskutojnë rregullisht për artin, duke kontribuar në krijimin e tij dhe duke treguar një kuptim dhe vlerësim të thelluar të artit dhe kulturës brenda sistemit arsimor

1.1.2. Avancimi i kapaciteteve programore të Teatrit të Kukullave "Dodona", si dhe prodhimi i një ekspozite historike	Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Kulturës	150,000 në vit	Teatri i Kukullave "Dodona" përballet me financim të pamjaftueshëm me një buxhet vjetor prej 20,000 euro, dhe financim programor nga komuna përmes një thirrjeje të hapur për aplikime me 48,000 euro në 2022. Pavarësisht kësaj edhe pse ka këtë sfidë, Dodona arrin të zhvillojë shfaqje javore, me 500 fëmijë dhe prindër që vizitojnë Dodonën çdo muaj. Dodona ka një rëndësi për historinë e viteve të 90-ta të qytetit të Prishtinës. Megjithatë, ajo histori mbetet e patreguar dhe e paarritshme	Në vitin 2026, buxheti i Teatrit të Kukullave "Dodona" 100,500 euro. Në vitin 2031, buxheti për teatrin të rritet për 20,000 euro çdo vit Në vitin 2031, një ekspozitë e përhershme mbi historinë e Dodonës instalohet në vend	Deri në vitin 2026, 1000 fëmijë dhe prindër vizitojnë Dodonën çdo muaj. Deri në vitin 2026, përgatitja dhe kërkimi rreth ekspozitës së përhershme mbi historinë e Dodonës dhe deri në vitin 2031, ekspozita e përhershme është instaluar në terren. Deri në vitin 2031, afro 3000 fëmijë dhe prindër vizitojnë Dodonën çdo muaj	Përmirësimi i kapaciteteve operacionale dhe qëndrueshmëria e teatrit të kukullave "Dodona". Teatri "Dodona" qendër e dedikuar ku prindërit dhe fëmijët mund të angazhohen në përvoja teatrale dhe aktivitete të kohës së lirë Promovimi i angazhimit kulturor dhe lidhjes familjare nëpërmjet aktiviteteve teatrale në teatrin "Dodona"
1.1.3. Ridizajnim dhe zgjerim i festivalit ekzistues "Ylberi i Prishtinës" në një festival mbarëqytetas, njëjavor, shumëdisiplinor dhe artistik	Komuna e Prishtinës, Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës Partneritet me OJQ-në me program kreativ	50 mijë euro në vit	Festivali tradicional i valleve për fëmijë "Ylberi i Prishtinës" 2019, organizohet për të shtatëmbëdhjetin vit me radhë, dhe është një ndër ngjarjet më të rëndësishme kulturore për fëmijë që zhvillohet në Prishtinë, që zgjat dy ditë dhe shfaq një gamë të gjerë të valleve folklorike nga valltare vendore dhe ndërkombëtare Ai tërheq qindra pjesëmarrës të entuziazmuar çdo vit dhe një audiencë të gjerë, duke promovuar trashëgiminë kulturore dhe shkëmbimin kulturor. Edicioni i 21-të në vitin 2023, pati pjesëmarrje nga 400 valletarë nga vende si Shqipëria, Maqedonia Veriore, Mal i Zi, Ukraina, Rumania, Bullgaria dhe Kirgistan Qendrës Kulturore për Fëmijë të Prishtinës aktualisht mungon një drejtor dhe staf i mjaftueshëm. Pas zgjedhjes së drejtorit, vizioni i festivalit duhet të rishikohet, duke zgjeruar artet vizuale në një mënyrë dialoguese. Vetëm 200 fëmijë aktualisht marrin pjesë në aktivitetet vullnetare	Deri në vitin 2028 do të organizohet piloti i parë i festivalit të zgjeruar "Ylberi i Prishtinës"	Deri në vitin 2026, stafi i nevojshëm do të rekrutohet dhe do të fillojë planifikimi për pilotin e parë të edicionit të zgjeruar të festivalit. Deri në vitin 2027, do të organizohet piloti i parë i festivalit të zgjeruar "Ylberi i Prishtinës" Deri në vitin 2027, programi i ridizajnuar "Ylberi i Prishtinës" do të përfshijë së paku katër forma të tjera të artit, duke zgjeruar diversitetin dhe shtrirjen e ofertave kulturore Deri në vitin 2027, 1000 studentë do të kenë mundësinë të krijojnë një vepër të re arti në disiplinën e zgjedhjes së tyre dhe ta shfaqin atë në festival Deri në vitin 2031, të paktën 5000 studentë marrin pjesë në programin e larmishëm të "Ylberi i Prishtinës"	Përmirësimi i demonstruar në aftësitë dhe talentet e fëmijëve pjesëmarrës në aktivitetet kulturore. Rritja e prestigjit dhe popullaritetit të Festivalit "Ylberi i Prishtinës" si një ngjarje që tërheq vëmendjen dhe pjesëmarrjen e fëmijëve të Prishtinës në shfaqje dhe gara kulturore
1.1.4 Komuniteti dhe përfshirja	Komuna e Prishtinës – Drejtoria e	Investime kapitale (infrastrukturë)	Aktivizimi i komunitetit përmes aktiviteteve kulturore	Nr. aktiviteteve	Rritje e kohezionit social	

	Investimeve Kapitale Komuna e Prishtinës – Drejtoria e Kulturës Drejtoria e Urbanizmit Organizatat e personave me aftësi të kufizuara (PAK) – rol këshillues Partnerë zhvillimorë (BE, UNDP, KfW – sipas projekteve)	kulturore dhe përshtatje) Integrim i komponentëve të aksesueshmërisë në projektet ekzistuese Buxhet komunal + bashkëfinancim nga donatorët			Rritje e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse	
Objektivi specifik 1.2: Mundësimi i krijimtarisë profesionale						
1.2.1. Krijimi i një programi të specializuar të edukimit dhe promovimit të rritjes për CCS-të në Prishtinë	Komuna e Prishtinës STIKK, shoqatat e biznesit, CCS. Institucionet e nivelit qendror: MKRS dhe MASHT, donatorë ndërkombëtarë Organizatrat e trajnimeve profesionale	320 000 euro Vlerësimi i nevojave 50,000 euro. 50.000 euro dizajni i programit. 100,000 në vit + bashkëfinancim nga donatorë ndërkombëtarë dhe CCS. 20,000 euro vlerësimi i programit	Programe të pamjaftueshme trajnimi për artistët dhe punonjësit e kulturës në zhvillim e përqendruar nga mungesa e udhëzimeve të specializuara në disiplinën dhe fushën të ndryshme teknike, krahas zhvillimit të portofolit të neglizhuar Shkaqet e mundshme përfshijnë shkëputjen ndërmjet nevojave akademike dhe industrisë, financimin e kufizuar, përparimet e shpejta teknologjike dhe prioritetin e pamjaftueshëm të këtyre fushave të aftësive në institucionet arsimore Mungesa e mundësive adekuata të trajnimit për startup-et kulturore dhe krijuese, e karakterizuar nga boshllëqe të aftësive në menaxhim dhe udhëheqje, me shkaqe të mundshme duke përfshirë mungesën e programeve të përshtatura, kuptimin e kufizuar të sfidave unike dhe integrimin e pamjaftueshëm të aftësive të	2026; kontraktimi i vlerësimit të nevojave. 2027; krijimi i një komiteti drejtues të partneritetit strategjik ndërsektorial për zhvillimin e programit 2028; zhvillimi i programit dhe shpërndarja e roleve. 2029; nisja pilot e programit arsimor 2030; vlerësimi i pilotit	Formimi i komitetit drejtues i përbërë nga përfaqësues nga CCS, MKRS dhe MASHT, donatorë ndërkombëtarë Zhvillimi i një kuadri bashkëpunimi përmes një MoU. Deri në vitin 2031, organizohen dy edicione të programit; 1000 pjesëmarrës e përfunduan me sukses programin Raporti i vlerësimit që vlerëson ndikimin dhe rezultatet e pilotit	Zbatimi i një programi arsimor gjithëpërfshirës bazuar në nevojën për punëtorët e CCS, në Prishtinë përmes partneriteteve strategjike ndërsektoriale, rezultojnë në ngritjen e kapaciteteve, rritjen e bashkëpunimit brenda CCS dhe promovimin e një ekosistemi kreativ dinamik dhe fleksibil brenda komunës

			menaxhimit në trajnime të fokusuara në kreativitet			
1.2.2. Krijimi i një fondi dedikuar artit publik	Komuna e Prishtinës Drejtoria e Kulturës Komuniteti i Artistëve Arkitekt i qytetit të Prishtinës	450.000 euro 30,000 euro x 15 vepra arti / instalime publike mbi 4 vjet	Në Prishtinë, peizazhi i artit publik përkufizohet aktualisht nga disa vende përkujtime dhe instalacione të artit bashkëkohor, duke përfshirë statuja dhe skulptura të dukshme të përgendruara kryesisht në sheshin e qytetit Përtej këtyre, qyteti përmban vende dhe murale të përkohshme, me një pjesë të konsiderueshme të veprave të artit të centralizuara në një zonë Kjo shpërndarje nxjerr në pah potencialin e pashfrytëzuar të kryeqytetit për të përfshirë më tej veprat e artit bashkëkohor në arkitekturën e tij, duke krijuar kënde lojërash tërheqëse dhe vende interaktive që mund të pasurojnë mjedisin urban dhe të nxisin përfshirjen e komunitetit	2026; përfundimi i fazës përgatitore për nismën e artit publik 2027; nisja dhe ekzekutimi i suksesshëm i një thirrjeje të hapur për propozime të artit publik 2028; kontraktimi i pesë artistëve dhe instalimi i pesë veprave të reja të artit publik në Prishtinë, duke kontribuar në pasurimin kulturor dhe estetik të qytetit Deri në vitin 2031; një minimum 15 vepra të artit publik janë porositur dhe instaluar me sukses	Në të paktën 7 instalime arti publike janë vendosur në zona rurale me densitet të lartë të popullsisë dhe trafik këmbësor Nga veprat e komisionuara, të paktën 3 nga 15 janë parqe lojërash bashkëkohore dhe interaktive	Deri në vitin 2031, ky projekt synon të transformoj Prishtinën në një qytet ikonik, i shënuar nga angazhimi i saj për qëndrueshmëri ekologjike dhe inovacion artistik Duke përdorur materiale të lartë cilësie dhe miqësore me mjedisin, projekti do të zbulojë pika referimi kulturore të pasura dhe të papritura nëpër qytet, duke kthyer hapësirat popullore në qendra ikonike të komunitetit dhe kreativitetit
1.2.3. Rezidencat profesionale në fushën e artit dhe kulturës	Komuna e Prishtinës, Institucionet dhe organizatat kulturore, Programet dhe iniciativat e rezidencës	120 mijë euro 5000 euro x 24 rezidenca mbi 4 vjet	Në Prishtinë, ekziston një numër i kufizuar i mundësive të qëndrimit për artistët dhe praktikuesit, me disa programe që lehtësojnë udhëtimin e artistëve vendas jashtë vendit. Mungesa e dialogut ndërkombëtar dhe mundësive të shkëmbimit të artistëve në Prishtinë MKRS ofron fonde mobiliteti për promovimin ndërkombëtar të artit dhe trashëgimisë kulturore, ndërsa Fondacioni 17 dhe Qendra Multimedia ofrojnë rezidenca si për	2026; përfundimi i draftit të programit të rezidencës dhe identifikimi i mundësive të partneritetit strategjik me organizata të pavarura dhe institucione publike në art dhe kulturë	Një minimum prej 24 rezidencash të krijuara me sukses Së paku 4 rezidenca të caktuara posaçërisht për pjesëtarët e diasporës kosovare Së paku 4 rezidenca të caktuara për individë nga qytetet tjera brenda Kosovës	Deri në vitin 2031, synohet të transformohet Prishtina në një epiqendër kulturore, e njohur për përqafimin e estetikës së re dhe në zhvillim që pasuron peizazhin kulturor të qytetit Programi i rezidencës do të sjellë në jetë vepra arti të rëndësishme në skenën globale, duke vendosur Prishtinën si një qendër për artin bashkëkohor, dhe duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në diversitetin e ekosistemit artistik të qytetit. Programi do të nxisë dialogun mes

			krijuesit vendas ashtu edhe për ata ndërkombëtarë, duke përfshirë shkrimtarët, përkthyesit dhe artistët, duke shfrytëzuar hapësirat në pronësi publike si shtëpia "Hivzi Sylejmani" Ekzistojnë pak programe rezidenciale për artistët kosovarë që të fitojnë përvojë ndërkombëtare, duke përfshirë programin e praktikantëve Cultural Works në Vjenë dhe Çmimin Artists of Tomorrow organizuar nga YVAA dhe Stacion CCA	2027; shpallja dhe fillimi i thirrjes së hapur për rezidenca, me 3 rezidenca të inicuar me sukses 2031; përfundimi me sukses i 24 rezidencave deri në fund të ciklit strategjik	Së paku 4 rezidenca u janë dhënë artistëve nga komunitetet joshumicë Një minimum prej 4 rezidencash të dedikuara për mbështetjen e artistëve në zhvillim	komuniteteve dhe do të krijojë ura, duke forcuar lidhjet në mes të skenës së artit në Prishtinë
Objektivi specifik 1.3: Nxitja e komuniteteve të praktikës në art dhe kulturë						
1.3.1. Përcaktimi i zgjidhjeve optimale për financimin dhe sigurimin e hapësirave për ansamblet folklorike të Prishtinës	Drejtorja e Kulturës Kuvendet Popullore Drejtorja e Arsimit Drejtorja e Pronave	TBD 3000 euro janë ndarë për organizimin e takimeve të grupit punues për hartimin e zgjidhjes opsionale	Ansamblet folklorike të Prishtinës përballen me sfida të mëdha resurse Duke funksionuar pa ambiente apo pajisje teknike të duhura, ata pengohen në realizimin e plotë të vizionit të tyre artistik Për më tepër, mungesa e zyrave të dedikuara për ruajtjen e arkivave të trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore i shton më tej betejat e tyre Megjithatë, përmes përkushtimit dhe qëndrueshmërisë së tyre të palëkundur, këto ansamble luajnë një rol jetik në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Prishtinës, pasurimin e peizazhit kulturor të qytetit dhe kultivimin e talentit artistik brenda komunës	2026; krijohet një grup pune ndër-departamental me përfaqësues të ansambleve folklorike me qëllim ofrimin e zgjidhjeve optimale për financimin dhe sigurimin e hapësirave Deri në vitin 2027; kryetari i komunës nxjerr një vendim që rregullon përdorimin afatgjatë të hapësirës dhe financimin e ansambleve popullore Asambletë popullore nënshkruajnë memorandumet e mirëkuptimit për përdorimin e hapësirës Deri në vitin 2028; kuvendet popullore të kenë hapësirë	7 folk ensembles have. Deri në vitin 2031, infrastruktura e përmirësuar dhe korniza rregullatore sigurojnë që kuvendet popullore në Prishtinë të kenë hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme për prova, dhoma të zhveshjes, depo dhe realizim të programit Rritja e aksesit u mundëson të rinjve dhe banorëve të Prishtinës të marrin pjesë aktive në kuvendet popullore, duke u angazhuar në valle tradicionale dhe aktivitete kulturore. Rritja e ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore brenda komunës	Deri në vitin 2031, infrastruktura e përmirësuar dhe korniza rregullatore do të sigurojnë hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme për prova, dhoma të zhveshjes, depo dhe realizim të programit për kuvendet popullore në Prishtinë Rritja e aksesit për të rinjtë dhe banorët e Prishtinës do të mundësojë pjesëmarrjen aktive në kuvendet popullore, duke u angazhuar në valle tradicionale dhe aktivitete kulturore Rritja e përkujdesjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore brenda komunës

				të përshtatshme për prova të rregullta, dhoma të zhveshjes dhe për ruajtjen e kostumeve, materialeve arkivore, etj. Deri në vitin 2031; kuvendet popullore të kenë kushte adekuate për të realizuar programet e tyre		
1.3.2. Zhvillimi i Programit të Arteve dhe Artizanatit të Prishtinës	Drejtoria e Kulturës Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Drejtoria e Buxhetit dhe Financave Bizneset dhe shoqatat e Arteve dhe Artizanatit	TBD 3000 euro janë ndarë për organizimin e takimeve të grupit të punës për hartimin e zgjidhjes optimale	Qasje e kufizuar në burime dhe mekanizma mbështetës për punëtoritë lokale të artit dhe artizanatit, duke çuar në mungesë të qëndrueshmërisë dhe mundësive të rritjes për artizanët dhe industrinë krijuese në tërësi Për më tepër, ndërgjegjësimi dhe vlerësimi i pamjaftueshëm i zanateve tradicionale në mesin e komunitetit mund të kontribuojë në një rënie në përpjekjet për ruajtjen e trashëgimisë kulturore	2026; kontraktimi i palës së tretë për të administruar një proces gjithëpërfshirës konsultimi me komunitetin lokal të artit dhe artizanatit, duke përfshirë bizneset dhe punëtoritë e artit dhe artizanatit të përgjithshme 2027; krijohet një grup pune me përfaqësues të artit dhe artizanatit dhe të tri drejtorive komunale 2026; pilotohet programi i parë i artit dhe zejtarisë në Prishtinë 2028; vlerësimi i pilotimit dhe	Të paktën 200 pjesëmarrës janë të angazhuar në procesin e konsultimit. Janë konsultuar të paktën 50 biznese arti dhe zejtarie dhe punëtori të përgjithshme Zhvillimi i një mandati dhe termash të qartë referimi për grupin e punës Zbatimi me sukses i edicionit të parë të programit të Arteve dhe Artizanatit të Prishtinës me 200 pjesëmarrës në vitin 2026 Nivelet e pjesëmarrjes në aktivitetet e programit rriten me 50% çdo vit	Deri në vitin 2031, zbatimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i programit të artit dhe zejtarisë në Prishtinë, i lehtësuar nga një proces konsultimi dhe vlerësimi të vazhdueshëm, do të çojë në krijimin e një komuniteti të gjallë dhe të përfshirë në mbarëvajtjen e artit dhe zejtarisë Artet dhe zanatet do të kontribuojnë në rritjen ekonomike, pasurimin kulturor dhe kohezionin e komunitetit në rritje Përforsimi i identitetit të Prishtinës si një qendër e lamishme e shprehjes artistike dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore

				përditësimi i programit të Arteve dhe Artizanatit në Prishtinë Deri në vitin 2031; janë zbatuar së paku 5 botime të programit të Arteve dhe Artizanatit në Prishtinë		
1.3.3. Angazhime artistike për të moshuarit	Komuna e Prishtinës, Komunitete, OJQ-të apo kompanitë	132 000 euro 30.000 euro në vit për palën kontraktuese për zbatimin 3000 euro në vit për furnizime	Aktualisht, banorët e shtëpive të të moshuarve dhe frekuentuesit e qendrave ditore në qytetin tonë përballen me mundësi të kufizuara për angazhim kulturor dhe shprehje artistike, duke çuar në një boshllëk në mirëqenien dhe cilësinë e tyre të përgjithshme të jetës Mungesa e aksesit në një gamë të larmishme aktiviteteve artistike kufizon aftësinë e tyre për të eksploruar interesat personale, për t'u angazhuar në shprehje krijuese dhe për të përjetuar përfitimet pasuruese të artit Duke e ditur këtë, ekziston një nevojë urgjente për të prezantuar një program vjetor gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm që përfshin disiplina të ndryshme artistike	2026; puna përgatitore dhe plotësimi i Termave të Referencës për thirrjen e hapur, me qëllim përzgjedhjen e një kompanie OJQ për hartimin dhe zbatimin e një programi vjetor për të moshuarit në Prishtinë, krahas prokurimit të furnizimeve dhe materialeve të nevojshme për shtëpinë dhe qendrat e të moshuarve 2027; nisja dhe ekzekutimi i edicionit të parë të programit, duke shfaqur aktivitete javore si pjesë e orarit vjetor, duke përfshirë vizita, ekspozita dhe	2026; përfundimi i procesit të kontraktimit të një kompanie apo OJQ-je për hartimin dhe zbatimin e një programi vjetor për të moshuarit në Prishtinë 2026; sigurimi me furnizime arti në baza të rregullta për përdorim të pavarur nga banorët e shtëpive të të moshuarve dhe frekuentuesit e qendrës ditore 2026; nisja dhe ekzekutimi i suksesshëm i edicionit të parë të programit, duke shfaqur aktivitete javore si pjesë e orarit vjetor, duke përfshirë vizita, ekspozita dhe sesione kërcimi 2027; zbatimi i edicionit të dytë të programit, pas një vlerësimi gjithëpërfshirës të vitit të parë të programit për të informuar përmirësimet dhe rregullimet	Programi vjetor për të moshuarit në Prishtinë, i cili përfshin aktivitete të ndryshme javore dhe ofrimin e rregullt të mjeteve të artit, synon të nxisë angazhimin, pasurimin dhe mirëqenien mes banorëve të moshuar dhe pjesëmarrësve të qendrës ditore

				sesione kërcimi, etj		
				2028; zbatimi i edicionit të dytë të programit, pas një vlerësimi gjithëpërfshirës të vitit të parë të programit për të informuar përmirësimet dhe rregullimet		
Objektivi Strategjike 2: : E DREJTA PËR QYTETIN						
Udhëheqje demokratike për hapësirat publike						
Treguesit e ndikimit të objektivit strategjik 2:						
- Treguesit e ndikimit të objektivit strategjik 2: Rritja e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në qeverisjen lokale; forcimi i partneriteteve ndërmjet institucioneve publike, qytetarëve dhe sektorit civil; krijimi i hapësirave publike gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme; promovimi i diversitetit dhe barazisë në përdorimin e tyre; rivitalizimi dhe rritja e përdorueshmërisë së hapësirave publike; përmirësimi i kohezionit social dhe cilësisë së jetës; pozicionimi i Prishtinës si një qendër inovative urbane dhe kulturore; sigurimi i qëndrueshmërisë në zhvillimin urban dhe mirëqenies afatgjatë; rritja e dukshmërisë ndërkombëtare të qytetit.						
Intervenimet kryesore të strategjisë (masa)	Institucionet përgjegjëse	Buxheti ose lloji i veprimit	Lidhja e problemit / Shkakut me objektivin	Periudha e implementimit	Treguesi i produktit (autputeve)	Treguesit i rezultatit caku deri 2031
Objektivi specifik 2.1: Mundësimi i programimit kulturor i hapësirave publike në qytet përmes partneritetit publiko-qytetar						
2.1.1. Baza e të dhënave gjithëpërfshirëse e hapësirës publike të përpunuara dhe kodifikuara në platformën Gepgraphical Information System (GIS)	Komuna e Prishtinës, Specialistët e GIS Planifikuesit dhe Arkitektët Urban, Ofruesit e Teknologjisë, Qytetarët dhe Anëtarët e Komunitetit Drejtorja e Pronave, Drejtorja e Parqeve dhe Hapësirave Publike, Drejtorja e Kulturës	30,000 për e hapur platformën interaktive online	Mungesa e informacionit gjithëpërfshirës për hapësirat publike brenda Prishtinës, duke përguar shfrytëzimin efikas për aktivitetet kulturore dhe shfrytëzimin e komunitetit. Instrumentet institucionale, përmeshjen e funksioneve të nevojshme të komunës dhe ofrimin e shërbimeve publike transparente	2027	Zhvillimi i një baze të dhënash gjithëpërfshirëse të hapësirës publike Identifikimi dhe kategorizimi i të gjitha hapësirave publike brenda Prishtinës. Përfshirja e parqeve, shesheve, trotuareve, ndërtesave dhe parcelave të tokës në bazën e të dhënave Krijimi i një ndërfaqeje miqësore për përdoruesit për akses publik në bazën e të dhënave	Të gjitha hapësirat publike janë përpunuar në platformën Gepgraphical Information System (GIS) dhe janë kodifikuar. Rritja e transparencës dhe aksesueshmërisë së informacionit për hapësirat publike për të siguruar që qytetarët të kenë njohuri të mjaftueshme për përdorimin dhe menaxhimin e tyre. Fuqizimi i anëtarëve të komunitetit për të identifikuar hapësirat e përshtatshme për nismat e tyre duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive në proceset vendimmarrëse Forcimi i ndjenjës së angazhimit qytetar dhe pjesëmarrjes së tyre në zhvillimin urban për të siguruar që vendimet dhe projektet qeverisëse të përmeshin nevojat dhe preferencat e komunitetit. Përmirësimi i shfrytëzimit të hapësirave publike të pashfrytëzuara ose të neglizhuara për të krijuar ambiente të reja dhe të pasura kulturore për të gjithë banorët

2.1.2. Aktivizimi i hapësirave publike nëpërmjet partneritetit qytetar-publik	Komuna e Prishtinës CSOs	3000 per sherbimet ne vit	Përdorimi i kufizuar i pronës publike për interes publik nga organizatat e shoqërisë civile për shkak të kufizimeve ligjore ose mungesës së mjedisit të favorshëm	2026;	Krijimi i partneriteteve ndërmjet komunës dhe OSHC-ve kulturore. Aktivizimi i hapësirave publike si qendra të gjalla kulturore. Hapësirat ikonike të braktisura kthehen në të hapura dhe të aktivizuara	Krijimi i një modeli për bashkëpunimin e ardhshëm midis pushtetit lokal dhe organizatave të shoqërisë civile në zhvillimin kulturor për të siguruar një partneritet efektiv dhe të qëndrueshëm në këtë fushë. Përmirësimi i mirëqenies dhe cilësisë së jetës për banorët duke ofruar akses në ngjarje kulturore të përshtatshme dhe të cilësisë së lartë për të gjithë. Promovimi i kohezionit social dhe ndërveprimit ndërmjet grupeve të ndryshme të komunitetit përmes organizimit të aktiviteteve dhe ngjarjeve kulturore që inkurajojnë bashkëpunimin dhe solidaritetin
2.1.3. Adoptimi i rregullores së Prishtinës për përdorim të hapësirës komunale	Komuna e Prishtinës – Drejtoria e Kulturës Komuna e Prishtinës – Drejtoria e Shërbimeve Publike Organizatrat kulturore dhe OJQ-të	3000 për një kontratë për të zhvilluar udhëzime të qarta	Mungesa e qasjes dhe transparencës në lidhje me të drejtat e shfrytëzimit të hapësirave publike në Prishtinë Mungesa e udhëzimeve të qarta të aplikimit dhe një procesi i thjeshtuar për marrjen e të drejtave të përdorimit për hapësirat publike. Keqpërdorimi i mundshëm ose shpërndarja e pabarabartë e hapësirave publike për shkak të mungesës së kriterëve të mbikëqyrjes dhe vlerësimit		Krijimi i udhëzimeve të qarta të aplikimit për marrjen e të drejtave të përdorimit të hapësirave publike Krijimi i një komisioni të dedikuar për vlerësimin e aplikacioneve Zhvillimi i kriterëve të bazuara në interesin publik, qeverisjen demokratike, sigurinë e komunitetit dhe aksesin e hapur	Rritja e aksesit për individët dhe organizatat për të përdorur hapësirat publike, duke siguruar një qasje të lehtë dhe të barabartë për të gjithë. Niveli i transparencës në shpërndarjen e të drejtave të përdorimit të hapësirave publike, duke promovuar besimin dhe llogaridhënien në mes të qytetarëve dhe autoriteteve lokale Promovimi i parimeve demokratike në vendimmarrjen lidhur me përdorimin e hapësirës publike, duke inkurajuar pjesëmarrjen e komunitetit në proceset vendimmarrëse. Forcimi i ndjenjës së pronësisë dhe përgjegjësisë ndaj administrimit të hapësirave publike tek banorët, duke iu dhënë atyre rolin dhe përgjegjësinë e tyre për kujdesin dhe mirëmbajtjen e tyre. Përmirësimi i planifikimit dhe menaxhimit urban për të përafruar përdorimin e hapësirës publike me nevojat dhe preferencat e komunitetit lokal, duke siguruar një shërbim më efikas dhe të përshtatshëm për banorët
2.1.4. Riaktivizimi i Qendrës për Praktikë Narrative (ish - biblioteka “Hivzi Sylejmani” përmes partneritetit publiko - qytetar	Komuna e Prishtinës Bordi Mbikëqyrës i Manifesta 14 Prishtinë CSOs	N/A	Manifesta 14 Prishtina rinovoi me sukses, riaktivizoi dhe rivitalizoi ish- Bibliotekën e braktisur “Hivzi Sylejmani” në Qendër për Praktikë Narrative duke e shndërruar atë në një hapësirë për tregim dhe eksperimentim. Ajo funksionoi si një hapësirë bashkëpunimi dhe një vend parësor arti e kulturor në qytet, i bashkëkrijuar me komunitetin	2027	Konsultimet me Manifesta 14 Prishtinë, CCS - të lokale të artit dhe kulturës dhe rihapja përmes partneriteteve publiko - qytetare deri në vitin 2026	Krijimi dhe funksionimi i një institucioni kulturor në vazhdimësi, i hapur për të gjithë, që siguron akses për publikun në përgjithësi dhe ofron lehtësira të përbashkëta për shfrytëzimin e tij. Qendra për Praktikë Narrative vazhdon të angazhojë komunitetin dhe të mbështesë artet dhe kulturën lokale duke ofruar një sërë burimesh dhe hapësirash për projekte, ngjarje dhe aktivitete bashkëpunuese për të gjithë banorët

			Megjithatë, pavarësisht suksesit të saj, më 30 janar u njoftua se Qendra do të mbyllet përkohësisht deri në pranverë për shkak të mungesës së burimeve financiare			
Objektivi specifik 2.2. Rivitalizimi, përvetësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës ekzistuese për artin dhe kulturën për të adresuar nevojat e publikut						
2.2.1. Rivitalizimi dhe përshtatja e infrastrukturës ekzistuese të ish- objektit të Gërmisë në Qendrën Multikulturore të Gërmisë "Evropa" - GMCE	Komuna e Prishtinës ¹ MASHT	N/A Nevojitet studimi i fizibilitetit ² ³	Ish- ndërtesa e Gërmisë, e vendosur në një zonë qendrore kryesore, aktualisht kërkon rinovim për t'u bërë një institucion i qëndrueshëm Në gjendjen e tij aktuale, ai përfaqëson një mundësi të humbur të konsiderueshme, duke theksuar nevojën urgjente për investime në infrastrukturën kulturore	N/A	Zbatimi i restaurimit të zonës së trashëgimisë kulturore dhe ndërtimi i hapësirës së re, duke rinovuar 11, 400 metra katrorë brenda objektit ekzistues të trashëgimisë kulturore dhe duke ndërtuar një shtesë prej 3,550 metra katrorë. Sigurimi i menaxhimit efektiv të Qendrës Multikulturore Gërmia, duke iu përmbajtur praktikave më të mira për qeverisje kulturore dhe gjithëpërfshirëse	Sigurimi i burimeve të nevojshme nga qyteti për funksionimin e sallës së koncerteve dhe galerisë në mënyrë të vazhdueshme. Përkushtimi i qytetit për të zhvilluar një model të qëndrueshëm të qeverisjes, duke synuar të krijojë mjedise institucionale të mëdha dhe efikase për sallën e koncerteve dhe galerinë. Përdorimi i planifikimit strategjik dhe përfshirjes aktive të komunitetit për të siguruar që sala e koncerteve dhe galeria të arrijnë qëndrueshmëri afatgjatë dhe të kontribuojnë në pasurimin e peizazhit kulturor të qytetit
2.2.2. Rivitalizimi dhe përshtatja e Pallatit të Rinisë	Komuna e Prishtinës Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	N/A ⁴	Pallati i Rinisë dhe Sporteve është një hapësirë gjysmë e braktisur që kërkon urgjentisht ndërhyrje në shumë fusha, veçanërisht në infrastrukturë dhe mungesë të planifikimit strategjik të zhvillimit. Ky plan duhet të krijohet në bashkëpunim me publikun dhe të përfshijë një model biznesi pjesëmarrës I krijuar nga publiku dhe komuniteti lokal, sektorët e artit dhe kulturës do të formësojnë këtë plan biznesi përmes konsultimeve të gjera	N/A	2026; në fund të vitit 2026 fillon një proces konsultimi publik për planin e zhvillimit të biznesit dhe planifikimin strategjik për të ardhmen e Rinisë dhe Sportit. Angazhimi i komunitetit matet nga pjesëmarrësit në procesin e planifikimit dhe kënaqësia e publikut me rezultatet 2026; miratohet plani i zhvillimit të biznesit dhe plani strategjik 2027–2031; nisën dhe përfunduan rinovimet e identifikuar të infrastrukturës në seksione	Krijimi i një mjedisi të favorshëm për përpjekjet kulturore dhe artistike brenda Pallatit të Rinisë për të inkurajuar aktivitete të ndryshme artistike dhe kulturore. Sigurimi i hapësirave dhe burimeve të nevojshme për organizimin e ngjarjeve kulturore dhe artistike në Pallatin e Rinisë. Promovimi i përdorimit të Pallatit të Rinisë si një qendër kulturore dhe artistike të qytetit për të rritur pjesëmarrjen dhe interesin e publikut për këto aktivitete Mbështetja e inovacionit dhe krijimtarisë në sferën kulturore dhe artistike në kuadër të programit të Pallatit të Rinisë

¹ Sipas buxhetit të aplikuar për fondet IPA, ky është vlerësimi. Kostoja totale e parashikuar; 39 100 000 euro. Shuma totale e kontributit buxhetor të BE-së 24 000 000.00 euro. Ky veprim është bashkëfinancuar në bashkëfinancim të përbashkët nga: Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) për një shumë prej 1 500 000.00 euro. Ministria e Arsimit, Shkencë, Teknologji dhe Inovacion për një shumë prej 8 600 000.00 euro, Komuna e Prishtinës për një shumë prej 5 000 000.00 euro.

² Sipas (KASH-it të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve) 2024 - 2026, të Komunës së Prishtinës të dhënë nga Ministria e Financave (MF), të miratuar nga Qeveria e Kosovës, më 15 maj 2023, janë planifikuar për sallën e koncerteve në vitin 2024. (2,000,000 euro), 2025 (2,000,000 euro), 2026 (1,000,000 euro) që sipas grupit të ekspertëve për zhvillimin e strategjisë ka nevojë për një studim të saktë fizibiliteti.

³ Sipas propozimit të buxhetit 2024 për kuvendin_përfundimtar_9.8.2023 për vitin 2024, të komunës së Prishtinës janë ndarë 2 000 000 euro.

⁴ Në prill 2024 u nënshkrua një memorandum i mirëkuptimit midis MKRS dhe Pallatit të Rinisë për investime 5- vjeçare për 5 vjet.

					të veçanta të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve	
2.2.3. Rivitalizimi dhe përshtatja e Fabrikës së Tullave – në Tulltorja “Art Tek”	Komuna e Prishtinës	Konkursi ndërkombëtar për projektimin dhe transformimin e Tulltorja u fitua nga kompanitë Rafi Segal A+U (profesor i asociuar në MIT), ORG Permanent Modernity, OUD+Architects dhe artistja Marisa Moran Jahn, synojnë ta kthenin ish- fabrikën e tullave në Prishtinë në një pikë kulturore si një qendër për kreativitet dhe inovacion të quajtur “Art Tek” Tulltorja N/A⁵	Braktisja dhe deshtimi në perkujdesjen dhe mirembajtje të Fabrikës së Tullës - Tulltorja - si një pikë referimi e trashëgimisë industriale. Mungesa e hapësirave të komunitetit CCS për bashkëpunim, evente, prodhim Komuna e Prishtinës e ka blerë Tulltorja nga Agjencia e Privatizimit në vitin 2021, duke ia kthyer publikut. Që atëherë, ai është përdorur vetëm përkohësisht disa herë, dhe ende mbetet i pashfrytëzuar	N/A	Deri në vitin 2028 rinovimi dhe ndërtimi kanë përfunduar në vend Deri në vitin 2029 krijohet një organ qeverisës që përfshin përfaqësues të komunës, shoqërisë civile, artit dhe kulturës, industrive krijuese. Deri në vitin 2031, është krijuar një plan menaxhimi dhe faqja e “Art Tek” është aktive	Përdorimi i 70% të hapësirave të rinovuara dhe të sapondërtuara në Tulltorja “Art Tek” në mënyrë aktive për ngjarje kulturore, teknologjike dhe komunitare, duke sjellë një rritje të ndjeshme të aktiviteteve kulturore lokale dhe angazhimit të komunitetit. Miratimi i planit të menaxhimit të Tulltorja “Art Tek” dhe operacionalizimi i tij, siç dëshmohej nga raportet e progresit dhe vlerësimet e palëve të interesuara deri në vitin 2031
2.2.4. Rivitalizimi dhe adaptimi i Kino Rinisë	Komuna e Prishtinës	N/A⁶ ⁷ Sipas (Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve MTEF- 2024/2026)		N/A		Rigjallërimi i Kino Rinisë në një institucion udhëheqës për kinematografi, i zhvilluar nëpërmjet konsultimeve me publikun për të pasqyruar me saktësi gjendjen aktuale të kinematografisë në Kosovë si një çështje me interes publik Kontributi i Kino Rinia në pasurimin e peizazhit kulturor të qytetit me programe dhe ngjarje të ndryshme. Zgjerimi i përfshirjes dhe mundësive të bashkëpunimit për artistët dhe artistet e kinematografisë nëpërmjet Kino Rinisë. Zgjerimi i aksesit në filma të pavarur, histori, bashkëpunime dhe produksione ndërkombëtare dokumentare dhe kinematografi lokale përmes veprimtarive të Kino Rinisë

⁵ Sipas buxhetit të miratuar për vitin 2024 të komunës së Prishtinës janë ndarë 2 000 000 euro.

⁶ Sipas prezantimit në Forumin e Biznesit të Kosovës të mbajtur më 23-24-25 janar 2024, në Prishtinë, kryetari i Komunës, z. Rama, prezantoi një vlerë investimi prej 98,000,000 euro.

⁷ Sipas (Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve KASH- 2024/2026), të Komunës së Prishtinës të dhënë nga Ministria e Financave (MF), të miratuar nga Qeveria e Kosovës, më 15 maj 2023, janë planifikuar për Kino Rinia në vitin 2024. 500.000 euro), 2025 ((2.000.000 euro), 2026 (2.000.000 euro) që sipas grupit të ekspertëve për zhvillimin e strategjisë ka nevojë për një studim të saktë fizibiliteti.

2.2.5. Rivitalizimi dhe përshtatja e Shtëpisë së Kulturës në Hajvali	Municipality of Prishtina	200 000 Euro. Sipas (KASH Korniza e Afatmesme Shpenzimeve 2024/2026) të Komunës së Prishtinës	Shtëpia e Kulturës në Hajvali aktualisht ka mungesë të infrastrukturës dhe burimeve për të shërbyer si hapësirë kulturore dhe artistike	2027	Krijimi i hapësirës së montimit, ngjarjeve, ekspozitave, vendit të koncerteve dhe zonave për punëtori artistike dhe aktivitete më në qendër familjen. Miratohet plani i menaxhimit të Shtëpisë së Kulturës Hajvalia. Struktura qeverisësë e Shtëpisë së Kulturës Hajvalia është e vendosur	Rritja e aksesit në aktivitetet kulturore dhe artistike në zonën e Hajvalisë për të siguruar një pjesëmarrje më të gjerë dhe të barabartë të komunitetit në ngjarjet kulturore dhe artistike. Implementimi i një menaxhimi dhe qeverisjeje efektive të infrastrukturës së kulturës publike në zonën e Hajvalisë për të siguruar një përdorim më të mirë dhe të koordinuar të hapësirave kulturore dhe artistike për të gjithë banorët
2.2.6. Renovimi artistik dhe infrastrukturor i tunelit të kurrizit Dardani	Municipality of Prishtina	⁸ 400,000 euro, janë ndarë për rivitalizimin e "Kurrizit" në vitin 2024; 1 mil. EUR, do të ndahen deri në vitin 2026. Sipas (Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve KASH 2024/2026) të komunës Prishtinës	Neglizhimi i monumentit "Kurri" si hapësirë publike për shprehje artistike	2029	Shndërrimi i monumentit "Kurri" në një hapësirë publike për komunitetin, artin dhe kulturën, shfaqje në rrugë	Promovimi i artistëve vendas dhe iniciativave kulturore, duke kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm kulturor të komunitetit
Objektivi Specifik; 2.3. Zhvillimi i infrastrukturës së re për artin dhe kulturën						
2.3.1: Përmirësimi i qasshmërisë dhe gjithëpërfshirjes për persona me aftësi të kufizuara (PAK) Zhvillimi dhe përshtatja e infrastrukturës kulturore përmes investimeve kapitale, duke integruar standardet e aksesueshmërisë, dizajnit universal dhe gjithëpërfshirjes në të gjitha ndërhyrjet infrastrukturorë	Komuna e Prishtinës (Drejtoria e Kulturës, Drejtoria e Investimeve Kapitale), në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, organizatat e personave me aftësi të kufizuara (PAK) dhe partnerët zhvillimorë.	Investime kapitale dhe ndërhyrje infrastrukturorë, me integrim të komponentëve të aksesueshmërisë në projektet ekzistuese dhe të reja pa rritje disproporcionale të koston.	Përshtatshmëria e hapësirave Mungesa e infrastrukturës së përshtatshme dhe standardeve të aksesueshmërisë kufizon pjesëmarrjen e barabartë në jetën kulturore, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e tjera të nën-përfaqësuar.	2026–2031: 2026: hartimi i standardeve dhe auditimi i infrastrukturës 2027–2029: implementimi gradual 2030–2031: konsolidimi dhe monitorimi	Numri i objekteve kulturore të përshtatura Numri i ndërhyrjeve infrastrukturorë (rampa, ashensorë, sinjalistikë) Numri i institucioneve që zbatojnë standarde të aksesueshmërisë Numri i projekteve që integrojnë dizajnin universal	Rritja e aksesit në hapësira kulturore Rritja e pjesëmarrjes së PAK dhe grupeve të nën-përfaqësuar (%) Ulja e barrierave fizike dhe sociale Përmirësimi i përvojës së përdoruesve Caku (targeti) deri në vitin 2031 60% e infrastrukturës kulturore e aksesueshme

⁸ Sipas (Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve KASH- 2024/2026) të Komunës së Prishtinës të dhënë nga Ministria e Financave (MF), të miratuar nga Qeveria e Kosovës, më 15 maj 2023, janë planifikuar për Kurri në vitin 2024 (500,000 euro), 2025 ((500.000 euro), 2026 (500.000 euro). Sipas propozimit_buxheti_2024_për_kuvendin_përfundimtar_9.8.2023 për vitin 2024 të komunës së Prishtinës janë ndarë 400.000 euro.

						Rritje e pjesëmarrjes së grupeve të nën-përfaqësuar me ≥30%
2.3.2. Rivitalizimi dhe pasurimi kulturor i qendrave komunitare të fshatrave	Komuna e Prishtinës	N/A Nevoja për Studim Fizibiliteti	Aktualisht, në shumë fshatra të komunës së Prishtinës, ka mungesë të programeve kulturore për shkak të mungesës së hapësirave publike. Disa prej tyre janë të braktisura dhe të rrënuara, megjithëse ndodhen brenda qendrave të fshatrave. Ekzistojnë mundësi të kufizuara për aktivitete kulturore si teatri, vallet, shfaqjet folklorike dhe muzikore, duke çuar në një mungesë të peizazhit artistik dhe kulturor	2027	Deri në fund të vitit 2026, janë realizuar të paktën 24 ngjarje të konsultimit publik me fshatar për ripërdorimin e hapësirave në qendrat e fshatrave. Deri në vitin 2027, është zhvilluar një plan veprimi i detajuar për ripërdorimin e hapësirave në qendrat e fshatrave. Deri në vitin 2028, fondet ndahen nga qyteti dhe fillon puna në të paktën 2 fshatra për ripërdorimin e hapësirave specifike në qendrat e fshatrave për aktivitete kulturore	Rritje e pjesëmarrjes së komunitetit në zonat rurale në aktivitetet kulturore të Prishtinës. Qendrat komunitare të fshatrave janë ripërdorur me sukses për aktivitete kulturore si teatër, vallëzime, arte pamore, biblioteka ose hapësira takimi. Ndërgjegjësimi dhe përfshirja kulturore janë përmirësuar, me banorët që ndihen më të lidhur me trashëgiminë e tyre kulturore dhe komunitetin
5.1.6. Takime vjetore me qeverinë qendrore dhe donatorë ndërkombëtarë	Komuna e Prishtinës, qeveria qendrore dhe donatorët ndërkombëtarë	Instrumente institucionale	Mungesa e takimeve të rregullta me Qeverinë qendrore dhe donatorët ndërkombëtarë, mund të humbet mundësitë për të identifikuar dhe përfituar nga burimet financiare shtesë. Pa dialog të rregullt dhe takime të përbashkëta, mund të ketë mungesë përafrimi midis prioriteteve të financimit vendor dhe atyre të jashtëm. Kjo mund të çojë në përdorimin e subvencioneve në projekte që nuk janë në përputhje me nevojat dhe prioritetet e komunitetit lokal		Krijimi i takimeve vjetore me qeverinë qendrore dhe donatorë ndërkombëtarë. Bashkëpunim për të identifikuar kërkesat prioritare për financimin e projekteve kulturore. Financim suplementar i siguruar nga qeveria qendrore dhe donatorë ndërkombëtarë për të plotësuar burimet financiare lokale për zhvillimin kulturor	Identifikimi dhe përfitimi nga mundësitë shtesë të financimit, si dhe rritja e fondacioneve të disponueshme për sektorin kulturor në Prishtinë. Forcimi i partneriteteve ndërmjet komunës, qeverisë qendrore dhe donatorëve ndërkombëtarë në mbështetjen e zhvillimit kulturor. Diversitet dhe shkallë më e madhe e aktiviteteve dhe projekteve kulturore në qytet për shkak të rritjes së mundësive të financimit. Përmirësimi i infrastrukturës kulturore dhe komoditeteve për të mirën e banorëve dhe vizitorëve

Shtojca 2.

Dokumentet e politikave, legjislacioni dhe raporte hulumtuese;

- Buxheti i aprovuar për vitin 2020, Komuna e Prishtinës
- Buxheti i aprovuar për vitin 2021, Komuna e Prishtinës
- Buxheti i aprovuar për vitin 2022, Komuna e Prishtinës
- Buxheti i aprovuar për vitin 2023, Komuna e Prishtinës
- Buxheti i aprovuar për vitin 2024, Komuna e Prishtinës
- Korniza afatmesme buxhetore për vitet 2021-2023, Komuna e Prishtinës
- Korniza afatmesme buxhetore për vitet 2023-2025, Komuna e Prishtinës
- Korniza afatmesme buxhetore për vitet 2024-2026, Komuna e Prishtinës
- Statistikat e Kulturës, 2023, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
- Statistikat e Kulturës, 2022, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
- Statistikat e Kulturës, 2021, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
- Statistikat e arsimit në Kosovë 2022 - 2023

Legjislacioni;

- Ligjin nr. 08/L-245 për Artin dhe Kulturën.
- Ligjin nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës ,Prishtinën.
- Udhëzimin Administrativ (QRK) nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Përpilimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planet e Veprimit.
- Udhëzimin Administrativ (QRK) nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Përpilimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planet e Veprimit.
- Manualin për Zhvillim dhe Monitorim të Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit.
- Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.
- Ligjin nr . 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
- Ligjin nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën.
- Statuti i Komunës se Prishtinës, 2010.
- Koncept-dokumenti për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës se Paluajtshme të Komunës. Aprovuar më datën: 8.3.2023, nga Kryeministri Republikes se Kosoves.

Raportet hulumtuese;

- Pytesori i zhvilluar nga IETL, me titull “Përpilimi i Strategjisë për Artin dhe Kulturën në Prishtinë”, 2024.
- Plani i Zhvillimit Komunal të Prishtinës, Baza e të Dhënave e CHwB 2022, Studimi i Fizibilitetit për zonën historike nga UN-HABITAT dhe MCRS 2023.
- A Cultural Strategy for Albania, Implanting the Cultural Bug, march 2018, Philippe Kern.
- Challenges and Opportunities for the Independent Cultural Sector in Kosovo: Policy Paper EU financial Instruments for Culture, january 2015, Prishtina.
- City of London Cultural Strategy 2018 – 2022 , december 2017.
- Cultural Policy Peer Review of Serbia: Report of the Council of Europe Experts 1 Art and Culture, an Investment for Serbia’s Future Rapporteur: Philippe Kern 26 august 20152
- Cultural Policy Review of the Republic of North Macedonia, Towards a Strategy for Heritage and the Development of Culture and Creative Industries (Online Peer Review, december 2020), Author: Philippe Kern, Founder and Managing Director, KEA European Affairs (Lead Expert).
- Arts & Culture: Supporting Equitable Access and Participation in Arts Throughout Chicago’s 77 Countries.
- Chicago Cultural Vision: Strategy, Imagination, Planning, Ideas to Action, october 2022.
- Forumi Kulturor, Hapësirat kulturore te Kosovës, 2022.
- Hulumtim i Politikave Qeverisëse në Kulturë në Kosovë, korrik 2014.
- Kultura, Arti dhe Zhvillimi Ekonomik: Raport i Debatit - Rrjet i Organizatave të Pavarura të
- Kulturës të Kosovës, qershor 2014, Prishtinë, www.forumikulturor.net.
- Program Razvoja Kulture Grada Zagreba 2024 - 2030, dhjetor 2023.
- Raport Hulumtimi i Skenës Kulturore të Kosovës, Programi Kultura për Ndryshim financohet nga Bashkimi Evropian, menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatohet nga Qendra Multimedia dhe Goethe-Institut, Prishtinë / Priština, 2020.
- Strategjia e Zhvillimit të Turizmit, Komuna e Prishtinës 2018.
- Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 –2026, Ministria e Kulturës, Republika e Shqipërisë.

- Understanding Creative Industries: Their definitions, Models, Measurements and Drivers.
- Buxheti Shtetëror për Kulturën- Raport i Fokus Grupit, Forumi Kulturor qershor 2014, Prishtinë.
- Plani i Veprimit për Qytetin e Gjellbër, Prishtinë, Komuna e Prishtinës, gusht 2021.

Shtojca 3.

Lista e kontribuesve;

Lista e kontribuesve përmes punëtorive, intervistave dhe takimeve (shënim sipas renditjes alfabetike)

- Adelina	Paloja
- Adrian	Berisha
- Afërdita	Statovci
- Agim	Sopi
- Agon	Ahmeti
- Agon	Shyti
- Ajete	Kërqeli
- Alban	Goranci
- Albulena	Bokshi
- Amalia	Koleka
- Anyla	Kabashi
- Aranit	Krasniqi
- Arba	Hatashi
- Arbana	Hajredinaj
- Arbër	Salihu
- Arbër	Selmani
- Arbnor	Dragaj
- Ari	Zharku
- Arif	Muharremi
- Aron	Dobroshi
- Arsim	Sfishta
- Arta	Agani
- Arta	Selimi
- Arta	Jashari
- Arta	Balaj
- Artan	Balaj
- Artrit	Bytyçi
- Avni	Krasniqi
- Bajram	Kinolli
- Bardha	Meta
- Ben	Apolloni
- Berin	Hasi
- Berna	Saraçi
- Besa	Rugova
- Besa	Luzha
- Besa	Zogaj Gashi
- Besiana	Blakaj
- Bjeshkë	Guri

- Blend	Bytyqi
- Blerta	Ismaili
- Blerta	Hashani
- Dardan	Hoti
- Dardan	Zhegrova
- Dardan	Selimaj
- Diellza	Gosalci
- Diellza	Mehmeti
- Diora	Binxhiu
- Don	Shala
- Donjetë	Murati
- Dren	Maliqi
- Dren	Suldashi
- Dren	Abazi
- Driton	Selmani
- Diona	Budima
- Edis	Agani
- Edon	Muhaxheri
- Edon	Ramadani
- Edon	Zeneli
- Edvin	Susuri
- Elfie	Beqiri
- Elikona	Hysaj
- Eliza	Hoxha
- Endrit	Zabërgja
- Engjëll	Berisha
- Enis	Bytyqi
- Enkelejda	Shatri
- Era	Qena
- Ermir	Zhinipotoku
- Eroll	Murati
- Erza	Kurti
- Esat	Ramadani
- Eshref	Qahili
- Fadil	Hysaj
- Fat	Gjakova
- Fatlum	Neziri
- Fatmir	Mustafa
- Fatos	Berisha
- Fatos	Hoxha
- Fis	Cahani
- Fisnik	Ismaili
- Fitore	Berisha
- Florida	Gashi
- Gaz	Ejupi
- Gresa	Nuredini

- Hana	Zeqa
- Idila	Ibrahimi
- Ilir	Dalipi
- Ilir	Tolaj
- Ismail	Myrseli
- Ismet	Sijarina
- Jehona	Sopi
- Jehona	Shyti
- Jeta	Çitaku
- Jeta	Dumnica
- Kaltërinë	Shala
- Kaltrina	Thaçi
- Kamuran	Goranci
- Kaonë	Duriqi
- Korab	Krasniqi
- Kushtrim	Dushi
- Klodeta	Krasniqi
- Laureta	Hajrullahu
- Leart	Rama
- Lekë	Rezniqi
- Leutrim	Fishekqiu
- Likanë	Cana
- Linda	Mustafa
- Lindita	Hajdari
- Lindita	Hajdari
- Lindita	Cervadiku Dibra
- Luan	Durmishi
- Lule	Ballata
- Lumnije	Kadriu
- Lumturie	Krasniqi
- Majlinda	Hoxha
- Marigona	Bekteshi
- Merita	Dragaj
- Mirjeta	Qehaja
- Mjellmë	Istrefi
-Muhamer	Hasani
- Musa	Kalaveshi
- Naim	Spahiu
- Nita	Zeqiri
- Nita	Qahili
- Nita	Qena
- Njomza	Dragusha
- Nol	Binakaj
- Nuredin	Ibishi
- Orhan	Ramadani
- Pellumb	Bajqinovci

- Petrit	Reçica
- Philippe	Kern
- Pranvera	Hoxha - Bryma
- Premtime	Preniqi
- Qëndresa	Zeka
- Rebeka	Qena
- Renea	Begolli
- Rina	Gosalci
- Rina	Statovci
- Rona	Nishliu
- Rozafa	Maliqi
- Rozafë	Imami
- Rrezarta	Basha
- Rrezarta	Gashi
- Reze	Kryeziu - Breznica
- Reze	Kurteshi
- Rudina	Hasimja
- Sali	Shoshi
- Sami	Isufi
- Selvete	Shala
- Shkamb	Jaka
- Shpat	Shkodra
- Simon	Kurti
- Skender	Boshtrakaj
- Tanju	Sülejman
- Taulant	Hoxha
- Tringa	Sefedini
- Uran	Badivuku
- Valdet	Rama
- Valon	Ibraj
- Valton	Beqiri
- Vanesa	Orana
- Vatra	Abrashi
- Vesa	Bunjaku
- Vlora	Hajdini – Hajrullahu
- Vullent	Sanaja
- Ylber	Havolli
- Zake	Prelvukaj
- Zana	Maxhuni



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), neneve 19, 22 dhe 28 të Udhëzimit administrativ (MAPL), nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna, nenit 32, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 2026, merr këtë

V E N D I M
PËR VËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

1. Miratohet fillimi i procedurave për vënie në diskutim publik për ndryshim-plotësimin e Rregullores së orarit të punës dhe mbrojtjes nga ndotja akustike në sektorin e gastronomisë, 01-11004-27721822, të datës 29.12.2022.
2. Organizimi i diskutimit publik do të bëhet sipas Udhëzimit administrativ (MAPL), nr. 04/2023, për administratë të hapur në komuna;
3. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, diskutimi publik do të zgjatë 15 ditë kalendarike, nga data e shpalljes së njoftimit publik për mbajtjen e konsultimeve;
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit, respektivisht zyrtari përgjegjës për koordinimin e konsultimit publik;
5. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e kryeqytetit.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
2026

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës



Opština Priština –Municipality of Prishtina

NDRYSHIM PLOTËSIMI I R R E G U L L O R E S
PËR ORARIN E PUNËS DHE MBROJTJEN NGA NDOTJA AKUSTIKE NË
SEKTORIN E GASTRONOMISË

Prishtinë, 2026

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c, nenit 17, pika e, f dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika a të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenit 3 dhe 5 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 5 të Ligjit nr. 02/L-102 për mbrojtje nga zhurma, nenit 7 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, si dhe mbështetur në pikën a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më _____, miratoi këtë

RREGULLORE PËR ORARIN E PUNËS DHE MBROJTJEN NGA NDOTJA AKUSTIKE NË SEKTORIN E GASTRONOMISË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Me këtë rregullore përcaktohet orari i punës për subjektet afariste në sektorin e gastronomisë si dhe parandalimi dhe shmangia e efekteve të dëmshme, duke përfshirë bezdisjen e qytetarëve si rezultat i ekspozimit të zhurmës së krijuar si pasojë e ndotjes akustike nga sektori i gastronomisë brenda kufijve administrativ të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës (mëtej: Kryeqyteti).
2. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e orarit të punës dhe të nivelit të lejuar të zhurmës për subjektet që ushtrojnë veprimtari në sektorin e gastronomisë, dhe në asnjë rast nuk rregullon apo nuk mund të interpretohet se rregullon mënyrën e operimit të subjekteve, organizimin e tyre të brendshëm, aspektet e sigurisë, apo çfarëdo elementi tjetër që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë. Përgjegjësia për respektimin e legjislacionit në fuqi në këto fusha mbetet ekskluzivisht tek subjektet përkatëse dhe institucionet kompetente, sipas ndarjes së përgjegjësisë të përcaktuara me ligj.

Neni 2 Fushëveprimi i Rregullores

Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të zbatueshme ndaj të gjitha subjekteve afariste të sektorit të gastronomisë të cilat operojnë në territorin administrativ të Kryeqytetit.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet dhe përkufizimet e mëposhtme për qëllime të kësaj rregulloreje kanë këtë kuptim:

1.1. **Sektori i gastronomisë** - përfshin por nuk kufizohet në subjekte afariste si në vijim: kafene, resturane, bare, klube të natës dhe hapësira të gastronomisë në kuadër të lokaleve që ushtrojnë veprimtari të ndryshme.

1.2. **Zonat** - në të cilat mund të ushtrohet veprimtaria, sipas orarit të përcaktuar në këtë Rregullore, përfshijnë: zonën urbane, zonën industriale dhe zonën rurale, ashtu siç përcaktohet në shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.

II. ORARI I PUNËS

Neni 4

Orari i punës në sektorin e gastronomisë

1. Subjektet afariste të sektorit të gastronomisë janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore.
2. Orari i punës nënkupton periudhën kohore për fillimin dhe mbarimin e punës, rrjedhimisht shërbimit/shitjes për konsumatorë. Subjektet afariste marrin kohën prej maksimumin 45 minuta para dhe pas orarit të punës/shërbimit për të hapur dhe mbyllur lokalet.
3. Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar me këtë Rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin ushtrohet veprimtaria e biznesit. Në orar të punës duhet cekur ditët kur nuk punohet.

Neni 5

Periudhat kohore

1. Orari i punës përcaktohet në bazë të llogaritjes verore dhe dimërore, në intervale kohore:

- 1.1. periudha verore fillon më 1 prill dhe mbaron më 30 shtator;
- 1.2. periudha dimërore fillon më 1 tetor dhe mbaron më 31 mars.

Neni 6 Orari i rregullt ditor

1. Orari i punës në *kafene* dhe *restaurane*, pavarësisht zonës, duhet të jetë brenda kornizave kohore 07:00-24:00, në periudhën verore dhe dimërore.

2. Pavarësisht orarit nga paragrafi 1 i këtij neni, Kryetari i Kryeqytetit me vendim të veçantë mund të lejojë zgjatjen e orarit edhe për 2 (dy) orë shtesë, me decibelë të njëjtë, gjatë periudhës 15 korrik – 15 gusht, 20 dhjetor – 10 janar dhe në ditët e festave.

3. Orari i punës në *klube të natës* duhet të jetë brenda kornizave kohore, sipas zonave të caktuara:

3.1. periudha verore, në zonë urbane prej orës 24:00–03:00 përveç të premteve dhe të shtuneve, prej orës 24:00–05:00, dhe në zonë industriale dhe rurale prej orës 24:00–05:00, përveç të premteve dhe të shtuneve prej orës 24:00–08:00;

3.2. periudha dimërore, në zonë urbane prej orës 23:00–02:00 përveç të premteve dhe të shtuneve prej orës 24:00–04:00 dhe në zonë industriale dhe rurale prej orës 23:00–04:00 përveç të premteve dhe të shtuneve prej orës 24:00–05:00.

4. Orari i punës në *hapësira të gastronomisë në kuadër të subjekteve afariste* që ushtrojnë veprimtari të ndryshme (psh. hotele, motele, salla dasmash, pompa të benzinës, qendra rekreative etj.) duhet të jetë brenda kornizave kohore:

4.1. periudha verore, prej orës 06:00-24:00

4.2. periudha dimërore, prej orës 07:00-24:00

5. Përfshihet nga paragrafi 4 i këtij neni, subjektet në fjalë mund të punojnë në orare të veçanta sipas kërkesës dhe aprovimit nga organi komunal kompetent.

6. Për qëllime të këtij neni, hapësirat e gastronomisë (hotele, motele etj) të cilat organizojnë ndeja të shoqëruara me muzikë pas orës 24:00, konsiderohen klube nate dhe për to do të aplikohen rregullat për klubin e natës.

7. Kafenetë, restorantet dhe subjektet e tjera, të cilat sipas kësaj rregulloreje punojnë me orar të rregullt deri në ora 24:00, në raste të veçanta kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për punë me orar të zgjatur për një periudhë prej 1 (një) deri në 7 (shtatë) ditë brenda vitit kalendarik.

Orari i zgjatur nënkupton ushtrimin e veprimtarisë deri në ora 02:00.

Taksa për shfrytëzimin e orarit të zgjatur është 300 (treqind) euro për secilën ditë të miratuar.

Kërkesa për orar të zgjatur duhet të dorëzohet së paku 5 (pesë) deri në 7 (shtatë) ditë pune para datës së fillimit të periudhës së kërkuar.

8. Organet përkatëse të Kryeqytetit kujdesen që pas orarit të punës të subjekteve afariste në Lagjet rezidenciale (zona miks sipas shtojcës 1 të kësaj rregulloreje) të mos bezdisen nga zhurma nga qytetarët. Me këtë rast organet përkatëse të Kryeqytetit përdorin mekanizmat institucional brenda kompetencave ligjore (mbyllja e përkohshme për kalim e rrugëve specifike, angazhim i policisë në pika me frekuentim të shpeshtë, etj.).

Neni 7

Taksa për punën gjatë orarit të natës

1.Subjektet afariste – *klubet e natës*, të cilat sipas kësaj Rregulloreje kanë të drejtë të punojnë pas orës 24:00, janë të obliguara të paguajnë taksën e njëhershme në vlerë prej 10,950 euro për vit.

2.Të gjitha subjektet afariste të përcaktuara në paragrafin 4 të nenit 6, të cilat sipas kësaj Rregulloreje kanë të drejtë të punojnë pas orës 24:00 janë të obliguara që të paguajnë taksën e njëhershme në vlerë prej 3,650 euro për vit.

1. MASAT MBROJTËSE NGA NDOTJA AKUSTIKE

Neni 8

Masat për mbrojtjen nga ndotja akustike

Me këtë rregullore përcaktohen masat për mbrojtjen nga ndotja akustike duke përfshirë decibelët e lejuar, pajisjet për matjen e burimit të zhurmës së emituar jashtë (ndotje) dhe gjobat në sektorin e gastronomisë në territorin e Kryeqytetit.

Neni 9

Ndotja akustike

Ndotje akustike janë zërat e padëshiruar që emetohen jashtë, të bezdisshëm ose të dëmshëm, të krijuar nga aktivitetet njerëzore duke përfshirë zhurmën e emetuar nga vendet e aktiviteteve të subjekteve afariste që ofrojnë shërbime të gastronomisë.

Neni 10

Indikatorët e zhurmës

1. Burimet e zhurmës janë çdo vibracion i detektuar nga veshi i njeriut, i shkaktuar nga ndonjë mjet apo aktivitet i njeriut.
2. “Lden” – indikator i zhurmës – ditë – mbrëmje – natë, indikator i zhurmës për shqetësimin e përgjithshëm nga zhurma.
3. “Lditë” – indikator i zhurmës gjatë ditës, indikator i zhurmës për shqetësimin nga zhurma gjatë ditës.
4. Lmbrëmje – indikator i zhurmës gjatë mbrëmjes, indikator i zhurmës për shqetësimin nga zhurma gjatë mbrëmjes.
5. Lnatë – indikator i zhurmës gjatë natës, indikator i zhurmës për shqetësimin nga zhurma gjatë natës.

Neni 11

Masat mbrojtëse nga ndotja akustike

1. Me masat e mbrojtjes nga ndotja akustike pengohet paraqitja e zhurmës, gjegjësisht zvogëlohet zhurma ekzistuese në nivel optimal, deri në masën që nuk shkakton shqetësim për qytetarët.
2. Mbrojtja nga ndotja akustike aplikohet ditën, në mbrëmje dhe natën. Dita zgjatë 12 orë dhe fillon nga ora 07:00 deri 19:00, mbrëmja zgjatë 3 orë dhe fillon nga ora 19:00 deri 22:00, kurse nata zgjatë 9 orë dhe fillon nga ora 22:00 deri në ora 07:00 në mëngjes.
2. Të gjitha pajisjet për matjen e nivelit të zhurmës së emituar në ambientet e jashtme (sipër, përreth, poshtë) duhet të mbajnë etiketën CE, shenjën, shkallën e garantuar të fuqisë së zhurmës dhe të jenë të shoqëruara me deklaratën CE të konformitetit.

Neni 12

Pajisjet për matjen e nivelit të zhurmës

1. Kryeqyteti duhet që ti siguroj pajisjet për matjen e nivelit të zhurmës të cilat masin zhurmën e emituar në ambientet e jashtme (sipër, përreth, poshtë), të cilat duhet të mbajnë etiketën CE, shenjën, shkallën e garantuar të fuqisë së zhurmës dhe të jenë të shoqëruara me deklaratën CE të konformitetit.
2. Kryeqyteti duhet të krijojë bazën me të dhënat e subjekteve afariste në sektorin e gastronomisë në territorin e saj, në bazë të së cilës do të bëhet shpërndarja e pajisjeve për matjen e nivelit të zhurmës.
3. Në lokalet e një subjekti afarist, Kryeqyteti duhet të vendosë aq pajisje sa sigurojnë matjen efektive të nivelit të zhurmës nga secili pozicion, të përcaktuar me ekspertizë për mbulimin e nevojshëm të matjes efektive të nivelit të zhurmës të emituar jashtë.

Neni 13

Obligimi për pajisje me certifikatë për nivelin e decibelëve të lejuar

1. Çdo subjekt afarist i sektorit të gastronomisë është i obliguar të pajiset me certifikatë nga drejtoria përkatëse e shërbimeve publike, dhe me të cilin përcaktohet:
 - 1.1. Niveli i decibelëve të lejuar sipas vlerave të përcaktuara në Shtojcën 2 të kësaj Rregullore;
 - 1.2. Obligimi për vendosjes se pajisjes për matje;
 - 1.3. Taksa e njëhershme në vlerë 180 euro për një pajisje që mbulon shpenzimet e pajisjes, mirëmbajtjes së saj dhe dërgimin e inspektorit në rast të shkeljes me pasojë dëmtimi të pajisjes;
 - 1.4. Data e lëshimit kur hyn në fuqi matja e nivelit të zhurmës, në pajtim me procedurat si dhe kushtet tjera eventuale të përcaktuara me dispozitat e kësaj rregullore.
3. Çdo subjekt afarist obligohet që këtë certifikatë ta vendosë në një vend të dukshëm në hapësira të lokalit.

Neni 14

Procedura e aplikimit për certifikatë dhe pajisje për matjen e zhurmës

1. Secili subjekt afarist, që hapet i ri pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të jetë i pajisur me certifikatë dhe pajisje për matjen e zhurmës në momentin e fillimit të punës.

2.Kryeqyteti obligohet që brenda afatit prej 30 ditësh, nga koha e aplikimit të subjektit afarist, të pajisë të njëjtin me pajisje/et dhe me certifikatën që përcakton nivelin maksimal të lejuar të zhurmës.

Neni 15

Obligimet e subjektit afarist dhe personit përgjegjës të subjektit afarist

- 1.Personi përgjegjës i subjektit afarist (lokaleve) janë të obliguar që të lejojnë montimin e pajisjeve për matjen e nivelit të zhurmës në hapësirat e subjektit të tyre afarist. Të njëjtët nuk guxojnë ti dëmtojnë apo të marrin veprime të cilat pengojnë këto pajisje që të bëjnë matjen e nivelit të zhurmës.
2. Personi përgjegjës i subjektit afarist në sektorin e gastronomisë duhet të kujdeset që pajisjet për matjen e nivelit të zhurmës të mos dëmtohen nga palët e treta. Përgjegjësinë e dëmtimit nga palët e treta e merr Personi përgjegjës i subjektit afarist.
- 3.Në rast të ndonjë dëmtimi të pajisjes, që të njëjtën e bën jo funksionale, Personi përgjegjës i subjektit afarist obligohet që brenda afatit prej 24 orëve të njoftojë drejtorinë përkatëse për shërbime publike dhe të kërkojë zëvendësimin e pajisjes, duke e paguar taksën prej 180 euro për pajisjen e re. Kryeqyteti obligohet që më së largu brenda 72 orësh të vendosë pajisjen e re.
- 4.Në rast se konstatohet se dëmtimi i pajisjes ka qenë i qëllimshëm, Personi përgjegjës i subjektit afarist obligohet që brenda afatit prej 24 orëve të njoftojë drejtorinë përkatëse për shërbime publike dhe të kërkojë zëvendësimin e pajisjes, duke e paguar taksën prej 180 euro për pajisjen e re dhe gjobën e përcaktuar në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje. Kryeqyteti obligohet që më së largu brenda 72 orësh të vendosë pajisjen e re.
5. Për qëllime të kësaj rregulloreje, personi përgjegjës i subjektit afarist e ka kuptimin sikurse është përkufizuar në nenin 24 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje dhe me nenin 24 paragrafi 3 të Ligji Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare.

Neni 16

Përmbajtja e të dhënave të softuerit

1. Pajisja për matjen e zhurmës monitorohet nga një sistem softueri, të dhënat e të cilit do të mbeten pronë intelektuale e Kryeqytetit dhe përdoren në pajtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Softueri duhet të përmbajë dhe t'i ofrojë të dhënat si në vijim:
 - 2.1. Nivelin e tejkualuar të zhurmës në lokalin përkatës;
 - 2.2. Datën dhe kohën e tejkualimit të nivelit të zhurmës; dhe
 - 2.3. Vendin dhe të dhënat e subjektit afarist.
3. Softueri duhet të ruaj në kohë reale të dhënat, përfshirë nivelin e zhurmës së emituar jashtë për çdo sekond, dhe në kohë reale të njoftoj Personin përgjegjës i subjektit afarist për kujdes në tejkualimin e afërt të zhurmës dhe në momentin e tejkualimit të nivelit të lejuar të zhurmës sipas paragrafit 1 të këtij neni.
4. Subjektet afariste do të kenë pamjen e veçantë në softuer për të parë nivelin e zhurmës së shkaktuar nga ta ku edhe njoftohet kur është afër tejkualimit të nivelit të lejuar të zhurmës apo veçse është tejkualuar i njëjti. Niveli i zhurmës së emituar nga të gjitha subjektet afariste, pa të dhëna personale, do të mund të shfaqen në një hartë publike ku shihen nivelet sipas zonave në kohë reale.

Neni 17

Tejkualimi i nivelit të lejuar të zhurmës

1. Tejkualimi i nivelit të lejuar të zhurmës, sipas vlerave të përcaktuara në certifikatën e lëshuar për subjektin afarist, në kohë mesatarisht pa ndërprerje mbi 5 minuta, konsiderohet shkelje.
2. Nëse brenda periudhës 5 orë, tejkualimi i nivelit të lejuar të zhurmës përsëritet të paktën tri herë, edhe atë në intervale më të gjata se 2 minuta, gjithashtu konsiderohet shkelje.

Neni 18

Tejkualimi i lejuar për raste të veçanta

Me rastin e plotësimit të nevojave për organizimin e aktiviteteve të veçanta të gastronomisë në hapësira publike, në rastet kur ekzistojnë mundësitë e tejkualimit të nivelit të zhurmës së lejuar, Drejtoria kompetente për Shërbime Publike, mund të lejoj

tejkalimin e decibelëve të lejuar, duke caktuar nivelin e decibelëve për atë aktivitet dhe lokacionin e përshtatshëm për qëllime të tilla.

IV. AUTORIZIMET E DREJTORISË SË INSPEKSIONIT

Neni 19

Ndërmarrja e masave dhe veprimeve nga Inspeksioni

1. Drejtoria e Inspeksionit të Kryeqytetit, varësisht nga shkeljet e evidentuara, në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, ndërmerr masa dhe shqipton gjoba për shkelësit e evidentuar, duke u bazuar në të dhënat që sigurohen nga softueri.

2. Në rastet kur softueri lajmëron ndërprerjen e funksionit të pajisjes, Inspeksioni duhet të vizitojë subjektin afarist për të konstatuar nëse pajisja është dëmtuar qëllimshëm dhe të merr masat dhe veprimet adekuate në rast të konstatimit të shkeljes.

Neni 20

Autorizimet e inspektorit për respektimin e orarit të punës dhe të nivelit të zhurmës

1. Gjatë ushtrimit të detyrës, inspektori i është i autorizuar:

- 1.1. Të konstatojë shkeljen e dispozitave të *orarit të punës* në bazë të kësaj rregulloreje përmes kontrollit të drejtpërdrejtë;
- 1.2. Të konstatojë shkeljen e dispozitave të *nivelit të zhurmës* përmes të dhënave të cilat sigurohen vetëm nga softueri. Për sa i përket nivelit të zhurmës, inspektori nuk ka të drejtë të kontrollit të drejtpërdrejtë dhe as nuk mund të shfrytëzoj mjete tjera për matjen e zhurmës, përveç mjetit/et të autorizuar që vendoset në lokalin afarist.
- 1.3. Të urdhëroj ndërmarrjen e masave të menjëhershme për evitimin e shkeljes së konstatuar;
- 1.4. Të urdhëroj subjektin afarist, përkatësisht personin e autorizuar të të njëjtit, që të respektojë orarin e punës të përcaktuar me këtë rregullore;
- 1.5. Të urdhëroj subjektin afarist, përkatësisht personin e autorizuar të të njëjtit, që të ndërpresë përdorimin e burimit që shkakton zhurmë përtej nivelit të lejuar të zhurmës;
- 1.6. Të ndërmarr të gjitha masat ndëshkuese dhe të shqiptojë gjobë për mosrespektim të orarit të punës apo për tejkalim të nivelit të përcaktuar të zhurmës, në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

VI. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 21 Kundërvajtjet

1. Inspektori i inspektoratit të Kryeqytetit, ka të drejtë që të shqiptoj gjobat në pajtim me legjislacionin në fuqi. Për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje, varësisht nga niveli i shkeljeve dhe në përputhje me rrethanat ku ndodhë shkelja, do të shqipton gjobat në vlerë minimale prej 500 euro dhe në vlerë maksimale prej 5,000 euro.
2. Duke marr parasysh vlerën minimale dhe maksimale të gjobave të përcaktuara me këtë Rregullore, Inspektori i inspektoratit të Kryeqytetit, me rastin e shqiptimit të gjobave duhet t'i vlerësoj rrethanat dhe gjobat t'i shqiptoj duke filluar nga vlerat minimale për shkeljet e evidentuar. Në rastet kur përsëriten shkeljet dhe kemi edhe rrethana tjera renduese, gjobat duhet të shqiptohen në ekuivalencë me shkeljen e evidentuar.
3. Gjobat e përcaktuara për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje, janë si në vijim:
 - 3.1.Me gjobë prej 500 deri në 2,000 euro do të dënohet subjekti afarist i cili nuk e ka respektuar orarin e përcaktuar të punës, të përcaktuar me nenin 6 të kësaj Rregullore;
 - 3.2.Me gjobë prej 3,000 deri në 5,000 euro do të dënohet subjekti afarist i cili nuk ka aplikuar dhe rrjedhimisht nuk është pajisur me certifikatën për përcaktimin e nivelit të decibelëve, si dhe nuk ka marrë pajisjet për matjen e zhurmës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 13 të kësaj Rregullore;
 - 3.3.Me gjobë prej 3,000 deri në 5,000 euro do të dënohet subjekti afarist i cili pengon montimin e pajisjeve për matjen e zhurmës në hapësirat e subjektit afarist apo merr veprime të cilat i pengojnë këto pajisje që të bëjnë matjen e nivelit të zhurmës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 15, paragrafi 1, i kësaj Rregulloreje;
 - 3.4.Me gjobë prej 3,500 deri në 5,000 euro do të dënohet subjekti afarist i cili ka dëmtuar qëllimisht pajisjen për matjen e zhurmës, ashtu siç është përcaktuar në nenin 15 paragrafi 4 i kësaj Rregulloreje.
 - 3.5.Me gjobë prej 1,000 deri në 3,000 euro do të dënohet subjekti afarist i cili ka tejkaluar nivelin e përcaktuar të decibelëve të lejuar sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe rrjedhimisht ka shkaktuar zhurmë.
 - 3.6.Me gjobë prej 3,000 deri në 5,000 euro do të dënohet organizatori i aktiviteteve të veçanta të gastronomisë në hapësira publike, i cili ka tejkaluar nivelin e decibelëve të

lejuar për aktivitete te veçanta, ashtu siç është përcaktuar me nenin 18 të kësaj Rregulloreje.

4. Në rastet e përsëritjeve të shkeljeve dhe kur Inspektori e vlerëson gjendjen, mund të ndalojë kryerjen e veprimtarisë së caktuar personit fizik apo juridik me urdhëresë, në kohëzgjatje më së shumti prej 8 ditësh.
5. Për të gjitha procedurat e shqiptimit të kundërvajtjeve, mënyrës dhe afateve të pagesës së gjobave, si dhe procedurave tjera lidhur me gjobat të cilat nuk janë rregulluar me dispozitat e kësaj Rregullore, vlejnë dispozitat e Ligjit për Kundërvajtjet.

VII. PROCEDURA E ANKESËS

Neni 22

E drejta dhe procedura e ankesës

1. Kundër vendimit të lëshuar nga inspektori, mund të ushtrohet ankesë pranë komisionit për shqyrtimin e ankesave në Kryeqytet, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimi të aktit administrativ.
2. Procedurat dhe afatet lidhur me trajtimin dhe vendosjen e ankesave nga ana e komisionit për shqyrtimin e ankesave zhvillohen në përputhje me dispozitat e Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative.
3. Përjashtimisht nga pika 2 e këtij neni, në rastin e shqyrtimit dhe vendosjes së ankesës kundër ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë deri në 8 ditë, komisioni për shqyrtimin e ankesave në Kryeqyteti vendos brenda afatit prej njëzet e katër (48) orësh nga dita e pranimi të ankesës.
4. Ankesa e palës, e drejtuar në Gjykatën kompetente, kundër vendimit të Komisionit, nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit të inspektorit.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE HYRJA NË FUQI

Neni 23

Dispozitat shfuqizuese dhe kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohen dispozitat e Rregullores për Orarin e Punës si dhe vendimi i Kuvendit të Komunës së Prishtinës që përcakton orarin e punës për subjektet afariste të gastronomisë, e që përcaktohen me këtë Rregullore.
2. Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, subjektet afariste që janë aktive duhet të aplikojnë brenda afatit prej 30 ditësh pranë Drejtorisë përkatëse të Shërbimeve Publike në Kryeqytet, që të pajisen me certifikatën e cila përcakton nivelin maksimal të lejuar të decibelëve, si dhe me pajisjen për matjen e zhurmës.
3. Kryeqyteti obligohet që brenda afatit prej 30 ditësh të pajisë subjektin afarist me pajisje/t dhe me certifikatën që përcakton nivelin maksimal të lejuar të zhurmës.
4. Prej momentit të hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje e deri me 31 mars 2023, konsiderohet periudhë e vetëdijesimit dhe informimit për subjektet afarist, brenda së cilës periudhë nuk do të aplikohen masat dhe gjobat e parapara me këtë rregullore.

Neni 24

Shtojcat e Rregullores

1.Kjo rregullore ka të bashkëngjitura dy shtojca:

1. Shtojca për ndarjen e zonave urbane, periferike dhe rurale të Kryeqytetit; dhe
 2. Shtojca për vlerat e lejuara të emisioneve të zhurmës.
2. Shtojcat e përcaktuar me këtë nen konsiderohen pjesë përbërëse të Rregullores dhe të njëjtat duhet të zbatohen nga organet e Kryeqytetit dhe nga subjektet afariste të sektorit të gastronomisë.

Neni 25

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
_____, më .2026

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në mbështetje të nenit 12, paragrafit 12.2, pika **d**, nenit 17, pika **o**, dhe nenit 40, paragrafit 40.2, pika **i**, të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 7, nenit 11 dhe nenit 24 të Ligjit nr. 04/L-071 për sistemin e adresave, të ndryshuar dhe plotësuar, Udhëzimit administrativ (MMPH), nr. 17/2019, për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime, listës rezervë dhe vendosjen e tyre në Regjistrin komunal të adresave, si dhe nenit 34, paragrafit 34.1, pika **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110-391, të datës 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 2026, merr këtë

V E N D I M

I.

Miratohet Vendimi për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet.

II.

Anëtarë të Komisionit, të cekur në pikën I të këtij vendimi, janë:

1. , anëtar;
2. , anëtar;
3. , anëtar;
4. , anëtar;
5. , anëtar;
6. , anëtar;
7. , anëtar;
8. , anëtar;
9. një anëtar nga Shoqatat e dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;
10. një anëtar nga Shoqëria civile;
11. një anëtar nga drejtoria përkatëse.

III.

Detyrë e Komisionit është bashkëpunimi me drejtoritë komunale, ku duhet të veprojnë në harmoni me dispozitat e Ligjit nr. 04/L – 071, për sistemin e adresave dhe rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet.

IV.

Pas përfundimit të punës së këtij komisioni, listat me emërtimet e propozuara paraqiten në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, të Ligjit nr. 03/ L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më .2026, merr këtë

V E N D I M

I.

MIRATOHET Raportit i komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në Komunën e Prishtinës, për periudhën janar-qershor 2026.

II.

Raporti i cekur në pikën I të këtij vendim, është hartuar nga Komisioni i caktuar nga Kryetari i Kryeqytetit me Vendimin nr. 14-020/04 – 13037/2 të datës 23.01.2026.

III.

Pjesë e këtij vendimi është Raporti i komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, janar-qershor 2026.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit dhe drejtritë e tjera përgjegjëse.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUES I KUVENDIT

Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality
of Prishtina

Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera

RAPORT PËRMBLEDHËS

Për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

1. Baza ligjore

Ky raport është hartuar në bazë të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dhe Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës për emërimin e Komisionit Komunal nr Nr. 14-020/04-13037/26 të datës:23.01.2026

2. Qëllimi i raportit

Ky raport paraqet përmbledhjen e procesit të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, që ka ndodhur gjatë periudhës **Janar – Qershor 2026**, si dhe rezultatet e vlerësimit të realizuar në teren nga Komisioni i nivelit lokal .

3. Aktivitetet e komisionit

Komisioni ka zhvilluar aktivitetet në vijim:

- Pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve/subjekteve të dëmtuara;
- Vizitat në teren për konstatimin e gjendjes faktike;
- Dokumentimin fotografik dhe evidentimin e dëmeve;
- Vlerësimin e dëmeve sipas metodologjisë së përcaktuar në Rregulloren (QRK) Nr. 17/2015;
- Përgatitjen e raporteve individuale të vlerësimit.

Vlerësimi financiar i dëmeve është kryer në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Rregulloren (QRK) Nr. 17/2015, duke u bazuar në çmimet referuese të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Për kategoritë e dëmeve për të cilat nuk janë përcaktuar çmime referuese nga ASK, janë përdorur çmimet mesatare të tregut, të verifikuara në periudhën e



vlerësimit, sipas llojit dhe karakteristikave të dëmit. Në të gjitha rastet është synuar që vlerësimi të pasqyrojë vlerën reale të dëmit në kohën e ndodhjes së fatkeqësisë.

4. Përmbledhja e dëmeve të evidentuara

Gjatë procesit të vlerësimit janë shqyrtuar gjithsej:

- Numri i kërkesave të pranuar: 46
- Numri i kërkesave të refuzuara: 15
- Numri i kërkesave të përsëritura: 1
- Numri i kërkesave të aprovuara për vlerësim: 30

Pasqyrë përmbledhëse



Kategoria e dëmit, numri i rasteve dhe vlera e dëmit (€)

- Bujqësi : 16 raste, vlerë e dëmit 30,803.56€
- Ekonomi Familjare: 11 raste, vlerë e dëmit 14,484.84€
- Të tjera (vetura): 3 raste, vlerë e dëmit 3,859.20€

6. Përfundimi

Bazuar në verifikimet e realizuara dhe raportet individuale të komisionit, vlera e përgjithshme e dëmeve të evidentuara arrin në vlerën : **49,147.60 €**

Komisioni:

1. Behar Krasniqi 
2. Adem Uka 
3. Afërdita Hasimi 
4. Skender Gashi 
5. Seniha Bajraktari 

Datë: 10.07.2026






Lista e vlerësimit të dëmeve në Bujqësi të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore në periudhën Janar - Qershorë 2026

Nr	Emri dhe mbiemri i fermerit	Adresa	Komuna	Nr. personal	Emri i bankes	Nr. i llogarisë bankare	Periodha e demit (muajt)	Shkaku i demitimit	Lloji i demit	Totali euro sipas raporteve nga komisioni
1	Leutrim Verbovci	Barilevë	Prishtinë	1232521810	ReiffeisenBank	1501120001325140	Janar	Vërshime	Bujqësi	325.08
2	Shemsi Shala	Prugoc	Prishtinë	1004189481	Banka Ekonomike	1401000013931028	Janar	Vërshime	Bujqësi	40.64
3	Hyssen Xhafoili	Prugoc	Prishtinë	1015255559	ReiffeisenBank	1501110004318706	Janar	Vërshime	Bujqësi	203.18
4	Muharrem Sinani	Barilevë	Prishtinë	1010151429	ReiffeisenBank	1501140000304990	Janar	Vërshime	Bujqësi	7.051.37
5	Rifat Leci	Bërnice e Poshtme	Prishtinë	1015147829	NLB Banka	1701003218739714	Janar	Vërshime	Bujqësi	3,111.00
6	Gani Verbovci	Barilevë	Prishtinë	1011452886	ReiffeisenBank	1501110003780065	Janar	Vërshime	Bujqësi	165.00
7	Hyssen Xhafoili	Prugoc	Prishtinë	1015255559	ReiffeisenBank	1501110004318706	Janar	Vërshime	Bujqësi	225.75
8	Shefki Berisha	Prugoc	Prishtinë	1015254773	NLB Banka	1701003015438147	Mars	Erërat e Forta	Bujqësi	858.00
9	Bekim Vërbovci	Barilevë	Prishtinë	2015253927	NLB Banka	1701003025614514	Janar	Vërshime	Bujqësi	146.74
10	Nexhat Krasniqi	Lukar	Prishtinë	1004917347	NLB Banka	1700100100632909	Prill	Erërat e Forta	Bujqësi	3,575.00
11	Halim Ruhani	Prapashicë	Prishtinë	1013891512	ReiffeisenBank	1501140001223483	Maj	Erërat e Forta	Bujqësi	4,210.00
12	Bukurie Ballu	Prapashicë	Prishtinë	1001051918	BKT	1904000244021112	Maj	Erërat e Forta	Bujqësi	1,782.80
13	Xhevat Mustafa	Rimanishitë	Prishtinë	1019638509	NLB Banka	1701018600216493	Maj	Erërat e Forta	Bujqësi	1,566.00
14	Bujar Shala	Barilevë	Prishtinë	2004006677	BPB	1300003016873039	Qershorë	Erërat e Forta	Bujqësi	1,113.00
15	Leutrim Verbovci	Prugoc	Prishtinë	1232521810	ReiffeisenBank	1501120001325140	Qershorë	Erërat e Forta	Bujqësi	5,715.00
16	Ardian Dragusha	Prugoc	Prishtinë	1011080649	TEB Bank	2011000083346611	Qershorë	Erërat e Forta	Bujqësi	715.00
Totali										30,803.56
Lista e vlerësimit të dëmeve në Bujqësi të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore në periudhën Janar - Qershorë 2026										
1	Basri Tashvci	Aziz Zhilivoda	Prishtinë	1231088039	TEB Bank	2033000223342895	Janar	Vërshime	Ekonomi Familjare	870.88
2	Durim Demiri	Aziz Zhilivoda	Prishtinë	1251061234	ReiffeisenBank	1501140001292450	Janar	Vërshime	Ekonomi Familjare	2,828.39
3	Ali Kaçuri	Prugoc	Prishtinë	2004008777	ProCreditBank	1110232062000123	Janar	Vërshime	Ekonomi Familjare	320.00
4	Feriz Gashi	Hajvali	Prishtinë	1030096831	TEB Bank	2033000189818434	Janar	Vërshime	Ekonomi Familjare	3,436.80
5	Fazile Ahmeti Kullovci	Prugoc	Prishtinë	1171437063	TEB Bank	2011000189497397	Janar	Vërshime	Ekonomi Familjare	291.59
6	Leonida Haskaj Morina	Emshir	Prishtinë	1173103421	NLB Banka	1700900103205697	Janar	Vërshime	Ekonomi Familjare	903.08
7	Ibrahim Hasimi	Fadi Sejdiu	Prishtinë	2000934227	ReiffeisenBank	1501150002285487	Janar	Vërshime	Ekonomi Familjare	728.50
8	Labinot Rexhepi	Dardani	Prishtinë	1173212786	NLB Banka	1701003030447151	Janar	Vërshime	Ekonomi Familjare	1,845.12
9	Admir Dushullovci	Faton Shabani	Prishtinë	1173757448	BKT	1902003607021106	Janar	Vërshime	Ekonomi Familjare	833.38
10	Daut Bilacaku	Bërnice e Epërme	Prishtinë	1014715688	Banka Ekonomike	1401000100928679	Janar	Vërshime	Ekonomi Familjare	1,400.00
11	Naser Berisha	Prugoc	Prishtinë	1004005569	BKT	1904630408321184	Janar	Vërshime	Ekonomi Familjare	1,027.10
Totali										14,484.84
Lista e vlerësimit të dëmeve në vetura të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore në periudhën Janar - Qershorë 2026										
1	Shefqet Berisha	Kodra e Trimave	Prishtinë	1000666904	NLB Banka	1701018800127091	Janar	Erërat e Forta	Vetura	400.00
2	Rina Zejnullahu	Barilevë	Prishtinë	1242375781	Banka Ekonomike	1401000014271110	Qershorë	Erërat e Forta	Vetura	260.00
3	Agron Blakaj	Mujo Ujqinaku	Prishtinë	1008834376	ReiffeisenBank	1501150004055931	Qershorë	Erërat e Forta	Vetura	3,199.20
Totali										3,859.20
Totali i dëmeve										49,147.60

Anëtarët e komisionit

- 1 Behar Krasniqi
- 2 Adem Uka
- 3 Afërdita Hasimi
- 4 Skender Gashi
- 5 Seniha Bajraktari

Kryetari i Komunes





Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-02/04-13037/26, më 23 JAN 2026

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/I -040, për Vetëqeverisje Lokale, neni 90 dhe 91 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, neni 8 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2, dhe neni 9 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera si dhe neni 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01.nr.110-391, të datës 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë:

VE N D I M

- I. Miratohet themelimi i Komisionit për vlerësim e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
- II. Anëtarët e Komisionit të cekur në pikën I të këtij vendimi janë:
 1. Behar Krasniqi, kryesues – Drejtoria e Bujqësisë.
 2. Adem Uka, anëtar – Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë.
 3. Afërdita Hasimi, anëtare, - Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.
 4. Skender Gashi, anëtar, - Drejtoria e Inspektionit.
 5. Seniha Bajraktari, anëtare – Drejtoria e Shërbimeve Publike.
- III. Sekretare e Komisionit caktohet Afërdita Hasimi e cila do të veprojë në përputhje me përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara sipas nenit 10, paragrafi 2 të Rregullores (QRK) – NR. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
- IV. Përgjegjësitë dhe detyrat e komisionit të cekur si në pikën II të këtij vendimi, janë:
 - 4.1. organizon numrin e nevojshëm të komisioneve profesionale për vlerësimin e dëmeve dhe përcakton zonën përkatëse për secilin komision. Në rastet e dëmeve të përmasave të vogla vlerësimin e dëmeve e kryen vetë komisioni lokal;
 - 4.2. cakton afatin deri kur duhet të kryhet vlerësimi i dëmeve;
 - 4.3. kujdeset për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje;
 - 4.4. bashkon punën e të gjitha komisioneve profesionale në territorin e komunës dhe ju ofron ndihmën e nevojshme profesionale;
 - 4.5. përpilon raportin përmbljedhës për dëmet e vlerësuara në territorin e komunës dhe ia dorëzon kryetarit të komunës për shqyrtim;

- 4.6. raportin e miratuar nga asambleja komunale ia dorëzon Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit dhe një kopje ia dorëzon komisionit qendror;
- 4.7. propozon prioritetet për shfrytëzimin e mjeteve të ndara për sanimin dhe mënjanimin e pasojave që kanë ndodh nga fatkeqësia dhe për këtë e njofton Kryetarin e Komunës dhe
- 4.8. mbanë evidencë për dëmet e shkaktuara në territorin e komunës.
- V. Mandati i komisionit të cekur sipas pikës II të këtij Vendimi, është katër (4) vjeçar.
- VI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi Nr. 14-020/04-67857/23, i datës 30.03.2023 dhe Vendimi nr. 14-020/04-108726/25 i dt. 25.07.2025.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

